VENDIME

TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

2025

VENDIMET PËRFUNDIMTARE
TË GJYKATËS KUSHTETUESE 2025

III

Volumi III

VENDIME
TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
2025

Vendime 55-85

Volumi III

© Botim i Gjykatës Kushtetuese
Tiranë, 2026

ISBN 9789928861580 (Set)
ISBN 9789928861610 (v. 3)

PRINTED AND BOUND IN ALBANIA BY ONUFRI

Rr. “Konferenca e Pezës”, Nr. 71, Kodi Postar 1027, Tiranë;
Tel & Fax 00355 42 220 017 / 270 399
www.onufri.com; E-mail: info@onufri.com

Përmbajtja

Vendim nr. 55, datë 10.10.2025 (V-55/25) 1331
Vendim nr. 56, datë 10.10.2025 (V-56/25) 1373
Vendim nr. 57, datë 14.10.2025 (V-57/25) 1391
Vendim nr. 58, datë 15.10.2025 (V-58/25) 1397
Vendim nr. 59, datë 16.10.2025 (V-59/25) 1442
Vendim nr. 60, datë 16.10.2025 (V-60/25) 1461
Vendim nr. 61, datë 21.10.2025 (V-61/25) 1513
Vendim nr. 62, datë 23.10.2025 (V-62/25) 1520
Vendim nr. 63, datë 23.10.2025 (V-63/25) 1539
Vendim nr. 64, datë 23.10.2025 (V-64/25) 1554
Vendim nr. 65, datë 24.10.2025 (V-65/25) 1577
Vendim nr. 66, datë 03.11.2025 (V-66/25) 1587
Vendim nr. 67, datë 05.11.2025 (V-67/25) 1634
Vendim nr. 68, datë 05.11.2025 (V-68/25) 1659
Vendim nr. 69, datë 06.11.2025 (V-69/25) 1683
Vendim nr. 70, datë 06.11.2025 (V-70/25) 1696
Vendim nr. 71, datë 12.11.2025 (V-71/25) 1708
Vendim nr. 72, datë 17.11.2025 (V-72/25) 1728
Vendim nr. 73, datë 19.11.2025 (V-73/25) 1734
Vendim nr. 74, datë 20.11.2025 (V-74/25) 1746
Vendim nr. 75, datë 20.11.2025 (V-75/25) 1760
Vendim nr. 76, datë 02.12.2025 (V-76/25) 1775
Vendim nr. 77, datë 02.12.2025 (V-77/25) 1795
Vendim nr. 78, datë 03.12.2025 (V-78/25) 1817
Vendim nr. 79, datë 12.12.2025 (V-79/25) 1835
Vendim nr. 80, datë 16.12.2025 (V-80/25) 1855
Vendim nr. 81, datë 16.12.2025 (V-81/25) 1872
Vendim nr. 82, datë 18.12.2025 (V-82/25) 1885
Vendim nr. 83, datë 18.12.2025 (V-83/25) 1904
Vendim nr. 84, datë 22.12.2025 (V-84/25) 1921
Vendim nr. 85, datë 23.12.2025 (V-85/25) 1941

Indeks i vendimeve të vitit 2025 1955

Vendim nr. 55, datë 10.10.2025
(V-55/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 19.06.2025, 16.09.2025 dhe 09.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KASTRIOT ISMAILAJ**, përfaqësuar nga avokat Arben Braçe, me prokurë të përgjithshme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2818, datë 25.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1231, datë 08.05.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1012, datë 30.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 31, shkronjat "d" dhe "ç", 32, pika 2, 33, pika 1, 34, 42, 122, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pikat 2 e 3 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar; Konventa e Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit"; nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000**

"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Kastriot Ismailaj (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 36871, datë 28.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shoqëria "Adriatic Development Corporation" Ltd. sh.p.k. *(shoqëria "ADC")* është njohur si person juridik, me ortak të vetëm e themelues të saj kërkuesin. Po kështu, në datën 05.07.2010 është themeluar shoqëria "Debt International Advisory" *(DIA)* me kapital prej 50 mijë USD dhe seli në Ishujt e Virgjër të Shteteve Britanike, me ortakë kërkuesin dhe shtetasin A.L., e cila në datën 02.08.2010 ka krijuar degë në Tiranë, ku kërkuesi është emëruar përfaqësues ligjor dhe është autorizuar për të realizuar procedurat e regjistrimit të kësaj dege në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit *(QKR)*. Në vijim, në datën 04.08.2010 shoqëria "Debt International Advisory - Dega Shqipëri" *(DIA, Dega Shqipëri)* është regjistruar në regjistrin tregtar, me objekt të veprimtarisë investime financiare, mbledhje detyrimesh, konsulta në fusha të ndryshme etj., me përfaqësues ligjor, deri në muajin dhjetor të vitit 2014, kërkuesin.

2. Në datën 01.09.2010 "DIA, Dega Shqipëri" dhe "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. *(OSSH)* kanë nënshkruar kontratën e porosisë "Marrëveshja e shërbimeve të mbledhjes së borxhit", sipas së cilës "DIA, Dega Shqipëri" do të mblidhte nga debitorët e OSSH-së, me mbështetjen dhe shpërblimin e kësaj të fundit, të gjitha borxhet dhe kamatat që kishin kaluar afatin prej 90 ditësh, duke përdorur mjete juridike të përshtatshme. Kjo kontratë është nënshkruar nga kërkuesi,

në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë "DIA, Dega Tiranë", kryetari i bordit drejtues të OSSH-së, J.H., e anëtari i këtij bordi, J.I., dhe është parashikuar të zgjasë për një afat 2-vjeçar. Duke qenë se sipas statutit të shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. *(CEZ)* miratimi i kontratave bëhej nga këshilli mbikëqyrës i saj, ky i fundit është mbledhur në datën 25.10.2010 për marrëveshjen në fjalë. Nënshkrimi i saj nuk është realizuar, për shkak se marrëveshja nuk përmbante bashkëlidhur anekset përkatëse, ndaj nuk mund të hidhej në votim. Në vijim, në datën 01.02.2011 mes palëve është nënshkruar një marrëveshje e dytë, me të njëjtin objekt dhe për një afat dyvjeçar, e cila është zgjidhur në muajin tetor të vitit 2011. Bazuar në këtë marrëveshje, një pjesë e punonjësve të shoqërisë "CEZ" i kanë kaluar shoqërisë "DIA, Dega Shqipëri".

3. Si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të krijuara mes palëve, në datën 23.01.2013 shoqëria "DIA, Dega Shqipëri" i është drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit me padi ndaj OSSH-së, duke kërkuar shpërblimin e dëmit, si pasojë e zgjidhjes së kontratës. Çështja rezulton të jetë zgjidhur me mirëkuptim mes palëve në datën 03.12.2014.

4. Po kështu, mbi bazën e informacioneve të përcjella nga sektori i krimit ekonomik dhe financiar i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, në vitet 2008 dhe 2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë *(Prokuroria e Tiranës)* ka regjistruar procedimet penale nr. 978 *(procedimi penal nr. 978/2008)* dhe nr. 963 *(procedimi penal nr. 963/2012)* në ngarkim të kërkuesit për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal *(KP)*, pasi dyshohej se përmes llogarive të shoqërive të krijuara e administruara prej tij kishte kryer transaksione financiare pa logjikë ekonomike, me burime të ardhurash të dyshuara nga aktivitete të paligjshme kriminale. Në përfundim të hetimeve Prokuroria e Tiranës ka vendosur pushimin e procedimeve penale në fjalë, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur shfuqizimin e këtyre vendimeve. Procedimet e sipërpërmendura janë bashkuar më pas me procedimin penal nr. 6381 të vitit 2014 *(procedim penal nr. 6381/2014),* të regjistruar nga Prokuroria e Tiranës në ngarkim të kërkuesit për kryerjen e veprave penale "Mashtrimi", më shumë se një herë, me pasoja të rënda e në bashkëpunim dhe "Pastrimi i produkteve të veprave penale", në bashkëpunim, më shumë se një herë, të parashikuara respektivisht nga nenet 143, paragrafi i dytë dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së. Në vijim, në datën 15.12.2015 prokuroria i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 6381/2014.

5. Po kështu, duke marrë shkas nga procedimi penal nr. 6381/2014, bazuar në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" *(ligji nr. 10192/2009)*, në datën 16.12.2014 Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin pasuror nr. 12 në ngarkim të kërkuesit dhe i është drejtuar në vijim Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me kërkesë për konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të disa pasurive në emër të tij, të së ëmës, bashkëshortes dhe shoqërisë "ADC". Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesës, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, për të cilin, me vendimin nr. 135, datë 02.12.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Ky proces është kundërshtuar më pas nga kërkuesi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*, e cila, me vendimin e datës 08.07.2025, ka vlerësuar se pretendimet e tij për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për shkak të përbërjes së trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, ishin të bazuara.

6. Për sa i takon çështjes penale, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 2818, datë 25.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka deklaruar kërkuesin fajtor për veprat penale "Mashtrimi", me pasoja të rënda në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i tretë, i KP-së dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së, i ndryshuar me ligjin nr. 9686 të datës 26.02.2007, si dhe dënimin e tij përfundimisht me 11 vjet burgim në bashkim të dënimeve. Gjykata ka vlerësuar se, në bashkëpunim me shtetasit J.H. dhe J.I., me veprime aktive të kundërligjshme dhe nëpërmjet mashtrimit kërkuesi kishte vjedhur shuma të mëdha, mbi 5.000.000 euro, në dëm të shoqërisë "CEZ" dhe shtetit shqiptar. Sipas gjykatës, lëshimi dhe përfitimi i faturave pa asnjë bazë kontraktuale ose ligjore dhe pa kryer punë reale, pagesa e faturave për mbledhjen e borxhit dhe identifikimin e debitorëve pa pasur formalisht kontratë të miratuar për këtë qëllim e për shërbim të njëjtë me atë të kryer nga vetë shoqëria "CEZ" (përmes projektit "Master Data Cleaning"), si dhe falsifikimi i dokumenteve me qëllim mbulimin e vjedhjes, tregonin për kryerjen e veprës penale të vjedhjes përmes mashtrimit, ndërsa, referuar jurisprudencës unifikuese të Gjykatës

së Lartë, dëmi i shkaktuar përbënte "pasojë të rëndë". Po kështu, kërkuesi kishte konsumuar edhe elementet e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", pasi nuk kishte arritur të paraqiste dokumente justifikuese për transfertat hyrëse dhe dalëse të shoqërisë "ADC", për të cilën të dhënat dhe provat indirekte (indiciet) tregonin se paratë e transferuara në llogaritë e saj rridhnin nga veprimtari të paligjshme kriminale. Krahas vendimit të dënimit, në bazë të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*, gjykata e rrethit ka vendosur edhe konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të provave materiale të sekuestruara me vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht të shumave 3.215.176 dollarë dhe 451.132 euro të sekuestruara pranë bankës "Credit Agricole" dhe 938.868 dollarë, 1.028 euro e 12.360.000 lekë të sekuestruara pranë bankës "Venetto" në llogarinë e shoqërisë "ADC". Në datën 08.11.2017 kërkuesi ka ankimuar vendimin e gjykatës së rrethit, ndërsa në datën 19.03.2018 ka paraqitur ankim shtesë.

7. Me vendimin nr. 1231, datë 08.05.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e çmuar të drejtë atë, me argumentin se nga faktet dhe provat direkte e indirekte të administruara gjatë gjykimit rezultonte e provuar fajësia e kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

8. Me vendimin nr. 00-2024-1012, datë 30.05.2024, të marrë në dhomën e këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar se cilësimi juridik i faktit në veprën penale "Mashtrimi", me pasoja të rënda dhe në bashkëpunim, ishte kryer nga gjykatat në përputhje me ligjin penal material e procedural dhe me të drejtë gjykatat e faktit e kishin konsideruar pasojë të rëndë dëmin e shkaktuar shoqërisë "CEZ". Po kështu, cilësimi i fakteve ishte kualifikuar drejt nga të dyja gjykatat edhe për sa u përket elementeve të veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së.

9. Në datën 25.11.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 24.02.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, ndërsa në datën 19.05.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje të një gjyqtareje kushtetuese.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

10.1. *Parimi ne bis in idem*, i garantuar nga neni 34 i Kushtetutës dhe *parimi i sigurisë juridike,* pasi (i) prokuroria nuk ka marrë parasysh vendimet e saj për pushimin e procedimeve penale nr. 978/2008 dhe nr. 963/2012, të cilat bazoheshin në të njëjtat informacione, të dhëna, fakte dhe ngjarje ndaj të njëjtit shtetas e operatori ekonomik si ato të procedimit penal nr. 6381/2014; (ii) vendimet e prokurorit më të lartë për shfuqizimin e vendimeve të pushimit të procedimeve penale nr. 978/2008 dhe nr. 963/2012 janë marrë në shkelje të neneve 4, pika 1, 15 e 42, pika 1, të Kushtetutës, nenit 24, pika 5, të KPP-së së kohës, si dhe vendimit unifikues nr. 4, datë 14.10.2002 *(vendim unifikues nr. 4/2002)* të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; (iii) ai është dënuar njëkohësisht si për veprën penale të mashtrimit, ashtu edhe atë të pastrimit të produkteve të veprës penale, ndonëse këto vepra konkurrojnë me njëra-tjetrën. Dënimi për veprat penale të mashtrimit dhe të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale është bërë në interpretim të gabuar të neneve 143, paragrafi i tretë, dhe 287 të KP-së, në cenim të *parimit të ligjshmërisë*. Sipas konventës së Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit" *(ETS nr. 198),* të ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 9646, datë 27.11.2006, subjekti i veprës penale kryesore nuk mund të jetë edhe subjekti i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale. Gjykata e rrethit ka ngatërruar konceptet ligjore të veprës penale të mashtrimit me atë të vjedhjes së pasurisë. Si për veprën penale me objekt aktivitetin ekonomik, ashtu edhe për pastrimin e produkteve të veprës penale, kjo gjykatë ka referuar në direktivë të Këshillit të Evropës, pa e cituar konkretisht atë.

10.2. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme,* e garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi:

10.2.1. Vendimet e gjykatave janë bazuar në dëshmi të personave lidhur me fakte dhe ngjarje të dëgjuara ose mësuara nga

persona të tretë, të panjohur prej tyre. Pyetja e dëshmitarit R.K., jurist e avokat mbrojtës i "DIA, Dega Shqipëri" dhe OSSHE-së në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar, është bërë në shkelje të ligjit për profesionin e avokatit, i cili ndalon pyetjen e avokatit për rrethana të mësuara gjatë ushtrimit të profesionit. Po kështu, në shkelje të nenit 156, pika 1, shkronja "ç", të KPP-së, gjykatat e faktit kanë marrë në konsideratë dëshminë e shtetasit A.S., i cili ishte në konflikt interesi me të, pasi e kishte kallëzuar 2 herë penalisht kërkuesin e ishte shpallur debitor nga "DIA, Dega Shqipëri" me vendim gjykate, si dhe dëshmitë e shtetasve O.K., S.H. e R.K., të cilët ishin në kushte papajtueshmërie. Duke qenë se në ankim kërkuesi kishte pretenduar shkelje të dispozitave procedurale për mënyrën e marrjes së provave, gjykata e apelit kishte detyrimin të përsëriste hetimin gjyqësor, duke urdhëruar paraqitjen në seancë të dëshmitarëve të kërkuar prej tij. Kjo gjykatë u ka dhënë vlerë të paracaktuar dëshmive të administruara në gjykatën e rrethit, duke ndërtuar skemë ngjarjeje të ndryshme nga aktet e administruara në dosje.

10.2.2. Ai nuk ka qenë i pranishëm në procedurën e sekuestrimit të akteve shkresore të datës 09.09.2015. Projekti i ashtuquajtur "Master Data Cleaning" nuk është marrë me procesverbal sekuestrimi dhe vendimi i prokurorit për sekuestrimin nuk ndodhet në fashikullin e gjykimit. Po kështu, *e-mail*-i bashkëshoqërues i dokumentit "P.&P.", i depozituar nga organi i prokurorisë në seancën e datës 23.09.2016 të gjykatës së rrethit, është fabrikuar. Gjykatat kanë vlerësuar si fiktiv dokumentin e përgatitur në gjuhën angleze nga DIA, duke marrë përsipër të bëjnë njëkohësisht rolin e përkthyesit e të ekspertit. Edhe pse dokumentacioni origjinal i sekuestruar në banesën e tij në datën 12.05.2025 provonte dhe u jepte përgjigje pyetjeve për krijimin e shumave monetare të sekuestruara e origjinën e tyre, ai nuk është marrë parasysh nga organi i akuzës dhe gjykatat. Dënimi i tij është bazuar në prova indirekte.

10.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës,* në drejtim të:

10.3.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi

(i) të 7-a kërkesat e tij për përjashtimin e trupit gjykues të gjykatës së rrethit janë rrëzuar nga trupa të tjerë gjykues të kësaj gjykate. Pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë parasysh nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. (ii) Gjyqtari i Gjykatës së Lartë I.P., që ka shqyrtuar rekursin e tij, ka qenë njëkohësisht edhe pjesë e trupit gjykues të kësaj gjykate që ka vendosur për konfiskimin e llogarive bankare të tij, të shoqërisë "ADC" dhe automjeteve në emër të tij. Ky gjyqtar duhet të kishte kërkuar dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, ashtu si dy gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate, dorëheqjet e të cilëve janë pranuar. (iii) Çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve dhe (iv) në një periudhë kohore prej 10 minutash.

10.3.2. *Së drejtës së aksesit,* pasi pavarësisht 35 kërkesave të tij për: vënien në dispozicion të kopjeve të akteve, marrjen e provave, deklarimin e njoftimit të dërguar nga një dëshmitar, shënimin në procesverbalin e seancës të deklarimit të bërë, revokimin e vendimit të ndërmjetëm, ekspertimin e dokumentit dhe ballafaqimin e dëshmitarëve, gjykata e rrethit nuk ia ka vënë ato në dispozicion dhe nuk i ka kthyer përgjigje.

10.3.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar,* pasi gjykatat kanë lejuar leximin e deklarimeve të shtetasit E.M., pa marrë parasysh pretendimet e kërkuesit për dëshminë e këtij shtetasi, kontradiktat në deklarimet e tij dhe pamundësinë e kërkuesit për t'u ballafaquar me të.

10.3.4. Së *drejtës për t'u mbrojtur*, të garantuar nga neni 31, shkronja "ç", i Kushtetutës, pasi gjykata e rrethit nuk ka shtyrë seancën gjyqësore, pavarësisht se kërkuesi ka qenë në pamundësi për të marrë pjesë personalisht për shkaqe shëndetësore ose të përfaqësohej përmes mbrojtësit të zgjedhur, i cili ishte angazhuar në tjetër proces gjyqësor. Ajo ka caktuar mbrojtëse kryesisht, D.Ç., ndaj së cilës kërkuesi kishte paraqitur kallëzim penal dhe kishte kërkuar heqjen e licencës, për shkak të mungesës së njohurive të saj për çështjen. Po kështu, në cenim të *së drejtës për të pasur kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes,* kjo gjykatë nuk ka marrë parasysh kundërshtimet e tij për caktimin kryesisht të avokates N.P., në kushtet kur ai kishte zgjedhur mbrojtës, ose

për pavlefshmërinë absolute të akteve në proces; kërkesat e mbrojtësve të zgjedhur për shtyrjen e seancës për paraqitjen e kërkimeve përfundimtare ose pretendimet e kërkuesit për pamundësinë objektive të pjesëmarrjes së tyre, në kushtet kur provohej se njëri mbrojtës ishte angazhuar në tjetër proces, ndërsa tjetri kishte depozituar raporte mjekësore, ose kundërshtimet e tij për caktimin kryesisht të mbrojtëses E.U.

10.3.5. *Së drejtës për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve në favor të tij*, pasi gjykata e rrethit nuk ka marrë masa për njoftimin e dëshmitarit kryesor E.M. në adresën tjetër në Shqipëri të dhënë prej tij, si dhe në adresën jashtë vendit të vënë në dispozicion nga mbrojtësit e kërkuesit. Ajo është mjaftuar me njoftimin e këtij dëshmitari në njërën prej adresave në Shqipëri, duke lejuar leximin në gjykim të deklarimeve të bëra nga ky shtetas, edhe pse ai kishte paraqitur deklaratë të shkruar, përmes së cilës shprehte gatishmërinë për të dëshmuar. Në zbatim të nenit 164 të KPP-së gjykatat duhej të kishin vendosur shoqërimin e detyrueshëm të këtij dëshmitari. Kërkesa e kërkuesit për ripërsëritjen e shqyrtimit gjyqësor për këtë qëllim është rrëzuar nga gjykata e apelit në kundërshtim me ligjin e provat dhe pretendimet e tij nuk janë marrë parasysh as nga Gjykata e Lartë. Po kështu, gjykatat e ulëta i kanë mohuar edhe të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët J.H., J.I., J.K. e R.G.G., si dhe për të ripyetur dëshmitarët S.H., O.K., A.S., M.Sh. e E.M. Pretendimet e tij në lidhje me pavlefshmërinë e njoftimeve të bëra dëshmitarëve J.K. e R.G.G. nuk janë marrë parasysh nga gjykatat.

10.3.6. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi:

10.3.6.1. Prokuroria e Tiranës nuk ka pranuar të marrë deklarimet e tij, ndonëse është paraqitur 4 herë para këtij organi për këtë qëllim, ndërkohë që është marrë në pyetje vetëm 1 herë. Po kështu, asnjë organ ose institucion nuk u ka kërkuar familjarëve të tij të vënë në dispozicion dokumente në lidhje me shoqëritë "ADC" dhe "DIA, Dega Shqipëri".

10.3.6.2. Gjykatat kanë mbajtur standarde të dyfishta për sa i përket pyetjes së dëshmitarëve, duke mos pranuar

për të dëshmuar dëshmitarët e mbrojtjes. Gjykata e rrethit nuk ka marrë parasysh kërkesat e tij të datave 18.10.2016 dhe 23.12.2016 për marrjen e provave të kërkuara paraprakisht, thirrjen e dëshmitarëve, subjekte debitore, dhe ballafaqimin e shtetasve S.H. e A.S. me dëshmitarin R.K. ose kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve të mbrojtjes E.M., E.N., M.Sh., E.L., P.A., A.B. dhe S.R., ndërsa ka vendosur revokimin e vendimit për thirrjen e dëshmitarëve S.R., P.A., E.L. dhe M.Sh., ndonëse ata ishin pranuar më parë si dëshmitarë, si dhe ka ndryshuar vendimin për pyetjen e dëshmitarëve T.S., A.H. dhe R.R. Po kështu, me vendim të ndërmjetëm të datës 17.03.2017, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për pyetjen e dëshmitarëve të tjerë, ish-punonjës të "DIA, Dega Shqipëri", të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me procesin penal në ngarkim të tij, ndërkohë që ka revokuar pa shkak vendimin për thirrjen e dëshmitares A.H. Gjykata e apelit ka rrëzuar kërkesën e tij për ripërsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Po kështu, kjo gjykatë dhe Gjykata e Lartë kanë rrëzuar ankimet e tij ndaj këtyre vendimeve të ndërmjetme.

10.3.6.3. Gjykata e rrethit nuk ka pranuar kërkesën e tij për marrjen e dokumenteve, në cilësinë e provave shkresore, që ndodheshin në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar. Argumentet e kësaj gjykate se këto dokumente mund të siguroheshin nga mbrojtja janë të pabazuara, pasi mbrojtja nuk mund t'i vinte ato në dispozicion, për shkak të natyrës konfidenciale të tyre. Kërkesa e tij për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen e dokumenteve nga gjykata e arbitrazhit nuk është pranuar nga gjykata e apelit, në cenim të nenit 8/a, paragrafi 2, të KPP-së, sipas të cilit organi procedues ka detyrimin të mbledhë edhe provat në favor të të pandehurit.

10.3.6.4. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e tij për pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit të ekspertëve kontabël dhe pavërtetësinë e gjetjeve të

tyre, në shkelje të parimit të *prezumimit të pafajësisë*, *së drejtës për t'u mbrojtur dhe për mbrojtje efektive*, *si dhe së drejtës për shqyrtim të plotë e efektiv të provave*. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë për marrjen në pyetje të ekspertit Sh.M. është i pavërtetë, pasi kërkuesi nuk është lejuar nga gjykata të marrë në pyetje këtë ekspert.

10.3.6.5. Gjykatat nuk kanë pranuar si provë studimin e realizuar nga shoqëria "D." për llogari të Entit Rregullator të Energjisë, raportet e përgatitura nga ekspertët e pavarur "M.", Francë dhe "M.S." ose prapësimet e shoqërisë "CEZ" drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar.

10.3.7. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi procesi penal ndaj tij ka filluar më 15.09.2014 dhe ka përfunduar më 30.05.2024, pasi ka shlyer dënimin me burgim prej 11 vjetësh.

10.3.8. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi:

10.3.8.1. (i) Në vendimin e ndërmjetëm të datës 03.05.2016 gjykata e rrethit nuk është shprehur për kërkesat e tij për thirrjen e dëshmitarëve të mbrojtjes E.M., E.N., M.Sh., E.L., P.A., A.B. e S.R., për të marrë transaksionet bankare të realizuara nga shoqëritë "DIA" ltd. e "ADC" e dokumentet shoqëruese të tyre, për njoftimin për media të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas të cilit kërkuesi është detyruar të tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar, si dhe për marrjen në shqyrtim të provave të paraqitura nga organi i akuzës, të cilat nuk duhej të ishin pjesë e fashikullit gjyqësor. (ii) Gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij për pavlefshmërinë e akteve në proces. Konkluzioni i kësaj gjykate për mungesën e dokumentacionit justifikues për transfertat hyrëse dhe dalëse të shoqërisë "ADC" është i pabazuar në prova. (iii) Gjykata e Lartë nuk ka analizuar pretendimet e tij për paligjshmërinë e marrjes së provave dhe mosmarrjen nga gjykatat më të ulëta të provave në favor të tij. Zbatimi dhe interpretimi i ligjit është bërë nga gjykatat në cenim të parimeve

dhe standardeve kushtetuese. (iv) Gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij për dokumentin e depozituar në gjuhën angleze nga organi i akuzës gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e rrethit. (v) Gjykata e Lartë ka arsyetuar për konfliktin e tij me disa nga dëshmitarët, ndërkohë që pretendimet e tij nuk ishin ngritur për shkak konflikti, por për shkak të marrjes së dëshmisë në kundërshtim me ligjin.

10.4. *Neni 14 i Kushtetutës* në lidhje me *të drejtën për përkthyes*, të parashikuar nga neni 31, shkronja "c", i Kushtetutës, pasi dokumenti "P.&P." i depozituar nga organi i prokurorisë në seancën e datës 23.09.2016 të gjykatës së rrethit ishte i përpiluar në gjuhën angleze, në kundërshtim me nenin 8 të KPP-së.

10.5. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor për një vepër penale e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj,* e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi në rastin e tij bëhej fjalë për zbatimin e një kontrate juridike civile, të lidhur rregullisht mes palëve. Faturat tatimore të lëshuara nga "DIA, Dega Shqipëri" janë hartuar në përputhje me marrëdhënien kontraktore mes saj dhe shoqërisë "CEZ". Gjykata e rrethit dhe ajo e apelit nuk kanë sqaruar pozitën procedurale të "DIA, Dega Shqipëri" dhe nuk kanë marrë parasysh parashikimet e ligjeve për tregtarët e shoqëritë tregtare dhe për përgjegjësinë penale të personave juridikë. Gjykatat nuk kanë përcaktuar shumën e pretenduar të përfituar padrejtësisht nga kërkuesi, dëmin ekonomik të shkaktuar dhe përfitimin e shoqërisë "CEZ" nga aktiviteti i "DIA, Dega Shqipëri". Gjykata e rrethit nuk ka marrë parasysh kërkesën e tij për kryerjen e ekspertimit për përcaktimin e dëmit ekonomik.

10.6. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi në njoftimin e bërë për shtyp në lidhje me çështjen, Prokuroria e Përgjithshme e ka deklaruar fajtor. Po kështu, gjykata e rrethit i ka kaluar atij barrën e provës për vënien e provave në dispozicion të saj dhe të ekspertëve. Si kjo gjykatë, ashtu edhe ajo e apelit janë nisur nga premisa se mungesa e justifikimit të burimit të të ardhurave çon automatikisht në kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale". Pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë parasysh as nga Gjykata e Lartë.

10.7. *E drejta për të mos u detyruar për të dëshmuar kundër vetes,* e garantuar nga neni 32, pika 1, i Kushtetutës.

11. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur nga mbrojtës pa prokurë. Po sipas këtij subjekti, kopja e kërkesës drejtuar Gjykatës është nënshkruar nga mbrojtësi dhe jo kërkuesi, ndërsa kopja e prokurës së përgjithshme bashkëlidhur kërkesës nuk përbën dokument ligjor përfaqësimi, sipas përcaktimeve të nenit 48, pika 2, të KPP-së, neneve 70 e vijues të Kodit Civil *(KC)* dhe neneve 62, 63, 99 e 101 të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" *(ligji nr. 110/2018)*.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Për sa i përket legjitimit *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet për këtë kriter, për shkak se ankimi kushtetues individual është paraqitur nga mbrojtës pa prokurë. Po sipas Prokurorisë së Përgjithshme, kopja e kërkesës drejtuar Gjykatës është nënshkruar nga mbrojtësi dhe jo kërkuesi, ndërsa kopja e prokurës së përgjithshme bashkëlidhur saj nuk përbën dokument ligjor përfaqësimi, sipas përcaktimeve të nenit 48, pika 2, të KPP-së, neneve 70 e vijues të KC-së dhe neneve 62, 63, 99 e 101 të ligjit nr. 110/2018. Kjo prokurë, e përkthyer në gjuhën shqipe nga akti "Prokurë e përgjithshme"

në gjuhën maqedonase, nuk përmban nënshkrimin e kërkuesit. Ndërsa, sipas kërkuesit, prokura e depozituar me ankimin kushtetues individual është në përputhje me kërkesat ligjore, Konventën e Hagës të vitit 1961 dhe jurisprudencën shqiptare e atë ndërkombëtare. Pretendimet e organit të akuzës përbëjnë veprim procedural për shmangien e thelbit të kontrollit kushtetues.

14. Gjykata vëren se ankimi kushtetues individual është nënshkruar nga mbrojtësi i kërkuesit dhe atij i është bashkëlidhur kopje e përkthyer në gjuhën maqedonase e prokurës së përgjithshme të datës 30.04.2024, përmes së cilës kërkuesi ka autorizuar për përfaqësim avokatin Arben Braçe. Në mungesë të kopjes origjinale ose të noterizuar të kësaj prokure, në seancën e datës 19.06.2025 Gjykata ka shtyrë gjykimin e çështjes, duke çmuar të domosdoshëm për vijimin e shqyrtimit kushtetues plotësimin nga kërkuesi të aktit të përfaqësimit. Në datën 28.07.2025 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë kopjen në gjuhën shqipe të prokurës së përgjithshme të datës 30.04.2024, si dhe aktet noteriale të përpiluara në Vjenë në datën 24.06.2025 për konfirmimin e autorizimit të dhënë avokatit Arben Braçe me prokurën e datës 30.04.2024, emërimin e tij si përfaqësues ligjor në gjykimin kushtetues dhe dijeninë e kërkuesit për veprimet e kryera nga ky mbrojtës. Gjykata vë në dukje, gjithashtu, se pas depozitimit të këtyre akteve Prokuroria e Përgjithshme nuk ka paraqitur prapësime të mëtejshme për çështjen. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se kërkesa përmbush kriteret formale, të parashikuara nga neni 27, pika 2, shkronja "ë", të Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual e ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive,* që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, sipas të cilit individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë *(shih vendimet nr. 61, datë 19.09.2024; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* për shkak se është marrë në pyetje vetëm një herë nga organi i ndjekjes penale dhe organet shtetërore nuk u kanë kërkuar familjarëve të tij të paraqesin argumente, si dhe të *së drejtës për të mos u detyruar për të dëshmuar kundër vetes*, pretendime të cilat nuk i ka parashtruar më parë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke mos shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Në këto rrethana, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak të kohëzgjatjes së procesit penal në ngarkim të tij rreth 10 vjet. Për sa i takon këtij pretendimi, Gjykata sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", sipas të cilave, individët kanë dispozicion mjetin juridik të kërkesës që u drejtohet gjykatave të zakonshme për përshpejtimin e procedurave dhe konstatimin e shkeljes (nenet 399/1 e vijues të KPC-së). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret *(shih vendimet nr. 11, datë 28.02.2024; nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues ndonjë akt që të provojë se ka përdorur mjetet ligjore që ka pasur në dispozicion, për rrjedhojë çmon se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis* të kërkuesit*,* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, Gjykata

vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 30.05.2024 dhe i është komunikuar kërkuesit në rrugë elektronike në datën 26.07.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 25.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

21. Po në kuadër të këtij kriteri, Gjykata evidenton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, për shkak se: dokumenti "Raporti i Identifikimit të Debitorëve", i administruar si provë në seancën gjyqësore të datës 09.12.2016, është i rremë e i falsifikuar; shkresa përcjellëse e këtij raporti, e depozituar nga prokuroria në gjykatë, nuk është ajo e dorëzuar nga DIA; përkthimi i këtij raporti, i depozituar nga prokuroria në seancën e datës 23.09.2016 të gjykatës së rrethit, ka qenë i pasaktë, me deformime dhe shtrembërime të fjalëve, duke u ndryshuar atyre kuptimin dhe duke i dhënë faktit tjetër kuptim. Gjykata vëren se këto pretendime janë parashtruar nga kërkuesi si shkaqe të reja në parashtrimet e tij të datës 06.03.2025, pra pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Duke pasur parasysh qëndrimin e saj në çështje të ngjashme *(shih vendimet nr. 21, datë 22.04.2025; nr. 4, datë 21.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim, pasi janë paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

22. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit ne bis in idem, parimit të sigurisë juridike, parimit të ligjshmërisë, së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, së drejtës për proces të rregullt ligjor* (në disa aspekte), *së drejtës për përkthyes, së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një vepër penale e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj* dhe *parimit të prezumimit të pafajësisë*.

23. Për sa i takon *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, kërkuesi ka parashtruar se gjykata e apelit ka ndërtuar skemë ngjarjeje të ndryshme nga aktet e administruara në dosje, dhe se gjykatat kanë vlerësuar si fiktiv dokumentin e përgatitur në gjuhën angleze nga DIA. Ndërsa në lidhje me *të drejtën për proces të rregullt ligjor,* ai ka pretenduar se i është cenuar në aspekt të: *i) së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, për shkak se gjykata e rrethit ka refuzuar në shumë raste pyetjet e adresuara prej tij dëshmitarëve dhe nuk ka pranuar kërkesat e tij për thirrjen e ballafaqimin e disa dëshmitarëve; *ii) së drejtës për t'u dëgjuar*, për shkak se gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e tij për dëshminë e shtetasit E.M.

dhe deklarimet kontradiktore të këtij shtetasi; *iii) parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, *së drejtës për t'u mbrojtur dhe për mbrojtje efektive* e *së drejtës për shqyrtim të plotë dhe efektiv të provave,* për shkak se gjykatat nuk kanë pranuar si provë studimin e realizuar nga shoqëria "D." për llogari të Entit Rregullator të Energjisë, raportet e përgatitura nga ekspertët e pavarur "M.", Francë dhe "M.S." ose prapësimet e shoqërisë "CEZ" drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit; *v) standardit të arsyetimit të vendimit* gjyqësor, për shkak se konkluzioni i gjykatës së apelit për mungesën e dokumentacionit justifikues për transfertat hyrëse dhe dalëse të shoqërisë "ADC" është i pabazuar në prova; *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një vepër penale e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj*, pasi gjykata e rrethit nuk ka marrë parasysh kërkesën e tij për kryerjen e ekspertimit për përcaktimin e dëmit ekonomik. Gjykata vë në dukje se këto pretendime kanë të bëjnë, në thelb, me vlerësimin e fakteve dhe provave nga gjykatat e zakonshme, ndaj si të tilla nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

24. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar cenimin së drejtës për proces të rregullt në aspekt të *barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, për shkak se gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e tij për pavlefshmërinë dhe pavërtetësinë e gjetjeve të aktit të ekspertimit. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se akti i ekspertimit është një provë shkencore që edhe pse mbart në vetvete shumë avantazhe, për gjykatën do të mbetet një provë si gjithë llojet e tjera të provave që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e çmojnë atë *(shih vendimin nr. 45, datë 23.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit parashtrohen në kuadër të gjetjeve të këtij akti, konkretisht vërtetësisë të konkluzioneve të nxjerra në të, si dhe vlerësimit të tij nga gjykatat e zakonshme. Në lidhje me to, Gjykata konstaton se përgjatë procesit gjyqësor kërkuesit i është dhënë mundësia që, në kushte të barabarta me organin e ndjekjes penale, të kundërshtojë gjetjet e aktit të ekspertimit, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të argumenteve të tij. Pretendimet e tij për konkluzionet e këtij akti janë vlerësuar nga gjykatat e faktit në raport me provat e tjera të administruara gjatë gjykimit dhe gjykatat kanë dhënë përgjigje të argumentuara për shkaqet e rrëzimit të tyre. Në këtë situatë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për shkak të pavlefshmërisë dhe pavërtetësisë së gjetjeve të aktit të ekspertimit, janë haptazi të pabazuara.

25. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, duke parashtruar si argumente se gjykata e rrethit i ka kaluar atij barrën për vënien e provave në dispozicion të saj dhe të ekspertëve. Kjo gjykatë dhe gjykata e apelit janë nisur nga premisa se mungesa e justifikimit të burimit të të ardhurave çon automatikisht në kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh pretendimet e tij në këtë drejtim.

26. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë nënkupton se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, barra e provës i takon palës akuzuese, çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza *(shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 14, datë 03.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vëren se, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet e tyre për deklarimin e tij fajtor mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, përfshirë ato për të ardhurat e fituara nga shoqëritë "ADC" dhe "DIA", ku kërkuesi ka qenë ortak. Në analizë të fakteve të rezultuara gjatë gjykimit përkundrejt provave të administruara, gjykatat kanë arritur në përfundimin se fajësia e kërkuesit provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke arsyetuar për shkaqet mbi të cilat kanë bazuar vendimmarrjet e tyre. Ndërsa, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykata e apelit për pretendimet e tij për cenimin e prezumimit të pafajësisë. Në analizë të këtyre vendimmarrjeve nuk rezulton që gjykatat të kenë filluar procesin me bindjen se kërkuesi ka kryer veprat penale, të kenë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi ose të kenë nxjerrë konkluzione të paarsyeshme në lidhje me provat. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë janë haptazi të pabazuara.

28. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *parimit ne bis in idem* dhe *parimit të sigurisë juridike*, duke parashtruar tri argumente *(shih paragrafin 10.1. të vendimit)*. Në jurisprudencën e saj në lidhje me parimin *ne bis in idem*, Gjykata ka theksuar se ideja e këtij parimi nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit

për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar ose liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm *(shih vendimet nr. 11, datë 13.03.2025; nr. 8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

29. Për sa u përket dy argumenteve të para për cenimin e parimit *ne bis in idem*, që kanë të bëjnë me mosmarrjen parasysh nga organi i akuzës të vendimeve të tij të mëparshme për pushimin e procedimeve penale në ngarkim të kërkuesit (i) dhe vendimmarrjet e prokurorit më të lartë për shfuqizimin e vendimeve të prokurorëve më të ulët për pushimin e çështjeve (ii), Gjykata vëren se ato mbështeten në faktin e bashkimit të procedimit penal nr. 6381/2014 me procedimet penale nr. 978/2008 dhe nr. 963/2012, të cilat ishin pushuar me vendim të prokurorit. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes penale nuk përbën vendim përfundimtar të formës së prerë të dhënë nga një gjykatë e caktuar me ligj për qëllime të zbatimit të parimit *ne bis in idem*, të garantuar nga neni 34 i Kushtetutës *(shih vendimin nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata çmon se këto argumente të kërkuesit nuk gjejnë mbështetje në aspektin kushtetues, për sa kohë që parimi *ne bis in idem* vendos ndalimin për gjykimin/dënimin dy herë me vendim gjyqësor dhe jo me vendim të prokurorit.

30. Në lidhje me argumentin e tretë, që ka të bëjë me dënimin e kërkuesit njëkohësisht si për veprën penale të mashtrimit, ashtu edhe atë të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe arsyetimin e gjykatës së rrethit në këtë drejtim (iii), Gjykata vëren se për sa u përket veprimeve që do të konsiderohen pastrim parash dhe veprës kryesore (mëmë), gjykata e rrethit, duke vënë në dukje se direktivat e ETS-së nr. 198 ishin në përputhje me nenin 9 të kësaj konvente, ka vlerësuar se sipas praktikës gjyqësore konsiderohet veprim i dënueshëm, në kuptim të nenit 287 të KP-së, pastrimi jo vetëm i produkteve të veprës penale, por dhe i çdo veprimtarie kriminale, edhe në rastin kur nuk është filluar asnjëherë çështja penale ose nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë *(shih faqet 106-107 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*, qëndrim ky i vlerësuar i drejtë në thelb nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, në interpretim të ETS-së nr. 198 dhe Konventës Evropiane për

Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit *(ETS nr. 141)*, të ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8646, datë 20.07.2000, ka theksuar se vepra penale kryesore prej së cilës burojnë produktet ose pasuritë kriminale është e mëvetësishme nga vepra penale e pastrimit të këtyre produkteve dhe se subjekti i kryerjes së veprës penale kryesore mund të jetë njëherazi edhe subjekti i kryerjes së veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, por ky i fundit jo detyrimisht duhet të jetë autori i veprës penale kryesore *(shih faqen 31, paragrafi 75, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

31. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme, Gjykata vëren se në vendimin e saj gjykata e rrethit ka vënë në dukje direktivat e ETS-së nr. 198, duke iu referuar për këtë qëllim parashikimeve të kësaj konvente. Pretendimet e kërkuesit për përcaktimet e këtij akti ndërkombëtar janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për shkaqet e rrëzimit të tyre. Në analizë të vendimeve të gjykatave të zakonshme përkundrejt parashikimeve të konventave në fjalë, Gjykata vë në dukje se neni 9, pika 2, shkronja "b", i ETS-së nr. 198 dhe neni 6, pika 2, shkronja "b", i ETS nr. 141 parashikojnë se për qëllime të zbatimit të paragrafëve 1 të këtyre neneve (vepra penale e pastrimit), shteti *mund* të parashikojë se veprat penale të shpallura nga këta paragrafë nuk zbatohen ndaj autorëve të veprës penale kryesore (që ka gjeneruar produktet e veprës penale të pastrimit), duke njohur në këtë mënyrë diskrecionin e shtetit për të vendosur dënimin e individit vetëm për njërën prej veprave penale. Në këto kushte, duke pasur parasysh rregullimet normuese të dy konventave të Këshillit të Evropës, si dhe faktin se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuara nga gjykatat për sa i përket dënimit për të dyja veprat penale për të cilat është akuzuar, Gjykata çmon se pretendimet e tij për cenimin e parimit *ne bis in idem* dhe *parimit të ligjshmërisë,* për shkak të parashikimeve të ETC-së nr. 198 dhe referimit të gabuar nga gjykata e rrethit në direktivën e Këshillit të Evropës, janë haptazi të pabazuara.

32. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga në gjykatë e paanshme*, duke parashtruar katër argumente *(shih paragrafin 10.3.1. të vendimit)*. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, ka në vetvete elementin *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv,* me të cilin kuptohet dhënia

e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Sipas Gjykatës, kjo e drejtë merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv *(shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

33. Për sa i përket argumentit të parë për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, mospranimit nga gjykata e rrethit të kërkesave të tij për përjashtimin e trupit gjykues të kësaj gjykate *(i)*, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se gjatë gjykimit të çështjes në atë gjykatë kërkuesi ka paraqitur disa kërkesa për përjashtimin e gjyqtares relatore, duke parashtruar si shkak mohimin nga kjo gjyqtare të të drejtave të tij. Po kështu, ai ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve të tjerë të trupit gjykues të gjykatës së rrethit, me argumentin se nuk kishin pranuar kërkesat procedurale të tij ose të mbrojtësve të tij. Këto kërkesa janë shqyrtuar nga gjyqtarë të tjerë të kësaj gjykate, të cilët në përfundim kanë vendosur rrëzimin e tyre, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në to nuk ishin nga ato të parashikuara në nenet 18-19 të KPP-së. Qëndrimi i gjykatës së rrethit është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit *(shih faqen 37 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)* dhe më pas nga Gjykata e Lartë *(shih faqen 26, paragrafi 61, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*. Në analizë të këtyre vendimmarrjeve, Gjykata vëren se kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat e zakonshme për shkaqet e rrëzimit të pretendimeve për njëanshmërinë e gjyqtarëve të trupit gjykues të gjykatës së rrethit. Në vlerësimin e Gjykatës, arsyetimet e gjykatave nuk rezultojnë në kundërshtim me parimin e paanshmërisë së gjyqtarit, në drejtim të testit objektiv dhe subjektiv të përcaktuar nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto pretendime janë haptazi të pabazuara.

34. Për sa i takon argumentit të dytë, i cili parashtrohet në drejtim të pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar si në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar procesin e konfiskimit të pasurive, ashtu edhe në trupin gjykues të kësaj gjykate që ka shqyrtuar procesin penal në ngarkim të tij *(ii)*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në trupin gjykues që ka gjykuar çështjen e sekuestrimit të pasurisë në kuadrin e një procedimi parandalues bazuar në dyshimin dhe prezumimin për zotërimin e prejardhjen e paligjshme të pasurisë, si dhe

në trupin gjykues që ka vendosur për çështjen penale, nuk përbën shkak që çon domosdoshmërish në anësinë e gjyqtarit në fjalë në vlerësimin e veprave penale për të cilat kërkuesi është akuzuar. Nëse ka dyshime për paanshmërinë e gjyqtarit, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por nuk është vendimtar. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet se është objektivisht e justifikueshme. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson nëse ka fakte të vërtetueshme, të cilat mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e gjyqtarit *(shih vendimin nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

35. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vëren se në procesin e konfiskimit të pasurive gjykatat e faktit kanë konkluduar se kërkuesi nuk justifikonte burimet e ligjshme të pasurive të tij, vendime të cilat janë vlerësuar të drejta në vijim nga Gjykata e Lartë, në përbërje të trupit gjykues të së cilës ka qenë edhe gjyqtari për të cilin kërkuesi ka pretenduar njëanshmërinë. Në atë proces çështjet ligjore të vëna në diskutim nga Gjykata e Lartë kishin të bënin, në thelb, me të drejtën e pronës dhe kufizimin e saj sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10192/2009. Ndërsa, në çështjen në shqyrtim, trupi gjykues i Gjykatës së Lartë ka analizuar vendimmarrjen e gjykatave të faktit për të përcaktuar nëse akuzat ndaj kërkuesit janë provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për këtë qëllim, Gjykata e Lartë ka analizuar mënyrën e marrjes së provave, si dhe elementet e figurave të veprave penale për të cilat kërkuesi është akuzuar, duke konkluduar se vendimet e gjykatave të zakonshme ishin marrë në zbatim të drejtë të ligjit penal procedural e material. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se çështjet ligjore të vëna në diskutim nga Gjykata e Lartë në procesin objekt ankimi kushtetues individual nuk kanë qenë të njëjta me ato të ngritura gjatë procesit të konfiskimit, duke pasur këto procese, në thelb, natyra të ndryshme. Në këtë situatë, Gjykata çmon se dyshimet e kërkuesit për njëanshmërinë e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, si rrjedhojë e pjesëmarrjes në trupin gjykues të saj që ka shqyrtuar edhe procesin për konfiskimin e pasurive të tij, nuk rezultojnë objektivisht të justifikuara, për rrjedhojë janë haptazi të pabazuara.

36. Për sa i përket argumentit të tretë, që ka të bëjë me gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e kështillimit (ii), Gjykata vëren se kjo formë gjykimi parashikohet nga neni 436/a i KPP-së. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se veprimtaria seleksionuese e dhomës së kështillimit në Gjykatën e Lartë është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon

ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 27, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të kërkuesit, në të cilin ka parashtruar shkaqet për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të faktit. Në përputhje me kompetencat ligjore dhe rregullat procedurale, çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, e cila në përfundim ka vendosur mospranimin e rekursit. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë në këndvështrimin kushtetues sesi gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë ka ndikuar në të drejtën e tij për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

37. Për sa i përket argumentit të katërt, kohëzgjatjes së shkurtër të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë *(iv)*, përveç faktit që ky argument mbështetet në hamendësime të paprovuara nga kërkuesi, Gjykata sjell në vëmendje se në procedurën e shqyrtimit të rekursit këshilltari dhe gjyqtari relator kryejnë paraprakisht veprimet përgatitore të nevojshme dhe përgatisin materialet për çështjen, të cilat u shpërndahen më pas gjyqtarëve të tjerë të kolegjit përkatës përpara datës së shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Kjo mënyrë organizimi siguron që anëtarët e trupit gjykues të njihen me përmbajtjen e çështjes dhe argumentet përkatëse të parashtruara në rekurs që në fazën paraprake të shqyrtimit të tij. Duke mbajtur në konsideratë këtë fakt, si dhe jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës periudha e shkurtër e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përbën argument që të provojë pretendimin për cenimin e paanshmërisë në kuptimin subjektiv *(shih vendimin nr. 30 datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*, Gjykata çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

38. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit*, për shkak se gjykata e rrethit nuk i ka vënë në dispozicion materialet e kërkuara me shkresa zyrtare dhe nuk u ka kthyer përgjigje kërkesave të tij. Në analizë të këtij pretendimi, Gjykata konstaton se ai parashtrohet në drejtim të mosmarrjes përgjigje nga gjykata për kërkesat e tij për vënien në dispozicion të akteve. Në këtë drejtim, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues,

Gjykata konstaton se, në kundërshtim nga sa pretendohet, ndërsa disa nga materialet e kërkuara janë vënë në dispozicion të kërkuesit gjatë gjykimit, gjykata e rrethit e ka informuar atë edhe për të drejtën për t'u konsultuar çdo ditë, pas orës 14:30, me aktet e dosjes gjyqësore *(shih procesverbalet e seancave të datave 23.09.2016, 07.10.2016 dhe 22.11.2016, faqet 90, 107 dhe 116, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*. Veprimet e kryera nga kjo gjykatë janë vlerësuar të drejta nga gjykata e apelit, e cila ka vënë në dukje se gjatë gjykimit kërkuesit i është dhënë mundësia të njihet me çdo akt të kërkuar e të marrë si provë në gjykim *(shih faqen 37 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)*, qëndrim ky i gjetur i drejtë në thelb nga Gjykata e Lartë *(shih faqen 26, paragrafi 61, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

39. Në analizë të fakteve kushtetuese përkundrejt qëndrimit të gjykatave të zakonshme, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit, si rrjedhojë e mosvënies në dispozicion nga gjykata e rrethit të materialeve të kërkuara me shkresa zyrtare, është haptazi i pabazuar.

40. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar cenimin nga gjykatat e zakonshme *të së drejtës për t'u dëgjuar, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve*, si dhe të *standardit të arsyetimit gjyqësor,* duke parashtruar si shkaqe se gjykata e rrethit nuk ka pranuar kërkesat e tij për thirrjen e disa dëshmitarëve, nuk ka arsyetuar për to, ka revokuar vendimet e saj të mëparshme për thirrjen e disa prej tyre, kjo gjykatë dhe gjykata e apelit nuk kanë marrë parasysh kërkesat e tij për thirrjen në gjykim të dëshmitarëve të mbrojtjes e dëshmitarëve të tjerë ose pretendimet e tij për deklarimet e dëshmitarit E.M., ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e tij në këtë drejtim. Për sa u përket këtyre pretendimeve, duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Gjykata vëren se ato parashtrohen në drejtim të së drejtës për të kërkuar paraqitjen në gjykim të dëshmitarëve, të cilat do t'i analizojë më tej në vijim.

41. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme* dhe *parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit,* për shkak se gjykata e apelit nuk ka përsëritur hetimin gjyqësor e nuk ka pranuar kërkesat e tij për thirrjen e dëshmitarëve e për marrjen e dokumenteve nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit.

42. Gjykata vëren se neni 427, pika 1, i KPP-së, sipas përmbajtjes së kohës, ka parashikuar se kur një palë në aktin e apelit ose plotësimin e tij kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së

parë ose marrjen e provave të reja, gjykata, në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin gjyqësor.

43. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe, në lidhje me to, ka vënë në dukje se, referuar nenit 427 të KPP-së, riçelja e shqyrtimit gjyqësor ishte në diskrecionin e saj e vendosej kur ishte e pamundur për të konkluduar për akuzën, autorësinë e fajësinë bazuar në provat e marra në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë. Kërkesa e kërkuesit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor nuk bazohej në nevojën për marrjen e provave të reja, por synonte rimarrjen e provave të cilat ishin administruar në shkallë të parë dhe të atyre që, për shkak të pengesave ligjore, nuk kishin mundur të merreshin në atë fazë ose të administroheshin në apel, por që në çdo rast rezultonin jorelevante për provimin e faktit penal, të autorësisë ose fajësisë së të pandehurit *(shih faqet 35-36 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)*. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja nuk evokonin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, ndaj nuk përbënin shkak për cenimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe kërkuesi kishte marrë përgjigje të arsyetuar për to nga ajo gjykatë *(shih faqet 21, paragrafi 49, dhe 24, paragrafi 55, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

44. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se arsyetimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton arbitrar nga pikëpamja kushtetuese. Në këtë drejtim, Gjykata vë në dukje se, ashtu siç kanë arsyetuar gjykatat e zakonshme, neni 427, pika 1, i KPP-së nuk detyron gjykatën e apelit të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe vlerësimi për këtë ngelet në diskrecionin e asaj gjykate. Për rrjedhojë, çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit, për shkak të mospërsëritjes së hetimit gjyqësor nga gjykata e apelit, mospranimit prej saj të kërkesave të kërkuesit për thirrjen e dëshmitarëve e për marrjen e dokumenteve nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit, është haptazi i pabazuar.

45. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për përkthyes*, me argumentin se dokumenti "P.&P.", i depozituar nga organi i prokurorisë në seancën e datës 23.09.2016 të gjykatës së rrethit, ishte i përpiluar në gjuhë të huaj. Me të njëjtin argument kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin nga gjykatat të *standardit të arsyetimit të*

vendimit gjyqësor, si rrjedhojë e mosdhënies përgjigje nga gjykatat në këtë drejtim. Gjykata vëren se, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, me vendimin e datës 14.09.2016 organi i prokurorisë ka vendosur caktimin e përkthyeses për përkthimin e materialit në fjalë. Materiali i përkthyer është administruar në dosjen hetimore, e cila është bërë më pas pjesë e dosjes gjyqësore dhe kërkuesi ka pasur mundësinë të njihet me përmbajtjen e të paraqesë argumente për kundërshtimin e tij. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për përkthyes dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor për këtë shkak janë haptazi të pabazuara.

46. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, *së drejtës për t'u mbrojtur, parimit të prezumimit të pafajësisë dhe së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një vepër penale e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj,* duke parashtruar të tjera shkaqe. Bazuar në natyrën e thelbin e këtyre pretendimeve dhe argumentet e parashtruara në mbështetje të tyre, Gjykata në vijim do të analizojë bazueshmërinë e tyre në themel. Po kështu, Gjykata do të shqyrtojë në themel edhe pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës për të kërkuar paraqitjen në gjykim të dëshmitarëve*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

47. Kërkuesi ka pretenduar se *(i)* dëshmitarët A.S., S.H. e O.K. kanë qenë në gjendje papajtueshmërie dhe konflikti interesi me të, sipas nenit 156, pika 1, shkronja "ç", të KPP-së; *(ii)* dëshmitari R.K. ka qenë në gjendje papajtueshmërie, si jurist dhe avokat i "DIA, Dega Shqipëri" e OSSHE-së në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar; *(iii)* kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm në procedurën e sekuestrimit të akteve shkresore të datës 09.09.2015; *(iv)* projekti i ashtuquajtur "Master Data Cleaning" nuk është marrë me procesverbal sekuestrimi dhe vendimi i prokurorit për sekuestrimin nuk ndodhet në fashikullin e gjykimit; *(v) e-mail*-i bashkëshoqërues i dokumentit "P.&P.", i depozituar në seancë gjyqësore nga organi i prokurorisë, është fabrikuar.

48. Sipas nenit 32, pika 2, të Kushtetutës askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se mënyra e marrjes së provave

ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nënkupton që procesi ka qenë i parregullt *(shih vendimin nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po sipas Gjykatës, ndërsa vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia provuese e provave në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, detyrë e saj është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, Gjykata kontrollon nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe verifikon në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 49, datë 29.09.2014; nr. 47, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

49. Gjykata vëren se llojet e provave dhe mënyrat e marrjes së tyre rregullohen posaçërisht nga ligji procedural penal. Neni 149 i KPP-së përcakton kuptimin e provës, neni 150 objektin e provave, ndërsa neni 151 mënyrën e marrjes së tyre. Sipas nenit 151 të KPP-së, gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë kod *(pika 1)*, kurse në gjykim ato merren me kërkesën e palëve dhe gjykata vendos me urdhër, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme *(pika 2)*, ndërkohë që provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren, ndërsa papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit *(pika 4)*.

50. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të analizojë në vijim nëse provat mbi të cilat gjykatat e zakonshme kanë bazuar vendimmarrjet e tyre janë marrë në përputhje me dispozitat e KPP-së, si dhe nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e për të kundërshtuar përdorimin e tyre, në respektim të së drejtës së tij të mbrojtjes.

51. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar paligjshmërinë e marrjes së dëshmive të dëshmitarëve A.S., S.H. e O.K. (i), bazuar në faktin se këta persona kanë qenë debitorë ndaj shoqërisë "DIA, Dega Shqipëri" dhe kjo shoqëri ka iniciuar ndaj tyre procese civile për kthimin e shumave. Për sa i përket shtetasit A.S. kërkuesi ka pretenduar paligjshmërinë e marrjes së dëshmisë së tij edhe për shkak të konfliktit të

interesit, si rrjedhojë e kallëzimit penal të bërë nga ky shtetas ndaj kërkuesit. Sipas kërkuesit, dëshmia e këtyre dëshmitarëve në procesin penal binte në kundërshtim me parashikimet e nenit 156, shkronja "ç", të KPP-së.

52. Neni 156, shkronja "ç", i KPP-së, sipas përmbajtjes së kohës, parashikonte se nuk mund të pyetej si dëshmitar i padituri civil. Gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit nga gjykata e rrethit, përmbajtja e kësaj dispozite është ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 03.03.2017, duke parashikuar se nuk mund të pyeten si dëshmitarë i padituri civil dhe personi civilisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga i pandehuri. Gjykata vëren se ky ndalim lidhet me padinë civile në procesin penal, e cila rregullohet nga nenet 58, pika 1, shkronja "g", dhe 61 të KPP-së. Sipas këtyre dispozitave, i dëmtuari/viktima e veprës penale ka të drejtë të ngrejë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

53. Në këndvështrim të këtyre dispozitave, në rastin konkret Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për dëshmitë e shtetasve A.S., S.H. dhe O.K. kanë të bëjnë, në thelb, me besueshmërinë e provës me dëshmitar dhe jo me ekzistencën e shkaqeve të papajtueshmërisë të parashikuara nga neni 156, shkronja "ç", i KPP-së. Në këtë aspekt, Gjykata vë në dukje se fakti që këta dëshmitarë janë paditur civilisht nga kërkuesi në procese gjyqësore për kthimin e huave të dhëna prej shoqërisë "DIA, Dega Shqipëri", nuk i vendos ata në kushtet e ndalimit ligjor për dhënien e dëshmisë në procesin objekt ankimi kushtetues individual, në kuptim të rregullimit ligjor në fjalë. Po kështu, kallëzimi penal që shtetasi A.S. ka bërë ndaj kërkuesit nuk përbën rrethanë që cenon legjitimitetin e dëshmisë së tij në këtë proces, në kuptim të parashikimit ligjor në fjalë. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për paligjshmërinë e marrjes së dëshmisë së këtyre dëshmitarëve A.S., S.H. e O.K. janë të pabazuara.

54. Për sa i takon pretendimit për papajtueshmërinë me rolin e dëshmitarit të shtetasit R.K., jurist e avokat mbrojtës i "DIA, Dega Shqipëri" dhe OSSHE-së në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar *(ii),* Gjykata vëren se qëndrimet e kërkuesit për këtë dëshmitar janë kontradiktore në raport me pohimet e tij gjatë gjykimit. Kështu, në seancën e datës 16.09.2016, gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata e rrethit, kërkuesi ka kërkuar moslejimin e marrjes së dëshmisë së këtij shtetasi, bazuar në nenin 159, pika 1, shkronja "b", të KPP-së *(shih faqen 67 të procesverbalit të kësaj seance)*, ndërsa në seancën e datës 17.03.2017 ka kërkuar marrjen e tij në pyetje jashtë funksionit avokat-klient, me pretendimin se prania në seancë e këtij

dëshmitari ishte e nevojshme për njohjen e dokumenteve dhe firmave *(shih faqen 158 të procesverbalit të seancës së datës 17.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*.

55. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata evidenton se R.K. ka qenë punonjës i shoqërisë "DIA, Dega Shqipëri" dhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve me shoqërinë në fjalë është punësuar pranë OSSHE-së. Në cilësinë e punonjësit të autorizuar të kësaj të fundit, ai ka nënshkruar padinë civile në procesin penal në ngarkim të kërkuesit, për të cilën gjykata e rrethit, bazuar në nenin 62, pika 3, të KPP-së, ka vendosur veçimin nga çështja penale, me arsyetimin se shqyrtimi i kësaj padie vështirësonte gjykimin e çështjes penale *(shih faqet 22-45 të dosjes gjyqësore nr. 1231, datë 08.05.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe faqen 8 të procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 15.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*. Në momentin e paraqitjes së kërkesave paraprake, organi i akuzës ka çmuar të nevojshme pyetjen e R.K., në rolin e paditësit civil *(shih faqen 67 të procesverbalit të seancës së datës 16.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*, ndërsa gjykata e rrethit ka vlerësuar të nevojshme pyetjen e këtij dëshmitari, si subjekt që ka informacion në lidhje me çështjen, në cilësinë e ish-punonjësit të shoqërisë "DIA, Dega Shqipëri" *(shih faqet 69 të procesverbalit të seancës së datës 16.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 96 të dosjes gjyqësore nr. IV të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 71-82 të vendimit të kësaj gjykate për çështjen)*. Gjatë gjykimit R.K. ka deklaruar se është takuar në Vjenë me avokatët e zgjedhur nga kërkuesi për përfaqësimin e çështjes së tij në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, të cilëve u ka bërë me dije qëndrimin e tij ligjor si ekspert *(shih faqen 73 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*. Gjykata e apelit ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së rrethit për marrjen e dëshmive në gjykim *(shih faqen 37 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)*, ndërsa Gjykata e Lartë ka çmuar se pretendimet e kërkuesit për paligjshmërinë e marrjes së dëshmisë së dëshmitarëve në konflikt me të nuk përbënin shkak që, sipas nenit 432 të KPP-së, cenonte vendimmarrjen e gjykatës së apelit ose që çonte në papërdorshmëri të këtyre dëshmive, pasi nuk rezultonte që ndonjëri prej dëshmitarëve të ishte në papajtueshmëri me detyrën *(shih faqen 25, paragrafi 59, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*

56. Për sa më lart, Gjykata vëren se gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e zakonshme kërkuesi nuk rezulton të ketë vënë në dispozicion të gjykatave informacione ose prova që provonin cilësinë juridike të shtetasit R.K. si

avokat mbrojtës i "DIA, Dega Shqipëri" në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit ose informacione me natyrë konfidenciale të atij gjykimi të dhëna nga ky dëshmitar. Për më tepër, Gjykata sjell në vëmendje se pyetja e një avokati si dëshmitar, sipas nenit 159, pika 1, shkronja "b", të KPP-së, nuk përbën shkak papajtueshmërie me këtë rol. Dispozita ligjore vendos ndalimin e detyrimit të avokatit për të dëshmuar për rrethana që lidhen me ushtrimin e mbrojtjes, pa i ndaluar atij të drejtën për të dëshmuar, nëse e çmon të arsyeshme. Përmes rregullimit ligjor në fjalë ligjvënësi ka synuar t'i japë mbrojtje dhe privilegj marrëdhënies së veçantë që avokati ka me të mbrojturin prej tij. Në rastin konkret, dëshmitari R.K., jo vetëm që nuk rezulton të ketë pasur cilësinë e avokatit të kërkuesit në çështjen në ngarkim të këtij, por as që të jetë detyruar kundër vullnetit të tij të dëshmojë gjatë gjykimit. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për paligjshmërinë e marrjes së dëshmisë së shtetasit R.K. janë të pabazuara.

57. Për sa u përket pretendimeve se nuk ka qenë i pranishëm gjatë sekuestrimit të akteve (iii), Gjykata vëren se në datën 12.05.2015, me vendimin nr. 2925/1 akti të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg", masë e cila është ekzekutuar po në këtë datë, ndërsa pretendimet e tij në gjykimin kushtetues parashtrohen ndaj arsyetimit të gjykatës së apelit, e cila ka hedhur poshtë kërkesën e tij për kryerjen e riekspertimit kontabël, me argumentin se ka pasur mundësi t'u bëjë pyetje ekspertëve dhe t'u vërë në dispozicion dokumente, gjë të cilën nuk e ka bërë, qëndrim ky i cili është gjetur i drejtë në vijim nga Gjykata e Lartë. Gjykata evidenton se për këtë qëllim gjykata e apelit i është referuar procesverbalit të datës 09.09.2015 të mbajtur nga oficerët e Policisë Gjyqësore për ekzekutimin e vendimit të prokurores së çështjes që ka urdhëruar vendosjen e sekuestros ndaj dokumenteve financiare, tatimore, kontraktuale dhe çdo dokumenti tjetër që kishte të bënte me aktivitetin e shoqërive nën hetim, ku kërkuesi ishte ortak ose administrator. Sipas kopjes së këtij procesverbali të administruar në dosjen gjyqësore rezulton se përmes mbrojtësit të tij kërkuesit i është vënë në dispozicion kopje e vendimit të sekuestrimit, ndërsa ka deklaruar se nuk dispononte asnjë dokument për këto shoqëri. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se qëndrimi i Gjykatës së Lartë për pranimin e arsyetimit të gjykatës së apelit, lidhur me mosvënien e dokumenteve në dispozicion të ekspertëve nga kërkuesi, nuk përmban pasaktësi në evidentimin e këtij fakti, për rrjedhojë çmon se pretendimet për marrjen e provave në mënyrë të paligjshme, si rrjedhojë e mungesës së kërkuesit në procedurën

e sekuestrimit të akteve të datës 09.09.2015, nuk gjejnë mbështetje nga pikëpamja kushtetuese.

58. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit se projekti i ashtuquajtur "Master Data Cleaning" nuk është marrë me procesverbal sekuestrimi e vendimi i prokurorit për sekuestrimin nuk ndodhet në fashikullin e gjykimit *(iv)*, si dhe se *e-mail*-i bashkëshoqërues i dokumentit "P.&P.", i depozituar në seancë gjyqësore nga organi i prokurorisë, është fabrikuar *(v)*, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të përcaktojë në aspektin kushtetues ndikimin vendimtar të këtyre provave në deklarimin e fajësisë së tij.

59. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme janë të pabazuara.

B.2. Për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur

60. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e rrethit nuk ka shtyrë seancën gjyqësore, pavarësisht pamundësisë së tij për të marrë pjesë në gjykim personalisht ose përmes mbrojtësit të zgjedhur, ndërsa i ka caktuar si mbrojtëse kryesisht, D.Ç., ndaj së cilës ai kishte paraqitur kallëzim penal dhe kishte kërkuar heqjen e licencës, për shkak të mungesës së njohurive për çështjen. Po sipas kërkuesit, gjykata e rrethit nuk ka marrë parasysh kundërshtimet e tij për caktimin kryesisht të avokates N.P., kërkesat e mbrojtësve të zgjedhur për shtyrjen e seancës për paraqitjen e kërkimeve përfundimtare dhe kundërshtimet e tij në caktimin kryesisht të mbrojtëses E.U., në cenim edhe të së drejtës së tij për pasjen e kohës së nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes. Pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë në konsideratë nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë.

61. Neni 31, shkronja "b", i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të ketë kohën e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e vet. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal përbën një nga elementet thelbësore për një proces të drejtë (*shih vendimet nr. 20, datë 22.09.2022; nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe përfshin edhe të drejtën e gjithkujt të akuzuar penalisht për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht. Sipas Gjykatës, që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë

e armëve *(shih vendimet nr. 73, datë 14.12.2015; nr. 10, datë 02.04.2009; nr. 33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese)*.

62. Po kështu, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*, zëvendësimi me avokat të caktuar kryesisht nga gjykata i mbrojtësit të zgjedhur nga kërkuesi, si rrjedhojë e mosparaqitjes në gjykim të këtij të fundit pa shkaqe të arsyeshme, nuk përbën shkak për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur *(shih çështjen Tafa k. Shqipërisë, datë 28.05.2025, § 11)*.

63. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata evidenton se gjatë shqyrtimit të çështjes nga gjykata e rrethit kërkuesi është përfaqësuar nga mbrojtës të zgjedhur prej tij, të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në disa seanca gjyqësore, duke parashtruar si shkaqe angazhimin në procese të tjera gjyqësore e gjendjen shëndetësore ose janë larguar nga salla me kërkesë të kërkuesit ose me vullnet të tyre. Në këto kushte, për qëllime të mbrojtjes të të drejtave të kërkuesit dhe administrimit në kohë të drejtësisë, gjykata ka caktuar kryesisht avokaten D.Ç., e cila ka realizuar mbrojtjen e tij deri më 23.12.2016, kur ka paraqitur dorëheqjen, për shkak të kallëzimit penal të bërë ndaj saj nga kërkuesi. Më pas, në seancat ku mbrojtësit e zgjedhur nuk janë paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, gjykata ka caktuar kryesisht avokatet N.P. e E.U., ku kjo e fundit ka paraqitur edhe konkluzionet përfundimtare për llogari të kërkuesit. Procedura e ndjekur nga gjykata e rrethit është vlerësuar e drejtë nga gjykata e apelit, e cila ka vënë në dukje se shtyrja e seancave gjyqësore është bërë nga kërkuesi pa shkaqe ligjore, ndërsa ai ka gëzuar të drejtën e mbrojtjes me mbrojtës të zgjedhur prej tij ose të caktuar kryesisht nga gjykata, kur të parët nuk kanë qenë të pranishëm *(shih faqen 37 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)*. Ky qëndrim është konfirmuar nga Gjykata e Lartë, e cila, bazuar edhe në vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, ka vënë në dukje se sjellja e mbrojtësve të zgjedhur dhe shkaqet e paraqitura prej tyre nuk justifikonin shtyrjen e seancave, kërkesat e kërkuesit në gjykim ishin garantuar përmes mbrojtësve të zgjedhur ose të caktuar kryesisht, si dhe nisur edhe nga mënyra e formulimit të diskutimit përfundimtar, pranisë së të pandehurit në seancën e fundit dhe deklarimet e dhëna prej tij në këtë seancë, mbrojtja e ofruar kishte qenë efektive *(shih faqen 25, paragrafi 60, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

64. Nga sa më lart, Gjykata vëren se gjykata e rrethit ka marrë masat për balancimin si të së drejtës së kërkuesit për t'u mbrojtur gjatë gjykimit, ashtu edhe për administrimin në kohë të drejtësisë. Po kështu, pretendimet

e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes janë analizuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për shkaqet e rrëzimit të tyre. Në vlerësimin e Gjykatës, qëndrimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për sa kohë që gjatë procesit gjyqësor kërkuesit i është dhënë mundësia të ketë kohën dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet, si përmes avokatëve të zgjedhur prej tij, ashtu edhe përmes avokatëve të caktuar kryesisht nga gjykata.

65. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, si rrjedhojë e caktimit të avokateve kryesisht D.Ç., N.P. e E.U., dhe së drejtës për të pasur kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, për këto shkaqe, janë të pabazuara.

B.3. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

66. Kërkuesi ka pretenduar se njoftimi për shtyp i bërë nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me çështjen e tij bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë.

67. Parimi i prezumimit të pafajësisë garantohet nga neni 30 i Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

68. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë, si një nga elementet e një gjykimi të drejtë, ndalon shprehjen e parakohshme nga gjykata të vlerësimit se personi "i akuzuar për një vepër penale" është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin *(shih vendimet nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

69. Edhe sipas GJEDNJ-së, neni 6, pika 2, i KEDNJ-së synon parandalimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor penal nga deklaratat paragjykuese të bëra në lidhje të ngushtë me procesin. Kjo dispozitë ndalon jo vetëm shprehjet e parakohshme të gjykatës për fajësinë, por edhe deklaratat e funksionarëve të tjerë publikë, përfshirë ato të organit të ndjekjes penale, për sa u përket hetimeve penale, të tilla që inkurajojnë publikun të besojë se i dyshuari është fajtor dhe të paragjykojë vlerësimin e fakteve nga autoriteti kompetent gjyqësor *(shih Karaman k. Gjermanisë, datë 27.02.2014, § 41)*. Megjithatë, ka një dallim thelbësor mes deklarimit se një person është thjesht i dyshuar se ka kryer një krim dhe deklarimit të qartë, në mungesë të dënimit përfundimtar, se ai person ka kryer krimin në fjalë *(shih Vardan Martirosyan k. Armenisë, datë*

15.06.2021, § 48; Matijašević k. Serbisë, datë 19.09.2006, § 48). Ndërsa gjuha e përdorur paraqet rëndësi thelbësore në këtë drejtim, vlerësimi nëse parimi i prezumimit të pafajësisë është cenuar përcaktohet duke mbajtur në konsideratë rrethanat në të cilat deklarata e kundërshtuar është bërë. Përdorimi i shprehjeve të pavend mund të mos jetë vendimtar nëse mbahen parasysh natyra dhe konteksti i procesit në fjalë *(shih Karaman k. Gjermanisë, datë 27.02.2014, § 63; Daktaras k. Lituanisë, datë 10.10.2000, §§ 42-44)*. GJEDNJ-ja ka theksuar, gjithashtu, se liria e shprehjes, e garantuar nga neni 10 i KEDNJ-së, nënkupton lirinë për të dhënë dhe marrë informacione, ndaj për qëllime të ushtrimit të kësaj lirie, neni 6, pika 2, i KEDNJ-së nuk mund të ndalojë autoritetet të informojnë publikun për hetimet që po kryejnë. Megjithatë, ky informacion duhet të jepet me maturi dhe të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë *(shih Yoncheva k. Bullgarisë, datë 07.01.2025, §§ 40-41)*.

70. Bazuar në standardet e mësipërme, në rastin konkret Gjykata evidenton se gjykimi i çështjes nga gjykata e rrethit është zhvilluar në seancë publike me praninë e medias. Në seancën e zhvilluar në tetor të vitit 2015 kërkuesi ka deklaruar se procesi penal kundër tij është nisur me qëllimin e vetëm të tërheqjes së tij nga procesi gjyqësor që po zhvillohej në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar, ku Shqipëria rrezikonte të humbiste shuma të mëdha financiare. Deklaratat e kërkuesit janë pasqyruar gjerësisht në media, duke marrë vëmendjen e publikut. Në përgjigje të tyre, në datën 18.12.2015 Prokuroria e Përgjithshme ka njoftuar në faqen e saj zyrtare pushimin nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit të gjykimit të kërkesës së kompanisë "DIA". Sipas këtij njoftimi, nga dokumentet e Prokurorisë së Tiranës provohej plotësisht se kërkuesi kishte krijuar skemë mashtruese, bazuar në dokumente fiktive, në bashkëpunim me persona të tjerë nën hetim, për të përfituar në mënyrë të padrejtë vlera financiare nga "CEZ-Shpërndarje", ndërsa provat hetimore të grumbulluara gjatë hetimeve paraprake, marrja në përgjegjësi penale, caktimi i masës së sigurimit etj. kishin ndikuar në vendimmarrjen e administratores së re të "DIA-s" për t'u tërhequr nga gjykimi në arbitrazh që kompania kishte nisur me shtetin shqiptar. Në vijim, në datën 21.12.2015 Prokuroria e Përgjithshme ka njoftuar në faqen e saj zyrtare përfundimin e hetimeve ndaj kërkuesit, i akuzuar për veprat penale "Mashtrimi", të kryer në bashkëpunim e me pasoja të rënda dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale", të kryer më shumë se një herë. Sipas këtij njoftimi, në lidhje me këto vepra, organi i ndjekjes penale ka evidentuar dy episode, konkretisht krijimin e kompanisë

fiktive "ADC", përmes së cilës janë kryer transaksione financiare në miliona euro, si dhe të shoqërisë "DIA" e degës së saj në Shqipëri, e cila ka lidhur me OSSH-në kontratën për mbledhjen e borxhit. Po sipas njoftimit, qëllimi i kërkuesit në lidhjen e kësaj marrëveshjeje nuk ka qenë mbledhja e borxhit të shoqërisë dhe as kryerja e ndonjë pune reale, por vjedhja e parave të shoqërisë "CEZ Shpërndarje", veprim kriminal të cilin kërkuesi e ka kryer në bashkëpunim me kryetarin e bordit të kësaj të fundit, përmes përdorimit të të dhënave të rreme dhe dokumenteve fiktive.

71. Në analizë të përmbajtjes së informacionit të publikuar nga Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata vëren se edhe pse deklaratat për shtyp të këtij organi nuk janë formuluar në mënyrë të kujdesshme dhe janë bërë në një fazë kur procesi penal ishte për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e parimi i prezumimit të pafajësisë duhej të ishte respektuar, ato kanë ardhur si reagim i organit të akuzës ndaj pretendimeve të kërkuesit për lidhjen e procesit penal me procesin përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, të cilat kishin pasur jehonë të gjerë mediatike. Në këtë kuadër, Gjykata gjen rastin të theksojë se në deklaratat për shtyp për gjendjen e hetimit ose gjykimit penal institucionet dhe zyrtarët publikë duhet të sillen me maturi dhe të respektojnë në çdo rast parimin e prezumimit të pafajësisë. Megjithatë, duke mbajtur parasysh kontekstin e rrethanave mbi të cilat Prokuroria e Përgjithshme ka reaguar përmes deklarimeve për shtyp, si dhe faktin se nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale ose ta kenë konsideruar atë fajtor përpara dhënies së vendimit përfundimtar për fajësinë e tij, Gjykata vlerëson se deklarimet e organit të ndjekjes penale nuk duket se kanë pasur ndikim vendimtar në rezultatin përfundimtar të procesit gjyqësor penal në ngarkim të kërkuesit.

72. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e prezumimit të pafajësisë, si rrjedhojë e publikimit të njoftimeve për shtyp të organit të ndjekjes penale, është i pabazuar.

B.4. Për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj

73. Kërkuesi ka pretenduar se në rastin e tij bëhej fjalë për zbatimin e një kontrate juridike civile, të lidhur rregullisht mes palëve, ndaj në këtë situatë gjykata e rrethit dhe ajo e apelit duhej të kishin sqaruar pozitën procedurale të "DIA, Dega Shqipëri" e të merrnin parasysh parashikimet e ligjeve për tregtarët e shoqëritë tregtare dhe për përgjegjësin penale të personave juridikë. Po sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë përcaktuar

shumën e pretenduar të përfituar padrejtësisht prej tij, dëmin ekonomik të shkaktuar dhe përfitimin e "CEZ Shpërndarje" sh.a. nga aktiviteti i "DIA, Dega Shqipëri".

74. Neni 29, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj dhe individi duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm *(shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po sipas Gjykatës, natyra e përgjegjësisë sipas legjislacionit civil është e ndryshme nga ajo e legjislacionit penal, pasi standarde të ndryshme të të provuarit zbatohen në çështje civile dhe penale. Një dënim penal nuk përjashton gjetjen e një përgjegjësie civile që lind nga të njëjtat fakte dhe se në të kundërt, ekzistenca e përgjegjësisë civile nuk sjell nevojshmërisht një vendim fajësie sipas ligjit penal, në lidhje me të njëjtat veprime të të pandehurit *(shih vendimin nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

75. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në çështjen në shqyrtim Gjykata vëren se, në analizë të veprave penale "Mashtrimi" dhe "Pastrimi i produkteve të veprave penale", gjykata e rrethit ka vlerësuar se kërkuesi, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "DIA, Dega Shqipëri", ka kryer mashtrim të dukshëm, duke lidhur kontrata shërbimi, përfituar shuma monetare dhe gënjyer të dëmtuarit që në momentin e lidhjes së tyre, si dhe i ka shkaktuar dëm të rëndë financiar e ekonomik shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. në vlerën 649.803.520 lekë, ndërsa nuk ka arritur të justifikojë likuiditetet e shoqërisë "ADC" të sekuestruara nga bankat e nivelit të dytë. Sipas gjykatës, ekzistenca e elementeve të veprës penale në faktet objekt procedimi nuk përjashton ekzistencën njëkohësisht të marrëdhënies juridike-civile mes tij dhe të dëmtuarve dhe ky detyrim civil nuk e përjashton kërkuesin nga përgjegjësia penale për veprimet kriminale dhe abuzivitetin të kryera në dëm të të dëmtuarve *(shih faqet 3-5, 102-106 dhe 108 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*. Qëndrimi i

gjykatës së rrethit është vlerësuar i drejtë nga gjykata e apelit *(shih faqet 24-32 dhe 90-95 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)* dhe Gjykata e Lartë, e cila në përfundim të analizës së ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta i ka vlerësuar ato të drejta e të bazuara në ligj *(shih faqet 27-29 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

76. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuar për pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj, referuar natyrës juridiko-civile të marrëdhënies mes palëve, si shkak për cenimin e kësaj të drejte kushtetuese. Në vlerësimin e Gjykatës, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, arsyetimi i gjykatave nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për sa kohë që kërkuesi ka qenë objektivisht në gjendje, qoftë edhe përmes mbrojtësve të tij, të kuptojë përmbajtjen e normave penale për veprimet ose mosveprimet që do e bënin atë jo vetëm penalisht, por edhe civilisht përgjegjës, sipas parashikimeve të KPP-së.

77. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj, është i pabazuar.

B.5. Për cenimin e drejtës për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve

78. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e rrethit nuk ka marrë masa për njoftimin e dëshmitarit kryesor E.M. në adresën tjetër në Shqipëri dhe atë jashtë shtetit, por është mjaftuar vetëm me njoftimin e tij në njërën prej adresave në Shqipëri, duke lejuar leximin në gjykim të deklarimeve të bëra nga ky shtetas. Pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë në konsideratë nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Në zbatim të nenit 164 të KPP-së gjykatat duhej të kishin vendosur shoqërimin e detyrueshëm të këtij dëshmitari. Po kështu, gjykatat nuk kanë marrë parasysh kërkesat e tij për thirrjen e disa dëshmitarëve dhe i kanë mohuar të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët J.H., J.I., J.K. dhe R.G.G. ose për të pyetur e ripyetur dëshmitarë të tjerë.

79. Neni 31, shkronja "d", i Kushtetutës parashikon se kushdo gjatë procesit penal ka të drejtën të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar rëndësinë e thirrjes së dëshmitarëve në gjykim, me qëllim bërjen e pyetjeve për të kundërshtuar provën në procesin penal. Sipas Gjykatës, çdo i akuzuar për kryerjen e veprës së dënueshme penale ka të drejtë të marrë në pyetje ose të kërkojë

të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës, si dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes në kushte të njëjta me ata të akuzës. Megjithatë, nuk mjafton që i akuzuari të tregojë se i është mohuar mundësia t'u drejtojë pyetje disave prej dëshmitarëve, por duhet, përveç kësaj, të bëjë të besueshme se këto pyetje ishin të domosdoshme për të përcaktuar të vërtetën dhe se ky mosveprim i kishte cenuar të drejtën për t'u mbrojtur. Nëse gjykatat e zakonshme vërejnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë *(shih vendimin nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po sipas Gjykatës, nëse gjykatat e zakonshme nuk janë në gjendje të realizojnë pyetjen personalisht të dëshmitarëve, ato mund të bazohen edhe në dëshmitë e tjera, të marra në seancë gjyqësore, të dëshmitarëve të pyetur në fazën e hetimit gjyqësor, ose në një sërë dokumentesh e provash materiale *(shih vendimin nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nëse gjykata e zakonshme mbështet vendimin e saj në shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të sjella nga palët, për të cilat këto të fundit kanë debatuar duke shprehur opinionet e prapësimet e tyre pa u vënë në kushte pabarazie dhe pa iu mohuar ndonjë e drejtë që lidhet me cenimin e së drejtës së mbrojtjes në kuptimin kushtetues dhe nuk ka çmuar të nevojshme marrjen e provave të tjera me dëshmitarë, pasi ka bërë vlerësim të rëndësisë së tyre nga këndvështrimi i zgjidhjes së drejtë të çështjes, kjo nuk cenon të drejtën e mbrojtjes *(shih vendimet nr. 42, datë 18.12.2007; nr. 90, datë 25.07.2001 të Gjykatës Kushtetuese)*.

80. Edhe sipas GJEDNJ-së, përdorimi si provë i dëshmive të marra gjatë fazës së hetimit, në vetvete, nuk përbën shkelje të nenit 6, paragrafët 1 dhe 3, shkronja "d", të KEDNJ-së *(shih Caka k. Shqipërisë, datë 21.05.2024, § 18)*. Edhe pse dënimi i një të pandehuri bazuar vetëm ose kryesisht në dëshmitë e dhëna gjatë fazës hetimore nga dëshmitarët, të cilët ai nuk ka pasur mundësi t'i marrë në pyetje gjatë gjykimit, passjell kufizim të së drejtës së tij të mbrojtjes *(shih Al-Khawaja dhe Tahery k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], datë 15.12.2011, § 128)*, mungesa e pjesëmarrjes në gjykim të një dëshmitari nuk mund të konsiderohet, në vetvete, cenim i së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa kohë që ekzistojnë prova të tjera që mbështesin deklarimet e tij dhe dënimi nuk mbështetet vetëm në dëshminë e dëshmitarit në mungesë, si provë e vetme e vendimtare *(shih Vasile Pruteanu dhe të tjerë k. Rumanisë, datë 14.01.2025, §§ 55, 71)*.

81. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata

konstaton se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve parashtrohen në kuadër të mosmarrjes së masave nga gjykatat e faktit për thirrjen e dëshmitarit E.M. në adresat e këtij shtetasi në Shqipëri dhe jashtë vendit, si dhe mosmarrjes parasysh të kërkesave të kërkuesit për thirrjen dëshmitarëve J.H., J.I., J.K. e R.G.G. dhe të dëshmitarëve të tjerë të mbrojtjes.

82. Në lidhje me këto pretendime, nga të dhënat e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se ndërsa ka rrëzuar kërkesat e kërkuesit për thirrjen e disa dëshmitarëve, gjykata e rrethit ka proceduar me njoftimin e dëshmitarit E.M. në adresat e vëna në dispozicion të organit të akuzës nga ky dëshmitar. Njoftimi ka qenë i pamundur, pasi nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se ky shtetas ndodhej jashtë vendit, ndërsa prindërit nuk kishin dijeni për vendndodhjen e tij. Në seancën e datës 22.11.2016 kërkuesi ka vënë në dispozicion të gjykatës adresën jashtë vendit të këtij shtetasi, ndërsa në vijim ka depozituar deklaratën e E.M. të datës 28.11.2016, përmes së cilës shprehej gatishmëria e tij për t'u paraqitur në gjykim. Gjatë gjykimit kërkuesi ka pranuar se mund siguronte vetë praninë në gjykim të dëshmitarit E.M., fakt të cilin gjykata e ka konfirmuar, duke deklaruar se nuk kishte asnjë pengesë në këtë drejtim. Në vijim, kërkuesi ka vënë në dispozicion të gjykatës deklaratën e shtetasit E.M. të datës 25.05.2017 drejtuar gjykatës për të dëshmuar, në të cilën pretendohet se deklarata e dhënë prej tij oficerëve të Policisë Gjyqësore është bërë në kushtet e kërcënimit, ndërkohë që zarfi i dërgimit të kësaj deklarate, i administruar në dosje nga gjykata e rrethit, nuk përmbante adresë të këtij shtetasi në shtetin gjerman.

83. Po kështu, për sa u përket thirrjes në gjykim të shtetasve të huaj J.H., J.I., J.K. dhe R.G.G., Gjykata evidenton se nga të dhënat e dosjes gjyqësore rezulton se gjykata e rrethit ka vepruar me njoftimin e tyre për pjesëmarrje në gjykim në adresat e depozituara nga mbrojtësi i kërkuesit. Njoftimi dërguar shtetasit J.K. është kthyer nga shërbimi postar me shënimin "*Adresë e panjohur"*. Ndërsa për sa u përket njoftimeve të shtetasve J.H. dhe J.I., të thirrur fillimisht në gjykim në cilësinë e dëshmitarëve deri në datën 10.04.2017 kur gjykata ka vendosur revokimin e vendimit të saj për marrjen në pyetje të këtyre shtetasve, për shkak të ndryshimit të pozitës së tyre procedurale tashmë si të pandehur, rezulton se në datën 06.02.2017 CEZ Pragë ka njoftuar gjykatën se ata nuk ishin më punonjës të kësaj shoqërie. Po kështu, gjykata ka evidentuar se shtetasja R.G.G. ishte njoftuar për gjykimin në adresën e dhënë, njoftim i cili ishte kthyer nga shërbimi

postar, ndaj, në këto kushte, kërkuesi duhej të saktësonte adresën e saktë të saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

84. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për mosnjoftimin e dëshmitarëve të kërkuar prej tij, Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar se leximi në gjykim i dëshmisë së shtetasit E.M. është bërë në respektim të nenit 369, pika 3, të KPP-së, pasi ka rezultuar se ky shtetas jetonte jashtë shtetit, në adresë të pasaktësuar. Po kështu, gjykata e rrethit kishte ezauruar të gjitha mundësitë e njoftimit të këtij dëshmitari dhe prania e tij nuk ishte bërë e mundur. Nga ana tjetër, kërkuesi dhe mbrojtësit e tij kishin marrë kopje të deklarimeve të dëshmitarit E.M. dhe i kishin kontestuar ato në seancë gjyqësore gjatë gjykimit, në konkluzionet përfundimtare, si dhe në apel. Mbrojtja nuk rezultonte të kishte paqartësi, pasaktësi ose pikëpyetje për deklarimet e lexuara të këtij dëshmitari, të tilla që kërkonin rithirrjen e tij në gjykim. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit edhe për sa u përket pretendimeve të kërkuesit në lidhje me thirrjen e dëshmitarëve të tjerë, duke vlerësuar se kërkesa e kërkuesit për riçeljen e hetimit gjyqësor, me qëllim marrjen e dëshmive të tyre, nuk kishte të bënte me marrjen e provave të reja, por të atyre provave që kishin qenë të pamundura për t'u marrë gjatë gjykimit në shkallë të parë e që, për të njëjtat arsye, ishin të pamundura të administroheshin gjatë gjykimit në apel, të cilat, për më tepër, nuk ishin relevante për të provuar ekzistencën ose jo të faktit penal *(shih faqet 35-37 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)*. Ky qëndrim i gjykatës së apelit është vlerësuar i drejtë në thelb nga Gjykata e Lartë, sipas së cilës kërkuesi kishte marrë përgjigje të arsyetuar për këto pretendime nga gjykata e apelit dhe se pretendimet e tij për marrjen e provave të kërkuara ose të reja ishin të pabazuara e nuk përbënin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së *(shih faqet 21-22 e 24, paragrafët 49 e 56, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

85. Në analizë të vendimeve të gjykatave të zakonshme, Gjykata vëren se, në përputhje me parashikimet e KPP-së, gjykata e rrethit ka marrë të gjitha masat e ka bërë të gjitha përpjekjet për njoftimin e thirrjen në gjykim të dëshmitarëve E.M., J.H., J.I., J.K. dhe R.G.G. të kërkuar nga kërkuesi. Në pamundësi të njoftimit të tyre, ajo ka proceduar me leximin në gjykim të deklarimeve të dhëna nga shtetasi E.M. gjatë marrjes në pyetje, si dhe ka administruar në gjykim një sërë provash të tjera, të tilla si: dëshmitë e ish-punonjësve të "DIA, Dega Shqipëri", të thirrur e pyetur gjatë gjykimit si nga gjykata, ashtu edhe nga kërkuesi e mbrojtësit e tij; të dhënat e aktekspertimit

kontabël; informacionet dhe dokumentet e marra nga bankat e nivelit të dytë; dokumentet e paraqitura në gjykim nga OSSHE-ja e të administruara në cilësinë e provave materiale, të tilla si kontratat e lidhura me shoqërinë "DIA, Dega Shqipëri"; informacionet e ndryshme të dërguara nga ky institucion; shkresat e dërguara nga shoqëria "CEZ, Shpërndarje" sh.a.; aktkontrollet e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj; dokumentacioni i marrë nga tatimet për shoqëritë "ADC" dhe "DIA, Dega Shqipëri"; dokumentet e sekuestruara nga oficerët e Policisë Gjyqësore, etj. Në përfundim të gjykimit, gjykata e rrethit ka deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesin për veprat penale të akuzuara, duke e mbështetur vendimmarrjen e saj në tërësinë e provave të administruara në gjykim, për të cilat kërkuesit i është dhënë mundësia të kundërshtojë përmbajtjen e tyre. Pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për thirrjen e dëshmitarëve në gjykim janë vlerësuar në vijim nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për shkaqet e rrëzimit të tyre.

86. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se deklarimet e dhëna nga shtetasi E.M. gjatë hetimeve paraprake e të lexuara në gjykim nuk kanë qenë vendimtare në përcaktimin e fajësisë së kërkuesit, për sa kohë që vendimmarrja e gjykatave të zakonshme për dënimin e tij është mbështetur në një sërë provash, për të cilat kërkuesi ka pasur mundësi të parashtrojë pretendimet e tij dhe t'i kundërshtojë ato pa u vënë në kushte pabarazie dhe pa iu mohuar e drejta e mbrojtjes në kuptimin kushtetues. Në vlerësimin e Gjykatës, vendimet e gjykatave të zakonshme për rrëzimin e pretendimeve të kërkuesit për cenimin e së drejtës për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve nuk rezultojnë arbitrare në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bien ndesh me konceptimin e gjykimit të drejtë.

87. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët janë të pabazuara.

88. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa nuk është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.10.2025
Shpallur më 12.01.2026

Vendim nr. 56, datë 10.10.2025
(V-56/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 09.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SHOQËRIA "SIONTIS" S.A.**
SHOQËRIA "DESIGN AND CONSTRUCTION SIONTIS" S.A.
CHRISTOS SIONTIS (KRISTOS SIONTIS), të përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
SHOQËRIA TREGTARE "GJALLICA" SH.P.K., NË ADMINISTRIM, në mungesë.
ZYRA PËRMBARIMORE ELBASAN, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 24 (86-2017-1981), datë 09.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2777, datë 27.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 11, pika 2, 15, 41, 42, 121, 122, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1,**

71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*; ligji nr. 7760, datë 14.10.1993 "Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, shoqërisë tregtare "Gjallica" sh.p.k. (*shoqëria "Gjallica"*) në administrim dhe Zyrës Përmbarimore Elbasan, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shoqëritë "Siontis" s.a. (*kërkuesi i parë*) dhe "Design and Construction Siontis" s.a. (*kërkuesi i dytë*) janë persona juridikë të së drejtës greke, me seli në qytetin e Janinës dhe me administrator kërkuesin Christos Siontis (Kristos Siontis) (*kërkuesi i tretë*). Midis kërkuesit të dytë, në cilësinë e sipërmarrësit dhe shoqërisë "Gjallica", në cilësinë e porositësit, në datat 04.04.1996 dhe 10.08.1996 janë nënshkruar dy kontrata, respektivisht për ndërtimin e objektit "Business Center Albania" në qytetin e Vlorës, me kosto punimesh në vlerën 3,300,000 dollarë amerikanë (*USD*) dhe për ndërtimin e fabrikës së tullave në Vlorë, me kosto punimesh në vlerën 1,300,000 USD. Për këtë qëllim shoqëria "Gjallica" ka bërë disa pagesa në favor të sipërmarrësit.

2. Në bazë të ligjeve nr. 8188, datë 23.01.1997 "Për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes" dhe nr. 8215, datë 09.05.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", i ndryshuar (*ligji nr. 8215/1997*) veprimtaria e shoqërisë "Gjallica" është ndërprerë dhe ajo është vendosur në administrim. Me VKM-në nr. 44, datë 21.01.1999, të botuar në Fletoren Zyrtare, kërkuesi i

parë është deklaruar, mes të tjerave, si person juridik i lidhur me shoqërinë huamarrëse "Gjallica". Pas shqyrtimit të dokumentacionit të shoqërisë në administrim, bazuar në ligjin nr. 8471, datë 08.04.1999 "Për nxjerrjen e detyrimeve debitorëve dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" (*ligji nr. 8471/1999*), administratorët e përbashkët të shoqërisë "Gjallica" në administrim kanë deklaruar debitorë: (i) kërkuesit e parë dhe të tretë, për shumën 295,920,000 lekë, me vendimin nr. 15, datë 11.08.1999 (*vendimi i administratorëve nr. 15/1999*), për të cilin, duke qenë titull ekzekutiv sipas ligjit të veçantë, është lëshuar urdhri i ekzekutimit me vendimin nr. 835 akti, datë 18.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*urdhri gjyqësor i ekzekutimit nr. 835/2008*); (ii) kërkuesit e dytë dhe të tretë, për shumën 1,700,000 USD, me vendimin nr. 2, datë 07.09.2009 (*vendimi i administratorëve nr. 2/2009*), për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit me vendimin nr. 911 akti, datë 25.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*urdhri gjyqësor i ekzekutimit nr. 911/2010*), vendim që, gjithashtu, konsiderohej titull ekzekutiv sipas ligjit të veçantë.

3. Në datën 03.05.2010 shoqëria "Gjallica" në administrim i është drejtuar Zyrës Përmbarimore Elbasan, së cilës, më herët, në datën 29.04.2010, i është drejtuar edhe kërkuesi i tretë për vënien në ekzekutim të vendimit nr. 509, datë 19.03.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë (*vendimi gjyqësor nr. 509/2010*), me të cilin është vendosur detyrimi i një shoqërie të tretë për t`i kthyer këtij kërkuesi disa mjete dhe makineri.

4. Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të kërkesës së shoqërisë "Gjallica" në administrim, Zyra Përmbarimore Elbasan, me vendimin e datës 02.06.2010, ka vendosur masën e sekuestros për disa sende të luajtshme të kërkuesit të tretë (mjete dhe makineri), për të cilat ai ishte në procedurë ekzekutimi si kreditor, sipas vendimit gjyqësor nr. 509/2010. Duke mos qenë dakord me këtë veprim përmbarimor, kërkuesi i tretë i është drejtuar gjykatës së apelit për kundërshtimin e vendimit të sekuestros dhe anulimin e tij, pezullimin e titullit ekzekutiv, vendimit të administratorëve nr. 2/2009, si dhe urdhërimin e Zyrës Përmbarimore Elbasan të ekzekutojë vendimin gjyqësor nr. 509/2010. Në përfundim të këtij gjykimi, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 28, datë 20.09.2010, ka vendosur rrëzimin e padisë.

5. Nga ana tjetër, në datën 17.06.2010, kërkuesi i dytë i është drejtuar gjykatës së apelit me padi, me objekt: (i) kundërshtimin e veprimit përmbarimor, vendimit të sekuestros dhe anulimin e tij; (ii) kundërshtimin

e titullit ekzekutiv, vendimit të administratorëve nr. 2/2009 dhe anulimin e tij; (iii) pezullimin e ekzekutimit të vendimit të sekuestros dhe të titullit ekzekutiv; (iv) rivendosjen në afat të padisë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 27, datë 15.09.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes të kërkuesit të dytë në seancë gjyqësore, pa shkaqe të përligjura.

6. Po ashtu, në datën 21.06.2010, edhe kërkuesi i parë i është drejtuar gjykatës së apelit me padi, me objekt: (i) kundërshtimin e veprimit përmbarimor, vendimit të sekuestros dhe anulimin e tij; (ii) kundërshtimin e titullit ekzekutiv, vendimit të administratorëve nr. 15/1999 dhe anulimin e tij; (iii) pezullimin e ekzekutimit të vendimit të sekuestros dhe të titullit ekzekutiv; (iv) rivendosjen në afat të padisë. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje gjykata e apelit ka vendosur bashkimin e saj me çështjen e vënë në lëvizje në datën 04.11.2010 nga kërkuesi i dytë me të njëjtin objekt padie *(shih paragrafin 5 të vendimit)*. Po ashtu, gjykata e apelit ka vendosur edhe pranimin e kërkesës së datës 09.02.2011 për ndërhyrje kryesore të kërkuesit të tretë, duke shqyrtuar edhe padinë e paraqitur prej këtij të fundit. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 15, datë 12.04.2011, ka vendosur rrëzimin e padisë, vendim që është prishur me vendimin nr. 00-2015-1251 (379), datë 09.06.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe çështja është dërguar për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Gjatë rigjykimit të çështjes, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 08.06.2016, ka vendosur ndarjen dhe gjykimin veçmas të kërkimeve, atij për rivendosjen në afat të padisë nga kërkimet për themelin e mosmarrëveshjes, atyre për: (a) kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor për vendosjen e masës së sekuestros mbi sendet e luajtshme dhe anulimin e tij; (b) kundërshtimin e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009 dhe anulimin e tyre; (c) pezullimin e ekzekutimit të vendimit të sekuestros dhe të titujve ekzekutivë.

i) Procesi gjyqësor për kërkimin e rivendosjes në afat të padisë

8. Për kërkimin e rivendosjes në afat të padisë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 49, datë 15.11.2016 *(vendimi nr. 49/2016)*, ka vendosur rrëzimin e tij, kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesve, me vendimin nr. 00-2024-17(4), datë 11.01.2024,

ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

9. Në datën 10.05.2024 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual për kundërshtimin e këtyre vendimeve, për të cilin Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 172, datë 19.07.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosplotësimit të kriterit të shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Sipas Kolegjit të Gjykatës, pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë me themelin e mosmarrëveshjes, e cila është shqyrtuar në një proces të ndarë nga procesi gjyqësor i kundërshtuar, ndaj duke mbajtur parasysh se në përfundim të këtij të fundit është vendosur pushimi i gjykimit, kërkuesit kanë ende mundësitë dhe mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara të cenuara, duke mos përjashtuar edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë në rast të një vendimi gjyqësor përfundimtar të pafavorshëm për ta.

ii) Procesi gjyqësor për kërkimet e padisë për themelin e mosmarrëveshjes

10. Pas ndarjes së kërkimeve të padisë dhe gjykimin veçmas të tyre, për sa u përket atyre për themelin e mosmarrëveshjes në lidhje me kundërshtimin dhe anulimin e veprimit përmbarimor, vendimit të sekuestros dhe kundërshtimin dhe anulimin e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, si dhe për pezullimin e tyre, Gjykata Administrative e Apelit, fillimisht, me vendimin e ndërmjetëm të datës 17.10.2016, bazuar në nenin 297, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në përfundim të procesit gjyqësor në lidhje me kërkimin për rivendosjen në afat të padisë, duke vlerësuar se kërkimet e padisë në këtë gjykim nuk mund të shqyrtohen në themel pa u përcaktuar gjyqësisht nëse ishte parashkruar apo jo padia për anulimin e vendimeve të administratorëve të shoqërisë "Gjallica" në administrim dhe për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, si dhe pezullimin e tyre.

11. Pas përfundimit në gjykatën e apelit të procesit gjyqësor për rivendosjen në afat të padisë, Gjykata Administrative e Apelit ka vijuar gjykimin e kërkimeve për themelin e mosmarrëveshjes dhe në përfundim, me vendimin nr. 24 (86-2017-1981), datë 09.05.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2777, datë 27.06.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara

në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012),* që të jenë të afta dhe të passjellin cenim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

13. Në datën 09.01.2025 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 13.01.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 25.03.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. ***Kërkuesit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

14.1. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh se gjykatat shqiptare nuk janë kompetente për sa kohë që palët kanë përcaktuar si kompetente Gjykatën Ndërkombëtare të Parisit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre në lidhje me kontratat e sipërmarrjes të datave 04.04.1996 dhe 10.08.1996. Shoqëria "Gjallica", pavarësisht se është shoqëri në administrim, si palë e kontratës nuk mund të përcaktojë në mënyrë të njëanshme me fuqinë e një titulli ekzekutiv, detyrimin e kërkuesve si palë kontraktuese. Ky kusht kontraktor i përcaktuar në kontratat e lidhura mes palëve është detyrues, në kuptimin që asnjë gjykatë tjetër, e cilitdo vendi, nuk mund të merret me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindnin nga moszbatimi i kontratave. Shkelja me qëllim e dispozitave që rregullojnë juridiksionin e gjykatave nga shoqëria "Gjallica" në administrim dhe administratorët e saj e bën të pavlefshme të gjithë procedurën e ndjekur.

14.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim,* pasi gjyqtarët A.A. dhe A.V. kanë marrë pjesë si në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të padisë, ashtu edhe në atë që ka gjykuar edhe pjesën tjetër të padisë për kundërshtimin e veprimit përmbarimor të sekuestrimit dhe për pavlefshmërinë

e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve të shoqërisë "Gjallica" në administrim. Edhe pse është kërkuar përjashtimi ose heqja dorë e këtyre gjyqtarëve, kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë.

14.3. *Së drejtës së aksesit dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit në gjykim,* pasi Gjykata Administrative e Apelit, si gjykatë e shkallës së parë, nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga kërkuesit, përfshirë edhe provat e reja shkresore që vërtetonin mosekzistencën e detyrimit, si dhe nuk ka zhvilluar një hetim shterues. Përfundimi i asaj gjykate për rrëzimin e padisë si të parashkruar është i pabazuar në prova dhe ligj, pasi padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është një padi që, sipas ligjit të kohës, nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet në çdo kohë, ndaj gjykata e apelit ishte e detyruar ta shqyrtonte atë në themel, duke marrë të gjitha provat që vërtetonin se detyrimi nuk ekzistonte ose ekzistonte në një masë më të vogël. Kërkuesi i parë ka përmbushur detyrimet kontraktuale duke përgatitur studimet dhe projektet, të cilat i janë dorëzuar shoqërisë "Gjallica", sikundër ka përgatitur edhe skeletin metalik të fabrikës, i cili gjendej në Janinë, përveçse ka përfunduar edhe punimet parapërgatitore ndërtimore në rajonin e zgjedhur për ngritjen e fabrikës. Vlera e këtyre punimeve nuk u llogarit asnjëherë, përveçse edhe mosdorëzimi i tyre ka ndodhur nga pafuqia e marrjes së tyre në dorëzim nga vetë shoqëria 'Gjallica". Për më tepër, pas datës 31.12.1997 të përfundimit të afatit të kontratave të sipërmarrjes, çdo pretendim i shoqërisë "Gjallica" për përmbushjen e tyre u bë i vonuar, duke sjellë parashkrimin e së drejtës për kërkimin e përmbushjes së detyrimeve, qoftë sipas ligjit grek, që parashikon një afat 5-vjeçar, ashtu edhe sipas ligjit shqiptar, që parashikon një afat 10-vjeçar. Pretendimet e asaj shoqërie në çdo rast u ngritën në vitin 2010. Ajo shoqëri nuk ka të drejtë të kërkojë pagesën e cilësdo shumë nga kërkuesi i tretë, i cili nuk ka qenë palë kontraktuese. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm po ashtu nuk kanë mbajtur parasysh as faktin se çështja është gjykuar nga gjykatat greke, vendimet e të cilave nuk janë marrë parasysh dhe as nuk përmenden në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

14.4. *Së drejtës së ankimit,* pasi Gjykata e Lartë, për sa kohë që gjykata e apelit ka gjykuar si shkallë e parë, duhet ta gjykonte çështjen si

gjykatë e shkallës së dytë, pra në themel, duke marrë në shqyrtim të gjitha provat e paraqitura nga kërkuesit dhe çdo provë tjetër të nevojshme dhe nuk mund të vendoste mospranimin e rekursit.

14.5. *Standardit të arsyetimit gjyqësor,* pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë të arsyetuara. Gjykatat nuk kanë marrë në analizë provat shkresore të administruara në gjykim e aq më pak të kërkonin dhe administronin provat e tjera shkresore. Përfundimet e tyre janë të paarsyetuara dhe pa asnjë analizë juridike, duke mos respektuar kërkesat e neneve 16 e vijues të KPC-së në lidhje me cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen dhe zgjidhjen e saj në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që kanë qenë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ato gjykata.

15. ***Subjektet e interesuara, shoqëria "Gjallica" në administrim dhe Zyra Përmbarimore Elbasan***, nuk kanë paraqitur parashtrime me shkrim edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

16. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku sipas nenit 16, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, përfshihen si të huajt, ashtu edhe personat juridikë, sikurse janë edhe kërkuesit në këtë gjykim. Në këtë këndvështrim, kërkuesit legjitimohen *ratione*

personae si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

18. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

19. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 27.06.2024, i cili, sipas shkresës së Gjykatës së Lartë, bashkëlidhur kërkesës, është publikuar në faqen e saj zyrtare më 13.09.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 09.01.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

20. Në lidhje me kriterin e legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *parimit të paanshmërisë në gjykim,* pasi gjyqtarët A.A. dhe A.V. kanë marrë pjesë si në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të padisë, ashtu edhe në atë që ka gjykuar kërkimet e padisë për themelin e mosmarrëveshjes në lidhje me kundërshtimin e veprimeve përmbarimore dhe pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë. Sipas kërkuesve, edhe pse është kërkuar përjashtimi ose heqja dorë e këtyre gjyqtarëve, kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë.

21. E drejta për t`u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si element i së drejtës për proces të rregullt, nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar atë në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim

tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 4, datë 25.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata konstaton se pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka njoftuar datën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit dhe përbërjen e trupit gjykues, kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për përjashtimin e dy prej gjyqtarëve të trupit gjykues, me pretendimin se ndodhen përpara rastit të parashikuar nga neni 72, pika 4, i KPC-së, në situatën që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka dhënë vendimin nr. 00-2024-17(4), datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur përfundimisht pushimi i çështjes. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin e datës 25.06.2024, ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar.

23. Bazuar në faktet dhe standardet si më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret pjesëmarrja në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesve edhe e dy gjyqtarëve të asaj gjykate që kanë marrë pjesë në kolegjin që ka shqyrtuar më parë rekursin e tyre në procesin gjyqësor për rivendosjes në afat të padisë, nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të vërë në lëvizje të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme. Në këtë kuptim, pavarësisht se proceset gjyqësore janë vënë në lëvizje nga të njëjtat palë (kërkuesit) dhe në thelb lidhen me të njëjtën mosmarrëveshje, në procesin e parë gjyqësor, duke vendosur pushimin e çështjes, gjyqtarët nuk kanë gjykuar dhe as janë shprehur për faktet dhe ligjin që qëndrojnë në themel të mosmarrëveshjes së palëve ndërgjyqëse, e cila ka qenë objekt i procesit gjyqësor të kundërshtuar. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, për sa kohë që gjyqtarët nuk kanë gjykuar dhe nuk janë shprehur më parë për themelin e kësaj çështjeje, pra për të njëjtën çështje, vetëm pjesëmarrja e tyre në dy vendimet gjyqësore në fjalë nuk krijon dyshim të justifikuar për mungesën e paanshmërisë së tyre në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

24. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së ankimit* sipas nenit 43 të Kushtetutës, pasi për sa kohë që gjykata e apelit ka gjykuar çështjen si shkallë e parë, Gjykata e Lartë duhet ta gjykonte si gjykatë e shkallës së dytë, pra në themel, dhe nuk mund të vendoste mospranimin e rekursit. Neni 43 i Kushtetutës i garanton individit të drejtën për t'u ankuar të paktën një herë ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo

e drejtë kuptohet si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 27, datë 09.05.2012; nr. 12, datë 14.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete ka qenë gjykata e apelit, kurse Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për ushtrimin e juridiksionit rishikues për kontrollin e vendimmarrjes së gjykatës së apelit, në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës dhe nenit 43 të Kushtetutës, si instanca më e lartë gjyqësore për kontrollin e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykata më e ulët. Në kushtet që Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, pavarësisht se kjo e fundit e ka shqyrtuar çështjen në shkallë të parë, juridiksioni i saj në rastin konkret është ai rishikues, i përcaktuar nga mjeti procedural i përdorur nga vetë kërkuesit (rekursi) në përputhje me kompetencat e asaj gjykate sipas nenit 141 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesve u është garantuar e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë dhe vetëm fakti i shqyrtimit paraprak të rekursit në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës kushtetuese të ankimit. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesve është haptazi i pabazuar.

25. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar se janë cenuar: *parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim,* për shkak se gjykata e apelit, edhe pse ka gjykuar si shkallë e parë, nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga kërkuesit dhe nuk ka zhvilluar një hetim shterues; *e drejta për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* në drejtim të kompetencës të gjykatave shqiptare për shqyrtimin e kësaj çështjeje; *e drejta e aksesit,* për shkak se përfundimi i gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë si të parashkruar është i pabazuar në prova dhe ligj, pasi gjykimi i çështjes ka qenë i lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, padi që nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet në çdo kohë; *standardi i arsyetimit,* pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë të arsyetuara në rrethanat kur për përfundimet e arritura mungon analiza e provave dhe ajo juridike, duke mos vënë përballë faktet dhe provat në raport me ligjin në fuqi, pretendime këto me natyrë kushtetuese, ndaj do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel. Në lidhje me pretendimet e

kërkuesve në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e tyre, për sa kohë që kanë të bëjnë me mënyrën sesi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë trajtuar dhe u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura përpara tyre nga kërkuesit, vlerëson që këto pretendime t`i shqyrtojë në themel së bashku.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

26. Kërkuesit kanë pretenduar se përfundimi i gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë si të parashkruar është i pabazuar në prova dhe ligj, pasi padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është një padi që, sipas ligjit të kohës, nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet në çdo kohë, ndaj gjykata e apelit ishte e detyruar ta shqyrtonte atë në themel, duke marrë të gjitha provat që vërtetonin se detyrimi nuk ekzistonte ose ekzistonte në një masë më të vogël. Po sipas tyre, vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë të arsyetuara. Gjykatat nuk kanë marrë në analizë provat shkresore të administruara në gjykim e aq më pak të kërkonin dhe administronin provat e tjera shkresore. Sipas kërkuesve, përfundimet e tyre janë të paarsyetuara dhe pa asnjë analizë juridike, duke mos respektuar kërkesat e neneve 16 e vijues të KPC-së, në lidhje me cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen dhe zgjidhjen e saj në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që kanë qenë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ato gjykata.

27. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të çështjes së tij nga një gjykatë. E drejta e aksesit i garanton individit t'i drejtohet një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tij dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet*

nr. 26, datë 09.04.2024; nr. 22, datë 25.04.2023; nr. 14, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Nga ana tjetër, kjo e drejtë kushtetuese përfshin edhe atë për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit edhe nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 22, datë 06.06.2011; nr. 18, datë 18.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar në gjykimin kushtetues, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje me padinë e kërkuesve. Ata kanë kundërshtuar veprimin përmbarimor, vendimin e sekuestros, sikundër edhe titujt ekzekutivë, vendimet e administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, duke kërkuar anulimin, përveçse edhe pezullimin e ekzekutimit të tyre. Gjithashtu, ata kanë kërkuar edhe rivendosjen në afat të padisë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 15, datë 12.04.2011, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesve, me arsyetimin se ajo është paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga ligji i veçantë (ligji nr. 8471/1999) dhe se kërkuesit, ndonëse në objektin e padisë kanë kërkuar edhe rivendosjen në afat të saj, nuk paraqitën asnjë provë që të justifikonte mosveprimin në kohë të tyre për kundërshtimin e titujve ekzekutivë.

30. Çështja, në vijim, mbi rekursin e kërkuesve, është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin nr. 00-2015-1251(379) datë 09.06.2015, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, duke e kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit. Ai kolegj ka vlerësuar se shoqëria "Gjallica" në administrim, në lidhje me vendimet objekt padie të administratorëve, nuk e ka realizuar njoftimin në përputhje me kërkesat e nenit 6 të ligjit nr. 8471/1999, pasi emrat e debitorëve janë shpallur vetëm në dy gazeta kombëtare, por nuk

janë publikuar në mediat elektronike dhe në stendat e asaj shoqërie në administrim, ndërkohë që sipas ligjit njoftimi i debitorit konsiderohet i kryer kur bëhet në të tria mënyrat e njoftimit të përcaktuara në këtë dispozitë. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit në rigjykim duhet të hetojë nëse listat ku figurojnë debitorë paditësit (kërkuesit) janë afishuar në stendën pranë selisë së shoqërisë "Gjallica" në administrim dhe nëse ato janë publikuar në ndonjë medie elektronike, ku vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore dhe çdo veprimi tjetër që do të vlerësohet i domosdoshëm, mund të arrihet në një përfundim të drejtë për afatin e ngritjes së padisë dhe shkaqet e humbjes së tij.

31. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 08.06.2016, ka vendosur ndarjen dhe gjykimin veçmas të kërkimeve të padisë. Fillimisht, me vendimin nr. 49/2016, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkimit për rivendosjen në afat të padisë, me arsyetimin se edhe pse shoqëria "Gjallica" në administrim nuk ka paraqitur akte provuese për publikimin e vendimeve të kundërshtuara të administratorëve të saj nëpërmjet mjeteve elektronike dhe shpalljes së tyre pranë selisë së saj, provohet se paditësit (kërkuesit) padinë për kundërshtimin e titujve ekzekutivë e kanë paraqitur përtej afatit 10-ditor sipas ligjit të veçantë. Paditësit kanë marrë dijeni për ato vendime të administratorëve në datën 14.06.2010, gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, kur përfaqësuesit të kërkuesit të tretë i është komunikuar veprimi përmbarimor i sekuestros. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, ky mosveprim në kohën e duhur passjell humbjen e afatit për shkaqe subjektive që nuk justifikojnë rivendosjen e tij gjyqësisht në kuptim të neneve 151 dhe 152 të KPC-së. Për sa i përket rivendosjes në afat të kundërshtimit të veprimit përmbarimor, gjykata e apelit ka vlerësuar se kundërshtimi i kërkuesit të parë është paraqitur brenda afatit ligjor, ndaj kërkesa e tij për rivendosjen në afat është e papërligjur, kurse kundërshtimet e kërkuesve të tjerë janë paraqitur përtej afatit ligjor 5-ditor.

32. I vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesve, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-17(4), datë 11.01.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se kërkimi i kërkuesve për rivendosjen në afat të së drejtës për të ngritur padi kundër përmbaruesit gjyqësor dhe shoqërisë "Gjallica", sipas nenit 151 të KPC-së, është një kërkim që nuk mund të ngrihej, pasi instituti i rivendosjes në afat është i zbatueshëm vetëm për afatet procedurale dhe jo për afatet materiale,

ndërkohë që afati për ngritjen e padisë rregullohet posaçërisht në të drejtën materiale, pavarësisht ligjit ku ai parashikohet.

33. Për sa i përket procesit të dytë, atij të themelit, Gjykata Administrative e Apelit fillimisht e ka pezulluar gjykimin e çështjes deri në përfundim të procesit gjyqësor për rivendosjen në afat të padisë. Pasi ky proces ka përfunduar në gjykatën e apelit, por përpara se Gjykata e Lartë të vendoste përfundimisht për këtë çështje, Gjykata Administrative e Apelit ka rifilluar gjykimin e çështjes së themelit dhe me vendimin nr. 24 (86-2017-1981), datë 09.05.2017 ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesve. Sipas asaj gjykate, për zgjidhjen e çështjes duhet të merrte në konsideratë përfundimet e arritura në vendimin nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili përbënte vendim gjyqësor të formës së prerë në kuptim të nenit 451/a të KPC-së. Referuar përfundimeve të këtij vendimi, sipas të cilit padia e paditësve (kërkuesve) në lidhje me kërkimin për anulimin e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, është parashkruar për shkak të mosveprimit në kohë të titullarit të së drejtës subjektive, në kuptim të nenit 112 të Kodit Civil (*KC*), ajo gjykatë ka vlerësuar se ka pengesë ligjore për shqyrtimin në themel të këtij kërkimi padie, ndaj duhet të vendosë rrëzimin e tij si padi e parashkruar. Nga ana tjetër, po referuar vendimit të saj nr. 49/2016, gjykata e apelit ka arsyetuar se është rasti për shqyrtimin në themel vetëm të pretendimit të kërkuesit të parë për kundërshtimin e veprimit përmbarimor të sekuestros, për të cilin ai nuk ka parashtruar asnjë shkak se ku konsistonin shkeljet e kryera nga Zyra e Përmbarimit Elbasan. Sipas saj, pretendimet e këtij kërkuesi lidhen vetëm me pabazueshmërinë në fakt dhe në të drejtë të vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, të cilat mbetën të pacenuara për shkak të pengesës procedurale për t'i shqyrtuar ato në themel. Për rrjedhojë, edhe ky kërkim padie është vlerësuar i pabazuar nga ana e asaj gjykate.

34. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje nga kërkuesit, me vendimin nr. 00-2024-2777, datë 27.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Ai kolegj ka vlerësuar se shkaqet e parashtruara në rekurs janë të njëjta në përmbajtje me pretendimet/prapësimet në gjykimin administrativ të zhvilluar në gjykatën e apelit, të cilave ajo u ka dhënë përgjigje përfundimtare, duke sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, si dhe duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që

lidhen me to. Sipas atij kolegji, përfundimi i Gjykatës Administrative të Apelit është rrjedhojë e një analize tërësore dhe objektive të provave dhe të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga gjykata e apelit, e cila ka bërë një analizë të hollësishme nenit 112 të KC-së në lidhje me dispozitat e ligjit nr. 8471/1999, të zbatueshme për mosmarrëveshjen në gjykim.

35. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit, në procesin gjyqësor të kundërshtuar, nuk ka shqyrtuar në themel padinë e kërkuesve, me argumentin se për të është i detyrueshëm për zbatim vendimi i saj nr. 49/2016, ndonëse ky vendim ishte ankimuar në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë, kjo e fundit, ndonëse më herët ka prishur vendimin nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe ka pushuar gjykimin e asaj çështjeje, në çështjen në shqyrtim ka konsideruar të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit, megjithëse vendimi ku ajo është bazuar, në momentin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, nuk ishte më pjesë e rendit juridik dhe asnjë diskutim nuk shtrohej për pasjen ai të ndonjë efekti juridik. Në këtë drejtim, Gjykata çmon të ritheksojë se një vendim i gjykatës së apelit konsiderohet si i formës së prerë në kuptim të fuqisë ekzekutive, por ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar *(res judicata)* nëse palët kanë përdorur mjetet e zakonshme të ankimit *(shih vendimin nr. 55, datë 07.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese).* Pra, në aspektin formal, gjë e gjykuar nënkupton mosankimueshmërinë e vendimit gjyqësor përmes mjeteve të zakonshme, përfshirë edhe të rekursit në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar padinë e kërkuesve, pa e shqyrtuar atë në themel, me arsyetimin se ishte parashkruar, duke u bazuar për këtë në një vendim gjyqësor, i cili jo vetëm nuk ishte përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar *(res judicata),* për shkak se ndaj tij ishte paraqitur rekurs nga kërkuesit, por edhe se më vonë ai u prish nga gjykata më e lartë. Ky qëndrim i Gjykatës Administrative të Apelit u gjet i drejtë nga Gjykata e Lartë, ndonëse ajo, për më tepër, atë vendim gjyqësor të konsideruar si pengesë për shqyrtimin në themel të padisë (vendimin nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit) e kishte prishur dhe ajo çështje ishte pushuar. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka vepruar në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës, duke mos kontrolluar mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykata e apelit, për më tepër, edhe në kuptim të vendimmarrjes së mëparshme të vetë asaj gjykate.

36. Gjykata vlerëson se ajo mënyrë të vepruari nga gjykatat e zakonshme në procesin gjyqësor të kundërshtuar ka bërë që kërkuesit të mos kenë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e tyre në lidhje me (pa)vlefshmërinë e titujve ekzekutivë dhe, për rrjedhojë të kësaj, edhe të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, duke iu cenuar atyre e drejta e aksesit. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata është i bazuar, ndaj vendimet objekt kërkese duhet të shfuqizohen dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

37. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesve në drejtim *të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* për shkak të mosmarrjes së provave dhe moshetimit të çështjes, si dhe s*ë drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, e lidhur kjo me kompetencën e gjykatave shqiptare për gjykimin e padisë, Gjykata, në kushtet që çështja e kërkuesve do të rigjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson të mos ndalet në analizën e tyre, për sa kohë që gjatë gjykimit në themel kërkuesit kanë të gjitha mundësitë të kërkojnë paraqitjen ose marrjen e provave, si dhe të parashtrojnë pretendimet e tyre përpara asaj gjykate.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 24 (86-2017-1981), datë 09.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-2777, datë 27.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.10.2025
Shpallur më 11.11.2025

Vendim nr. 57, datë 14.10.2025
(V-57/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datat 25.09.2025 dhe 14.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ELTON QYNO**, përfaqësuar nga avokat Dorian Matlija, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
AVOKATURA E SHTETIT, në mungesë.
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, në mungesë.

OBJEKTI: **Plotësimi i vendimit nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Neni 313 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkuesit Elton Qyno *(kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 14.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për lejimin e kontrolleve personale dhe të vendeve (banesë dhe vendi i punës), vendimeve gjyqësore për sekuestrimin e provave materiale (sende dhe të dhëna kompjuterike) dhe vendimit të prokurorit për sekuestrimin e dy aparateve telefonike, si dhe shkatërrimin e të gjitha kopjeve të të dhënave të nxjerra nga pajisjet e sekuestruara. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 23.07.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, por në seancën plenare të datës 05.03.2025 Gjykata e ka ndryshuar formën e shqyrtimit të çështjes në atë publike, me praninë e palëve.

2. Në parashtrimet përpara seancës së datës 02.04.2025, kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka kërkuar rimbursimin e shpenzimeve të përfaqësimit në masën 263.500 lekë në rastin eventual të pranimit të ankimit kushtetues individual. Këtë kërkim ai e ka përsëritur edhe në konkluzionet përfundimtare të seancës së datës 10.04.2025.

3. Në përfundim të gjykimit kushtetues, Gjykata, me vendimin nr. 21, datë 22.04.2025, (*vendimi nr. 21/2025*) vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesës, shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë lejuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike të nxjerra nga provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe të vendit të punës së kërkuesit, si dhe asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara me këto vendime. Vendimi nr. 21/2025 i Gjykatës është shpallur në datën 21.05.2025 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 26.05.2025.

4. Në datën 28.05.2025 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë, me objekt plotësimin e vendimit nr. 21/2025 lidhur me shpenzimet e përfaqësimit. Kolegji i Gjykatës, në datën 08.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi nr. 21/2025 i Gjykatës duhet të plotësohet me disponimin për rimbursimin e shpenzimeve të përfaqësimit, sipas faturës tatimore të lëshuar nga avokati. Ato shpenzime janë reale dhe të nevojshme për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së kërkuesit si gazetar, që përbënte çështje komplekse në hartimin e ankimit kushtetues individual dhe përfaqësimin në seancë.

6. ***Subjektet e interesuara, Avokatura e Shtetit dhe Prokuroria e Posaçme***, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Në rastet kur Gjykata vihet në lëvizje për plotësimin e vendimit të saj, legjitimimi i kërkuesit dhe procedura parashikohen në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Vendimi i Gjykatës në këto raste publikohet në Fletoren Zyrtare. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*), sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata.

8. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata çmon se në rastin konkret kërkuesi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës sipas objektit, pasi ka qenë palë pjesëmarrëse në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi nr. 21/2025 i Gjykatës dhe i është drejtuar asaj në datën 28.05.2025, pra brenda 2 muajve nga data 21.05.2025 kur është shpallur vendimi. Po kështu, kërkimi për të plotësuar vendimin edhe me disponimin për shpenzimet gjyqësore, sipas nenit 28 të ligjit nr. 8577/2000, hyn në kompetencën lëndore të Gjykatës të përcaktuar nga neni 80 i të njëjtit ligj, i cili emërtohet "*Saktësimi dhe plotësimi i vendimit*", pasi është kërkim i paraqitur në parashtrimet shtesë të ankimit kushtetues individual të parë dhe nuk ndryshon thelbin e vendimmarrjes, ndaj, në vijim, Gjykata do ta analizojë atë në themel.

9. E drejta për të kërkuar shpenzimet e përfaqësimit parashikohet në

nenin 28 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit shpenzimet e procesit gjyqësor u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (*pika 1*), dhe kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar në nenin 14 të Rregullores, që përcakton se kur Gjykata vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

10. Gjykata ka pohuar se çështja e shpenzimeve gjyqësore është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre kufizon në mënyrë të pajustifikuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimet nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi është përfaqësuar nga i njëjti avokat që në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual fillestar (14.06.2024), ndërsa kërkesën për pagesën e shpenzimeve të përfaqësimit e ka parashtruar në parashtrimet para seancës publike të datës 02.04.2025 dhe përsëritur në konkluzionet e datës 10.04.2025, duke paraqitur edhe faturën tatimore. Kjo e fundit përmban vlerën e përgjithshme prej 263.500 lekësh, si rezultat i vlerës për përfaqësimin në gjykimin kushtetues (186.000 lekë) dhe asaj për paraqitjen e kërkesës (77.500 lekë). Kërkuesi ka argumentuar se shpenzimet e pasqyruara në faturën tatimore të fiskalizuar janë reale dhe ato janë të nevojshme, pasi në themel të ankimit kushtetues individual fillestar qëndronte vlefshmëria e një mase hetimore që prekte lirinë e shprehjes

së kërkuesit si gazetar. Sipas tij, çështja ishte komplekse, pasi kërkonte hartimin e ankimit kushtetues individual sipas standardeve kushtetuese dhe evropiane, analizën krahasimore me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), analizën e ligjshmërisë së masave të veprimeve hetimore dhe trajtimin e parimeve kushtetuese dhe konventore të zbatueshme në rastin e kërkuesit, të cilat kërkojnë ndihmë profesionale. Po sipas kërkuesit, koha e shpenzuar për këtë çështje ka qenë mbi 120 orë pune, ndonëse në faturën tatimore janë pasqyruar vetëm 20-50 orë. Kërkuesi mund të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve të përfaqësimit vetëm pranë saj, ndërkohë shpenzimet në shkallët më të ulëta të gjyqësorit mbeten të pakompensuara për shkak të natyrës së gjykimit penal.

12. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkimi i kërkuesit për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar përpara marrjes së vendimit për pranimin e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me masën, Gjykata, duke marrë në konsideratë faktin se gjykimi kushtetues i përfunduar me vendimin nr. 21/2025 ka qenë relativisht kompleks, se çështja ka të bëjë me kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të fazës së hetimit penal, numrin e seancave të zhvilluara në Gjykatë dhe zhvillimin e disa prej tyre në seancë publike me praninë e palëve, mungesën e formimit dhe të përvojës juridike për të kuptuar çështjen (profesion gazetar), si dhe numrin e pretendimeve të pranuara nga Gjykata, vlerëson masën e shpenzimeve të përfaqësimit në vlerën 200.000 lekë.

13. Për sa i përket subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka vënë në dukje se në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit (*shih vendimet nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se detyrimi për pagimin e shpenzimeve të përfaqësimit duhet t'i ngarkohet Ministrisë së Financave.

14. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Plotësimin e vendimit nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese në dispozitivin e tij si më poshtë:

"*Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave*.".

3. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 14.10.2025
Shpallur më 04.11.2025

Vendim nr. 58, datë 15.10.2025
(V-58/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datat 02.10.2025 dhe 08.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 22 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SINDIKATA E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR**, përfaqësuar nga kryetari Gentian Stroni dhe avokatët Semir Sali e Esmeralda Maillard (Ndoci), me autorizim.
URDHRI I MJEKËVE TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Presidenti i Këshillit Kombëtar, Dritan Trepça dhe studioja ligjore "Inter Partes" sh.p.k., me avokatë Shkëlzen Selimi dhe Rilinda Selimi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Mimoza Arbri dhe Flavieta Bela, me autorizim.
KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja dhe Herald Jonuzaj, Vangelt Duni, Mejvis Kola, Olsi Akshia, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i aktit normativ nr. 2, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë"", miratuar me ligjin nr. 94/2024, datë 12.09.2024 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 18.10.2024.**
Në alternativë:

Shfuqizimi i neneve 1, 2, 3, 4, shkronja "ç", 7, 8, 9, 10 dhe 11 të aktit normativ nr. 2, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë"", si dhe shfuqizimi i nenit 5 të aktit normativ nr. 2, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë"" që shton nenin 8/a, pika 3, në ligjin nr. 123/2014.

Dhe në alternativë:

Shfuqizimi dhe deklarimi i ometimit ligjor nga ana e kësaj dispozite të (i) mundësisë së mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv (me kohë të plotë) ose joekskluziv (me kohë të pjesshme); si dhe (ii) trajtimit me pagesë suplementare për mjekët që zgjedhin raport pune ekskluziv me strukturën spitalore publike.

Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 10.02.2025 "Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 11, 17, 18, 42, 46, 49, 55, 59, 101, 124, 131, pika 1, shkronja "a", 134, pikat 1, shkronja "h" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 8 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj; neni 26 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes andër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesve, Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor *(Sindikata)* dhe Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë *(Urdhri i Mjekëve),* që kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 123, datë 25.09.2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 123/2014*), i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të veprimtarisë së Urdhrit të Mjekëve dhe marrëdhëniet juridike të profesionistëve mjekësorë. Sipas nenit 3 të këtij ligji, Urdhri i Mjekëve është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të këtij urdhri dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

2. Në datën 01.08.2024 Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 2 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë"" (*akti normativ nr. 2/2024*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 07.08.2024. Objekti i tij, sipas relacionit shoqërues, është rregullimi dhe përmirësimi i veprimtarisë dhe i menaxhimit të profesionit të mjekut në Shqipëri, duke siguruar standardet më të larta etike dhe profesionale. Ndryshimet ligjore synojnë të forcojnë rregullat dhe disiplinën brenda profesionit të mjekut, të sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie, duke eliminuar konfliktet e interesit gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Në datën 12.09.2024 Kuvendi, me ligjin nr. 94/2024 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 2, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë""" (*ligji nr. 94/2024*), ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 2/2024. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 18.10.2024.

4. Akti normativ nr. 2/2024 ka ndryshuar pjesërisht nenet 4, 5, 7, 8, 11,

13, 14 dhe 19 të ligjit nr. 123/2014, tërësisht nenet 16, 17 dhe 18 të këtij ligji, si dhe ka shtuar nenin 8/a. Këto shtesa dhe ndryshime lidhen me kompetencat e Urdhrit të Mjekëve, kriteret dhe ndërprerjen e anëtarësisë, detyrimet e anëtarëve të këtij urdhri, kushtet e ushtrimit të profesionit, organet e Urdhrit të Mjekëve, përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar, funksionet e këshillave rajonalë, komisionet disiplinore, masat disiplinore dhe ankimin gjyqësor, si dhe kompetencën e Këshillit Kombëtar për Kodin e Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore.

5. Në vijim, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 16, pika 4, të ligjit nr. 123/2014, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 85, datë 05.02.2025 "Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit" (*VKM-ja nr. 85/2025*). Ky akt është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 26, datë 10.02.2025. Vendimi ka për qëllim të përcaktojë rregullat për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit, duke siguruar një proces të rregullt ligjor për shqyrtimin e pretendimeve për shkelje disiplinore dhe zbatimin e masave disiplinore, në përputhje me parimet e transparencës dhe të llogaridhënies në sistemin shëndetësor. Ai zbatohet për mjekët që ushtrojnë profesionin në institucionet shëndetësore publike dhe jopublike në Republikën e Shqipërisë.

6. Sipas VKM-së, Komisioni i Disiplinës funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët kanë përvojë në fushën e mjekësisë ose në fushën juridike: 3 (tre) përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve, me përvojë ose specializim në çështje të Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore; 1 (një) përfaqësues i emëruar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, me njohuri në fushën shëndetësore ose në procedurat administrative; shefi i shërbimit të specialitetit të mjekut, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen. Ndërsa Komisioni i Apelimit ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me të drejtë rizgjedhjeje: 2 (dy) përfaqësues të zgjedhur nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë; 1 (një) përfaqësues i zgjedhur nga Urdhri i Mjekëve; 1 (një) përfaqësues i zgjedhur nga Fakulteti i Mjekësisë; 1 (një) ekspert i jashtëm, i specialitetit të mjekut, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen.

7. Sindikata i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 18.12.2024 me kërkesë, me objekt shfuqizimin e aktit normativ nr. 2/2024 ose në alternativë shfuqizimin e neneve 1, 2, 3, 4, shkronja "ç", 5, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të tij, ose deklarimin e ometimit ligjor të mundësisë së mjekëve që

punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv (me kohë të plotë) ose joekskluziv (me kohë të pjesshme), si dhe trajtimin me pagesë suplementare për mjekët që zgjedhin raport pune ekskluziv me strukturën spitalore publike. Kërkesa pasi është plotësuar sipas përcaktimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 23.12.2024. Me vendimin e datës 18.02.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

8. Në datën 26.05.2025 kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, me objekt shfuqizimin e aktit normativ nr. 2/2024 dhe të VKM-së nr. 85/2025, e cila, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 30.05.2025. Me vendimin e datës 16.07.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 22.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike dhe bashkimin me çështjen e paraqitur më herët nga Sindikata në një të vetme.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesja,*** *Sindikata*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

9.1. *Për legjitimimin*

Kërkuesja legjitimohet, pasi është krijuar si organizatë sindikale kombëtare dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Akti normativ nr. 2/2024, si dhe ligji miratues prekin drejtpërdrejt interesat ekonomikë dhe shoqërorë të anëtarëve të Sindikatës që janë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve dhe sjellin pasoja negative për të. Ajo legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e saj. Konkretisht, për pretendimin e cenimit të nenit 101 të Kushtetutës kërkuesja legjitimohet, pasi Gjykata, në vendimin nr. 1, datë 06.02.2013, ka legjitimuar shoqatën kërkuese në një rast të ngjashëm, akti normativ është çështje që prek interesin e drejtpërdrejtë të Sindikatës, si dhe cenon parimin e shtetit të së drejtës.

9.2. *Për themelin e kërkesës*

Akti normativ nr. 2/2024 ka cenuar:

9.2.1. *Nenin 101 të Kushtetutës,* duke mos u identifikuar konkretisht

ngjarja e jashtëzakonshme që ka sjellë nevojën e miratimit. Argumenti i Këshillit të Ministrave për parandalimin e menjëhershëm të spekulimeve nuk është bazuar në fakte konkrete, pasi dypunësimi i mjekëve është një fenomen 20-vjeçar, për të cilin qeveria është në dijeni dhe nuk mund të justifikohet se rrethana është e pavarur nga vullneti i saj. Për më tepër, një ngjarje e vetme penale nuk mund të konsiderohet si "situatë jo e zakonshme", e cila kërkon nevojën urgjente për ndërhyrje nëpërmjet një akti normativ. Për sa kohë kontrolli dhe disiplinimi administrativ i mjekëve bëhet nga titullarët e emëruar nga ekzekutivi, ngjarja e ndodhur ishte e varur nga vullneti i qeverisë. Gjithashtu, provohet ekzistenca e mjeteve të tjera ligjore për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave që parashikon akti normativ. Pretendimet se legjislacioni nuk ka rezultuar efektiv dhe është miratuar për eliminimin e konfliktit të interesit nuk qëndrojnë, për sa kohë ky i fundit është i rregulluar mjaftueshëm në Kodin e Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore. Ndryshimet ligjore mund të ndiqnin rrugën e zakonshme të miratimit nga ligjvënësi, qoftë edhe me procedurë të përshpejtuar. Akti normativ është miratuar pa asnjë analizë reale paraprake të gjendjes aktuale dhe nuk plotëson kriterin e "masës së përkohshme", si dhe është kontradiktor e nuk është i nevojshëm për arritjen e dy objektivave kryesorë të tij.

9.2.2. *Parimin e shtetit të së drejtës,* pasi pushteti ekzekutiv ka ndërhyrë në miratimin e Kodit të Etikës, mënyrën e ngritjes, funksionimin dhe përbërjen e anëtarëve të komisioneve disiplinore, duke cenuar pavarësinë dhe vetërregullimin e Urdhrit të Mjekëve. Këshilli i Ministrave nuk ka paraqitur asnjë arsye konkrete për ndryshimin e procedimit disiplinor të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve, duke shkrirë komisionet rajonale dhe atë kombëtar dhe duke i zëvendësuar me komisione të tjera, përbërja e të cilave do të përcaktohet nga pushteti ekzekutiv. Një ndërhyrje e tillë nuk është parashikuar në urdhrat e tjerë në fushën e shëndetësisë. Analogjia e përdorur nga Këshilli i Ministrave nuk qëndron për sa kohë ato profesione kanë karakter publik dhe të deleguar.

9.2.3. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën për punë të*

lidhur me parimin e proporcionalitetit, *të drejtën për kujdes shëndetësor dhe për standardin më të lartë shëndetësor,* të garantuara nga nenet 11, 17, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës. *Së pari*, neni 5 i aktit normativ ka ndaluar dypunësimin për anëtarët e Urdhrit të Mjekëve të punësuar në një institucion shëndetësor publik, që ka përfituar statusin e autonomisë spitalore financiare, kufizim i cili do të zgjasë pa afat dhe ka si qëllim ndalimin tërësisht të dypunësimit në vitin 2026. Ky parashikim ka ometuar (i) mundësinë e mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv ose joekskluziv, si dhe (ii) trajtimin me pagesë suplementare për mjekët që zgjedhin raport pune ekskluziv me strukturën spitalore publike.

Së dyti, ashpërsimi drastik i masave disiplinore është bërë pa një analizë për qëllimin, por ka qenë rrjedhojë e një ngjarjeje të vetme penale. Heqja e licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut në mënyrë të përhershme është e ashpër, arbitrare dhe nënkupton mohimin tërësor të së drejtës për të ushtruar profesionin. Nuk përmbushet as kriteri i përshtatshmërisë, pasi kjo masë përbën dënim plotësues në Kodin Penal dhe mund të arrijë qëllimin e kërkuar. Gjithashtu, detyrimi për të punuar jo më shumë se 30 % të orëve mujore në sistemin publik nuk mund të arrijë qëllimin e kërkuar që mjekët të respektojnë orarin e punës dhe ky kufizim nuk ndikon as në shmangien e interesit.

9.2.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi akti normativ (i) diskriminon mjekët në raport me profesionet e tjera të rregulluara, si: stomatologu, farmacisti, infermieri ose psikologu; (ii) mjekët që punojnë në strukturat universitare me autonomi spitalore në raport me kolegët e tjerë që punojnë në struktura të tjera publike, si dhe (iii) mjekët që punojnë në strukturat shëndetësore me autonomi spitalore dhe që do të lejohen të ushtrojnë dypunësimin në raport me kolegët e tjerë që punojnë në të njëjtën strukturë, por nuk lejohen të ushtrojnë dypunësim. Ky diskriminim paraqitet edhe në raport me masat disiplinore dhe pavarësinë, si dhe vetërregullimin e Urdhrit të Mjekut në procedimet disiplinore.

10. ***Kërkuesi,*** *Urdhri i Mjekëve,* në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

10.1. *Për legjitimimin*

Kërkuesi legjitimohet, pasi është person juridik i krijuar me ligj si ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekut dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut. Ai ka interes real për mbrojtjen e standardeve kushtetuese të funksionimit të profesionit të mjekut në mënyrë cilësore dhe të pavarur. Po kështu, pretendimet e tij janë me natyrë kushtetuese, ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, për sa kohë kërkuesi ka legjitimitet të kushtëzuar, Gjykata ushtron kontrollin kushtetues vetëm nëse provohet shkelje e të drejtave subjektive.

10.2. *Për themelin e kërkesës*

Akti normativ nr. 2/2024 dhe VKM-ja nr. 85/2025 kanë cenuar:

10.2.1. *Nenin 101 të Kushtetutës,* pasi Këshilli i Ministrave nuk ka arritur të provojë nevojën që ka ekzistuar për miratimin e aktit normativ dhe faktin nëse fenomeni i lëvizjes së mjekëve gjatë orarit zyrtar në klinika private ka ekzistuar prej kohësh, duke mos u bazuar në dokumente, raporte ose statistika. Këshilli i Ministrave nuk ka argumentuar nëse fenomeni mund të zgjidhej me ndërhyrje normative ose ishte problematikë e moszbatimit të rregullave ligjore aktuale dhe mosveprimit të autoriteteve për formimin e mekanizmave kontrollues dhe monitorues për respektimin e orarit të punës. Po kështu, nuk përmbushet as kriteri i urgjencës, pasi ngjarja që ka shërbyer për fillimin e procesit është ndjekur penalisht nga prokuroria, ndaj Këshilli i Ministrave nuk pengohej të ndiqte procedurën e zakonshme ligjvënëse. Çështjet e disiplinës në punë dhe respektimi i orarit nuk përbëjnë urgjencë që kërkon miratimin e një akti normativ.

10.2.2. *Lirinë e organizimit dhe parimin e sigurisë juridike të lidhur me parimin e shtetit të së drejtës*, të garantuara nga nenet 46 dhe 4 të Kushtetutës. Akti normativ cenon vetërregullimin e Urdhrit të Mjekëve, si ent i pavarur në shërbim të dhënies së kujdesit mjekësor cilësor të individëve, veçanërisht në nenet 11 dhe 16 të ligjit nr. 123/2014. Ky

parim cenohet edhe nga VKM-ja nr. 85/2025, e cila parashikon organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit. Urdhri i Mjekëve, si ent i pavarur me anëtarësim të detyrueshëm, duhet të ketë autonomi nga Ministria e Shëndetësisë. Dispozitat ligjore të kundërshtuara dobësojnë pavarësinë organizative dhe funksionale të Urdhrit të Mjekëve në disa drejtime. *Së pari*, kompetenca e Ministrisë së Shëndetësisë për të miratuar Kodin e Etikës cenon vetëqeverisjen profesionale të mjekëve, ul përgjegjshmërinë e tyre dhe dëmton besueshmërinë e profesionit, duke lënë pa qëllim dhe efekt vetë misionin e Urdhrit të Mjekëve. *Së dyti*, organizimi dhe funksionimi i komisioneve të disiplinës dhe të apelimit, të cilat rregullohen me VKM, cenojnë pavarësinë organizative të Urdhrit të Mjekëve dhe politizimin e vendimmarrjes, si dhe krijojnë paqartësi, pasi nuk specifikohet sesi do të funksionojnë këto komisione dhe cilat do të jenë garancitë ndaj mjekëve të proceduar administrativisht. E drejta për t'u gjykuar nga një organ i pavarur profesional nuk është parashikuar me një ligj të miratuar me shumicë të cilësuar. Kjo paqartësi thellohet edhe nga VKM-ja nr. 85/2025, e cila parashikon se një nga anëtarët e komisionit do të jetë ekspert i jashtëm pa e qartësuar mënyrën e përzgjedhjes ose organizmin nga i cili do të përzgjidhet, nisur nga fakti se të gjithë mjekët janë pjesë e Urdhrit të Mjekëve. Edhe pjesëmarrja e dy përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë në komision cenon pavarësinë, veçanërisht për shkak se vendimet merren me të paktën 3 anëtarë, duke e lënë praktikisht atë në dorë të ekzekutivit. Delegimi i Këshillit të Ministrave në nenin 16 të aktit normativ parashikon se akti nënligjor mund të ndryshohet lehtësisht në ndryshim nga ligji, i cili garanton qëndrueshmëri. VKM-ja nr. 85/2025 parashikon shpërblim për anëtarët e komisioneve, duke zvogëluar garancitë e Komisionit të Apelimit, të cilët financohen nga buxheti i shtetit, në ndryshim nga Komisioni i Disiplinës, të cilët financohen nga Urdhri i Mjekëve, ndërkohë që relacioni shoqërues i aktit normativ parashikon se ai nuk shoqërohet me efekte financiare. Për më tepër, ndonëse Këshilli i Ministrave

ka pasur detyrimin për nxjerrjen e VKM-së brenda 3 muajve, ajo është miratuar në datën 05.02.2025, duke sjellë pasoja në drejtim të paqartësisë së funksionimit të këtyre organeve disiplinore.

10.2.3. *Lirinë e ushtrimit të profesionit dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike të lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe të drejtën për kujdes shëndetësor,* të garantuara nga nenet 11, 17, 49 dhe 55 të Kushtetutës, për sa i përket raportit 30% të punësimit në sektorin publik dhe privat dhe faktit se masa disiplinore e heqjes së licencës nuk shuhet asnjëherë. Ndërhyrja nuk plotëson kriterin e proporcionalitetit, pasi përbën një masë të ashpër në raport me qëllimin që synohet të arrihet. *Së pari*, kufizimi i punësimit në sektorin privat në 30% të orëve mujore ka fuqi prapavepruese dhe nuk janë parashikuar dispozitat tranzitore, duke u dëmtuar planet e aktivitetit ekonomik të mjekëve dhe pa marrë parasysh kreditë ose detyrimet financiare të tyre. Po kështu, raporti 30% nuk është argumentuar ose bazuar në ndonjë studim specifik. *Së dyti,* mosshuarja e masës disiplinore cenon dinjitetin njerëzor dhe thelbin e së drejtës për të ushtruar profesionin e mjekut. Po kështu, këto të drejta cenohen edhe nga neni 5 i aktit normativ që ka shtuar nenin 8/a të ligjit në lidhje me kushtet dhe procedurën që duhet të ndjekë një mjek, i cili kërkon të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik. Në këtë mënyrë cenohet aksesi në shëndetësi i qytetarëve dhe *e drejta për kujdes shëndetësor cilësor*.

10.2.4. *Procesin e rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili zbatohet edhe në procesin ligjvënës, pasi kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur brenda një kohe të arsyeshme gjatë procesit ligjvënës. Ndonëse Urdhri i Mjekëve është njoftuar për seancën dëgjimore në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, ky njoftim ka ardhur pas kërkesës për të pasur seancë dëgjimore. Kërkuesit nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme (vetëm 3 ditë) për t'u përgatitur, dëgjuar dhe mbrojtur në seancën dëgjimore, veçanërisht duke mbajtur në konsideratë faktin se akti normativ është miratuar në kushte urgjence.

11. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se:

11.1. *Për juridiksionin e Gjykatës*

Urdhri i Mjekëve nuk është një organ kushtetues, nuk është i parashikuar nga Kushtetuta dhe nuk përmendet në të, për rrjedhojë organizimi dhe funksionimi i tij nuk gëzojnë mbrojtje kushtetuese. Ligjvënësi ka diskrecion të plotë që të vendosë për organizimin e profesioneve dhe formën e organizimit dhe kërkuesja, Sindikata, nuk ka arritur të provojë se cila e drejtë themelore kushtetuese i është cenuar nga mënyra e organizimit të Urdhrit të Mjekëve.

11.2. *Për legjitimimin e kërkueses, Sindikatës*

Kërkuesja nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për të kundërshtuar organizimin e Urdhrit të Mjekëve, pasi akti normativ nuk ka asnjë ndikim mbi vetë atë. Ajo është një sindikatë me organizim vullnetar, me objekt të ndryshëm nga Urdhri i Mjekëve, i cili është i krijuar me ligj. Për rrjedhojë, ajo nuk legjitimohet që të kërkojë shfuqizimin e një ligji që rregullon veprimtarinë e një organizate tjetër. Kërkuesja nuk legjitimohet as për pretendimin për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, pasi është subjekt i kushtëzuar dhe nuk provohet se asaj i janë cenuar të drejta kushtetuese. Ajo nuk legjitimohet as për pretendimin e cenimit të parimit të shtetit të së drejtës, pasi krijimi i institucioneve administrative që shërbejnë për rregullimin e profesioneve të ndryshme është diskrecion i Kuvendit. Urdhri i Mjekëve nuk është organ kushtetues ose institucion i parashikuar nga Kushtetuta. Ajo nuk legjitimohet as nga ana formale, pasi nuk paraqitet asnjë dokumentacion që autorizon kryetarin e Sindikatës të veprojë në emër dhe për llogari të saj. Po kështu, kryetari i Sindikatës rezulton të jetë zgjedhur që në datën 14.11.2019, ndonëse statuti parashikon se ai ka një mandat 1-vjeçar.

11.3. *Për themelin e pretendimeve*

11.3.1. Pretendimi për cenimin e *nenit 101 të Kushtetutës* është i pabazuar. Për sa i përket *kriterit të nevojës*, pretendimi se një ngjarje e vetme nuk mund të justifikojë nismën ligjore është i pabazuar. Edhe deklaratat e mëparshme të Këshillit të Ministrave nuk mund të merren në konsideratë, pasi ato janë deklarata politike dhe nuk bazohen në raporte inspektimi. Pretendimi se ekzistojnë akte të tjera ligjore dhe nënligjore

nuk qëndron, pasi Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave nuk kanë asnjë ndalim kushtetues për të miratuar një legjislacion të ri më efektiv. Shkelja e akteve ekzistuese passjell përgjegjësi disiplinore, e cila është shmangur nga Urdhri i Mjekëve, ndonëse kjo përgjegjësi konkurron me përgjegjësinë penale. Fakti se akti normativ është miratuar një muaj pas ngjarjes së ndodhur nuk përbën argument kushtetues. Lidhur me pretendimin për masën e "përkohshme", në rastin konkret akti normativ është miratuar nga Kuvendi dhe konsiderohet i përhershëm.

11.3.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës,* për shkak të cenimit të vetërregullimit të Urdhrit të Mjekëve është i pabazuar, pasi krijimi i institucioneve administrative që shërbejnë për rregullimin e profesioneve të ndryshme është diskrecion i Kuvendit. Shteti shqiptar nuk ka detyrim për të miratuar një model të caktuar të huazuar nga shtete të tjera.

11.3.3. Pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe ushtrimit të profesionit të lidhur me *parimin e proporcionalitetit* është i pabazuar, pasi mjekëve nuk u ndalohet të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike ose private, ndërsa pretendimi se ata mund të punojnë 16 orë në ditë nuk gjen mbështetje ligjore. Akti normativ përmbush kriterin e kufizimit vetëm me ligj, është miratuar për një interes publik me qëllim mbrojtjen e së drejtës për kujdes shëndetësor dhe atë të proporcionalitetit. Argumentet e kërkueses në këtë drejtim nuk janë kushtetuese, pasi zgjedhjet politike të ekzekutivit dhe të ligjvënësit nuk mund të vihen në diskutim nga Gjykata. Akti normativ synon të rregullojë situatën kur mjeku kërkon të punësohet njëkohësisht në qendrat shëndetësore publike dhe private në respektim të masave kufizuese, parashikime të cilat gjenden edhe në shtete të tjera. Akti normativ nuk i ka ndaluar mjekët të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike ose jopublike, për rrjedhojë nuk ka kufizuar të drejtën për punë dhe profesion të mjekëve. Ai i lë të lirë të zgjedhin nëse duan të punojnë në qendra shëndetësore publike ose private me kohë të plotë.

Për sa i përket pretendimit të kërkueses lidhur me nenin 8/a, pika 3, pra pamundësinë e mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv ose joekskluziv, ligji nr. 55/2022, datë 07.07.2022 "Për shërbimin spitalor" *(ligji nr.55/2022)* ka parashikuar se kur një spital arrin autonomi të plotë spitalore, marrëdhënia e punësimit do të rregullohet nga vetë spitali dhe jo nga ligji nr. 123/2014. Edhe pretendimi për mungesën e parashikimit të kontratave ekskluzive dhe joekskluzive është i pabazuar, pasi ato materializohen në ligjin nr. 55/2022, i cili nuk është objekt kontrolli në këtë gjykim kushtetues. Argumentet e kërkueses janë hipotetike dhe i përkasin periudhës pas vitit 2026 e në vijim.

Në lidhje me pretendimin për ashpërsinë e masave disiplinore, evidentohet se për një periudhë 18-vjeçare numri i procedimeve ka qenë shumë i ulët, çka tregon se rregulli i deritanishëm nuk ka rezultuar efektiv. Për këtë shkak, nevojitet ashpërsimi i masave dhe miratimi i Kodit të ri Etik dhe Deontologjik nga ministri përkatës.

11.3.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi profesioni i mjekut nuk është i njëjtë me profesionet e tjera të infermierit, stomatologut ose të farmacistit, nisur nga përkufizimi që shkenca gjuhësore u jep këtyre termave, arsimimi që ata zhvillojnë dhe kuadri ligjor që rregullon këto profesione.

12. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,*** në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar:

12.1. *Për juridiksionin e Gjykatës*

Kërkuesit nuk kanë argumentuar se cila e drejtë kushtetuese e tyre ose e anëtarëve cenohet nga organizimi që ligjvënësi i ka bërë Urdhrit të Mjekëve, për sa kohë ai nuk është një organ kushtetues dhe as i parashikuar nga Kushtetuta. Po kështu, Urdhri i Mjekëve nuk është një organizim vullnetar, por organ i së drejtës administrative i krijuar me ligj dhe pjesëmarrja e mjekëve është detyruese, pra nuk mund të pretendohet se cenohet e drejta për organizim e mjekëve. Çështja objekt shqyrtimi nuk përmban probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë

në zbatim norma me fuqi të njëjtë juridike, të cilat nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

12.2. *Për legjitimimin e kërkuesve*

Kërkuesja, Sindikata, ka objekt të ndryshëm nga kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, pasi ky i fundit është një organizatë e krijuar me ligj, ndërsa kërkuesja është organizim vullnetar, pra ka anëtarësi dhe qëllime të ndryshme. Kërkuesja nuk mund të kërkojë shfuqizimin e një ligji që rregullon veprimtarinë e një organizate tjetër vetëm për faktin se një pjesë e veprimtarisë së saj përfaqëson edhe anëtarë të asaj organizate. Edhe për sa u përket pretendimeve për cenimin e neneve 11, 17, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës, ato nuk lidhen me veprimtarinë e Sindikatës, por janë të drejta dhe liri të anëtarëve të saj. Akti normativ nuk ka cenuar një të drejtë të lidhur me Sindikatën për shkak të shkeljeve procedurale të pretenduara. Po kështu, ajo nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimin për cenimin e së drejtës së shtetasve për kujdes shëndetësor dhe për standardin më të lartë shëndetësor, të garantuara nga nenet 55 dhe 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, pasi nuk provon interesin e drejtpërdrejtë. Në drejtim të legjitimimit formal mungon autorizimi për përfaqësuesin që të veprojë në emër dhe për llogari të Sindikatës dhe nuk rezulton se cili organ ka të drejtë të marrë një nismë për vënien në lëvizje të Gjykatës. Ndonëse statuti parashikon se kryetari zgjidhet për një mandat 1-vjeçar pa të drejtë riemërimi, rezulton se kryetari është i zgjedhur që prej datës 14.11.2019.

Kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, nuk legjitimohet për pretendimet e tij për cenimin e neneve 11, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës, pasi ato janë të drejta dhe liri të individit dhe jo të organizatës. Kërkuesi nuk legjitimohet as për pretendimet në lidhje me nenin 101 të saj, pasi është subjekt i kushtëzuar.

12.3. *Për themelin e pretendimeve*

12.3.1. Pretendimi për cenimin e *nenit 101 të Kushtetutës* është i pabazuar, pasi plotësohen kriteret e nevojës dhe të urgjencës. Këshilli i Ministrave u gjend përballë nevojës për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike, sikurse është kujdesi shëndetësor i garantuar nga nenet 55 dhe 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe nevoja për parandalimin e menjëhershëm të spekulimeve. Rezultatet

e një hetimi penal kanë ngritur dyshime për mosdhënien e shërbimeve mjekësore dhe dërgimin e pacientëve në struktura private dhe, në vijim, hetimi administrativ i kryer në strukturën spitalore konstatoi se mjekët nuk ishin të pranishëm gjatë orarit zyrtar në mjediset e punës. Nevoja për miratimin e aktit normativ konsiston në mungesën e rregullimit ligjor të ushtrimit të profesionit të mjekut në mënyrë të njëkohshme në sistemin shëndetësor publik dhe jopublik, faktin se legjislacioni për etikën nuk ka rezultuar efektiv dhe garantimin e kujdesit shëndetësor. Për sa i përket kriterit të urgjencës, ai u evidentua pas hetimit penal të datës 25.06.2024, i pasuar nga hetimi administrativ. Analiza e raporteve për gjendjen e sistemit shëndetësor kërkoi një periudhë kohore deri në paraqitjen e propozimit për aktin normativ. Ndjekja e procesit legjislativ do të kërkonte 3-9 muaj, ndërsa miratimi me procedurë të përshpejtuar do të pengohej nga mbyllja e sesionit parlamentar. Ndërhyrja urgjente është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetësor publik dhe abuzimin në ofrimin e këtij shërbimi. Pamundësia e mjekëve për të paraqitur kërkesë për të ushtruar profesionin në një institucion shëndetësor jopublik është e përkohshme, pasi lidhet me çastin e arritjes së statusit të autonomisë spitalore financiare.

12.3.2. Kërkuesja nuk ka ngritur asnjë problematikë të natyrës kushtetuese për pretendimin për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës*, pasi nuk ka arritur të evidentojë asnjë shkelje kushtetuese, ndërkohë që ndërhyrja me ligj për të rregulluar aspekte funksionale të një institucioni të krijuar me ligj nuk përbën shkelje të Kushtetutës. Vende të ndryshme kanë pranuar rolin mbikëqyrës të organeve shtetërore për rregullimin e profesioneve shëndetësore. Ashpërsimi i masave disiplinore ndikon në rritjen e përgjegjësisë personale dhe llogaridhënien dhe nuk mund të arrihej me mjete të tjera. Edhe pretendimi i kërkuesit tjetër, Urdhrit të Mjekëve, në drejtim të *parimit të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi ai është ent publik i krijuar me ligj dhe i nënshtrohet kontrollit dhe mbikëqyrjes më të theksuar nga organet publike, për të garantuar interesin publik

dhe të drejtën për jetën dhe shëndetin. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë në miratimin e Kodit Etik është instrument për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Pavarësia e funksionale dhe organizative nuk cenohen as nga dispozitat e aktit normativ për komisionet disiplinore, pasi ligjvënësi ka të drejtë të parashikojë një mekanizëm kontrolli shtetëror si garanci shtesë për qytetarët dhe për vetë mjekët. Përbërja e komisioneve disiplinore forcon legjitimitetin dhe paanshmërinë e vendimmarrjes. Po kështu, pretendimi për cenimin e lirisë së organizimit u referohet shoqatave dhe organizatave që krijohen nga individët me vendim gjyqësor dhe jo Urdhrit të Mjekëve, që është ent i krijuar me ligj.

12.3.3. Pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe ushtrimit të profesionit të lidhur me *parimin e proporcionalitetit* nuk qëndron, pasi kufizimi i së drejtës për punë ka respektuar kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Është objektivisht e pamundur që mjekët të jenë të punësuar me kohë të plotë njëkohësisht në institucionet shëndetësore publike dhe jopublike dhe e papajtueshme me legjislacionin aktual. Kufizimi i orëve të punës 30% është bërë me qëllim që mjekët të mos i neglizhojnë detyrat në sistemin publik. Ndërhyrja është bërë për interes publik, në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të qytetarëve, pasi në praktikë është evidentuar reduktimi i cilësisë në ofrimin e shërbimit shëndetësor si rezultat i mungesës së mjekëve gjatë orarit të punës. Po kështu, është respektuar kriteri i proporcionalitetit, pasi akti normativ ka për qëllim forcimin e disiplinës, llogaridhënies dhe eliminimin e konfliktit të interesit. Numri i procedimeve disiplinore ka qenë shumë i ulët ndër vite dhe legjislacioni nuk ka rezultuar efektiv. Akti normativ përmbush nënkriteret e nevojës, të domosdoshmërisë dhe të përshtatshmërisë. Ai nuk kufizon të drejtën e mjekëve që punojnë vetëm në sistemin shëndetësor publik, por rregullon situatën kur ata kërkojnë angazhimin edhe në sistemin jopublik. E drejta e ankimimit të vendimeve të Komisionit të Apelimit është një garanci e shtuar, ndërsa masat disiplinore përmbushin kriterin e proporcionalitetit dhe qëllimi i kërkuar

nuk mund të arrihet me masa të tjera. Rregullimi i mënyrës së ushtrimit të profesionit të mjekut është i domosdoshëm me qëllim eficiencën në ofrimin e shërbimit.

12.3.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi mjekët nuk janë në kushte objektivisht të njëjta me punonjësit e tjerë të shërbimit shëndetësor, si për sa u përket kualifikimeve të nevojshme, ashtu edhe peshës që ka shërbimi i tyre. Për këto kategori mund të parashikohen masa disiplinore të ndryshme. Pretendimi për diskriminimin e mjekëve të punësuar në strukturat me autonomi spitalore në raport me ata në strukturat publike nuk qëndron, pasi këto dy kategori janë në situata jo të njëjta, sepse të parat mund të sigurojnë më tepër të ardhura, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimit.

12.3.5. Pretendimi i kërkuesit, Urdhrit të Mjekëve, për cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi argumentet e parashtruara nuk kanë të bëjnë me qëllimin dhe përmbajtjen e nenit 42 të Kushtetutës, i cili nuk është i zbatueshëm për situatën konkrete. Kjo dispozitë kushtetuese lidhet me të drejtën e individit për proces të rregullt ligjor përpara gjykatave dhe jo me procedurat e brendshme parlamentare. Kërkuesi është njoftuar dhe i është dhënë mundësia për të shprehur qëndrimin e tij, ndërsa afatet e shkurtra lidhen me natyrën emergjente të aktit normativ.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

13. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se Gjykata nuk ka juridiksion të shqyrtojë aktin normativ, pasi ligjvënësi ka diskrecion të plotë që të vendosë për organizimin e profesioneve dhe çështja objekt shqyrtimi nuk përmban probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë në zbatim norma me fuqi të njëjta juridike, të cilat nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

14. Nisur nga përmbajtja dhe thelbi i argumenteve të paraqitura nga subjektet e interesuara, Gjykata vëren se pretendimet e tyre nuk lidhen me kufijtë e juridiksionit të saj kushtetues, por kanë të bëjnë kryesisht

me vlerësimin e përmbushjes së kritereve të legjitimimit të subjekteve kërkuese. Për këtë arsye, Gjykata çmon t'i trajtojë këto argumente në kuadër të analizës së legjitimimit *ratione materiae*.

B. Për legjitimimin e kërkuesve

15. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 43 datë 24.07.2025; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

B.1. Për legjitimimin e kërkueses, Sindikatës

16. Kërkuesja ka pretenduar se legjitimohet, pasi është krijuar si organizatë sindikale kombëtare dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Sipas saj, akti normativ nr. 2/2024, si dhe ligji miratues prekin drejtpërdrejt interesat ekonomikë dhe shoqërorë të anëtarëve të Sindikatës që janë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve dhe sjellin pasoja negative për të. Ajo ka pretenduar se legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e saj. Konkretisht, për pretendimin e cenimit të nenit 101 të Kushtetutës kërkuesja ka pretenduar se legjitimohet, pasi Gjykata në vendimin nr. 1, datë 06.02.2013, ka legjitimuar një shoqatë në një rast të ngjashëm, akti normativ është çështje që prek interesin e drejtpërdrejtë të Sindikatës, si dhe cenon parimin e shtetit të së drejtës.

17. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesja nuk legjitimohet, pasi ajo është një organizëm që ka objekt të ndryshëm nga Urdhri i Mjekëve, pasi ky i fundit është një organizatë e krijuar me ligj, ndërsa kërkuesja është organizim vullnetar, pra ka anëtarësi dhe qëllime të ndryshme. Sipas tyre, kërkuesja nuk mund të kërkojë shfuqizimin e një ligji që rregullon veprimtarinë e një organizate tjetër vetëm për faktin se një pjesë e veprimtarisë së saj përfaqëson edhe anëtarë të organizatës tjetër. Po sipas subjekteve të interesuara, pretendimet për cenimin e neneve 11, 17, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës nuk lidhen me veprimtarinë e Sindikatës, por janë të drejta dhe liri të individit, potencialisht anëtarë të saj. Për sa kohë akti normativ nuk ka cenuar një të drejtë të lidhur me Sindikatën për shkak të shkeljeve procedurale të pretenduara, kërkuesja nuk legjitimohet. Po kështu, sipas subjekteve të interesuara, ajo (Sindikata) nuk legjitimohet

ratione personae për pretendimin për cenimin e së drejtës së shtetasve për kujdes shëndetësor dhe për standardin më të lartë shëndetësor, të garantuara nga nenet 55 dhe 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, pasi nuk provon interesin e saj të drejtpërdrejtë. Në drejtim të legjitimimit formal sipas tyre, mungon autorizimi për përfaqësuesin që të veprojë në emër dhe për llogari të Sindikatës dhe nuk rezulton se cili organ ka të drejtë të marrë një nismë për vënien në lëvizje të Gjykatës. Po kështu, kryetari i Sindikatës rezulton të jetë zgjedhur që në datën 14.11.2019, ndonëse statuti parashikon se ai ka një mandat 1-vjeçar.

18. Për legjitimimin e organizatave, sipas nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit *(shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese).*

19. Për sa i përket legjitimimit *ratione personae* në aspektin formal, Gjykata vëren se kërkuesja është person juridik i regjistruar me vendimin nr. 17, datë 14.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Organet drejtuese të saj janë kongresi, bordi drejtues, kryesia, kryetari dhe organet në nivel vendor. Sipas përmbajtjes së nenit 18 të statutit të saj, bordi drejtues është organi më i lartë vendimmarrës që drejton veprimtarinë e Sindikatës midis dy kongreseve, ndërsa referuar nenit 26, kryetari i Sindikatës zgjidhet dhe shkarkohet nga bordi drejtues për një mandat 1-vjeçar pa të drejtë rikandidimi dhe me sistem rotacioni. Kryetari është përfaqësuesi që menaxhon të gjithë aktivitetin e Sindikatës me të tretët. Sipas vërtetimit gjyqësor të datës 10.02.2025, rezulton se kryetar i Sindikatës është zoti Gentian Stroni, i cili nëpërmjet autorizimit të datës 15.11.2024 ka autorizuar përfaqësuesit ligjorë që të përfaqësojnë Sindikatën përpara Gjykatës për çështjen objekt kërkese.

20. Lidhur me prapësimet e subjekteve të interesuara se mungon autorizimi për kryetarin e Sindikatës për t'iu drejtuar Gjykatës për

kundërshtimin e aktit normativ, në praktikën e saj Gjykata nuk e ka vënë në dyshim legjitimitetin formal dhe procedural të shoqatave, pavarësisht se cili nga organet drejtuese ka marrë nismën për t`iu drejtuar Gjykatës (*shih vendimet nr. 35, datë 22.11.2022; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, në aspektin formal kryetari i Sindikatës legjitimohet t`i drejtohet Gjykatës pa qenë e nevojshme paraqitja e ndonjë akti të organeve të tjera për të provuar vullnetin e Sindikatës për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

21. Në lidhje me prapësimin tjetër se zoti Gentian Stroni është i vetmi kryetar i zgjedhur që prej datës 14.11.2019, ndonëse statuti parashikon se kryetari zgjidhet për një mandat 1-vjeçar pa të drejtë riemërimi, Gjykata vëren se referuar vërtetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të datës 30.09.2025, kërkuesja, Sindikata, në kongresin e parë të saj të mbajtur në datën 18.04.2025 ka vendosur saktësimin e nenit 26 të statutit që ka të bëjë me kompetencat e kongresit për të zgjedhur kryetarin e Sindikatës për një mandat 5-vjeçar, si dhe rizgjedhjen e kryetarit, zotit Gentian Stroni. Në këtë kuptim, Gjykata e gjen të pabazuar prapësimin e subjekteve të interesuara.

22. Po kështu, Gjykata vëren se në mbështetje të prapësimeve të tyre, subjektet e interesuara kanë referuar edhe vendimin nr. 21, datë 28.04.2021 të kësaj Gjykate, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për shkak të mungesës së legjitimimit të organit përfaqësues të shoqatës kërkuese, të cilit i kishte mbaruar mandati. Gjykata evidenton se në atë çështje konstatoi mungesën e legjitimimit të përfaqësimit të shoqatës kërkuese, pasi jo vetëm kishte kaluar një periudhë shumë e gjatë kohore në të cilën organi përfaqësues kishte vepruar në mungesë të mandatit të dhënë, por edhe se gjatë kësaj periudhe shoqata kishte zgjedhur një kryetar tjetër, i cili e kishte përfaqësuar atë në marrëdhënie me të tretët. Duke mbajtur në konsideratë faktin se në rastin konkret, kryetari Gentian Stroni është rizgjedhur në datën 18.04.2025 dhe ka përfaqësuar Sindikatën në seancën plenare publike të zhvilluar për këtë gjykim kushtetues, Gjykata vlerëson se ai vendim i saj nuk gjen zbatim në rastin konkret.

23. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë shkak për të vënë në dyshim materializimin e vullnetit të Sindikatës dhe tagrat e përfaqësimit në këtë gjykim, ndaj pretendimi i subjekteve të interesuara, për mungesën e legjitimimit formal të kërkueses, është haptazi i pabazuar.

24. Ndërsa në lidhje me aspektin substancial, Gjykata vëren se, sipas statutit, Sindikata është krijuar me bashkimin vullnetar të punonjësve të

shërbimit shëndetësor ku përfshihen mjekë, stomatologë, farmacistë etj., si dhe çdo punonjës që shërben në shërbimin shëndetësor (*neni 1*). Ajo është një organizatë sindikale profesionale, shoqërore që përfaqëson interesat ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të saj, të punëmarrësve të sektorëve shëndetësorë që ajo përfaqëson (*neni 3*). Referuar nenit 11, kërkuesja përfaqëson dhe mbron drejtpërdrejt interesat dhe të drejtat në punë të anëtarëve të saj përpara institucioneve shtetërore ose subjekteve private, si dhe në raport me pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Sipas nenit 6 të aktit të themelimit, objekti i aktivitetit të Sindikatës është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të saj dhe të punëmarrësve të sistemit shëndetësor. Anëtarët themelues të saj janë 25 shtetas shqiptarë me profesionin "mjek".

25. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës,* pasi akti normativ cenon pavarësinë dhe vetërregullimin e Urdhrit të Mjekëve. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vë në dukje se dispozitat ligjore të kundërshtuara u drejtohen Urdhrit të Mjekëve si ent publik jobuxhetor i krijuar me ligj, cilësi që kërkuesja si sindikatë nuk rezulton ta gëzojë. Për këtë shkak, sikurse ka prapësuar subjekti i interesuar, Gjykata çmon se ndonëse një pjesë e anëtarëve të Sindikatës janë njëkohësisht edhe anëtarë të Urdhrit të Mjekëve, kërkuesja nuk ka arritur të provojë të drejtën e cenuar nga akti normativ dhe interesin e ligjshëm vetjak të saj. Për rrjedhojë, ajo nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për këtë pretendim.

26. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e *së drejtës për kujdes shëndetësor dhe për standardin më të lartë shëndetësor,* të garantuara nga nenet 55 dhe 59 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të provojë interesin e saj të drejtpërdrejtë, për sa kohë ato janë të drejta vetjake që lidhen me individin dhe jo me Sindikatën si organizatë dhe qëllimin e saj për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj, të punëmarrësve të sektorëve shëndetësorë. Anëtarët e Sindikatës nuk paraqiten në këtë gjykim thjesht si individë, por në cilësinë e mjekut, për rrjedhojë ata nuk janë titullarë të këtyre të drejtave. Ndërsa për pretendimet e tjera kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, pasi ka justifikuar interesin e saj në çështjen në shqyrtim.

27. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja

në fuqi e aktit. Akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 2/2024 ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 07.08.2024. Më pas, ky akt normativ me fuqinë e ligjit është miratuar me ligjin nr. 94/2024 të Kuvendit, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 18.10.2024. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 18.12.2024, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar, ndaj kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

28. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 2/2024 dhe ligji miratues i saj nr. 123/2014 kanë cenuar nenin 101 të Kushtetutës për shkak të mungesës së nevojës, urgjencës dhe marrjes së masave të përkohshme në nxjerrjen e aktit të kundërshtuar, lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën për punë të lidhur me parimin e proporcionalitetit, si dhe parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, të garantuara nga nenet 11, 17, 18 dhe 49 të saj.

29. Lidhur me pretendimin për *cenimin e nenit 101 të Kushtetutës*, sipas të cilit akti normativ nuk është miratuar në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, pasi mungon ngjarja e jashtëzakonshme që ka sjellë nevojën e miratimit dhe dypunësimi i mjekëve është fenomen 20- vjeçar, pra nuk justifikohet urgjenca në miratimin e tij, në përfundim të diskutimeve Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

30. Kështu, sipas njërit qëndrim, u vlerësua se subjektet e kushtëzuara legjitimohen për të kundërshtuar procedurën për miratimin e ligjit vetëm nëse dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë ndonjë të drejtë themelore të garantuar nga Kushtetuta.[1] Sipas qëndrimit tjetër, u vlerësua se Gjykata vlerëson edhe pretendimet me natyrë procedurale, pra procedurën për miratimin e ligjeve dhe të akteve të tjera normative, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja "c", të Ligjit Organik të Gjykatës, për sa kohë kërkuesi që vë në lëvizje gjykimin kushtetues justifikon interesin vetjak në çështjen e parashtruar dhe ngre pretendime substanciale me natyrë kushtetuese, pavarësisht nëse gjatë shqyrtimit të themelit të çështjes ato mund të rezultojnë të pabazuara.[2] Ndërsa sipas qëndrimit të tretë, u vlerësua se pretendimet me natyrë procedurale të ngritura nga subjektet e kushtëzuara

[1] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marjana Semini.
[2] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja.

nuk mund t'i nënshtrohen juridiksionit kushtetues.[3] Duke mbajtur në konsideratë kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje dhe qëndrimet e gjyqtarëve, Gjykata do t'i trajtojë në themel pretendimet për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës në rast se do të konstatojë cenimin e të drejtave dhe lirive të pretenduara nga kërkuesit.

31. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të kërkueses për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe së drejtës për punë të lidhur me parimin e proporcionalitetit, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, Gjykata çmon se kërkuesja legjitimohet *ratione materiae* dhe këto pretendime bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, prandaj do të trajtohen në vijim në themel.

B.2. Për legjitimimin e kërkuesit, Urdhrit të Mjekëve

32. Kërkuesi ka parashtruar se legjitimohet, pasi është person juridik i krijuar me ligj si ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekut dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut. Ai ka pretenduar se ka interes real për mbrojtjen e standardeve kushtetuese të funksionimit të profesionit të mjekut në mënyrë cilësore dhe të pavarur. Po kështu, sipas tij, përmbushet edhe kriteri i legjitimimit *ratione materiae,* pasi pretendimet janë me natyrë kushtetuese, ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, për sa kohë kërkuesi ka legjitimitet të kushtëzuar, Gjykata ushtron kontrollin kushtetues vetëm nëse provohet shkelje e të drejtave subjektive.

33. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet që lidhen me cenimin e neneve 11, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës, pasi ato janë të drejta dhe liri të individit dhe jo të organizatës. Sipas tyre, kërkuesi nuk legjitimohet as për pretendimet për nenin 101 të Kushtetutës, pasi është subjekt i kushtëzuar.

34. Gjykata vëren se referuar ligjit nr. 123/2014, Urdhri i Mjekëve është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut (*neni 3*). Organet kryesore të tij janë asambletë, këshillat dhe presidentët (*neni 11*). Ndërsa sipas statutit, Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës, e cila zgjedh Këshillin Kombëtar *(neni 15*). Ky i fundit

[3] Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Ilir Toska e Genti Ibrahimi.

zgjedh Presidentin e Urdhrit të Mjekëve me mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë (*neni 16*). Presidenti i Këshillit Kombëtar në kuadër të marrëdhënieve me institucionet e administratës shtetërore, si dhe organizma të tjera brenda dhe jashtë vendit, përfaqëson Këshillin Kombëtar dhe shprehet në emër të tij (*neni 20*).

35. Me vendimin nr. 1, datë 30.08.2024, Asambleja e Përgjithshme e Urdhrit të Mjekëve ka autorizuar Këshillin Kombëtar dhe drejtuesit e tij ta dërgojnë çështjen në Gjykatë. Presidenti i Këshillit Kombëtar, zoti Fatmir Brahimaj (i zgjedhur me vendimin nr. 1, datë 26.06.2020), ka autorizuar përfaqësuesit ligjorë të përfaqësojnë Urdhrin e Mjekëve për të kundërshtuar në Gjykatë aktin normativ nr. 2/2024 dhe VKM-në nr. 85/2025. Gjatë gjykimit të çështjes, kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, ka paraqitur vendimin nr. 1, datë 25.04.2025, sipas të cilit, zoti Dritan Trepça është zgjedhur në detyrën e Presidentit të Këshillit Kombëtar dhe e ka përfaqësuar kërkuesin në seancë plenare. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në aspektin formal.

36. Ndërsa në lidhje me aspektin substancial, sipas statutit, Gjykata vëren se Urdhri i Mjekëve përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut (*neni 2*). Anëtarë të tij janë të gjithë mjekët, mjekët e specializuar që ushtrojnë profesionin në sistemin shëndetësor publik dhe privat dhe anëtarësimi është parakusht për ushtrimin e profesionit (*neni 3*). Misioni i tij është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut, si dhe mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve (*neni 4*).

37. Në referim të këtyre parashikimeve, Gjykata vëren se, për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për kujdes shëndetësor*, të garantuar nga neni 55 i Kushtetutës, sikurse theksoi edhe për kërkuesen tjetër, Sindikatën, kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, nuk legjitimohet *ratione personae,* pasi nuk provon interesin e drejtpërdrejtë, në kushtet kur kjo e drejtë i përket individit dhe jo Urdhrit të Mjekëve, si ent publik, i cili ka për qëllim të përfaqësojë interesat e anëtarëve të tij, pra të mjekëve, të cilët nuk janë titullarë të kësaj të drejte. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, duke mbajtur në konsideratë qëllimin e veprimtarisë së kërkuesit, anëtarësinë e tij dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së Urdhrit të Mjekëve, kërkuesi provon

interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet edhe në aspektin substancial për t'iu drejtuar Gjykatës.

38. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 26.05.2025, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit që ka miratuar aktin normativ nr.2/2024 (datë 18.10.2024) dhe VKM-së nr. 85/2025 (datë 10.02.2025).

39. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 2/2024 dhe VKM-ja nr. 85/2025 kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, lirinë e organizimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe shtetit të së drejtës, lirinë e veprimtarisë ekonomike, të drejtën për të ushtruar profesionin të lidhur me parimin e proporcionalitetit, si dhe nenin 101 të Kushtetutës.

40. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, kërkuesi ka argumentuar se kjo e drejtë gjen zbatim edhe në procesin legjislativ dhe atij nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur brenda një kohe të arsyeshme gjatë procesit ligjvënës. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi neni 42 i Kushtetutës që parashikon të drejtën për proces të rregullt nuk është i zbatueshëm për situatën konkrete. Sipas tyre, kjo dispozitë kushtetuese lidhet me të drejtën e individit për proces të rregullt ligjor përpara gjykatave dhe jo me procedurat e brendshme parlamentare. Kërkuesi është njoftuar dhe i është dhënë mundësia për të shprehur qëndrimin e tij, ndërsa afatet e shkurtra lidhen me natyrën emergjente të aktit normativ.

41. Mbështetur në argumentet e kërkuesit, Gjykata e gjen të bazuar prapësimin e subjekteve të interesuara dhe konstaton se pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim nuk lidhet me procesin e rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por me procedurën parlamentare të konsultimit publik të akteve. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata vëren se kërkuesi ka qenë i pranishëm në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe koha e pamjaftueshme për t'u përgatitur për projektaktin nuk përbën në vetvete argument kushtetues në mbështetje të pretendimit të kërkuesit, për rrjedhojë ai është haptazi i pabazuar.

42. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e nenit 101 të Kushtetutës*, Gjykata me të njëjtin arsyetim si në rastin e kërkueses tjetër, Sindikatës (*shih paragrafin 30 të vendimit*) dhe duke mbajtur në konsideratë se edhe

kërkuesi Urdhri i Mjekëve është një subjekt i kushtëzuar, do të vijojë me analizën e këtij pretendimi në themel në rast se do të konstatojë cenimin e të drejtave dhe të lirive të pretenduara nga kërkuesi. Ndërsa për pretendimet e tjera, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione materiae.*

43. Gjithashtu, pretendimet për cenimin e lirisë së organizimit, parimit të sigurisë juridike dhe parimit të shtetit të së drejtës, në kushtet kur argumentet e kërkuesit, Urdhri i Mjekëve kanë të bëjnë me organizimin dhe vetërregullimin e tij, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të shtetit të së drejtës.

44. Lidhur me pretendimet që kërkuesit kanë ngritur në mënyrë të përbashkët për *cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe të lirisë së ushtrimit të profesionit* të lidhur me *parimin e proporcionalitetit,* të garantuara nga nenet 11, 17 dhe 49 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje se në thelb, pretendimet e tyre janë përqendruara mbi dy shkaqe kryesore: i) kufizimi i së drejtës së mjekëve për të mos punuar në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 % të orëve mujore që punon në sistemin shëndetësor publik së bashku me detyrimin e mjekut që të marrë leje nga titullari i institucionit shëndetësor publik për të ushtruar profesionin në një institucion privat; ii) ashpërsimi i masave disiplinore, veçanërisht ajo që lidhet me heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit në mënyrë të përhershme në aspektin e paqartësisë së normës dhe faktit se mosshuarja e masës disiplinore cenon thelbin e së drejtës për të ushtruar profesionin e mjekut. Nisur nga kjo, Gjykata çmon të analizojë shkakun e parë në drejtim të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe shkakun e dytë në drejtim të së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni, secila në raport me parimin e proporcionalitetit, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, Gjykata çmon ta analizojë në themel të lidhur me lirinë e veprimtarisë ekonomike.[4]

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës

45. Kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, ka pretenduar se akti normativ nr. 2/2024 dhe VKM-ja nr. 85/2025 cenojnë vetërregullimin e Urdhrit të Mjekëve si ent i pavarur, i cili duhet të ketë autonomi nga Ministria e

[4] Gjyqtarja Marjana Semini vlerësoi se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit duhej të trajtohej në themel i ndarë nga pretendimet e tjera.

Shëndetësisë, duke dobësuar pavarësinë organizative dhe funksionale në drejtim të kompetencës së Ministrisë së Shëndetësisë për të miratuar Kodin e Etikës dhe mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të komisioneve të disiplinës dhe të apelimit, për shkak se ky i fundit do të funksionojë pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

46. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për këtë pretendim, pasi është një ent publik i krijuar me ligj dhe i nënshtrohet kontrollit dhe mbikëqyrjes më të theksuar nga organet publike, për të garantuar interesin publik dhe të drejtën për jetën dhe shëndetin. Sipas tyre, roli i Ministrisë së Shëndetësisë në miratimin e Kodit Etik është instrument për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Sipas subjekteve të interesuara, pavarësia funksionale dhe organizative nuk cenohet as nga dispozitat e VKM-së për komisionet disiplinore, pasi ligjvënësi ka të drejtë të parashikojë një mekanizëm kontrolli shtetëror si garanci shtesë për qytetarët dhe për vetë mjekët. Përbërja e komisioneve disiplinore forcon legjitimitetin dhe paanshmërinë e vendimmarrjes.

47. Gjykata ka vlerësuar se parimi i shtetit të së drejtës është një nga parimet më themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Ky parim është një normë e pavarur kushtetuese, shkelja e së cilës përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.20, datë 09.07.2009; nr.20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se shteti i ushtron funksionet e tij jo vetëm nëpërmjet një sistemi institucionesh shtetërore por, në një farë mase, edhe nëpërmjet organizimeve të tjera joshtetërore, të cilave u besohet me ligj ushtrimi i funksioneve publike të caktuara. Ajo ka pranuar se profesione të tilla, ndaj të cilave shteti ushtron një mbikëqyrje të kufizuar, nënkuptojnë vetërregullimin e profesionit përkatës, vetërregullim që përfshin të gjithë profesionin dhe siguron, mes të tjerave, përfaqësimin e këtij profesioni në marrëdhëniet me shtetin dhe institucionet e vetërregulluara. Pa garantimin e një sistemi të tillë vetërregullimi dhe vetëqeverisjeje, delegimi i funksioneve përkatëse në duart e individit privat do të ishte i pajustifikueshëm nga pikëpamja kushtetuese (*shih vendimin nr. 7, datë 12.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

48. Në respektim të këtij standardi, Gjykata ka pranuar se pavarësia dhe autonomia e disa enteve publike të krijuara me ligj nga këndvështrimi i parimit të shtetit të së drejtës ka vlerë kushtetuese. Të tillë ajo ka konsideruar shërbimin e avokatisë, duke vlerësuar se ai luan një rol të rëndësishëm për të garantuar shtetin e së drejtës, si dhe për të siguruar një mbrojtje

eficiente të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se ndonëse ligjvënësit i lejohet të rregullojë profesionin e avokatit për interes publik, ndërhyrja nuk duhet të cenojë autonominë e profesionit, konkretisht autonominë financiare/buxhetore (*shih vendimin nr. 7, datë 12.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Ndërsa, në dallim me sa më sipër, për sa i përket profesionit të noterisë, Gjykata është shprehur se funksioni i noterit në thelb është një funksion publik i "deleguar", qëllimi i të cilit është që të realizohet një shërbim i pavarur, i paanshëm e profesional. Parashikimi me ligj i funksioneve mbikëqyrëse të këtij profesioni nga shteti është bërë me qëllim garantimin e parametrave të besueshmërisë së noterëve në ushtrimin e drejtë të autoritetit që u është deleguar nga shteti dhe kontrolli shtetëror nuk është antikushtetues për sa kohë është i lidhur me kontrollin e respektimit të funksionit që u është deleguar noterëve dhe që shprehet në vlerën që kanë dokumentet e tyre *(shih vendimin nr.3, datë 19.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe për sa i përket profesionit të ekspertit kontabël, Gjykata ka pohuar se ai është një funksion publik i shtetit i deleguar dhe, për rrjedhojë, mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre nuk mund të jetë e pakontrolluar dhe e lirë nga çdo lloj rregullimi ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 05.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Gjykata paraprakisht vëren se Urdhri i Mjekëve nuk përfshihet në rrethin e organeve të parashikuara nga Kushtetuta. Ai përfaqëson një ent publik jobuxhetor, profesional dhe të pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut. Megjithatë, bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, Urdhri i Mjekëve ndonëse është një person juridik i së drejtës publike i krijuar me ligj, ushtron kompetenca që ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e objektivave socialë të shtetit në fushën e shëndetësisë, siç përcaktohet në nenin 59 të Kushtetutës, çka do të thotë se ai ushtron funksion të një natyre publike, prandaj edhe ndaj tij duhet të garantohet një sistem vetërregullimi dhe vetëqeverisjeje.

51. Nëpërmjet aktit normativ të kundërshtuar është parashikuar se komisionet disiplinore (Komisioni i Disiplinës dhe Komisioni i Apelimit) ushtrojnë procedimin disiplinor. Ndërsa i pari funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve dhe realizon shqyrtimin e ankesave, hetimin administrativ dhe, në rast konstatimi të shkeljeve, cakton me vendim masat disiplinore, i dyti ngrihet pranë Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë. Ndërsa sipas VKM-së nr. 85/2025 Komisioni i Disiplinës funksionon pranë Urdhrit të

Mjekëve dhe përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 përfaqësues emërohet nga Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë, kurse Komisioni i Apelimit ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 përfaqësues zgjidhen nga Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë. Gjithashtu, sipas aktit normativ, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve harton Kodin e Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës të Shëndetësisë.

52. Gjykata konstaton se sipas parashikimit të mëparshëm nënligjor, komisionet disiplinore përbëheshin vetëm nga anëtarë të zgjedhur nga këshilli rajonal ose këshilli kombëtar i Urdhrit të Mjekëve, ndërsa Kodi i Etikës hartohej dhe miratohej nga Këshilli Kombëtar. Kjo do të thotë se në organizimin e mëparshëm nuk kishte përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësisë, pra nga ekzekutivi, porse funksionimi dhe organizimi i brendshëm ka qenë tërësisht nën autoritetin e vet Urdhrit të Mjekëve.

53. Në kuptim të standardeve të sipërcituara dhe në analizë të rrethanave të rastit konkret, Gjykata çmon se përfshirja e ministrisë përkatëse në organizimin dhe funksionimin e komisioneve të disiplinës të Urdhrit të Mjekëve, si dhe në procesin e miratimit të Kodit të Etikës, përbën një masë të arsyeshme dhe proporcionalisht të justifikuar të mbikëqyrjes shtetërore. Kjo ndërhyrje gjen mbështetje në natyrën publike të funksionit që ushtron Urdhri i Mjekëve (*shih paragrafin 50 të vendimit*). Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se detyrimi kushtetues i shtetit për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të shtetasve legjitimon rolin e ministrisë përgjegjëse në garantimin e respektimit të standardeve etike dhe profesionale në ushtrimin e profesionit të mjekut. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të kësaj ministrie në komisionet disiplinore dhe roli mbikëqyrës në procesin e miratimit të Kodit të Etikës nuk cenon pavarësinë funksionale të Urdhrit të Mjekëve, por synon të krijojë një ekuilibër ndërmjet autonomisë profesionale dhe përgjegjësisë publike në mbrojtje të interesit publik.[5]

54. Gjykata thekson gjithashtu se autonomia dhe pavarësia e Urdhrit të Mjekëve nuk përjashton ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse të shtetit në fushat ku realizohet një interes publik. Pavarësia e Urdhrit të Mjekëve ka për qëllim të sigurojë vetërregullimin e profesionit të mjekut, por ajo nuk mund të interpretohet si një imunitet ndaj kontrollit të ligjshmërisë, etikës dhe standardeve të cilësisë në ofrimin e kujdesit shëndetësor. Për

[5] Në lidhje me miratimin e Kodit të Etikës gjyqtarja Marjana Semini mbajti qëndrimin se ndërhyrja e ministrisë përkatëse përbën një masë joproporcionale, prandaj pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i bazuar.

më tepër, Gjykata evidenton se ligjvënësi nuk ka hequr ose transferuar në mënyrë të plotë kompetencat e Urdhrit të Mjekëve në fushën disiplinore ose në përcaktimin e rregullave të etikës profesionale, por ka parashikuar një formë ndërveprimi institucional që garanton transparencë dhe llogaridhënie në ushtrimin e funksioneve. Përfshirja e anëtarëve nga ministria përgjegjëse përkrah atyre të Urdhrit të Mjekëve në përbërjen e komisioneve disiplinore, të cilët janë në pakicë në raport me anëtarët e Urdhrit të Mjekëve, synon të parandalojë abuzimet dhe konfliktet e interesit që mund të cenojnë besimin publik ndaj profesionit të mjekut. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se organizimi i miratuar nga akti normativ objekt kundërshtimi nuk përbën ndërhyrje të pajustifikuar në autonominë e Urdhrit të Mjekëve, por është një mekanizëm kontrolli që i shërben zbatimit të detyrimeve kushtetuese të shtetit në mbrojtje të sigurimit të standardeve të larta shëndetësore.

55. Thënë kjo, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës është i pabazuar, për rrjedhojë edhe pretendimet që lidhen me VKM-në nr. 85/2025, e cila rregullon mënyrën e funksionimit të komisioneve disiplinore janë, të pabazuara.

C.2. Për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit

56. Kërkuesit kanë pretenduar se akti normativ ka ndaluar dypunësimin për anëtarët e Urdhrit të Mjekëve të punësuar në një institucion shëndetësor publik, që ka përfituar statusin e autonomisë spitalore financiare, kufizim i cili do të zgjasë pa afat dhe ka si qëllim ndalimin tërësisht të dypunësimit në vitin 2026. Sipas tyre ky parashikim ka ometuar (i) mundësinë e mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv ose joekskluziv; (ii) trajtimin me pagesë suplementare për mjekët që zgjedhin raport pune ekskluziv me strukturën spitalore publike. Gjithashtu sipas kërkuesve detyrimi për të punuar jo më shumë se 30 % të orëve mujore në sistemin publik nuk mund të arrijë qëllimin e kërkuar që mjekët të respektojnë orarin e punës dhe ky kufizim nuk ndikon as në shmangien e interesit si dhe nuk është argumentuar apo bazuar në ndonjë studim specifik. Po kështu, kërkuesit kanë pretenduar se kufizimi i punësimit në sektorin privat në 30% të orëve mujore ka fuqi prapavepruese dhe nuk janë parashikuar dispozitat tranzitore duke u dëmtuar planet e aktivitetit ekonomik të mjekëve dhe pa marrë parasysh kreditë apo detyrimet financiare të tyre. Sipas kërkuesve, këto të drejta

cenohen edhe nga neni 5 i aktit normativ që ka shtuar nenin 8/a të ligjit në lidhje me kushtet dhe procedurën që duhet të ndjekë një mjek i cili kërkon të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik. Po sipas tyre, akti normativ diskriminon (i) mjekët në raport me profesionet e tjera të rregulluara (ii) mjekët që punojnë në strukturat universitare me autonomi spitalore në raport me kolegët e tjerë që punojnë në struktura të tjera publike, si dhe (iii) mjekët që punojnë në strukturat shëndetësore me autonomi spitalore dhe që do të lejohen të ushtrojnë dypunësimin në raport me kolegët e tjerë që punojnë në të njëjtën strukturë, por nuk lejohen të ushtrojnë dypunësim.

57. Sipas subjekteve të interesuara, mjekëve nuk u ndalohet të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike apo private, ndërsa pretendimi se ata mund të punojnë 16 orë në ditë nuk gjen mbështetje ligjore. Akti normativ përmbush kriterin e kufizimit vetëm me ligj, është miratuar për një interes publik me qëllim mbrojtjen e të drejtës për kujdes shëndetësor dhe atë të proporcionalitetit. Sipas tyre argumentet e kërkuesve nuk janë kushtetuese, pasi zgjedhjet politike të ekzekutivit dhe ligjvënësit nuk mund të diskutohen në mënyrë gjyqësore. Akti normativ nuk i ka ndaluar mjekët të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike apo jopublike. Ai i le të lirë të zgjedhin nëse duan të punojnë në qendra shëndetësore publike ose private me kohë të plotë dhe kufizimi i orëve të punës 30% është bërë me qëllim që mjekët të mos i neglizhojnë detyrat në sistemin publik. Sipas subjekteve të interesuara, ndërhyrja është bërë për interes publik, në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të qytetarëve, pasi në praktikë është evidentuar reduktimi i cilësisë në ofrimin e shërbimit shëndetësor si rezultat i mungesës së mjekëve gjatë orarit të punës. Subjektet e interesuara kanë parashtruar se për sa i përket pretendimit të kërkueses për pamundësinë e mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv ose joekskluziv, ligji nr. 55/2022 ka parashikuar se kur një spital arrin autonomi të plotë spitalore, marrëdhënia e punësimit do të rregullohet nga vetë spitali, dhe jo nga ligji nr. 123/2014. Edhe pretendimi për mungesën e parashikimit të kontratave ekskluzive dhe joekskluzive, sipas subjekteve të interesuara, është i pabazuar, pasi ato materializohen në ligjin nr. 55/2022 i cili nuk është objekt kontrolli në këtë gjykim kushtetues. Argumentet e kërkueses janë hipotetike dhe i përkasin periudhës pas vitit 2026 e në vijim. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, subjektet e interesuara kanë prapësuar se ai

është i pabazuar pasi mjekët nuk janë në kushte objektivisht të njëjta me punonjësit e tjerë të shërbimit shëndetësor dhe as me mjekët e punësuar në strukturat me autonomi spitalore në raport me ata në strukturat publike.

58. Neni 11 i Kushtetutës parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kjo liri përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmërinë e çmimit, lirinë fiskale për të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror ose lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti *(shih vendimet nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë drejtim, ajo ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike përfshin edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet legjislacionit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Në këtë rast shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 56 datë 16.07.2024; nr. 60, datë 31.07.2017; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar gjithashtu se parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë *(shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 27, datë 29.06.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

60. Gjykata e ka vlerësuar cenimin ose jo të lirive dhe të drejtave kushtetuese duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës. Kjo dispozitë, përveç arsyes publike, përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja

e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet *(shih vendimet nr. 1, datë 25.01.2024; nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Sikurse u analizua më sipër (*shih paragrafin 44 të vendimit*), Gjykata në vijim do të trajtojë këtë pretendim të kërkuesve në dy aspekte (i) kufizimi i së drejtës së mjekëve për të mos punuar në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 % të orëve mujore që punon në sistemin shëndetësor publik dhe (ii) detyrimin e mjekëve që të marrin leje nga titullari i institucionit shëndetësor publik për të ushtruar profesionin në një institucion shëndetësor privat.

C.2.1. Për kufizimin 30% të orëve mujore

62. Gjykata vëren se neni 4 i aktit normativ ka ndryshuar nenin 8 të ligjit nr. 123/2014, duke shtuar në detyrimet e anëtarit të Urdhrit të Mjekëve, ndër të tjera, edhe detyrimin "*të mos punojë në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 për qind të orëve mujore, që punon në sistemin shëndetësor publik*".

63. Për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, ndërsa vlerësoi se kufizimi prej 30% përbën ndërhyrje të vendosur me ligj dhe për interes publik, në lidhje me proporcionalitetin e masës, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

64. Kështu, sipas njërit qëndrim, kufizimi prej 30%, i lidhur me faktin se aplikohet vetëm ndaj mjekëve që punojnë në sistemin shëndetësor publik, përbën ndërhyrje të pajustifikuar në lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe trajtim jo të barabartë të tyre, pasi është miratuar në mungesë të një analize të qartë të nevojës dhe domosdoshmërisë për mbrojtjen e interesit publik dhe pa u mbështetur në kritere objektive, duke cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit. Subjektet e interesuara nuk kanë arritur të provojnë proporcionalitetin e këtij kufizimi dhe po kështu nuk kanë dhënë ndonjë argument as për trajtimin ndryshe të kësaj kategorie të mjekëve, ndonëse barra e provës në këtë drejtim u përket autoriteteve shtetërore. Thënë kjo, nuk ekziston ndonjë arsye që të përligjë trajtimin e ndryshëm të tyre. Duke mbajtur në konsideratë situatën aktuale të numrit të përgjithshëm të mjekëve dhe prirjes së tyre për t'u larguar nga vendi, arrihet në përfundimin se shteti ka mjete të tjera më pak kufizuese për të

garantuar përmbushjen e detyrimeve të mjekëve në sistemin shëndetësor publik, si forcimi i masave mbikëqyrëse dhe disiplinore, mjete të cilat janë në raport të drejtë me qëllimin legjitim për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të individëve.[6]

65. Sipas qëndrimit tjetër, kufizimi prej 30% i përcaktuar nga ligjvënësi nuk përbën ndërhyrje në lirinë e veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi ajo nuk është e ashpër në kuptimin që të cenojë thelbin e kësaj të drejte. Duke mbajtur në vëmendje rëndësinë e shërbimit shëndetësor publik, ky kufizim përbën një masë të arsyeshme, proporcionale dhe të justifikuar nga interesi publik që i jep përparësi shërbimit publik me qëllim mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të individëve për kujdes shëndetësor cilësor. Nga ana tjetër, kufizimi prej 30% synon parandalimin e orëve të gjata të punës që cenojnë cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e pacientit, ndërkohë që kjo kategori profesionistësh nuk përbën grup vulnerabël dhe u jepet zgjedhja e lirë për të ushtruar veprimtarinë në sektorin shëndetësor publik ose privat.[7] Gjithashtu ky kufizim nuk cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi trajtimi i ndryshëm i mjekëve justifikohet nga natyra specifike e profesionit të tyre, niveli i përgjegjësisë dhe nevoja për të garantuar interesin publik dhe jetën e individëve, duke u mbështetur në kritere objektive dhe proporcionale.[8]

66. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike për shkak të kufizimit 30% konsiderohet i rrëzuar.

C.2.2. Për detyrimin për t'i bërë kërkesë titullarit për të ushtruar profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik

67. Gjykata vëren se neni 8/a i ligjit nr. 123/2014 ka përcaktuar kushtet dhe procedurat që një mjek në një institucion shëndetësor publik mund të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik. Kështu sipas

[6] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci.

[7] Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi e Marjana Semini.

[8] Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Sonila Bejtja e Genti Ibrahimi, ndërsa gjyqtarja Marjana Semini e shqyrtoi pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit të lidhur me mënyrën potencialisht të ndryshme të trajtimit të mjekëve brenda vetë institucioneve shëndetësore me autonomi financiare, përsa i përket marrjes së autorizimit të titullarit për të ushtruar profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik.

pikës 1 të këtij neni, një anëtar i Urdhrit të Mjekëve, që kërkon të ushtrojë profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik, duhet t'i bëjë kërkesë titullarit të institucionit shëndetësor publik, ku ai është i punësuar, ndërsa anëtarët të cilët janë punësuar në një institucion shëndetësor publik, që ka përfituar statusin e autonomisë spitalore financiare, nuk mund të bëjnë kërkesë sipas kësaj pike *(pika 3)*. Titullari i institucionit vlerëson: a) ngarkesën e orëve që mjeku ushtron në institucionin shëndetësor publik; b) mbulimin e shërbimit nga personeli tjetër mjekësor në institucionin shëndetësor publik; c) mundësinë e konfliktit të interesit *(pika 5)*. Në rast se titullari vlerëson se nuk plotësohen kërkesat e pikave 5 dhe 6 të këtij neni, vendos mosmiratimin e kërkesës. Në rast se titullari vlerëson se nuk ka pengesa për pranimin e kësaj kërkese, miraton kërkesën dhe njofton ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë (*pika 7*) Procedura e verifikimit dhe e shqyrtimit të kërkesës, si dhe të dhënat, që do të bëhen publike në regjistrin elektronik, formati dhe mënyra e përditësimit të tij rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë (*pika 9*).

68. Në kuptim të këtyre parashikimeve, Gjykata vëren se akti normativ i ka lënë në diskrecion titullarit të institucionit të miratojë ose jo kërkesën e një mjeku për të punuar në një institucion shëndetësor jopublik, duke vlerësuar ngarkesën e orëve, mbulimin e shërbimit nga personeli tjetër mjekësor në institucionin shëndetësor publik dhe mundësinë e konfliktit të interesit. Në lidhje me këtë fakt, subjektet e interesuara kanë parashtruar se një parashikim i tillë gjendet edhe në ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Gjykata konstaton se neni 8 i këtij ligji ka parashikuar se për kryerjen e veprimtarive të jashtme nëpunësi i administratës publike njofton paraprakisht eprorin direkt dhe njësinë e personelit, por nuk vëren detyrimin për marrjen e miratimit nga ai.

69. Në kuptim të parashikimit të ri ligjor, konstatohet se detyrimi i mjekëve për të bërë kërkesë te titullari për të ushtruar profesionin në një institucion shëndetësor jopublik përbën ndërhyrje/kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, në kuptim të nenit 11 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë, në vijim, nëse ky kufizim ka respektuar kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pra nëse është bërë me ligj, për interes publik dhe nëse është respektuar kriteri i përpjesëtimit midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë.

70. Për sa u përket dy kritereve të kufizimit "vetëm me ligj" dhe atij "për interes publik", Gjykata çmon se ato janë respektuar, pasi akti normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2/2024 është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr.

94/2024. Po kështu, akti normativ synon garantimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor, në kuptim të nenit 55, pika 1, të Kushtetutës, si dhe garantimin e standardeve më të larta të shëndetit publik, sipas nenit 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës.

71. Në kushtet kur janë përmbushur dy kriteret e mësipërme të kufizimit, Gjykata vlerëson të analizojë kriterin tjetër, atë të *proporcionalitetit të ndërhyrjes,* në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t'i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

72. Në analizë të përmbajtjes së nenit 8/a të ligjit nr. 123/2014 konstatohet se ky parashikim ligjor i jep titullarit të institucionit shëndetësor publik një kompetencë vendimmarrëse të gjerë dhe të pakufizuar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së mjekut për të ushtruar profesionin edhe në një institucion shëndetësor jopublik. Ky mekanizëm vlerësimi, megjithëse formalisht ka për qëllim të sigurojë funksionimin normal të institucioneve publike shëndetësore dhe shmangien e konfliktit të interesit, në praktikë duket se *per se* vendos një kufizim për ushtrimin e së drejtës së mjekut për dypunësim.

73. Gjykata evidenton se dypunësimi i mjekëve nuk është i ndaluar nga ligji, përkundrazi, ai lejohet me plotësimin e kriterit kufizues prej 30% të orëve mujore, i cili garanton ruajtjen e cilësisë së shërbimit publik dhe shmangien e konfliktit të interesit. Në këtë pikë Gjykata thekson se për sa kohë ushtrimi i veprimtarisë në një institucion shëndetësor jopublik nuk pengon kryerjen e detyrave në institucionin publik dhe nuk krijon konflikt interesi, nuk ekziston ndonjë arsye kushtetuese që ta kushtëzojë këtë me dhënien e një lejeje administrative. Vetë balanca midis interesit publik dhe së drejtës individuale ruhet përmes respektimit të detyrimeve të mjekut

ndaj institucionit publik dhe rregullave mbi konfliktin e interesit, pa pasur nevojë për një autorizim paraprak nga titullari.

74. Po kështu, Gjykata vlerëson se kriteret mbi të cilat titullari mbështet vlerësimin e tij, si ngarkesa e orëve të punës, mbulimi i shërbimit ose mundësia e konfliktit të interesit, janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me standarde objektive që të mundësojnë një vendimmarrje objektive. Në këtë këndvështrim, mungesa e detyrimit për arsyetimin e vendimit dhe pamundësia e një mjeti efektiv ankimi e bën këtë kompetencë të titullarit diskrecionale dhe nuk ofron garancitë e nevojshme procedurale.

75. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kufizimi që vendos ky nen nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit ndërmjet qëllimit publik të garantimit të standardeve më të larta shëndetësore dhe ushtrimit të lirë të profesionit nga mjekët. Nga njëra anë, ligji vetë njeh mundësinë e dypunësimit të mjekëve si një formë të ligjshme të ushtrimit të profesionit, ndërsa, nga ana tjetër, i jep titullarit një kompetencë vendimmarrëse që praktikisht e bën këtë të drejtë të pamundur për t'u realizuar. Kjo situatë passjell cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi ushtrimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike varet nga vullneti subjektiv i një organi administrativ. Për më tepër, kufizimi i vendosur nga neni 8/a i ligjit nr. 123/2014, në formën e detyrimit për të marrë leje nga titullari, është i tillë që, në praktikë, mund të çojë në mohimin e plotë të së drejtës për të ushtruar profesionin në sektorin shëndetësor jopublik, duke e bërë kufizimin joproporcional në raport me qëllimin e ndjekur.[9]

76. Për të gjitha argumentet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, për sa u përket pikave 1, 3, 5, 7 dhe 9 të nenit 8/a të ligjit nr.123/2014, është i bazuar.

C.3. Për cenimin e së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni të lidhur me parimin e proporcionalitetit

77. Kërkuesit kanë pretenduar se ashpërsimi drastik i masave disiplinore është bërë pa një analizë në lidhje me qëllimin, por ka qenë rrjedhojë e një ngjarjeje të vetme penale. Sanksioni i heqjes së licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut është i ashpër dhe nënkupton mohimin tërësor të së

[9] Gjyqtarja Marjana Semini vlerësoi se detyrimi i mjekëve për të marrë leje nga titullari për t'u punësuar në një institucion jopublik shëndetësor përmbush kriterin e proporcionalitetit, por cenon parimin e mosdiskriminimit, pasi vendos në pozita jo të barabarta sa i takon marrjes ose jo të lejes për mjekët të cilët janë të punësuar në strukturat me autonomi financiare në krahasim me kolegët e tjerë të punësuar në të njëjtën strukturë.

drejtës për të ushtruar profesionin. Sipas tyre, nuk përmbushet as kriteri i përshtatshmërisë, pasi heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie përbën dënim plotësues në Kodin Penal dhe mund të arrijë qëllimin e kërkuar. Po sipas kërkuesve, mosshuarja e masës disiplinore cenon dinjitetin njerëzor dhe thelbin së drejtës për të ushtruar profesionin e mjekut.

78. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se për një periudhë 18-vjeçare numri i procedimeve ka qenë shumë i ulët, çka tregon se rregulli i deritanishëm nuk ka rezultuar efektiv. Për këtë shkak nevojitet ashpërsimi i masave. Sipas këtyre subjekteve, numri i procedimeve disiplinore ka qenë shumë i ulët ndër vite dhe legjislacioni nuk ka rezultuar efektiv. Po sipas tyre, e drejta e ankimimit të vendimeve të Komisionit të Apelimit është një garanci e shtuar, ndërsa masat disiplinore përmbushin kriterin e proporcionalitetit dhe qëllimi i kërkuar nuk mund të arrihet me masa të tjera. Rregullimi i mënyrës së ushtrimit të profesionit të mjekut është i domosdoshëm me qëllim eficiencën në ofrimin e shërbimit.

79. E drejta për punë, sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi (*shih vendimet nr.17, datë 23.03.2023; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

80. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën së drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese (*shih vendimin nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

81. E drejta për ushtrimin e një profesioni mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t'u atribuohen konsideratave të së mirës së

përgjithshme. Nëse ligjvënësi e kushtëzon të drejtën për të nisur një aktivitet profesional me përmbushjen e disa kritereve të caktuara, duke cenuar kështu të drejtën për të zgjedhur një profesion, në këtë rast rregullimet për të mirën e përgjithshme janë të legjitimuara. Por këto kufizime duhen bërë vetëm kur veprime të tilla janë absolutisht të nevojshme për të mbrojtur në veçanti interesa të rëndësishëm të komunitetit dhe duhet që në të gjitha këto raste masa kufizuese e përzgjedhur të përmbajë cenimin më të vogël të mundshëm (*shih vendimet nr.17, datë 23.03.2023; nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

82. Nisur nga analiza e mësipërme (*shih paragrafin 44 të vendimit*), Gjykata çmon ta analizojë këtë pretendim në dy drejtime: në aspekt të paqartësisë së normës dhe të proporcionalitetit të ndërhyrjes.

83. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kur kontrollohen aktet e pushtetit publik sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë përpara ligjit, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 30, datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, ligji duhet jo vetëm të jetë i aksesueshëm për të interesuarin dhe i parashikueshëm për efektet e tij, por edhe mjaftueshmërisht i qartë, me qëllim që t'u japë individëve një tregues të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuara të ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese të tyre (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 30, datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzistenca e paqartësisë, e pasaktësisë, e kontradiksionit logjik ose e pazbatueshmërisë së normave ligjore mbartin drejtpërsëdrejti rrezikun e mosrespektimit të parimit të shtetit të së drejtës, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t`i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk është në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike (*shih vendimet nr. 4 datë 15.02.2021; nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Gjykata vëren se me nenin 10 të aktit normativ është ndryshuar neni 17 i ligjit nr. 123/2014, sipas të cilit janë riformuluar masat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve. Kështu, sipas pikës 1, shkronja "d", të nenit 17, Komisioni Disiplinor heton e gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe të seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit të Mjekëve, ndaj të cilit mund të merret masa

disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit të Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore ose ka bërë gabime teknike, Urdhri i Mjekëve, ndër të tjera, jep masën disiplinore "Heqja e licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut". Ndërsa sipas pikës 3 të këtij neni kjo masë disiplinore nuk shuhet.

85. Në analizë të këtij parashikimi, Gjykata çmon se mënyra e formulimit të kësaj dispozite mbart paqartësi për kriteret dhe shkallën e shkeljeve që mund të çojnë në aplikimin e masës më të rëndë disiplinore, atë të heqjes së licencës. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar qartë nëse kjo masë lidhet vetëm me raste të rënda të shkeljeve etike dhe deontologjike, ose mund të aplikohet edhe për gabime teknike të karakterit profesional, të cilat mund të kenë natyrë dhe peshë të ndryshme. Në vlerësimin e Gjykatës, një mungesë e tillë krijon pasiguri juridike si për subjektet që i nënshtrohen këtij parashikimi, ashtu edhe për vetë Urdhrin e Mjekëve që zbaton dispozitën, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe për rrezikun e vendimmarrjes arbitrare. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se dispozita në fjalë nuk përmbush standardin e qartësisë dhe të parashikueshmërisë së ligjit, i cili është një element thelbësor i parimit të shtetit të së drejtës dhe i sigurisë juridike, të garantuara nga neni 4 i Kushtetutës.

86. Gjithashtu, Gjykata thekson se çdo ndërhyrje që prek ushtrimin e së drejtës për të ushtruar profesionin duhet të bazohet në norma të qarta, të kuptueshme dhe të parashikueshme, në mënyrë që individi (mjeku në rastin konkret) të mund të dijë paraprakisht pasojat disiplinore të veprimeve ose mosveprimeve të tij. Mungesa e një përcaktimi të tillë objektiv bën që masa disiplinore e heqjes së licencës të zbatohet në mënyrë disproporcionale me qëllimin e ndëshkimit disiplinor.

87. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se dispozita e ndryshuar e nenit 17 të ligjit nr. 123/2014, në pjesën që parashikon aplikimin e masës disiplinore "Heqja e licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut", nuk plotëson standardin kushtetues të qartësisë dhe të parashikueshmërisë.

88. Përveç sa më sipër, Gjykata konstaton se masa disiplinore e heqjes së licencës përbën në thelb ndërhyrje në të drejtën për punë dhe për të ushtruar profesionin, të garantuar në nenin 49 të Kushtetutës, e cila do të analizohet në vijim në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pra nëse është bërë me ligj, për interes publik dhe nëse është respektuar kriteri i përpjesëtimit midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë. Fillimisht Gjykata evidenton se përpara ndryshimeve me aktin normativ, heqja e licencës nuk

ishte e parashikuar si masë disiplinore, por ky nen parashikonte përjashtimin nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet.

89. Për sa u përket dy kritereve të para, të "kufizimit vetëm me ligj" dhe "ndërhyrjes për interes publik", Gjykata i konsideron ato të përmbushura, duke iu referuar analizës së mësipërme për pretendimin e cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike (*shih paragrafin 70 të vendimit*). Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit, Gjykata bazuar edhe në pretendimet e kërkueseve, çmon ta analizojë atë në drejtim të ashpërsisë së masës.

90. Në këtë kuptim, Gjykata evidenton fillimisht se heqja e së drejtës së ushtrimit të profesionit është një nga masat më të ashpra të parashikuara nga akti normativ, e cila në thelb penalizon mjekun duke e ndaluar të ushtrojë profesionin e tij. Nga leximi literal i dispozitës duket se kjo masë disiplinore, e cila jepet për shkaqe që lidhen me shkelje të rregullave të Kodit të Etikës e për një afat të pacaktuar, ndonëse ka karakter administrativ, është më e ashpër edhe se vetë dënimi plotësues në procesin penal, në kuptim të nenit 39 të Kodit Penal. Sipas këtij neni, heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose të një profesioni jepet për një kohë të caktuar dhe është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale që kryhen, duke i shpërdoruar ato, ose kur vlerësohet se ushtrimi i mëtejshëm i veprimtarisë ose profesionit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete. Ndonëse heqja e së drejtës për ushtrimin e profesionit sipas ndryshimeve të reja ligjore ndjek një kronologji të caktuar në nivelin e ashpërsimit të masës, e vendosur në këtë mënyrë duket të jetë arbitrare dhe përbën një kufizim më të ashpër sesa është i nevojshëm për arritjen e qëllimit të synuar, që është mbrojtja e jetës dhe shëndeti i individëve, për rrjedhojë e cenon këtë drejtë në atë masë sa, në thelb, e asgjëson atë.

91. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata sjell në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila, ndonëse e ka trajtuar ndalimin e përhershëm të ushtrimit të profesionit të mjekut në kuadër të nenit 7 të KEDNJ-së, pra të mosdënimit pa ligj, ka argumentuar se një masë kaq e ashpër, në thelb, përbën një dënim penal (*shih Gouarré Patte kundër Andorrës, datë 12.01.2016, § 35*).

92. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se parashikimi në aktin normativ i masës disiplinore të heqjes së licencës në mënyrë të përhershme dhe pa përcaktuar kritere të qarta, për të cilat ajo mund të jepet, shkon përtej karakterit të dënimit penal dhe për këtë arsye kjo masë cenon në thelb të drejtën për punë dhe ushtrimin e një profesioni. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve në këtë drejtim është i bazuar, prandaj Gjykata vlerëson se

shkronja ”d” e pikës 1 të nenit 17 dhe fjalia e fundit e pikës 3 të po këtij neni, ndryshuar me nenin 10 të aktit normativ nr. 2/2024 duhet të shfuqizohen.

Ç. Për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës

93. Gjykata, bazuar në analizën e mësipërme (*shih paragrafët 30 dhe 42 të vendimit*), në kushtet kur konstatoi cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni, çmon të vijojë me analizën në themel të pretendimit të kërkuesve për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, pra nëse akti normativ ka dalë në kushtet e nevojës dhe të urgjencës.

94. Kërkuesit kanë pretenduar se Këshilli i Ministrave nuk ka arritur të provojë nevojën që ka ekzistuar për miratimin e aktit normativ dhe faktin nëse fenomeni i lëvizjes së mjekëve gjatë orarit zyrtar në klinika private ka ekzistuar prej kohësh, duke mos u bazuar në dokumente, raporte ose statistika. Po sipas tyre, Këshilli i Ministrave nuk ka argumentuar nëse fenomeni mund të zgjidhej me ndërhyrje normative ose ishte problematikë e moszbatimit të rregullave ligjore aktuale dhe mosveprimit të autoriteteve për formimin e mekanizmave kontrollues dhe monitorues për respektimin e orarit të punës. Gjithashtu, kërkuesit kanë parashtruar se një ngjarje e vetme penale nuk mund të konsiderohet si “situatë jo e zakonshme”, e cila kërkon nevojën urgjente për ndërhyrje nëpërmjet një akti normativ. Sipas kërkuesve, nuk përmbushet as kriteri i urgjencës, pasi ngjarja që ka shërbyer për fillimin e procesit është ndjekur penalisht nga prokuroria, ndaj Këshilli i Ministrave nuk pengohej të ndiqte procedurën e zakonshme ligjvënëse. Çështjet e disiplinës në punë dhe respektimi i orarit nuk bëjnë urgjencë që kërkon miratimin e një akti normativ.

95. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi plotësohen kriteret e nevojës dhe të urgjencës. Sipas tyre, nevoja për miratimin e aktit normativ konsiston në mungesën e rregullimit ligjor të ushtrimit të profesionit të mjekut në mënyrë të njëkohshme në sistemin shëndetësor publik dhe jopublik, faktit se legjislacioni për etikën nuk ka rezultuar efektiv dhe për garantimin e kujdesit shëndetësor. Për sa i përket kriterit të urgjencës, subjektet e interesuara kanë parashtruar se ai u evidentua pas hetimit penal të datës 25.06.2024, i pasuar nga hetimi administrativ, ndërsa analiza e raporteve për gjendjen e sistemit shëndetësor kërkoi një periudhë kohore deri në paraqitjen e propozimit për aktin normativ. Po sipas tyre, ndjekja e procesit legjislativ do të kërkonte 3-9 muaj, ndërsa miratimi me procedurë të përshpejtuar do të pengohej nga

mbyllja e sesionit parlamentar, ndaj ndërhyrja urgjente është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetësor publik dhe abuzimin në ofrimin e këtij shërbimi.

96. Neni 101 i Kushtetutës parashikon se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

97. E drejta e pushtetit ekzekutiv për të ushtruar autoritet me anë të akteve normative me fuqinë e ligjit duhet të justifikohet në çdo rast me praninë e rrethanave të veçanta që e bëjnë të nevojshëm miratimin e rregullimit urgjent *(shih vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nevoja dhe urgjenca janë kushte me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Kuptimi i tyre është autonom, i lidhur me tërësinë e përmbajtjes së dispozitës dhe me parimet bazë që përshkojnë Kushtetutën *(shih vendimet nr. 1, datë 06.02.2013; nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*. Duke qenë kushte paraprake, nevoja dhe urgjenca duhet të jenë vërtetuar se ekzistojnë përpara momentit të marrjes të iniciativës nga qeveria për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit *(shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*.

98. Lidhur me këtë pretendim, në përfundim të diskutimeve, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe pretendimi u konsiderua i rrëzuar.

99. Kështu, sipas njërit qëndrim, akti normativ synon garantimin e jetës dhe të shëndetit të shtetasve, rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor dhe sigurimin e aksesit efektiv të tyre në shërbimin shëndetësor. Punësimi i mjekëve njëkohësisht në sistemin shëndetësor publik dhe jopublik ka qenë një çështje e parregulluar në mënyrë të plotë nga legjislacioni në fuqi dhe bazuar në relacionin e Këshillit të Ministrave parashikimet ligjore të deritanishme janë treguar joefektive në drejtim të etikës. Në këto kushte, miratimi i aktit normativ paraqitet si masë e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik dhe për funksionimin e rregullt të shërbimit shëndetësor. Edhe për sa i përket kushtit të urgjencës, procedimi penal i muajit qershor 2024 solli domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore, ndërsa procesi legjislativ kërkon

kohë që zgjat për një periudhë disa mujore, sikurse janë hartimi i projektligjit, faza e konsultimit, paraqitja në komisionet përkatëse dhe diskutimi i tij, miratimi në seancë plenare në varësi të kalendarit të punimeve të Kuvendit, publikimi në Fletoren Zyrtare dhe hyrja në fuqi. Ndërkohë parandalimi i situatave të krijuara në ofrimin joadekuat të shërbimit shëndetësor publik ka kërkuar ndërhyrjen e menjëhershme nëpërmjet aktit normativ.[10]

100. Sipas qëndrimit tjetër, në parim, akti normativ përbën një masë të jashtëzakonshme, me të cilin Këshilli i Ministrave ushtron përjashtimisht kompetencë legjislative që, si rregull, i përket një pushteti tjetër, ndaj ekzistenca e nevojës dhe e urgjencës ka rëndësi thelbësore. Në rastin konkret, akti normativ nuk përmbush kushtet e nevojës, pasi ndonëse Këshilli i Ministrave ka argumentuar se masa synon garantimin e jetës dhe të shëndetit të shtetasve, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor, jo domosdoshmërisht situata të papritura ose të jashtëzakonshme kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme me akt normativ. Çështja e punësimit të mjekëve njëkohësisht në shërbimin shëndetësor publik dhe jopublik ka qenë e njohur prej kohësh dhe mungesa e një rregullimi të plotë ligjor nuk përbën *apriori* nevojën për ndryshime ligjore. Lidhur me kushtin e urgjencës, ekzistenca e një procedimi penal e nisur për një numër mjekësh në muajin qershor 2024 qartësisht nuk provon një rrezik të menjëhershëm për funksionimin e shërbimit shëndetësor, i cili të kërkonte detyrimisht shmangien e procesit të zakonshëm legjislativ dhe nxjerrjen e aktit normativ në muajin gusht 2024. Ky proces, pavarësisht kohëzgjatjes, është rruga e zakonshme dhe kushtetuese për ndryshimet e politikave publike dhe shqetësimet e evidentuara nuk justifikojnë ndërhyrjen përmes instrumentit të jashtëzakonshëm të aktit normativ.[11]

101. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve janë të bazuara pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

[10] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

[11] Votoi sipas këtij qëndrimi gjyqtarja Marsida Xhaferllari.

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e pikave 1, 3, 5, 7 dhe 9 të nenit 8/a të ligjit nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shtuar me nenin 5 të aktit normativ nr. 2, datë 01.08.2024, si dhe të shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 17 dhe të fjalisë së fundit të pikës 3 të po këtij neni, ndryshuar me nenin 10 të aktit normativ nr. 2, datë 01.08.2024, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.10.2025
Shpallur më 24.12.2025

Vendim nr. 59, datë 16.10.2025
(V-59/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 16.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 3 (I) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ISUF DASHI**

SUBJEKT I INTERESUAR:
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE,
BERAT, përfaqësuar nga drejtori, Altin Kazazi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2399/2516, datë 30.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-3568, datë 19.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja "e", 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet dhe prapësimet e kërkuesit Isuf Dashi (*kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH)*, Berat, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë oficer aktiv i Forcave të Armatosura nga data 16.06.1982. Ai ka dalë në rezervë në datën 01.09.2004, ndërsa mbante gradën "Kapiten" dhe me një vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv prej 22 vjetësh e 2 muajsh.

2. Pas përfundimit të trajtimit me pagesë kalimtare deri në datën 01.09.2006, kërkuesi, në vijim, është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi *(pensioni i parakohshëm).* Me vendimin nr. 735, datë 05.02.2007 *(vendimi nr. 735/2007),* DRSSH-ja, Berat i ka caktuar atij pension të parakohshëm në masën 16.480 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 01.09.2006, duke u bazuar në ligjin nr. 8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8087/1996)*. Pensioni i parakohshëm është llogaritur sipas nenit 11 të këtij ligji, në masën 50% të pagës referuese, mbi të cilën është derdhur kontributi për 15 vjet punë, e shtuar kjo me 2% të pagës referuese, mbi 15 vjet punë, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal në shkallë vendi.

3. Në vijim, me vendimin nr. 735/1, datë 20.10.2011 *(vendimi nr. 735/1/2011),* DRSSH-ja, Berat ka rillogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuesit, me efekt nga data 01.07.2009 e në vazhdim. Rillogaritja e pensionit është bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 10142/2009).*

4. Në datën 15.10.2014, duke mos qenë dakord si me llogaritjen fillestare, ashtu edhe me rillogaritjen e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, kërkuesi i është drejtuar DRSSH-së, Berat, duke i kërkuar rillogaritjen e këtij pensioni sipas nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 9210/2004*). Në përgjigje, me shkresën nr. 3622/1, datë 19.11.2014, DRSSH-ja, Berat është shprehur se llogaritja dhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm janë bërë në përputhje me ligjin dhe me vendimin nr. 2, datë 18.02.2013 *(vendimi nr. 2/2013)* të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)*.

5. Në datën 17.12.2014 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e DRSSH-së, Berat: (i) të revokojë vendimin nr. 735/2007 dhe t'i rillogarisë, ricaktojë dhe paguajë masën e pensionit të parakohshëm në përputhje me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, nga data 01.09.2006 dhe deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie; (ii) të revokojë vendimin nr. 735/1/2011 me të gjitha efektet negative të tij nga data 01.07.2009 e në vazhdim; (iii) t'i paguajë diferencat midis masës së pensionit sipas nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004 dhe pensionit të paguar, së bashku me kamatëvonesat, nga data 01.09.2006 dhe deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

6. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 586, datë 29.04.2015, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit, sipas objektit të saj. Kjo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se llogaritja e masës së pensionit të parakohshëm të kërkuesit nga DRSSH-ja, Berat është bërë në kundërshtim me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, që ka qenë në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për të, përveçse ajo kishte zbatuar një dispozitë të shfuqizuar, shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, për kufizimin e pensionit të parakohshëm të kërkuesit në masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuesin sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9210/2004 dhe me vetë përmbajtjen e këtij neni (nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009), por edhe me vendimin e Gjykatës nr. 33, datë 24.06.2010 (*vendimi nr. 33/2010*), duke cenuar parimin e sigurisë juridike, për sa kohë rillogaritja ka ndikuar negativisht në situatën e kërkuesit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur, DRSSH-ja, Berat.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2399/2516, datë 30.05.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative

të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit. Gjykata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se ndonëse në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuesin, në datën 01.09.2006, ka qenë në fuqi ligji nr. 9418/2005, në zbatim të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *(vendimi unifikues nr. 3/2016),* ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të kërkuesit është ligji nr. 8087/1996. Për rrjedhojë, llogaritja, caktimi dhe pagimi i pensionit të parakohshëm për kërkuesin është bërë në përputhje me ligjin. Edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuesin është në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009 dhe me vendimin nr. 2/2013 të Gjykatës, ku është arritur në përfundimin se megjithëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimit suplementar ka prekur parimin e sigurisë juridike, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë, duke respektuar ajo kriteret kushtetuese të nenit 17/1 të Kushtetutës. Në të njëjtën linjë arsyetimi, edhe në vendimin unifikues nr. 3/2016, është arritur në përfundimin se rillogaritja e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 i ligjit nr.10142/2009 do të bëhet sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj, edhe në situatën kur kjo rillogaritje ul masën e pensionit të parakohshëm të njohur dhe të caktuar më parë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3568, datë 19.09.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012).* Sipas atij kolegji, shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila u ka bërë një analizë të hollësishme dispozitave ligjore të zbatueshme, konkretisht ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 10142/2009, duke i dhënë meritën çështjes në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016. Po sipas atij kolegji, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të ketë zbatuar gabim ligjin material ose procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

9. Në datën 15.01.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 është regjistruar më 23.01.2025. Në datën 23.03.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 23.04.2025

ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:
10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:
10.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial* të lidhur *me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar dhe nuk u ka kthyer përgjigje shkaqeve të ngritura në rekursin e tij, ndonëse ato kishin të bënin si me zbatimin e gabuar të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit, që ishin të një rëndësie themelore, ashtu edhe me parimin e sigurisë juridike në aspektin e të drejtave të fituara.
10.1.2. *Parimit të sigurisë juridike në aspektin e së drejtës së fituar*, pasi:
10.1.2.1. Ndonëse e drejta për pension të parakohshëm kërkuesit i ka lindur në datën 01.09.2006 dhe ajo rregullohej nga ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012 dhe në mosrespektim edhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013 *(vendimi unifikues nr. 3/2013)* të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, masa e pensionit atij i është llogaritur sipas ligjit nr. 8087/1996, megjithëse ky ligj nuk zbatohej në rastin e tij. Si pasojë e kësaj, kërkuesit i është cenuar masa e pensionit me 8.032 lekë në muaj. Në vendimin unifikues nr. 3/2016 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur të mos zbatohen ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005, por ligji nr. 8087/1996 së bashku me kufizimin e tij në shkronjën "b" të nenit 11, megjithëse ky kufizim ishte shfuqizuar duke filluar nga data 14.04.2004.
10.1.2.2. Masa e pensionit është përligjur edhe në zbatim të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, duke i dhënë atij fuqi prapavepruese, në kundërshtim me vendimin e Gjykatës nr. 33/2010, ku është përcaktuar qartë se

rillogaritja do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve. Për më tepër, kërkuesi nuk është as subjekt i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, pasi objekt rillogaritjeje, sipas tij, janë pensionet e parakohshme të përfituara sipas ligjit nr. 8087/1996 dhe jo ato sipas ligjeve nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005. Si pasojë e kësaj, pas datës 01.07.2009 kërkuesit i është ulur masa e pensionit të parakohshëm me 19.998 lekë në muaj.

10.2. *Parimi i shtetit të së drejtës* dhe ai i *hierarkisë së akteve normative,* pasi gjykatat e zakonshme në vendimet e kundërshtuara*:*

10.2.1. Nuk kanë zbatuar ligjin që ka qenë në fuqi në datën 01.09.2006, në momentin e lindjes për kërkuesin të së drejtës së pensionit të parakohshëm, pikërisht ligjin nr. 9210/2004. Ato kanë zbatuar ligjin nr. 8087/1996, megjithëse ligji nr. 9210/2004 bën pjesë në listën e ligjeve që miratohen me shumicë të cilësuar sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës. Për më tepër, ligji nr. 8087/1996, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9418/2005, nuk zbatohej për ushtarakët që përfitonin sipas këtij të fundit (neni 33). Po kështu, është zbatuar kufizimi sipas shkronjës "b" të nenit 11 të këtij ligji (ligjit nr. 8087/1996), në një kohë kur ky kufizim ishte shfuqizuar me nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004.

10.2.2. I kanë dhënë fuqi prapavepruese nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, megjithëse kjo dispozitë parashikon rillogaritjen e përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 8087/1996, por jo edhe të atyre sipas ligjeve nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005. Si pasojë, kërkuesit i janë cenuar të drejtat e fituara dhe, për më tepër, në mosrespektim të vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, e cila, në interpretim pajtues të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, ka arritur në përfundimin se rillogaritja do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve.

10.3. *Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk kanë respektuar vendimet e Gjykatës nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013, përmes të cilave është pranuar se zvogëlimi i pensionit të parakohshëm nuk mund të përligjej me interesin publik, se rillogaritja e pensionit sipas

nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 do të bëhej vetëm në rast se ndryshonte pozitivisht situatën e përfituesve dhe se prekja e skemës së sigurimeve shoqërore bazë nuk duhej kurrsesi të pësonte ndryshime të tilla që të përkeqësonin ndjeshëm jetën e shtetasve, të cilët përfitonin këtë sigurim. Edhe pse ishin përpara një të drejte që buronte nga neni 52, pika 2, i Kushtetutës dhe të njohur me ligj të miratuar me shumicë të cilësuar, gjykatat kanë zvogëluar masën e pensionit të tij të parakohshëm pa marrë parasysh këto vendime të Gjykatës. Vendimi unifikues nr. 3/2016 ka përcaktuar rillogaritjen në përkeqësim të pensionit të parakohshëm.

11. ***Subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Berat,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës* nuk qëndron, pasi DRSSH-ja, Berat e ka përllogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuesit bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, sipas kufizimit të vendosur në shkronjën "b", pra jo më shumë se masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Kufizimi i masës së përfitimit ekziston jo vetëm në ligjin e sigurimeve shoqërore, por edhe në ligjet për sigurimet shoqërore suplementare, ndaj një mënyrë e ndryshme të vepruari nga ajo do të ishte në zbatim të gabuar të ligjit, duke abuzuar me fondet e buxhetit të shtetit. Pensioni i parakohshëm i kërkuesit është përllogaritur në përputhje të plotë me ligjin nr. 10142/2009 dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij, sikundër edhe me udhëzimet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore *(ISSH).*

11.2. Pretendimi për cenimin e p*arimit të sigurisë juridike në aspekt të së drejtës së fituar* nuk qëndron, pasi ligji nr. 10367, datë 23.12.2010, i cili ndryshoi ligjin nr. 10142/2009, iu nënshtrua kontrollit kushtetues dhe Gjykata, me vendimin nr. 2/2013, ka vlerësuar se megjithëse skema e re e përllogaritjes së masës së sigurimeve suplementare ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë, pasi masa e pensionit e përllogaritur sipas formulës së re mbështetet në mundësitë reale buxhetore, siguron funksionimin e parimeve të funksionimit të skemave suplementare dhe ruan raporte të arsyeshme midis masës së sigurimit të parakohshëm dhe pagës mesatare neto nga puna.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në lidhje me vendimet e kundërshtuara të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të dhëna në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga ai, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu objekt i ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se, sipas jurisprudencës kushtetuese, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 24, datë 23.04.2025; nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se kërkuesi nuk ka qenë palë në procesin për të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur me vendimin unifikues nr. 3/2016, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij në

këndvështrim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues, për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.09.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 15.01.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të sigurisë juridike, përveç edhe të parimeve të shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve, si dhe të standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, ka paraqitur të njëjtat argumente që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, prandaj ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

19. Kërkuesi ka pretenduar se masa e pensionit të parakohshëm të caktuar nga DRSSH-ja, Berat nuk është bazuar në ligjin në fuqi në kohën e lindjes të së drejtës, ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005, por në ligjin nr. 8087/1996, i cili nuk ka qenë i zbatueshëm në rastin e tij dhe,

për më tepër, duke konsideruar atë kufizim të masës së pensionit që ky i fundit parashikonte, në një kohë kur ky kufizim ishte shfuqizuar prej datës 14.04.2004, përmes nenit 49 të ligjit nr. 9210/2004. Po ashtu, edhe rillogaritja në vijim e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është bërë në shkelje të përmbajtjes së kësaj dispozite, përveçse kjo dispozitë bie ndesh me ligjin nr. 9210/2004, i cili bën pjesë në listën e ligjeve që miratohen me shumicë të cilësuar sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës. Pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat, për sa i përket përcaktimit të masës së përfitimit të këtij pensioni, nuk kanë interpretuar e zbatuar drejt jurisprudencën kushtetuese dhe legjislacionin e fushës, në cenim të parimit të sigurisë juridike në aspekt të të drejtave të fituara. Po sipas tij, edhe për sa i përket rillogaritjes së masës së pensionit të parakohshëm, interpretimi që këto gjykata u kanë bërë dispozitave ligjore dhe vendimeve të Gjykatës, si dhe zbatimi i vendimit unifikues nr. 3/2016 kanë bërë që ajo rillogaritje të jetë në përkeqësim të situatës së tij financiare, duke cenuar edhe në këtë rast parimin e sigurisë juridike. Po sipas kërkuesit, edhe pse shkaqet e ngritura në rekursin e tij kishin të bënin si me zbatimin e gabuar të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit dhe me cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar dhe nuk ka vlerësuar bazueshmërinë e tyre në ligj.

20. Subjekti i interesuar ka prapësuar se llogaritja e pensionit të parakohshëm të kërkuesit është bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, sipas kufizimit të vendosur në shkronjën "b", pra jo më shumë se masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Ky lloj kufizimi i masës së përfitimit ekziston jo vetëm në ligjin e sigurimeve shoqërore, por edhe në ligjet për sigurimet shoqërore suplementare, ndaj një mënyrë e ndryshme të vepruari do të ishte në zbatim të gabuar të ligjit, duke abuzuar me fondet e buxhetit të shtetit. Për pasojë, sipas subjektit të interesuar, pensioni i parakohshëm i kërkuesit është llogaritur në përputhje të plotë me ligjin, përfshirë edhe periudhën pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009. Ky i fundit, sipas tij, u ndryshua me ligjin nr. 10367, datë 23.12.2010 dhe iu nënshtrua kontrollit kushtetues. Gjykata, me vendimin nr. 2/2013, ka vlerësuar se megjithëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimeve suplementare ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë, pasi formula e re për llogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm mbështetet në mundësitë reale buxhetore,

siguron funksionimin e parimeve të funksionimit të skemave suplementare dhe ruan raporte të arsyeshme midis masës së sigurimit të parakohshëm dhe pagës mesatare neto nga puna.

21. Duke sjellë në vëmendje se neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon edhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata çmon të ritheksojë se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 24, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Po kështu, për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, Gjykata çmon të ritheksojë se ai përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohen, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë

ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 78, datë 06.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm ose në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 1, datë 31.01.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata gjithashtu çmon të ritheksojë se edhe se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Lidhur me legjislacionin që ka rregulluar ndër vite të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrollin e tij kushtetues dhe për sa u përket përfundimeve njësuese të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, Gjykata e ka bërë tashmë në disa raste *(shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025 §§ 26-35; nr. 25, datë 23.04.2025 §§ 42-48; nr. 24, datë 23.04.2025 §§ 25-31),* ndaj çmon të mos ndalet në evidentimin e tij në hollësi edhe në këtë vendim.

26. Mbi atë bazë, nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata në vijim do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

27. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesit, si ushtarak i dalë në rezervë, e drejta për pension të parakohshëm i ka lindur në datën 01.09.2006. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 16.480 lekë në muaj, sipas aktit administrativ, vendimit nr. 735/2007 të DRSSH-së, Berat *(shih paragrafin 1 të vendimit)*. Në vijim, me një akt tjetër administrativ, vendimin nr. 735/1/2011, DRSSH-ja, Berat ka rillogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuesit sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 *(shih paragrafin 2 të vendimit)*. Duke mos qenë dakord me llogaritjen fillestare, ashtu edhe me rillogaritjen në vijim të pensionit të parakohshëm, sipas këtyre akteve administrative, kërkuesi ka paraqitur ankim përpara DRSSH-së, Berat, e cila i ka kthyer përgjigje negative *(shih paragrafin 3 të vendimit)*. Pas kësaj, kërkuesi ka kundërshtuar gjyqësisht aktet administrative në fjalë, duke kërkuar revokimin e tyre dhe detyrimin e organit administrativ t'i rillogarisë dhe t'i paguajë atij pensionin e parakohshëm në përputhje me masën e përcaktuar në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, si dhe t'i paguajë diferencat e këtij pensioni, së bashku me kamatëvonesat, nga data 01.09.2006 deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor *(shih paragrafin 4 të vendimit)*.

28. Padia e kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, e cila, me vendimin nr. 586, datë 29.04.2015, ka vendosur pranimin sipas objektit të saj. Sipas asaj gjykate, ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të kërkuesit në çastin e lindjes të së drejtës, në datën 01.09.2006, nuk ka qenë ligji nr. 8087/1996, por ligji nr. 9210/2004 dhe referuar nenit 35, pika 1, të tij, masa e këtij pensioni në këtë datë, e llogaritur nga vetë pala e paditur, është 24.512 lekë (për 22 vjet vjetërsi shërbimi dhe pagën referuese 38.300 lekë) dhe jo 16.480 lekë. Për rrjedhojë, llogaritja e masës së pensionit të parakohshëm të kërkuesit është bërë në kundërshtim me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004. Për

më tepër, sipas asaj gjykate, kufizimi i masës së pensionit të parakohshëm të kërkuesit sa pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi është bërë në bazë të shkronjës "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, në një kohë kur ky kufizim sipas kësaj shkronje ishte shfuqizuar nga neni 49 i ligjit nr. 9210/2004.

29. Po sipas asaj gjykate, edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuesin sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është bërë në kundërshtim: i) me ligjin nr. 9210/2004, i cili, referuar nenit 81, pika 2, shkronja "e", të Kushtetutës, bën pjesë në kategorinë e atyre ligjeve që miratohen me shumicën e cilësuar, ndërsa ligji nr. 10142/2009, i cili ka dalë në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9210/2004, bën pjesë në ligjet e zakonshme që miratohen me shumicën e thjeshtë, ndaj ai nuk mund të ndryshojë atë që ka përcaktuar ligji organik (ligji nr. 9210/2004); ii) me vetë përmbajtjen e këtij neni (nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009), i cili lejon rillogaritjen vetëm të atyre përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 8087/1996, por jo edhe për ato të caktuara sipas ligjit nr. 9210/2004; iii) me vendimin e Gjykatës nr. 33/2010, ku është mbajtur qëndrimi se rillogaritja do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve, përndryshe cenohet parimi i sigurisë juridike. Ndonëse Gjykata në vendimin nr. 2/2013 ka pranuar se vetëm skema e sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet të pësojë ndryshime që përkeqësojnë ndjeshëm jetën e shtetasve, duke lejuar ndryshime të skemës së përfitimeve suplementare, në rastin konkret jemi para një pensioni të parakohshëm të ushtarakut, i cili përbën një të drejtë sipas nenit 52, pika 2, të Kushtetutës, e drejtë kjo që rregullohet sipas kushteve të ligjit, që në këtë rast është ligji nr. 9210/2004.

30. Çështja është shqyrtuar në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 2399/2516, datë 30.05.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Sipas gjykatës së apelit, ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të kërkuesit ka qenë ligji nr. 8087/1996. Sipas saj, ndonëse në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuesin, në datën 01.09.2006, në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 3/2016, kanë arritur në përfundimin se për periudhën nga data 01.01.1999 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përllogaritet sipas ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe se në rastet kur e drejta për pension ka lindur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9418/2005 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.10142/2009, në kuptim të

nenit 29 të këtij ligji, skema për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, e parashikuar nga ligji nr. 9418/2005 dhe e ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, nuk zbatohet, pavarësisht nëse masa e pensionit rritet ose ulet në raport me skemën e parashikuar nga ligji nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, llogaritja, caktimi dhe pagimi i pensionit të parakohshëm për kërkuesin është bërë në përputhje me ligjin në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës.

31. Po sipas gjykatës së apelit, edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuesin është në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009 dhe me vendimin nr. 2/2013 të Gjykatës, ku është arritur në përfundimin se megjithëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimit suplementar ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit, pra ka prekur parimin e sigurisë juridike, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë, duke respektuar ajo kriteret kushtetuese të nenit 17/1 të Kushtetutës, konkretisht mbrojtjen e interesit publik, vendosjen e një raporti të drejtë midis së drejtës së cenuar dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet ndërhyrjes legjislative, si dhe ruajtjen e thelbit të së drejtës për sigurim shoqëror. Skema e re e rillogaritjes, sipas ligjit nr. 10142/2009, vijon gjykata, është gjetur e aplikueshme pas datës së miratimit të këtij ligji dhe në përputhje me Kushtetutën jo vetëm sipas vendimit në fjalë të Gjykatës, por, në të njëjtën linjë arsyetimi, edhe në vendimin unifikues nr. 3/2016, është arritur në përfundimin se rillogaritja e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 i ligjit nr.10142/2009 do të bëhet sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj edhe në situatën kur kjo rillogaritje ul masën e pensionit të parakohshëm të njohur dhe të caktuar më parë.

32. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3568, datë 19.09.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se pretendimeve në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila u ka bërë një analizë të hollësishme dispozitave ligjore të zbatueshme, konkretisht ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 10142/2009, duke i dhënë meritën çështjes në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016. Sipas atij kolegji, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të ketë zbatuar gabim ligjin material ose procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

33. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur

e drejta për pension të parakohshëm në datën 01.09.2006, moment në të cilin kjo e drejtë rregullohej nga nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, të cilat përcaktonin kushtet dhe kriteret për përfitimin e pensionit të parakohshëm dhe masën e tij, për të cilën përcaktohej se ajo ishte 50% e pagës referuese dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese, por masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të ishte më e madhe se 3-fishi i pensionit bazë për ushtarakët e tjerë (për ata që nuk mbanin gradat "Gjeneral", "Kolonel", "Major" dhe "Nënkolonel"). Ndërkohë, për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, sipas shkronjës "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, si dhe parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 9418/2005, sipas të cilit, me hyrjen e tij në fuqi, ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se ai do të përfitonte nga këto dispozita, pra se ndaj atij nuk do të zbatohej tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm (referuar ligjit nr. 9210/2004) ose që ky kufizim do të ishte deri në 3-fishin e pensionit bazë (referuar ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006).

34. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht momentit kur kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm dhe ligjit në fuqi në atë moment, konkretisht ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se ky ligj nuk zbatohej, por zbatohej ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, megjithëse neni 33 i ligjit të parë parashikonte shprehimisht se ky i dyti nuk do të zbatohej për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji (ligjit të parë). Për këtë, ajo gjykatë i është referuar përfundimit të arritur në vendimin unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilave, referuar nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 10142/2009, për periudhën nga data 01.01.1999 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përllogaritej sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), përfshirë edhe për përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në kohën kur në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005 (i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), ligj i cili nuk zbatohej. Po sipas atyre kolegjeve, zbatimi me fuqi prapavepruese i nenit 29 të ligjit është në përputhje me Kushtetutën, sikurse është vlerësuar edhe në vendimet

e Gjykatës nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013. Megjithatë, objekt rregullimi i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është rillogaritja e të drejtave të njohura, ku pika 1 e tij përcakton zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8087/1996 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (nr. 10142/2009), duke mos u shprehur për ndonjë efekt prapaveprues të ligjit në fjalë, por as për (pa) zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 ose rregullimin ndryshe të pasojave të ardhura nga zbatimi i tij. Po kështu, edhe në vendimet e referuara të Gjykatës nuk ka ndonjë vlerësim për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 për periudhën që ai ka qenë në fuqi dhe as për zbatimin në mënyrë përjashtimore me efekt prapaveprues të ligjit nr. 10142/2009, pra me qëllim rregullimin e ndonjë prej atyre situatave, të cilat, në aspektin kushtetues, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, do të lejonin, përjashtimisht, zbatimin me efekt prapaveprues të këtij ligji ndaj situatave ose marrëdhënieve të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi.

35. Gjithashtu, përtej kësaj, Gjykata konstaton se ndonëse me ligjin nr. 9210/2004 tavani i masës së pensionit maksimal të pleqërisë ishte shfuqizuar, Gjykata Administrative e Apelit për pensionin e parakohshëm të kërkuesit për periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009, duke u bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, ka përcaktuar se masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalonte masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke vlerësuar edhe ajo se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohej, pasi nuk kishin dalë aktet nënligjore në zbatim të tij.

36. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit duket se nuk ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, si dhe nuk e ka llogaritur masën e pensionit sipas kushteve e kritereve të parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.

37. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit nr. 9210/2004 dhe e nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, si dhe mënyra e interpretimit të tyre nga gjykata e apelit nuk rezultojnë të jenë analizuar nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit nuk shprehet se përse ligji nr. 9210/2004, i identifikuar nga gjykata administrative e shkallës së parë si i zbatueshëm në rastin konkret ose dhe ligji nr. 9418/2005, i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, i identifikuar

nga gjykata e apelit si ligji që ka qenë në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuesin, janë të pazbatueshëm për periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009 dhe se i tillë është ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk shprehet as se përse në rastin në shqyrtim kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues për periudhën në fjalë dhe as se përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm nga gjykata e apelit (ligji nr. 8087/1996) vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar. Në këtë drejtim, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, sikundër edhe për sa i përket zbatimit të kritereve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm.

38. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Për sa i përket këtij të fundit, ajo gjykatë nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti në drejtim të masës së kufizimit të pensionit të parakohshëm të kërkuesit për periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009. Prandaj, vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuesit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji. Ndërkohë për sa u përket pretendimeve të kërkuesit në lidhje me nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009, për periudhën pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra pas datës 01.07.2009, Gjykata vëren se interpretimi i kësaj dispozite nga gjykata e apelit dhe pranimi i tij nga Gjykata e Lartë nuk duket i paarsyeshëm dhe që të bjerë ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, pra i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Prandaj, pretendimet e kërkuesit në lidhje me masën e pensionit të parakohshëm për periudhën 01.07.2009 e në vijim nuk janë të bazuara.

39. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit, në lidhje me periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009, është i bazuar. Megjithatë, Gjykata, duke mbajtur në

konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se i përket Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre, prandaj duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i saj.

40. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3568, datë 19.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.10.2025
Shpallur më 20.11.2025

Vendim nr. 60, datë 16.10.2025
(V-60/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Annjeza Puka, në datën 16.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Genci Gjonçaj.
GJYKATA E LARTË, përfaqësuar nga kryetari Sokol Sadushi.

OBJEKTI: **Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Neni 131, shkronja "ç", i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 54, pika 3, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*)

dhe Gjykatës së Lartë, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 62, datë 23.09.2024 (*vendimi nr. 62/2024*), Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtares kushtetuese, zonjës E.T., përpara afatit, për shkak të paraqitjes së dorëheqjes prej saj. Vendimi, edhe pse ka deklaruar datën e mbarimit të mandatit për shkak të dorëheqjes, nuk ka deklaruar datën e mbarimit të këtij mandati kushtetues. Ky vendim i është njoftuar edhe Kuvendit, i cili, si organi i emërtesës, ka shpallur hapjen e procedurave për plotësimin e kësaj vakance. Në njoftimin për shpallje Kuvendi ka konsideruar se gjyqtarja E.T. ishte emëruar në datën 14.11.2019 për një mandat të plotë 9-vjeçar, duke përcaktuar kështu si datë të mbarimit të mandatit plotësues të shpallur datën 14.11.2028.

2. Me vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 (*vendimi nr. 84/2024*), Gjykata, e vënë në lëvizje nga Kryetarja e saj, ka deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtares H.Z. (vetë Kryetares) në datën 10.03.2025, për shkak të përfundimit të afatit të kohëzgjatjes së tij. Në situatën që kryetari i organit të emërtesës, Gjykatës së Lartë, me njoftimin e datës 11.12.2024 kishte hapur procedurën për zgjedhjen e gjyqtarit të ri kushtetues, Gjykata vlerësoi të ndalet dhe të analizojë edhe procedurën që duhet të ndiqet në rastin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, me qëllim shmangien e konfliktit me organin e emërtesës në këtë drejtim, për të siguruar pavarësinë dhe legjitimitetin e tij sikundër edhe të Gjykatës, nga njëra anë, por edhe për të garantuar ushtrimin nga organi i emërtesës të kompetencës së tij për zgjedhjen/emërimin e gjyqtarit kushtetues, nga ana tjetër. Ajo theksoi se, mbi bazën e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, që përfshin edhe parimin e luajalitetit kushtetues, hapja e procedurës për plotësimin e një vendi vakant duhet të fillojë vetëm pasi kjo Gjykatë të ketë deklaruar mbarimin e mandatit të anëtarit të saj, sipas nenit 127, pika 2, të Kushtetutës dhe vetëm pasi Kryetari i saj të ketë njoftuar organin përkatës të emërtesës sipas nenit 9, pika 3, të Ligjit Organik të Gjykatës. Për rrjedhojë, në çdo rast kur një organ i emërtesës vlerëson se Kryetari i saj/Gjykata nuk e ka

ushtruar kompetencën e tij/saj brenda afatit ligjor, ai duhet t`i drejtohet Gjykatës, duke i kërkuar me shkrim ushtrimin e një kompetence të tillë, si dhe duke parashtruar, në çdo rast, edhe argumentet përkatëse në drejtim të fakteve dhe dispozitave kushtetuese në të cilat mbështet qëndrimin e tij për mbarimin e mandatit të gjyqtarit për pozicionin e të cilit është organ emërtese sipas Kushtetutës dhe ligjit. Në këtë rast Gjykata, pa vonesë, duhet të shprehet me vendim, i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim. Në vlerësimin e Gjykatës kjo është mënyra e vetme e të vepruarit të organeve kushtetuese të përfshira në procedurën e emërimit/zgjedhjes të gjyqtarit kushtetues, bazuar jo vetëm në parimin e luajalitetit kushtetues, por që garanton ushtrimin pa pengesa të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga çdo organ dhe, çka është më e rëndësishme, parimin e pavarësisë së kësaj Gjykate (*shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Presidenti, pasi është njohur me vendimin nr. 84/2024 të Gjykatës, në cilësinë e njërit prej tre organeve të emërtesës për emërimin e gjyqtarëve kushtetues sipas nenit 125, pika 1, të Kushtetutës, në datën 30.01.2025 i është drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt dhe bazë ligjore si më sipër. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 11.04.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

4. ***Presidenti***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

i) Për legjitimimin:

4.1. E drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën, bazuar në vendimin e saj nr. 84/2024, mund të ushtrohet vetëm në kuadër të konfliktit të kompetencave sipas pikës 3 të nenit 54 të Ligjit Organik të Gjykatës, sepse ky ligj nuk parashikon procedurë të posaçme për shqyrtimin e kërkesës së organit të emërtesës nëse Kryetari i Gjykatës nuk kërkon dhe ajo nuk vendos deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues. Objekti i kërkesës nuk mund të jetë veçse deklarimi i mbarimit të mandatit, pasi organi i emërtesës nuk mund të parashtrojë kërkesë për interpretim të dispozitës kushtetuese pas ndryshimeve të vitit 2016 dhe as kërkesë për saktësim dhe plotësim të vendimit nr. 84/2024, duke mos qenë palë në atë gjykim.

ii) Për themelin:

4.2. Në vendimin nr. 84/2024 Gjykata e ka gjetur të drejtë arsyetimin e kryetarit të Gjykatës së Lartë në njoftimin për hapjen e procedurës së aplikimit si për sa i përket parimit të përtëritjes së pjesshme, ashtu edhe përcaktimit se data e mbarimit të mandatit duhet të jetë ajo korresponduese me datën e mbarimit të mandatit pasardhës. Edhe pse Kushtetuta në dispozitën kalimtare ka përcaktuar dy mandate 8-vjeçare, Gjykata ka çmuar në vendimin nr. 84/2024 se mandati mund të shkurtohet edhe më shumë në rast se emërimi është kryer kohë pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës. Situata kalimtare nuk vlen vetëm për atë rast, përndryshe arsyetimi i vendimit nr. 84/2024 nuk do të kishte kuptim. Ajo situatë vlen për të gjithë dispozitën e nenit 179 të Kushtetutës, qëllimi i së cilës ka qenë të sigurojë kalimin pa ngërçe nga njëra trupë tek tjetra në momentin e ndryshimeve kushtetuese dhe, në mënyrë të veçantë, përtëritjen e pjesshme të trupës në intervalet kohore 2025, 2028 dhe 2031. Ky parashikim është transkriptuar në nenin 86, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe sipas kësaj skeme do të ishin kalimtare jo vetëm dy mandatet 8-vjeçare që përfundonin në vitet 2025 dhe 2028, por të gjitha mandatet fillestare, prej të cilave dy mandate të plota duhet të mbaronin në vitin 2025, dy në vitin 2028 dhe tre të fundit, të plota, në vitin 2031.

4.3. Në analizën e atij vendimi nuk është shprehur asnjë konkluzion për impaktin që ka arsyetimi i Gjykatës për "parimin organizativ të përtëritjes së rregullt të pjesshme" dhe për "lidhjen mes mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës dhe fillimit të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri" mbi mandatet e të gjithë gjyqtarëve të tjerë, të cilët ndodhen aktualisht në kushtet e humbjes së kësaj lidhjeje dhe për këtë shkak kohëzgjatja 9-vjeçare e mandatit të secilit prej tyre shtrembëron zbatimin e parimit të përtëritjes së rregullt. Gjykata nuk ka vepruar për të deklaruar mbarimin edhe të dy mandateve të tjera që përfshihen në përtëritjen e parë pas ndryshimeve të vitit 2016, atë të vitit 2025. Nëse nuk deklarohet mbarimi i këtyre mandateve dhe nëse arsyetimi i vendimit nr. 84/2024 nuk vlen edhe për to, nuk mund të ketë përtëritje të pjesshme në vitin 2025, për pasojë shkurtimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues sipas atij vendimi është bërë në kundërshtim me Kushtetutën. Nëse parimi i përtëritjes prevalon mbi atë të qëndrueshmërisë në detyrë, Gjykata

duhej të kishte përfunduar procedurën për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit emërtesë e Presidentit dhe ta njoftonte atë për vakancën përpara datës 25.01.2025. Në situatën faktike Gjykata duhet të shprehet edhe për mandatin tjetër emërtesë e Kuvendit, për sa kohë që vijimi i procedurës së shpallur nga ky i fundit për mandatin plotësues që mbaron më 14.11.2028 i humb kuptimin detyrimit për përtëritjen e pjesshme të mbrojtur në vendimin nr. 84/2024.

4.4. Parimi i luajalitetit kushtetues do të kërkonte nga Presidenti dhe Kuvendi që të respektonin prerogativën e Kryetarit të Gjykatës për ta vënë atë në lëvizje për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues. Këto dy organe nuk do të kishin nevojë të viheshin në lëvizje pas datës 25.01.2025, nëse në vendimin nr. 84/2024 nuk do të ishte lidhur mbarimi i atij mandati konkret me nevojën për zbatimin e parimit të përtëritjes dhe data e mbarimit të atij mandati me atë të mbarimit të mandatit paraardhës. Presidenti e ka nisur këtë procedurë me qëllimin që Gjykata të sqarojë përfundimisht atë çka është lënë pa sqaruar në vendimin nr. 84/2024, si për sa i përket zbatimit të mekanizmit të përtëritjes së pjesshme, në kushtet kur emërimi i gjyqtarëve është bërë në kapërcim të afateve ligjore, ashtu edhe për sa i përket saktësimit të rëndësisë që ka data e përfundimit të mandatit paraardhës për fillimin e procedurës për deklarimin e mbarimit të mandatit në të gjitha rastet kur gjyqtari i zgjedhur në vonesë është zgjedhur me mandat të plotë 9-vjeçar.

4.5. Konflikti i kompetencave nga buron e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën ka lidhje me faktin se Presidenti është i kushtëzuar në ushtrimin e kompetencës kushtetuese nga vendimmarrja e Gjykatës për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit emërtesë e tij, pasi mosmarrja e këtij vendimi e pengon Presidentin, si organ emërtese, të ushtrojë kompetencën për emërimin e gjyqtarit të ri. Nëse ai do të kalonte në heshtje rrethanat konkrete dhe pasojat që sjell vendimi nr. 84/2024 për të gjitha mandatet që për shkak të emërimit me vonesë kapërcejnë afatet për përtëritjen e pjesshme të Gjykatës, kjo e fundit do të vihej në kushtet e pamundësisë për vendosur deklarimin e mbarimit të mandateve të caktuara dhe për të siguruar përtëritjen e pjesshme, gjë që sipas vendimit nr. 84/2024 e bën edhe organin e emërtesës përgjegjës për shkelje

të Kushtetutës nëpërmjet mosveprimit për të vënë në lëvizje Gjykatën.

5. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi****,* ka parashtruar si vijon:

5.1. Kuvendi, pasi u njoh me vendimin nr. 62/2024 të Gjykatës për deklarimin e mbarimit të mandatit përpara afatit të gjyqtarit kushtetues emërtesë e tij, në përputhje me kompetencat e tij dhe në respektim të afateve ligjore, shpalli hapjen e procedurës së aplikimit për plotësimin e kësaj vakance. Në njoftimin për shpalljen e vakancës Kuvendi ka vlerësuar se mandati plotësues përfundon në datën 14.11.2028, duke u bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që përcaktojnë afatin e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit kushtetues dhe momentin e fillimit të llogaritjes së këtij afati, si dhe në vendimin e tij të vitit 2019 për zgjedhjen në detyrë të gjyqtarit të dorëhequr. Kuvendi u bazua edhe në jurisprudencën e Gjykatës dhe Opinionin e Komisionit të Venecias të vitit 2016, i cili, mes të tjerash, është shprehur se vitet fikse të fillimit e përfundimit të mandateve 9-vjeçare duhen hequr dhe se gjyqtarët kushtetues duhet të gëzojnë gjithmonë mandat të plotë.

5.2. Vendimi nr. 84/2024 i Gjykatës përfaqëson vendimin e parë interpretues për mekanizmin e përtëritjes së pjesshme të përbërjes së saj pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016. Ky vendim, përveçse ka përcaktuar fundin e mandatit të një gjyqtari kushtetues, ka arsyetuar një kuadër parimor të zbatueshëm për të gjitha rastet e ngjashme, duke sqaruar kuptimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës dhe mekanizmave të përtëritjes periodike. Në vendimin nr. 84/2024 Gjykata duket/lë të kuptohet se ka sanksionuar rëndësinë e parimit të përtëritjes së rregullt dhe të pjesshme jo vetëm për atë rast konkret, por për të garantuar stabilitetin institucional dhe ruajtjen e ekuilibrit midis eksperiencës dhe gjeneratës së re të gjyqtarëve, duke lënë të kuptohet se ai vendim përbën një kornizë orientuese detyruese edhe për rastet e ardhshme. Në vendimin nr. 84/2024 Gjykata ka analizuar si parimin e pavarësisë së gjyqtarit në aspektin e patundshmërisë në detyrë, ashtu edhe atë të përtëritjes periodike të pjesshme të saj, duke arsyetuar se ky i fundit prevalon në raport me tjetrin.

5.3. Kuvendi vlerëson nevojën për plotësime, sqarime dhe interpretim përfundimtar të mekanizmit të përtëritjes së pjesshme, në kushtet kur emërimi i gjyqtarëve kushtetues është bërë në kapërcim të

afateve ligjore, si dhe për sa i përket saktësimit të rëndësisë që ka data e përfundimit të mandatit të gjyqtarit pararendës për fillimin e procedurës për deklarimin e mbarimit të mandatit në rastet kur anëtari i zgjedhur me vonesë është zgjedhur me mandat 9-vjeçar, kërkesë kjo edhe e Presidentit. Kuvendi ka shpallur hapjen e procedurës për plotësimin e vakancës për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit të dorëhequr në një mandat të plotë 9-vjeçar. Ndërkohë, referuar frymës së vendimit nr. 84/2024 të Gjykatës, i dalë pas shpalljes së kësaj vakance nga Kuvendi, në përllogaritjen e afatit të fillimit të mandatit prezumohet, megjithëse jo në mënyrë taksative, se duhet të ishte përfshirë edhe koha e vonesës në zgjedhjen e gjyqtarit të dorëhequr, pra periudha nga data 25.04.2016, që është data e mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës deri në datën 14.11.2019, që është data e kryerjes së betimit. Në këtë kontekst, vlerësohet si vlerë e shtuar konsiderimi nga Gjykata i nevojës ose jo për rishpalljen e kësaj vakance nga Kuvendi.

6. ***Subjekti i interesuar, Gjykata e Lartë,*** ka prapësuar si vijon:

i) Për aspektet procedurale të shqyrtimit të kërkesës:

6.1. Kolegji i Gjykatës, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak, ka kaluar për gjykim në seancë plenare një çështje të konsideruar si "mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve", edhe pse vendimi për deklarimin e mbarimit të mandatit nuk lidhet as formalisht dhe as substancialisht me një shkak të tillë kushtetues. Kërkesa e Presidentit ka objekt të qartë dhe ky lloj gjykimi është i natyrës deklarative, pa palë kundërshtare, në përfundim të të cilit jepet një vendim deklarativ, për sa kohë që në këtë proces nuk nevojitet kryerja e një hetimi të thelluar gjyqësor dhe kërkimi i ndonjë dokumentacioni, paraqitja e parashtrimeve nga organet kushtetuese, dëgjimi i ndonjë pale a subjekti të interesuar ose kryerja e një debati gjyqësor. Fakti që në kërkesë është cituar si bazë ligjore neni 131, shkronja "ç", i Kushtetutës dhe neni 54, pika 3, i Ligjit Organik të Gjykatës, përbën vetëm anën formale dhe jo atë substanciale për nisjen e këtij gjykimi. Nëse Presidenti ka vendosur formalisht në kërkesë edhe dy organet e tjera të emërtesës, por pa evidentuar asnjë mosmarrëveshje me to, kjo nuk është arsye thelbësore për të shndërruar çështjen në një proces adversial, me palë kundërshtare. Duke e kaluar çështjen

për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si një mosmarrëveshje kompetence dhe me palë kundërshtare, ky proces gjyqësor synohet të deformohet proceduralisht.

6.2. Kolegji i Gjykatës duhej të kishte proceduar duke i kërkuar Kryetarit të Gjykatës zbatimin e Kushtetutës dhe nisjen e procesit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit emërtesë e Presidentit ose, në të kundërt, të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës ushtrimin e kompetencës kushtetuese për deklarimin e mbarimit të këtij mandati. Kolegji i Gjykatës, duke mos e vlerësuar rëndësinë që paraqet kërkesa e Presidentit për t`u shprehur sa më parë për deklarimin e mbarimit të mandatit kushtetues, si dhe duke mos respektuar as vendimin e Gjykatës nr. 84/2024, e ka kryer shqyrtimin paraprak në kufijtë e afatit 3-mujor sipas nenit 47 të Ligjit Organik të Gjykatës. Është në autoritetin dhe kompetencën e trupës së plotë të Gjykatës për të korrigjuar këtë proces, duke e zgjidhur menjëherë dhe përfundimisht çështjen, në zbatim të jurisprudencës kushtetuese dhe të vendimit nr. 84/2024.

ii) Për themelin:

6.3. Për të garantuar përtëritjen e rregullt sipas nenit 125, pika 6, të Kushtetutës procesi duhet të kryhet në kohë nga tre organet e emërtesës, me qëllim shmangien e çdo krize a tensioni që mund të cenojë legjitimitetin dhe funksionimin normal të vet Gjykatës. Për shkak të rëndësisë së përtëritjes të rregullt e të vazhdueshme, në ndryshimet e vitit 2016 ligjvënësi kushtetues i kushtoi vëmendje të veçantë realizimit në kohë të procesit, duke parashikuar që disa gjyqtarë të mos zgjidheshin me mandat të plotë. Për këtë arsye, neni 179 i Kushtetutës sanksionon një skemë të qartë, e cila kufizon mandatin 9-vjeçar të gjyqtarëve që do të zëvendësonin dy gjyqtarët mandatet e të cilëve do të përfundonin në vitin 2017 dhe vitin 2020, ndërkohë që mandatet e shtatë gjyqtarëve të tjerë përfundonin rregullisht në vitet e përtëritjes, dy në vitin 2016, dy në vitin 2019 dhe tre në vitin 2022. Nëpërmjet mekanizmit të kufizimit të mandateve të dy gjyqtarëve që do të pasonin, ata që nuk ishin zgjedhur në vitin e rregullt të kryerjes së përtëritjes, realizohej përtëritja e Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën. Një zgjidhje e tillë konfirmoi përtëritjen e Gjykatës si një detyrim kushtetues që prevalon ndaj kohëzgjatjes 9-vjeçare të mandatit të gjyqtarit kushtetues.

6.4. Ky standard është qartësuar edhe në nenin 86, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, ku përcaktohet kryerja e përtëritjes për fazën kalimtare (deri në vitin 2022), ndërkohë që pas kësaj periudhe (çdo tre vjet 2025, 2028, 2031 e vijim), përtëritja kthehet në normalitet. Rregullimi kushtetues që përcakton mënyrën e mbarimit të mandatit (neni 127, pika 2, i Kushtetutës) dhe neni 9 i Ligjit Organik të Gjykatës që parashikon detyrimin e kësaj të fundit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit, imponojnë, gjithashtu, kryerjen e procedurës për emërimin e gjyqtarit të ri jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i deklarimit të mbarimit të mandatit, afate këto që nuk mund të shmangen nga asnjë organ kushtetues. Qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë në njoftimin e datës 11.12.2024 për hapjen e procedurës së aplikimit për gjyqtar kushtetues u konfirmua edhe në vendimin nr. 84/2024 të Gjykatës, sipas të cilit "*në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së Gjykatës, [ligjvënësi kushtetues] i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij të fundit*". Referuar këtij vendimi, mosveprimi në kohë i Gjykatës për të deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues emërtesë e Presidentit, që duhej të ishte kryer para datës 25.04.2025, nuk rezulton të ketë ndonjë justifikim, aq më pak kushtetues. Me qëllim vijimin nga Presidenti të procedurës për plotësimin e vakancës, me synim shmangien e çdo krize që delegjitimon autoritetin e Gjykatës dhe pengon organet e emërtesës në ushtrimin e pushtetit kushtetues, është në përgjegjësinë kushtetuese të trupës së plotë të Gjykatës për t`u shprehur "pa vonesë, me vendim përfundimtar dhe të detyrueshëm për zbatim" për kërkesën e Presidentit.

III
Procesi në gjykimin kushtetues

7. Gjykata vëren, fillimisht, se ndonëse në objektin e kërkesës kushtetuese Presidenti ka kërkuar deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, baza ligjore dhe shkaqet në përmbajtje të saj kanë të bëjnë me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash dhe, në funksion të kësaj, interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese të zbatueshme.

8. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se sipas nenit 48 të Ligjit Organik të Gjykatës kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda

objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të dhe se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 23.04.2025; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 20, datë 04.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*.

9. Bazuar në sa më lart, Gjykata evidenton se Presidenti ka parashtruar përpara saj dy kërkime (i) deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues dhe (ii) zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave, të cilat, për nga natyra dhe shkaqet e tyre, përbëjnë çështje të ndryshme kushtetuese. Për sa i përket kërkimit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, Gjykata vëren se në kuptim të nenit 127, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 9, pika 2, të Ligjit Organik të saj, për sa kohë që ai lloj gjykimi ka natyrë deklarative, zhvillohet pa palë ndërgjyqëse dhe nuk kërkon debat gjyqësor, nuk mund të shqyrtohet në kuadër të procesit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Për rrjedhojë, ky kërkim, për nga natyra e tij, do të shqyrtohet veçmas nga Gjykata.

10. Në këtë pikë Gjykata gjen me vend të ritheksojë qëndrimin e mbajtur prej saj në vendimin nr. 84/2024 (*shih paragrafin 2 të vendimit*), sipas të cilit, mbi bazën e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, që përfshin edhe parimin e luajalitetit kushtetues, në çdo rast kur një organ i emërtesës vlerëson se Kryetari i saj/Gjykata nuk ka ushtruar, brenda afatit ligjor, kompetencën e tij/saj për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues që i përket si emërtesë atij organi, ai duhet t`i drejtohet Gjykatës me shkrim, me qëllim ushtrimin e kësaj kompetence, kërkesë që duhet të përmbajë, në mbështetje të saj, edhe argumentet lidhur me faktet dhe dispozitat kushtetuese përkatëse. Në këtë rast Gjykata, pa vonesë, duhet të shprehet me vendim, i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim (*shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në vlerësimin e Gjykatës, një kërkesë e paraqitur nga një organ i emërtesës në një rast të tillë konsiderohet si rast përjashtimor, si një kërkesë kushtetuese për të filluar menjëherë procedura e deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, e cila aktivizon kompetencën e Gjykatës sipas pikës 2 të nenit 127 të Kushtetutës. Në kuptim të kësaj dispozite, në një rast të tillë Gjykata mblidhet pa vonesë edhe vetiu, pra edhe nëse nuk ka një kërkesë të Kryetarit të saj, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 9 të Ligjit Organik, dhe procedon sipas rregullave për deklarimin e mbarimit të mandatit. Qëllimi i këtij interpretimi nuk është shmangia e kompetencës së Kryetarit të saj sipas ligjit, por garantimi i ushtrimit të

kompetencës kushtetuese nga Gjykata për të shmangur interpretimin që secili subjekt i përfshirë në këtë procedurë, në ushtrim të kompetencës përkatëse kushtetuese/ligjore, u jep normave kushtetuese dhe ligjore.

12. Gjykata vëren, gjithashtu, se subjekti i interesuar Gjykata e Lartë është përfaqësuar nga kryetari i saj, i cili ka nënshkruar të gjitha aktet e paraqitura për qëllim të këtij gjykimi. Sipas nenit 125, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata e Lartë është një prej tre organeve të emërtesës që emërojnë/zgjedhin gjyqtarët kushtetues. Referuar parashikimeve të Ligjit Organik, i cili ka përcaktuar edhe procedurat që ndiqen nga Gjykata dhe organet e emërtesës për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, konkretisht sipas nenit 7/ç të tij, pas paraqitjes së raportit të arsyetuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (*KED*) dhe listës së kandidatëve, kryetari i Gjykatës së Lartë thërret Mbledhjen e Posaçme. Kjo e fundit përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e asaj gjykate dhe është e vlefshme nëse marrin pjesë jo më pak se tre të katërtat e tyre (*pika 3*). Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë voton për secilin nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës dhe nëse nuk arrihet shumica e kërkuar prej tri të pestat e votave të të pranishmëve në mbledhje, konsiderohet i zgjedhur kandidati i renditur i pari nga KED-ja (*pika 4*).

13. Lidhur me aspektin procedural të përfaqësimit të këtij subjekti të interesuar në gjykimin kushtetues, Gjykata, në kuptim të parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore, vlerëson të theksojë, fillimisht, se Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve nuk është një organ i veçantë, me personalitet të ndarë nga Gjykata e Lartë, por një nga format e organizimit të atij institucioni. Në këtë pikëpamje, kompetenca e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 125, pika 1, të Kushtetutës, për emërimin e gjyqtarit kushtetues ushtrohet në formë administrative përmes Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve. Për sa i përket kryetarit të Gjykatës së Lartë, ai, sipas nenit 26 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 98/2016*) dhe nenit 51 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e asaj gjykate sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në ligj. Ai ushtron kompetencat e përcaktuara shprehimisht në nenin 37 të ligjit nr. 98/2016, mes të cilave edhe ajo e përfaqësimit të Gjykatës së Lartë në marrëdhënie me të tretët. Gjykata vëren, gjithashtu, se një kompetencë e tillë i njihet edhe organit tjetër të emërtesës, me natyrë kolegjiale, Kuvendit (neni 76, pika 1, i Kushtetutës), ndërkohë që legjitimiteti formal i përfaqësimit të këtij organi në gjykimin kushtetues

nëpërmjet kryetarit të tij nuk është vënë asnjëherë në dyshim nga Gjykata, edhe në ato raste kur objekt gjykimi kanë qenë aktet e llojit "vendim" të miratuara nga Kuvendi në seancë plenare, sipas rregullave të tij të procedurës, siç janë, për shembull, ato për nisjen e procedurës së shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*), për shkarkimin e Presidentit (*shih vendimin nr. 1, datë 16.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), për mosngritjen e komisioneve hetimore, çka ka përbërë shkak për lindjen e një konflikti kompetencash (*shih vendimin nr. 38, datë 12.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*) ose për dërgimin në Gjykatë të çështjes së pajtueshmërisë me mandatin e deputetit (*shih vendimin nr. 32, datë 03.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*) etj.

14. Për rrjedhojë, për sa kohë që kryetari i Gjykatës së Lartë ka vepruar edhe në këtë rast në ushtrimin e kompetencave të tij si përfaqësues i organit të emërtesës palë në gjykimin kushtetues, Gjykata nuk ka ndonjë arsye që të vërë në dyshim vullnetin e formalizuar në aktet e paraqitura prej tij për qëllime të këtij gjykimi.[1]

IV
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

15. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe të kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas

[1] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi mbajtën qëndrimin se kryetari i Gjykatës së Lartë nuk legjitimohej në këtë gjykim kushtetues, për sa kohë që ai nuk ka paraqitur aktin e përfaqësimit përmes të cilit të provohej se qëndrimi i materializuar në aktet e nënshkruara prej tij përfaqëson qëndrimin e Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Edhe pse formalisht aktet e Gjykatës së Lartë nënshkruhen administrativisht nga kryetari i saj si përfaqësues në marrëdhënie me të tretët, nga pikëpamja materiale vullneti i shprehur në këto akte në rastin konkret, duke pasur parasysh edhe natyrën e çështjes kushtetuese, nga njëra anë, ashtu edhe natyrën e pretendimeve që janë parashtruar në këto akte, të cilat kanë të bëjnë si me procesin kushtetues ashtu edhe me interpretimin e dispozitave kushtetuese, nuk provohet se përfaqëson në të vertetë vetë vullnetin e atyre gjyqtarëve që përbëjnë Mbledhjen e Posaçme të gjyqtarëve, si organi kolegjial që ushtron kompetencën kushtetuese të Gjykatës së Lartë për të zgjedhur gjyqtarin kushtetues. Për rrjedhojë, për sa kohë që Mbledhja e Posaçme e Gjykatës së Lartë, si organi që është thirrur nga Gjykata në gjykimin kushtetues, nuk ka legjitimuar kryetarin e asaj gjykate si për të marrë pjesë në gjykim, ashtu edhe për qasjen që duhej të mbahej në çështjen konkrete, ai nuk duhej të ishte legjitimuar, duke mos u marrë parasysh pretendimet e parashtruara në këtë gjykim.

të cilit: "*1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.*". Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 i saj parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se referuar shkaqeve të kërkesës kushtetuese të Presidentit, përmes së cilës është vënë në lëvizje ky gjykim kushtetues, ai ka pretenduar, në thelb, se në cilësinë e njërit prej tre organeve të emërtesës për zgjedhjen/emërimin e gjyqtarëve kushtetues është vënë në pamundësi/vështirësi të ushtrojë kompetencën kushtetuese nga mosmarrja e vendimit nga Gjykata për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit emërtesë e tij, duke qenë ushtrimi i kompetencës kushtetuese i kushtëzuar nga ajo vendimmarrje. Sipas tij, situata kalimtare për të cilën shprehet Gjykata në vendimin nr. 84/2024 nuk vlen vetëm për atë rast, por për të gjithë dispozitën e nenit 179 të Kushtetutës, qëllimi i së cilës ka qenë, në mënyrë të veçantë, të sigurojë përtëritjen e pjesshme të trupës në intervalet kohore 2025, 2028 dhe 2031. Presidenti ka pretenduar se ndonëse parimi i luajalitetit kushtetues do të kërkonte nga Presidenti dhe Kuvendi që të respektonin prerogativën e Kryetarit të Gjykatës për të vënë në lëvizje Gjykatën për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, këto dy organe nuk do të kishin nevojë të viheshin në lëvizje pas datës 25.01.2025 nëse në vendimin nr. 84/2024 nuk do të ishte lidhur mbarimi i atij mandati konkret me nevojën për zbatimin e parimit të përtëritjes dhe data e mbarimit të atij mandati me atë të mbarimit të mandatit paraardhës.

17. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore). Veç këtyre, në mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve mund të përfshihen edhe mosmarrëveshje të tjera, siç janë ato që mund të lindin midis organeve ose subjekteve që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të shprehur në njërin apo tjetrin pushtet, siç janë

Presidenti, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria ose organe të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka pohuar se mosmarrëveshja e kompetencave mund të shtrohet në disa raste: kur objekt i mosmarrëveshjes është ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij; kur konflikti i mirëfilltë i kompetencave lidhet me faktin kur një ose disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër (*shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 26, datë 25.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*); kur një organ nuk e kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre (*shih vendimet nr. 48, datë 08.11.2011; nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në mënyrë që të arrihet në një përfundim lidhur me ekzistencën ose jo të mosmarrëveshjes së pretenduar, Gjykata analizon se midis cilave organe ka lindur konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç'mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç'mënyrë një organ e ushtron pa të drejtë një kompetencë të një organi tjetër (*shih vendimet nr. 26, datë 25.05.2021; nr. 54, datë 05.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se në dukje ka lindur një mosmarrëveshje kompetencash midis subjekteve kushtetuese, Presidentit dhe Gjykatës, për shkak të mënyrës së ndryshme të të kuptuarit të normës kushtetuese, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Presidenti ka paraqitur kërkesën për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave në kushtet kur Gjykata ende nuk ka shpallur vakancën për mandatin që i përket atij si organ emërtese. Interpretimi i bërë nga Gjykata në vendimin nr. 84/2024, mënyra e zbatimit të të cilit, për sa kohë lidhet me garantimin e përtëritjes së rregullt dhe veprimin e organeve të emërtesës në përgjithësi, nuk vlen vetëm për atë rast konkret, por edhe për dy mandatet e tjera që i përkasin si organ emërtese Presidentit dhe Kuvendit, ndaj duket se e detyron Presidentin që të veprojë për emërimin e gjyqtarit të ri, me qëllim garantimin e përtëritjes së pjesshme të Gjykatës në vitin 2025, pavarësisht qëndrimit të këtij organi emërtese për interpretimin dhe zbatimin e normave kushtetuese në fjalë.

20. Interpretimi i ndryshëm i dispozitave kushtetuese në fakt rezulton të jetë evidentuar edhe nga Kuvendi, i cili, edhe pse nuk është subjekt në mosmarrëveshjen konkrete kushtetuese, në cilësinë e subjektit të interesuar në këtë gjykim kushtetues ka vlerësuar nevojën për interpretimin përfundimtar të mekanizmit të përtëritjes së pjesshme të Gjykatës, në

kushtet kur vetë ky organ ka bërë tashmë një interpretim të ndryshëm për kohëzgjatjen e mandatit plotësues të shpallur prej tij, duke konsideruar se ai mbaron në datën 14.11.2028 dhe jo në kohën që përkon, sipas vendimit nr. 84/2024, me përtëritjen e parë të pjesshme të Gjykatës në vitin 2025. Për rrjedhojë, dy nga organet e emërtesës së gjyqtarëve kushtetues, në kuptim të interpretimit të bërë në vendimin nr. 84/2024, kanë vënë në diskutim çështjen e ushtrimit të kompetencës së tyre kushtetuese për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj të Gjykatës të lidhur me garantimin e parimit të përtëritjes së përbërjes së saj çdo tre vjet me një të tretën.

21. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se konflikti i kompetencave midis organeve të përfshira në procedurën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues është konkret e *prima facie* ka natyrë kushtetuese. Ky konflikt në dukje është krijuar nga interpretimi i ndryshëm i kohëzgjatjes së mandateve të gjyqtarëve kushtetues, por dhe në thelb ka ardhur për shkak të zbatimit dhe konkurrimit të dy parimeve kushtetuese, ai i përtëritjes periodike të pjesshme të Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën e anëtarëve të saj dhe ai i kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues. Për rrjedhojë, në referim të nenit 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se ka juridiksion për të marrë në shqyrtim kërkesën e Presidentit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, sipas objektit.

22. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është funksioni më i rëndësishëm i saj, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse interpretimi i dispozitave kushtetuese nuk përbën *per se* mosmarrëveshje kushtetuese (*shih vendimin nr. 85, datë 24.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është funksioni më i rëndësishëm i Gjykatës, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim. Në këto raste Gjykata synon t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës*

Kushtetuese). Nëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse (*shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Bazuar në këto standarde, për të zgjidhur mosmarrëveshjen kushtetuese konkrete midis Presidentit dhe Gjykatës bëhet i nevojshëm interpretimi përfundimtar i dispozitave kushtetuese lidhur me ndërveprimin e parimeve kushtetuese të përtëritjes periodike të pjesshme çdo tre vjet me një të tretën e saj me atë të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues.

24. Gjykata vëren, gjithashtu, se Presidenti legjitimohet t`i drejtohet asaj për zgjidhjen e çështjes së konfliktit të kompetencave për sa kohë ka plotësuar kriteret kumulative sipas neneve 54-56 të Ligjit Organik, aspekte këto të gjykimit kushtetues për të cilat nuk pati as ndonjë diskutim nga palët në këtë gjykim.

B. Për themelin e mosmarrëveshjes

25. *Presidenti* ka parashtruar se konflikti i kompetencave, nga buron edhe e drejta e tij si organ emërtese për të vënë në lëvizje Gjykatën, ka lidhje me faktin se ai është i kushtëzuar në ushtrimin e kompetencës së tij nga vendimmarrja e Gjykatës për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues për sa kohë mosmarrja e këtij vendimi e pengon Presidentin, si organ emërtese, në ushtrimin e kompetencës së tij kushtetuese. Nga ana tjetër, nëse Presidenti do të kalonte në heshtje këto rrethana dhe pasojat që sjell vendimi nr. 84/2024 për të gjitha mandatet e tjera, që për shkak të emërimit me vonesë kapërcejnë afatet për përtëritjen e pjesshme, Gjykata do të vihej në pamundësi për të vendosur deklarimin e mbarimit të mandateve dhe për të siguruar përtëritjen e pjesshme që, sipas atij vendimi, e bën edhe organin e emërtesës përgjegjës për shkeljen e Kushtetutës nëpërmjet mosveprimit. Sipas tij, situata kalimtare për të cilën shprehet vendimi nr. 84/2024 vlen për të gjithë dispozitën e nenit 179 të Kushtetutës, qëllimi i së cilës ka qenë të sigurojë, në mënyrë të veçantë, përtëritjen e pjesshme të trupës në intervalet kohore 2025, 2028 dhe 2031. Presidenti ka pretenduar se Gjykata duhet të sqarojë në mënyrë të plotë dhe përfundimtare atë çfarë ka lënë pa sqaruar edhe për dy organet e tjera të emërtesës në vendimin nr. 84/2024 për zbatimin e mekanizmit të përtëritjes së pjesshme, në kushtet kur emërimi i gjyqtarëve është bërë në tërësi në kapërcim të afateve ligjore,

si dhe për saktësimin e rëndësisë që ka data e përfundimit të mandatit të gjyqtarit pararendës për fillimin e procedurës për deklarimin e mbarimit të mandatit në të gjitha rastet kur gjyqtari në vonesë është zgjedhur me mandat të plotë 9-vjeçar.

26. *Subjekti i interesuar, Kuvendi*, ka parashtruar se mbetet i rëndësishëm interpretimi i zbatimit të neneve 125, pikat 3 dhe 6, 129 dhe 179, pika 3, të Kushtetutës dhe sqarimi në mënyrë të plotë e përfundimtare i mekanizmit të përtëritjes së pjesshme të Gjykatës. Sipas tij, vendimi nr. 84/2024 i Gjykatës përfaqëson vendimin e parë interpretues të këtij mekanizmi pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe lë të kuptohet se rëndësia e parimit të përtëritjes së rregullt dhe të pjesshme është sanksionuar jo vetëm për rastin konkret, por si një kornizë orientuese detyruese edhe për të ardhmen. Në këtë situatë, referuar shpalljes së Kuvendit për plotësimin e vakancës së krijuar pas dorëheqjes së gjyqtarit emërtesë e tij, e llogaritur si një mandat i plotë 9-vjeçar, i cili ka filluar nga data e betimit, si dhe referuar frymës së vendimit nr. 84/2024, që ka dalë pas shpalljes së kësaj vakance, në përllogaritjen e afatit të fillimit të mandatit prezumohet, megjithëse jo në mënyrë taksative, se duhet të ishte përfshirë edhe koha e vonesës në zgjedhjen e gjyqtarit, që është periudha nga data 25.04.2016 (kur ka mbaruar mandatin gjyqtari paraardhës) deri në datën 14.11.2019, kur është kryer betimi. Në këtë kontekst, sipas Kuvendit, Gjykata duhet të konsiderojë edhe nëse është ose jo nevoja për rishpalljen e kësaj vakance.

27. Kurse *subjekti i interesuar, Gjykata e Lartë*, ka parashtruar se për garantimin e përtëritjes së rregullt të Gjykatës procesi është i detyrueshëm të kryhet në kohë nga tre organet e emërtesës, me qëllim shmangien e çdo krize a tensioni që mund të cenojë legjitimitetin dhe funksionimin normal të saj. Sipas tij, skema për përtëritjen kalimtare në nenin 179, pika 3, të Kushtetutës, duke u kufizuar mandati 9-vjeçar i dy gjyqtarëve që do të pasonin ata që nuk ishin zgjedhur në vitin e rregullt të kryerjes së përtëritjes, ndërsa mandati i gjyqtarëve të tjerë përfundonte rregullisht në vitet e përtëritjes, dy në vitin 2016, dy në vitin 2019 dhe tre në vitin 2022, konfirmoi përtëritjen e Gjykatës si një detyrim kushtetues që prevalon ndaj kohëzgjatjes së mandatit, e qartësuar edhe në nenin 86, pika 4, të Ligjit Organik. Në vendimin nr. 84/2024 është vlerësuar se në ekuilibrin mes parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së Gjykatës, i është kushtuar vëmendje e veçantë këtij të fundit, ndaj mosveprimi i Gjykatës për të deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtarit emërtesë e Presidentit, që duhej të ishte kryer para datës 25.04.2025, nuk ka justifikim,

aq më pak kushtetues. Sipas këtij subjekti, me qëllim vijimin e procedurës për plotësimin e vakancës së Presidentit, për shmangien e çdo krize që delegjitimon autoritetin e Gjykatës dhe pengon organet e emërtesës në ushtrimin e kompetencës kushtetuese, është në përgjegjësinë kushtetuese të Gjykatës për t`u shprehur pa vonesë me vendim përfundimtar dhe të detyrueshëm për zbatim.

28. Sipas nenit 125, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata përbëhet nga 9 anëtarë, tre nga të cilët emërohen nga Presidenti, tre zgjidhen nga Kuvendi dhe tre nga Gjykata e Lartë. Pika 3 e këtij neni parashikon se gjyqtarët e Gjykatës qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi dhe sipas nenit 129 të Kushtetutës, gjyqtari fillon detyrën pasi bën betimin përpara Presidentit. Pikat 6 dhe 7 të nenit 125 të Kushtetutës sanksionojnë se përbërja e Gjykatës përtërihet çdo tre vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj dhe gjyqtari vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 127, pika 1, shkronjat "c", "ç", "d" dhe "dh", të Kushtetutës. Sipas shkronjës "b" të këtij të fundit, një nga rastet e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues është kur ai përfundon mandatin 9-vjeçar.

29. Ndërkohë, sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri që do të zëvendësojë gjyqtarin të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028, kurse gjyqtarët e tjerë emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit.

30. Gjykata, siç ka theksuar edhe në vendimin e saj nr. 84/2024, çmon se për mandatet e gjyqtarëve kushtetues janë të zbatueshme dy parime kushtetuese, ai i përtëritjes së pjesshme të Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën e saj, sipas pikës 6 të nenit 125 të Kushtetutës dhe ai i kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues, sipas pikës 3 të nenit 125 të lidhur me nenin 129 të Kushtetutës, çka bën të nevojshëm interpretimin përfundimtar të Kushtetutës lidhur me ndërveprimin e këtyre parimeve.

31. Në vlerësimin e Gjykatës, çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, pasi çdo dispozitë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me dispozitat e tjera dhe së bashku ato formojnë një tërësi normash të harmonizuara (*shih vendimet nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 2, datë 19.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi

i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes tyre (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që ajo nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete *(shih vendimet nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 8, datë 08.03.2013 të Gjykatës Kushtetuese).*

32. Gjykata vëren se sipas nenit 125, pika 3, të Kushtetutës gjyqtarët kushtetues qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, detyrë që fillon, sipas nenit 129 të Kushtetutës, pasi gjyqtari bën betimin përpara Presidentit. Për sa i përket mbarimit të mandatit kushtetues, sipas nenit 127, pika 1, shkronja "b", të Kushtetutës ai mbaron kur përfundon mandati 9-vjeçar. Lidhur me përllogaritjen e datës së saktë të mbarimit të këtij mandati, sipas parashikimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit Organik të Gjykatës, ajo përkon me datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë të bërjes së betimit. Gjykata ka theksuar se dispozitat kushtetuese që parashikojnë fillimin dhe mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues janë të lidhura me pavarësinë e Gjykatës dhe të gjyqtarëve të saj. Me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është "i pavarur", ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Nga ana tjetër, Kushtetuta në nenin 125, pika 6, ka përcaktuar se përbërja e Gjykatës përtërihet çdo tre vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Gjykata ka theksuar se përtëritja periodike ka më shumë avantazhe se përtëritja tërësore, sepse në këtë mënyrë garantohet vazhdimësia e jurisprudencës dhe realizohet kombinimi

i përvojës së Gjykatës (e paraqitur si shuma e koncepteve dhe qëndrimeve që janë bërë të qëndrueshme gjatë vendimmarrjes së një trupe të caktuar gjyqësore) me atë vetjake të gjyqtarëve të rinj, çka do ta bënte më të vështirë vazhdimësinë e vendimmarrjes së Gjykatës në rast se mandati i të gjithë gjyqtarëve do të përfundonte në të njëjtën kohë. Ky rregullim kushtetues përbën një parim organizativ, i cili bazohet pikërisht në veçoritë specifike të procesit kushtetues që, përveç njohurive të gjyqtarëve, kërkon dhe përvojën e duhur dhe ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve me stazh në detyrë, çka bën të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme dhe të specializuar në gjykimin kushtetues, e cila nuk mund të përftohet askund tjetër. Kjo bazë njohurish tekniko-juridike në fushën e gjykimit kushtetues, duke qenë se ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes, konsiderohet nga Gjykata si një vlerë e mbrojtur nga Kushtetuta. Përtëritja e Gjykatës çdo tre vjet, me një të tretën e gjyqtarëve, është mjet për të garantuar pavarësinë e saj, sepse mandati i gjyqtarëve nuk përplaset me kohëzgjatjen e mandatit presidencial dhe atij parlamentar, por i tejkalon ato (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata, në aspektin krahasimor, duke iu referuar vendeve që kanë të njëjtën formulë kushtetuese për përtëritjen periodike të pjesshme të Gjykatës, vëren se Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë është vënë në lëvizje nga Presidenti i Republikës për interpretimin e dispozitave kushtetuese lidhur me kohëzgjatjen e mandatit, fillimin dhe mbarimin e tij, kur një gjyqtar kushtetues emërohet/zgjidhet dhe fillon detyrën pas përtëritjes së përbërjes së saj. Ajo gjykatë ka vlerësuar se skema për përtëritjen e përbërjes së saj, sipas Kushtetutës, parashikon mundësinë që një gjyqtar kushtetues të ketë një mandat më të shkurtër se 9 vjet, eventualitet që ka një bazë kushtetuese dhe është i lejueshëm sipas vetë ligjvënësit kushtetues, i cili ka krijuar konceptin e përbërjes së gjykatës, formimit dhe përtëritjes së saj. Në analizë të parimit të kuotës së secilit organ emërtese, si dhe të kohëzgjatjes së mandatit 9-vjeçar, ajo gjykatë ka vlerësuar se përtëritja periodike e pjesshme është një detyrim kushtetues dhe asnjë nga organet që marrin pjesë në konstituimin e gjykatës nuk mund të privohet nga e drejta ose të çlirohet nga detyra e pjesëmarrjes në këtë përtëritje. Për të siguruar realizimin e kësaj skeme, ligjvënësi kushtetues ka kufizuar diskrecionin e organeve të emërtesës, duke përcaktuar periodicitetin e përtëritjes me të cilin lidhet ushtrimi i autoritetit kushtetues të këtyre organeve, gjithmonë çdo tre vjet. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, diskrecioni i organeve të

emërtesës nuk mund të ushtrohet në atë mënyrë që do ta çonte atë përtej afateve kohore kushtetuese të vendosura nga formula kushtetuese në favor të përtëritjes periodike (*shih vendimin nr. 1, datë 11.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë*).

35. Mbi këtë qasje, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, po në të njëjtin vendim, ka vlerësuar se interpretimi i të gjitha dispozitave të tjera i nënshtrohet parimit të përtëritjes së pjesshme, ashtu sikundër edhe kohëzgjatja e vet mandatit të një gjyqtari kushtetues të zgjedhur pas përtëritjes së pjesshme. Skema e përtëritjes së përbërjes së gjykatës është një zgjidhje kushtetuese që krijon një detyrim për organin e emërtesës për të ushtruar kompetencën e tij kushtetuese në kohën e duhur. Qasja interpretuese që i jep përparësi parimit të përtëritjes së pjesshme përshtatet brenda mekanizmit mbrojtës të respektimit të rendit kushtetues demokratik, i zbatueshëm në situata të jashtëzakonshme të mosveprimit nga ana e ndonjërit prej organeve kushtetuese që ka mundësinë të shkelë këtë kërkesë themelore (të përtëritjes së pjesshme periodike) të parashikuar në Kushtetutë. Sipas saj, ky lloj kuptimi nuk e shfuqizon afatin 9-vjeçar të ushtrimit të detyrës, por e lidh zbatimin e tij si një proces gjithëpërfshirës me periudhat e përtëritjes së gjykatës. Interpretimi i dispozitave kushtetuese bazohet në kufijtë kushtetues të mandatit të përcaktuar kushtetutshmërisht, ku fillimi dhe mbarimi përcaktohen në momentet përkatëse të përtëritjes së përbërjes së gjykatës. Në përfundim, ajo gjykatë interpretoi dispozitën kushtetuese se një gjyqtar kushtetues i emëruar/zgjedhur pas përtëritjes së përbërjes së saj ushtron kompetencat vetëm për pjesën e mbetur të mandatit nga momenti i përcaktuar kushtetues i kësaj përtëritjeje (*shih vendimin nr. 1, datë 11.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë*).

36. Në vijim, pas dhënies së atij vendimi, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë është vënë sërish në lëvizje nga Presidenti i Republikës dhe nga një grup deputetësh për kundërshtimin e vendimeve të Asamblesë Kombëtare të datës 19.01.2024 për zgjedhjen e dy gjyqtarëve të rinj kushtetues për një mandat 9-vjeçar. Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, në përputhje me vendimin interpretues të saj nr. 1 të vitit 2024, vendosi të deklarojë jokushtetuese vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj kushtetues në pjesën që ato përcaktojnë mandatin e tyre 9-vjeçar (*shih vendimin datë 09.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë*).

37. Duke iu kthyer rastit konkret, për sa i përket zbatimit të skemës që ka synuar garantimin e parimit kushtetues të përtëritjes së pjesshme, parim i cili ka funksionuar që në kohën e ngritjes së Gjykatës, ajo konstaton se

ai nuk ka arritur të respektohet rregullisht, shkak për të cilin Gjykata është vënë disa herë në lëvizje, si për interpretimin e rregullit të përtëritjes së pjesshme sipas dispozitave të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" (*shih vendimin nr. 4, datë 02.06.1995 të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe për përcaktimin e raportit që duhet të ekzistojë mes dy parimeve që sanksionon neni 125 i Kushtetutës, parimit të përtëritjes periodike e të pjesshme të përbërjes dhe parimit të garantimit të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues (*shih vendimet nr. 41, datë 19.07.2012; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se është në kompetencë të ligjvënësit kushtetues që të gjejë dhe të zbatojë mekanizmin e përshtatshëm për të respektuar parimin kushtetues të përtëritjes së përbërjes së saj çdo tre vjet në një të tretën (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, pavarësisht këtij rekomandimi të Gjykatës, deri në vitin 2016 kushtetutëbërësi nuk ka ndërhyrë për gjetjen e atij mekanizmi të përshtatshëm që do të garantonte respektimin e nenit 125, pika 3, të Kushtetutës, sipas formulimit të tij në atë kohë.

38. Në vitin 2016 u miratua paketa e reformës në drejtësi, ndryshime kushtetuese që prekën, mes të tjerash, edhe formulën e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, ndërkohë që mbetën të pandryshuara parashikimet për kohëzgjatjen 9-vjeçare të mandatit të gjyqtarit kushtetues dhe për përtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet, me një të tretën e saj. Procesit të miratimit të kësaj pakete i parapriu një proces analitik i gjendjes aktuale të sistemit të drejtësisë, ku u evidentuan problematikat në aspektet e organizimit, funksionimit dhe administrimit të tij. Pjesë e analizës ishin edhe dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit Organik të Gjykatës, me qëllim identifikimin e problemeve që janë hasur në praktikë nga zbatimi i tij në të gjitha aspektet e organizimit dhe funksionimit të kësaj Gjykate. Ndër të tjera, u konstatua problematika e zbatimit të parimit të përtëritjes së pjesshme (rotacioni) dhe e procedurës për realizimin e saj, mekanizëm kushtetues që ishte bërë i pazbatueshëm në praktikë; nuk rezultonte eficient procesi i emërimit të gjyqtarëve kushtetues; gjyqtarët qëndronin në detyrë për një kohë të gjatë, tej mandatit kushtetues, për shkak të mosplotësimit brenda afateve të arsyeshme të vendeve vakante; Ligji Organik nuk parashikonte afate të përcaktuara kohore për procesin e emërimit, etj. Sipas dokumentit analitik, edhe pse Gjykata lidhur me pengesën për kryerjen e rotacionit është shprehur në vendimin e saj nr. 24, datë 09.06.2011 që në dispozitën kushtetuese përkatëse të rregullohet mekanizmi nga ana e ligjvënësit, ky

vendim nuk është zbatuar (*shih "Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, faqet 28 dhe 44*). Po kështu, është evidentuar se vonesat në përtëritjen e Gjykatës dhe në plotësimin e vakancave të saj kanë sjellë deformim të Kushtetutës për sa i takon tejzgjatjes së mandatit të gjyqtarëve kushtetues (*po aty, faqe 32*).

39. Në kohën e hartimit dhe miratimit të ndryshimeve kushtetuese, pra deri në datën 22.07.2016, situata e mandateve kushtetuese të gjyqtarëve në detyrë paraqitej si vijon: dy gjyqtarë (V.K. dhe S.B.) kishin mbaruar mandatin 9-vjeçar në datën 25.04.2016, por vijonin të qëndronin në detyrë në pritje të zgjedhjes së pasardhësit të tyre; gjyqtarja V.T. mbaronte mandatin 9-vjeçar në datën 10.03.2017; dy gjyqtarë (B.D. dhe A.Xh.) mbaronin mandatin 9-vjeçar në datën 25.05.2019; gjyqtari F.H. mbaronte mandatin 9-vjeçar në datën 04.07.2020; tre gjyqtarët e tjerë (B.I., G.D. dhe F.L.), mbaronin mandatin e tyre 9-vjeçar në datat 08.04.2022 (dy të parët) dhe 02.05.2022 (i treti).

40. Referuar momentit kohor të zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues në detyrë në atë kohë, si dhe në kuptim të përmbajtjes së pikës 3 të nenit 125 të Kushtetutës që parashikon kohëzgjatjen 9-vjeçare të qëndrimit në detyrë, konstatohet se përtëritja periodike e pjesshme e Gjykatës, çdo tre vjet me një të tretën e anëtarëve, nuk mund të realizohej në përputhje me parashikimin e pikës 6 të nenit 125 të Kushtetutës, për shkak se dy mandate mbaronin në vitin 2016 dhe një në vitin 2017, dy mandate të tjera mbaronin në vitin 2019 dhe një në vitin 2020 kurse tre mandatet e tjera në vitin 2022. Për rrjedhojë, në përtëritjen e parë dhe të dytë të Gjykatës që do të realizohej pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, dy mandate (një për secilën prej tyre) përfundonin në vitin pasardhës, duke mos u garantuar kështu përtëritja e Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën, gjë që diktoi nevojën e ndërhyrjes së ligjvënësit kushtetues.

41. Për sa më sipër, për këtë qëllim, në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 ligjvënësi kushtetues ka miratuar në dispozitën kalimtare, nenin 179, pikën 3, që parashikon: "*Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri, që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit*.".

42. Këto parashikime u reflektuan edhe në Ligjin Organik të Gjykatës dhe

konkretisht, sipas nenit 86, pika 4, të tij: "*Përtëritja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese deri në vitin 2022 do të bëhet sipas skemës së parashikuar më poshtë: a) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2016, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi. b) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2025. c) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2019, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi. ç) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2028. d) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2022, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë.*".

43. Gjykata rithekson se qëllimi i miratimit të kësaj dispozite, referuar materialeve në lidhje me reformën kushtetuese në drejtësi, por edhe opinionit të Komisionit të Venecias për emërimin e anëtarëve të Gjykatës (*shih opinionin CDL-AD (2020)010, datë 19.06.2020*), ka qenë gjetja e një mekanizmi për të mundësuar zbatimin e parimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës, por edhe për të bërë funksionale kompetencën e organeve të emërtesës sipas modelit të ri të emërimit/zgjedhjes së gjyqtarëve, duke parashikuar mënyrën e zbatimit të këtij parimi në të ardhmen në raport me situatën faktike të përbërjes së Gjykatës në atë moment për sa i përket mbarimit të mandateve të gjyqtarëve të saj, situatë e cila, për shkak të një konflikti të organeve të mëparshme të emërtesës (President/Kuvend), kishte çuar në mosrespektimin e këtij parimi kushtetues (*shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në vitin 2024 Gjykata, për deklarimin e mbarimit të mandatit kushtetues që sipas dispozitës kalimtare mbaronte në vitin 2025, u përball për herë të parë edhe me përmbajtjen dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese pas reformës kushtetuese të vitit 2016, konkretisht të pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës. Gjykata vlerësoi se, me qëllim përputhjen e kësaj situate faktike me rregullin kushtetues të përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës, ligjvënësi kushtetues dhe, në vijim, ligjvënësi, përmes asaj dispozite kushtetuese kalimtare dhe rregullimeve të bëra në Ligjin Organik, duket se e kanë përcaktuar kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit zëvendësues të lidhur jo thjesht me vitin 2025, por edhe

me momentin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës. Në atë rast konkret, në situatën që Kushtetuta ka përcaktuar vetëm vitin 2025, Gjykata u ndal në përcaktimin e datës së saktë (ditës dhe muajit) të mbarimit të atij mandati, duke vlerësuar se qëndrimi në detyrë dhe kohëzgjatja e mandatit ka të bëjë me kuptimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, të normave të tjera kushtetuese, për aq sa ato lidhen me të, të normave të Ligjit Organik të Gjykatës, si dhe të akteve të procedurës së zgjedhjes së gjyqtarit në fjalë. Gjykata, në analizë edhe të parimeve kushtetuese të garancisë së kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit dhe të përtëritjes së pjesshme të saj, referuar përmbajtjes së nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, si norma e zbatueshme në atë rast konkret, vlerësoi se momenti i mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës duket se ka lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit që e ka zëvendësuar atë, në veçanti për sa i përket momentit të mbarimit të kësaj kohëzgjatjeje. Ligjvënësi kushtetues dhe, në vijim, ligjvënësi, duket se e kanë përcaktuar kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit zëvendësues të lidhur jo thjesht me vitin 2025, por edhe me momentin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës (*shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Për sa më sipër, Gjykata çmon se edhe në rastin konkret çështja që vihet në diskutim përpara saj është pikërisht garantimi i përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe në këtë drejtim, nëse dispozitat kalimtare janë të zbatueshme ndaj të gjithë gjyqtarëve që janë duke ushtruar detyrën apo vetëm ndaj dy gjyqtarëve të cilët, sipas pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës, kanë të përcaktuar kohëzgjatjen e mandatit të tyre përkatësisht deri në vitin 2025 dhe vitin 2028.

46. Gjykata thekson se dispozitat kushtetuese dhe ligjore me natyrë kalimtare kanë rregulluar momentin e kalimit nga një sistem në një tjetër, duke parashikuar mënyrën e zbatimit të dispozitave të reja për situatat faktike ose marrëdhëniet ekzistuese. Në situatën faktike si më sipër (*shih paragrafët 37-38 të vendimit*), të konstatuar në momentin e miratimit të paketës ligjore të vitit 2016, vit deri në të cilin qartazi skema e përtëritjes së pjesshme të Gjykatës kishte dështuar të funksionontе, sikundër në përmbushje të detyrimit të përcaktuar për ligjvënësin kushtetues për të gjetur mekanizmin e vlefshëm dhe të përshtatshëm për respektimin e parashikimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), në nenin 179, pika 3, të

Kushtetutës u parashikua në mënyrë të shprehur koha e qëndrimit në detyrë e dy gjyqtarëve kushtetues, atyre që do të zëvendësonin dy gjyqtarët të cilëve u mbaronte mandati në vitet 2017 dhe 2020.

47. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se për sa kohë ligjvënësi kushtetues në përmbushje të jurisprudencës kushtetuese u aktivizua dhe përcaktoi mekanizmin e vlefshëm dhe të përshtatshëm për respektimin e parashikimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme të saj, një interpretim i ndryshëm i nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, qoftë edhe duke kërkuar përsëri ndërhyrjen e ligjvënësit kushtetues, do të binte ndesh me parimin e luajalitetit kushtetues dhe atij të koherencës së jurisprudencës së Gjykatës, të cilave i nënshtrohet edhe vetë Gjykata. Nga ana tjetër, një interpretim i ndryshëm i Gjykatës, pa kërkuar ndërhyrjen e ligjvënësit kushtetues, në zbatim të jurisprudencës së sipërcituar, nuk është i mundur pa u testuar më parë mekanizmi i gjetur nga ligjvënësi kushtetues. Prandaj, duke marrë parasysh rrethanat mbizotëruese në bazë të të cilave u miratuan dispozitat e reja kushtetuese, është e nevojshme fillimisht të sigurohet një interpretim konstruktiv dhe funksional i parimit të përtëritjes së Gjykatës. Nën këtë optikë, Gjykata thekson se organet e emërtesës, në zbatim të parimit të luajalitetit kushtetues, i cili shpreh në thelb respektin e ndërsjellë të organeve kushtetuese ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre, duhet ta kuptojnë dhe interpretojnë parimin e përtëritjes së Gjykatës në të njëjtën mënyrë, duke ndjekur e zbatuar të njëjtat rregulla.

48. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se regjimi tranzitor që parashikon kjo dispozitë është i zbatueshëm për të gjitha mandatet e gjyqtarëve kushtetues në detyrë në momentin e miratimit të tij. Përmes dispozitës kushtetuese të pikës 3 të nenit 179, kushtetutëbërësi ka synuar të rregullojë regjimin tranzitor të mandateve të gjyqtarëve kushtetues të emëruar/zgjedhur menjëherë pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016. Me shtimin e togfjalëshit "*me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës*" në përmbajtje të dispozitës kalimtare, në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së saj, kushtetutëbërësi i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij të fundit (*shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, Gjykata vlerëson se qëllimi i dispozitës kushtetuese është garantimi i përtëritjes së rregullt të përbërjes së saj, parim i përcaktuar shprehimisht në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës.

49. Bazuar në sa më lart, parimi i përtëritjes së pjesshme për gjyqtarët

në regjimin tranzitor sipas pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës mbizotëron në raport me parimin e kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues. Gjykata thekson se kohëzgjatja e mandateve kushtetuese që i përkasin këtij regjimi tranzitor, ka qenë e kufizuar në kohë që në krye të herës, pasi vetëm në këtë mënyrë dhe vetëm përmes këtij interpretimi do të garantohet qëllimi kryesor i dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Në këtë këndvështrim, parashikimi i shprehur në po këtë dispozitë për përcaktimin e dy mandateve më të shkurtra se 9 vjet, konkretisht ato që mbarojnë në vitin 2025 dhe vitin 2028, i shërben dhe është në funksion të garantimit të parimit të përtëritjes së rregullt, i cili ka kuptimin të vendosë rregullin e përtëritjes me një të tretën dhe jo anasjelltas. Përndryshe, nëse këtyre parashikimeve do u jepej një kuptim i ndryshëm, shkurtimi i mandateve i vetëm dy gjyqtarëve kushtetues në vitin 2025 dhe vitin 2028, jo vetëm do të mbetej i pakuptimtë, por ai, përkundrazi, do të bëhej në vetvete pengesë për arritjen e vet qëllimit të kësaj norme, pra për garantimin e mbarimit të njëkohshëm, brenda të njëjtit vit, të tre mandateve kushtetuese, si i vetmi mekanizëm për të siguruar përtëritjen e Gjykatës me një tretën çdo tre vjet. Po në funksion të garantimit të këtij qëllimi kushtetutëbërësi ka parashikuar në dispozitën kalimtare se gjyqtarët e tjerë të Gjykatës emërohen për të gjithë "*kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit*". Ky formulim qartëson qëllimin e kushtetutëbërësit që përgjatë regjimit tranzitor, sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, kohëzgjatja e mandateve kushtetuese të gjyqtarëve të emëruar/zgjedhur në detyrë nuk i nënshtrohet parashikimeve të regjimit të përhershëm kushtetues që rregullohet sipas neneve 125, pika 3 dhe 129 të Kushtetutës. Referenca "sipas ligjit" ka të bëjë me pikën 4 të nenit 86 të Ligjit Organik të Gjykatës, që është pjesë e së njëjtës paketë legjislative me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016. Kjo dispozitë nuk ka parashikuar shprehimisht kohën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, por ka përcaktuar skemën kohore të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës, skemë sipas së cilës, në funksion të qëllimit të kushtetutëbërësit, përtëritja e parë me një të tretën bëhet në vitin 2025, përtëritja e dytë me një të tretën bëhet në vitin 2028 dhe përtëritja e tretë me një të tretën bëhet në vitin 2031.

50. Thënë kjo, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim edhe në interpretimin e dispozitave kushtetuese dhe lidhur me to, të dispozitave të Ligjit Organik të Gjykatës që përcaktojnë datën e fillimit dhe mbarimit të qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve kushtetues përgjatë kësaj periudhe tranzitore.

51. Gjykata vëren se sipas nenit 125, pika 3, të Kushtetutës gjyqtarët

kushtetues qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, detyrë që, sipas nenit 129 të Kushtetutës, fillon pasi bëjnë betimin përpara Presidentit. Nga ana tjetër, dispozitat kalimtare kushtetuese dhe ligjore kanë parashikuar një rregull të ndryshëm për kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve që ndodhen në regjimin tranzitor dhe që ushtrojnë detyrën brenda mandateve kushtetuese që përfshihen në skemën e përcaktuar në pikën 4 të nenit 86 të Ligjit Organik të Gjykatës. Për rrjedhojë, neni 129 i Kushtetutës i lidhur me nenin 8, pika 3, të Ligjit Organik të Gjykatës, nuk mund të gjejnë zbatim në rastin e gjyqtarëve kushtetues në detyrë përgjatë regjimit kushtetues tranzitor. Neni 179, pika 3, i Kushtetutës, në ndryshim nga neni 125, pika 7, i saj, që parashikon se gjyqtari kushtetues vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, nuk flet për gjyqtarë pasardhës, por për gjyqtarin që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017.

52. Për rrjedhojë, norma kushtetuese (dispozita kalimtare) përmban një parashikim të ndryshëm nga rregulli i përgjithshëm i kohëqëndrimit në detyrë dhe mbarimit të mandatit. Në funksion të zbatimit të parimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme të Gjykatës, nga kushtetutëbërësi duket se është pasur në konsideratë lidhja mes mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës dhe fillimit (ideal) të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri, e reflektuar kjo edhe në parashikimin e pikës 4 të nenit 86 të Ligjit Organik të Gjykatës. Gjykata, në kuptim të parimit të kushtetutshmërisë, që nënkupton sistemin harmonik të normave kushtetuese dhe nuk lejon kontradiktat e brendshme, vlerëson se ky është i vetmi interpretim kushtetues që do të garantonte qëllimin e kushtetutëbërësit, si më sipër, për respektimin e parimit të sanksionuar në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës. Ndonëse në pikën 4 të nenit 86 të Ligjit Organik të Gjykatës nuk parashikohet shprehimisht koha e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, referuar skemës kohore të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës, sipas së cilës përtëritja e parë me një të tretën bëhet në vitin 2025, përtëritja e dytë me një të tretën bëhet në vitin 2028 dhe përtëritja e tretë me një të tretën bëhet në vitin 2031, përgjatë këtij regjimi tranzitor, fillimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues përkon me datën e deklaruar ose që duhej deklaruar nga Gjykata dhe jo nga ndonjë organ tjetër kushtetues të mbarimit të mandatit kushtetues të gjyqtarit që ai zëvendëson.

53. Edhe pse skema për përtëritjen e përbërjes së Gjykatës përgjatë regjimit tranzitor parashikon mundësinë që gjyqtari kushtetues të ushtrojë detyrën për një kohëzgjatje më të shkurtër se mandati kushtetues

9-vjeçar, kjo gjen mbështetje kushtetuese dhe është e lejueshme nga vetë kushtetutëbërësi, për sa kohë reflekton vetë konceptin e tij kushtetues, me qëllim garantimin e parimit të përtëritjes periodike të pjesshme të kësaj Gjykate. Ky lloj kuptimi nuk e shfuqizon afatin 9-vjeçar të ushtrimit të detyrës, por e lidh zbatimin e tij si një proces gjithëpërfshirës me periudhat e përtëritjes të Gjykatës. Në vlerësimin e Gjykatës, respektimi i këtij parimi do të garantonte edhe respektimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve përmes respektimit të mekanizmit kushtetues të kuotave të secilit organ emërtese në përbërjen e Gjykatës çdo tre vjet.

54. Gjykata vlerëson se një interpretim i ndryshëm, duke njohur si moment të fillimit të kohëzgjatjes 9-vjeçare në detyrë atë të betimit përpara Presidentit, do të çonte në mosrespektimin e vullnetit të kushtetutëbërësit dhe mosrespektimin e skemës së përcaktuar prej tij, të përtëritjes periodike, për rrjedhojë do të ishte kushtetutshmërisht i palejueshëm. Po kështu, një qëndrim i ndryshëm do të vishte organet e emërtesës ose organet e përfshira në procesin e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarit kushtetues me një pushtet që vetë Kushtetuta nuk ua ka njohur atyre, për të përcaktuar përmes (mos) veprimeve të tyre momentin nga i cili do të fillojë e për rrjedhojë do të mbarojë një mandat kushtetues që i përket një kuote të caktuar, duke u përfshirë kështu drejtpërdrejt në mënyrën e zbatimit të parimit të përtëritjes së pjesshme.

55. Po në këtë kuptim, edhe pse Komisioni i Venecias në opinionin për emërimin e anëtarëve të Gjykatës është i mendimit se vitet fikse të fillimit dhe mbarimit të mandateve 9-vjeçare duhet të hiqen (së bashku me rregullin e radhës ose sekuencën e emërimeve) dhe gjyqtarët kushtetues duhet të gëzojnë gjithmonë një mandat të plotë 9-vjeçar, edhe nëse janë zgjedhur me vonesë ose marrin një mandat që ka mbaruar përpara afatit, ai vë theksin te ndryshimet që do ta bënin pozicionin e gjyqtarit kushtetues më tërheqës për kandidatët e kualifikuar, si dhe më kuptimplotë (*shih opinionin CDL-AD (2020)010, datë 19.06.2020, paragrafi 107)*. Në këtë pikë Gjykata gjen me vend të theksojë se ai opinion, pavarësisht se lidhej me radhën e emërimeve të gjyqtarëve kushtetues, nisur nga konteksti kohor mbi të cilin është dhënë, jo vetëm i referohej numrit të ulët të aplikimeve për disa vakanca shumë të shkurtra (2-3 vjet) për gjyqtar kushtetues të asaj kohe dhe kandidimit njëherazi në disa vakanca të disa kandidatëve, por qartazi bën fjalë për një situatë që duhet të rregullohet/ndryshohet në të ardhmen për shkak të kompleksitetit të formulës së emërimeve/zgjedhjes së këtyre gjyqtarëve. Si i tillë, në vlerësimin e Gjykatës ai mund të merret në konsideratë (nga

kushtetutëbërësi ose vetë Gjykata) vetëm nëse formula aktuale nuk do të funksionojë, ndaj nuk mund të interpretohet se gjen zbatim për gjyqtarët në detyrë. Fakti që rregullimin e përtëritjes së parë të Gjykatës pas vitit 2016 kushtetutëbërësi e ka zgjedhur ta bëjë me një dispozitë kalimtare, dëshmon se rastet e mbarimit të mandateve të gjyqtarëve që janë emëruar/zgjedhur në periudhën tranzitore do të konsiderohen si mekanizmi i duhur që do të sigurojë vazhdimësinë përtëritëse të Gjykatës në përbërjen e ardhshme të saj.

56. Për sa më sipër, Gjykata, bazuar edhe në përmbajtjen e nenit 127, pika 2, të Kushtetutës, që parashikon se mbarimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues deklarohet me vendim të kësaj Gjykate, i cili është zbërthyer në parashikimet e nenit 9, pika 2, të Ligjit Organik, arrin në përfundimin se data e fillimit të të gjitha mandateve kushtetuese që përfshihen në regjimin tranzitor sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 86, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, pavarësisht se cilës kuotë i përkasin ato, përkon me datën e deklaruar (apo që duhej të deklarohej) nga Gjykata të mbarimit të mandatit kushtetues 9-vjeçar të gjyqtarit që zëvendësohet, datë nga e cila, për rrjedhojë, përllogaritet, sipas parashikimeve përkatëse kushtetuese dhe ligjore, edhe data e mbarimit të atij mandati kushtetues.

57. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit, Presidentit, në drejtim të ekzistencës së një konflikti kushtetues mes tij dhe Gjykatës janë të bazuara dhe duhet të pranohen. Për rrjedhojë, e vetmja mënyrë për zgjidhjen e këtij konflikti kompetencash është deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues emërtesë e Presidentit, vendim që do i hapë rrugë fillimit të procedurave për ushtrimin nga ky organ emërtese të kompetencës kushtetuese për emërimin e gjyqtarit të ri, pjesë e kuotës së tij në përtëritjen e pjesshme të Gjykatës në vitin 2025, vendim i cili, sikurse u theksua më lart, për shkak të natyrës së tij deklarative do të shqyrtohet veçmas nga ky proces.

58. Gjykata vëren, gjithashtu, se subjekti i interesuar, Kuvendi, ka shpallur vakancën e pjesshme për shkak të mbarimit përpara afatit të mandatit të zonjës E.T., duke konsideruar në njoftimin për hapjen e procedurave se ky është një mandat i plotë 9-vjeçar që përfundon në datën 14.11.2028. Në parashtrimet e tij drejtuar Gjykatës ky subjekt ka kërkuar edhe që të konsiderohet nevoja për rishpalljen ose jo të kësaj vakance nga Kuvendi. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se, në përputhje me interpretimin e vendimit të saj, mandati kushtetues që është emërtesë e Kuvendit ka mbaruar po në

datën 25.04.2025, që përkon me datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që është zëvendësuar (zotit V.K.). Megjithatë, në situatën që mbarimi i këtij mandati (zonjës E.T.) është deklaruar tashmë nga Gjykata me vendimin nr. 62/2024, për shkak të heqjes dorë të gjyqtarit kushtetues, në të cilin nuk është përcaktuar data e mbarimit të mandatit kushtetues, i takon Kuvendit të marrë masat për të garantuar respektimin e përtëritjes së pjesshme të Gjykatës në vitin 2025, duke rishpallur kështu procedurat për zgjedhjen e gjyqtarit të ri kushtetues, pjesë e kuotës së tij, në përputhje me parashikimet kushtetuese e ligjore në fuqi, si dhe me arsyetimin e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 124, 131, pika 1, shkronja "ç" dhe 134, pikat 1, shkronja "a" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri dhe me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Kompetenca për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues i përket Gjykatës Kushtetuese dhe vetëm pas kësaj organi i emërtesës ushtron kompetencën e tij të emërimit/zgjedhjes të gjyqtarit kushtetues.

2. Shqyrtimin veçmas të kërkimit të Presidentit të Republikës për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

3. Interpretimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, si vijon:

Qëllimi i dispozitës kushtetuese është garantimi i përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, parim i përcaktuar në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës. Për këtë arsye, neni 179, pika 3, i Kushtetutës ka përcaktuar shkurtimin me më pak se 9 vjet të mandateve të dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, njëri deri në vitin 2025 dhe tjetri deri në vitin 2028. Për sa i përket "*kohëzgjatjes së mandatit, sipas ligjit*" të gjyqtarëve të tjerë, kjo dispozitë kushtetuese i referohet nenit 86, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, i cili ka përcaktuar skemën kohore të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar përtëritjen e parë me një të tretën në vitin 2025, përtëritjen e dytë me një të tretën në vitin 2028 dhe përtëritjen e tretë me një të tretën në vitin 2031.

Fillimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përgjatë këtij

regjimi tranzitor përkon me datën e deklaruar nga Gjykata Kushtetuese të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai zëvendëson.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.10.2025
Shpallur më 13.01.2026

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkimit tjetër të Presidentit, atij për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave dhe, për këtë shkak, interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, gjyqtarët e pakicës mbajnë qëndrim të kundërt me shumicën për sa i përket pikës 3 të dispozitivit, pra interpretimit të dispozitave kushtetuese të zbatueshme në rastin konkret dhe që lidhen me parimin e përtëritjes së Gjykatës. Qëndrimi ynë bazohet, në thelb, mbi të njëjtat argumente të parashtruara në qëndrimin në pakicë të mbajtur në vendimin nr. 65, datë 24.10.2025 (*vendimi nr. 65/2025*), me të cilin, nga e njëjta shumicë e anëtarëve të Gjykatës, është deklaruar i mbyllur, përpara përfundimit të kohëzgjatjes së tij, mandati i gjyqtares kushtetuese emërtesë e Presidentit, e emëruar me dekretin nr. 11886, si zëvendësuese në vakancën e plotë 9-vjeçare që ka filluar në datën 15.10.2019.

2. Për shkak se ai vendim (nr. 65/2025) ishte pasojë dhe zbatoi në mënyrë të menjëhershme këtë vendim interpretues të shumicës dhe qëndrimin e mbajtur prej saj në dispozitivin e shpallur publikisht, edhe pse u shpall, u publikua dhe prodhoi efektet e tij më parë në kohë sesa ky vendim, në atë mendim pakice janë parashtruar argumentet që kanë të bëjnë pikërisht me kuptimin dhe interpretimin e gabuar që u është bërë dispozitave kushtetuese nga shumica, çka ka sjellë edhe pasoja antikushtetuese, për sa kohë shkelen parime e të drejta kushtetuese. Siç është theksuar në mendimin e pakicës të vendimit nr. 65/2025, këto pasoja konsistojnë në cenimin e parimit të sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme dhe cenimin e mandatit kushtetues, që është edhe cenimi më i rëndë.

3. Po siç është theksuar edhe në atë mendim pakice, duket sikur qëndrimi i shumicës ka qenë i paracaktuar që në vendimin e saj nr. 84/2024, i cili, edhe pse i dhënë në një çështje konkrete, duket të ketë qenë hapi i parë, përcaktues, i qasjes që do të mbahej në vijim edhe për disa, por jo për të gjitha mandatet e tjera kushtetuese të gjyqtarëve që i përkasin regjimit tranzitor sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Ai vendim (nr. 84/2024) qartazi është dhënë nga Gjykata në situata të ndryshme, që imponoheshin nga rrethanat faktike të zbatueshme në vetëm atë rast konkret, në momentin e aplikimit të normës, të cilat janë tërësisht të ndryshme me ato që kanë ekzistuar në çështjen në shqyrtim dhe atë të shqyrtuar me vendimin nr. 65/2025, ndaj lindte nevoja për verifikimin dhe analizën e

tyre në rastin konkret. Përveç kësaj, Gjykata ishte e detyruar nga parimi i vetëpërmbajtjes në një situatë të tillë *ex post* sa kohë që, pavarësisht çfarëdo qëndrimi që mund të mbahej lidhur me interpretimin e normës kushtetues, pashmangërisht do të vinin pasoja të menjëhershme në drejtim të mandateve konkrete të gjyqtarëve kushtetues në detyrë, të cilët kishin vepruar në përputhje me sjelljen institucioneve dhe organeve kushtetuese të përfshira në procedurë, si zbatuesit dhe interpretuesit e parë të normave kushtetuese e që kishin marrë garancitë më të plota, bazuar në aktet e kandidimit, emërimit e betimit të këtyre institucioneve shtetërore, sidomos ato të organeve të emërtesës.

4. Sikundër edhe në qëndrimet e tjera të shumicës për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të normave kushtetuese (vendimet nr. 84/2024 dhe nr. 65/2025), ajo është mbështetur në qasjen se kushtetutëbërësi, përmes miratimit të nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, përgjatë periudhës tranzitore që rregullon kjo normë kushtetuese i ka dhënë epërsi parimit të përtëritjes së pjesshme të Gjykatës ndaj një parimi tjetër po kushtetues, atij të kohëzgjatjes së mandatit dhe patundshmërisë në detyrë të gjyqtarit kushtetues. Në këtë mënyrë, shumica ka anashkaluar parimet e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike për sa kohë që të gjithë gjyqtarët kushtetues në detyrë, me përjashtim të atyre që kanë një mandat të kufizuar nga vetë norma kushtetuese (që janë dy gjyqtarët, të dy emërtesë e Gjykatës së Lartë, me afat të përfundimit të mandatit në vitin 2025 (H.Z.) dhe në vitin 2028 (S.B.)), kanë kandiduar, kanë pranuar, janë emëruar/zgjedhur e në fund janë betuar mbi Kushtetutë për mandate të plota 9-vjeçare, çka nuk është vënë asnjëherë në diskutim as në momentin e emërimit/zgjedhjes dhe as gjatë ushtrimit të mandatit kushtetues, as nga organet e emërtesës dhe as nga ndonjë organ tjetër.

5. Në vlerësimin tonë në pakicë, pa vënë në dyshim qëllimin që ka pasur kushtetutëbërësi në miratimin e dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës dhe në vijim ligjvënësi në miratimin e nenit 86, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, i cili përcakton shprehimisht se skema e përtëritjes duhej të ishte zbatuar deri në dhjetor 2022, kjo skemë nuk u zbatua asnjë moment më parë. Duke humbur kështu aktualitetin e zbatimit të saj, skema e përtëritjes së pjesshme dështoi edhe një herë tjetër, për shkak të një situate objektive, të shkaktuar nga faktorë të jashtëm siç ishin vonesat në krijimin e institucioneve të reja të përfshira në procesin e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarit kushtetues dhe efektet e shkaktuara nga procesi i rivlerësimit që bënte të pamundur ngritjen dhe funksionimin e

institucioneve të përzgjedhjes dhe të emërimit të gjyqtarëve kushtetues. Duhet mbajtur në konsideratë këtu edhe ajo që vetë Komisioni i Venecias referon në Opinionin e tij të datës 19.06.2020, se KED-ja, organi i vetëm seleksionues i kandidatëve për gjyqtarë kushtetues, në vitet 2017 dhe 2018 nuk bëri asnjë rankim të këtyre kandidatëve.

6. Duke pasur parasysh të gjithë situatën që i parapriu miratimit të paketës së reformës në drejtësi, konkretisht atë në Gjykatë për sa i takon kohëzgjatjes së mandateve të gjyqtarëve në detyrë, së cilës i referohet edhe Komisioni i Venecias në opinionin e tij, si dhe me qëllim zbatimin e vendimeve të Gjykatës që kishin përcaktuar detyrimin e ligjvënësit kushtetues për të bërë efektiv rregullin e përtëritjes së rregullt të pjesshme, por duke zbatuar parimin kushtetues të kohëzgjatjes 9-vjeçare të mandatit të gjyqtarit kushtetues, dispozita kalimtare, si përjashtim nga ky i fundit, kufizoi shprehimisht vetëm dy mandate me kohëzgjatje 8-vjeçare, njëri deri në vitin 2025 dhe tjetri deri në vitin 2028. Duke vepruar në këtë mënyrë kushtetutëbërësi, qartazi e pa ekuivok, në ndryshim nga sa arsyeton shumica, i ka dhënë epërsi parimit kushtetues të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtues, përkundrejt rregullit (e jo parimit) të përtëritjes së pjesshme të rregullt, duke iu referuar në momentin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese pikërisht mandatave 9-vjeçare të gjyqtarëve kushtetues që do të emëroheshin/zgjidheshin në detyrë pas vitit 2016.

7. Siç ka theksuar Gjykata, me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është "i pavarur", ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre (*shih vendimin nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Këto garanci, të sanksionuara në këto vendime të Gjykatës, ku pjesë e asaj vendimmarrjeje është edhe kryetari aktual i Gjykatës së Lartë që çuditërisht në këtë periudhë përfaqëson një nga organet e emërtesës dhe mban një qasje tërësisht të ndryshme nga ajo e mbajtur prej tij në këto vendime, janë të tilla që duhet ta mbrojnë gjyqtarin jo vetëm nga faktorët e jashtëm, por edhe nga vetë kjo Gjykatë, që në çdo rast duhet të ndalojë çdo ndërhyrje ose presion të jashtëm ndaj gjyqtarëve të saj dhe, në ndryshim nga sa është vepruar konkretisht prej saj, duhet

të garantojë paprekshmërinë e mandatit/qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues përgjatë gjithë kohëzgjatjes së tij. Kjo duke pasur në konsideratë edhe se në rastin konkret Gjykata është ndodhur përpara një situate *ex post*, në rrethanat që gjyqtarët në detyrë, përfshirë dy gjyqtarët që sipas shumicës u mbaron mandati në vitin 2025, kanë kandiduar, janë emëruar dhe kanë filluar ushtrimin e detyrës për një mandat të plotë, në përputhje me përmbajtjen e parashikimeve kushtetuese, interpretimin dhe zbatimin e tyre në atë kohë ndaj në kuadër të parimit të vetëpërmbajtjes dhe të paprekshmërisë së një mandati kushtetues, në mënyrë kushtetuese do të duhej, sikundër jemi shprehur edhe më sipër, që të interpretonte normat kushtetuese me qëllim gjetjen e atij mekanizmi që do të përcaktonte sjelljen kushtetuese për situatat e tjera *ex ante,* pa prekur mandatet e gjyqtarëve në një situatë të tillë *ex post*.

8. Mandati në këtë rast nuk përkthehet thjesht si koha gjatë së cilës ushtrohet një detyrë e caktuar, pra si një detaj procedural, por ai lidhet drejtpërdrejt me garancitë dhe parimet kushtetuese, përfshirë ato *të pavarësisë* së Gjykatës dhe *të patundshmërisë* në detyrë të gjyqtarit kushtetues. *Parimi i pavarësisë* nënkupton gjithashtu se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi këtë qasje Gjykata, në vendimin nr. 84/2024, duke iu referuar akteve të njoftimit të vakancës nga organi i emërtesës, Gjykata e Lartë, njoftimit për rihapjen e procedurës së aplikimit, kërkesës për aplikim dhe konfirmimit të kandidaturës pas rishpalljes së kësaj vakance, ka vlerësuar se gjyqtarja kishte shprehur vullnetin e saj, pra ishte në dijeni të faktit që kandidonte për pjesën e mbetur të mandatit që përfundonte në muajin mars të vitit 2025, përcaktim i cili përmbahej shprehimisht në nenin 179, pika 3, të Kushtetutës. E megjithatë shumica devijoi tërësisht nga qasja e mbajtur prej saj në vendimin nr. 84/2024. Edhe pse në atë vendim ky duket se ka qenë një nga argumentet më të forta të shumicës në përcaktimin e datës dhe muajit konkret të përfundimit të mandatit të gjyqtares emërtesë e Gjykatës së Lartë, në vendimet e tjera të së njëjtës shumicë ajo anashkalon, deri në zhbërjen e saj, analizën në këtë drejtim, konkretisht të elementit të "dijenisë së gjyqtarit për kohëzgjatjen e mandatit të tij në momentin e emërimit, dekretimit e betimit", edhe pse ai lidhet ngushtë me zbatimin e parimit të pavarësisë së gjyqtarit kushtetues. Gjykata ka anashkaluar të analizojë dhe

të shprehet se përse nuk përbën argument kushtetues fakti që për të gjitha mandatet e tjera përveç atyre 8-vjeçare (atij deri në vitin 2025 dhe atij deri në vitin 2028), si në aktet e njoftimit të vakancës nga organet e emërtesës, në kërkesat për aplikim të kandidatëve, në aktet e KED-së, të hartuara e të nxjerra përgjatë këtyre procedurave, ashtu edhe vetë aktet e emërimit/zgjedhjes të organeve të emërtesës flitet për mandate të plota 9-vjeçare, të shpallura dhe të pranuara si të tilla. Të njëjtën qasje kanë mbajtur të tria organet e emërtesës, ndërkohë që edhe vetë Kuvendi, si organi që ka miratuar të gjithë paketën e reformës në drejtësi, përgjatë procedurës për shpalljen dhe zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues emërtesë të tij për "mandat të plotë 9-vjeçar", nuk ka vënë asnjëherë më parë në dyshim mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të dispozitave kushtetuese, posaçërisht asaj kalimtare. Edhe organi tjetër i emërtesës, vetë kërkuesi në rastin konkret (Presidenti), nuk ka vënë në asnjë moment në dyshim dekretet e lëshuara më parë nga pararendësi i tij, konkretisht dekretet e Presidentit I.M. mbi emërtesën për të cilën pretendon se ka lindur konflikti i kompetencave e për të cilën pretendon se ka përfunduar afati 9-vjeçar i emërimit në detyrë, akte të cilat as nuk janë kërkuar të shfuqizohen apo të kontrollohen për ndonjë pavlefshmëri.

9. Siç theksuam më sipër, skema/rregulli i përtëritjes së pjesshme të Gjykatës ka dështuar të funksionojë për shkak të mënyrës dhe kohës së zbatimit të ndryshimeve kushtetuese, ndaj mënyra për të siguruar zbatimin e saj nuk mund të jetë përmes ndërhyrjes së kësaj Gjykate, pra përmes shkurtimit dhe ndërprerjes së mandateve të disa gjyqtarëve të saj që janë në detyrë në regjimin tranzitor sipas shumicës, pasi ata kanë marrë mandate të plota 9-vjeçare. Gjykata nuk mund të ndërhynte për të zhbërë mosfunksionimin e kësaj skeme, duke sjellë pasoja negative, duke sakrifikuar kështu në zbatim të një rregulli procedural parime kushtetuese që duhet të mbroheshin më së pari prej saj, siç janë ai i shtetit të së drejtës dhe lidhur me të parimet e pavarësisë së gjyqtarit kushtetues, të sigurisë juridike, sikundër ai i barazisë në të drejta.

10. Edhe pse në rastin konkret ishte e nevojshme ndërhyrja e Gjykatës për të zgjidhur çështjen konkrete, pra mosmarrëveshjen e kompetencave të pretenduar të lindur nga Presidenti, përmes qasjes dhe sjelljes së saj, të ndryshme nga ajo e mbajtur në vendimin e vitit 2011 ose atë nr. 84/2024, Gjykata nuk ka bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, por i ka dhënë një kuptim të ri, pra të ndryshëm, normave kushtetuese të zbatueshme, duke arritur deri në krijimin e një norme të re kushtetuese që

përbën deformim të vullnetit të ligjvënësit kushtetues. Gjykata nuk mund të ndërhynte në këtë mënyrë, pra duke kufizuar *ex post* mandatet e plota të gjyqtarëve kushtetues të emëruar me mandate të plota 9-vjeçare, vetëm me qëllim rregullimin e pasojave që kanë ardhur në mënyrën e zbatimit të skemës së përtëritjes, që kishte humbur si afatin e zbatimit të saj, ashtu edhe aktualitetin për sa kohë nuk ishte zbatuar më parë.

11. Në vlerësimin tonë, edhe kësaj here i takonte ligjvënësit kushtetues që të riparonte situatën përmes miratimit, edhe një herë, të mekanizmit/formulës/skemës që do të siguronte zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe vetë vendimet e kësaj Gjykate.

12. Në nenin 127 të Kushtetutës janë përcaktuar të vetmet shkaqe të lejueshme kushtetutshmërisht për mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, mes të cilave, shkronja "b" parashikon si të tillë përfundimin e mandatit 9-vjeçar. Kushtetuta e rregullon mandatin e gjyqtarit kushtetues në nenet 125 e vijues të saj dhe flet vetëm për një lloj mandati "*mandati i gjyqtarit kushtetues*", i cili në rastet kur është i plotë, siç është rasti i të gjithë gjyqtarëve në detyrë, me përjashtim të vetëm dy mandateve (njëri që mbaron në vitin 2025 dhe tjetri që mbaron në vitin 2028), nënkupton qëndrimin në detyrë për 9 vjet, në kuptim dhe zbatim të nenit 125, pika 3, të Kushtetutës. Kohëzgjatja 9-vjeçare e mandatit fillon nga dita e betimit të atij gjyqtari, sipas nenit 129 të Kushtetutës dhe do përfundon në ditën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë. Për rrjedhojë, qëndrimi i shumicës se qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë që përgjatë regjimit tranzitor sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, kohëzgjatja e mandateve kushtetuese të gjyqtarëve të emëruar/zgjedhur në detyrë nuk iu nënshtrohet parashikimeve të regjimit të përhershëm kushtetues që rregullohet sipas neneve 125, pika 3 dhe 129 të Kushtetutës (*shih paragrafin 49 të vendimit*) nuk gjen bazë kushtetuese dhe zhbën zbatimin e neneve 125, pika 3 dhe 129 të Kushtetutës, që janë premisa nga e cila është arritur në formulën e dispozitës kalimtare (pavarësisht se ajo solli efektet e dëshiruara). Mbi këtë interpretim asgjësohet koncepti kushtues "betimi i gjyqtarit kushtetues para Presidentit" dhe vetë dekreti i tij si akt, si parakusht për fillimin e detyrës, e vetmja ngjarje me pasoja kushtetuese në fillimin dhe mbarimin e mandatit/qëndrimit në detyrë për 9 vjet të gjyqtarit kushtetues.

13. Në vlerësimin tonë, për sa kohë që vetë dispozita tranzitore, neni 179, pika 3, i Kushtetutës, nuk ka një parashikim të shprehur për përjashtimin e zbatimit të rregullave të përgjithshme për fillimin dhe mbarimin e mandatit/qëndrimit në detyrë të "gjyqtarëve të tjerë" kushtetues dhe as për kufizimin

e mandateve të këtyre gjyqtarëve përgjatë regjimit tranzitor, kjo Gjykatë, në respekt edhe të parimit të vetëpërmbajtjes, nuk mund të bënte përmes interpretimit të saj atë që vetë kushtetutëbërësi nuk ka dashur ta bëjë. Parashikimi "*kohëzgjatjes së mandatit, sipas ligjit*", në nenin 179, pika 3, të Kushtetutës, nuk mund të nënkuptojë anashkalimin e normave kushtetuese të zbatueshme, si më sipër, për sa kohë që përmes normave me natyrë ligjore nuk mund të kufizohen ose të interpretohen normat garantuese të nivelit kushtetues.

14. Mbrojtja e së drejtës së gjyqtarit për të ushtuar mandatin e tij të plotë përgjatë periudhës 9-vjeçare mbështetet në parimet kushtetuese të pavarësisë së Gjykatës dhe të vet gjyqtarit, si dhe të patundshmërisë në detyrë. Për sa i përket mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, Kushtetuta ka parashikuar shprehimisht këto raste. Procesi i deklarimit të mbarimit të mandatit është deklarativ dhe gjatë tij verifikohen aktet e emërimit dhe afatet e përcaktuara në to, siç është data e betimit të gjyqtarit dhe, lidhur me të, data që i përket ditës së njëjtë të të njëjtit muaj të vitit të nëntë kalendarik, dhe vetëm në këtë rast angazhohet trupa e gjyqtarëve me një proces deklarativ të bazuar në verifikimin e vetëm këtyre fakteve. Mënyra e ushtrimit të kësaj kompetence nga Gjykata përbën një garanci tjetër për mbrojtjen e gjyqtarit nga interpretimi dhe ndërhyrja subjektive individuale në ushtrimin e mandatit të tij nga vetë kjo Gjykatë ose gjyqtarët e saj përmes interpretimit, i cili nuk mund të ndërpresë një detyrë kushtetuese që ka filluar të ushtrohet sipas rregullave kushtetuese të zbatueshme në kohën e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarit, të njohura dhe të pranuara prej vetë atij, organeve të emërtesës dhe atyre të përfshira në proces, ashtu edhe prej vetë kësaj Gjykate.

15. Nga ana tjetër, edhe Komisioni i Venecias, në ndryshim nga si e referon ose interpreton shumica, ka vlerësuar se modeli kushtetues i miratuar në vitin 2016 është shumë kompleks dhe, në planin afatgjatë, është rekomanduar thjeshtimi i tij, në radhë të parë, *duke hequr rregullin e sekuencës.* Sipas Komisionit të Venecias, kuotat e tre organeve të emërtesës mund të ruhen duke i caktuar automatikisht rinovimin e një mandati të njëjtit autoritet që ka emëruar gjyqtarin që largohet. Po sipas tij, vitet fikse të fillimit dhe të mbarimit të mandateve 9-vjeçare duhet të hiqen dhe gjyqtarët kushtetues duhet të gëzojnë gjithmonë një mandat të plotë 9-vjeçar, edhe nëse janë zgjedhur me vonesë ose marrin një mandat që ka mbaruar përpara afatit (*shih paragrafin 107 të opinionit të Komisionit të Venecias nr. 978/2020 CDL-AD(2020)010*). Sipas shumicës, ai opinion, pavarësisht se lidhej me

radhën e emërimeve të gjyqtarëve kushtetues, nisur nga konteksti kohor mbi të cilin është dhënë, jo vetëm i referohej numrit të ulët të aplikimeve për disa vakanca shumë të shkurtra (2-3 vjet) për gjyqtarë kushtetues të asaj kohe dhe kandidimit njëherazi në disa vakanca të disa kandidatëve, por qartazi bën fjalë për një situatë që duhet të rregullohet/ndryshohet në të ardhmen për shkak të kompleksitetit të formulës së emërimeve/zgjedhjes së këtyre gjyqtarëve (*shih paragrafin 55 të vendimit*). Kjo qasje është tërësisht e gabuar dhe është hequr nga konteksti i tërë tekstit të opinionit të Komisionit të Venecias, duke e zhveshur dhe larguar qëllimisht nga shkaku për të cilin është kërkuar ai dhe rekomandimet konkrete që janë dhënë, të cilat nuk flasin për një situatë kalimtare, por flasin për rregullime të përhershme kushtetuese dhe reforma që kërkojnë ndërhyrjen e ligjvënësit kushtetues. Përkundrazi, ky opinion është miratuar nga Komisioni i Venecias më 19.06.2020, pra pas miratimit të paketës së reformës në drejtësi dhe pasi situata e ngërçit ishte tejkaluar dhe Gjykata kishte filluar të përtërihej e ku tashmë ishin emëruar tre gjyqtarë të rinj kushtetues, duke iu referuar ai një rasti konkret dhe një situate konkrete. Në vlerësimin tonë, shumica e referon këtë opinion të copëzuar dhe vetëm për aq sa ai mbështet qëndrimin e saj, ndërkohë që synon ta anashkalojë atë për sa ka shprehur në lidhje me kufizimin e mandateve kushtetuese dhe në konkluzionin e tij.

16. Po kështu, dëshirojmë të sqarojmë edhe mënyrën e referimit nga shumica të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë (*shih paragrafët 34-36 të vendimit*), një vend në të cilin zbatohet i njëjti model kushtetues për kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarit dhe përtëritjen e Gjykatës. Pavarësisht qëndrimit që është mbajtur në ato vendime, vlerësojmë se ai do të ishte i vlefshëm në një situatë tjetër (jo ajo së cilës i referohet shumica), pra jo në një situatë të jashtëzakonshme si ajo e rastit shqiptar. Ato vendime, nëse do të lexohen me kujdes, kanë synuar që të evitojnë devijimin nga respektimi i parimeve kushtetuese për shkak të sjelljes jokushtetuese të organeve të emërtesës të gjyqtarëve kushtetues, konkretisht të Kuvendit, pra për të evituar vonesat e qëllimshme në zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, për të siguruar kuotat më të mëdha në përbërjen e Gjykatës dhe, në vijim, kanë synuar të rregullojnë një pasojë të krijuar për shkak të sjelljes së Kuvendit. Për më tepër, rasti i dytë i cituar nga shumica është një rast konkret, ku Gjykatës i është kërkuar nga Presidenti që të shprehet mbi aktet individuale të emërimit të Kuvendit të dy gjyqtarëve kushtetues, gjë që nuk ka ndodhur aspak në rastin në fjalë objekt i këtij gjykimi kushtetues.

17. Nuk është as qëllim i yni, do të thotë as qasje e jona, që të vëmë në diskutim rëndësinë e secilit parim apo rregulli kushtetues, pra edhe atij që synon të sigurojë përtëritjen periodike të pjesshme të Gjykatës. Ajo që ne vëmë në diskutim dhe që na ndan në qasjen nga shumica është raporti i zhdrejtë në të cilin ajo e ka vënë këtë rregull kundrejt parimit kushtetues të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues, si një parim që ka rëndësi kushtetuese për legjitimitetin, pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarit dhe të vet Gjykatës.

18. Skema e përtëritjes së pjesshme nuk është arritur të respektohet rregullisht, shkak për të cilin Gjykata është vënë disa herë në lëvizje, si për interpretimin e rregullit të përtëritjes së pjesshme sipas dispozitave të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" (*shih vendimin nr. 4, datë 02.06.1995 të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe me qëllim përcaktimin e raportit që duhet të ekzistojë mes dy parimeve që sanksionon neni 125 i Kushtetutës, parimi i qëndrueshmërisë në përbërjen e saj dhe parimi i garantimit të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues (*shih vendimet nr. 41, datë 19.07.2012; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur se është në kompetencë të ligjvënësit kushtetues që të gjejë dhe të zbatojë mekanizmin e përshtatshëm për të respektuar parimin kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës çdo tre vjet në një të tretën e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas shumicës, për sa kohë ligjvënësi kushtetues në përmbushje të jurisprudencës kushtetuese u aktivizua dhe përcaktoi mekanizmin e vlefshëm dhe të përshtatshëm për respektimin e parashikimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme të saj, një interpretim i ndryshëm i nenit 179, pika 3 të Kushtetutës, qoftë edhe duke kërkuar përsëri ndërhyrjen e ligjvënësit kushtetues, do të binte ndesh me parimin e luajalitetit kushtetues dhe atij të koherencës së jurisprudencës së Gjykatës, të cilave i nënshtrohet edhe vetë Gjykata (*shih paragrafin 47 të vendimit*). Kohëzgjatja e mandateve kushtetuese që i përkasin këtij regjimi tranzitor, ka qenë e kufizuar në kohë që në krye të herës, pasi vetëm në këtë mënyrë dhe vetëm përmes këtij interpretimi do të garantohet qëllimi kryesor i dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Po sipas shumicës, nëse do t'u jepej një kuptim i ndryshëm dispozitave kushtetuese, shkurtimi i mandateve i vetëm dy gjyqtarëve kushtetues në vitin 2025 dhe vitin 2028, jo vetëm do të mbetej i pakuptimtë, por ai, përkundrazi, do të bëhej në vetvete pengesë për arritjen e vet qëllimit të kësaj norme, pra për garantimin e mbarimit të njëkohshëm, brenda të njëjtit vit, të tre mandateve kushtetuese, si i vetmi

mekanizëm për të siguruar përtëritjen e Gjykatës me një tretën çdo tre vjet (*shih paragrafin 49 të vendimit*).

19. Në të vërtetë, përmes këtij vendimi, shumica, pavarësisht për sa është shprehur, ka sjellë si pasojë pikërisht mosarritjen e qëllimit të pretenduar prej saj dhe nuk ka evituar pengesën për përtëritjen brenda të njëjtit vit të një të tretës së Gjykatës. Ajo jo vetëm që nuk ka rregulluar dhe as ka krijuar ndonjë ekuilibër kushtetues, por ka ndikuar në krijimin e një pasigurie juridike dhe moskoherence në praktikën kushtetuese dhe institucionale, duke parashikuar dy rrethana kushtetuese të ndryshme të papërcaktuara më parë askund, regjimi tranzitor dhe një regjim tjetër i zakonshëm, me pasoja në parimet kushtetuese të zbatueshme, edhe pse kjo nuk rezulton as nga përmbajtja dhe as nga fryma e normave kushtetuese. Shumica e kishte shumë të lehtë që të konstatonte pasojat që do të vijnë nga vendimi i saj në drejtim të zbatimit të parimit të përtëritjes së pjesshme në kushtet që është tashmë tepër e qartë se për shkak të zëvendësimit të njërit gjyqtar në vitin 2025 dhe zhvillimit të procedurave për emërimin/zgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë në vitin 2026 (në rastin më të mirë), zëvendësimi i këtyre gjyqtarëve nuk është më e mundur që të bëhet në të njëjtën kohë, pra në të njëjtin vit. Ky është edhe testimi që duhet t`i ishte bërë mekanizmit të aplikuar në këtë vendim, me qëllimin për të arritur në përfundimin se skema/rregulli i përtëritjes së pjesshme ishte tashmë e pamundur të rregullohej/rivendosej përmes një vendimi interpretativ, por kërkonte gjetjen e një formule të re kushtetuese, referuar edhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Kjo bëhet edhe më e qartë për sa kohë që shumica, përveçse ka përcaktuar mbarimin e mandateve të gjyqtarëve që i përkasin, sipas saj, përtëritjes së parë në vitin 2025, nuk ka dhënë asnjë përcaktim për mbarimin e mandateve të gjyqtarëve të tjerë, që u përkasin përtëritjeve të tjetra (në vitet 2028 dhe 2031), me qëllimin që të garantojë qëllimin e evidentuar dhe sjelljen institucionale të organeve kushtetuese të emërtesës në të ardhmen, gjë që ishte pjesë edhe e kërkimit të kërkuesit (Presidentit), në cilësinë e njërit prej këtyre organeve të emërtesës. Përmes këtij vendimi shumica nuk ka sjellë dhe siguruar zbatimin e rregullit kushtetues të përtëritjes, por thjesht kufizimin/shkurtimin *ex post* me gati një të tretën e kohës së qëndrimit në detyrë të mandateve të vetëm dy prej anëtarëve të saj, duke evituar ta aplikojë këtë rregull për gjyqtarët e tjerë. Shumica ka krijuar të njëjtën situatë faktike që kishte përbërë më parë shkas për thirrjen nga Gjykata të kushtetutëbërësit për të ndërhyrë për rregullimin e saj.

20. Parimi i përtëritjes së pjesshme çdo tre vjet me një kuotë për secilin nga tre organet e emërtesës, përbën zbatim edhe të parimit të ndarjes dhe

balancimit ndërmjet pushteteve, duke siguruar që asnjë nga organet e përfshira në këtë proces të mos ketë pozitë dominuese në përtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet. Ndërsa garanton balancën në raportin e përbërjes së Gjykatës, ky mekanizëm nuk lejon që ndonjë organ të privohet nga e drejta për të emëruar/zgjedhur gjyqtarin kushtetues që i përket kuotës së tij, pra në ushtrimin e kompetencave të tij. Situata aktuale, megjithatë, nuk ka ardhur për shkak të sjelljes jo të duhur institucionale nga organet kushtetuese të emërtesës apo ato të përfshira në këtë proces, pra për shkak të (mos) ushtrimit të kompetencave prej tyre apo vlerësimit të ndonjë diskrecioni në këtë proces, çka nuk është e lejueshme kushtetutshmërisht. Kjo sepse çdo mosushtrim i kompetencave në kohën dhe mënyrën e duhur, apo çdo ushtrim i diskrecionit nga ndonjë prej organeve të përfshira në procesin e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues për interpretimin/zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, me pasojë pengimin e ushtrimit të kësaj kompetence nga ndonjë prej organeve të tjera kushtetuese, do të përbënte prishje të ekuilibrit mes një parimi dhe një rregulli kushtetues. Kushtetutëbërësi nuk e ka lidhur fillimin e mandatit të një gjyqtari me përfundimin e mandatit të gjyqtarit pararendës që i përket së njëjtës kuotë, ndërkohë që Gjykata ka mbajtur një qasje të tillë në vendimin nr. 84/2024 vetëm për mandatin me kohëzgjatje deri në vitin 2025, në interpretim të nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Referuar edhe parashikimeve të pikës 4 të nenit 86 të Ligjit Organik të Gjykatës, e miratuar në funksion të zbatimit të dispozitës kalimtare kushtetuese, ndërsa kjo dispozitë ka reflektuar përmbajtjen e pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës për dy mandatet e pjesshme 8-vjeçare (të vitit 2025 dhe 2028), duket se, në thelb, ka synuar që të përcaktojë kuotat e përtëritjes të secilit organ, pra radhën, sekuencën e emërimit, me qëllim më tej vijimin e garantimit të sistemit të këtyre kuotave edhe në të ardhmen.

21. Ne jemi të qëndrimit se në situatën aktuale rezulton të ketë humbur lidhja harmonike mes normave kushtetuese që synonin përtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet me gjyqtarë të emëruar për mandate 9-vjeçare, siç përcaktohet në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës, për shkak të vonesave në zbatimin dhe funksionimin e të gjithë sistemit të miratuar me paketën kushtetuese të vitit 2016, ndaj Gjykata nuk mund të vihet në kushtet e korrigjimit apo neutralizimit të këtyre pasojave nëpërmjet një vendimmarrjeje të saj me pasoja ndaj vetëm disa prej gjyqtarëve kushtetues, çka ka synuar të bëjë shumica me qëndrimin e saj. Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, edhe pse qëllimi i ligjvënësit kushtetues në miratimin e dispozitës kalimtare ka

qenë respektimi i përtëritjes periodike të pjesshme, forma përmes së cilës është zgjedhur të zbatohen vendimet e Gjykatës në këtë drejtim ka qenë përmes respektimit të mandateve të tjera 9-vjeçare. Përndryshe nuk do të kishte kuptim mënyra e formulimit të pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës, duke u kufizuar shprehimisht vetëm dy mandate kushtetuese. Ajo që iu kërkua Gjykatës në rastin konkret ishte të vendoste reduktimin/kufizimin e mandateve kushtetuese të të gjithë gjyqtarëve të saj, çka është një çështje që mund të zgjidhet vetëm nga ligjvënësi kushtetues, si pjesë e juridiksionit dhe diskrecionit të tij kushtetues, i cili ka detyrimin të garantojë si ritmin e rregullt institucional të përtëritjes së Gjykatës, ashtu edhe që anëtarët e saj të jenë në gjendje të ushtrojnë plotësisht mandatin 9-vjeçar.

22. Duke qenë kohëzgjatja e mandatit një element kushtetues përcaktues i pavarësisë së organit kushtetues, që garantohet vetëm nëse gjyqtarët kanë mundësinë të kryejnë detyrat e tyre për periudhën e përcaktuar në aktet e emërimit, të cilat janë të pandryshueshme gjatë kohëzgjatjes së mandatit, Kushtetuta vendosi në mënyrë të shprehur një përjashtim nga rregulli i mandatit 9-vjeçar, duke përcaktuar afate më të shkurtra të qëndrimit në detyrë në mënyrë të shprehur për dy mandate (secili nga 8 vjet) për të bërë të mundur zbatimin e zinxhirit të rinovimeve të gjyqtarëve kushtetues. Kjo do të thotë se Gjykata nuk mund të marrë pushtetin diskrecionar të ligjvënësit kushtetues për të kufizuar përmes interpretimit dhe zbatimit të një dispozite kalimtare të gjitha mandatet e anëtarëve të saj. Interpretimi i shumicës për lidhjen e datës së fillimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues me datën e deklaruar nga Gjykata të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai zëvendëson për të siguruar përtëritjen në vitet 2025, 2028 dhe 2031, ka bërë që mandatet e gjyqtarëve në detyrë të jenë më të shkurtra se ai 9-vjeçar i përcaktuar nga Kushtetuta, për të cilin ata kanë kandiduar, kanë pranuar dhe kanë marrë me aktet e emërimit/zgjedhjes së organeve të emërtesës. Shumica nuk ka pasur në konsideratë as se kërkesa në shqyrtim (në ndryshim edhe nga rastet e referuara të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë ku ajo gjykatë ishte shprehur përpara se Kuvendi të zgjidhte dy gjyqtarët kushtetues) është paraqitur pas marrjes nga gjyqtarët në detyrë të mandateve të plota kushtetuese dhe pas fillimit të ushtrimit të tyre, ndërkohë që në kuptim të parimit të sigurisë juridike dhe ndarjes e balancimit të pushteteve edhe verifikimi i kohëzgjatjes së këtyre mandateve *ex post* mund të sjellë një pasojë antikushtetuese dhe të përbëjë ndërhyrje joproporcionale, për sa kohë që një gjë e tillë nuk është verifikuar dhe korrigjuar, ose kërkuar të korrigjohet nga vetë organet e emërtesës ose ato të përfshira në këtë proces.

23. Parashikimet kushtetuese për kohëzgjatjen e mandatit kushtetues përcaktojnë, së bashku me të tjerat, stabilitetin dhe pavarësinë e Gjykatës, duke e ndarë dhe shkëputur veprimtarinë e saj nga ajo e organeve të emërtesës. Modeli i kohëzgjatjes së kufizuar në kohë të mandatit të gjyqtarit kushtetues lidhet me sistemin e përqendruar të drejtësisë kushtetuese, sipas modelit kelsenian, që duke krijuar një organ të drejtësisë kushtetuese të centralizuar, të dallueshëm nga pushteti gjyqësor, solli edhe nevojën e përcaktimit të garancive të pavarësisë si të vet atij organi, ashtu edhe të anëtarëve të tij në raport me pushtetet e tjera, veçanërisht atë politik. Funksioni i Gjykatës, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës, është interpretimi i dispozitës me qëllim përftimin e kuptimit normativ të tekstit kushtetues, duke ndjekur teknikat e njohura të interpretimit në gjykimin kushtetues. Në rastin konkret, garantimi i kërkesës kushtetuese për zbatimin e mekanizmit të përtëritjes së pjesshme nuk mund të arrihej përmes një vendimi interpretativ të Gjykatës, por i takonte ligjbërësit kushtetues që të vihej në lëvizje për të zhbllokuar edhe një herë situatën përmes gjetjes së një formule që do të sigurojë respektimin e këtij mekanizmi, pa prekur parimet e tjera kushtetuese.

24. Për rrjedhojë, mbi qasjen se Gjykata nuk mund të vihet në lëvizje për të përcaktuar mënyrën sesi do të zbatohet skema e përtëritjes së pjesshme të saj, pra për përcaktimin e kohës së mbarimit të mandateve të anëtarëve të saj në detyrë, organet e emërtesës nuk mund të thirren/vihen në lëvizje apo të kërkojnë fillimin e procedurave për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj kushtetues që u përkasin kuotës së tyre. Në këto kushte, për sa kohë që nuk është aktivizuar një kompetencë kushtetuese e këtyre organeve, jo për shkak të mosveprimit të Gjykatës/Kryetarit për thirrjen e saj për deklarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, po për shkak të zbatimit të dispozitave kushtetuese që garantojnë kohëzgjatjen e mandateve të cilat nuk janë kufizuar shprehimisht nga norma kushtetuese (pika 3 e nenit 179 të Kushtetutës), Presidenti nuk mund të pretendojë se ka lindur një mosmarrëveshje kushtetuese, ndaj kërkesa e tij duhej të ishte rrëzuar për këtë shkak.

25. Përveç argumenteve si më sipër, unë, gjyqtarja Sonila Bejtja, jam edhe e qëndrimit se shumica ka devijuar nga dispozitivi i vendimit, paragrafi i fundit i pikës 3 të tij, duke arsyetuar në vendim, në kundërshtim dhe tej për sa është disponuar në këtë paragraf të dispozitivit, sipas të cilit: "*Fillimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përgjatë këtij regjimi tranzitor përkon me datën e deklaruar nga Gjykata Kushtetuese të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai zëvendëson*". Mbi këtë paragraf

të fundit të dispozitivit të vendimit të saj, Gjykata, në vendimin nr. 65/2025, ka deklaruar mbarimin e mandatit të një prej gjyqtarëve të saj, konkretisht anëtarit emërtesë e Presidentit, dekretuar me dekretin nr. 11886, datë 28.12.2020, si dhe është shprehur për mbarimin, në të njëjtën datë, muaj dhe vit edhe të mandatit të gjyqtares tjetër kushtetuese, emërtesë e Kuvendit, së cilës i ka mbaruar mandati përpara afatit në datën 23.09.2024, për shkak të dorëheqjes.

26. Ndërkohë që, referuar përmbajtjes së vendimit, sipas shumicës, përtëritja e parë me një të tretën bëhet në vitin 2025, përtëritja e dytë me një të tretën bëhet në vitin 2028 dhe përtëritja e tretë me një të tretën bëhet në vitin 2031 (*shih paragrafin 52 të vendimit*), duke iu referuar jo më momentit efektiv të fillimit të detyrës dhe mandatit të gjyqtarit kushtetues të emëruar gjatë këtij regjimi tranzitor, sipas akteve të përzgjedhjes, renditjes, emërimit dhe dekretimit të organeve të emërtesës, por momentit kohor, në të cilin, sipas shumicës, duhet të quhej si i filluar ky mandat e detyrë, pra duke e lidhur këtë moment të fillimit jo më me afatet e përcaktuara nga Kushtetuta dhe aktet e emërimit të tyre, por duke e lidhur fillimin e këtij mandati në abstrakt, me datën e deklaruar ose që duhej deklaruar nga Gjykata dhe jo nga ndonjë organ tjetër kushtetues të mbarimit të mandatit kushtetues të gjyqtarit që ai zëvendëson (*shih paragrafin 52 të vendimit*).

27. *Së pari,* ndërsa në dispozitiv shumica flet vetëm për datën e mbarimit të mandatit të deklaruar nga Gjykata, në arsyetim i referohet datës që duhej të ishte deklaruar i përfunduar mandati, me qëllimin e vetëm final që të përdorë konceptin e saj për "mandatin ideal", edhe pse ai nuk është një koncept që mund të rezultojë nga përmbajtja ose interpretimi i dispozitave kushtetuese dhe as nga praktika e vet kësaj Gjykate, ndërkohë që nenet 127 dhe 129 të Kushtetutës qartazi përcaktojnë mënyrën dhe rastet se si fillon dhe mbaron mandati i gjyqtarit kushtetues. Edhe pse në dispozitiv flitet vetëm për deklarim të Gjykatës pa specifikuar se në cilën mënyrë bëhet kjo, në vendimin nr. 65/2025 shumica barazon për nga natyra dhe efektet, si vendimet për deklarimin e mbarimit të mandatit, ashtu edhe shkresat e Gjykatës drejtuar organeve të emërtesës. *Së dyti,* në vendim mungon arsyetimi sipas dispozitivit të vendimit për mandatet e tjera të gjyqtarëve në detyrë, referuar datave në të cilat Gjykata me vendime/shkresa ka njoftuar mbarimin e mandatit të gjyqtarit paraardhës, pavarësisht shkakut të mbarimit, ku përfshihet edhe vendimi i organeve të rivlerësimit sipas Kushtetutës.

28. Kjo qasje e bën tërësisht kontradiktor dhe të njëanshëm arsyetimin e

shumicës, për sa kohë që kjo mënyrë interpretimi e saj ka evituar, qartazi, që ky vendim të sjellë pasoja për të gjithë gjyqtarët e trupës në detyrë të emëruar përgjatë regjimit tranzitor, siç edhe kërkohej nga kërkuesi, Presidenti, por duke e zbatuar skemën e rotacionit të interpretuar në këtë mënyrë vetëm ndaj mandateve 9-vjeçare të dy prej gjyqtarëve kushtetues të emëruar përgjatë këtij regjimi, njëri emërtesë e Kuvendit, dorëhequr në datën 19.09.2024 dhe tjetri emërtesë e Presidentit, duke evituar kështu që ky vendim të prekte ose sillte pasoja mbi mandatet e gjyqtarëve të tjerë vendimmarrës të shumicës, që janë në detyrë e që sipas këtij vendimi i përkasin trupës gjyqësore të regjimit tranzitor.

29. Me qëllim respektimin e asaj çka ka është vendosur në dispozitivin e vendimit, gjë që nuk është bërë nga vetë shumica, unë, gjyqtarja në pakicë, do të trajtoj, në vijim, në mënyrë detajuese, atë çka ka dashur të thotë shumica në këtë pikë të dispozitivit, edhe pse ajo vetë e ka lënë pa arsyetuar vendimmarrjen e saj për këtë pjesë të rëndësishme të vendimit e nga ku edhe merr pikënisje interpretimi i skemës së përtëritjes në rastin e kësaj trupe gjyqësore. Në interpretim të këtij paragrafi të dispozitivit, e vetmja mënyrë për ta zbatuar përmbajtjen e tij do të ishte përcaktimi i secilës datë konkrete kur ka filluar mandati i secilit gjyqtar kushtetues, aktualisht në detyrë, për rrjedhojë edhe i datës kur mbaron ai, duke iu referuar këtu, në të njëjtën mënyrë, edhe interpretimit të bërë për dy nga gjyqtarët kushtetues e më tej interpretimit të mbajtur nga e njëjta shumicë edhe në vendimin nr. 65/2025, ku ajo i është referuar datës së deklaruar të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që është zëvendësuar e që në atë rast (pra në vendimin nr. 65/2025) nuk është bërë formalisht me vendim deklarativ, por që u konstatua përmes referimit në shkresa të ndryshme që Gjykata u kishte dërguar organeve të emërtesës, Presidentit dhe Kuvendit, kohë përpara emërimit të gjyqtarit kushtetues aktualisht në detyrë.

30. Duhet evidentuar fakti se në situatën pas miratimeve kushtetuese, Gjykata në shumë raste nuk është shprehur me vendim deklarativ për mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, qoftë për shkak se përfundimi i mandateve të disa gjyqtarëve ka ardhur në vijim të vendimeve të shkarkimit të organeve të rivlerësimit kalimtar, por edhe për shkak të mungesës së kuorumit të gjyqtarëve, apo edhe për shkaqe të tjera që duhet të jenë vlerësuar prej vet asaj në atë kohë. Në disa raste, Gjykata ka vepruar nëpërmjet shkresave zyrtare dërguar institucioneve dhe organeve të emërtesës, siç është konstatuar dhe arsyetuar edhe në vendimin nr. 65/2025, përmes të cilave ka informuar dhe ka vënë në dijeni organet e

emërtesës për mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, akte që, referuar atij vendimi, në kuptim të përfundimit të mandatit kushtetues ose çeljes së vakancave, duket se kanë të njëjtën vlerë juridike, siç edhe vendimi i Gjykatës për deklarimin e mbarimit të mandatit. Përtej këtij momenti, edhe pse procedurat e kandidimit janë çelur dhe riçelur për disa vakanca, nuk ka asnjë vendim apo veprim tjetër nga Gjykata për të përcaktuar një datë të ndryshme ose të mëtejshme në kohë të mbarimit të këtyre mandateve, çka do të thotë *se i vetmi moment/ngjarje përcaktuese për datën e fillimit të mandateve të gjyqtarëve në detyrë është vendimi/shkresa e Gjykatës që përcakton datën kur i ka mbaruar mandati gjyqtarit që është zëvendësuar*, pavarësisht shkakut të mbarimit të atij mandati, siç edhe vetë shumica e ka përcaktuar në formulimin e paragrafit të fundit të dispozitivit të vendimit të saj.

31. Nën këtë logjikë, referuar këtij momenti, bazuar në këtë paragraf të dispozitivit, edhe vetë skema e përtëritjes, e parashikuar në nenin 86 të Ligjit Organik të Gjykatës, nuk mund të respektohet tashmë si e tillë, konkretisht me sekuencat 2025, 2028 dhe 2031, pasi sipas interpretimit të këtij paragrafi të shumicës, por jo arsyetimit të munguar të tij, skema e rotacionit do të pësojë ndryshime dhe devijime, për sa vijon: i) një mandat i deklaruar i përfunduar në vitin 2025 është zëvendësuar dhe tashmë është në detyrë edhe gjyqtari i ri, me mandat të plotë 9-vjeçar, referuar vendimit të organit të emërtesës (Mbledhjes së Posaçme të Gjykatës së Lartë), por edhe të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës. Ky mandat i ri, sipas përcaktimit të këtij vendimi të Gjykatës, përfundon në vitin 2034; ii) dy mandatet e tjera të deklaruara të përfunduara, njëri me vendimin nr. 65/2025 të Gjykatës dhe tjetri sipas vendimit të Kuvendit për rishpalljen e vakancës, datë 10.12.2025, në rastin më të mirë do të zëvendësohen në vitin 2026 dhe mandatet 9-vjeçare të gjyqtarëve të rinj kushtetues do të mbarojnë, në rastin më të mirë, në vitin 2035, duke shpërpjesëtuar sërish qoftë vullnetin e kushtetutëbërësit, qoftë rregullin e përtëritjes që, sipas shumicës, ishin udhërrëfyesit dhe orientuesit e saj në këtë vendimmarrje.

32. Duke u futur më në thelbin e arsyetimit të munguar të paragrafit të fundit të pikës 3 të dispozitivit, tashmë në interpretim të momentit të parashikuar *të datës së deklaruar nga Gjykata të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai zëvendëson,* datat e fillimit dhe të mbarimit të mandateve të gjyqtarëve në regjimin tranzitor, edhe pse nuk është arsyetuar nga shumica, e që lidhet edhe me gjyqtarët e shumicës vendimmarrëse, janë si vijon:

33. Për mandatet e gjyqtarëve kushtetues në detyrë, përveç atij që sipas pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës mbaronte në vitin 2025 (mandati që

ushtroi H.Z. si pasuese e V.T.) dhe atij që mbaron në vitin 2028 (mandati që ushtron gjyqtari S.B. si pasues i F.H.), duke iu referuar akteve të emërimit në detyrë dhe vendimeve/shkresave përkatëse të Gjykatës apo organeve të tjera kushtetuese që kanë deklaruar/shpallur/njoftuar fillimin dhe mbarimin e mandateve, në kuptim dhe shtjellim të sa është përcaktuar në paragrafin e fundit të pikës 3 të dispozitivit të vendimit, duhet evidentuar, më së pari, se cilët janë gjyqtarët që kanë zëvendësuar gjyqtarët kushtetues në detyrë.

34. Kështu: *gjyqtarja E.T.,* e dorëhequr në datën 19.09.2024, emërtesë e Kuvendit, ka zëvendësuar në detyrë gjyqtarin V.K., mandati i të cilit ka përfunduar me shkresën/vendimin e Gjykatës më 25.04.2016; *gjyqtarja në detyrë S.B.*, emërtesë e Presidentit, ka zëvendësuar në detyrë gjyqtarin S.B., mandati i të cilit ka përfunduar me shkresën/vendimin e Gjykatës më 25.04.2016; *gjyqtarja H.Z.,* mandati i së cilës ka përfunduar më 10.03.2025 sipas vendimit nr. 84/2024, emërtesë e Gjykatës së Lartë, ka zëvendësuar në detyrë gjyqtaren V.T., mandati i së cilës ka përfunduar sipas vendimit/shkresës së Gjykatës, më 10.03.2017; *gjyqtarja në detyrë M.Xh.,* emërtesë e Presidentit, ka zëvendësuar gjyqtaren e shkarkuar me vendim të organeve të rivlerësimit kalimtar, A.Xh., mandati i së cilës ka përfunduar sipas shkresës së Gjykatës, më 24.10.2018; *gjyqtarja në detyrë F.P.,* emërtesë e Kuvendit, ka zëvendësuar gjyqtarin e shkarkuar me vendim të organeve të rivlerësimit kalimtar, B.D., mandati i të cilit ka përfunduar sipas shkresës së Gjykatës, më 12.12.2018; *gjyqtari në detyrë S.B.,* emërtesë e Gjykatës së Lartë, ka zëvendësuar gjyqtarin e shkarkuar me vendim të organeve të rivlerësimit kalimtar, F.H., por në këtë rast viti i përfundimit të mandatit të këtij gjyqtari është përcaktuar nga dispozita kalimtare kushtetuese, pra viti 2028; *gjyqtari në detyrë I.T.*, emërtesë e Gjykatës së Lartë, ka zëvendësuar gjyqtarin e shkarkuar me vendim të organeve të rivlerësimit kalimtar, G.D., mandati i të cilit ka përfunduar sipas shkresës së Gjykatës, më 14.02.2019; *gjyqtarja në detyrë M.S.,* emërtesë e Kuvendit, ka zëvendësuar gjyqtarin A.B., mandati i të cilit ka përfunduar sipas vendimit të Gjykatës, më 02.05.2022; *Gjyqtari në detyrë G.I.,* emërtesë e Presidentit, ka zëvendësuar gjyqtarin P.K., mandati i të cilit ka përfunduar sipas vendimit të Gjykatës, më 08.04.2022.

35. Edhe pse neni 86 i Ligjit Organik të Gjykatës, në nenin 86, pika 4, ka parashikuar një afat deri në dhjetor 2022 për zbatimin e skemës së rotacionit, kjo dispozitë jo vetëm nuk do duhej të prodhonte më efekte për shkak të natyrës kalimtare, por nuk mund të ishte as bazë ligjore për

vendimmarrjen e Gjykatës, pasi tashmë nga viti 2022 ajo ka humbur edhe aktualitetin e saj. Përmes arsyetimit të vendimit dhe fjalisë së fundit të dispozitivit të shumicës, duke iu referuar saktësisht vendimeve/shkresave, pra akteve zyrtare të prodhuara, përmes të cilave është deklaruar mbarimi i mandatit të secilit gjyqtar paraardhës të gjyqtarëve të Gjykatës në detyrë në regjimin tranzitor, bazuar në paragrafin e fundit të pikës 3 të dispozitivit të këtij vendimi, referuar paragrafit 34 më sipër skema e përtëritjes është devijuar në këtë mënyrë:

36. *Gjyqtares E.T.,* emërtesë e Kuvendit, tashmë e dorëhequr më 19.09.2024, konsiderohet se i ka filluar mandati në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ajo ka zëvendësuar, V.K., pra sipas arsyetimit të shumicës konsiderohet që ka filluar detyrën në datën 25.04.2016, për rrjedhojë konsiderohet tashmë i përfunduar në datën 25.04.2025 (mandati 9-vjeçar), edhe pse ajo është votuar, emëruar nga Kuvendi dhe ka bërë betimin në datën 14.11.2019 për një mandat të plotë 9-vjeçar nga data e betimit.

37. *Gjyqtares në detyrë S.B.*, emërtesë e Presidentit, sipas vendimit nr. 65/2025 konsiderohet se i ka filluar mandati në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ajo ka zëvendësuar, S.B., pra, sipas arsyetimit të shumicës konsiderohet që ka filluar detyrën në datën 25.04.2016, për rrjedhojë konsiderohet i përfunduar në datën 25.04.2025 mandati 9-vjeçar, edhe pse ajo është përzgjedhur dhe emëruar me dekret të Presidentit, duke hyrë në vakancën e krijuar nga shkarkimi i gjyqtarit B.M., i emëruar nga Presidentit për një mandat të plotë 9-vjeçar që ka filluar nga dita e betimit të tij më 15.10.2019.

38. *Gjyqtares në detyrë M.Xh.,* emërtesë e Presidentit, konsiderohet se i ka filluar mandati në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtares që ajo ka zëvendësuar, A.Xh., pra, sipas arsyetimit të shumicës, konsiderohet që ka filluar detyrën në datën 24.10.2018, datë nga e cila do të përllogaritet tashmë afati 9-vjeçar, i cili do të konsiderohet i përfunduar më 24.10.2027.

39. *Gjyqtares në detyrë F.P.*, emërtesë e Kuvendit, konsiderohet se i ka filluar mandati në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ajo ka zëvendësuar, B.D., pra, sipas arsyetimit të shumicës, konsiderohet që ka filluar detyrën në datën 12.12.2018, datë nga e cila do të përllogaritet tashmë afati 9-vjeçar, i cili do të konsiderohet i përfunduar më 12.12.2027.

40. *Gjyqtari në detyrë S.B.,* emërtesë e Gjykatës së Lartë, ka zëvendësuar në detyrë gjyqtarin F.H., por në këtë rast koha e përfundimit të mandatit të tij është përcaktuar nga vetë neni 179, pika 3, i Kushtetutës, që është

viti 2028. Mandati i tij, parashikohet ndër dy mandatet 8- vjeçare, sipas parashikimit të kësaj dispozite kushtetuese kalimtare.

41. *Gjyqtarit në detyrë I.T.,* emërtesë e Gjykatës së Lartë, konsiderohet se i ka filluar mandati në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai ka zëvendësuar, G.D., pra, sipas arsyetimit të shumicës, konsiderohet që ka filluar detyrën në datën 14.02.2019, datë nga e cila do të përllogaritet tashmë afati 9-vjeçar, i cili do të konsiderohet i përfunduar më 14.02.2028.

42. *Gjyqtares në detyrë M.S.,* emërtesë e Kuvendit, konsiderohet se i ka filluar mandati në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ajo ka zëvendësuar, A.B., pra, sipas arsyetimit të shumicës, konsiderohet që ka filluar detyrën në datën 02.05.2022, datë nga e cila do të përllogaritet tashmë afati 9-vjeçar, i cili do të konsiderohet i përfunduar më 02.05.2031.

43. *Gjyqtarit në detyrë G.I.*, emërtesë e Presidentit, konsiderohet se i ka filluar mandati në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai ka zëvendësuar, P.K., pra, sipas arsyetimit të shumicës, konsiderohet që ka filluar detyrën në datën 08.04.2022, datë nga e cila do të përllogaritet tashmë afati 9-vjeçar, i cili do të konsiderohet i përfunduar më 08.04.2031.

44. Mbi këtë linjë të shumicës, e cila është shprehur se ka interpretuar qëllimin e ligjvënësit kushtetues në miratimin e dispozitës kalimtare, duket sikur në rastin e vetëm dy gjyqtarëve, përkatësisht atij emërtesë e Presidentit dhe atij emërtesë e Kuvendit, ligjvënësi kushtetues ka pasur qëllim që të kufizojë kohëzgjatjen e mandatit, edhe pse nuk e ka shprehur një gjë të tillë, çka sipas jurisprudencës kushtetuese nuk është ometim, por tregon thjesht se ai nuk ka dashur (nuk ka pasur vullnet) ta bëjë një gjë të tillë. Po mbi këtë arsyetim, në rastet e tjera, pra të gjyqtarëve që bëjnë pjesë në vendimin e shumicës, të cilët janë në detyrë e që i përkasin trupës në regjimin tranzitor, duket se ligjvënësi kushtetues paska pasur për qëllim të zgjasë kohëzgjatjen e mandateve të tyre përtej momentit kohor kur kanë filluar të ecin ato, që sipas po vetë shumicës nuk mund të jetë veçse data e deklarimit të mbarimit të mandatit (dhe jo një moment tjetër) të gjyqtarit që është zëvendësuar nga secili prej gjyqtarëve në detyrë.

45. Në përfundim, në vlerësimin tim, kjo qasje e shumicës jo vetëm nuk ka dashur të arsyetojë efektet dhe pasojat e këtij interpretimi edhe mbi mandatet e secilit prej anëtarëve të saj, duke shënjuar kështu një standard të dyfishtë në trajtim, por do të shkaktojë në vijim paqartësi dhe një ngërç kushtetues, si për Gjykatën ashtu edhe për vetë organet e emërtesës, në këndvështrim të momentit në të cilin do të duhet të fillojë procedura për

deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarëve në detyrë, i cili, referuar dispozitivit të vendimit të shumicës, është një moment tërësisht i ndryshëm nga ai që ajo ka përcaktuar në arsyetimin e vendimit të saj.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi

Vendim nr. 61, datë 21.10.2025
(V-61/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 21.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (H) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **HISMET DRAZHI**

SUBJEKT I INTERESUAR:
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS,
përfaqësuar nga drejtori Ergyst Skënderi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.
Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Hismet Drazhi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (*ALUIZNI*) (*sot ASHK*) dhe Drejtorisë Vendore të saj, t'i legalizojë objektin "banesë" dhe ta pajisë me leje legalizimi.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2129 (80-2018-2169), datë 04.06.2018, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur që të vazhdojë procesin e legalizimit të objektit "shtëpi banimi njëkatëshe", të ngritur mbi pasurinë e paluajtshme nr. 7/275, zona kadastrale nr. 8210, Tiranë, si dhe ta pajisë kërkuesin me leje legalizimi për këtë objekt. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur në gjykim. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.07.2018 me nr. 31121-03020-86-2018, nr. akti 14591.

3. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit kërkuesi ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së në datën 12.07.2024. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, por për shkak të ngarkesës së madhe dhe akumulimit ndër vite të dosjeve. Sipas asaj gjykate, gjyqtarja relatore ka marrë të gjitha masat e nevojshme, por ajo ka deklaruar se ndodhet në gjykimin e çështjeve të

regjistruara në vitin 2017, ka në ngarkim 2450 dosje dhe çështja i ka kaluar me shortin e datës 08.05.2024.

4. Në datën 06.02.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 01.04.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi çështja e kërkuesit ka 6 vjet e 6 muaj në pritje të gjykimit në gjykatën e apelit, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë interesat kushtetues të kërkuesit, rrethanat e faktit, si dhe nuk janë marrë në analizë aspekte të pasojave të tejzgjatjes së gjykimit të çështjes. Ky vendim është i padrejtë dhe antikushtetues dhe cenon *standardin e arsyetimit të vendimit*.

6. ***Subjekti i interesuar, ASHK-ja***, nuk ka paraqitur argumente në lidhje me pretendimet e kërkuesit por ka vënë në dispozicion praktikën e ndjekur për legalizimin e pasurisë së tij.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së

kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

10. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 08.10.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 06.02.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

11. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

12. Kërkuesi ka pretenduar se çështja e tij ka 6 vjet e 6 muaj në pritje të gjykimit në gjykatën e apelit, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti. Po sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë interesat kushtetues të kërkuesit, rrethanat e faktit, si dhe nuk ka marrë në analizë aspekte të pasojave të tejzgjatjes së gjykimit të çështjes. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Lartë është i padrejtë dhe antikushtetues.

13. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se

në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi me objekt detyrimin e ALUIZNI-t t'i legalizojë objektin "banesë" dhe ta pajisë me leje legalizimi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga pala e paditur. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.07.2018, pra deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual kanë kaluar 7 vjet e 3 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarrje për themelin e saj.

15. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

16. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kritereve: (i) sjellja e kërkuesit; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi.

17. Gjykata thekson se, për sa u përket kritereve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuesit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuesi* në rastin konkret për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij.

18. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ata që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata i referohet edhe qëndrimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Sipas asaj gjykate, një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë, datë 27.05.2025, §§ 111, 118, 122*).

19. Në analizë të kritereve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesi ka të bëjë me pamundësinë e përfundimit të procesit të legalizimit të banesës së tij dhe pajisjen me leje legalizimi. Kjo çështje, për nga natyra e saj, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, bazuar në shkaqet objektive, të parashtruara nga kërkuesi, pra duke pasur parasysh se banesa është e vetmja pasuri që ai disponon, si dhe moshën e tij në pension pleqërie, duket se ata janë specifikë dhe të mjaftueshëm për të provuar se çështja është e një natyre të tillë që interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata**,** në kontekst të rrethanave të çështjes konkrete, si dhe në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga vonesa në gjykim, çmon se është argumentuar dhe provuar rreziku për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve justifikojnë trajtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

20. Në përfundim, Gjykata, duke pasur parasysh periudhën prej 7 vjetësh e 3 muajsh gjatë së cilës çështja është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë vendimi nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024 i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesit, si dhe mundësitë aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata çmon që, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, të urdhërojë detyrimin e asaj gjykate për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.10.2025
Shpallur më 07.11.2025

Vendim nr. 62, datë 23.10.2025
(V-62/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 23.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (F) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **FATOS METUSHI**, përfaqësuar nga avokati Ilir Oboni, me akt përfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Hysen Keta, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2019-5240 (1523), datë 21.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 669, datë 05.12.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2024-1085, datë 11.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar *(ligji organik i Gjykatës)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Fatos Metushi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja me paramendim", të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal *(KP)*, për të cilën, në përfundim të gjykimit të zhvilluar në mungesë të tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 63, datë 23.02.2000 *(vendimi nr. 63/2000)*, e ka dënuar me 25 vjet burg. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga palët dhe në datën 09.03.2000 organi i ndjekjes penale ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e tij.

2. Kërkuesi është arrestuar në shtetin grek, bazuar në urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij, dhe është ekstraduar për në Shqipëri në datën 02.08.2019, ndërsa në datën 03.08.2019 është vënë në dijeni nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e vendimit nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Bazuar në nenin 147 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*, në datën 13.08.2019 ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të fajësisë, duke pretenduar se procedimi penal dhe gjykimi i çështjes penale ishin bërë në kundërshtim me nenet 140, 141 e vijues të KPP-së, që përcaktojnë detyrimin për njoftimin e të pandehurit të lirë ose të paraburgosur, dhe vendimin unifikues nr. 1, datë 15.02.2001 *(vendimi unifikues nr. 1/2001)* të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

3. Me vendimin nr. 62-2019-5240 (1523), datë 21.10.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat, me argumentin se ajo nuk ishte shoqëruar me ankimin, çka sipas nenit 420/1 të KPP-së passillte mospranimin e saj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim.

4. Me vendimin nr. 669, datë 05.12.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e gjetur atë

të drejtë dhe të bazuar në ligj. Sipas kësaj gjykate, neni 420/1 i KPP-së përcaktonte qartësisht detyrimin për shoqërimin e kërkesës për rivendosje në afat me ankimin ndaj vendimit që kundërshtohej, si dhe pasojën në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi, konkretisht mospranimin e kërkesës si rrjedhojë e pamundësisë së gjykatës për të vlerësuar në themel shkaqet e ngritura në të. Po sipas gjykatës së apelit, depozitimi i ankimit nga kërkuesi pas dhënies së vendimit nga gjykata e rrethit dhe tej afatit ligjor të parashikuar nuk e bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për mospranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs dhe më pas ka paraqitur shtesë të tij.

5. Me vendimin nr. 00-2024-1085, datë 11.06.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin marrë në interpretim e në zbatim të drejtë të ligjit. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në shtesën e rekursit për rrëzimin nga gjykatat të kërkesës së tij për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, Kolegji Penal ka vlerësuar se ato nuk mund të merreshin në shqyrtim, pasi i përkisnin një gjykimi tjetër.

6. Në datën 29.01.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 04.02.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

Në procesin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit

7.1. *Së drejtës së aksesit substancial*, si rrjedhojë e mospranimit nga gjykatat e zakonshme të kërkesës së tij për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit dhe mosmarrjes parasysh nga Gjykata e Lartë të pretendimeve të tij kushtetuese për cenimin nga gjykatat e faktit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, barazisë së armëve, prezumimit të pafajësisë dhe parimit *in dubio pro reo*.

7.2. *Së drejtës së ankimit*, pasi vendimi nr. 63/2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është marrë në kundërshtim me parashikimet ligjore të njoftimit të të pandehurit të lirë, të paraburgosur ose

të deklaruar në mungesë dhe përcaktimet e vendimit unifikues nr. 1/2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në procesin e rivendosjes në afat, gjykatat duhej të kishin marrë parasysh të drejtën e tij të ankimit ndaj vendimit të fajësisë.

7.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara. Edhe pse në rekurs ishin ngritur pretendime për mosrespektim nga gjykatat e faktit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë ato në shqyrtim dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar, duke u mjaftuar me një arsyetim *de plano*, i cili edhe pse është konsideruar i mjaftueshëm nga kjo Gjykatë dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*, është pranuar vetëm për rastet kur procesi në gjykatat e zakonshme nuk ka shfaqur probleme. Në rastin e tij, Gjykata e Lartë duhej të ishte investuar në shqyrtimin e pretendimeve për shkelje procedurale të parashtruara në rekurs dhe të mbante qëndrim të shprehur për to.

Në procesin penal të themelit

7.4. *Së drejtës për t'u njoftuar për gjykimin, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi ndonëse për periudhën 11.05.1999-23.02.2000 gjykimi i çështjes penale në ngarkim të tij është zhvilluar në praninë e mbrojtësit të caktuar kryesisht, kërkuesi nuk është njoftuar për seancat e zhvilluara në datat 02.04.1999 e 23.04.1999, në shkelje të neneve 140 e 351 të KPP-së dhe vendimit unifikues nr. 354, datë 28.07.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njoftimin e të pandehurit të deklaruar në mungesë.

7.5. *Prezumimit të pafajësisë*, pasi dënimi penal është bazuar vetëm në deklarimet e tij, si person ndaj të cilit zhvilloheshin hetime dhe nuk ka asnjë provë tjetër që provon akuzën. Nënshkrimi i deklarimeve mbi të cilat është bazuar dënimi nuk është bërë prej tij, çka provohet edhe nga aktekspertimi i datës 02.12.2019.

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*,** ka prapësuar:

Për legjitimimin

8.1. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi aktet e përfaqësimit të bashkëlidhura me kopjet e kërkesave të drejtuara Gjykatës përmbajnë mangësi procedurale që cenojnë legjitimitetin e tij. Akti i përfaqësimit të mbrojtëses, e cila ka nënshkruar kërkesën e parë drejtuar Gjykatës, nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 109 të KPP-së, pasi i mungon nënshkrimi i

drejtorit të Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale *(IEVP)*, Peqin, ose vula e këtij institucioni. Pavarësisht se plotësimi i tij është nënshkruar nga kërkuesi dhe mbrojtësi i tij tjetër, Ilir Oboni, akti i përfaqësimit të këtij të fundit ka të njëjtat mangësi si ai i mëparshmi.

Për themelin

8.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial* janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë arsyetuar qartë për mangësitë procedurale në paraqitjen e kërkesës për rivendosjen në afat dhe pasojat që rrjedhin nga kjo. Në ankim, rekurs ose ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument për mangësitë procedurale të konstatuara nga gjykatat. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute dhe rivendosja në afat e së drejtës së ankimit, sipas nenit 420/1 të KPP-së, është e ndryshme nga e drejta për rivendosje në afat, sipas nenit 147 të këtij kodi. Në lidhje me të parën, në nenin 420/1 ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht detyrimin për shoqërimin e saj me ankimin ndaj vendimit penal dhe përmbajtja e kësaj dispozite përmbush kriteret e qartësisë dhe të parashikueshmërisë.

8.3. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së ankimit* janë të pabazuara, pasi ndaj kërkuesit ka qenë caktuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg" dhe ai është larguar nga burgu gjatë trazirave të vitit 1997. Pretendimet për vendimin nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i takojnë ankimit ndaj këtij vendimi, çka përbën akt procedural më vete dhe duhej të ishte paraqitur së bashku me kërkesën për rivendosje në afat. Humbja e së drejtës së ankimit është pasojë e mosveprimeve të kërkuesit, i cili edhe pse kishte në dispozicion mjetin ligjor, nenin 420/1 të KPP-së, nuk ka respektuar kërkesat formale të kësaj dispozite, detyrimi për plotësimin e të cilave është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese. Ankimi ndaj vendimit është paraqitur tej afatit ligjor 10-ditor, çka përbën arsye për mospranimin e kërkesës.

8.4. Pretendimet për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për vendimmarrjet e tyre, Arsyetimi *de plano* i Gjykatës së Lartë është pasojë e mungesës së argumenteve dhe arsyetimit ligjor të kërkesës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka pretenduar se kërkuesi nuk plotëson kriterin e legjitimimit *ratione personae*, pasi aktet e përfaqësimit bashkëlidhur kërkesës drejtuar Gjykatës dhe plotësimit të saj nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 109 të KPP-së, për shkak se u mungon nënshkrimi i drejtorit të IEVP-së, Peqin. Ndërsa, sipas kërkuesit, prapësimet e organit të ndjekjes penale janë të pabazuara, pasi, në kundërshtim nga sa ky organ pretendon, akti i përfaqësimit i datës 04.11.2024 është nënshkruar nga drejtori i IEVP-së, Peqin dhe përmban vulën e këtij institucioni.

11. Neni 27, pika 2, shkronja "ë", i ligjit organik të Gjykatës parashikon se ankimi kushtetues individual duhet të përmbajë nënshkrimin e kërkuesit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe aktin e përfaqësimit të këtij të fundit, ku sipas nenit 109 të KPP-së, akti i përfaqësimit (prokura) jepet me akt noterial ose me shkresë private të vërtetuar nga organet kompetente. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, sipas nenit 70 të Kodit Civil, prokura përbën një akt përmes të cilit, me vullnetin e tij të lirë, i përfaqësuari përcakton karakterin dhe vëllimin e tagrave që i jep përfaqësuesit dhe, sipas nenit 70 të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", mund të hartohet nga noteri edhe në mjediset e IEVP-së, Peqin. Po kështu, neni 111 i KPP-së ka përcaktuar të drejtën e individit që i është kufizuar liria për të paraqitur kërkesa, ankesa dhe deklarata nëpërmjet drejtorit të institucionit. Në interpretim të këtyre dispozitave, Gjykata vë në dukje se në rastin e individit të izoluar, aktet e

paraqitura prej tij duhet të vërtetohen me nënshkrimin e drejtorit të IEVP-së, Peqin.

12. Në këndvështrim të parashikimeve të mësipërme ligjore, në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se ankimi kushtetues individual i datës 29.01.2025 është nënshkruar vetëm nga mbrojtësja e zgjedhur nga kërkuesi, Sonila Çekrezi, ndërsa akti i përfaqësimit nuk është hartuar sipas formës së kërkuar nga ligji. Për këtë shkak, në zbatim të parashikimeve të nenit 27, pika 2, shkronja "ë", të ligjit organik të Gjykatës, kërkuesi është njoftuar për nevojën e plotësimit të kërkesës me aktin e përfaqësimit ose, në mungesë të tij, nënshkrimin e vetë kërkuesit. Në zbatim të kërkesave të Gjykatës, në datën 04.02.2025 kërkuesi ka plotësuar të metat, duke paraqitur kopje të ankimit kushtetues individual të nënshkruar prej tij dhe mbrojtësit të zgjedhur prej tij, Ilir Oboni. Kjo kërkesë është shoqëruar me aktin e IEVP-së, Peqin ("vërtetim") për akomodimin e kërkuesit në këtë institucion, të cilit i është bashkëlidhur edhe akti i përfaqësimit të kërkuesit nga ky avokat. Të dyja këto dokumente mbajnë vulën e IEVP-së, Peqin.

13. Për sa më sipër, në kushtet kur ankimi kushtetues individual është nënshkruar nga vetë kërkuesi, si dhe ai ka qenë palë në gjykimin për të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, Gjykata vlerëson se, në kundërshtim nga sa subjekti i interesuar pretendon, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës.

14. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit organik, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual kërkuesi i ka ngritur më parë, në formë dhe substancë, në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë e përmbush edhe këtë kriter.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit organik të Gjykatës parashikon afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi nr. 63/2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes, është i datës 23.02.2000, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 04.02.2025, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1085, datë 11.06.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

16. Gjykata thekson se paraqitja e një kërkese për rivendosje në afat, që nuk pranohet nga gjykatat e zakonshme, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të procesit gjyqësor penal. Ndaj, në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, me objekt kundërshtimin e procesit të rivendosjes në afat, individët nuk mund të ngrenë pretendime për procesin gjyqësor penal të themelit, duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit organik të saj referuar procesit të zhvilluar lidhur me mjetin e jashtëzakonshëm të ankimit, të rrëzuar nga gjykata si të pabazuar në ligj. Në këtë kontekst, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar për gjykimin, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimit të prezumimit të pafajësisë, të cilat parashtrohen ndaj procesit penal në ngarkim të tij, nuk mund të merren në shqyrtim, pasi janë paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor 4-mujor. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve për procesin gjyqësor lidhur me kërkesën për rivendosje në afat, sipas informacionit të marrë në rrugë elektronike nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi i kësaj gjykate që ka përmbyllur këtë proces është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 16.10.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 04.02.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për procesin gjyqësor që ka rrëzuar kërkesën e tij për rivendosje në afat.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial*, *së drejtës së ankimit* dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues. Duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Gjykata çmon të analizojë çështjen në vijim në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial* në procesin gjyqësor për shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial

18. Kërkuesi ka pretenduar se mospranimi nga gjykatat i kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të dhënë në mungesë të tij, i ka cenuar

të drejtën e aksesit substancial. Po sipas kërkuesit, vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara dhe, edhe pse në rekurs ishin ngritur pretendime për mosrespektimin nga gjykatat e faktit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë ato në shqyrtim e nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar, duke u mjaftuar me një arsyetim *de plano*. Kjo gjykatë duhej të ishte investuar në shqyrtimin e pretendimeve për shkelje procedurale të parashtruara në rekurs dhe të mbante qëndrim të shprehur për to.

19. Prokuroria e Përgjithshme ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit për shkeljen e së drejtës së aksesit substancial janë të pabazuara, pasi ai ka pasur dijeni për procesin penal, duke qenë se ndaj tij ishte caktuar masa e sigurimit "Arresti në burg", dhe është larguar nga burgu gjatë trazirave të vitit 1997. Humbja e së drejtës së ankimit ndaj vendimit penal të fajësisë është pasojë e mosveprimeve të kërkuesit, i cili, edhe pse kishte në dispozicion mjetin ligjor, nenin 420/1 të KPP-së, nuk ka respektuar kërkesat formale të kësaj dispozite. Ankimi ndaj vendimit penal është paraqitur tej afatit ligjor 10-ditor, edhe pse përmbajtja e nenit 420/1 të KPP-së plotëson kriteret e qartësisë dhe të parashikueshmërisë. Ndërsa pretendimet për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për vendimmarrjet e tyre. Arsyetimi *de plano* i Gjykatës së Lartë është pasojë e mungesës së argumenteve dhe arsyetimit ligjor të kërkesës.

20. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik *(shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 6, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Gjykata ka pranuar, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt ligjor

përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po sipas Gjykatës, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Në lidhje me rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 420/1 i KPP-së synon mbrojtjen dhe administrimin e mirë të drejtësisë, përmes plotësimit të kushteve formale të kërkesës për rivendosje në afat. Sipas Gjykatës, norma ligjore, në mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit nga gjykatat, plotëson kriterin e qartësisë dhe të parashikueshmërisë, ndaj dhe një kërkues, përmes përfaqësuesit ligjor, është i qartë paraprakisht për plotësimin e kushteve dhe konkretisht të detyrimit për t'i bashkëlidhur kërkesës aktin e kërkuar nga ligji, sipas formës dhe mënyrës së kërkuar *(shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Në vështrim të jurisprudencës së mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim nëse vendimmarrja e gjykatave të zakonshme i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit substancial, si dhe nëse interpretimi prej tyre i nenit 420/1 të KPP-së ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që bie ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë.

24. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 420/1, pika 1, të KPP-së, Gjykata vëren se palët rivendosen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore. Po sipas kësaj dispozite, kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet së bashku me ankimin dhe pasoja që parashikohet kur nuk shoqërohet me ankim është mospranimi i kërkesës për rivendosje në afat. Ndërsa sipas pikës 2, kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të

nenit 351 të këtij kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

25. Në rastin konkret, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja me paramendim", shkak për të cilin është arrestuar, duke u caktuar ndaj tij masa e sigurimit "Arresti në burg" nën të cilën ka qëndruar nga data 19.02.1997 deri në datën 13.03.1997 të hapjes së IEVP-ve për shkak të trazirave, kur dhe është larguar jashtë vendit *(shih faqet 141-142 të dosjes gjyqësore nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier)*. Në këtë situatë, procesi gjyqësor penal është zhvilluar në mungesë të tij e në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht dhe në përfundim të gjykimit kërkuesi është dënuar me 25 vjet burgim me vendimin nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që ka marrë formë të prerë për shkak se nuk është ankimuar. Ai është arrestuar në shtetin grek nga ku është ekstraduar për në Shqipëri në datën 02.08.2019 dhe në vijim ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit penal të dënimit, duke pretenduar se gjykimi ishte bërë në mungesë e pa dijeninë e tij, në kundërshtim me parashikimet e neneve 140 e 141 të KPP-së dhe vendimin unifikues nr. 1/2001 të Gjykatës së Lartë.

26. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mospranimin e kërkesës, me argumentin se ajo nuk ishte shoqëruar me ankimin ndaj vendimit penal nr. 63/2000 të saj, për të cilin kërkohej rivendosja në afat, kusht ky i domosdoshëm, sipas parashikimeve të nenit 420/1, pika 1, të KPP-së. Vendimi i gjykatës së rrethit është vlerësuar i drejtë në thelb nga gjykata e apelit, e cila ka vënë në dukje se ankimi ndaj vendimit nr. 63/2000 ishte depozituar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën 29.10.2019, pra 8 ditë pas datës 21.10.2019 të dhënies së vendimit objekt ankimi dhe tej afatit të parashikuar nga neni 420/1 i KPP-së. Po sipas gjykatës së apelit, mosshoqërimi i kërkesës me ankimin dhe pretendimet ndaj vendimit të çështjes penale të themelit bënte që gjykata të ishte në pamundësi të vlerësonte në themel shkaqet e ngritura për atë vendim dhe paraqitja e ankimit pas dhënies nga gjykata e rrethit të vendimit për kërkesën për rivendosje në afat, nuk e bënte të cenueshëm vendimin e kësaj të fundit. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë zbatuar dhe interpretuar drejt ligjin procedural.

27. Në analizë të vendimmarrjeve gjyqësore përkundrejt parashikimeve ligjore të nenit 420/1 të KPP-së, Gjykata vëren se mospranimi nga gjykatat e zakonshme të kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit është rrjedhojë e mosveprimeve në përputhje me përcaktimet ligjore nga ana e kërkuesit. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se aktet normative marrin fuqi juridike pasi botohen në Fletoren Zyrtare dhe prezumimi *"nemo censetur ignorare legem"* (askush nuk mund të quhet se nuk e njeh ligjin) gjen zbatim që në momentin e botimit të ligjit në këtë fletore e kalimit të afatit të caktuar pas botimit, si kusht i domosdoshëm për hyrjen e tij në fuqi *(shih vendimet nr. 47, datë 07.07.1999; nr. 3, datë 23.02.1995 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vlerëson se kërkuesi kishte mundësi, qoftë edhe përmes ndihmës së mbrojtësit, të parashikonte pasojën e mospranimit të kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në zbatim të dispozitave të lartpërmendura të KPP-së, si rrjedhojë e mosshoqërimit të saj me ankimin ndaj vendimit gjyqësor të themelit.

28. Për sa më lart, duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë që neni 420/1 i KPP-së synon, e balancuar kjo me interesat e kërkuesit, i cili me nismën e tij vë në lëvizje gjykatën, Gjykata çmon se interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë nenit 420/1 të KPP-së nuk është arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Po kështu, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, këto gjykata kanë arsyetuar vendimmarrjet e tyre, duke dhënë përgjigje të arsyetuara për shkakun ligjor të mospranimit të kërkesës për rivendosje në afat, konkretisht mosshoqërimin e saj me ankimin ndaj vendimit penal, si kusht i domosdoshëm për të vijuar me shqyrtimin e themelit të pretendimeve. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara.

29. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, për rrjedhojë rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.10.2025
Shpallur më 04.12.2025

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 5 (F) 2025 të Regjistrit Themeltar, me kërkues Fatos Metushin, në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se pretendimet e kërkuesit për vendimmarrjen e gjykatës që ka shqyrtuar kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, janë të bazuara, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës dhe shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1085, datë 11.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë.

2. Kërkuesi, edhe pse në objekt të kërkesës ka kundërshtuar formalisht vetëm vendimet gjyqësore të dhëna në lidhje me kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, pretendimet e tij i ka shtrirë edhe për procesin gjyqësor të themelit të çështjes penale, në të cilin, me vendimin nr. 63, datë 23.02.2000 *(vendimi nr. 63/2000)* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ai është dënuar me 25 vjet burgim. Ky proces gjyqësor është zhvilluar në mungesë të kërkuesit dhe në prani të një avokati të caktuar kryesisht nga gjykata. Pas kalimit të afatit të ankimit, ai vendim ka marrë formë të prerë në datën 09.03.2000 dhe organi i prokurorisë ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e tij. Kërkuesi në vijim është arrestuar në shtetin grek, bazuar në urdhrin e arrestit ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij, dhe është ekstraduar në Shqipëri në datën 02.08.2019, ndërsa në datën 03.08.2019 ai është vënë në dijeni nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e dënimit me burgim të caktuar me vendimin nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

3. Në datën 13.08.2019, kërkuesi, bazuar në nenin 147 të KPP-së, ka paraqitur në gjykatë një kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit penal të dënimit të tij. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2019-5240 (1523), datë 21.10.2019, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkese, me arsyetimin se ajo nuk është shoqëruar me aktin e ankimit kundër vendimit për të cilin kërkohej rivendosja në afat e së drejtës së ankimit, çka sipas nenit 420/1 të KPP-së passillte mospranimin e kërkesës. Megjithëse kërkuesi ka paraqitur ankim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 669, datë 05.12.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të drejtë përfundimin e asaj gjykate për interpretimin dhe zbatimin e pikës 1 të nenit 420/1 të KPP-së. Ajo gjykatë, po ashtu, ka

arsyetuar se depozitimi i ankimit nga kërkuesi pas dhënies së vendimit nga gjykata e shkallës së parë dhe tej afatit ligjor të parashikuar nuk e bënte të cenueshëm vendimin e kësaj të fundit për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Kurse për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1085, datë 11.06.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së dhe se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin marrë në interpretim e në zbatim të drejtë të ligjit.

4. Në datën 29.01.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të dhëna në procesin gjyqësor për kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ankim, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 04.02.2025.

5. Në këtë ankim kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së njoftimit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, parimit të barazisë së armëve dhe atij të prezumimit të pafajësisë, pretendime këto që i adresohen procesit gjyqësor për themelin e çështjes penale, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues individual. Pavarësisht kësaj, duke pasur parasysh natyrën e këtyre pretendimeve, Gjykata do të duhej t'i mbante në vëmendje në funksion të procesit tjetër gjyqësor objekt i këtij gjykimi, që ka vendosur për kërkesën për rivendosjen në afat, konkretisht në këndvështrim të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial.

6. Shumica ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial, është i pabazuar, me arsyetimin se duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë që neni 420/1 i KPP-së synon, e balancuar kjo me interesat e kërkuesit, i cili me nismën e tij vë në lëvizje gjykatën, interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë kësaj dispozite ligjore nuk është arbitrar në këndvështrimin kushtetues dhe se në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, këto gjykata kanë arsyetuar vendimmarrjet e tyre, duke dhënë përgjigje të arsyetuara për shkakun ligjor të mospranimit të kërkesës për rivendosjen në afat, konkretisht mosshoqërimin e saj me ankimin ndaj vendimit penal, si kusht i domosdoshëm për të vijuar me shqyrtimin e themelit të pretendimeve (*shih paragrafin 28 të vendimit*). Mbi këtë bazë shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit.

7. Për përfundimin si më lart dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje, ne, si gjyqtarë në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm, duke vlerësuar se ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe, për pasojë, kërkesa e tij, për sa i përket shfuqizimit të vendimit nr. 00-2024-1085, datë 11.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duhej të pranohej.

8. Në rastin konkret, vlerësojmë se është i zbatueshëm vetëm neni 420/1 i KPP-së, i shtuar me ligjin nr. 35/2017, sipas të cilit: "*1. Palët rivendosen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore. Kërkesa shoqërohet së bashku me ankimin, me pasojë mospranimi. 2. Kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351, të këtij Kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin. 3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë dhe për çdo shkallë të procedimit ...*".

9. Kjo dispozitë ka përcaktuar kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës, konkretisht formën, subjektin dhe afatin. Nga ana tjetër, ajo ka parashikuar qartësisht edhe pasojën në rastin kur nuk plotësohen këto kërkesa ligjore. Dispozita kërkon paraqitjen e një kërkese formale për rivendosjen në afat të ankimit, të shoqëruar me ankimin, i cili sigurisht duhet të plotësojë kriterin formal, sikurse kërkon edhe neni 412 i KPP-së. Megjithatë, kjo dispozitë, ndryshe nga sa kanë vepruar gjykatat e zakonshme, nuk mund të interpretohet se përjashton mundësinë e përfshirjes së ankimit (elementeve formale të tij) brenda kërkesës për rivendosjen në afat, situatë e cila do të kënaqte atë kërkesë të ligjit për formalizimin e ankimit në funksion të miradministrimit të drejtësisë.

10. Duke iu referuar akteve bashkëlidhur kërkesës në shqyrtim, rezulton se kërkuesi ka paraqitur kërkesë formale për rivendosjen në afat, por pa e shoqëruar atë me një akt tjetër formal të ankimit kundër vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj. Megjithatë, referuar përmbajtjes së kërkesës, krahas pretendimeve për rivendosjen në afat të ankimit, rezulton që kërkuesi të ketë parashtruar edhe pretendime për vendimin penal të dënimit të tij me burgim, për të cilin kërkonte të rivendosej në afat, konkretisht mohimin atij të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale penale në lidhje me njoftimin e të pandehurit dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij, pa pasur ai

dijeni, në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Po kështu, edhe në parashtrimet me shkrim gjatë shqyrtimit të kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, në funksion të pretendimit si më lart, kërkuesi ka evidentuar dhe analizuar njoftimet e bëra për të, sikundër edhe kuadrin ligjor përkatës dhe jurisprudencën unifikuese, duke konsideruar se nuk i është garantuar e drejta për proces të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Në këtë rast, ai ka shtuar edhe një pretendim tjetër, për sa i përket marrjes së provave në kundërshtim me ligjin dhe mungesën e provave për fajësinë e tij.

11. Të njëjtat pretendime si më lart kërkuesi i ka parashtruar edhe në apelin e tij kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit. Përpos kësaj, pretendimet për vendimin penal të dënimit të tij me burgim, për të cilin kërkonte të rivendosej në afat, kërkuesi i ka parashtruar edhe në një akt të veçantë, të cilin e ka paraqitur në vijim të ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

12. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 6, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë kuptim, shumica duhej të ndalej në mënyrën sesi është interpretuar dhe zbatuar neni 420/1 i KPP-së nga gjykatat e zakonshme që kanë shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit dhe nëse kjo mënyrë ka cenuar të drejtat kushtetuese të kërkuesit. Kjo çështje merr veçanërisht rëndësi, duke pasur parasysh dy fakte me natyrë kushtetuese: i) procesi gjyqësor i dënimit penal të kërkuesit është bërë në mungesë dhe ai nuk ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtat e tij kushtetuese; ii)

pretendimet, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, përveç edhe me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe atij për të mos u deklaruar fajtor mbi prova të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

14. Për nga natyra e pretendimeve dhe natyra e procesit gjyqësor në tërësinë e tij, gjykatat e zakonshme nuk duhej të mbanin një qasje të tillë formaliste, por duhej të ushtronin funksionin e tyre kushtetues dhe ligjor, duke synuar të drejtën. Gjykatat e zakonshme kanë detyrimin që interpretimi që u bëjnë dispozitave ligjore gjatë zbatimit të tyre të shkojë drejt mbrojtjes të të drejtave të individit, veçanërisht atij që është dënuar e gjykuar në mungesë dhe nuk ka pasur asnjë mundësi të mbrohet ose të parashtrojë qëndrimin e tij. Të tilla qëndrime të gjykatave të zakonshme (duke pasur parasysh, ritheksojmë, se në kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit kërkuesi ka parashtruar edhe elementet formale të ankimit kundër vendimit penal të dënimit me burgim të tij) kthehen në kufizuese të të drejtave të individit dhe vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor.

15. Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj është shprehur se fakti që aplikanti ishte në gjendje të paraqiste çështjen e tij përpara një gjykate, nuk përmbush domosdoshmërisht në vetvete kërkesat e nenit 6/1 të KEDNJ-së. Rregullat që disiplinojnë hapat formalë që duhen ndërmarrë për paraqitjen e një ankimi synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë *(shih Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee kundër Greqisë, datë 16.11.2001; Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, datë 19.12.1997; Saez Maeso kundër Spanjës, datë 09.11.2004).* Gjykatat kanë detyrimin që të sillen në atë mënyrë që të tilla kërkesa të mos e humbasin qëllimin e tyre dhe individit të mos i cenohet në thelb edhe e drejta për një mjet juridik efektiv. Në këtë kuptim, qasja e gjykatave në rastin konkret, duke verifikuar formalisht paraqitjen e kërkesës, pa u ndalur në leximin e saj tërësor, ka cenuar në thelb të drejtën e aksesit substancial të kërkuesit në gjykatë, për më tepër në kushtet kur ai nuk ka në dispozicion asnjë mjet tjetër juridik për të kërkuar rivendosjen e të drejtave të cenuara.

16. Duke pasur parasysh qëndrimin e gjykatave të zakonshme, në kuptim të pozicionit e funksionit të saj sipas nenit 141 të Kushtetutës, i takonte Gjykatës së Lartë që t`i jepte një interpretim të drejtë normës ligjore në kuptim të zbatimit të saj, në rastin konkret në zbatim të parimit të subsidiaritetit, pasi, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata e Lartë, në arsyetimin e saj, ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, në një kohë kur kjo e fundit, nga njëra anë, ka parashtruar si argument për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, pikërisht mosparaqitjen nga kërkuesi të aktit formal të ankimit, ndërkohë që, nga ana tjetër, në arsyetimin e vendimit të saj, ka evidentuar edhe pretendimet e kërkuesit ndaj vendimit penal të dënimit të tij me burgim, sikurse ato ishin pasqyruar në ankimin e tij formal kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por edhe në kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

18. Nga ana tjetër, edhe shumica duhej të kishte evidentuar në rastin konkret problematikat që shoqërojnë këtë çështje, që në nivel kushtetues kanë sjellë mohimin e të drejtave të kërkuesit për t`u mbrojtur në procesin penal të dënimit të tij me burgim. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar gjerësisht se i gjykuari në mungesë duhet të ketë të gjitha mundësitë që të kundërshtojë procesin penal ndaj tij, duke iu garantuar çdo e drejtë që buron nga dispozitat kushtetuese. Megjithatë, shumica nuk arriti të shkojë përtej vlerësimit formal të kritereve ligjore që kanë bërë edhe gjykata e zakonshme. Në vlerësimin tonë, të tilla çështje janë të rëndësishme jo vetëm për sa u përket të drejtave që kërkohen të mbrohen dhe që vihen në diskutim, por ato i japin mundësinë kësaj Gjykate të zgjerojë këndvështrimin dhe mbrojtjen kushtetuese të individit, veçanërisht kur bëhet fjalë për kufizimin e lirisë personale.

19. Në përfundim, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë nenit 420/1 të KPP-së duket i paarsyeshëm, duke i cenuar kërkuesit të drejtën për akses substancial. Për pasojë, pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial është i bazuar, ndaj Gjykata duhej të vendoste pranimin pjesërisht të kërkesës dhe, për rrjedhojë, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1085, datë 11.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e kësaj çështjeje për rishqyrtim po në atë gjykatë.

Anëtarë: Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi

Vendim nr. 63, datë 23.10.2025
(V-63/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 23.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (U) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ULJANA JESHILI**, **ERIND JESHILI**, përfaqësuar nga avokate Arjola Sheri Abdyli, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
BYROJA SHQIPTARE E SIGURIMIT, përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive, Anila Hoxha.
SHOQËRIA E SIGURIMEVE "INSIG" SH.A., përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, Kadri Morinaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2029 (280), datë 15.05.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Uljana Jeshili (*kërkuesja e parë*) dhe kërkuesit Erind Jeshili *(kërkuesi i dytë)*, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Byrosë Shqiptare të Sigurimit (*BSHS*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Shoqërisë së Sigurimeve "INSIG" sh.a. (*shoqëria INSIG*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit E.J., përkatësisht bashkëshortja dhe djali i tij, i cili ka humbur jetën si pasojë e një aksidenti automobilistik, të ndodhur në datën 27.08.2008, në Tiranë.

2. Duke qenë se mjeti shkaktar i aksidentit nuk ka qenë i siguruar në asnjë nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në treg, kërkuesja e parë, personalisht dhe si përfaqësuese e djalit të saj të mitur në atë kohë, kërkuesit të dytë, i është drejtuar BSHS-së, si subjekti i përcaktuar me ligj për përgjegjësinë ndaj të tretëve në rastet kur mjeti motorik shkaktar i aksidentit nuk është i siguruar. Në vijim, BSHS-ja ia ka deleguar kompetencat shoqërisë së sigurimit, e cila ka bërë përllogaritjen e vlerës së dëmit në shumën totale 9.680. 782 lekë. Kjo shumë është tërhequr nga kërkuesja e parë.

3. Më pas, në datën 20.06.2011, kërkuesja e parë ka nënshkruar një deklaratë noteriale, me anë të së cilës ka deklaruar se është dakord me shumën e dëmshpërblimit dhe se nuk ka asnjë pretendim tjetër financiar ndaj shoqërisë së sigurimit lidhur me aksidentin e ndodhur.

4. Pas më shumë se dy vjetësh kërkuesja e parë i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar diferencën e dëmit real pasuror dhe jopasuror të pësuar për shkak të aksidentit, më palë të paditura shoqërinë INSIG dhe BSHS-në. Gjatë gjykimit në shkallë të parë është futur në gjykim në cilësinë e personit të tretë, ndërhyrës kryesor, edhe kërkuesi i dytë. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10174, datë 23.10.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se fakti që kërkuesja e parë ka pranuar si detyrim shumën 9.690.782 lekë nëpërmjet deklaratës noteriale, duke deklaruar se nuk ka asnjë pretendim tjetër financiar lidhur me ngjarjen, nënkupton se detyrimi i palës së paditur mbi

çdo shumë tjetër tej asaj të pranuar si të tillë, është shuar, duke u njohur si detyrim i ri ai në shumën e pranuar dhe të ekzekutuar.

5. Për ankimin e kërkueses së parë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2361, datë 24.11.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe detyrimin e palës së paditur për t'u paguar kërkuesve diferencën e dëmit të pësuar, në shumën 8.862.470 lekë. Sipas asaj gjykate, shuma e dhënë nga shoqëria e sigurimit përmban vetëm dëmin pasuror, ndërsa në bazë të vendimit unifikues nr. 12, datë 13.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 12/2007*), është zgjeruar përmbajtja e llogaritjes së dëmit për këto raste, duke përfshirë edhe dëmin jopasuror. Sipas gjykatës së apelit, pala e paditur i ka përqendruar pretendimet në ekzistencën e deklaratës noteriale, të cilën e ka cilësuar si joligjore. Pretendimi për parashkrimin e padisë, vijon ajo, me të drejtë nuk është marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë. Kundër atij vendimi kanë paraqitur rekurs shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja.

6. Në datën 15.05.2024 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit rekurset e subjekteve të interesuara, shoqërisë së sigurimit dhe BSHS-së dhe me vendimin nr. 00-2024-2029 (280) ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të gjykatës së shkallës së parë.

7. Në datën 29.01.2025 kërkuesit, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 31.01.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 04.04.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesit*****,** në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se u është cenuar e *drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1. *E drejta e aksesit* e lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Lartë, e cila është vetëm dy faqe, nuk janë analizuar, arsyetuar dhe shtjelluar faktet dhe ligji ku është bazuar ajo gjykatë për marrjen e vendimit të saj. Në atë vendim nuk janë analizuar dhe interpretuar as pretendimet e palëve në dy shkallët më të ulëta të gjykimit. Vendimi i Gjykatës së Lartë, rrjedhimisht edhe ai i shkallës së

parë, i cili është lënë në fuqi, janë në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil (*KC*), pasi kërkuesve u është shpërblyer vetëm dëmi pasuror i pësuar nga aksidenti, por nga gjykimi ka rezultuar se dëmi real i pësuar është më i madh se shuma e dhënë. Ato gjykata, edhe pse e kanë marrë në analizë vendimin unifikues nr. 12/2007, e kanë anashkaluar atë, me pretendimin se vetë kërkuesja e parë, nëpërmjet deklaratës noteriale, ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë pretendim tjetër. Ky interpretim është i pabazuar në ligj, pasi sipas nenit 610 të KC-së marrëveshja që paraprakisht përjashton/kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj është e pavlefshme, për rrjedhojë ekzistenca e deklaratës noteriale nuk i heq kërkueses të drejtën për të pretenduar pasaktësinë e llogaritjes së dëmit. Ndërsa pretendimi se detyrimi është shuar për shkak të vullnetit të shprehur nga kërkuesja në deklaratën noteriale, nuk qëndron, pasi sipas KC-së, detyrimet lindin nga kontratat ose ligji. Edhe pretendimi i palës së paditur për parashkrimin e padisë nuk qëndron, pasi plotësohen kushtet e nenit 131/a të KC-së për ndërprerjen e afatit të parashkrimit të padisë, i cili, për më tepër, është tre vjet dhe jo dy vjet, siç pretendon pala tjetër, duke qenë se dëmi derivon nga një marrëdhënie jashtëkontraktore.

8.2. *E drejta për t'u dëgjuar,* pasi Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë me praninë e palëve, në mënyrë që të dëgjonte dhe parashtrimet e tyre e më pas të mbante një qëndrim përfundimtar.

8.3. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet ta kishte zgjidhur çështjen duke interpretuar ligjin, pa marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga palët dhe pa mbajtur një qëndrim për to.

9. ***Subjekti i interesuar, BSHS-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

9.1. Në lidhje me *legjitimimin e kërkuesve*, në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, ata i janë drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura, megjithatë ata nuk kanë ushtruar të drejtën e kundërrekursit në Gjykatën e Lartë, në përputhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Për rrjedhojë, kërkuesit kanë legjitimitet pjesor për t'iu drejtuar Gjykatës.

9.2. Në lidhje me *themelin e çështjes*, kërkesa e kërkuesve është e

pabazuar, pasi ata nuk kanë parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme që të mbështesin pretendimet e tyre.

9.3. Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u dëgjuar* nuk qëndron. Sipas nenit 482/1 të KPC-së, shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë bëhet si rregull në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, përveç rasteve të përcaktuara në nenin 482/1 të atij kodi. Procesi në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga palët e paditura në proces, duke u zhvilluar gjykim në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve.

9.4. Edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi ky pretendim nuk mund të mbështetet në numrin e faqeve të vendimit të Gjykatës së Lartë, por duhet të bazohet në argumente konkrete të pretenduara se mungojnë dhe se nuk janë arsyetuar nga ajo gjykatë. Pretendimet për mënyrën e trajtimit të dëmshpërblimit lidhen me çështjet e gjykimit në themel të çështjes dhe, si të tilla, nuk mund të pretendohen përpara kësaj Gjykate, për më tepër që kërkuesit nuk i kanë shteruar mjetet juridike efektive lidhur me to. Çështjet e interpretimit të ligjit janë zgjidhur tashmë nga Gjykata e Lartë. Gjithsesi, në rastin konkret, është kryer përllogaritja e dëmit pasuror dhe jopasuror në përputhje me ligjin e kohës dhe dëmshpërblimi është shlyer tërësisht. Në këtë kuadër, vlen të theksohet se referimi te vendimi unifikues nr. 12/2007 ndodh në rastet kur ka boshllëqe në legjislacion, ndërsa në rastin konkret është i zbatueshëm udhëzimi metodik i trajtimit të dëmeve i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 15.11.2007, mbi bazën e të cilit është bërë përllogaritja.

10. ***Subjekti i interesuar, shoqëria INSIG,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

10.1. Në lidhje me *legjitimimin e kërkuesve*, në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, ata i janë drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura, megjithatë ata nuk kanë ushtruar të drejtën e kundërrekursit në Gjykatën e Lartë, në përputhje me nenin 472 të KPC-së. Për rrjedhojë, kërkuesit kanë legjitimitet pjesor për t'iu drejtuar kësaj Gjykate.

10.2. Në lidhje me *thirrjen e saj si subjekt i interesuar*, shoqëria INSIG prapëson se, siç ka rezultuar edhe gjatë gjykimit, shkaktari i aksidentit nuk ka qenë i siguruar me policë sigurimi për

përgjegjësinë e palëve të treta dhe se institucioni përgjegjës për administrimin e fondit të kompensimit dhe dëmshpërblimin për raste, si rasti konkret, është BSHS-ja, e cila ka personalitetin e saj juridik. Ndërsa shoqëria INSIG është autorizuar nga BSHS-ja për kryerjen e pagesës së dëmit në fjalë dhe nuk ka pasur legjitimitet pasiv për të marrë pjesë në gjykim dhe, rrjedhimisht, nuk mund të jetë subjekt i interesuar në këtë gjykim kushtetues, si dhe as të ngarkohet nga gjykata me detyrime për pagime dëmi të mëtejshme.

10.3. Pretendimet e kërkuesve lidhen me interpretimin e ligjit që janë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Për këto pretendime ata nuk kanë paraqitur argumente kushtetuese.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

11. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se kërkuesit, në cilësinë e familjarëve të afërt të viktimës (bashkëshortja dhe i biri), kanë ngritur padi në gjykatat e zakonshme për të kërkuar diferencën e shpërblimit të dëmit nga humbja e jetës së tij, proces i cili ka përfunduar me vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, ata justifikojnë interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

13. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit

i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

14. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 15.05.2024 dhe sipas shkresës nr. 835/1 prot., datë 21.02.2025, lënda "Kthim përgjigjeje" të asaj gjykate, rezulton se ai është bërë i disponueshëm për palët në datën 26.12.2024, kur është publikuar në faqen zyrtare të saj, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 29.01.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në disa aspekte të saj.

16. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë u ka cenuar të *drejtën për t'u dëgjuar* duke e lidhur atë me formën e gjykimit në dhomën e këshillimit, pasi, sipas tyre, ajo gjykatë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në mënyrë që të dëgjonte dhe parashtrimet e tyre e më pas të mbante një qëndrim përfundimtar për çështjen. Për pasojë, sipas tyre, ajo gjykatë ka keqinterpretuar ligjin material civil për sa i përket shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor për shkak të vdekjes në aksident.

17. Subjekti i interesuar, BSHS-ja, ka prapësuar se ky pretendim nuk qëndron, pasi sipas nenit 482, pika 1, të KPC-së, shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë bëhet si rregull në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, përveç rasteve të përcaktuara po në atë kod. Procesi në Gjykatën e Lartë, sipas këtij subjekti të interesuar, është vënë në lëvizje nga palët e paditura në proces, duke u zhvilluar gjykim në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve.

18. Gjykata konstaton se, bazuar në nenin 482, pika 1, të KPC-së, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Ndërsa në dhomën e këshillimit ajo gjykatë mund të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve vetëm kur Kolegji Civil vlerëson se çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, ose nëse e vlerëson si të nevojshme thirrjen dhe dëgjimin e palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, sipas

përcaktimit të nenit 482/a, pika 1, të po atij kodi. Nisur nga përmbajtja e këtyre dispozitave, Gjykata vëren se, për sa i takon mënyrës së zhvillimit të seancës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka dy mundësi: si rregull, shqyrtimin mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe, përjashtimisht, me praninë e palëve, vetëm për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes (*shih vendimin nr. 9, datë 27.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se shqyrtimi i rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve nuk rezulton të jetë në shkelje të dispozitave procedurale civile, pasi një formë e tillë gjykimi është lejuar nga ligji. Po kështu, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësinë të debatonin ose të jepnin mendimin e tyre më parë. Pavarësisht formës së shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, Gjykata vlerëson se kjo mënyrë e zhvillimit të seancës gjyqësore mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar. Përkundrazi, në këto raste debati i palëve realizohet njësoj, pavarësisht formës së paraqitjes së argumenteve me shkrim, pra përmes shkëmbimit respektiv dhe në kohën e duhur të parashtrimeve, prapësimeve dhe provave dokumentare të paraqitura, të cilave Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje, duke vlerësuar shkaqet dhe bazueshmërinë e tyre në themel (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, Gjykata konstaton se gjykimi në gjykatat e faktit (në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit) është zhvilluar në seancë gjyqësore me praninë e palëve, gjatë të cilave kërkuesve u është krijuar mundësia të marrin pjesë dhe të japin vlerësimin e tyre për çështjet e ligjit. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e kërkuesve në lidhje me procesin e rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar për shkak të formës së shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë.

20. Po në drejtim të legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesit në ankimin kushtetues individual kanë ngritur pretendime për cenimin e së *drejtës e aksesit, standardit të arsyetimit të vendimit* dhe *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, duke i lidhur ato me arsyetimin e Gjykatës së Lartë, e cila, sipas tyre, ka interpretuar në mënyrë të gabuar kuadrin ligjor të zbatueshëm për shpërblimin e dëmeve për shkak të humbjes së jetës nga aksidentet, për rrjedhojë ka arritur në konkluzionin e gabuar se detyrimi për t'u paguar kërkuesve shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga vdekja e familjarit të tyre është

shuar me falje përmes deklaratës noteriale të kërkueses së parë, por duke referuar për këtë në dispozita të KC-së që rregullojnë detyrimet kontraktore dhe, për këtë shkak, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka rrëzuar padinë e tyre.

21. Gjykata evidenton se për të drejtën e jetës, e cila ka qenë objekti i gjykimit në gjykatat e zakonshme, neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) parashikojnë se jeta e personit mbrohet me ligj. Ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se në rast vdekjeje ose dëmtimi fizik të rrezikshëm për jetën, detyrimi pozitiv i shtetit, sipas nenit 2 të KEDNJ-së, duhet të konsiderohet se përfshin edhe krijimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe të pavarur, të aftë për t'i ofruar viktimës dëmshpërblim të përshtatshëm. Në rastet që kanë të bëjnë me shkaktimin e vdekjes nga pakujdesia, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse sistemi ligjor u ofron viktimave ose të afërmve të tyre një mjet juridik në gjykimin civil, qoftë veçmas ose edhe në lidhje me një mjet juridik në gjykimin penal, duke mundësuar përcaktimin e çdo përgjegjësie dhe marrjen e çdo mjeti juridik civil të përshtatshëm (*shih Stanevi k. Bullgarisë, nr. 56352/14, § 51, datë 30.05.2023; Nicolae Virgiliu Tănase k. Rumanisë, nr. 41720/13, datë 25.06.2019, §§ 135, 157-59*).

22. Për sa më sipër, Gjykata, nisur nga thelbi dhe përmbajtja e pretendimeve të kërkuesve, si dhe në konsideratë të faktit se neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë (ku përfshihet edhe e drejta e jetës), nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, çmon që, në rastin konkret, këto pretendime të kërkuesve t`i analizojë në themel në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë

23. Kërkuesit kanë pretenduar se argumenti se detyrimi është shuar për shkak të vullnetit të shprehur nga kërkuesja në deklaratën noteriale, nuk qëndron, pasi, sipas KC-së, detyrimet lindin nga kontratat ose ligji. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se detyrimi për t'u paguar atyre shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor për shkak të vdekjes së familjarit të tyre, është shuar me falje përmes deklaratës noteriale të kërkueses së parë, duke referuar në dispozita që rregullojnë detyrimet kontraktore dhe, për

këtë shkak, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka rrëzuar padinë e tyre. Ai vendim, sipas tyre, përmban analizë të gabuar dhe është në kundërshtim me nenin 610 të KC-së, i cili përcakton se është e pavlefshme marrëveshja që paraprakisht përjashton/kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj. Për rrjedhojë, ekzistenca e deklaratës noteriale nuk i heq kërkueses të drejtën për të pretenduar pasaktësinë e llogaritjes së dëmit. Mbi këtë argument, sipas kërkuesve, është anashkaluar edhe zbatimi i vendimit unifikues nr. 12/2007, edhe pse formalisht ai është analizuar.

24. Subjekti i interesuar, BSHS-ja, ka prapësuar se pretendimet për mënyrën e trajtimit të dëmshpërblimit, sipas saj, lidhen me çështjet e gjykimit në themel të çështjes dhe, si të tilla, nuk janë lëndë për këtë Gjykatë, për më tepër që kërkuesit nuk i kanë shteruar mjetet juridike efektive për këto pretendime. Ndërsa çështjet e interpretimit të ligjit janë zgjidhur tashmë nga Gjykata e Lartë. Sipas këtij subjekti të interesuar, në rastin konkret është kryer përllogaritja e dëmit pasuror dhe jopasuror në përputhje me udhëzimin metodik për trajtimin e dëmeve të Ministrisë së Financave, nr. 24, datë 15.11.2007, ndërsa referimi te vendimi unifikues nr. 12/2007 ndodh në rastet kur ka boshllëqe në legjislacion.

25. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili, në çdo rast, duhet të jetë logjik dhe në tërësinë e tij duhet konsideruar si një unitet, ku pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre.

Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata evidenton se në aksidentin e datës 27.08.2008, në të cilin ka humbur jetën trashëgimlënësi E.J. i kërkuesve, shoqëria INSIG e ka njohur si ngjarje sigurimi dhe ka filluar procedurat e verifikimit dhe të përllogaritjes së shumës së sigurimit. Pas përfundimit të këtyre procedurave ajo i ka ofruar kërkueses së parë shumën 9.690.782 lekë si shpërblim për dëmin e pësuar nga vdekja në aksidentin automobilistik të bashkëshortit të saj, të cilën ajo rezulton që e ka tërhequr. Pas kësaj, në datën 20.06.2011 kërkuesja e parë ka nënshkruar një deklaratë noteriale, me të cilën ka pranuar se është dakord me shumën e marrë dhe se nuk ka pretendime financiare të tjera ndaj shoqërisë INSIG për ngjarjen e sigurimit. Pas më shumë se dy vjetësh nga nënshkrimi i deklaratës noteriale, kërkuesja e parë, edhe në cilësinë e përfaqësueses së kërkuesit të dytë, të mitur, i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar diferencën e dëmit real pasuror dhe jopasuror të pësuar për shkak të vdekjes së familjarit të tyre. Kjo padi është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila ka vlerësuar se detyrimi është shuar, pasi kërkuesja e parë me deklaratën noteriale të datës 20.06.2011 ka pranuar si detyrim shumën e ekzekutuar tashmë, duke mos pasur asnjë pretendim tjetër financiar për ngjarjen, duke nënkuptuar se çdo detyrim tej shumës së pranuar si të tillë është shuar, ndaj nuk mund të kërkohet gjyqësisht. Në arritjen e këtij përfundimi, ajo gjykatë është bazuar në përmbajtjen e nenit 511 të KC-së, sipas të cilit "*deklarata me shkrim e kreditorit për faljen e detyrimit, e shuan atë kur i njoftohet debitorit...*", si dhe të nenit 512 të po atij kodi, i cili përcakton se "*kur debitori ka në dorë dokumentin privat që provon detyrimin, prezumon se ky është shuar me falje*" (*shih faqet 5 dhe 6 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

27. Në të kundërt me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, gjykata e apelit, e vënë në lëvizje me ankimin e kërkueses së parë, ka konkluduar se vendimi i ankimuar është i gabuar, duke arsyetuar se marrëveshja që paraprakisht përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj është e pavlefshme, referuar përmbajtjes së nenit 610 të KC-së. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka çmuar se lëshimi i deklaratës noteriale të datës 20.06.2011 nga kërkuesja e parë, me anë të së cilës ajo pranon shumën

e akorduar nga shoqëria INSIG, duke deklaruar se nuk ka pretendime të mëtejshme, nuk i heq asaj të drejtën që, në rast se konstaton se vlerësimi i dëmit që ka pësuar nuk është i saktë, ta kërkojë atë. Lidhur me masën e dëmshpërblimit, gjykata e apelit ka konstatuar se shuma e dhënë nga shoqëria INSIG përmban vetëm dëmin pasuror, ndërsa ka evidentuar se në bazë të vendimit unifikues nr. 12/2007, për këto raste përfshihet edhe dëmi jopasuror në përllogaritjen e dëmit.

28. Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje me rekurset e subjekteve të interesuara, shoqërisë INSIG dhe BSHS-së, pasi ka evidentuar se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për ligjin e zbatueshëm, gjë që ka kushtëzuar edhe disponimin e tyre për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, ka çmuar ta zgjidhë vetë mosmarrëveshjen, duke konsideruar se çështja ka lidhje me efektet juridike që krijon deklarata noteriale e datës 20.06.2011 në raport me të drejtat dhe detyrimet e palëve në çështjen konkrete. Sipas asaj gjykate, kjo deklaratë është nënshkruar me vullnetin e lirë dhe të pavesuar të kërkueses së parë dhe, si e tillë, nuk mund të evidentohet ndonjë shkak pavlefshmërie, qoftë në drejtim të formës së kryerjes së veprimit juridik, ose të metave të vullnetit të shfaqur nga ajo palë. Në kushtet e vlefshmërisë së një deklarate të tillë, Gjykata e Lartë e ka vijuar analizën e saj në drejtim të përmbajtjes së asaj deklarate, për të përcaktuar nëse duhet të vlerësohet si një mënyrë e shuarjes së detyrimit, sipas neneve 511 dhe 512 të KC-së, ose si një marrëveshje paraprake që kufizon përgjegjësinë e palës debitore, sipas nenit 610 të KC-së. Në këtë drejtim, ajo gjykatë e ka çmuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret plotësohen kushtet e shuarjes së detyrimit nëpërmjet faljes si një mënyrë e parashikuar nga neni 511 i KC-së, i cili parashikon se deklarata me shkrim e kreditorit për faljen e detyrimit e shuan atë kur i njoftohet debitorit, përveçse kur ky i fundit nuk dëshiron të përfitojë nga falja. Ndërsa referimin e gjykatës së apelit tek neni 610 i KC-së për të argumentuar pavlefshmërinë e deklaratës noteriale, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të gabuar, duke vlerësuar se kjo dispozitë (neni 610) gjen zbatim në rastin e marrëveshjeve paraprake për të përcaktuar masën e dëmshpërblimit ndërmjet kreditorit dhe debitorit përpara momentit të ndodhjes së faktit të paligjshëm si burim i lindjes së këtij detyrimi (*shih faqet 10 dhe 11 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi ka konstatuar se çështja objekt gjykimi bazohet në dëmin jashtëkontraktor që rrjedh nga sigurimi i detyrueshëm i mjeteve

motorike dhe se nuk ka të bëjë me një kërkim për shpërblim dëmi që rrjedh nga marrëdhëniet kontraktore, ka vlerësuar se detyrimi është shuar për shkak të faljes, sipas përcaktimeve të nenit 511 të KC-së "Falja e detyrimit".

29. Gjykata rithekson se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet nr. 56, datë 09.11.2023; nr. 6 datë 22.02.2022; nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se në rastin konkret Gjykata e Lartë ka gabuar në përcaktimin e fakteve për deklaratën noteriale të nënshkruar nga kërkuesja e parë më 20.06.2011, për shkak se e ka vlerësuar përmbajtjen e saj si një mënyrë të shuarjes së detyrimit që rrjedh nga marrëdhëniet kontraktore, me bazë ligjore në mbështetje të arsyetimit të saj, nenin 511 të KC-së "Falja e detyrimit", në pjesën IV të atij kodi "Detyrimet", e cila përmban dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet kontraktore dhe detyrimeve që burojnë prej tyre.

30. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë nuk e ka interpretuar ligjin e zbatueshëm në koherencë me rrethanat e çështjes, pasi, megjithëse ka parashtruar se çështja objekt gjykimi lidhet me kërkimin e dëmit jashtëkontraktor që, si i tillë, nuk ka të bëjë me shpërblimin e dëmit që rrjedh nga marrëdhëniet kontraktore (*shih paragrafin 22 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*), me qëllim arritjen e përfundimit të saj në çështjen konkrete, ka referuar dhe analizuar parashikimet ligjore, të cilat rregullojnë detyrimet që burojnë nga marrëdhëniet kontraktore, konkretisht në nenet 511 dhe 512 të KC-së, që i përkasin pjesës IV të atij kodi të titulluar "Detyrimet", duke arritur në përfundimin se detyrimi për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor është shuar nëpërmjet faljes. Për më tepër, Gjykata e Lartë, duke analizuar vlerësimin e gjykatës së apelit lidhur me nenin 610 të KC-së, sipas të cilit "*është e pavlefshme marrëveshja që paraprakisht përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj*", dispozitë kjo që bën pjesë në titullin IV të atij kodi "Detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit", ka arsyetuar se ai gjen zbatim në rastin e marrëveshjeve paraprake për përcaktimin e masës së dëmshpërblimit ndërmjet "kreditorit" dhe "debitorit", që janë palë në marrëdhënie detyrimi. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kjo mënyrë arsyetimi e Gjykatës së Lartë, e cila, nga njëra anë, ka pranuar se ndodhemi përpara shpërblimit të dëmit në një marrëdhënie jashtëkontraktore dhe, nga ana tjetër, u është referuar për zgjidhjen e çështjes dispozitave që rregullojnë marrëdhënie

me natyrë të ndryshme, ato kontraktore, e bën kontradiktor vendimin e saj. "Falja", e parashikuar nga neni 511 i KC-së, si një nga mënyrat e shuarjes së detyrimeve, gjen zbatim kur kreditori i detyrimit heq dorë nga përfitimi i një detyrimi konkret dhe i përcaktuar, gjë që nuk ka ndodhur në rastin e kërkueses, sepse deklarata noteriale nuk ka të evidentuar se cili ka qenë detyrimi i subjektit të interesuar si debitor dhe në cilën shifër ose masë ky detyrim është shuar me falje nga kreditori (kërkuesja). Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se në rast kundërshtimi të vlerës së dëmshpërblimit në këto raste, duhet të jetë gjykata ajo që vendos përfundimisht për vlerën e detyrimit dhe se vetëm përmbushja e tij mund të jetë e aftë të pasjellë shuarjen e detyrimit.

31. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se një interpretim i ligjit i palidhur me faktet konkrete ose abstrakt dhe i larguar prej rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi nuk pajtohet me gjykimin konkret, pasi, në thelb, nuk i shërben zgjidhjes së mosmarrëveshjes në fjalë. Kjo sjell, si pasojë, që pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë të jetë formaliste dhe jokoherente në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese të individit (*shih vendimin nr. 66, datë 03.10.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nën dritën e sa më sipër, Gjykata vë në dukje se për shkak të përcaktimit të gabuar të fakteve për deklaratën noteriale në çështjen e kërkuesve, Gjykata e Lartë, duke mbështetur arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, ka bërë një interpretim abstrakt të ligjit, i cili nuk pajtohet me gjykimin konkret, duke prodhuar një vendim kontradiktor që nuk e zgjidh mosmarrëveshjen në fjalë. Ky arsyetim i Gjykatës së Lartë në drejtim të pasojave që ka sjellë deklarata në shuarjen e detyrimit për shkak të faljes së tij, ka cenuar edhe të *drejtën e aksesit* në gjykim të kërkuesve, për shkak se ata nuk kanë mundur të realizojnë të drejtën e tyre për të kërkuar dhe kundërshtuar masën e dëmshpërblimit për shkak të humbjes së

jetës së familjarit të tyre. Nën këtë optikë, pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë rezulton të jetë formaliste, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së *drejtës për jetën*, të parashikuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, në kuptim të garantimit të së drejtës për dëmshpërblim të përshtatshëm për familjaret e viktimës. Për rrjedhojë, interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës, duke e bërë atë haptazi të paarsyeshëm ose arbitrar.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71/a dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2029 (280), datë 15.05.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.10.2025
Shpallur më 12.12.2025

Vendim nr. 64, datë 23.10.2025
(V-64/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 23.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 11 (R) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **RENATO SINA,** përfaqësuar nga avokat Roland Islami, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Alfred Progonati, me autorizim.
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Genci Gjonçaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 110, datë 18.10.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 19, datë 04.03.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00– 2024 – 1630, datë 03.10.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 224 të ligjit nr. 35/2017, datë 30.03.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", që ka ndryshuar nenin 403, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 15, 17, 18, 32, 35, 36, 42, 49, 78, 116, 124, 125, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", 138, 145, 147, 148, 149 dhe 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Renato Sina *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi)* vetëm për kërkimin për shfuqizimin e nenit 224 të ligjit nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"" *(ligji nr. 35/2017),* që ka ndryshuar nenin 403, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale *(KPP),* duke kërkuar rrëzimin e kërkimit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Nga materialet e dosjes rezulton se midis kërkuesit dhe babait të tij, shtetasit P.S., nga njëra anë, si dhe vëllezërve T.S. dhe E.S., nga ana tjetër, në datën 08.02.2017 ka ndodhur një konflikt për të drejtat e përdorimit të materialeve të inerteve në lumin Drin, tek ura e fshatit Muhur në Dibër. Gjatë mosmarrëveshjes ka pasur shkëmbim zjarri me armë luftarake, nga të cilat është plagosur shtetasi E.S., i cili është dërguar menjëherë në Spitalin Rajonal Dibër. Për shkak të plagëve të marra, shtetasi E.S. ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe pas disa ditësh ka ndërruar jetë. Për këtë ngjarje, Policia Gjyqësore, në kushtet e flagrancës, ka proceduar me arrestimin e të dyshuarve, të kërkuesit dhe të shtetasve P.S. e T.S.

Ndërkohë, nga hetimet paraprake të zhvilluara, ka rezultuar se shtetasi P.S. (babai i kërkuesit) është në lidhje gjinie të afërt (baballarët vëllezër) me shtetasit T.S. dhe E.S.

2. Në këto rrethana Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda *(prokuroria)* ka regjistruar ndaj kërkuesit dhe shtetasve të tjerë P.S. dhe T.S. procedimin penal nr. 48 akti, datë 09.02.2017. Prokuroria i ka akuzuar ata për kryerjen e veprës penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare", të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë (në këtë moment viktima nuk kishte ndërruar ende jetë), sipas neneve 79/c, 25 dhe 22 të Kodit Penal *(KP),* për të cilën parashikohet dënimi jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve të parashikuar nga neni 278, paragrafi i katërt, i KP-së.

3. Prokuroria, pas kryerjes së hetimeve, ka arritur në përfundimin se vetëm kërkuesi ka qenë autor i veprës penale të vrasjes së shtetasit E.S. dhe ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim, duke e akuzuar përfundimisht atë për kryerjen e veprës penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79/c dhe 25 të KP-së, për cilësimin e së cilës ka administruar si prova certifikatat personale të kërkuesit, babait të tij dhe viktimës, si dhe për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake". Ndërsa dy shtetasit e tjerë P.S. dhe T.S. janë akuzuar për veprën penale "Dhuna në familje", të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i parë, i KP-së.

4. Në datën 11.07.2017, sipas kërkesës së prokurorisë, çështja penale i ka kaluar për gjykim Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda *(gjykata e shkallës së parë),* e cila ka caktuar datën 27.07.2017 për zhvillimin e seancës gjyqësore. Ndërkohë, me shkresat e datës 26.07.2017 mbrojtësi i kërkuesit i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë, duke parashtruar tri kërkesa për: (i) shpalljen e moskompetencës lëndore të saj; (ii) ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, si të kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme; (iii) zhvillimin e procesit me procedurën e gjykimit të shkurtuar.

5. Në vijim, seanca gjyqësore e datës 27.07.2017 është shtyrë pas kërkesës së paraqitur nga mbrojtësi i të bashkëpandehurit T.S. Për këtë arsye, gjyqtari relator, mes të tjerave, me shkresën e datës 27.07.2017 ka njoftuar kërkuesin për zhvillimin e seancës gjyqësore në datën 14.09.2017, e cila është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 28.09.2017, për shkak se nuk provohej fakti që i bashkëpandehuri T.S. kishte marrë dijeni të rregullt

për datën dhe orën e seancës. Edhe seanca e datës 28.09.2017 është shtyrë për shkak të mosekzekutimit korrekt të urdhrit të shoqërimit për të bashkëpandehurin T.S. Seanca e radhës u caktua për t'u zhvilluar në datën 12.10.2017.

6. Gjatë seancës së datës 12.10.2017 gjykata e shkallës së parë ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura nga mbrojtësi i kërkuesit dhe ka vendosur: (i) se është kompetente për gjykimin e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesi, të parashikuar në nenin 79/c të KP-së; (ii) rrëzimin e kërkimit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, duke arsyetuar se cilësimi juridik i veprës penale, nëse është i saktë ose jo, si dhe çështje të tjera objekt gjykimi që lidhen me fajësinë ose pafajësinë dhe masën e dënimit nuk mund të shqyrtohen ose disponohen nga gjykata në këtë moment procedural, pasi në fazën e kërkesave paraprake gjykata nuk ka marrë në shqyrtim asnjë provë të paraqitur nga prokurori ose palët në funksion të këtij gjykimi. Nga përmbajtja e procesverbalit të kësaj seance gjyqësore nuk rezulton që gjykata e shkallës së parë të jetë shprehur për kërkesën për gjykimin e shkurtuar, për shkak se nga prokuroria është paraqitur një provë e re dhe me qëllim lënien kohë mbrojtësit të kërkuesit për t'u njohur me të, seanca gjyqësore është shtyrë për në datën 26.10.2017. Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues dhe është caktuar data 02.11.2017 për zhvillimin e seancës së ardhshme gjyqësore.

7. Në seancën e datës 02.11.2017, pasi ka dëgjuar palët, gjykata e shkallës së parë ka vendosur refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke arsyetuar se tashmë (në datën 01.08.2017) kishte hyrë në fuqi ligji nr. 35/2017, me të cilin ishte ndryshuar edhe pika 2 e nenit 403 të KPP-së, duke parashikuar se *"nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm"*, për pasojë duke qenë se për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare parashikohej dënimi jo me pak se 20 vjet burgim ose burgim të përjetshëm, çështja do t'i nënshtrohej procedurës së gjykimit të zakonshëm *(shih faqen 9 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda)*.

8. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 110, datë 18.10.2018, mes të tjerave, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale: (i) "Vrasja me dashje" dhe në bazë të nenit 76 të KP-së, dënimin me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim; (ii) "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i

municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së dhe dënimin me 4 (katër) vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, pas bashkimit të dënimeve, është vendosur dënimi me 20 (njëzet) vjet burgim.

9. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim Prokuroria, duke kërkuar ndryshimin e vendimit vetëm në lidhje me cilësimin e veprës penale për të pandehurin Renato Sina/kërkuesin, duke e deklaruar fajtor për veprat penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare", të parashikuar nga neni 79/c i KP-së dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së, si dhe në bashkim të dënimeve, dënimin me 35 vjet burgim. Ankim ka paraqitur edhe kërkuesi, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për cilësimin juridik të veprës penale, duke pretenduar se duhej të cilësohej si plagosje e rëndë, me pasojë vdekjen, e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, e parashikuar si vepër penale nga nenet 88, pika 2 dhe 19 të KP-së. Për veprën penale të armëmbajtjes pa leje kërkuesi ka kërkuar dënimin me kohën e paraburgimit.

10. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda *(gjykata e apelit),* me vendimin nr. 19, datë 04.03.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga prokuroria për shkak të heqjes dorë prej tij dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 110, datë 18.10.2018 të gjykatës së shkallës së parë për pjesën e deklarimit fajtor të kërkuesit për kualifikimin ligjor të veprës penale "Vrasja me dashje", sipas nenit 76 të KP-së. Gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit vetëm në lidhje me disponimin për masën e dënimit për këtë vepër penale, duke e dënuar kërkuesin me 15 vjet burgim, sipas neneve 76 dhe 48, shkronja "ç" dhe 49 të KP-së. Gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për kërkuesin në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të KP-së, ka vendosur dënimin me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim. Ndaj vendimit, mes të tjerëve, ka ushtruar rekurs edhe kërkuesi, për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1630, datë 03.10.2024, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

11. Kërkuesi në datën 19.12.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 12.02.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

12.1. Gjatë procesit gjyqësor është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës për gjykim të shkurtuar dhe së drejtës për të përfituar uljen me një të tretën e dënimit për shkak të shkeljeve të rënda procedurale*, pasi prokuroria ka gabuar në cilësimin juridik të akuzës në lidhje me faktet, duke rënduar pozitën e kërkuesit. Prokuroria e ka kualifikuar veprën penale për shkak të marrëdhënieve familjare, duke arsyetuar se viktima ishte gjini e afërt me kërkuesin, por në fashikull nuk gjendet asnjë provë për të provuar këtë marrëdhënie. Në kuptim të nenit 16 të KPP-së kërkuesi dhe viktima nuk janë "gjini e afërt". Nga certifikatat familjare rezulton se ata janë kushërinj të brezit të gjashtë. Kërkuesi e ka kryer veprën penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, pasi viktima kishte qëlluar në drejtim të tij me armë "automatik", prandaj vepra duhet të ishte kualifikuar si plagosje e rëndë me pasojë vdekjen, e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Në mënyrë që vepra penale të kualifikohet sipas nenit 79/c duhet që viktima dhe autori të kenë marrëdhënie të posaçme sipas përcaktimeve ligjore. Cilësimi juridik i gabuar i akuzës ka sjellë zbatimin e gabuar të nenit 403 të KPP-së, të ndryshuar. Gjithashtu, ky nen nuk gjen zbatim për rastin konkret, sepse ngjarja ka ndodhur përpara ndryshimeve të KPP-së dhe ligji penal nuk ka fuqi prapavepruese nëse nuk është favorizues për të pandehurin. Për të gjitha këto arsye kërkuesit i është cenuar e drejta për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar.

12.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit për kërkesën për cilësimin e veprës penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme,* sepse gjykatat nuk kanë arsyetuar për kërkesën e kualifikimit të veprës penale si të kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, pasi çdo veprim i kërkuesit ka pasur si qëllim kundërpërgjigjen e sulmit ndaj tij. Kërkuesi ka qëlluar ndaj viktimës, por ka qenë kjo e fundit që ka qëlluar e para. Kërkuesi, megjithëse ka pasur mundësi për të vazhduar sulmin, me vullnetin e tij e

ka ndërprerë atë. Në rastin konkret, edhe nëse do të ishim në kapërcim të kushteve të mbrojtjes së nevojshme, ligjvënësi në nenin 88/b të KP-së ka parashikuar veprën penale të plagosjes së rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Gjatë gjykimit është kërkuar që vepra penale të kualifikohej në kuadër të mbrojtjes së nevojshme sipas nenit 19 të KP-së dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar për këtë kërkesë, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e barazisë mes palëve.

12.1.3. *Parimit të mosgjykimit pa ligj,* pasi gjykata u ka dhënë fuqi prapavepruese ndryshimeve të nenit 403, pika 2, të KPP-së, në shkelje edhe të vendimit nr. 4, datë 27.03.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke cenuar disa parime, si: fuqia prapavepruese e ligjit, *ex post facto* dhe *in mitius*, *lex retro agit in mitius.* Duke qenë se gjykimi kishte filluar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 2017 të KPP-së, gjykatat nuk mund të rrëzonin kërkesën për gjykim të shkurtuar vetëm me pretendimin se në kohën e shqyrtimit të kërkesës kishte ndryshuar neni 403, pika 2, i KPP-së. Në rastin konkret ligji nuk është favorizues për kërkuesin dhe cenon edhe të drejtën për gjykim të shkurtuar. Kërkuesit i është cenuar e drejta për gjykim të shkurtuar vetëm si rezultat i akuzës së gabuar të prokurorisë, që është pranuar edhe nga prokuroria e apelit, pasi ka hequr dorë nga ankimi, në kushtet kur gjykata kishte vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të akuzës. Në nenin 3 të KP-së parashikohet se kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

12.1.4. *Parimit të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit dhe parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë vendime në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë, konkretisht me vendimin nr. 308, datë 20.11.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me elementin volitiv të të pandehurit dhe mundësinë e ardhjes së pasojës për të bërë dallimin midis vrasjes me dashje të mbetur në tentativë dhe plagosjes së rëndë me dashje, duke cenuar edhe parimin e

sigurisë juridike. E drejta për t'u trajtuar i barabartë është cenuar nga gjykatat më të ulëta, që nuk kanë arsyetuar për llojin e sulmit që i ka ndodhur kërkuesit dhe babait të tij, si dhe kundërpërgjigjen që ka bërë ai ndaj këtij sulmi të padrejtë. Gjykata duhet ta trajtojë cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit për dy shkaqe: (i) arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit nuk merret në shqyrtim cilësimi juridik i akuzës kur provueshmëria juridike e akuzës në rastin konkret nuk kërkon hetim; (ii) Gjykata e Lartë, në një rast tjetër, në të njëjtat rrethana ligjore, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Gjithashtu, nisur nga fakti se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje këtij pretendimi, Gjykata duhet ta trajtojë atë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, gjykimin pa ligj dhe të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ligjor për shkak të sjelljes të të bashkëpandehurit T.S., që ka pasur edhe cilësinë e të dëmtuarit nga vepra penale.

12.2. *Gjykatat kanë zbatuar gabim nenin 152 të KPP-së (çmuarja e provave)*, pasi kanë keqzbatuar këtë dispozitë lidhur me çmuarjen e provave, si dhe nuk kanë arsyetuar për kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e kërkuesit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, duke e rikualifikuar në kuadër të mbrojtjes së nevojshme. Gjykatat duhet të arsyetonin vendimin duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi nuk ka pasur si qëllim privimin e sulmuesit nga jeta, por vetëm për të zmbrapsur sulmin e atëçastshëm, të rrezikshëm dhe të kundërligjshëm që i ishte drejtuar atij. Në rastin konkret, duke u nisur nga domosdoshmëria që kishte kërkuesi për të qëlluar mbi viktimën si rezultat i goditjes në mënyrë të vazhdueshme me automatik nga ai, intensiteti i goditjeve me pistoletë dhe zonat ku janë përqendruar dëmtimet tek trupi i viktimës janë të tilla që duhet të orientonin gjykatat drejt ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale.

12.3. *Neni 224 i ligjit nr. 35/2017, që ka ndryshuar nenin 403, pika 2, të KPP-së (neni 403, pika 2, i KPP-së, i ndryshuar)*, cenon:

12.3.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, pasi i heq mundësinë të pandehurit t'i kërkojë gjykatës zbatimin e kritereve ligjore të procedurës të gjykimit të shkurtuar. Dispozita bie ndesh edhe me nenin 145, pika 1, të Kushtetutës, pasi ky rregullim

ka penguar gjykatat në dhënien e drejtësisë, duke cenuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

12.3.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë,* sepse gjykimi i veprave penale, për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, fillon duke e paragjykuar cilësimin juridik të veprës penale pa kryer hetim e gjykim për kërkesën e prokurorit, por duke e marrë atë të mirëqenë e duke rënduar pozitat e të pandehurit në gjykim. Kërkuesi është deklaruar fajtor jo për veprën penale për të cilën akuzohej, por për atë të vrasjes me dashje, për të cilën ai do të kishte përfituar nga gjykimi i shkurtuar. Për shkak të mënyrës së zbatimit të tij, rezulton se gjykatat janë përqendruar vetëm në akuzën e paraqitur nga prokuroria.

12.3.3. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi nuk respekton kriteret e qartësisë dhe saktësisë, si dhe ndryshon raportin mes shtetit dhe shtetasit që ndiqet penalisht. Në rastin konkret, kërkuesit i është bërë kualifikim ligjor i veprës penale i gabuar, duke iu cenuar e drejta për gjykim të shkurtuar. Në këto kushte, kërkuesi ka qenë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës në gjykim.

12.3.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi parashikon heqjen e së drejtës për gjykim të shkurtuar për shkak të llojit të dënimit, duke krijuar situata diskriminuese, pa përligjje të arsyeshme e objektive. Heqja e së drejtës për gjykim të shkurtuar për kërkuesin nuk justifikohet me ndonjë interes publik, si dhe gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme.

13. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** ka prapësuar për sa vijon:

13.1. *Për të drejtën për proces të rregullt ligjor:*

13.1.1. *Pretendimi për moszbatimin e gjykimit të shkurtuar* është i pabazuar, pasi gjykatat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 403, pika 2, të KPP-së. Pretendimi i kërkuesit është në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara nga KPP-ja për gjykimin e shkurtuar, vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës. Riti i gjykimit të shkurtuar nuk lidhet me disponimin përfundimtar të gjykatës për veprën penale

që do të dënohet i pandehuri, por me procedimin penal të dërguar për gjykim nga prokuroria, me veprën penale për të cilën ka filluar shqyrtimi gjyqësor. Në kushtet kur kërkuesi ka qenë i akuzuar për një vepër penale për të cilën KPP-ja ndalon aplikimin e gjykimit të shkurtuar, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk kanë qenë kushtet ligjore për të proceduar me gjykimin e shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, ajo gjykatë ka vlerësuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale. Gjithashtu, gjykimi i shkurtuar mund të aplikohet kur gjykata vlerëson dhe bindet se mund ta zgjidhë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtim gjyqësor. Ndërsa në rastin konkret, për shkak të zhvillimit të gjykimit sipas procedurës së zakonshme, kërkuesi ka dorëzuar prova dhe ka kërkuar marrjen e provave të reja, që kanë bërë të mundur ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal dhe dënimin e tij me një masë më të ulët se dënimi me burgim të përjetshëm. Në këtë këndvështrim nuk kanë ekzistuar kushtet që të mund të procedohej me gjykimin e shkurtuar.

13.1.2. *Pretendimet për ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale nga gjykata dhe mosaplikimi i nenit 403, pika 2, të KPP-së* kanë të bëjnë me themelin e çështjes që kanë gjykuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ato janë të lidhura me vlerësimin e provave dhe mënyrën e interpretimit e zbatimit të së drejtës materiale e procedurale (mënyra e kualifikimit të veprës penale, kuptimi i veprës penale dhe vlerësimi i provave) dhe nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku janë bazuar gjykatat për zgjidhen e themelit të çështjes. Nga aktet e dosjes rezulton se nuk janë konstatuar shkelje që do ta bënin procesin të parregullt nga ana ligjore. Vendimet e gjykatave janë rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural për sa i përket vlerësimit të provave, cilësimit ligjor, llojit të dënimit dhe trajtimit të kërkesës për gjykimin e shkurtuar. Për pasojë, nuk konstatohet që gjatë procesit gjyqësor të ketë pasur shkelje të të drejtave kushtetuese ose zbatim arbitrar të ligjit, në kuptimin që të jetë haptazi në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës. Kualifikimi ligjor i veprës penale është atribut

i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat shqyrtojnë dhe vlerësojnë provat.

13.1.3. *Pretendimi për gjykimin pa ligj* nuk është i bazuar. Mosaplikimi i gjykimit të shkurtuar dhe për pasojë edhe mospërfitimi që sjell ky lloj gjykimi, duke përfituar uljen me një të tretën e dënimit, nuk kanë ardhur vetëm për shkak se nga gjykata u është dhënë fuqi prapavepruese ndryshimeve të bëra në nenin 403 të KPP-së, të ndryshuar në vitin 2017, por sepse çështja nuk mund të gjykohej në gjendjen që ishin aktet. Edhe gjykata e apelit ka arsyetuar se zhvillimi i gjykimit të zakonshëm nën parimin e kontradiktoritetit ka bërë të mundur ndryshimin e cilësimit ligjor dhe lehtësimin e pozitës juridike të kërkuesit.

13.2. *Pretendimi për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar,* pasi cenon parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e sigurisë juridike, nuk gjen mbështetje kushtetuese e ligjore. Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të përcaktojë marrëdhëniet që rregullohen me nxjerrjen e një ligji të caktuar dhe njëkohësisht të përjashtojë nga përfitimi që parashikon ai ligj. Në këtë aspekt është në kompetencë të Kuvendit që për efekt të luftës kundër kriminalitetit dhe dhënies së drejtësisë efektive të përjashtojë një kategori veprash penale nga përfitimet që sjell gjykimi i shkurtuar. Mundësia e të pandehurit për t'i kërkuar gjykatës zbatimin e kritereve ligjore të procedurës së gjykimit të shkurtuar është një e drejtë e tij, por është atribut i gjykatës për të vendosur nëse plotësohen kriteret ligjore për pranimin e gjykimit të shkurtuar, për rrjedhojë uljen e dënimit me një të tretën.

14. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, ka paraqitur parashtrime me shkrim vetëm për kërkimin për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, si vijon:

14.1. *E drejta për një gjykim të drejtë* garantohet përmes procedurës së rregullt gjyqësore dhe jo nëpërmjet një forme specifike sikurse është gjykimi i shkurtuar. Ky i fundit është një alternativë procedurale e bazuar në rrethana të caktuara dhe jo një e drejtë kushtetuese për çdo të pandehur. Ligjvënësi ka të drejtë të kufizojë aplikimin e saj për raste që nga natyra kërkojnë një analizë më të thelluar të provave dhe fakteve. Edhe pretendimi i kërkuesit se nuk ka përfituar uljen e dënimit për shkak të ndalimit të gjykimit

të shkurtuar, nuk përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi gjykimi i shkurtuar është një përfitim që lidhet ngushtësisht me përdorimin e një procedure të veçantë dhe jo një e drejtë e garantuar për të gjithë personat e proceduar penalisht. Nëse procedura nuk zbatohet, përfitimet e saj nuk mund të pretendohen. Zbatimi i nenit 406 të KPP-së është i kushtëzuar nga vetë lejueshmëria e gjykimit të shkurtuar. Nuk ka detyrim kushtetues për të garantuar uljen e dënimit në çdo rrethanë dhe dënimi i vendosur sipas procesit të rregullt ligjor nuk përbën cenim të të drejtave kushtetuese.

14.2. *Për parimin e sigurisë juridike,* neni 403, pika 2, i KPP-së të ndryshuar është një dispozitë që ka dëshmuar stabilitet juridik ndër vite në raport me vetë normat e këtij kodi, i cili u është nënshtruar ndryshimeve ligjore ndër vite. Neni 403, pika 2, i KPP-së është një normë e qartë, e kuptueshme dhe e parashikueshme. Ai përjashton në mënyrë të drejtpërdrejtë aplikimin e gjykimit të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Nuk ka asnjë paqartësi ligjore në formulim dhe çdo subjekt i ligjit e kupton saktësisht kufirin e zbatueshmërisë së dispozitës.

14.3. *Dispozita nuk cenon garancitë e nenit 17 të Kushtetutës*. Nga leximi i dispozitës objekt kundërshtimi dhe jurisprudencës kushtetuese kuptohet se qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë cenimi i të drejtave të të pandehurit, por garantimi i një procedure të plotë gjyqësore për veprat penale më të rënda, duke pasur parasysh se burgimi i përjetshëm është forma më ekstreme e sanksionit penal.

14.4. *Pretendimi se dispozita cenon nenin 18 të Kushtetutës, i cili rregullon parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit nuk qëndron,* pasi ky parim nuk nënkupton trajtim të njëjtë për të gjithë, por kërkon trajtim të barabartë në raste të ngjashme. Personat që akuzohen për vepra për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm nuk janë në të njëjtën situatë juridike me ata që akuzohen për vepra për të cilat parashikohen dënime më të lehta.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

15. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,

shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Në rastin konkret Gjykata konstaton se kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka parashtruar 2 kërkime: 1) për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin gjyqësor penal të zhvilluar ndaj tij; 2) për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, sepse është palë në procesin gjyqësor penal objekt kundërshtimi, gjatë të cilit është zbatuar edhe neni 403, pika 2, i KPP-së, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkuesi ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual, me objekt kundërshtimin si antikushtetues të ligjit ose aktit normativ, Gjykata ka theksuar se kërkuesi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve

gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Gjithsesi, meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkuesi e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor penal në të tria shkallët e gjyqësorit, duke parashtruar pretendimet e tij përpara tyre si në formë dhe në substancë. Gjithashtu, ai përmbush kriterin e shterimit të mjeteve juridike edhe për pretendimet për kundërshtimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, duke qenë se, sikundër u theksua më sipër, kjo dispozitë është zbatuar gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, prandaj kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 19.12.2024, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 03.10.2024. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga nenet 50, pika 4, për kundërshtimin e normës juridike, si dhe 71/a, pika 1, shkronja "b", për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore, të ligjit nr. 8577/2000.

21. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar në lidhje me vendimet gjyqësore të kundërshtuara cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim të shkurtuar dhe së drejtës për të përfituar uljen me një të tretën e dënimit për shkak të shkeljeve të rënda procedurale, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor për kërkesën për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, parimit të mosgjykimit pa ligj, parimit të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit dhe parimit të sigurisë juridike, si dhe zbatimit të gabuar të nenit 152 të KPP-së.

22. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdriskriminimit kërkuesi ka parashtruar dy shkaqe: (i) arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk analizon cilësimin juridik të akuzës edhe pse provueshmëria juridike e akuzës nuk kërkon

hetim; (ii) Gjykata e Lartë në një rast tjetër, në të njëjtat rrethana ligjore, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke vendosur lënien në fuqi të gjykimit të shkurtuar. Për *shkakun e dytë*, sipas kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 308, datë 20.11.2013 ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga rasti i tij. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të mbështesë *apriori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rastet e ekzistencës së vendimeve njësuese/unifikuese, gjykatat, duke mos analizuar çështjen konform këtyre vendimeve, cenojnë parimin e sigurisë juridike të kërkuesit për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate (*shih vendimin nr. 47, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, në kushtet kur kërkuesi nuk argumenton nëse vendimi i referuar prej tij është njësues/unifikues i praktikës gjyqësore, pra që të jetë i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit është haptazi i pabazuar.

23. Ndërsa për pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të: i) së drejtës për gjykim të shkurtuar dhe së drejtës për të përfituar uljen me një të tretën e dënimit për shkak të shkeljeve të rënda procedurale; ii) parimit të mosgjykimit pa ligj, pasi gjykatat e zakonshme i kanë dhënë fuqi prapavepruese ndryshimeve të nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar; iii) zbatimit të gabuar të nenit 152 të KPP-së, Gjykata vëren se thelbi i argumenteve të paraqitura nga kërkuesi lidhet me mospërfitimin e uljes së një të tretës së dënimit, sipas parashikimeve ligjore që sipas tij duhet të ishin zbatuar, për shkak të cilësimit të gabuar të veprës penale nga ana e prokurorisë, prandaj Gjykata do t'i analizojë ato në drejtim *të parimit të mosdënimit pa ligj.* Gjithashtu, për sa i takon *shkakut të parë* të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit (*shih paragrafin 22 të vendimit*), nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, ai do të analizohet së bashku me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimet në lidhje me vendimet gjyqësore Gjykata do t'i analizojë në

këndvështrim të *parimit të mosdënimit pa ligj* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

24. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae* në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, kërkuesi ka pretenduar se dispozita bie ndesh me *të drejtën për proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e sigurisë juridike* dhe atë të *barazisë përpara ligjit*. Gjykata vëren se thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, edhe në lidhje me këtë dispozitë ka të bëjë ngushtësisht me zbatimin e saj në procesin gjyqësor penal të zhvilluar ndaj kërkuesit, prandaj ajo do t'i analizojë pretendimet për nenin 403, pika 2 të KPP-së, të ndryshuar, të lidhura me të drejtën për proces të rregullt ligjor, pra me pretendimet për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj

25. Kërkuesi ka pretenduar se për shkak të shkeljeve të rënda procedurale dhe cenimit të të drejtave gjatë procesit gjyqësor penal ai nuk ka përfituar uljen me një të tretën e dënimit. Sipas tij, për shkak se prokuroria ka gabuar në cilësimin juridik të akuzës, në lidhje me faktet e ngjarjes penale, është rënduar pozita juridike e kërkuesit. Prokuroria nuk ka sjellë asnjë argument për cilësimin juridik të veprës penale për shkak të gjinisë së afërt, madje nuk ka shpjeguar në pretendimet përfundimtare marrëdhënien farefisnore mes kërkuesit dhe viktimës. Për shkak të cilësimit juridik të gabuar të akuzës, gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesën e kërkuesit për të zhvilluar procesin sipas gjykimit të shkurtuar.

26. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjykatat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar duke u bazuar në nenin 403, pika 2, të KPP-së, pas ndryshimeve të vitit 2017. Pretendimi i kërkuesit është në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara nga KPP-ja për gjykimin e shkurtuar, vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës. Në kundërshtim nga sa pretendon kërkuesi, riti i gjykimit të shkurtuar nuk lidhet me disponimin përfundimtar të gjykatës se për cilën vepër penale do të dënohet i pandehuri, por me procedimin penal të dërguar për gjykim, me atë se për cilën vepër penale vendoset dërgimi i çështjes për gjykim. Në kushtet kur kërkuesi ka qenë i akuzuar për një vepër penale për të cilën KPP-ja ndalon aplikimin e gjykimit të shkurtuar, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar

se nuk kanë qenë kushtet ligjore për të proceduar me gjykimin e shkurtuar.

27. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar të individit (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Ndërsa në lidhje me karakteristikat e gjykimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime për këtë vlerësim, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Për sa i përket kërkesës për gjykim të shkurtuar, Gjykata konstaton se neni 403 i KPP-së, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017, parashikonte se i pandehuri/përfaqësuesi i tij mund të kërkojë që çështja të përfundohet në gjendjen që janë aktet derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor. Sipas parashikimit të kësaj dispozite, kërkesa për të zgjidhur çështjen në gjendjen që janë aktet nuk kufizohet nga lloji i veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Me ligjin nr. 35/2017, neni 403, pika 2, i KPP-së ndryshoi, duke parashikuar se *"nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm"*.

30. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive *(shih vendimet nr. 56, datë 09.11.2023; nr. 6 datë 22.02.2022; nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Për sa i takon ndarjes së detyrave midis juridiksionit kushtetues dhe atij të gjyqësorit të zakonshëm, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar

se ajo ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Mbi bazën e këtyre standardeve kushtetuese dhe nisur nga konteksti i rrethanave të çështjes, Gjykata do të vlerësojë nëse në rastin në shqyrtim cilësimi juridik i veprës penale nga prokuroria ka ndikuar në rrëzimin e kërkesës së individit për gjykimin sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar dhe nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për më tepër Gjykata e Lartë, kanë garantuar realizimin e një procesi gjyqësor të drejtë në drejtim të efektivitetit të së drejtës për gjykim të shkurtuar, pra të mosdënimit të tij pa ligj.

33. Gjykata vërën se prokuroria e ka akuzuar kërkuesin, ndër të tjera, për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare", të kryer në bashkëpunim, duke qenë se gjatë hetimeve ka rezultuar se babai i kërkuesit dhe viktima janë në lidhje gjinie të afërt (baballarët vëllezër). Gjykata e shkallës së parë ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale në ngarkim të kërkuesit në "Vrasja me dashje", të parashikuar nga neni 76 i KP-së. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesi me viktimën nuk bëjnë pjesë te "gjinia e afërt", duke pasur parasysh nenin 16 të KPP-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, duke qenë se kërkuesi dhe viktima nuk hyjnë në rrethin e personave "gjini e afërt", faktit penal i duhet dhënë një përcaktim i ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, duke e cilësuar si vrasje me dashje, të parashikuar në nenin 76 të KP-së. Në vijim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në

kushtet kur cilësimi juridik është më i lehtë nga ai i dhënë nga prokuroria, gjykata nuk ka detyrimin ligjor për të njoftuar palët për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, sipas nenit 375 të KPP-së *(shih faqen 36 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda)*. Për rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë, mes të tjerave, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje" (neni 76 i KP-së) dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" (neni 278, paragrafi 1, i KP-së).

34. Ndaj vendimit kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe prokuroria. Gjatë shqyrtimit të çështjes, në seancën gjyqësore të datës 04.03.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda ka paraqitur deklaratë për heqjen dorë nga ankimi, ku, mes të tjerave, ka parashtruar se kërkuesi dhe viktima nuk bëjnë pjesë në rrethin e personave "gjini e afërt" dhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka cilësuar si vrasje me dashje, duke i dhënë një përcaktim të ndryshëm nga prokurori. Gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të prokurorit për shkak të heqjes dorë dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pjesën e deklarimit fajtor të kërkuesit sipas veprave penale "Vrasja me dashje" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", si dhe ndryshimin e vendimit vetëm në lidhje me disponimin për masën e dënimit për veprën penale të vrasjes me dashje.

35. Pretendimi i kërkuesit për mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar është shqyrtuar edhe nga gjykata e apelit, e cila e ka gjetur të drejtë e të mbështetur në ligj vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar me të njëjtën linjë si gjykata e shkallës së parë se rastin në gjykim nuk mund të procedohet me gjykimin e çështjes me ritin e gjykimit të shkurtuar, për shkak të parashikimit të nenit 403 të KPP-së, të ndryshuar dhe se e drejta e të pandehurit për të kërkuar zhvillimin e gjykimit me procedurën e gjykimit të shkurtuar shqyrtohet nga gjykata e faktit dhe mbetet atribut i saj *(shih faqet 20 dhe 21 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda)*.

36. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, duke arsyetuar se nuk konstatohet zbatim i gabuar i ligjit procedural ose material nga gjykatat e faktit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e ngritur në rekurs nga kërkuesi për cenimin e së drejtës për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar. Ajo gjykatë ka mbajtur qëndrimin se gjykata e apelit ka arsyetuar me

të drejtë se për shkak të cilësimit ligjor të akuzës "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare", me të cilën akuza ka dërguar për gjykim çështjen e kërkuesit, parashikohej dënimi me burgim të përjetshëm dhe nuk mund të procedohej me procedurën e gjykimit të shkurtuar, referuar nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Zhvillimi i gjykimit me procedurën e gjykimit të zakonshëm, nën parimin e kontradiktoritetit, ka bërë të mundur edhe ndryshimin e këtij cilësimi ligjor, në lehtësim të pozitës së kërkuesit *(shih faqen 14 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

37. Nisur nga sa më lart, Gjykata vëren se qëndrimi i gjykatave të zakonshme për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar të kërkuesit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me dy shkaqe: (i) me përcaktimin e cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkuesi është akuzuar nga prokuroria dhe çështja është dërguar për gjykim; (ii) me kohën e shqyrtimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar.

38. Për sa i takon *shkakut të parë,* kualifikimit juridik të veprës penale nga ana e prokurorisë, sikurse u përmend më lart *(shih paragrafin 3 të vendimit),* kjo e fundit, duke e cilësuar marrëdhënien mes autorit të veprës penale/kërkuesit dhe viktimës si lidhje mes kushërinjve, e ka akuzuar atë për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare", të parashikuar nga neni 79/c i KP-së, që përcakton dënimin me jo më pak se 20 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dhe për të cilat nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar sipas nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Ndërkohë, prokuroria nuk ka analizuar në lidhje me marrëdhënien e posaçme midis autorit dhe viktimës sipas përcaktimeve ligjore, në mënyrë që të justifikonte kualifikimin e veprës penale sipas nenit 79/c të KP-së, edhe pse kjo lidhje përbën një rrethanë objektive dhe përcaktuese për cilësimin juridik të veprës penale, e cila nuk mund të ndryshonte gjatë gjykimit. Ajo është mjaftuar me ekzistencën e marrëdhënies së afërt mes kërkuesit dhe viktimës, duke u nisur nga marrëdhënia familjare që kishte gjyshi i autorit me babanë e viktimës, duke mos arsyetuar më tej lidhjen konkrete që kishte kërkuesi me viktimën, qoftë edhe duke iu referuar nenit 16 të KPP-së, ku lidhjet familjare, të gjinisë ose të krushqisë së afërt janë përcaktuar si shkaqe papajtueshmërie me funksionin e gjyqtarit në gjykim.

39. Gjykata gjithashtu vlerëson se kjo rrethanë përforcohet nga fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë e ka rikualifikuar faktin penal dhe kërkuesi është dënuar për veprën penale "Vrasja me dashje", të parashikuar nga neni 76 i KP-së, për të cilën

parashikohet dënimi me jo më pak se njëzet vjet burgim, masë dënimi kjo që nuk përbën kriter kufizues në rastet e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, sipas nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, gjykata e shkallës së parë është bazuar në aktet e gjendjes civile, sipas të cilave ka rezultuar se viktima dhe kërkuesi nuk hyjnë në rrethin e personave "gjini e afërt", për rrjedhojë kërkuesi, si autor i veprës penale, nuk është subjekt i posaçëm në kuptim të nenit 79/c të KP-së.

40. Në vijim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret përcaktimi nga prokuroria i marrëdhënies mes autorit të veprës penale dhe viktimës si dy kushërinj, pa treguar konkretisht lidhjen familjare, të gjinisë ose të krushqisë së afërt mes tyre, përbën gabim faktik që ka ndikuar në cilësimin e gabuar të veprës penale. Në këtë pikë vlen të theksohet se marrëdhëniet familjare ose gjinore janë rrethana objektive e përcaktuese për cilësimin juridik të veprës penale, që nuk pësojnë ndryshim si gjatë hetimit, po ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes dhe nuk lënë hapësira për shqyrtimin/rivlerësimin e tyre, ndaj përcaktimi i saktë i tyre është thelbësor për kualifikimin juridik të veprës penale, pasi ndikon në efektivitetin e së drejtës për gjykim të shkurtuar, pra në të drejtën kushtetuese të mosdënimit pa ligj.

41. *Për sa i takon shkakut të dytë*, kohës së shqyrtimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga kërkuesi në datën 26.07.2017, para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të nenit 403, pika 2, të KPP-së, por për shkak të shtyrjes së seancave gjyqësore është shqyrtuar në datën 02.11.2017, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore në KPP (*shih paragrafët 4-7 të vendimit*). Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar në lidhje me momentin kohor të paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar ose për mosshqyrtimin e saj në seancën e datës 27.07.2017 për shkaqe që nuk vareshin nga vullneti i kërkuesit, pavarësisht se edhe ky shkak ka ndikuar drejtpërdrejt në të drejtën kushtetuese të mosdënimit pa ligj.

42. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të gabimit konceptual të organit të prokurorisë në përcaktimin e marrëdhënies mes autorit të veprës penale dhe viktimës, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për të përfituar gjykimin në gjendjen që ishin aktet, sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, kërkesë që për shkak të momentit procedural kur paraqitet vlerësohet nga gjykata e shkallës së parë bazuar në akuzën e ngritur nga prokurori. Po ashtu, edhe në lidhje me momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë

mbajtur një qëndrim të arsyetuar lidhur me datën e paraqitjes së kërkesës dhe atë të shqyrtimit të saj, të trajtuara këto duke iu referuar kohës kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore në nenin 403, pika 2, të KPP-së. Në këto kushte dhe për më tepër në rrethanat kur organi i prokurorisë ka hequr dorë nga ankimi për shkak të gabimit faktik në përcaktimin prej tij të marrëdhënies midis kërkuesit dhe viktimës, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për të ushtruar të drejtat e tij në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur, pra për të përfituar nga zbatimi i procedurës me gjykim të shkurtuar.

43. Në këtë pikë, Gjykata vlerëson të ritheksojë efektet që sjell gjykimi i shkurtuar për sa i përket masës së dënimit. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, ndikon mbi masën ose llojin e dënimit që caktohet nga gjykata, për rrjedhojë kjo e drejtë procedurale ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtën materiale të mosdënimit pa ligj *(shih vendimin nr. 26, datë 29.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*.

44. Për këto arsye, Gjykata vëren se për shkak të përcaktimit të gabuar të veprës penale nga organi i prokurorisë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vendosur refuzimin e kërkesës së kërkuesit për gjykim të shkurtuar, duke i mohuar atij përfitimet e njohura nga ligji për masën e dënimit. Gjykata vlerëson se mënyra sesi kanë vepruar prokuroria e më tej gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë pasur të gjitha hapësirat ligjore për t'i garantuar kërkuesit të drejtën për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar gjatë procesit gjyqësor penal, ka sjellë, në thelb, cenimin e garancive efektive kundër dënimit arbitrar në kuptim të së drejtës kushtetuese të mosdënimit pa ligj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj janë të bazuara. Ndaj, Gjykata çmon se duhet të shfuqizohet vendimi i Gjykatës së Lartë, pasi duke u bazuar në kompetencat e saj si gjykatë ligji është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimin e kërkuesit dhe riparuar gabimet e gjykatave më të ulëta.

45. Në vijim, Gjykata, duke ritheksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të paraqitura nga kërkuesi për procesin gjyqësor penal të lidhura edhe me pretendimet për nenin 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pjesërisht e bazuar, ndaj dhe ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1630, datë 03.10.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, vetëm për kërkuesin Renato Sina.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.10.2025
Shpallur më 21.11.2025

Vendim nr. 65, datë 24.10.2025
(V-65/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 1/1 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

OBJEKTI: **Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 127 dhe 179, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 86, pika 4, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); vendimi nr. 60, datë 16.10.2025 i Gjykatës Kushtetuese (*vendimi nr. 60/2025*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim kërkesën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*) për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues emërtesë e tij, administroi dokumentacionin e nevojshëm, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj në datën

10.03.2025, për shkak të përfundimit të afatit të kohëzgjatjes së tij. Në atë vendim Gjykata u ndal edhe në përmbajtjen e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, që bën fjalë për një situatë kalimtare dhe që ka për qëllim garantimin e përtëritjes së rregullt të përbërjes së saj. Sipas Gjykatës, kushtetutëbërësi në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së saj i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij të fundit dhe nën këtë logjikë momenti i mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës duket se ka lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit që e ka zëvendësuar atë, në veçanti për sa i përket momentit të mbarimit të kësaj kohëzgjatjeje. Për rrjedhojë, ajo arriti në përfundimin se data e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues në rastin konkret ishte data e deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai ka zëvendësuar në detyrë. Po kështu, Gjykata theksoi se hapja e procedurës për plotësimin e një vendi vakant duhet të fillojë vetëm pasi ajo të ketë deklaruar mbarimin e mandatit të anëtarit të saj dhe vetëm pasi Kryetari i saj të ketë njoftuar organin përkatës të emërtesës. Ndaj, në çdo rast kur një organ i emërtesës vlerëson se Gjykata nuk e ka ushtruar kompetencën e saj brenda afatit ligjor, ai duhet t`i drejtohet asaj, duke i kërkuar me shkrim ushtrimin e një kompetence të tillë (*shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

2. Në datën 30.01.2025 Presidenti i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, duke parashtruar, në thelb, se ai, në cilësinë e njërit prej tre organeve të emërtesës, është penguar në ushtrimin e kompetencës kushtetuese, për sa kohë që Gjykata nuk ka deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues që është emërtesë e tij.

3. Gjykata, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 60, datë 16.10.2025, vendosi të shqyrtojë veçmas kërkimin e Presidentit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, duke disponuar edhe se një kompetencë e tillë i përket Gjykatës dhe vetëm pas kësaj organi i emërtesës ushtron kompetencën e tij të emërimit/zgjedhjes të gjyqtarit kushtetues.

4. Për sa i përket themelit të asaj çështjeje, Gjykata u ndal në interpretimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, për shkak se vlerësoi se paqartësia e krijuar lidhur me kohëzgjatjen e mandateve të gjyqtarëve kushtetues ka në dukje karakteristikat e një mosmarrëveshjeje kompetencash midis organeve të përfshira në procedurën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues, ndaj bën të nevojshëm interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese lidhur me ndërveprimin e parimeve kushtetuese të përtëritjes së pjesshme të

Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën e saj dhe të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues. Në përfundim, Gjykata interpretoi nenin 179, pika 3, të Kushtetutës si vijon: "*Qëllimi i dispozitës kushtetuese është garantimi i përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, parim i përcaktuar në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës. Për këtë arsye, neni 179, pika 3, i Kushtetutës ka përcaktuar shkurtimin me më pak se 9 vjet të mandateve të dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, njëri deri në vitin 2025 dhe tjetri deri në vitin 2028. Për sa i përket "kohëzgjatjes së mandatit, sipas ligjit" të gjyqtarëve të tjerë, kjo dispozitë kushtetuese i referohet nenit 86, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i cili ka përcaktuar skemën kohore të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar përtëritjen e parë me një të tretën në vitin 2025, përtëritjen e dytë me një të tretën në vitin 2028 dhe përtëritjen e tretë me një të tretën në vitin 2031. Fillimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përgjatë këtij regjimi tranzitor përkon me datën e deklaruar nga Gjykata Kushtetuese të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai zëvendëson.*".

5. Bazuar në sa më sipër, Gjykata u mblodh për shqyrtimin e kërkimit të Presidentit për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së saj, zonjës Sonila Bejtja.

II
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

6. Gjykata vëren se zonja Sonila Bejtja ka aplikuar si kandidate në procedurën e shpallur nga Presidenti për plotësimin e vendit vakant në Gjykatë, vakancë e parakohshme, të shpallur nga ai organ emërtese në datën 22.11.2019. Në përfundim të kësaj procedure, me dekretin nr. 11886, datë 28.12.2020, Presidenti ka dekretuar: "*Zonja Sonila Bejtja emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese*". Në datën 29.12.2020 zonja Sonila Bejtja ka bërë betimin përpara Presidentit dhe ka filluar detyrën.

7. Kjo vakancë e parakohshme është krijuar për shkak se zoti Besnik Muçi, i cili është emëruar gjyqtar i Gjykatës me dekretin nr. 11313, datë 15.10.2019 të Presidentit, është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 32, datë 21.11.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

8. Nga ana tjetër, zoti Besnik Muçi ka aplikuar si kandidat në procedurën e shpallur nga Presidenti për plotësimin e vendit vakant në Gjykatë, vakancë e plotë, e shpallur në datën 07.02.2018, për shkak të mbarimit të

mandatit 9-vjeçar të gjyqtarit Sokol Berberi. Për sa i përket këtij të fundit, ai është emëruar gjyqtar i Gjykatës me dekretin e Presidentit nr. 5250, datë 04.04.2007, për të cilin, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme në atë kohë, është dhënë pëlqimi me vendimin nr. 86, datë 16.04.2007 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*).

9. Gjykata vëren, fillimisht, bazuar në qëndrimin e saj në vendimin nr. 60, datë 16.10.2025, se mandati kushtetues i gjyqtares Sonila Bejtja përfshihet në "mandatet e tjera" që i përkasin regjimit tranzitor të mandateve të gjyqtarëve kushtetues të emëruar/zgjedhur pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, kohëzgjatja e të cilave, sipas përmbajtjes së pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës, rregullohet sipas skemës kohore të përtëritjes sipas nenit 86, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 dhe i përket përtëritjes së parë me një të tretën, e cila kryhet në vitin 2025. Për rrjedhojë, ky mandat mbaron në vitin 2025.

10. Për sa i takon përcaktimit të momentit kohor të mbarimit të këtij mandati kushtetues (dita dhe muaji), Gjykata vëren se edhe pse zoti Besnik Muçi, në mandatin kushtetues të të cilit ka hyrë si zëvendësuese gjyqtarja Sonila Bejtja, ka kandiduar dhe është emëruar për një mandat të plotë dhe ka filluar detyrën në datën 18.10.2019 (data e betimit përpara Presidentit), në rastin konkret nuk gjejnë zbatim përcaktimet e nenit 129 të Kushtetutës dhe nenit 8, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 për fillimin dhe mbarimin e këtij mandati kushtetues, për sa kohë që ai, siç u përmend më sipër, i përket regjimit tranzitor për të cilin kushtetutëbërësi në pikën 3 të nenit 179 të Kushtetutës, me qëllim garantimin e përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës, ka parashikuar një rregullim të ndryshëm nga rregulli i përgjithshëm i kohëqëndrimit në detyrë dhe mbarimit të mandatit. Referuar vendimit nr. 60, datë 16.10.2025 të Gjykatës fillimi i mandatit kushtetues që ushtron gjyqtarja Sonila Bejtja përkon me datën e deklaruar nga Gjykata të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ajo ka zëvendësuar, pra të gjyqtarit Sokol Berberi.

11. Lidhur me datën e fillimit dhe mbarimit të mandatit të gjyqtarit të zëvendësuar Sokol Berberi, sipas akteve shkresore rezulton se ai është emëruar me dekretin e Presidentit nr. 5250, datë 04.04.2007, për të cilin është dhënë pëlqimi me vendimin nr. 86, datë 16.04.2007 të Kuvendit. Gjykata vëren se në rastin konkret nuk ka një vendim të sajin për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi, ndërkohë që me shkresat nr. 101 prot. dhe nr. 101/1 prot., datë 25.03.2016, Gjykata i ka dërguar Presidentit dhe Kuvendit informacion për fillimin dhe mbarimin

e mandatit të atij gjyqtari, nga të cilat rezulton se ai ka filluar detyrën në datën 25.04.2007, kur ka bërë betimin përpara Presidentit, për rrjedhojë data 25.04.2016 konsiderohet edhe si data e mbarimit të mandatit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

12. Për sa më sipër, në situatën që mandati i gjyqtarit Sokol Berberi ka mbaruar në datën 25.04.2016 në po atë datë ka filluar edhe mandati kushtetues që ushtron gjyqtarja Sonila Bejtja, i cili, nga ana tjetër, konsiderohet se ka mbaruar në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, pra në datën 25.04.2025.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 127, pika 2 dhe 179, pika 3, të Kushtetutës, si dhe neneve 8, pika 3, 9, pikat 2 e 3 dhe 86, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Sonila Bejtja, në datën 25.04.2025.
- Njoftimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë si organi i emërtesës.
- Njoftimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Marrë më 24.10.2025
Shpallur më 24.10.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkesës së Presidentit me objekt "*Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese*", ne kemi qëndrim të kundërt me shumicës, pasi ky kërkim, i veçuar për shqyrtim nga kërkimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave dhe interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, është i pabazuar dhe, si i tillë, duhej rrëzuar.

2. Në vlerësimin tonë ky vendim ishte i pritshëm dhe i paracaktuar që prej mënyrës në të cilën po kjo shumicë në vendimin nr. 60, datë 16.10.2025 ka interpretuar dispozitat kushtetuese lidhur me mënyrën e zbatimit të dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, ku qartazi i ka dhënë epërsi parimit të përtëritjes së pjesshme të Gjykatës ndaj një parimi tjetër po kushtetues, atij të kohëzgjatjes së mandatit, por duke mos marrë në konsideratë as parimet e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike për sa kohë që gjyqtarët kushtetues në detyrë, pra edhe gjyqtarja Sonila Bejtja, ka kandiduar, ka pranuar dhe është emëruar si zëvendësuese në një mandat të plotë 9-vjeçar, gjë që as në atë moment dhe as gjatë ushtrimit të këtij mandati nuk është vënë asnjëherë në diskutim as nga organet e emërtesës, as nga ndonjë organ tjetër.

3. Pavarësisht qëllimit që ka pasur kushtetutëbërësi në miratimin e dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës dhe në vijim ligjvënësi në miratimin e nenit 86, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, skema e përtëritjes përgjatë regjimit tranzitor nuk mund të ndërhyjë në një mandat të plotë të gjyqtarit kushtetues, duke e prekur ose shkurtuar atë. Mandati në këtë rast nuk përkthehet thjesht si koha gjatë të cilës ushtrohet një detyrë e caktuar, pra si një detaj procedural, por ai lidhet drejtpërdrejt me garancitë dhe parimet kushtetuese, përfshirë ato të pavarësisë së Gjykatës dhe patundshmërisë në detyrë të gjyqtarit kushtetues. Siç ka theksuar Gjykata, me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është "i pavarur", ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre (*shih vendimin nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që

administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Këto garanci janë të tilla që duhet ta mbrojnë gjyqtarin jo vetëm nga faktorët e jashtëm, por edhe nga vetë kjo Gjykatë, që në çdo rast duhet të ndalojë çdo ndërhyrje ose presion të jashtëm ndaj gjyqtarëve të saj dhe, në ndryshim nga sa është vepruar konkretisht prej saj, duhet të garantojë paprekshmërinë e mandatit/qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues përgjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

4. Parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi këtë qasje Gjykata, në vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj, duke iu referuar akteve të njoftimit të vakancës nga organi i emërtesës - Gjykata e Lartë, njoftimit për rihapjen e procedurës së aplikimit, kërkesës për aplikim dhe konfirmimit të kandidaturës pas rishpalljes së kësaj vakance, ka vlerësuar se ajo gjyqtare ka shprehur vullnetin e saj për të kandiduar për pjesën e mbetur të mandatit që përfundon në muajin mars të vitit 2025. Në vlerësimin tonë nuk ka asnjë vlerë se çfarë vendi ka zënë ky argument në vendimmarrjen e Gjykatës, për sa kohë që ai ka përbërë bazën e arsyetimit dhe është i lidhur me mënyrën sesi është zbërthyer parimi i pavarësisë së gjyqtarit në jurisprudencën kushtetuese. Thënë kjo, në rastin konkret, shumica nuk është ndalur aspak në analizën e situatës konkrete, që është katërcipërisht e ndryshme, për sa kohë që, referuar akteve të njoftimit të vakancës së plotë nga organi i emërtesës – Presidenti, njoftimit të vakancës së pjesshme për plotësimin e vendit vakant të krijuar për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi, kërkesës për aplikim të këtij të fundit dhe të vetë kandidates Sonila Bejtja, sikundër të gjitha akteve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe vetë dekreteve të Presidentit për emërimin e tyre në detyrë, ajo gjyqtare ka pranuar dhe ka shprehur vullnetin për të hyrë në një mandat të plotë 9-vjeçar dhe në përfundim të procedurës është emëruar për një mandat të plotë 9-vjeçar. Në këtë kuptim, këto elemente e bëjnë qëndrimin e shumicës kontradiktor me qëndrimin e mëparshëm të saj.

5. Në vlerësimin tonë, në situatën aktuale, në të cilën qartazi skema e përtëritjes së pjesshme të Gjykatës ka dështuar të funksionojë për shkak të mënyrës dhe kohës së zbatimit të ndryshimeve kushtetuese, mënyra për

të siguruar zbatimin e saj nuk është përmes ndërhyrjes së kësaj Gjykate, pra përmes shkurtimit dhe ndërprerjes së mandateve të disa gjyqtarëve të saj që janë në detyrë në regjimin, sipas saj, tranzitor. Gjykata nuk mund të ndërhynte për të zhbërë mosfunksionimin e skemës duke sjellë pasoja negative në drejtim të parimeve kushtetuese që duhet të mbroheshin prej saj, që është ai i shtetit të së drejtës dhe lidhur me të parimi i pavarësisë së gjyqtarit kushtetues, i sigurisë juridike, sikundër ai i barazisë në të drejta.

6. Edhe nëse do të pranonim se kjo çështje nuk do të kërkonte ndërhyrjen e kushtetutëbërësit, por të Gjykatës për interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese, e vetmja mënyrë për të garantuar respektimin e parimeve kushtetuese do të ishte përmes zbatimit të skemës në mandatet vijuese, duke përcaktuar detyrimin e secilit organ emërtese, sipas kuotave të tij, që të shpallte në vijim mandate të pjesshme për kohën e nevojshme që do të garantonte në vijim përtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën, çka do të garantonte edhe që çdo gjyqtar pasues të kandidonte dhe të pranonte të ushtronte detyrën për kohëzgjatjen e shpallur të mandatit dhe në asnjë rast duke prekur një mandat të dhënë si të plotë.

7. Në nenin 127 të Kushtetutës janë përcaktuar të vetmet shkaqe të lejueshme kushtetutshmërisht për mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, mes të cilave, shkronja "b" parashikon si të tillë përfundimin e mandatit 9-vjeçar. Për rrjedhojë, ne nuk jemi dakord as me konceptin e "mandatit kushtetues" të futur nga kjo shumicë, përmes të cilit synohet të krijohen koncepte të reja kushtetuese, që bien ndesh edhe me vetë normat kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate gjatë zbatimit të tyre. Kushtetuta e rregullon mandatin e gjyqtarit kushtetues në nenet 125 e vijues të saj dhe flet vetëm për një lloj mandati "*mandati i gjyqtarit kushtetues*", i cili në rastet kur është i plotë, siç është rasti i gjyqtarit Besnik Muçi, të cilin ka zëvendësuar gjyqtarja Sonila Bejtja, nënkupton qëndrimin në detyrë për 9 vjet, sipas nenit 125, pika 3, të Kushtetutës. Kjo kohëzgjatje në rastin konkret ka filluar nga dita e betimit të atij gjyqtari, sipas nenit 129 të Kushtetutës dhe do të përfundonte në ditën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë. Për rrjedhojë, qëndrimi i shumicës dhe interpretimi se mandati fillon në ditën e deklarimit të mandatit kushtetues, e lidhur me datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që zëvendësohet, ka zhbërë nenin 125, pika 3 dhe nenin 129 të Kushtetutës, duke asgjësuar betimin përpara Presidentit dhe dekretin si akt, si parakusht për fillimin e detyrës, e vetmja ngjarje me pasoja kushtetuese në fillimin dhe mbarimin e mandatit/qëndrimit në detyrë për 9 vjet të gjyqtarit kushtetues.

8. Në vlerësimin tonë, për sa kohë që vetë dispozita tranzitore, neni 179, pika 3, i Kushtetutës nuk ka një parashikim të shprehur për përjashtimin e zbatimit të rregullave të përgjithshme për fillimin dhe mbarimin e mandatit/qëndrimit në detyrë të "gjyqtarëve të tjerë" kushtetues dhe as për kufizimin e mandateve të këtyre gjyqtarëve përgjatë regjimit tranzitor, kjo Gjykatë, në respekt edhe të parimit të vetëpërmbajtjes, nuk mund të bënte përmes interpretimit të saj atë që vetë kushtetutëbërësi nuk ka dashur ta bëjë. Parashikimi "*kohëzgjatjes së mandatit, sipas ligjit*", në nenin 179, pika 3, të Kushtetutës nuk mund të nënkuptojë anashkalimin e normave kushtetuese të zbatueshme si më sipër, për sa kohë që përmes normave me natyrë ligjore nuk mund të kufizohen ose interpretohen normat garantuese të nivelit kushtetues.

9. Siç u theksua edhe më sipër, mbrojtja e së drejtës së gjyqtarit për të ushtuar mandatin e tij të plotë përgjatë periudhës 9-vjeçare mbështetet në parimet kushtetuese të pavarësisë së Gjykatës dhe të vetë gjyqtarit, si dhe të patundshmërisë në detyrë, ndërkohë që ndërprerja e mandatit në mënyrë të parakohshme, pa pëlqimin e vetë gjyqtarit, mbështetet në shkaqe të tjera kushtetuese. Procesi i deklarimit të mbarimit të mandatit është deklarativ dhe gjatë tij verifikohet data e betimit të gjyqtarit dhe lidhur me të, data që i përket ditës së njëjtë të të njëjtit muaj të vitit të nëntë kalendarik, dhe vetëm në këtë rast angazhohet trupa e gjyqtarëve me një proces deklarativ të bazuar në verifikimin e vetëm këtyre fakteve. Mënyra e ushtrimit të kësaj kompetence nga Gjykata përbën një garanci tjetër për mbrojtjen e gjyqtarit nga interpretimi dhe ndërhyrja në ushtrimin e mandatit të tij nga vetë kjo Gjykatë ose gjyqtarët e saj përmes interpretimit, i cili nuk mund të ndërpresë një detyrë që ka filluar të ushtrohet sipas rregullave kushtetuese të zbatueshme në kohën e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarit, të njohura dhe të pranuara prej vetë atij, organeve të emërtesës dhe atyre të përfshira në proces, ashtu dhe prej vetë kësaj Gjykate.

10. Nga ana tjetër, edhe Komisioni i Venecias ka vlerësuar se modeli kushtetues i miratuar në vitin 2016 është shumë kompleks dhe, në planin afatgjatë, është rekomanduar thjeshtimi i tij, në radhë të parë duke hequr rregullin e sekuencës. Sipas Komisionit të Venecias, kuotat e tre organeve të emërtesës mund të ruhen duke i caktuar automatikisht rinovimin e një mandati të njëjtit autoritet që ka emëruar gjyqtarin që largohet. Po sipas tij, vitet fikse të fillimit dhe mbarimit të mandateve 9-vjeçare duhet të hiqen dhe gjyqtarët kushtetues duhet të gëzojnë gjithmonë një mandat të plotë 9-vjeçar, edhe nëse janë zgjedhur me vonesë ose marrin një mandat që ka

mbaruar përpara afatit (*shih paragrafin 107 të opinionit të Komisionit të Venecias nr. 978/2020 CDL-AD(2020)010, datë 19.06.2020 "Për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*").

11. Për të gjitha argumentet si më sipër, kërkimi i Presidentit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares Sonila Bejtja është i pabazuar, ndaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i tij.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtar: Genti Ibrahimi

Vendim nr. 66, datë 03.11.2025
(V-66/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga : Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 31.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike, çështjen nr. 28 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ERION VELIAJ**, përfaqësuar nga avokatët Alban Dokushi dhe Ermal Yzeiraj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Ilirjan Rusmali, Hemion Braho dhe Erjola Shia me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Vangelt Duni dhe Irma Qosja, avokate e shtetit, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 539, datë 25.09.2025, të Këshillit të Ministrave "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Shfuqizimi i dekretit nr. 350, datë 01.10.2025, të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore", për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë Tiranë, si i papajtueshëm me nenin 115, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i efekteve juridike të dekretit nr. 350, datë 01.10.2025, të Presidentit të Republikës

“Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë Tiranë, në zbatim të efekteve pezulluese që parashikojnë pikat 2 dhe 3 të nenit 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 13, 17, 30, 33, 42, 115, 116, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; Karta Evropiane e Autonomisë Vendore; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” *(ligji për qeverisjen vendore)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar *(ligji organik i Gjykatës).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Presidentit të Republikës (*Presidenti*) dhe Këshillit të Ministrave që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është zgjedhur kryetar i Bashkisë së Tiranës për herë të parë në zgjedhjet për qeverisjen vendore të vitit 2015. Ai është rizgjedhur në të njëjtën detyrë edhe dy herë të tjera në zgjedhjet vendore të viteve 2019 dhe 2023. Kërkuesi ka kandiduar dhe është zgjedhur si përfaqësues i shumicës qeverisëse (Partisë Socialiste).

2. Në fillim të vitit 2024, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) ka regjistruar procedimin penal nr. 27 të vitit 2024. Gjatë procedimit penal, me kërkesë të prokurorit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 7 akti, datë 09.02.2025, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit të arrestit në burg, si i dyshuar për veprat penale të korrupsionit pasiv të të zgjedhurve vendorë në bashkëpunim dhe të pastrimit të produkteve të veprës penale në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të Kodit Penal. Masa e sigurimit është ekzekutuar në datën 10.02.2025 dhe kërkuesi është izoluar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*) Durrës, seksioni i paraburgimit.

3. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, masa e sigurimit e arrestit në burg është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 13 (87-2025-25), datë 13.03.2025 dhe në vijim, edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2025-1153 (176), datë 08.07.2025.

4. Në datën 25.02.2025, disa ditë pas ekzekutimit të masës së sigurimit, një prej anëtarëve të këshillit bashkiak, në cilësinë e kryetarit të grupit të këshilltarëve të disa partive politike opozitare (Nisma Thurje, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe Partia Republikane), ka paraqitur kërkesë në këshillin bashkiak për të nisur procedurat për zëvendësimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë. Kërkesa është bazuar në nenet 61 dhe 62 të Ligjit për Qeverisjen Vendore dhe parashtronte argumentin se arrestimi i kërkuesit kishte krijuar boshllëk në drejtimin e bashkisë, që dëmtonte interesat e qytetarëve të Tiranës dhe rrezikonte stabilitetin e administratës së bashkisë.

5. Pas kalimit të tre muajve nga ekzekutimi i masës, konkretisht në datën 09.05.2025, dy këshilltarë të tjerë, në cilësinë e kryetarit dhe nënkryetarit të grupit të këshilltarëve të një partie tjetër politike opozitare (Partisë Demokratike), kanë paraqitur një kërkesë tjetër për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak, me qëllim nisjen e procedurave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë. Kërkesa parashtronte argumentin se në datën 12.05.2025 plotësoheshin tre muaj që kryetari i bashkisë nuk paraqitej në detyrë, ndaj duhej zbatuar neni 62, shkronja "c", i Ligjit për Qeverisjen Vendore. Sipas kësaj dispozite, kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e këshillit bashkiak për mosparaqitje në detyrë për një periudhë tremujore të pandërprerë.

6. Nuk rezulton që lidhur me këto dy kërkesa të jetë kryer ndonjë veprim administrativ. Pas rreth shtatë muajve nga ekzekutimi i masës së sigurimit, konkretisht në datën 18.09.2025, tridhjetë e tre këshilltarë të këshillit bashkiak, që i përkasin shumicës qeverisëse (Partisë Socialiste), kanë paraqitur kërkesë për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak, me qëllim shqyrtimin e propozimit për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë. Kërkesa e tyre i referohej nenit 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore dhe parashtronte argumentin se kryetari i bashkisë nuk ishte paraqitur në detyrë për një periudhë tremujore të pandërprerë. Gjithashtu, ata theksonin se kërkesa nuk duhej interpretuar si pranim i fakteve të pretenduara të procesit penal ndaj kërkuesit, por krejt e kundërta.

7. Në datën 19.09.2025 kërkuesi i është drejtuar këshillit bashkiak me shkrim, duke pranuar se kishte marrë dijeni nga media për mbledhjen që do të shqyrtonte propozimin për shkarkimin e tij nga detyra. Në shkresë ai kërkonte që përpara marrjes së vendimit të njihej me aktet, t'i sigurohej mundësia të ishte i pranishëm në mbledhje, të dëgjohej nga këshilli dhe të ushtronte të drejtën e mbrojtjes. Kësaj kërkese i është përgjigjur pas tre ditëve sekretari i këshillit bashkiak, me shkresën e datës 22.09.2025, me të cilën informonte kërkuesin se mbledhja do të zhvillohej të nesërmen, më 23.09.2025, ora 16.00 dhe në rast të pamundësisë për të qenë prezent, kërkuesi mund t'i paraqiste observacionet me shkrim, të cilat do të administroheshin në mbledhje. Brenda ditës (22.09.2025) kërkuesi ka njoftuar me shkrim këshillin bashkiak se: nuk ishte informuar zyrtarisht për arsyen e mbledhjes dhe rendin e ditës; nuk i ishte garantuar e drejta për t'u dëgjuar; sekretari, në dhënien e përgjigjes, kishte tejkaluar kompetencat e tij, duke marrë përsipër rolin e organit kolegjial - këshillit bashkiak. Të nesërmen, më 23.09.2025, sekretari i këshillit bashkiak i është përgjigjur sërish kërkuesit, duke parashtruar se nuk kishte asnjë vendim të këshillit që ndalonte pjesëmarrjen e tij në mbledhje dhe duke përsëritur se ai kishte mundësinë e dërgimit të observacioneve me shkrim.

8. Këshilli bashkiak është mbledhur në datën 23.09.2025, ora 16.00, me pjesëmarrjen e 53 këshilltarëve, përfaqësues të të gjithë spektrit politik. Pas diskutimeve të një numri të konsiderueshëm këshilltarësh, nga të gjithë krahët politikë, është vendosur bashkimi i të tria kërkesave të paraqitura. Në përfundim, këshilli bashkiak, me vendimin nr. 69, datë 23.09.2025 (*propozimi për shkarkim)*, me 50 vota pro dhe 1 kundër të këshilltarëve të pranishëm në momentin e votimit, ka vendosur t'i propozojë Këshillit të Ministrave shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë,

duke urdhëruar që vendimi t'i njoftohej Prefektit të Tiranës. Propozimi për shkarkim është vendosur bazuar në nenet 61, shkronja "ç" dhe 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore dhe është shoqëruar nga relacioni shpjegues, ku pasqyrohej vetëm qëndrimi i këshilltarëve të shumicës qeverisëse. Konkretisht, në relacion është shënuar se nga data 10.02.2025 kryeqyteti nuk e kishte kryetarin e zgjedhur nga qytetarët për shkak të procesit penal; atij i ishte mohuar e drejta e gjykimit në gjendje të lirë; kryeqytetit i duhej një kryetar në detyrë për ndjekjen e punëve; ndërmarrja e nismës për procedurën e shkarkimit të kryetarit ishte detyrim ligjor, politik dhe moral ndaj qytetarëve që kanë votuar për një qytet më të zhvilluar, me shërbime cilësore dhe të denjë për të qenë kryeqyteti i Shqipërisë. Po ashtu, në relacionin shoqërues është pasqyruar se vendimmarrja e këshillit bashkiak nuk nënkuptonte pranimin e fakteve të procesit penal ndaj kërkuesit, por krejt e kundërta.

9. Të nesërmen, më 24.09.2025, Prefekti i Tiranës, në mbështetje të nenit 61, pika 3, të Ligjit për Qeverisjen Vendore, ka verifikuar ligjshmërinë e propozimit për shkarkim dhe me shkresën e së njëjtës datë (24.09.2025) ia ka përcjellë atë Këshillit të Ministrave. Brenda ditës, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, në cilësinë e ministrit propozues, ka depozituar në Këshillin e Ministrave për shqyrtim dhe miratim projektvendimin për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Projektvendimit i është bashkëngjitur mendimi i ministrit të Drejtësisë, i lëshuar në të njëjtën datë (24.09.2025), me të cilin ai shprehej parimisht dakord në lidhje me bazën e autorizimit ligjor, në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës, ndërsa për përmbajtjen nuk jepte mendim me argumentin se projektakti ishte me karakter individual. Gjithashtu, projektvendimit i është bashkëngjitur edhe relacioni shpjegues. Në relacion është shënuar, ndër të tjera, se për sa kohë shkarkimi bazohej në shkronjën "c" të nenit 62 të Ligjit për Qeverisjen Vendore dhe jo në nenin 115 të Kushtetutës, i shkarkuari mund t'i drejtohej vetëm gjykatës administrative, ndaj ankimi eventual në gjykatë nuk pezullonte efektet e tij.

10. Një ditë më pas (25.09.2025), Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 539, datë 25.09.2025 "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj" (*vendimi i shkarkimit nga detyra*). Vendimi përmban si bazë ligjore nenin 100 të Kushtetutës dhe nenin 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore. Ai është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 173, datë 26.09.2025.

11. Kërkuesi në datën 29.09.2025 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese

(Gjykata) me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimit të shkarkimit nga detyra si të papajtueshëm me Kushtetutën. Regjistrimi i çështjes është njoftuar nga Gjykata brenda ditës në faqen e saj zyrtare.

12. Një ditë më pas (30.09.2025) Këshilli i Ministrave ka njoftuar Presidentin për krijimin e vakancave për kryetarë në gjashtë bashki të vendit, përfshirë edhe Bashkinë e Tiranës, duke kërkuar caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme në referim të neneve 10 të Kodit Zgjedhor dhe 61, pika 4, të Ligjit për Qeverisjen Vendore. Vakancat në pesë bashkitë e tjera ishin krijuar për shkaqe të ndryshme nga ai i kërkuesit (dorëheqje të kryetarëve të bashkive). Të nesërmen e njoftimit të vakancave (01.10.2025), Presidenti ka nxjerrë dekretin nr. 350, datë 01.10.2025 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore" (*dekreti për caktimin e zgjedhjeve*). Në pikën 1 të dekretit caktohej data 09.11.2025 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie në gjashtë bashki, përfshirë atë të Tiranës.

13. Një ditë pas nxjerrjes së dekretit (02.10.2025) kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për shtimin e objektit të ankimit kushtetues individual. Ai ka kërkuar edhe shfuqizimin e dekretit për caktimin e zgjedhjeve dhe pezullimin e efekteve të tij, për pjesën që lidhej me caktimin e datës së zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës.

14. Kolegji i Gjykatës, në datën 06.10.2025, bazuar në nenin 31, pika 3, të Ligjit Organik të Gjykatës, ka shqyrtuar ankimin për të dyja kërkimet dhe ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 09.10.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Njëkohësisht, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 45 të Ligjit Organik të Gjykatës, ka vendosur edhe pezullimin e dekretit për caktimin e zgjedhjeve për pjesën që përcaktonte datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës, me arsyetimin se zbatimi i tij rrezikonte të sillte pasoja të pariparueshme për të drejtat kushtetuese të kërkuesit, në cilësinë e të zgjedhurit vendor, për sa kohë kontrolli kushtetues i shkarkimit nga detyra ishte në proces.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

A. Për vendimin për shkarkimin nga detyra:

15.1. Gjykata ka *juridiksion* për të kontrolluar vendimin e shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë, bazuar në nenin 115 të Kushtetutës. Ligji për Qeverisjen Vendore ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 115 të Kushtetutës; shkronjat "b" dhe "c" të nenit 62 të tij zbërthejnë nocionin kushtetues të "shkeljes së rëndë". Interpretimi i kundërt e bën normën antikushtetuese, pasi ligjvënësi do të kishte shtuar një shkak të ri shkarkimi dhe kryetarët e bashkive humbasin mbrojtjen kushtetuese në procesin e shkarkimit. Kushtetutëbërësi e ka përcaktuar shprehimisht shkakun e shkarkimit të kryetarit të bashkisë dhe nuk ka dhënë delegim për zgjerimin me ligj të shkaqeve të tjera. Interpretimi i nenit 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore se përmban një shkak të ri, përtej shkeljes së rëndë, bie ndesh me parimin e epërsisë së Kushtetutës. Gjykatës nuk mund t'i hiqet me akt ligjor ose nënligjor një kompetencë që ia ka dhënë Kushtetuta.

15.2. Kërkuesi *legjitimohet* në paraqitjen e ankimit, pasi kushtetutëbërësi ka parashikuar të drejtën e kryetarit të bashkisë të shkarkuar nga detyra për t'u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatë, në mënyrë që të shmanget procesi i gjatë dhe i fragmentarizuar i gjykatave të zakonshme. Ankimi është paraqitur brenda afatit kushtetues 15-ditor. Pretendimet e tij lidhen me procedurën dhe kriteret e shkarkimit, si dhe cenimin e të drejtave kushtetuese.

15.3. Vendimi i ka cenuar:

15.3.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

15.3.1.1. *E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuesi nuk është informuar as nga këshilli bashkiak, as nga Këshilli i Ministrave për mbajtjen e mbledhjes dhe shkaqet e shkarkimit. Atij nuk i është kërkuar sqarimi ose paraqitja e provave lidhur me shkeljen e pretenduar, si dhe nuk i është dhënë mundësia, as fizikisht dhe as me shkrim, për t'u mbrojtur gjatë procesit të shkarkimit, për më tepër që gjendej i izoluar për shkak të arrestit në burg, çka nënkuptonte se kushtet i kishte edhe më të kufizuara. Kërkuesi është njohur nëpërmjet medias për fillimin e procedurës, pa pasur njoftim zyrtar për ushtrimin e së drejtës së tij për të marrë pjesë në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Këshilli bashkiak nuk ka njoftuar as Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, as Prokurorinë e Posaçme për këtë qëllim. Vetëm pas interesimit të kërkuesit, sekretari i këshillit bashkiak, në tejkalim të tagrave të tij, i është drejtuar me shkresë duke e informuar për të drejtën e paraqitjes së prapësimeve me shkrim ose pjesëmarrjes personalisht.

15.3.1.2. *Procedura e shkarkimit* është kryer me urgjencë. Vendimi i këshillit bashkiak është marrë në datën 23.09.2025, ndërsa vendimi i Këshillit të Ministrave është marrë dy ditë më vonë, pa i dhënë mundësinë kërkuesit të njihej paraprakisht me shkeljet që i atribuoheshin. Urgjenca nuk justifikohet me mbrojtjen e interesit publik nga një rrezik i menjëhershëm dhe as me vijimësinë e funksioneve të bashkisë. Kërkuesi i ka deleguar kompetencat për të drejtuar bashkinë, duke vijuar ushtrimin e detyrës së tij. Këshilli bashkiak ka votuar në mënyrë të hapur, në shkelje të rregullores, ndaj propozimi për shkarkim është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Mbledhja e Këshillit të Ministrave është zhvilluar pa praninë fizike të anëtarëve të tij dhe me procedurë të jashtëzakonshme. Shkarkimi nga detyra ka cenuar *parimin e proporcionalitetit dhe mbrojtjes së dinjitetit* të kërkuesit, si dhe ka deformuar funksionin institucional të këshillit bashkiak.

15.3.1.3. *Shqyrtimi i çështjes nuk ka qenë i thellë dhe efektiv*, pasi nuk është analizuar shkaku i shkarkimit, pra nëse kërkuesi nuk ishte paraqitur në detyrë për arsye objektive, të pavarura nga vullneti i tij. Nuk janë vlerësuar rëndësia e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura dhe kohëzgjatja e tyre, si dhe qëndrimi subjektiv i kërkuesit ndaj shkeljes. Konsiderimi i masave të sigurimit personal si shkelje e rëndë, i shndërron ato në instrumente politike për ndërprerjen e mandatit dhe deformon nocionin e shkeljes së rëndë të ligjit.

15.3.1.4. *Parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit*, pasi janë marrë parasysh vetëm argumentet e

njërës palë, duke e bërë procesin të mbyllur dhe të njëanshëm. Në këshillin bashkiak janë dëgjuar vetëm këshilltarët propozues, ndërsa kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të njihej me aktet dhe të paraqiste shpjegime. As Këshilli i Ministrave nuk e ka thirrur kërkuesin, por ka marrë parasysh vetëm propozimin e këshillit bashkiak.

15.3.1.5. *Standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi Këshilli i Ministrave nuk ka arsyetuar kriteret ligjore për shkarkimin e kryetarit të bashkisë. Ai organ nuk ka analizuar parimin e proporcionalitetit, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, ndonëse kërkuesi nuk kishte bërë asnjë shkelje për t'u shkarkuar menjëherë. Këshilli i Ministrave, si i vetmi organ që ka të drejtën e shkarkimit të një kryetari bashkie, nuk mundej thjesht të miratonte propozimin e këshillit bashkiak, por duhej të verifikonte themelin e çështjes. Për të përcaktuar sjelljen si shkelje të rëndë nuk janë analizuar pasojat për komunitetin, qëndrimi subjektiv i kërkuesit dhe ndërlidhja midis rrethanës së paraburgimit dhe ndonjë sjelljeje që mund të kualifikohej si shkelje e rëndë e ligjit.

15.3.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, i cili nuk kufizohet vetëm në procesin penal, por detyron çdo autoritet publik të mos e trajtojë individin si fajtor. Procedura e shkarkimit ka përmbysur barrën e provës, pasi mungesa në detyrë është trajtuar si vullnetare, e pajustifikuar dhe si shkelje e rëndë. Kërkuesi është konsideruar fajtor pa një vendim të formës së prerë dhe masa e sigurimit personal është përdorur si bazë faktike për ta shkarkuar atë nga detyra, ndonëse paraburgimi nuk mund të prodhojë *ipso facto* ndërprerje të mandatit. Kërkuesi është paragjykuar dhe ndaj tij është presupozuar një sjellje e fajshme. Organet përgjegjëse nuk kanë provuar nëse ekzistonte një masë më pak kufizuese që mbronte interesin publik. Shkarkimi nga detyra është mbështetur në paragjykim të fajit, duke e trajtuar mungesën për shkak të masës së sigurimit si provë të sjelljes së dënueshme.

15.3.3. Kërkuesi është shkarkuar për *shkaqe ekstra ligjore*, në kundërshtim me nenin 115 të Kushtetutës. Procedura për shkarkim nuk ka respektuar Ligjin për Qeverisjen Vendore, pasi ka nisur nga një këshilltar i këshillit bashkiak, me pretendimin se arrestimi i kërkuesit kishte krijuar boshllëk në drejtimin e bashkisë. Propozimi nuk është refuzuar nga këshilli bashkiak, po është miratuar së bashku me dy propozimet e tjera. Kushtetuta ka parashikuar se shkarkimi lejohet vetëm për shkelje të rënda të saj dhe të ligjit, ndaj çdo shkak tjetër është antikushtetues, që krijon pasiguri dhe precedent të rrezikshëm për të ardhmen e institucioneve vendore. Shkarkimi është bërë sipas *orientimeve politike* të asamblesë së partisë qeverisëse. Këshilli bashkiak nuk ka vepruar mbi bazën e vullnetit të tij institucional, ndonëse kishte detyrimin për të hetuar të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, objektive dhe të paanshme. Ai ka marrë vendim të paracaktuar, duke fshehur qëllimin real politik të shkarkimit, në shkelje të Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*).

15.3.4. *Parimin e autonomisë vendore* dhe *ai i shtetit të së drejtës*, pasi mandati është ndërprerë pa një shkak të parashikuar nga Kushtetuta dhe ligji i dalë në zbatim të saj. Neni 62 i Ligjit për Qeverisjen Vendore konkretizon rastet e shkarkimit të parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, përfshirë dhe mungesën tremujore pa arsye objektive. Kërkuesi ka munguar për arsye objektive, pra rasti i tij nuk përfshihet në nenin 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore, ndaj Këshilli i Ministrave ka krijuar një kriter të ri të paparashikuar nga ligji. Dispozita ligjore është interpretuar në mënyrë të zgjeruar, duke përfshirë edhe mungesën në detyrë për arsye objektive. Vendimi i shkarkimit ka cenuar Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave. Komisioni i Venecies ka theksuar se pezullimi ose përfundimi i mandatit të një kryetari bashkie për shkak të ndalimit ose paraburgimit prek thelbin e autonomisë vendore. Kjo bën iluzore garancitë e nenit 115 të Kushtetutës, duke cenuar në thelb decentralizimin dhe duke zëvendësuar vullnetin e zgjedhësve me diskrecionin ekzekutiv pa asnjë bazë juridike. Kërkuesit i

është cenuar ushtrimi i lirë i mandatit deri në përfundimin e tij. Vendimi i shkarkimit nuk ka dalë në bazë të nenit 115 të Kushtetutës, që përcakton shprehimisht rastet e shkarkimit të kryetarit të bashkisë dhe është burimi i vetëm i kompetencës për shkarkim. Shmangia e nenit 115 të Kushtetutës është përpjekje për të justifikuar një kompetencë që nuk ekziston.

15.3.5. *Parimin e hierarkisë së normave*, i garantuar nga neni 116 i Kushtetutës, pasi baza ligjore e vendimit të Këshillit të Ministrave përmban vetëm nenin 100 të Kushtetutës dhe nenin 62 të Ligjit për Qeverisjen Vendore, duke anashkaluar nenin 115 të Kushtetutës, i cili është i vetmi që autorizon ndërprerjen e parakohshme të mandatit të organit të zgjedhur vendor. Neni 62 i Ligjit për Qeverisjen Vendore ka zëvendësuar Kushtetutën, duke u shndërruar në burim të pavarur kompetencash, pa kaluar filtrin kushtetues. Vetë Ligji për Qeverisjen Vendore ka parashikuar se ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 115 të Kushtetutës, ai nuk ka ekzistencë të pavarur dhe nuk mund të kuptohet jashtë kornizës kushtetuese që e ka gjeneruar. Këshilli i Ministrave ka anashkaluar standardin e nenit 115 të Kushtetutës, i cili kërkon një shkelje të rëndë dhe ka përdorur mungesën objektive si shkak për shkarkim, ndonëse kjo nuk parashikohet nga Kushtetuta. Shkaqet e ndërprerjes së mandatit nuk mund të shtohen ose modifikohen nga ligjvënësi pa delegim të qartë kushtetues, pasi Kushtetuta do të humbiste funksionin mbrojtës të saj.

B. Për dekretin e caktimit të zgjedhjeve:

15.4. Gjykata ka *juridiksion*, pasi dekreti nuk është akt nënligjor dhe administrativ, por akt kushtetues, të cilin as gjykatat administrative dhe as kolegji zgjedhor nuk mund ta shqyrtojnë. Nëse dekreti do të shqyrtohej në gjykatat administrative, e drejta e ankimit të kryetarit të bashkisë, sipas nenit 115 të Kushtetutës, do të ishte iluzore dhe joefektive. Dekreti është akt i kushtëzuar nga e drejta e ankimit brenda 15 ditëve. Vendimi i shkarkimit dhe dekreti për caktimin e zgjedhjeve nuk janë dy akte të pavarura, por hallka të së njëjtës çështje kushtetuese, ku i pari përbën shkakun juridik dhe i dyti pasojën e drejtpërdrejtë. Për sa kohë Gjykata ka kompetencë të shqyrtojë vendimin e shkarkimit nga detyra, rrjedhimisht ka kompetencë edhe për dekretin e caktimit të zgjedhjeve.

15.5. Kërkuesi *legjitimohet* sepse nuk e kundërshton dekretin si votues ose formacion politik i prekur nga data e zgjedhjeve, por si i zgjedhur vendor, në kuadër të garancive të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës. Për sa kohë ai ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afatit 15-ditor, vendimi për shkarkimin është pezulluar *ipso jure*. Për rrjedhojë, Presidenti nuk kishte asnjë kompetencë të caktonte datën e zgjedhjeve përpara se të shprehej Gjykata për ankimin. Kërkuesi është mbajtës i një mandati kushtetues të pashfuqizuar ende, ndaj ka interes kushtetues për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për të ruajtur kuptimin real të mandatit deri në dhënien e vendimit nga Gjykata. Dekreti është i lidhur ngushtë me procedurën e shkarkimit dhe shqyrtimi i tij nga Gjykata është domosdoshmëri për të mos fragmentarizuar procesin kushtetues të parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës.

15.6. Dekreti ka cenuar *rendin normativ* dhe *parimin e sigurisë juridike*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi i ka hequr kërkuesit parashikueshmërinë e pasojave juridike që lidhen me pezullimin *ipso jure* të shkarkimit. Ai ka dobësuar shtetin e së drejtës dhe ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, barazinë e palëve, efektivitetin e mjetit mbrojtës, si dhe të drejtën për të mos u shkarkuar arbitrarisht dhe për të mos u ndërprerë mandati i prodhuar nga sovraniteti i qytetarëve. Dekreti nuk përbën akt autonom, megjithatë është nxjerrë në kohën kur kompetenca e Presidentit nuk kishte lindur ende. Presidenti ka cenuar parimin e ndarjes së pushteteve. Ai ka marrë rolin e interpretuesit të normës, duke përcaktuar kompetencën e gjykatave, si dhe raportin midis juridiksionit kushtetues dhe atij administrativ. Presidenti ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme se ankimi i kërkuesit duhej bërë në gjykatat administrative. Mandati i të zgjedhurit vendor nuk është funksion administrativ i deleguar nga shteti, por përfaqësim i vullnetit popullor, ndaj gëzon mbrojtje nga ndërhyrjet e pushtetit qendror në nivel kushtetues. Në këtë këndvështrim, dekreti ndërhyn në autonominë e qeverisjes vendore dhe integritetin e mandatit të të zgjedhurit me votë të lirë. Shpallja e datës së zgjedhjeve është akt juridik i pavlefshëm dhe pa pasoja.

15.7. Dekreti ka cenuar *parimin e demokracisë përfaqësuese,* pasi caktimi i datës së zgjedhjeve i ka paraprirë vendimit të Gjykatës

duke passjellë faktin e kryer. Ai ka ushtruar presion mbi Gjykatën dhe ka cenuar pavarësinë e saj funksionale.

16. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

16.1. Gjykata *nuk ka juridiksion*, pasi kërkuesi nuk është shkarkuar sipas nenit 115 të Kushtetutës. Mungesa tremujore në detyrë nuk përbën "shkelje të rëndë", ndaj neni 115 i Kushtetutës nuk zbatohet. Mandati i kryetarit të bashkisë mund të përfundojë edhe për shkaqe të tjera objektive, të ndara nga shkelja e rëndë e Kushtetutës ose e ligjeve. Edhe kur kryetari i bashkisë shkarkohet pasi është dënuar penalisht, sipas shkronjës "b" të nenit 62 të Ligjit për Qeverisjen Vendore, dënimi penal nuk përbën shkelje të rëndë sipas nenit 115 të Kushtetutës, pasi në të përfshihen edhe veprat penale të cilat nuk kanë të bëjnë me detyrën shtetërore. Mungesa tremujore mund të vijë edhe për shkaqe të tjera, si ato shëndetësore. Kjo mungesë është fakt objektiv dhe nuk kushtëzohet nëse është e justifikuar, e vullnetshme ose e qëllimshme. Në të kundërt ligjvënësi do ta kishte parashikuar shprehimisht si në rastin e deputetit në nenin 71 të Kushtetutës. Kryetari i bashkisë është organ monokratik me kompetenca ekzekutive dhe mungesa e tij shkakton mospërmbushjen e detyrës publike. Delegimi i kompetencave nuk bëhet në tërësi, por për një ose disa të tilla dhe vetëm për një periudhë të përkohshme të kufizuar, jo pa afat. Nuk është e rëndësishme nëse ndërprerja e mandatit konsiderohet përfundim ose shkarkim, por rëndësi ka se shkaku buron nga ligji, dhe jo nga neni 115 i Kushtetutës. Vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkim sipas këtij neni kushtetues ka karakter konstitutiv në vijim të një procesi hetimor administrativ, ndërsa për rastet e tjera ligjore ka karakter deklarativ fakti. Për rrjedhojë, kompetenca u përket gjykatave administrative të juridiksionit të zakonshëm.

16.2. Kërkuesi *nuk ka shteruar mjetet juridike efektive* për pretendimet që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor, në kushtet kur akti i kundërshtuar i nënshtrohet kontrollit gjyqësor dhe jo atij kushtetues.

16.3. Pretendimet për cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor* nuk qëndrojnë, pasi konstatimi i mungesës tremujore në ushtrimin e detyrës nga këshilli bashkiak nuk kërkon hetim administrativ. Mungesa është fakt i njohur botërisht dhe objektiv. Shkarkimi

nuk varet nga fakti nëse mungesa është e justifikuar ose jo, pasi mungesa cenon funksionalitetin e bashkisë. Argumenti se akti i shkarkimit është i pavlefshëm, pasi është miratuar në një mbledhje të jashtëzakonshme, është i pabazuar, pasi afatet për organizimin e mbledhjeve në Këshillin e Ministrave janë me karakter organizativ-administrativ dhe nuk diktojnë vlefshmërinë e aktit. Kërkuesi ka pasur dijeni për nismën për shkarkimin e tij nga detyra, e cila i është bërë me dije nga sekretari i këshillit bashkiak sipas ligjit. Ai ka pasur dijeni edhe për shkakun e shkarkimit dhe i është dhënë mundësia të paraqesë observacionet e tij me shkrim, nuk është penguar prej këshillit bashkiak ose Këshillit të Ministrave të marrë pjesë në mbledhje personalisht. Pamundësia e kërkuesit për të marrë pjesë në mbledhjen e këshillit bashkiak ka ardhur si rezultat i vendimeve të organeve të drejtësisë. Këshilli bashkiak dhe Këshilli i Ministrave nuk kanë shkelur asnjë afat procedural që do të sillte pavlefshmërinë e akteve të tyre.

16.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është i pabazuar, pasi kërkuesi është shkarkuar për shkak të mosparaqitjes në detyrë dhe jo për faktet e procedimit penal. Pavarësisht arsyes së mungesës, shkarkimi është i detyrueshëm për efekt të ligjit.

16.5. Pretendimet për cenimin e *autonomisë vendore, shtetit të së drejtës, hierarkisë së normave dhe pabazueshmërisë së aktit të shkarkimit* nuk qëndrojnë, pasi shkarkimi nuk është bërë sipas nenit 115 të Kushtetutës, por sipas ligjit. Është i pabazuar edhe kërkimi për shfuqizimin e dekretit të Presidentit, i cili është akt i ndërvarur me vendimin e shkarkimit. Të dyja aktet janë të ligjshme, ndaj duhet të mbeten në fuqi.

17. ***Subjekti i interesuar, Presidenti***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

17.1. Gjykata *nuk ka juridiksion* për të shqyrtuar çështjen. Neni 115 i Kushtetutës ka parashikuar garancitë kushtetuese në rastin kur shkarkimi bëhet për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Vetëm në këtë rast Gjykata shqyrton aktin administrativ individual të shkarkimit dhe ai pezullohet. Në rastet e tjera të shkarkimit Gjykata nuk ka juridiksion dhe akti nuk pezullohet, pasi del jashtë përcaktimit të nenit 115 të Kushtetutës. Shkarkimi i kryetarit të bashkisë mund të bëhet edhe për raste të ndryshme nga ky nen. Këshilli bashkiak ka qartësuar se propozimi për shkarkim

është bazuar vetëm në shkakun e parashikuar në shkronjën "c" të nenit 62 të Ligjit për Qeverisjen Vendore, pra jo për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose ligjeve. Gjykata nuk është kompetente për të shqyrtuar dekretin e Presidentit, për rrjedhojë nuk mund të vendosë pezullimin e tij. Ligji kompetencën për kontrollin e aktit ia njeh gjykatës administrative. Gjykata mund të vendoste pezullimin e vendimit për shkarkimin nga detyra, duke e lënë pa objekt dekretin e Presidentit, por jo ta pengonte këtë të fundit në ushtrimin e kompetencave të tij. Gjykata nuk ka analizuar bazën ligjore të shkarkimit, e cila përcakton juridiksionin kushtetues dhe nëse ajo do të ishte kompetente për të gjitha rastet e shkarkimit, kjo kompetencë do të listohej në nenin 131 të Kushtetutës. Gjykata ka kapërcyer kufijtë e kompetencave që ia njeh Kushtetuta dhe ajo ka detyrimin të respektojë jurisprudencën e saj. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të vendosë heqjen e pezullimit të dekretit dhe të urdhërojë KQZ-në për përgatitjen e zgjedhjeve në Bashkinë e Tiranës.

17.2. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi ai nuk është shkarkuar nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve. Mbrojtja që bën Kushtetuta nuk është e përgjithshme dhe nuk vepron për çdo shkarkim. Ai nuk legjitimohet as *ratione materiae,* pasi akti i shkarkimit është akt administrativ individual, ndërsa dekreti i Presidentit një akt administrativ kolektiv, për kontrollin e të cilit Gjykata nuk është kompetente. Për rrjedhojë, dekreti nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi përcaktuese është natyra e aktit objekt shqyrtimi dhe jo efektet që ai shkakton.

III
Kërkesat paraprake

18. Subjekti i interesuar, Presidenti, në seancën plenare publike, parashtroi kërkesën paraprake për deklarimin e moskompetencës së Gjykatës për kontrollin e dekretit për caktimin e zgjedhjeve, me argumentin se ai është akt administrativ. Sipas tij, për shkak të mungesës së kompetencës, Gjykata duhet të vendosë edhe heqjen e masës së pezullimit të pjesshëm të dekretit. Ai vuri në dukje se Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pezullimin e një pjese të dekretit duke u bazuar vetëm në kërkesën e paraqitur nga

kërkuesi, pa i dhënë mundësinë Presidentit ose Këshillit të Ministrave të shpjegonin pozicionin dhe argumentet e tyre.

19. Kërkesa paraprake e Presidentit u mbështet edhe nga subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, i cili parashtroi se vendimi i shkarkimit të kërkuesit nga detyra është i ligjshëm. Për këtë arsye, sipas tij, edhe dekreti i Presidentit është i ligjshëm dhe nuk duhet pezulluar.

20. Kërkuesi prapësoi, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës. Sipas tij, Gjykata ka kompetencë për të dyja kërkimet, pasi procesi është i ndarë në dy faza: (i) faza e propozimit dhe e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra; (ii) faza e aktivizimit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve, i cili duhet të presë marrjen e vendimit nga Gjykata për të vepruar.

21. Gjykata vëren se pezullimi i akteve që kundërshtohen përpara saj parashikohet nga neni 45, pika 1, i Ligjit Organik të saj. Sipas kësaj dispozite, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare, urdhëron pezullimin e tij. Kjo dispozitë parashikon si organ kompetent Mbledhjen e Gjyqtarëve (jashtë seancës plenare) ose Gjykatën (në seancë plenare) për të vendosur masën e pezullimit. Me fjalë të tjera, masa e pezullimit, në varësi të rrethanave faktike të rastit dhe pasojave eventuale, mund të vendoset në çdo moment kohor, përfshirë momentin kur sapo është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Kjo do të thotë se kur rrethanat faktike të rastit tregojnë për pasoja urgjente të pariparueshme, Mbledhja e Gjyqtarëve mund të vendosë pezullimin e aktit edhe vetëm mbi bazën e akteve të paraqitura nga kërkuesi, pa pritur shpjegimet nga subjektet e interesuara, siç ka ndodhur edhe në rastin konkret. Këtë qasje Gjykata e ka mbajtur edhe në raste të tjera të mëparshme, të shqyrtuara ndër vite (*shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 2, datë 18.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata thekson se masa e pezullimit ka natyrë të përkohshme dhe mund të hiqet në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, ndaj pozicioni i subjektit të interesuar që ka nxjerrë aktin mund të mbrohet përmes kërkesave që mund të paraqiten në çdo kohë, së bashku me argumentet në favor të tyre. Në funksion të këtij qëllimi, Ligji Organik i Gjykatës parashikon disa garanci, të tilla si: vendimi për masën e pezullimit i njoftohet organit që ka nxjerrë aktin, si dhe bëhet publikimi i tij (*neni 45, pika 2*); pjesëmarrësit në procesin kushtetues kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të kundërshtojnë kërkesat

e palëve të tjera (*neni 43/b, pika 1, shkronjat "d" dhe "ë")*; Gjykata në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes mund të heqë masën e pezullimit (*neni 45, pika 3*). Në të njëjtën linjë, Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës parashikon se në rastet e vendosjes së masës së pezullimit, data e seancës plenare caktohet në datën më të afërt të mundshme (*neni 27, pika 3*), si një garanci e përshpejtimit të gjykimit kushtetues, e cila është përmbushur në rastin konkret.

23. Duke iu kthyer argumentit të subjektit të interesuar se dekreti ka natyrë administrative, ndaj shqyrtimi i tij nuk është në juridiksionin kushtetues, Gjykata çmon se ai (argumenti) është i lidhur ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, ndaj do të shprehet për të me vendimin përfundimtar. Për këtë arsye, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës paraprake të Presidentit dhe vijoi me gjykimin e çështjes.

IV
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

24. Gjykata vëren se çështja e parë e debatuar nga palët ka të bëjë me juridiksionin për shqyrtimin e vendimit të shkarkimit nga detyra të kërkuesit dhe të dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve. Si kërkuesi, ashtu edhe subjektet e interesuara pranuan se në parim Gjykata, sipas nenit 115 të Kushtetutës, ka juridiksion për të shqyrtuar ankimin e kryetarit të bashkisë ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra për shkak të shkeljeve të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Megjithatë, nisur nga fakti se kërkuesi është shkarkuar për shkak të mungesës në detyrë për tre muaj të pandërprerë, palët mbajtën qëndrime të kundërta për juridiksionin. Kërkuesi parashtroi se kontrolli i akteve të kundërshtuara (vendimit të shkarkimit dhe dekretit të Presidentit) i përket juridiksionit kushtetues, ndërsa dy subjektet e interesuara prapësuan se kontrolli i këtyre akteve i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme administrative.

25. Konkretisht, kërkuesi pretendoi se juridiksioni kushtetues buron nga neni 115 i Kushtetutës, që parashikon procedurën dhe shkaqet e shkarkimit të kryetarit të bashkisë, të drejtën e ankimit në Gjykatë dhe veprimet e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve. Sipas tij, Ligji për Qeverisjen Vendore ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 115 të Kushtetutës, ndaj të tria hipotezat e parashikuara në nenin 62, në shkronjat "a", "b" dhe "c", të ligjit zbërthejnë nocionin kushtetues të "shkeljes së rëndë". Një interpretim

i kundërt, sipas tij, e bën normën ligjore antikushtetuese, cenon parimin e epërsisë së Kushtetutës dhe passjell mundësinë që nëpërmjet një akti ligjor ose nënligjor t'i hiqet Gjykatës një kompetencë që ia ka dhënë Kushtetuta. Sipas kërkuesit, kushtetutëbërësi ka parashikuar të drejtën për t'u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatë, në mënyrë që të shmanget procesi i gjatë dhe i fragmentarizuar.

26. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, prapësoi se Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes, pasi shkarkimi i kërkuesit është bazuar në nenin 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore. Mungesa tremujore në detyrë nuk përbën shkelje të rëndë që lidhet me funksionin e kryetarit të bashkisë, ndaj neni 115 i Kushtetutës nuk zbatohet. Sipas tij, jurisprudenca kushtetuese i trajton rastet e shkarkimit të ndara dhe të ndryshme nga njëri-tjetri, ndërsa nocioni "shkelje e rëndë" nuk gjendet në të gjitha dispozitat e Ligjit të Qeverisjes Vendore. Mandati i kryetarit të bashkisë nuk përfundon vetëm me shkarkim për shkelje të rënda, sipas nenit 115 të Kushtetutës, por edhe për arsye të tjera objektive dhe të ndara nga shkelja e rëndë. Për rrjedhojë, sipas Këshillit të Ministrave, kontrolli i vendimit të shkarkimit është në kompetencë të gjykatave administrative.

27. Edhe subjekti tjetër i interesuar, Presidenti, prapësoi se Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar çështjen, pasi neni 115 i Kushtetutës ka parashikuar garancitë kushtetuese vetëm në rastin kur shkarkimi bëhet për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Sipas tij, propozimi i shkarkimit është bërë vetëm për shkak të mungesës në detyrë, pra jo për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose ligjeve. Po ashtu, sipas Presidentit, Gjykata ka kapërcyer kufijtë e kompetencave që ia njeh Kushtetuta kur ka pezulluar dekretin. Ajo ka detyrimin të respektojë jurisprudencën e saj, me të cilën ka pranuar se: dekreti i Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve është akt administrativ individual, pasi ka për objekt vetëm caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë; kur kryetari i bashkisë shkarkohet për shkaqe të ndryshme nga ato të nenit 115 të Kushtetutës, kompetenca u përket gjykatave të zakonshme administrative.

28. Nisur nga qëndrimet e kundërta të palëve, Gjykata vëren se çështja parësore që shtrohet për zgjidhje ka të bëjë me juridiksionin kushtetues. Në kontekstin e këtij gjykimi, zgjidhja e juridiksionit kërkon t'i jepet përgjigje pyetjes që ka të bëjë me hapësirën e kompetencës së Gjykatës në rastin e shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë, në dy drejtime: (i) nëse kjo kompetencë ushtrohet apo jo në çdo rast shkarkimi të kryetarit të bashkisë, pavarësisht shkakut që është referuar në vendimin e shkarkimit; (ii) nëse

kjo kompetencë ushtrohet apo jo edhe për dekretin e caktimit të zgjedhjeve vendore për plotësimin e vakancës së krijuar nga shkarkimi i kryetarit të bashkisë.

29. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit ajo zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 i saj parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese *(shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Gjykata vëren se një prej kompetencave të parashikuara përtej listës së nenit 131 të Kushtetutës është ajo e nenit 115. Sipas këtij neni, Gjykata ka kompetencë të shqyrtojë dhe të vendosë për ankimin e paraqitur nga organi i zgjedhur vendor, kur ai shpërndahet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Ndërsa në pikën 3 të nenit 115 parashikohet se Presidenti cakton (me dekret) datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse kur nuk ushtrohet e drejta e ankimit ose kur Gjykata e lë në fuqi vendimin e Këshillit të Ministrave për shpërndarjen ose shkarkimin e organit të zgjedhur vendor.

31. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se vendimi për shkarkimin nga detyra të organit të qeverisjes vendore është akt administrativ individual. Në rastin e shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore, kushtetutëbërësi, në mënyrë që t'u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve, në nenin 115, pika 2, të Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e tyre për t'u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatë, si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm sipas të cilit ajo shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ *(shih vendimet nr. 24, datë 23.03.2017; nr. 67, datë 11.11.2016; nr. 32, datë 10.07.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se shkarkimi nga detyra ose shpërndarja e organeve të qeverisjes vendore është një masë ndërhyrjeje që ushtrohet mbi këto organe nga qeverisja qendrore, për rrjedhojë procedura dhe kriteret e përcaktuara nga neni 115 i Kushtetutës duhet të zbatohen në funksion të autonomisë vendore (*shih vendimin nr. 25, datë 10.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu referuar përmbajtjes së debatit të zhvilluar gjatë procesit të hartimit të Kushtetutës, Gjykata konstaton se kjo kompetencë i është dhënë asaj për dy arsye. *Së pari*, kjo kompetencë lidhet me mbrojtjen e autonomisë vendore. Në këtë kuptim, hartuesit e Kushtetutës janë shprehur se ajo (Kushtetuta) duhet të garantojë imunitetin e të zgjedhurit vendor dhe statusin e tij. Motivet e shkarkimit duhet të jenë të bazuara, pra të jetë shkelur Kushtetuta, ligjet dhe aktet e tjera. Mbrojtja e autonomisë vendore, nga e cila rrjedh edhe mbrojtja e statusit të të zgjedhurit të pushtetit lokal, duhet të garantohet në Kushtetutë, duke përfshirë edhe të drejtën për t'u ankuar në instancat gjyqësore. Statusi i të zgjedhurit lokal duhet të garantohet me ligj sipas nenit 7 të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore (*shih faqet 548-550 dhe 558 të Debatit Kushtetues, vëllimi I*). *Së dyti*, kjo kompetencë i është dhënë Gjykatës për të siguruar shpejtësinë e shqyrtimit të ankimit për të siguruar të drejtat e zgjedhësve dhe legjitimitetin demokratik të organeve të pushtetit vendor. Në këtë kuptim, hartuesit e Kushtetutës janë shprehur se kur kryetari i një bashkie ka bërë shkelje të ndryshme, ka shkelur ligjin ose Kushtetutën, duhet të ketë rrugë të shpejta për të marrë masa për riparimin e gjendjes (*shih faqet 548-550 dhe 558 të Debatit Kushtetues, vëllimi I*). Konfliktet ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor kushtetues. Në mbështetje edhe të mendimit të Komisionit të Venecies, vendimi përfundimtar për shpërndarjen duhet t'i lihet Gjykatës (*shih faqet 116 dhe 320 të Debatit Kushtetues, vëllimi II*).

33. Nën dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata thekson se, sipas nenit 109 të Kushtetutës, kryetari i bashkisë është organi ekzekutiv i qeverisjes vendore, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Si i tillë, ai e ushtron veprimtarinë bazuar në parimin e autonomisë vendore, të garantuar nga neni 13 i Kushtetutës dhe neni 2 i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Ashtu siç ka pohuar Gjykata, qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pushteti vendor ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik (*shih vendimin nr. 37, datë 12.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata evidenton se formula kushtetuese e shkarkimit nga detyra e kryetarit të bashkisë prej Këshillit të Ministrave, e parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, në thelb është mbikëqyrje administrative e pushtetit qendror

ndaj veprimtarisë së pushtetit vendor, e cila garanton që ajo veprimtari të përmbushet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Për këtë arsye, çështja e shkarkimit të kryetarit të bashkisë nga Këshilli i Ministrave nuk përbën procedim administrativ ndaj një individi të thjeshtë, por ndaj një organi kushtetues autonom, që ka marrë legjitimitet demokratik përmes zgjedhjeve të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Mënyra e zgjedhjes së kryetarit të bashkisë lidhet jo vetëm me të drejtën individuale të kryetarit të bashkisë për t'u zgjedhur, por edhe me të drejtën themelore të qytetarëve për të zgjedhur. Në këtë kuptim, nuk është e rastit që neni 115 i Kushtetutës, kur parashikon procesin e shkarkimit, i referohet literalisht organit të shkarkuar, duke mos e trajtuar si individ atë. Për pasojë, ankimi kushtetues i kryetarit të bashkisë ndaj vendimit të shkarkimit përbën mekanizëm mbrojtës të organit kushtetues.

35. Nga kjo pikëpamje, garancia kushtetuese e ankimit të organit të zgjedhur përbën element thelbësor të autonomisë vendore dhe të balancimit të pushteteve, duke siguruar mbrojtje efektive ndaj ndërhyrjeve që cenojnë funksionimin e tyre. Fakti që Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht shkaqet e shkarkimit (shkelje të rënda të Kushtetutës dhe ligjeve), nënkupton se ligji nuk mund të krijojë shkaqe të reja, duke dalë përtej parashikimit kushtetues. Në këtë kuptim, neni 115 i Kushtetutës është një dispozitë me karakter material dhe procedural, që përcakton në mënyrë taksative rastet se kur mund të shkarkohet organi i zgjedhur i njësisë së qeverisjes vendore. Ekzistenca e shkaqeve kushtetuese për shkarkim përbën garanci të shtuar për ushtrimin e lirë të funksioneve që kryejnë të zgjedhurit me votë të drejtpërdrejtë.

36. Nën këtë optikë, Gjykata thekson se është ajo që ka kompetencën për të kontrolluar vendimin e Këshillit të Ministrave për shkarkimin e organit të zgjedhur drejtpërdrejt, bazueshmëria në Kushtetutë dhe ligj e të cilit vlerësohet vetëm prej saj, si autoriteti i cili thotë fjalën e fundit. Për rrjedhojë, parashikimet e bëra në Ligjin për Qeverisjen Vendore nuk mund të interpretohen dhe të zbatohen si mekanizma që lejojnë shmangien ose rrudhjen e mbrojtjes kushtetuese të organit të qeverisjes vendore, pasi ligji nuk mund të ketë epërsi ndaj Kushtetutës. Kjo do të thotë se nuk mund të ekzistojnë dy lloje të shkarkimit të organit të zgjedhur vendor, ai "ligjor" dhe "kushtetues". Shkarkimi nga detyra, duke u parashikuar shprehimisht nga neni 115, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, është koncept kushtetues dhe si i tillë përjashton krijimin me ligj të konceptit ligjor.

37. Gjykata vëren se Këshilli i Ministrave në vendimin e shkarkimit ka

përdorur si bazë ligjore nenin 100 të Kushtetutës dhe nenin 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore, duke mos iu referuar nenit 115 të Kushtetutës. Ndërsa në relacionin shoqërues të vendimit të shkarkimit është shënuar se për sa kohë shkarkimi bazohej në shkronjën "c" të nenit 62 të Ligjit për Qeverisjen Vendore dhe jo në nenin 115 të Kushtetutës, i shkarkuari mund t'i drejtohej vetëm gjykatës administrative, ndaj ankimi eventual në gjykatën e zakonshme nuk pezullonte (*ipso jure*) efektet e tij. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se kur ajo kontrollon aktet e pushtetit publik, vlerëson jo vetëm referencën ligjore të cituar, por edhe përmbajtjen e aktit në drejtim të çështjeve që ai vetë ka rregulluar, ndaj referenca ligjore e aktit ose mungesa e saj nuk ndikon në kontrollin kushtetues (*shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Nën dritën e sa më sipër, Gjykata evidenton se shkronja "c" e nenit 62 të Ligjit për Qeverisjen Vendore nuk mund të përdoret si bazë ligjore për të shmangur të drejtën e ankimit kushtetues të të zgjedhurit vendor dhe kompetencën e Gjykatës për të kontrolluar vendimin e shkarkimit. Çdo interpretim i kundërt do të sillte zvogëlimin e mbrojtjes kushtetuese të organit të qeverisjes vendore dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e epërsisë së Kushtetutës. Kjo e fundit nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë me ligj rastet e tjera të shkarkimit, përveç atyre të parashikuara në nenin 115 të saj. Mungesa e autorizimit ligjor në këtë dispozitë tregon qartazi se qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë që mbrojtja e të zgjedhurit me votë të realizohet drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht nëpërmjet kontrollit kushtetues. Gjykata rithekson se atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji (*shih vendimet nr. 10, datë 26.02.2015; nr. 25, datë 15.12.2008; nr. 212, datë 29.12.2002 të Gjykatës Kushtetuese*). Në të kundërt ekziston mundësia e kufizimit me ligj të garancive kushtetuese të organit të zgjedhur të qeverisjes vendore, çka, në thelb, kufizon vetë kompetencën e Gjykatës.

39. Lidhur me prapësimin e subjekteve të interesuara se Gjykata edhe më parë e ka përjashtuar juridiksionin e saj për kontrollin e mbarimit para kohe të mandatit të kryetarit të bashkisë *(shih vendimin nr. 24, datë 23.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*, duhet vënë në dukje se ai rast lidhej me një proces të ndryshëm kushtetues, konkretisht me procesin e dekriminalizimit, të parashikuar nga nenet 6/1 dhe 179/1 të Kushtetutës, sipas të cilave mandati kushtetues mbaron nëse funksionari është dënuar me burgim me vendim përfundimtar të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Ndërsa në të gjitha rastet e tjera të shkarkimit, Gjykata ka pranuar juridiksionin e saj

për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të organeve të zgjedhura drejtpërdrejt të njësisë së qeverisjes vendore. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se argumenti i subjekteve të interesuara për mungesën e juridiksionit kushtetues, që bazohet në atë rast të jurisprudencës kushtetuese, nuk qëndron dhe nuk duhet të merret në konsideratë.

40. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata çmon se procesi i shkarkimit të kryetarit të bashkisë ngërthen në vetvete parime themelore kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe mënyrës së ushtrimit të tyre, ndaj kontrolli i vendimit të shkarkimit, pavarësisht shkakut të referuar në të, i përket kompetencës së saj. Rrjedhimisht, kompetenca e Gjykatës për të shqyrtuar ankimin ndaj shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë ushtrohet në çdo rast, pavarësisht shkakut që është referuar në vendimin e shkarkimit.

41. Në kushtet kur Gjykata vlerëson se ka juridiksion për të shqyrtuar ankimin e kërkuesit ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave, kontrollit të saj do t'i nënshtrohet edhe dekreti i Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve, për shkak të lidhjes funksionale që ekziston midis këtyre dy akteve. Nga përmbajtja e nenit 115 të Kushtetutës është e qartë se vendimi i shkarkimit të organit të zgjedhur vendor dhe dekreti për caktimin e datës së zgjedhjeve janë akte të njëpasnjëshme në procedurën e zgjedhjes së organit të ri vendor në vendin vakant të krijuar nga shkarkimi. Ato janë akte të pushtetit publik, të cilat ndonëse nuk kanë karakter normativ, janë të integruara në të njëjtën normë kushtetuese dhe i shërbejnë të njëjtit qëllim kushtetues, atij të legjitimitetit demokratik të organit të zgjedhur vendor. Për rrjedhojë, këto dy akte kanë lidhje funksionale me njëri-tjetrin, ndaj kontrolli i tyre nuk mund të ndahet. Ashtu siç me të drejtë ka parashtruar kërkuesi, lidhja ndërmjet dy akteve është e natyrës shkak-pasojë, ndaj Gjykata çmon se kontrolli i tyre veçmas nga juridiksione të ndryshme do të dëmtonte jo vetëm vërtetimin e fakteve të mosmarrëveshjes, por do të rrezikonte edhe koherencën e akteve juridike. Për rrjedhojë, kur Gjykata shqyrton ankimin ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë, ajo ka kompetencë për të shqyrtuar edhe dekretin e caktimit të zgjedhjeve vendore për plotësimin e vakancës së krijuar nga kryetari i shkarkuar.

42. Në këto rrethana, Gjykata do të vijojë me analizimin e legjitimimit të kërkuesit për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues sipas objektit.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

43. Neni 115 i Kushtetutës, në pikat 1 dhe 2 të tij, parashikon se organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore, mund të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve dhe se ai mund të ankohet për këtë shkarkim në Gjykatë brenda 15 ditëve.

44. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi, në cilësinë e kryetarit të bashkisë, ka kundërshtuar vendimin e shkarkimit të tij nga detyra, si dhe dekretin e caktimit të datës së zgjedhjeve në bashkinë që ai drejtonte. Për rrjedhojë, duke ritheksuar edhe lidhjen funksionale që ekziston midis dy akteve të kundërshtuara (*shih paragrafin 41 të vendimit*), Gjykata çmon se kërkuesi e justifikon interesin në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet *ratione personae*[1].

45. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike, Gjykata thekson se në rastin e ankimit të organit të zgjedhur vendor ndaj vendimit të shkarkimit, në ndryshim nga sa parashtrojnë subjektet e interesuara, organi i shkarkuar e paraqet ankimin drejtpërdrejt në Gjykatë, sipas nenit 115, pika 2, të Kushtetutës, pa pasur detyrimin për të shteruar paraprakisht mjete të tjera juridike. Për shkak të lidhjes funksionale që dekreti për caktimin e datës së zgjedhjeve ka me vendimin e shkarkimit, Gjykata vlerëson se edhe për këtë akt të pushtetit publik (dekretit) nuk ka nevojë të ndiqen rregullat për shterimin e mjeteve në gjykatën administrative, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

46. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis*, kërkuesi është shkarkuar nga detyra në datën 25.09.2025, ndërsa ankimin kushtetues e ka paraqitur në datën 29.09.2025, pra brenda afatit kushtetues 15-ditor.

47. Në datën 20.10.2025 kërkuesi ka paraqitur shtesë të shkaqeve të ankimit, duke ngritur pretendime të reja për procedurën e shkarkimit. Ai shpjegoi në seancë plenare se shkaqet e reja janë paraqitur në momentin që pati mundësinë të njihej me përmbajtjen e akteve të kundërshtuara. Aktet atij iu vunë në dispozicion nga Gjykata dhe Presidenti, pasi çështja kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare.

[1] Gjyqtaret Holta Zaçaj dhe Sonila Bejtja vlerësuan se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të mënyrës së votimit në këshillin bashkiak, me arsyetimin se kërkuesi nuk është mbartës i së drejtës që pretendon se i është cenuar, pasi ajo u takon anëtarëve të këtij këshilli. Po kështu, kërkuesi nuk legjitimohet as për argumentin se mbledhja në Këshillin e Ministrave është zhvilluar me urgjencë dhe në mungesë të pranisë fizike të anëtarëve të tij, pasi ai nuk ka arritur të provojë interesin e drejtpërdrejtë, në kushtet kur kjo e drejtë u përket anëtarëve të këtij këshilli.

48. Gjykata ka pohuar se, në mbështetje të nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të saj dhe nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, shkaqet e ankimit kushtetues mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në rastin konkret, ekzistojnë disa rrethana specifike, të cilat standardin e mësipërm e bëjnë të pazbatueshëm, pasi do e shndërronin ankimin kushtetues në një mjet iluzor. Këto rrethana kanë të bëjnë me: (i) përshpejtimin e gjykimit kushtetues për shkak të interesit të lartë publik, ku duhet vënë në dukje se shqyrtimi paraprak i çështjes konkrete ka zgjatur gjithsej 10 ditë nga regjistrimi i ankimit; (ii) izolimin e kërkuesit për shkak të masës së sigurimit të arrestit në burg, që siç ka pohuar Gjykata në raste të tjera sjell pengesa në respektimin e afatit (*shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*); (iii) padijeninë e kërkuesit për aktet, pasi njëri prej pretendimeve të kërkuesit lidhet me të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, bazuar në argumentin se gjatë procedurës së shkarkimit nuk iu komunikuan aktet. Në vlerësim tërësor të këtyre rrethanave, Gjykata çmon se përjashtimisht në rastin konkret kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* edhe për shkaqet e reja të ankimit.

49. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, mbështetur në argumentin se është konsideruar fajtor pa një vendim të formës së prerë dhe masa e sigurimit personal është përdorur si bazë faktike për ta shkarkuar atë nga detyra, ndonëse paraburgimi nuk mund të prodhojë *ipso facto* ndërprerje të mandatit. Po kështu, shprehet kërkuesi, ai është paragjykuar dhe ndaj tij është presupozuar një sjellje e fajshme. Lidhur me këtë pretendim, në përfundim të diskutimeve, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim. Konkretisht, sipas njërit qëndrim, parimi i prezumimit të pafajësisë gjen zbatim në rastin e procedurave të dyfishta (procedim penal dhe procedim administrativ), të cilat zhvillohen paralelisht. Në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, ky pretendim është i lidhur ngushtësisht me atë për shkaqet antikushtetuese të shkarkimit, ndaj duhet shqyrtuar në themelin e tij.[2] Ndërsa sipas qëndrimit tjetër, ky parim përbën garanci kushtetuese për

[2] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Ilir Toska.

çështje të natyrës penale, ndaj për këtë shkak në një proces administrativ si rasti konkret nuk gjen zbatim.[3]

50. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, Gjykata rithekson se kur vihet në lëvizje nga organi i zgjedhur vendor, që ankohet ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij nga detyra, ajo kontrollon nëse gjatë procesit disiplinor administrativ është garantuar përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij, e drejta për proces të rregullt ligjor. Ajo e bën këtë shqyrtim si nga pikëpamja e faktit, ashtu dhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural (*shih vendimet nr. 25, datë 10.05.2021; nr. 32, datë 10.07.2013; nr. 29, datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese).*

51. Duke pasur parasysh se e drejta për proces të rregullt nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ, Gjykata do ta analizojë themelin e çështjes në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor të lidhur me masën e shkarkimit nga detyra. Në këtë pikë Gjykata thekson se shqyrtimi dhe vlerësimi i çështjes është i kufizuar vetëm në kontrollin kushtetues të procesit administrativ të shkarkimit të kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, pra jo me procesin penal të regjistruar në ngarkim të tij.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për të drejtën për proces të rregullt ligjor të shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë

52. Kërkuesi ka pretenduar se masa e shkarkimit të tij nga detyra është rezultat i një procesi të parregullt ligjor, duke evidentuar një sërë parregullsish procedurale. Sipas tij, ai nuk është informuar zyrtarisht për kohën, materialet e shqyrtuara (shkaqet e shkarkimit) dhe për të drejtën për t'u dëgjuar në mbledhjet e këshillit bashkiak dhe të Këshillit të Ministrave, ku u miratua propozimi dhe më pas, shkarkimi nga detyra. Atij nuk i është kërkuar sqarimi ose paraqitja e provave lidhur me shkeljet e pretenduara, ndaj vendimi është bazuar vetëm në argumentet e njërës palë. Votimi në këshillin bashkiak është bërë i hapur, në shkelje të rregullores. Këshilli i Ministrave është mbledhur në mbledhje të jashtëzakonshme dhe pa respektuar afatet ligjore. Po kështu, sipas kërkuesit, akti i shkarkimit bie ndesh me Kushtetutën për sa kohë mungesa e tij në detyrë është e shkaktuar nga rrethana objektive dhe nuk përbën shkelje të rëndë. Në thelb, shkaku

[3] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini.

i përdorur për shkarkim nuk lidhet me mungesën e dëshirës së tij për të mos u paraqitur në detyrë, por me arsyen objektive të masës së sigurimit të arrestit në burg. Ndërkohë, ai i ka deleguar kompetencat për drejtimin e bashkisë, duke vijuar ushtrimin e detyrës së tij. Sipas kërkuesit, këshilli bashkiak dhe Këshilli i Ministrave nuk kanë bërë asnjë analizë për të përcaktuar sjelljen si shkelje të rëndë në raport me pasojat për komunitetin dhe qëndrimin subjektiv të tij, si dhe nuk e kanë ndërlidhur rrethanën e paraburgimit me ndonjë sjellje që mund të kualifikohet si shkelje e rëndë e ligjit. Shkarkimi nga detyra është bazuar në një shkak ekstraligjor dhe mbi bazën e orientimeve politike. Këshilli i Ministrave në nxjerrjen e vendimit për shkarkimin nga detyra ka zëvendësuar vullnetin e zgjedhësve me diskrecionin ekzekutiv pa asnjë bazë juridike. Ai nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit midis ndërhyrjes dhe qëllimit që kërkohej të arrihej.

53. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuesi është informuar nga sekretari i këshillit bashkiak për mbledhjen e këshillit bashkiak, shkakun e shkarkimit dhe mundësinë për të paraqitur observacionet me shkrim. Kërkuesi nuk është penguar prej këshillit bashkiak ose Këshillit të Ministrave të marrë pjesë në mbledhje personalisht, por pamundësia ishte rezultat i vendimeve të organeve të drejtësisë për masën e sigurimit të arrestit në burg. Këshilli bashkiak dhe Këshilli i Ministrave nuk kanë shkelur asnjë afat procedural që do të sillte pavlefshmërinë e akteve të tyre. Afatet ligjore të mbledhjes së Këshillit të Ministrave janë me karakter organizativo-administrativ dhe nuk diktojnë vlefshmërinë e vendimit të shkarkimit nga detyra. Sipas Këshillit të Ministrave, konstatimi i mungesës tremujore në ushtrimin e detyrës nga këshilli bashkiak është rrethanë objektive dhe nuk kërkon hetim administrativ, pasi është fakt i njohur botërisht. Vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra ka karakter konstitutiv dhe është në vijim të një procesi hetimor administrativ, ndërsa për rastet e tjera të parashikuara në ligj ka karakter deklarativ dhe konstatim fakti. Shkarkimi nuk varet nga fakti nëse mungesa është e justifikuar ose jo, por është rezultat i faktit se mungesa cenon funksionalitetin e bashkisë. Sipas Këshillit të Ministrave, kryetari i bashkisë është organ monokratik me kompetenca ekzekutive dhe mungesa e tij sjell si pasojë mospërmbushjen e detyrës publike. Delegimi i kompetencave nuk bëhet në tërësi dhe pa afat, por për një ose disa kompetenca dhe vetëm për një periudhë të përkohshme.

54. Gjykata ka pohuar se gjykimi, i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, është gjykim në themel i çështjes.

Gjykata, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose ligjit heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm *(shih vendimet nr. 15, datë 08.06.2009; nr. 22, datë 07.10.2008; nr. 39, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykimi i çështjeve të tilla ka për objekt një akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata (*shih vendimet nr. 37, datë 25.07.2013; nr. 32, datë 10.07.2013; nr. 29, datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese).*

55. Nga pikëpamja e kushtetutshmërisë Gjykata është ndalur tek e drejta për proces të rregullt ligjor, duke theksuar se ajo nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt si një e drejtë themelore (*shih vendimet nr. 37, datë 25.07.2013; nr. 29, datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar gjithashtu se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur *(shih vendimin nr. 29, datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

56. Ndërsa nga pikëpamja e ligjshmërisë Gjykata i referohet përgjithësisht Kodit të Procedurave Administrative, i cili përmban një sërë garancish ligjore. Garancitë jo vetëm sigurojnë zhvillimin e rregullt të procesit administrativ, por mundësojnë edhe kontrollin e përmbushjes së detyrimeve nga organet publike (*shih vendimin nr. 25, datë 10.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë optikë, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar rregullat e procedimit disiplinor, si të drejtën e pjesëmarrjes në një procedurë administrative (*neni 33*), njoftimin e palës (*neni 42*), të drejtën e njohjes me dosjen (*neni 45*), të drejtën për të paraqitur mendime dhe shpjegime (*neni 47*), të drejtën për t'u dëgjuar në çdo formë të përshtatshme për të paraqitur komente dhe prova (*neni 88*) dhe rastet e përjashtimit nga kjo e drejtë (*neni 89*). Përveç elementeve formale, akti administrativ duhet

të jetë i qartë dhe të përmbajë, krahas shpjegimit të situatës faktike mbi të cilën është marrë akti, edhe shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave, bazën ligjore të aktit, një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast, si dhe në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar (*neni 100*).

57. Nisur nga konteksti i pretendimeve të kërkuesit, që ka kundërshtuar edhe procedurën e mbledhjes së këshillit bashkiak dhe të Këshillit të Ministrave, Gjykata evidenton se neni 55, pika 1, i Ligjit për Qeverisjen Vendore përcakton se votimi bëhet i hapur ose i fshehtë, ndërsa me kërkesë të jo më pak se 1/3-ës të anëtarëve të tij, këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Në plotësim të këtyre rregullave, neni 58 i rregullores së këshillit bashkiak parashikon se votimi bëhet i hapur ose i fshehtë, sipas vendimit që merr këshilli (*pika 1*), por procesi i votimeve të akteve me karakter individual kryhet si rregull me votim të fshehtë (*pika 2*). Po kështu, ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" (*Ligji për Këshillin e Ministrave*) përmban disa rregulla për organizmin e mbledhjeve ku shqyrtohen dhe miratohen akte të Këshillit të Ministrave. Këto rregulla kanë të bëjnë, ndër të tjera, me procesin e hartimit të akteve (*neni 23*), bashkërendimin e akteve (*neni 24*), përmbajtjen e projektakteve (*neni 25*), shqyrtimin e tyre (*neni 19*), rendin e ditës dhe afatin dyditor të njoftimit të tyre dhe materialeve të mbledhjes (*neni 15*) dhe mbledhjet e jashtëzakonshme, ku nuk zbatohen rregullat e përgjithshme (*neni 24*).

58. Mbi bazën e standardeve dhe garancive të mësipërme, Gjykata vëren se në çështjen konkrete kërkuesi është arrestuar në datën 10.02.2025 dhe është izoluar në seksionin e paraburgimit të IEVP-së, Durrës për efekte të një procedimi penal të filluar ndaj tij. Pas kësaj ngjarjeje, në këshillin bashkiak janë paraqitur tri kërkesa për t'i propozuar Këshillit të Ministrave shkarkimin e kërkuesit nga detyra, konkretisht në datat 25.02.2025, 09.05.2025 dhe 18.09.2025. Kërkesat janë paraqitur nga tre grupe të ndryshme politike të këshilltarëve, por dy prej tyre (kërkesa e dytë dhe e tretë) mbështeteshin në të njëjtin motivacion – atë të mosparaqitjes në detyrë për një periudhë tremujore të pandërprerë. Dy kërkesat e para kanë mbetur pa asnjë veprim deri më 18.09.2025 kur u paraqit kërkesa e tretë nga këshilltarët e këshillit bashkiak, që i përkasin shumicës qeverisëse (Partisë Socialiste). Kërkesa e tretë u paraqit në një kontekst faktesh me natyrë politike. Konkretisht, ajo u paraqit pas mbledhjes së asamblesë të

asaj partie politike, ku kryetari i partisë, njëherazi edhe kryeministër, u kërkoi anëtarëve socialistë të këshillit bashkiak të nisnin procedurën e shkarkimit të kryetarit të bashkisë.

59. Me paraqitjen e kërkesës së tretë është caktuar dhe është zhvilluar mbledhja e këshillit bashkiak në datën 23.09.2025. Procedura për propozimin e shkarkimit ka përfunduar brenda 5 ditëve (18.09.2025 – 23.09.2025). Përgjatë këtij segmenti kohor, kërkuesi, me nismën e tij, ka paraqitur dy kërkesa me shkrim, në datat 19.09.2025 dhe 22.09.2025, duke parashtruar se kishte marrë dijeni nga media për mbledhjen e këshillit bashkiak dhe duke kërkuar që përpara marrjes së vendimit të njihej me aktet, t'i sigurohej mundësia të ishte i pranishëm në mbledhje, të dëgjohej nga këshilli dhe të ushtronte të drejtën e mbrojtjes. Të dyja kërkesave iu është përgjigjur sekretari i këshillit bashkiak me shkresat e datave 22.09.2025 dhe 23.09.2025, me të cilat konfirmonte se mbledhja ishte caktuar për t'u zhvilluar në datën 23.09.2025, ora 16:00. Gjykata vëren se sekretari i këshillit bashkiak e ka informuar kërkuesin me shkrim se ndaj tij nuk ka një vendim të këshillit që e ndalonte të ishte i pranishëm fizikisht, ndonëse izolimi i kërkuesit për shkak të masës së sigurimit të arrestit në burg ishte fakt i njohur botërisht. Po ashtu, sekretari i këshillit bashkiak e ka informuar kërkuesin se ai mund t'i paraqiste me shkrim observacionet e tij, por pa i përcjellë ndonjë kopje të projektpropozimeve të depozituara për shqyrtim në mbledhjen e këshillit bashkiak.

60. Këshilli bashkiak është mbledhur sipas planifikimit dhe me vendimin e datës 23.09.2025, bazuar në nenet 61, shkronja "ç" dhe 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore, ka vendosur t'i propozojë Këshillit të Ministrave shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë, duke urdhëruar që vendimi t'i njoftohej Prefektit të Tiranës. Votimi është bërë i hapur, pavarësisht se rregullorja e këshillit bashkiak parashikon se procesi i votimeve të akteve me karakter individual kryhet si rregull me votim të fshehtë. Ndonëse propozimi për shkarkim është miratuar me 50 vota pro nga 51 këshilltarë të pranishëm në momentin e votimit, në relacionin shpjegues që e shoqëronte atë është pasqyruar vetëm qëndrimi i këshilltarëve të shumicës qeverisëse. Sipas relacionit shoqërues, nga data 10.02.2025 kryeqyteti nuk e ka kryetarin e zgjedhur nga qytetarët për shkak të procesit penal; kërkuesit i është mohuar e drejta e gjykimit në gjendje të lirë; kryeqytetit i duhet një kryetar në detyrë, për ndjekjen e punëve; ndërmarrja e nismës për procedurën e shkarkimit të kryetarit ishte detyrim ligjor, politik dhe moral ndaj qytetarëve që kanë votuar për

një qytet më të zhvilluar, me shërbime cilësore dhe të denjë për të qenë kryeqyteti i Shqipërisë; vendimmarrja e këshillit bashkiak nuk nënkuptonte pranim të fakteve të pretenduara të procesit penal ndaj kërkuesit, por krejt të kundërtën. Në relacionin shpjegues nuk është pasqyruar ndonjë e dhënë përse votimi është bërë i hapur. Nuk rezulton që në relacion të jetë analizuar përse mosparaqitja në detyrë përbënte shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe as mendimi i kërkuesit në raport me mungesën e pandërprerë në detyrë të tij. Po ashtu nuk është analizuar se përse këshilli bashkiak ka vlerësuar se kryebashkiaku nuk përfitonte nga e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

61. Ndonëse mbledhja e këshillit është zhvilluar pasditen e datës 23.09.2025, të nesërmen janë kryer një sërë veprimesh: (i) Prefekti i Tiranës, në mbështetje të nenit 61, pika 3, të Ligjit për Qeverisjen Vendore, ka verifikuar ligjshmërinë e propozimit për shkarkim dhe ia ka përcjellë atë Këshillit të Ministrave; (ii) ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, në cilësinë e ministrit propozues, ka hartuar projektvendimin e Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe ia ka përcjellë për mendim ministrit të Drejtësisë; (iii) ministri i Drejtësisë ka dhënë mendimin për projektvendimin dhe ia ka dërguar ministrit propozues; (iv) ministri propozues ka finalizuar praktikën dhe e ka përcjellë projektaktin për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave. Edhe në relacionin shoqërues të projektvendimit nuk rezulton të jetë analizuar përse mosparaqitja në detyrë e kërkuesit përbënte shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, as mendimi i tij në raport me mungesën e pandërprerë në detyrë të tij. Po kështu, nuk është dhënë ndonjë shpjegim përse Këshilli i Ministrave duhet të vlerësonte se kryetari i bashkisë nuk duhet të përfitonte nga e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

62. Ligji për Këshillin e Ministrave parashikon një afat minimal prej dy ditësh për shqyrtimin e akteve, por në rastin konkret, një ditë më pas, më 25.09.2025, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin për shkarkimin nga detyra të kërkuesit. Pas një dite ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 26.09.2025.

63. Nga analiza e rrethanave faktike, Gjykata evidenton, *së pari*, se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin një sërë garancish procedurale, të cilat përbëjnë detyrime pozitive të organeve publike që zhvillojnë procedurën e shkarkimit nga detyra të organit të zgjedhur të qeverisjes vendore. Barra për përmbushjen e këtyre garancive nuk mund të zhvendoset tek individi ndaj të cilit zhvillohet kjo procedurë. Këto garanci synojnë jo

vetëm sigurimin e transparencës dhe informimit të plotë për natyrën dhe arsyet e procedimit, por edhe krijimin e kushteve reale dhe efektive që subjekti i prekur të ushtrojë të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur mbrojtjen e tij. Në këtë kuptim, Gjykata vë në dukje se thjesht marrja dijeni nga kërkuesi për datën e mbledhjes së këshillit bashkiak nuk mjafton për të çliruar organin publik nga detyrimi për të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme procedurale që garantojnë një proces të drejtë dhe jo formalist. Standardi kushtetues i procesit të rregullt kërkon që organet publike të veprojnë me nismën e tyre, veçanërisht në rastet kur individi ndodhet në një situatë objektive jofavorizuese, siç është izolimi për shkak të masave të sigurimit personal. Kjo e fundit, logjikisht, e bën të pamundur pjesëmarrjen fizike të kërkuesit në mbledhjen e këshillit bashkiak pa ndërhyrjen e organeve kompetente.

64. Megjithëse kufizimi i kërkuesit ishte fakt i ditur botërisht, nuk rezulton që ndonjë prej institucioneve propozuese dhe miratuese të masës së shkarkimit të ketë ndërmarrë ndonjë masë administrative ose organizative për t'i njoftuar atij aktet e paraqitura dhe për të mundësuar pjesëmarrjen e tij, qoftë përmes kërkesës për shoqërim në mbledhjen e këshillit bashkiak ose edhe përmes ndonjë forme tjetër me shkrim. Nga ana tjetër, komunikimi i sekretarit të këshillit me kërkuesin rezulton formalist dhe jo efektiv në drejtim të garantimit të procesit të rregullt. Sekretari i këshillit bashkiak në mënyrë të papërshtatshme i vinte në dukje kërkuesit të izoluar në seksionin e paraburgimit se nuk kishte ndonjë vendim të këshillit bashkiak që pengonte pjesëmarrjen e tij në mbledhje. Ai, po ashtu, i kërkonte kërkuesit paraqitjen me shkrim të observacioneve, pa i njoftuar ndonjë akt të procedurës dhe për më tepër i kërkonte për një kohë tepër të shkurtër, "brenda 24 orëve", pa marrë në konsideratë vështirësitë praktike që rrjedhin nga situata e kufizimit të lirisë. Koha e shkurtër që i lihej kërkuesit është haptazi në raport të zhdrejtë me kohën prej tre ditësh që iu nevojit vetë sekretarit të këshillit për t'iu përgjigjur kërkuesit, ndonëse përgjigjja e hartuar ishte e shkurtër dhe nuk përmbante ndonjë informacion të ndërlikuar për t'u përgatitur. Për më tepër, një komunikim i tillë u ndërmor vetëm pas interesimit të drejtpërdrejtë të vet kërkuesit, çka tregon pasivitet në veprimet e organit publik për të përmbushur detyrimet ligjore për të garantuar në mënyrë aktive dhe të pavarur të drejtën e kërkuesit për t'u mbrojtur dhe marrë pjesë realisht dhe efektivisht në procedurën e propozimit për shkarkim.

65. Kjo qasje formaliste rezulton të jetë përligjur në vijim nga të gjitha

organet shtetërore të ngarkuara me kompetenca në këtë proces, duke filluar nga prefekti, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, ministri i Drejtësisë, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe vetë Këshilli i Ministrave. Këto organe kanë vepruar me shpejtësi, duke i kryer veprimet brenda disa orëve, pa mbajtur në konsideratë parimin e autonomisë vendore, në kuptimin që vendimi i shkarkimit të kryetarit të bashkisë, si një organ i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, përbën ndërhyrje të pazakontë të pushtetit qendror ndaj atij vendor. Në këtë pikëpamje, *prima facie* veprimet e kryera duken si efektivitet i veprimtarisë së organit publik. Megjithatë, duke i ndërthurur të dhënat faktike, Gjykata vlerëson se mënyra në të cilën është zhvilluar procedura nga këshilli bashkiak dhe, në vijim, nga Këshilli i Ministrave, nuk ka përmbushur standardet e procesit të rregullt, si në drejtim të kushtetutshmërisë, ashtu edhe të ligjshmërisë. Mosnjoftimi i kërkuesit për arsyet, bazën ligjore dhe ecurinë e procedurës, si dhe mosmarrja e masave të nevojshme për t'i mundësuar atij ushtrimin efektiv të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, krijuan një situatë në të cilën pjesëmarrja e tij u bë iluzore dhe formaliste. Nga ana tjetër, të dhënat faktike, të ndërthurura me njëra-tjetrën, tregojnë se vendimi për shkarkimin e organit të zgjedhur vendor është marrë pa përmbushur detyrimet kushtetuese, si në drejtim të procesit të rregullt, ashtu edhe në drejtim të parimit kushtetues të autonomisë vendore, duke kryer formalisht procedurën dhe duke cenuar thelbin e garancive kushtetuese deri në asgjësimin e tyre. Në një rast si ky, ku masa e shqyrtuar ka rëndësi dhe sjell pasoja të drejtpërdrejta në ushtrimin e mandatit të zgjedhur, organet publike kishin detyrimin pozitiv të ndërhynin në mënyrë aktive për të siguruar respektimin e të drejtave procedurale të kërkuesit dhe për të shmangur çdo praktikë që e privonte atë nga mundësia reale e mbrojtjes. Duke mos vepruar në këtë mënyrë, organet kompetente kanë cenuar jo vetëm procesin e rregullt ligjor, por nuk kanë respektuar as parimin e autonomisë vendore.

66. *Së dyti*, në vijim të analizës për juridiksionin (*shih paragrafin 41 të vendimit*), Gjykata thekson se neni 62 i Ligjit për Qeverisjen Vendore është detajim i nenit 115 të Kushtetutës, i cili përcakton qartë se shkarkimi i kryetarit të bashkisë bëhet vetëm në rast se ai ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës ose ligjeve. Përmbajtja eksplicite e normës kushtetuese për shkaqet e shkarkimit nuk i jep ligjvënësit të zakonshëm kompetencën për të parashikuar shkaqe të tjera ose më të gjera shkarkimi përtej shkeljes së rëndë kushtetuese ose ligjore. Një arsyetim i kundërt nuk pajtohet me parimin e autonomisë vendore, sepse kompetenca e Këshillit të Ministrave

për të shkarkuar nga detyra organin vendor të zgjedhur drejtpërdrejt nga zgjedhësit është e pazakontë dhe mund të justifikohet vetëm nga nevoja për të riparuar një veprimtari të rëndë antikushtetuese ose antiligjore të organit vendor.

67. Në këtë kuadër, Gjykata vëren se kërkuesi është shkarkuar bazuar në nenin 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore, i cili parashikon shkarkimin e kryetarit të bashkisë në rast të mosparaqitjes në detyrë për një periudhë të pandërprerë tremujore. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar nëse mungesa duhet të jetë e pajustifikuar, e qëllimshme ose e varur nga vullneti i organit të qeverisjes vendore, duke u mjaftuar vetëm me faktin objektiv të mosparaqitjes. Megjithatë, Gjykata çmon se kjo dispozitë nuk mund të interpretohet në mënyrë të shkëputur nga neni 115 i Kushtetutës. Çdo interpretim i nenit 62 të ligjit duhet të garantojë që zbatimi i tij të mos lejojë që rrethana faktike që nuk burojnë nga sjellja e vet kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të konsiderohen automatikisht shkelje e rëndë e Kushtetutës ose e ligjeve.

68. Gjykata nuk ndalet në interpretimin historik të nenit 62, shkronja "c", të Ligjit të Qeverisjes Vendore, në kushtet kur objekti i gjykimit është i kufizuar në kushtetutshmërinë e vendimit të shkarkimit nga detyra. Megjithatë, duhet vënë në dukje se është e mundur që mosparaqitja në detyrë për një periudhë të pandërprerë tremujore të përbëjë shkelje të rëndë në ushtrimin e detyrës nga kryetari i bashkisë, por gjithnjë kur ai mund dhe duhet të mbajë përgjegjësi, në ndryshim nga rasti konkret, ku kërkuesit nuk i atribuohet asnjë lloj përgjegjësie juridike. Në këtë rast shkelja e rëndë ka të bëjë me mospërmbushjen thelbësore të detyrës me vullnetin e tij, duke mbajtur në konsideratë se kryetari i bashkisë është organ ekzekutiv monokratik. Siç ka theksuar Gjykata, çdo organ kushtetues dhe pjesë përbërëse të tij kanë detyrimin t'i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Nga ky rregull rrjedh, gjithashtu, detyrimi që të gjitha organet gjatë ushtrimit të detyrës duhet të mbajnë përgjegjësinë që u takon në çdo aspekt të veprimtarisë së tyre dhe, në këtë kuptim, kushdo që ushtron një funksion publik nuk është i përjashtuar nga përgjegjësia. Për të realizuar efektivisht zbatimin e parimit të shtetit të së drejtës, kuadri normativ i një shteti parashikon edhe rastet ekstreme të përgjegjësisë, pra rastet kur funksionari mund të shkarkohet për shkak të mosushtrimit të përgjegjshëm të detyrës me të cilën është ngarkuar (*shih vendimet nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 23, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

69. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se Këshilli i Ministrave,

në momentin e ushtrimit të kompetencës për shkarkimin e kërkuesit, ka zbatuar nenin 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore pa e lidhur dhe pa e justifikuar atë me kriterin kushtetues të shkeljes së rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, siç kërkohet nga neni 115 i Kushtetutës. Vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili ka marrë për bazë vetëm faktin e mungesës tremujore në detyrë, nuk ka analizuar shkakun, rrethanat dhe as ndikimin e mungesës në ushtrimin e detyrës, duke mos vlerësuar nëse kjo situatë rridhte nga veprimet ose mosveprimet e vet kryetarit dhe nëse ajo mund të konsiderohej shkelje e rëndë e Kushtetutës ose e ligjeve. Gjykata thekson se mbrojtja e interesit publik për të siguruar funksionimin e rregullt të organeve të qeverisjes vendore dhe të drejtën e zgjedhësve për t'u qeverisur nga një organ i zgjedhur drejtpërdrejt nuk mund të përdoret si argument për të relativizuar ose anashkaluar kërkesat e qarta kushtetuese. Standardet kushtetuese të mbrojtjes së mandatit të të zgjedhurit vendor dhe të kufizimit të kompetencave shkarkuese të pushtetit ekzekutiv kanë për qëllim pikërisht mbrojtjen e parimit të autonomisë vendore dhe të vullnetit të zgjedhësve. Prandaj, zbatimi mekanik i një dispozite ligjore pa u lidhur me kriterin material kushtetues, përbën shmangie nga rendi kushtetues dhe cenon garancitë thelbësore të ushtrimit të mandatit të përfaqësimit vendor.

70. Për sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi i shkarkimit të kërkuesit nga detyra është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, që ka sjellë pasojë cenimin edhe të parimit të autonomisë vendore, ndaj pretendimet e tij që lidhen me atë proces janë të bazuara.

C.2 Për dekretin e caktimit të zgjedhjeve

71. Gjykata vëren se çështja e fundit e debatuar në gjykim ka të bëjë me vlefshmërinë e dekretit të Presidentit, për shkak të kohës së nxjerrjes së tij. Lidhur me këtë çështje kërkuesi dhe subjekti i interesuar, Presidenti, mbajtën qëndrime të kundërta, si rrjedhojë e interpretimit të ndryshëm të kuadrit normativ të zbatueshëm.

72. Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se dekreti është nxjerrë në një moment kur kompetenca e Presidentit nuk kishte lindur ende dhe i parapriu vendimit të Gjykatës, duke ushtruar presion mbi të, pasi e vendosi përballë faktit të kryer. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit, dekreti i caktimit të zgjedhjeve ka cenuar autonominë e qeverisjes vendore, rendin normativ, sigurinë juridike, demokracinë përfaqësuese, shtetin e së drejtës dhe të drejtën e kërkuesit për proces të rregullt ligjor.

73. Ndërsa subjekti i interesuar, Presidenti, në seancë plenare, ka

prapësuar se dekreti është kushtetues si në momentin që u nxor, ashtu edhe në kohën e këtij gjykimi. Për Presidentin çështja është formalitet, pasi ai merr një akt zyrtar të shtetit dhe sheh detyrimet e tij për procesin zgjedhor, pra nuk është hallkë verifikimi për të shqyrtuar ligjshmërinë e aktit. Presidenti kontrollon vetëm nëse institucioni kompetent ka zbatuar detyrat e veta dhe nëse akti i shkarkimit ka për bazë vullnetin e këshillit bashkiak, pra a ka plotësuar kushtet ligjore. Presidenti nuk mund të pretendojë se neni 62, shkronja "c", i Ligjit për Qeverisjen Vendore është antikushtetues dhe nuk është i detyruar ta zbatojë atë, por është i detyruar të zbatojë ligjin në formën që ai është dhe për sa kohë ai është në fuqi. Sipas tij, nëse ka një opinion jashtë procedurës zbatuese, ka të drejtën t'i drejtohet Gjykatës. Presidenti u orientua në verifikimin e ligjshmërisë së procedurës në rastin konkret dhe se për të neni 115 i Kushtetutës nuk përcakton shkaqet për shkarkimin e kryetarit të bashkisë, por garancitë e posaçme në rastin kur ai sulmohet politikisht. Presidenti kur ka marrë vendimin ka respektuar Kushtetutën, jurisprudencën kushtetuese, kuadrin ligjor dhe autoritetin e Gjykatës për të respektuar pezullimin. Presidenti ka parashtruar se i ka lënë kohë Gjykatës për të pezulluar aktin e shkarkimit, zgjedhjet caktohen pasi ka një akt shkarkimi dhe nëse pezullohet ky i fundit, edhe Presidenti rrjedhimisht pezullon veprimet e tij.

74. Në kushtet kur debati i palëve lidhet me rolin dhe kompetencën e Presidentit, Gjykata rithekson se Presidenti i Republikës i ushtron kompetencat në mënyrë të tillë që të ndihmojë, nxisë, komunikojë dhe bashkëveprojë me organet dhe subjektet e ndryshme, të cilave Kushtetuta u beson funksionet e drejtimit politik ose të garancive kushtetuese, me qëllim që të respektohen dhe mbrohen vlerat e parashikuara në ligjin themelor sipas parimit se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Ai ka rolin përfaqësues të unitetit të popullit, sidomos në drejtim të strukturës së rendit kushtetues, në mënyrë që pushtetet të funksionojnë në mënyrë harmonike dhe në kohezion të plotë, pra të përmbushin përgjegjësitë dhe të mos tejkalojnë pushtetet e tyre e të mos veprojnë në mënyrë të plogësht (*shih vendimin nr. 1, datë 16.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

75. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se Presidenti ka misionin kryesor të përfaqësimit të unitetit të popullit, ndaj ai ka mandatin kushtetues për të kontribuar në funksionimin normal të shtetit (*shih vendimin nr. 26, datë 25.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Presidenti i përmbahet parimit të neutralitetit, pasi është Kryetari i Shtetit dhe përfaqëson interesat e përgjithshëm të vendit dhe jo interesa partiakë. Në kontekstin e procesit

zgjedhor, ai, duke ruajtur asnjanësinë politike, njëherazi nxit dhe moderon organet dhe subjektet e ndryshme që kanë funksione të caktuara në këtë proces, me qëllim realizimin e tij në përputhje me standardet kushtetuese (*shih vendimin nr. 1, datë 16.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

76. Nga pikëpamja normative, Gjykata vëren se çështja konkrete lidhet me kompetencën e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve të parakohshme vendore. Kjo kompetencë parashikohet në mënyrë të përgjithshme në nenin 92, shkronja "gj", të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti cakton datën e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor. Kjo kompetencë në rastin e zgjedhjeve vendore të parakohshme rregullohet në mënyrë specifike në nenin 115, pika 3, të Kushtetutës, sipas të cilit në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata, Presidenti cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.

77. Gjykata, bazuar në këtë kuadër normativ, rithekson se dekreti për caktimin e zgjedhjeve vendore të parakohshme ka lidhje funksionale me vendimin e shkarkimit nga detyra të të zgjedhurit vendor (*shih paragrafin 41 të vendimit*). Ai dekret është akti i fundit që del në procedurën e shkarkimit të kryetarit të bashkisë, që i hap rrugën zgjedhjeve të parakohshme. Nuk është e tepërt të evidentohet se edhe në rastin e zgjedhjeve të parakohshme janë të zbatueshme kërkesat kushtetuese të nenit 109 të Kushtetutës, që lidhen me zgjedhjet e drejtpërdrejta dhe votimin e fshehtë, që i japin legjitimitetin demokratik kryetarit të bashkisë, si organi ekzekutiv i bashkisë.

78. Nisur nga përmbajtja në tërësi e nenit 115 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje se kompetenca e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve synon t'i japë legjitimitetin e nevojshëm demokratik zgjedhjeve të parakohshme që do të zhvillohen, në kuptim të rolit të tij kushtetues për të përfaqësuar unitetin e popullit dhe për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm. Kjo kompetencë nuk është përsëritje pa shkak në tekstin e nenit 115 të Kushtetutës ose shtesë e tepruar e përmbajtjes së nenit 92, shkronja "gj", të saj. Rregullimi në mënyrë specifike në nenin 115 të Kushtetutës tregon rolin neutral garantues të Presidentit në drejtim të procesit të rregullt dhe të parimit të autonomisë vendore. Për këtë qëllim, pika 3 e nenit 115 të Kushtetutës përcakton momentin kohor se kur vihet në lëvizje Presidenti për të caktuar datën e zgjedhjeve. Ky moment kohor është në varësi të faktit nëse organi vendor i shkarkuar paraqet ose jo ankim kushtetues. Në rast se ai nuk paraqet ankim kushtetues brenda 15 ditëve, atëherë Presidenti nxjerr dekretin, ndërsa kur paraqet ankim, Presidenti nuk vepron, por pret

vendimin e Gjykatës dhe vepron vetëm nëse kjo e fundit lë në fuqi vendimin e shkarkimit. Për këtë arsye, pika 2 e nenit 115 të Kushtetutës parashikon se kur organi i shkarkuar ankohet në Gjykatë, vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet. Lidhur me pezullimin, Gjykata thekson se kur organi i zgjedhur vendor paraqet ankim kundër vendimit të shkarkimit, vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet ***ipso iure***, në bazë të nenit 115 të Kushtetutës, pa pasur nevojë për një akt formal gjyqësor, pra për një vendim të ndërmjetëm pezullimi nga Gjykata.

79. Për shkak të këtij përcaktimi kushtetues është e nevojshme që Presidenti të marrë informacionin e nevojshëm nëse kryetari i bashkisë ka paraqitur ose jo ankim, qoftë edhe duke përdorur kompetencën e tij për të kërkuar informacion sipas nenit 92, shkronja "h", të Kushtetutës nga organi vendor përkatës, nga Këshilli i Ministrave ose edhe nga Gjykata. Nga ana tjetër, edhe vetë Gjykata duhet të informojë dhe të bëjë publikë faktin e paraqitjes së një ankimi të tillë, si dhe datën e paraqitjes së tij. Sikurse është theksuar në jurisprudencën kushtetuese, një sjellje e tillë e organeve kushtetuese nuk është gjë tjetër veçse zbatimi praktik i parimit të luajalitetit kushtetues, i cili siguron, në thelb, respektin e ndërsjellë të organeve kushtetuese ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre. Parimi i bashkëpunimit luajal shpreh nevojën e krijimit të një modeli qeverisjeje ku mekanizmat veprojnë në mënyrë eficiente, pasi një model i tillë, me detyrimin që cakton ndaj organeve, e bën Kushtetutën funksionale (*shih vendimet nr. 26, datë 25.05.2021; nr. 41, datë 19.07.2012; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

80. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se brenda katër ditëve pasi Këshilli i Ministrave ka vendosur shkarkimin nga detyra të kërkuesit, ky i fundit, më 29.09.2025, i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual. Në po të njëjtën ditë kur është paraqitur ankimi kushtetues individual, Gjykata ka njoftuar publikisht në faqen e saj zyrtare regjistrimin e çështjes. Të nesërmen e kësaj dite, më 30.09.2025, Këshilli i Ministrave ka njoftuar Presidentin, ndër të tjera, për krijimin e vakancës për kryetar në Bashkinë e Tiranës, duke kërkuar caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme. Brenda 24 orëve nga njoftimi i vakancave, Presidenti, më 01.10.2025, ka nxjerrë dekretin për caktimin e zgjedhjeve për Bashkinë e Tiranës, megjithëse Gjykata dy ditë më parë kishte njoftuar publikisht se kryetari i bashkisë kishte paraqitur ankim kushtetues ndaj vendimit të shkarkimit.

81. Në analizë të këtyre rrethanave dhe nën dritën e standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata çmon se Presidenti ka nxjerrë dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve, duke mos mbajtur në konsideratë se vendimi i shkarkimit të Këshillit të Ministrave, për shkak të paraqitjes së ankimit kushtetues nga ana e organit të zgjedhor vendor, ishte i pezulluar ***ipso iure***. Ai ishte i detyruar të priste vendimin përfundimtar të Gjykatës dhe vetëm në rast të lënies në fuqi të vendimit për shkarkimin nga detyra, mund të ushtronte kompetencën e tij. Në këtë mënyrë, Presidenti ka caktuar datën e zgjedhjeve në bashkinë e Tiranës, edhe pse gjendej përpara një pengese kushtetuese të parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës. Në vlerësimin e Gjykatës, kjo mënyrë e të vepruarit të Presidentit nuk respekton edhe parimin e luajalitetit kushtetues. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se dekreti i Presidentit, për pjesën që ka caktuar datën e zgjedhjeve në bashkinë Tiranë, ka dalë në shkelje të parashikimeve kushtetuese dhe duhet të shfuqizohet[4].

82. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkimi i paraqitur nga kërkuesi, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar dhe si i tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 539, datë 25.09.2025 të Këshillit të Ministrave "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj", si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 350, datë 01.10.2025 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për

[4] Gjyqtarja Marjana Semini, përtej argumenteve të mësipërme, mbajti qëndrimin se për sa kohë që Gjykata vendosi të shfuqizonte aktin e shkarkimit të kryetarit të bashkisë, Dekreti i Presidentit që lidhet në mënyrë derivative vetëm me deklarimin e datë së zgjedhjes për shkak të krijimit të vakancës nga ky shkarkim, do të binte automatikisht dhe do të pushonte së sjelli pasoja juridike, sepse nga momenti i shfuqizimit të shkarkimit vetë vakanca nuk ekziston më.

kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore" për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës, si të papajtueshëm me pikat 2 dhe 3 të nenit 115 të Kushtetutës.

4. Vazhdimin e masës së pezullimit të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 350, datë 01.10.2025 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore" për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 03.11.2025
Shpallur më 12.01.2026

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 28 (E) të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkuesit Erion Veliaj, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 539/2025 të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës; shfuqizimin e dekretit nr. 350/2025 të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës; pezullimin e efekteve të këtij dekreti, vlerësojmë të theksojmë, fillimisht, se i jemi bashkuar shumicës për sa i përket interpretimit të nenit 115 të Kushtetutës në drejtim të mbrojtjes kushtetuese që ai ofron sipas pikës 2 të tij, dispozitë që është e zbatueshme në çdo rast në të cilin kundërshtohet vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e organit të qeverisjes vendore, pavarësisht shkakut për të cilin është vendosur shkarkimi.

2. Në vlerësimin tonë, parashikimet e pikave 1 dhe 2 të nenit 115 të Kushtetutës nuk mund të zbatohen në mënyrë të shkëputur nga njëratjetra, pasi një qasje e tillë do të zbehte mbrojtjen kushtetuese që i është ofruar të zgjedhurit vendor nga norma kushtetuese, përveçse do të sillte arbitraritet në zbatimin e saj. Ne kemi mbajtur qasjen se kushtetutëbërësi nuk ka parashikuar në mënyrë shteruese rastet për të cilat mund të shkarkohet organi i zgjedhur i qeverisjes vendore, siç ka vepruar në rastin e funksionarëve të tjerë, duke i deleguar ligjvënësit të zakonshëm parashikimin në ligjin e posaçëm për qeverisjen vendore të rasteve konkrete që zbërthejnë normën kushtetuese (pikën 1 të nenit 115). Në vlerësimin tonë, për sa i përket mbrojtjes dhe garancive që gëzon organi i zgjedhur vendor, në çdo rast gjejnë zbatim parashikimet e pikës 2 të këtij nenit, që do të thotë se kompetente për shqyrtimin e vendimit të shkarkimit është vetëm Gjykata dhe se në çdo rast paraqitja e kërkesës pezullon automatikisht aktin e kundërshtuar dhe çdo veprim tjetër pasues.

3. Ndërkohë, për sa i përket themelit të pretendimeve të kërkuesit, në drejtim të bazueshmërisë së tyre, vlerësojmë se ato janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të ishte rrëzuar për këtë shkak.

4. Referuar të dhënave të çështjes konkrete, rezulton se ndaj kërkuesit, gjatë kohës që ai ushtronte detyrën e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, është caktuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg", në zbatim të

së cilës ai ndodhet i izoluar në IEVP-në, Durrës që nga data 09.02.2025. Pas një periudhe prej 7 muajsh, në datën 18.09.2025 këshilltarët e Partisë Socialiste kanë paraqitur në këshillin bashkiak propozimin për zbatimin e nenit 62, shkronja "c", të ligjit nr. 139/2015, sipas të cilit kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave kur propozohet për shkarkim nga këshilli bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë. Në datën 23.09.2025 këshilli bashkiak i Bashkisë së Tiranës, me vendimin nr. 69/2025, ka vendosur të miratojë propozimin për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë, bazuar në nenin 62, shkronja "c", të ligjit nr. 139/2015, për shkak të mosparaqitjes për një periudhë 3-mujore të pandërprerë në detyrë. Ky vendim i është dërguar Këshillit të Ministrave, i cili, me vendimin nr. 539/2025, bazuar në nenet 100 të Kushtetutës dhe 62, shkronja "c", të ligjit nr. 139/2015, ka vendosur shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Në datën 29.09.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit të shkarkimit të tij nga detyra si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në vijim, pas njoftimit të vendimit Presidentit të Republikës, me dekretin nr. 350/2025 ai ka caktuar datën e zgjedhjeve vendore për vakancën e krijuar për shkak të shkarkimit të kërkuesit nga detyra. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke kundërshtuar edhe dekretin e Presidentit si të papajtueshëm me Kushtetutën.

5. Shumica fillimisht është ndalur në analizimin e juridiksionit të Gjykatës, duke argumentuar se neni 115 i Kushtetutës është një dispozitë me karakter material dhe procedural, që përcakton në mënyrë taksative rastet se kur mund të shkarkohet organi i zgjedhur i njësisë së qeverisjes vendore. Në këtë kuptim, sipas shumicës, Gjykata është organi që ka kompetencën për të kontrolluar vendimin e Këshillit të Ministrave për shkarkimin e organit të zgjedhur drejtpërdrejt, bazueshmëria në Kushtetutë dhe ligj e të cilit vlerësohet vetëm prej saj, si organi i cili thotë fjalën e fundit dhe parashikimet e bëra në Ligjin për Qeverisjen Vendore nuk mund të interpretohen dhe të zbatohen si mekanizma që lejojnë shmangien ose rrudhjen e mbrojtjes kushtetuese të organit të qeverisjes vendore, pasi ligji nuk mund të ketë epërsi ndaj Kushtetutës. Në përfundim shumica ka vlerësuar se kompetenca e Gjykatës për të shqyrtuar ankimin ndaj shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë ushtrohet në çdo rast, pavarësisht shkakut që është referuar në vendimin e shkarkimit (*shih paragrafët 35, 36 dhe 40 të vendimit*).

6. Ne nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket

interpretimit të saj lidhur me shkaqet e parashikuara nga ligjvënësi që pasjellin shkarkimin e organit të zgjedhur të qeverisjes vendore sipas nenit 115 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, organi i zgjedhur i qeverisjes vendore mund të shkarkohet për "shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve", duke i lënë ligjvënësit hapësirën për të përcaktuar, përmes ligjeve të zakonshme, se cilat sjellje ose veprime përbëjnë shkelje të tilla. Sikurse Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj, rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet (*shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016; nr. 22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ligjvënësi, në ushtrim të këtij delegimi, ka parashikuar në nenin 62 të ligjit nr. 139/2015 një sërë shkaqesh që konkretizojnë këto raste, ndër to edhe "mosparaqitjen në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë" (shkronja "c").

7. Në vlerësimin tonë ligjvënësi, në frymën e dispozitës kushtetuese dhe brenda hapësirës së delegimit që i është njohur nga kjo normë kushtetuese, ka përcaktuar ato raste që në thelb përbëjnë shkelje kushtetuese dhe ligjore, e lidhur kjo me të drejtën e të zgjedhurve për të qenë të përfaqësuar nga organi i zgjedhur drejtpërdrejt prej tyre. Ndërsa shkronja "a" e nenit 62 të ligjit është një përsëritje e përmbajtjes së pikës 1 të nenit 115 të Kushtetutës, për sa i përket dy shkronjave të tjera të dispozitës ligjore, si për dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë, ashtu edhe pamundësinë e ushtrimit të detyrës, ne vlerësojmë se pasoja e ardhur për këto arsye përbën shkak të mjaftueshëm dhe të arsyeshëm për të justifikuar ndërprerjen e mandatit të të përfaqësuarit vendor. Në këtë kuptim, parashikimi i këtyre dy shkronjave të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 nuk kërkon në çdo rast vlerësimin e Këshillit të Ministrave për ekzistencën e elementeve të fajësisë ose rëndësisë së shkeljes, për sa kohë që kemi të bëjmë me një fakt juridik objektiv që passjell pasoja të rënda në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues në njësitë e qeverisjes vendore.

8. Thënë sa më lart, vlerësojmë se qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e një periudhe kohore, kalimi i së cilës nuk justifikon më mosushtrimin e detyrës nga organi i zgjedhur vendor, nuk ka të bëjë me elementet subjektive të sjelljes, as me verifikimin e pasojave, e cila në këtë rast është e verifikueshme njëkohësisht me kohën e mungesës në detyrë. Për sa i përket rëndësisë së këtyre pasojave, pavarësisht shkakut që i ka sjellë, ato janë të nivelit kushtetues, për sa kohë lidhen me krijimin e pamundësisë objektive në ushtrimin e detyrave vetëqeverisëse nga organi i zgjedhur

drejtpërdrejt nga populli. Kjo sepse procesi i zhvilluar në raste të tilla nga Këshilli i Ministrave nuk ka natyrë disiplinore, por karakter deklarativ dhe faktik. Në mënyrë të ngjashme, edhe shkronja "b" e të njëjtit nen, që parashikon shkarkimin kur organi i zgjedhur është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, është një dispozitë që thjesht pasqyron një fakt juridik objektiv, pasi Gjykata nuk ka asnjë kompetencë të vlerësojë ose analizojë natyrën apo llojin e veprës penale të kryer, rëndësinë e saj apo pasojave që do të sillte ajo, por konstaton nëse vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë.

9. Në vlerësimin tonë arsyeja se përse ligjvënësi ka zgjedhur të përfshijë edhe këtë shkak në ligj (mosparaqitjen në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë) lidhet edhe me natyrën monokratike të funksionit të kryetarit të bashkisë. Ndryshe nga organet kolegjiale, ku ushtrimi i funksioneve mund të vijojë edhe në mungesë të një anëtari, mosushtrimi i detyrës nga kryetari i bashkisë për një periudhë të gjatë, e cila është vlerësuar nga ligjvënësi për një periudhë 3-mujore të pandërprerë, sjell mosushtrimin e funksioneve të njësisë së qeverisjes vendore nga organi i zgjedhur vendor dhe, për rrjedhojë, cenon drejtpërdrejt të drejtën e banorëve të asaj bashkie për t'u qeverisur nga përfaqësuesi që ata kanë zgjedhur. Në këtë kuptim, mosparaqitja në detyrë përbën një shkelje të tillë që prek thelbin e mandatit përfaqësues. Në rastin konkret rezulton se që prej datës 09.02.2025 kërkuesi është i izoluar në një institucion paraburgimi, pra prej 9 muajsh, ndërkohë që ligji përcakton përmbushjen e elementit "shkelje" vetëm pas kalimit të një periudhe 3-mujore për konstatimin e saj.

10. Qëllimi i mandatit përfaqësues nuk është as ushtrimi i tij përmes delegimit, çka rrëzon edhe mundësinë e ushtrimit të detyrave edhe në kushtet e izolimit. Edhe nëse i referohemi nenit 64 të ligjit nr. 139/2015, kryetari, ndër të tjera, raporton në këshillin bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli; raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë; emëron zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata etj., kompetenca të cilat nuk mund të delegohen për një periudhë të pacaktuar dhe vështirësohen të kryhen në kushtet e izolimit.

11. Thënë kjo, në raport me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të mosdëgjimit të tij fillimisht nga këshilli bashkiak dhe më pas nga Këshilli i Ministrave, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se për sa kohë procedura në rastin konkret nuk ka

karakter disiplinor, por përbën vetëm një konstatim të një fakti juridik, të drejtat që burojnë nga procesi i rregullt ligjor nuk mund të pretendohet të realizohen me të njëjtin rigorozitet. Kështu, e drejta e kryetarit të bashkisë nuk mund të kuptohet si një privilegj i individit të zgjedhur, por si një e drejtë në funksion të zgjedhësve dhe të garantimit të funksionimit të organeve të zgjedhura. Ne, gjyqtarët në pakicë, pranojmë se në rastin konkret, në procesin e propozimit dhe më pas të shkarkimit të kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë konstatohen të meta, të cilat lidhen me urgjencën me të cilën janë kryer veprimet nga organet përkatëse. Edhe pse periudha 3-mujore e mosparaqitjes është plotësuar më 09.05.2025, rreth 4 muaj pas kalimit të kësaj date, pra në datën 18.09.2025, nga këshilltarët e Partisë Socialiste është kërkuar mbledhja e këshillit bashkiak për të propozuar shkarkimin e tij nga detyra. Për rrjedhojë, pas kalimit të kësaj periudhe kohe, rezulton e pajustifikueshme nevoja e veprimit me shpejtësi të tillë, pra me kryerjen e këtyre procedurave brenda 7 ditësh nga momenti i propozimit të vendimit të shkarkimit.

12. Megjithatë, veprimet e kryera për propozimin dhe shkarkimin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, pavarësisht faktit nëse janë ndërmarrë ose jo në kushtet e urgjencës, nuk janë të tilla që të passjellin cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Nga aktet e administruara gjatë këtij procesi rezulton se kërkuesi ka pasur dijeni për procedurën e nisur për shkarkimin e tij që në momentin e njoftimit të propozimit nga këshilltarët e Partisë Demokratike në datën 09.05.2025 (e cila i është përcjellë atij për dijeni), si dhe për bazën ligjore mbi të cilin bazohej propozimi. Sikurse Gjykata ka pohuar, e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nuk nënkupton vetëm atë për t`u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe nëpërmjet paraqitjes dhe shqyrtimit të dokumenteve të dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, ne vlerësojmë se ai, përmes përfaqësuesit, siç ka vepruar edhe në procesin kushtetues, kishte çdo mundësi për të paraqitur qëndrimin e tij me shkrim për sa i përket procedurës për shkarkimin nga detyra, sikundër të realizonte praninë e tij përpara organit administrativ nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Nën të njëjtin këndvështrim, bazuar në argumentet e vet kërkuesit, i cili pretendon se përfaqësimi dhe delegimi te persona të tretë e lejojnë ushtrimin e detyrës si kryetar bashkie edhe përgjatë periudhës që ndodhet në izolim, ai (kërkuesi) nuk përdori të njëjtën mënyrë përfaqësimi që të merrte pjesë në procesin administrativ në këshillin bashkiak përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej

tij përfshirë edhe mbrojtësin ligjor. Nëse do të përdornim të njëjtin arsyetim për të vlerësuar procesin e shkarkimit me atë të ushtrimit të kompetencave në distancë nëpërmjet delegimit, lehtësisht do të konstatonim standarde të ndryshme të përdoruara nga ana e kërkuesit. Thënë kjo, ai pretendon nga njëra anë, se mund ta ushtrojë detyrën e kryetarit të bashkisë në distancë, pra edhe në kushtet e izolimit dhe pa qenë fizikisht i pranishëm në zyrë ose në mbledhjet e këshillit bashkiak, nëpërmjet përfaqësimit/delegimit të kompetencave tek persona të tretë, të zgjedhur/caktuar prej tij dhe nga ana tjetër se nuk mund të mbrohet në procesin administrativ në këshillin bashkiak përveçse përmes pranisë fizike dhe jo përmes përfaqësuesve ose mbrojtësve ligjorë. Për më tepër, duke mbajtur në vëmendje faktin se shkaku i shkarkimit është një konstatim fakti sipas shkronjës "c" të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015, edhe pjesëmarrja e kërkuesit personalisht në mbledhjen e këshillit bashkiak nuk do të mund të ndryshonte rezultatin e kësaj procedure, për rrjedhojë do të ishte thjesht formale.

13. Të njëjtin qëndrim mbajmë edhe për sa u përket pretendimeve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit. Në kushtet kur procesi i shkarkimit të kërkuesit bazohet në një konstatim fakti të parashikuar në shkronjën "c" të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015, nuk lind nevoja për një detajim të shkeljes së parashikuar, si nga këshilli bashkiak, ashtu edhe nga Këshilli i Ministrave. Kjo, pasi, sikurse u arsyetua më lart, situata faktike e mosparaqitjes në detyrë nuk kërkon vlerësim diskrecional ose interpretim juridik mbi elemente fajësie ose proporcionalitetin e masës, por këto organe konstatojnë ekzistencën e rrethanës faktike të përcaktuar qartë në ligj. Për rrjedhojë, standardi i arsyetimit të vendimit nuk kërkon një zbatim të ngjashëm si në rastin e shkeljeve të tjera të Kushtetutës ose të ligjeve.

14. Gjithashtu, ne jemi të qëndrimit se në rastin e konstatuar sipas shkronjës "c" të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 e drejta e organit të zgjedhur vendor nuk humbet në mënyrë të pakthyeshme, pra pasojat nga vendimi i Këshillit të Ministrave nuk janë të tilla që të zhveshin të zgjedhurin vendor nga e drejta e tij për t`u zgjedhur ose për të fituar dhe ushtruar një mandat të tillë përfaqësues përgjithmonë. Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar raste të veçanta në të cilat ndalohet kandidimi ose zgjedhja e një kandidati, ndërkohë që rasti në fjalë nuk përbën asnjë ndalim për kandidatin që të kandidojë sërish në zgjedhjet vendore dhe të fitojë sërish besimin e zgjedhësve dhe të drejtën për t'i përfaqësuar ata në njësinë e qeverisjes vendore. Kjo nënkupton se ligjvënësi ka parashikuar një mekanizëm proporcional mes interesit publik që lidhet me të drejtën e zgjedhësve për të qenë të përfaqësuar dhe për t'u qeverisur nga organi i zgjedhur

prej tyre dhe jo nga persona të deleguar prej të zgjedhurit, çka justifikon ndërprerjen e mandatit të organit të zgjedhur të qeverisjes vendore, dhe së drejtës individuale të individit për t`u zgjedhur dhe për të marrë pjesë në jetën politike. Në këtë këndvështrim vlen të theksohet se e drejta e të zgjedhurve për t'u përfaqësuar dhe qeverisur nga organi i zgjedhur i qeverisjes vendore prej tyre prevalon ndaj vetë së drejtës të të zgjedhurit për të ushtruar detyrën dhe mandatin.

15. Për sa më sipër, në këto kushte, edhe pse vlerësojmë se procesi i zhvilluar nga organet përkatëse për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës ka pasur disa mangësi në aspektet procedurale të këtij procesi dhe zhvillimin e tij në kushtet e urgjencës, pavarësisht se nuk rezulton që të jetë verifikuar ekzistenca e tyre, duke qenë se kërkuesi ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit për shkarkimin e tij nga këshilli bashkiak dhe ka pasur mundësi efektive për t'u njohur me aktet e procesit dhe për të ushtruar të gjitha mjetet e tij procedurale për t'u dëgjuar nëpërmjet paraqitjes së parashtrimeve/pretendimeve me shkrim dhe përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tij, përfshirë edhe mbrojtësin ligjor, si një nga format që edhe Gjykata ka konsideruar se kënaq kërkesat e një procesi të drejtë, por ka zgjedhur të mos i ushtrojë këto të drejta, mendojmë se në thelb atij nuk i është mohuar e drejta për proces të rregullt ligjor.

16. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se kërkesa e paraqitur është haptazi e pabazuar dhe, për rrjedhojë, duhej të ishte rrëzuar në tërësi, duke lënë në fuqi VKM-në nr. 539/2025.

17. Po kështu, për sa u përket pretendimeve për shfuqizimin e dekretit të Presidentit, nisur nga fakti se ne gjyqtarët në pakicë nuk konstatojmë cenim të procedurës së shkarkimit të kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë, çmojmë të mos ndalemi në verifikimin e veprimeve të Presidentit dhe dekretit për shpalljen e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore, për sa kohë zgjidhja e kësaj çështjeje nuk do të ndikonte në konkluzionin e arritur për të.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi

Vendim nr. 67, datë 05.11.2025
(V-67/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 04.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ALEKSANDËR FADILI,** përfaqësuar nga avokat Fran Dashi, me akt përfaqësimi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Alfred Progonati, me autorizim.
FATIME FEJZILLARI, PETRIT FEJZILLARI

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 867-128, datë 05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; nr. 218, datë 14.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024- 1782, datë 05.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).***

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Aleksandër Fadili *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Fatime e Petrit Fejzillarit (prindërit/trashëgimtarët e viktimës), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në datën 30.04.2018 është paraqitur në Komisariatin e Policisë Kurbin për të bërë kallëzim penal, pasi një ditë më parë, në datën 29.04.2018, shoku i tij, shtetasi F.F., me të cilin e kishte lënë të takohej në orën 18:00 në qytetin e Laçit, kishte humbur kontaktet me të. Kërkuesi në kallëzimin e tij ka dhënë shpjegime se me shtetasin F.F. ka qenë shokë fëmijërie dhe se të dy, pjesë e komunitetit rom, punonin me tregtimin e rrobave të përdorura (perde, tyle e çarçafë). Sipas tij, megjithëse e kishte kërkuar gjithë natën, nuk kishte mundur ta gjente. Gjithashtu, po sipas shpjegimeve të kërkuesit, shtetasi F.F. kishte pasur me vete 270.000 lekë, gjysma e të cilave i përkiste atij.

2. Fillimisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin *(Prokuroria e Kurbinit)* në datën 02.05.2018, mbi bazën e materialit kallëzues të dërguar nga Komisariati i Policisë Kurbin, ka ngritur dyshime se shtetasi F.F. mund të jetë marrë peng nga persona të tjerë, për shkak të problemeve me lojërat e fatit. Për sqarimin e rrethanave Prokuroria e Kurbinit ka kërkuar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, si dhe bazuar në të dhënat/provat e grumbulluara ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "Heqja e paligjshme e lirisë".

3. Në datën 15.05.2018, pas veprimeve hetimore të kryera për këtë çështje, Prokuroria e Kurbinit ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, pasi, sipas saj, janë krijuar dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se shtetasi F.F. është vrarë me qëllim vjedhjen e shumës të të hollave që kishte pasur me vete dhe dyshohej se autor i këtij veprimi ishte shoku i tij, kërkuesi. Mbi këtë bazë, prokuroria ka marrë të pandehur kërkuesin, si personi i fundit që ka pasur kontakt

me shtetasin F.F., duke e akuzuar për veprën penal "Vjedhja me pasojë vdekjen", të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal *(KP).* Në datën 15.08.2018 prokuroria ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve. Pas përfundimit të hetimeve, prokurori, me kërkesën e datës 04.12.2018, e ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 867-128, datë 05.07.2019, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale "Vjedhja me pasojë vdekjen", të parashikuar nga neni 141 i KP-së dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Pas ankimit të kërkuesit dhe trashëgimtarëve të viktimës/prindërve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 14.05.2021**,** ka vendosur lënien në fuqi të vendimin nr. 867-128, datë 05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Pas rekursit të kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1782, datë 05.11.2024, ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP).*

5. Kërkuesi në datën 21.01.2025 *(data e shërbimit postar)* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 31.01.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 08.04.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës së aksesit,* pasi në rekurs janë paraqitur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, por Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje atyre, megjithëse janë me natyrë kushtetuese. Pretendimet e ngritura gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes.

6.1.2. *Parimit të paanshmërisë*, për shkak se gjyqtarja relarore Z.S. në Gjykatën e Apelit Tiranë ka manipuluar mënyrën për caktimin e datës së seancës gjyqësore. Vetëm pasi kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me

kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit, për shkak të kohëzgjatjes të afateve të paraburgimit, gjyqtarja relatore ka vepruar me shpejtësi për caktimin e datës së seancës gjyqësore për themelin e çështjes, pa respektuar rregullat procedurale të regjistrimit të datës në serverin e gjykatës dhe pa e afishuar atë në tabelën e njoftimit të datave në hyrje të gjykatës. Në datën 05.05.2021 gjyqtarja ka caktuar datën e seancës gjyqësore, duke njoftuar vetëm avokatin K.S. (që ka përfaqësuar kërkuesin në shkallën e parë), kurse avokati F.D. (që ka përfaqësuar kërkuesin në gjykimin në apel) është njoftuar nga familjarët e kërkuesit. Gjithashtu, në seancën për gjykimin e themelit të çështjes është kërkuar të gjykohej fillimisht çështja për shuarjen e masës së sigurimit, por kërkesa është refuzuar nga gjyqtarja Z.S. Kjo gjyqtare është kallëzuar nga avokati F.D. për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës". Në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë edhe gjyqtarja E.Ll., ish-bashkëshortja e gjyqtarit G.H., që ka gjykuar të njëjtën çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Vetë gjyqtarja E.Ll. i ka paraqitur kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, por kjo kërkesë nuk është pranuar. Ndërsa gjyqtarja E.T., po pjesë e trupit gjykues në gjykatën e apelit, është kallëzuar penalisht nga shtetasja M.H., e cila përfaqësohet nga avokati i kërkuesit në një çështje që pritet për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë.

6.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljet e proceseve gjyqësore të zhvilluara në shkallët e tjera. Në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk janë paraqitur shkaqet e rekursit, për të cilat kërkuesi ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, fakt që krijon dyshime për realizimin efektiv *të së drejtës së aksesit*. Gjithashtu, në përmbajtje të vendimit është cituar se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit, kur në fakt ai ka kundërshtuar vendimet e të dyja shkallëve më të ulëta. Kolegji Penal, në mënyrë absurde, ka refuzuar kalimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

6.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë,* i garantuar nga neni 32 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është dënuar pa prova. Në rastin e dhënies së dënimeve ekstreme, për vepra penale të rënda, duhet të ketë prova bindëse dhe në unitet me njëra-tjetrën, si dhe procesi nuk mund të fillojë me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin që akuzohet. Akti i ekspertimit të ADN-së nuk mund të përdoret si provë, pasi nuk përcakton kohën, mënyrën dhe vendin ku janë gjetur njollat e gjakut. Njollat e gjakut janë gjetur në makinë, për shkak të një aksidenti që ka kryer F.F. dhe prokuroria nuk ka hetuar për këtë rrethanë. Makina përdorej nga kërkuesi, pasi megjithëse ishte në pronësi të viktimës, ky i fundit nuk kishte leje drejtimi. Viktima nuk gëzon statusin e personit të zhdukur, madje sipas akteve të gjendjes civile rezulton të jetë i gjallë. Pra, ende nuk ka një viktimë, një vendngjarje, akt të ekspertimit mjeko-ligjor ose edhe vendim gjykate që të provojë se shtetasi F.F. është person i zhdukur ose të ketë humbur jetën. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 876, datë 21.12.2005 ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale vetëm me një provë, cilado qoftë ajo, edhe nëse është shkencore, nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë.

6.3. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkelur dispozitat procedurale lidhur me marrjen dhe vlerësimin e provave e një fakt i tillë ka sjellë një vendim të padrejtë dhe të pambështetur në prova e ligj. Gjykata e Apelit Tiranë kishte detyrimin për të bërë hetim të ngjarjes, sepse Prokuroria e Apelit Tiranë është mjaftuar me ato çfarë kanë shkruar punonjësit e policisë dhe Prokuroria e Kurbinit, pa u thelluar në hetimin e faktit.

7. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** ka paraqitur prapësime me shkrim, duke argumentuar, si vijon:

7.1. *Pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë,* për shkak se gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë qenë në konflikt interesi, është i pabazuar. Gjyqtarët janë të detyruar të zbatojnë rregullat e paanshmërisë, dhe nëse nuk ka prova të drejtpërdrejta që provojnë se lidhjet personale të tyre kanë ndikuar në vendim, kjo nuk mund të konsiderohet shkelje. Edhe pretendimi se gjykata

e apelit (gjyqtarja relatore) ka shkelur rregullat procedurale për caktimin e datës së seancës gjyqësore dhe njoftimin e palëve nuk është i bazuar. Në rastin konkret kërkuesi nëpërmjet mbrojtësit të tij ka marrë pjesë në gjykim dhe ka parashtruar argumentet duke realizuar mbrojtjen e tij. Edhe nëse do të vërtetoheshin shkelje, ato nuk kanë qenë të tilla që të kenë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Parregullsitë formale që mund të ndodhin në procesin gjyqësor, sikurse pretendohet mosafishimi i datës së gjykimit, nuk çojnë automatikisht në cenimin e procesit gjyqësor, pasi kërkuesi duhet të provojë dëmin e drejtpërdrejtë që i ka ardhur nga këto parregullsi. Pretendimit për shkeljen e rregullave për t'u njoftuar i ka dhënë përgjigje edhe Gjykata e Lartë.

7.2. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.* Arsyetimi i vendimit ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete, natyrës së vendimit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 436/a të KPP-së, e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, duke arsyetuar në vendim shkaqet e ngritura në rekurs. Vendimi është i mirarsyetuar dhe në të janë trajtuar me hollësi pretendimet e kërkuesit. Arsyetimi kryesisht është përqendruar rreth pretendimit thelbësor të kërkuesit, i cili lidhet me vlerësimin e provave nga dy gjykatat më të ulëta. Referuar akteve të dosjes pretendimet e kërkuesit nuk gjejnë mbështetje në to dhe në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë pasqyruar të gjitha shkaqet e rekursit.

7.3. *Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë* ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykatat e faktit sipas nenit 152 të KPP-së, mbi të cilat është disponuar për fajësinë e kërkuesit. Marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksionin e gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues, si dhe në rastin konkret nuk konstatohen të dhëna ose indicie që të tregojnë zbatim arbitrar të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë ka arsyetuar në lidhje me pretendimin se kërkuesi është dënuar vetëm mbi bazë të një prove, duke arsyetuar se përveç provës së ADN-së ka edhe prova të tjera, të cilat të çmuara në harmoni me njëra-tjetrën kanë krijuar bindjen për provueshmërinë e akuzës.

8. ***Subjektet e interesuara, Fatime Fejzillari dhe Petrit Fejzillari,*** kanë paraqitur prapësime me shkrim, si vijon:

8.1. Kërkuesi është personi i fundit që e ka parë shtetasin F.F. dhe nga data 29.04.2018 e në vazhdim ai rezulton i zhdukur. Prokurori i caktuar për këtë çështje nuk ka ushtruar ndjekjen penale ndaj kërkuesit dhe shtetasve të tjerë, të afërm të tij, të cilët kanë kryer veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Gjithashtu, kërkuesi ka konsumuar elementet e veprës penale "Fshehja ose asgjësimi i kufomës". Prokurori, në kundërshtim me ligjin, u ka caktuar avokat kryesisht personave që janë pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e ngjarjes, konkretisht kërkuesit dhe dy të afërmve të tij, shtetasve A.F. dhe Xh.F. Për këtë arsye, ndaj prokurorit dhe oficerit të Policisë Gjyqësore është bërë kallëzim penal për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës". Ndërsa për shtetasit A.F. dhe Xh.F. është bërë kallëzim penal për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Për këtë kallëzim penal, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme sipas detyrave të lëna në pjesën arsyetuese të vendimit për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës", "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" dhe "Fshehja ose asgjësimi i kufomës". Por deri në datën 30.04.2025 vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nuk është zbardhur/arsyetuar ende. Kërkuesi është person me rrezikshmëri të lartë dhe në raste analoge (të hetuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar) personat janë dënuar edhe për fshehjen dhe asgjësimin e kufomës, por ndaj kërkuesit nuk është ngritur kjo akuzë, ndoshta për arsye profesionale ose të lidhura me diskriminimin, pasi kërkuesi i përket komunitetit rom. Gjithashtu, nga kërkuesi janë depozituar edhe certifikata personale dhe familjare të subjekteve të interesuara, duke vënë në dyshim respektimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, por për këtë do të merren masa sipas ligjit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe

nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse/i dënuar në procesin gjyqësor penal ndaj të cilit ka ngritur pretendime.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm. Në përmbajtje të ankimit kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, edhe pretendimin *për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme,* duke parashtruar vetëm në mënyrë të përgjithshme se ka pasur shkelje të ligjit procedural në mënyrën e marrjes së provave gjatë hetimit ose gjykimit të çështjes së tij, por pa parashtruar argumente konkrete për këtë lloj shkeljeje. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk e ka parashtruar këtë pretendim në ankimin e paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, as në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, ndonëse e ka përmendur me fjalë të përgjithshme se është shkelur ligji për mënyrën e marrjes së provave *(shih faqen 12 të rekursit të paraqitur në Gjykatën e Lartë),* Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për pretendimin *për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme* kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Për pretendimet e tjera, Gjykata konstaton se kërkuesi i ka shteruar si në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual[1].

[1] Gjyqtarja Sonila Bejtja, në ndryshim nga shumica, për këtë pretendimi votoi me qasjen se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente të mjaftueshme kushtetuese dhe për këtë arsye ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 05.11.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 21.01.2025, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar pretendime për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në aspekt *të parimit të paanshmërisë* gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* dhe *të së drejtës së aksesit nga Gjykata e Lartë*, si dhe për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*.

14. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkuesi ka parashtruar dy argumente: i) gjyqtarja relatore ka manipuluar rregullat për caktimin e datës së seancës gjyqësore dhe njoftimin ia ka dërguar vetëm avokatit që ka përfaqësuar kërkuesin në shkallën e parë, ndërsa avokati që e ka përfaqësuar në apel është njoftuar nga familjarët; ii) në përbërje të trupit gjykues në gjykatën e apelit ka pasur dy gjyqtare në kushtet e papajtueshmërisë.

15. *Për argumentin e parë,* për shkeljen e rregullave të njoftimit të datës së seancës, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues rezulton se për seancën e datës 11.05.2021, ora 14:00, që do të zhvillohej në gjykatën e apelit, me njoftimin nr. 3969 akti, datë 06.05.2021 për kërkuesin është njoftuar dhe ka firmosur se ka marrë dijeni avokati K.S., që e ka përfaqësuar gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja relatore ka njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për shoqërimin e kërkuesit. Seanca gjyqësore e datës 11.05.2021, ku kërkuesi ka qenë i pranishëm, është shtyrë për në datën 14.05.2021, për shkak të mungesës së prokurorisë dhe trashëgimtarëve të viktimës. Edhe gjatë seancës së datës 14.05.2021 kërkuesi ka qenë përsëri i pranishëm. Në rrethanat kur kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe ka pasur mundësi për të parashtruar mbrojtjen e tij, Gjykata vlerëson se ai nëpërmjet argumenteve të paraqitura nuk ka provuar cenimin e të drejtave të tij kushtetuese, për rrjedhojë pretendimi është haptazi i pabazuar.

16. *Për argumentin e dytë,* Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar dy fakte: se i) njëra nga gjyqtaret e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit

Tiranë është kallëzuar penalisht nga shtetasja M.H., e cila përfaqësohet nga avokati i kërkuesit në një çështje që pritet për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë; ii) gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë gjyqtarja E.Ll. ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë, si ish-bashkëshorte e gjyqtarit G.H., që ka qenë pjesë e trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

17. *Në lidhje me faktin e parë*, Gjykata vëren se shtetasja M.H. nuk ka asnjë lidhje si me kërkuesin, po ashtu edhe me shtetasin F.F./viktimën, dhe çështja së cilës i referohet kërkuesi nuk ka lidhje me rastin në shqyrtim. Vetëm fakti që kërkuesi dhe shtetasja M.H. përfaqësohen në gjykime të ndryshme nga i njëjti avokat, nuk përbën argument në nivel kushtetues në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

18. *Në lidhje me faktin e dytë,* Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë gjyqtarja E.Ll., (ish) bashkëshortja e gjyqtarit G.H., që ka gjykuar të njëjtën çështje në Gjykatën e Rrethit e Gjyqësor Kurbin. Për këtë pretendim nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se gjyqtarja E.Ll. i ka paraqitur kryetarit të gjykatës së apelit kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes. Pas shqyrtimit të kërkesës, kryetari i gjykatës së apelit, me vendimin nr. 919 prot., datë 12.05.2021, ka vendosur mospranimin e saj, duke vlerësuar se shkaku i parashtruar për paanshmëri nga kërkuesi se në shkallë të parë ai është gjykuar nga gjyqtari G.H., nuk parashikohet nga neni 17 i KPP-së, pasi mes tij dhe gjyqtares E.Ll. është zgjidhur martesa me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe për këto arsye pretendimi i kërkuesit për paanshmëri ka qenë i pabazuar. Ky pretendim është vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila, pasi e ka marrë në shqyrtim, i ka dhënë kërkuesit përgjigje të arsyetuar se nuk rezulton të mos jenë respektuar garancitë e procesit të rregullt.

19. Në vijim të standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për parimin e paanshmërisë, në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes

personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm *(shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar fakteve konkrete, Gjykata vlerëson se në drejtim të testit subjektiv, për bindjen e brendshme të gjyqtares, parashtrimi i kërkuesit se parimi i paanshmërisë është cenuar vetëm se në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë gjyqtarja E.Ll., ish-bashkëshortja e gjyqtarit G.H. (pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e tij në gjykatën e shkallës së parë), nuk provon të kundërtën e prezumimit se gjyqtarja ka qenë e paanshme. Edhe për sa i përket testit objektiv, Gjykata konstaton se në kohën e gjykimit midis gjyqtares së apelit E.Ll. dhe gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë G.H. nuk ka pasur lidhje familjare që të vinin në dyshim që gjyqtarja E.Ll. do të cenonte parimin e paanshmërisë në gjykimin e çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i pabazuar[2].

20. Gjykata konstaton se në drejtim të pretendimit për cenimin *e parimit të prezumimit të pafajësisë,* të cilin në thelb kërkuesi e ka ndërlidhur me pretendimin për cenimin *e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkuesi ka parashtruar të njëjtat argumente të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si në vijim se: i) është dënuar pa prova; (ii) vetëm analiza e ADN-së nuk mjafton nëse nuk shoqërohet me prova të tjera; (iii) nuk është gjendur asnjëherë viktima; (iv) Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje kërkimeve të tij për parimin e prezumimit të pafajësisë; (v) Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në raste të ngjashme,

[2] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi se ky pretendim është haptazi i pabazuar me arsyetim paralel sipas qasjeve të mbajtura prej saj në vendimet e mëparshme *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese; nr. 103, datë 17.05.2023 të Mbledhje së Gjyqtarëve).* Në konsideratë të kësaj qasjeje, nga materialet e dosjes gjyqësore ka rezultuar se gjyqtarja E.Ll. (pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë) ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi, e cila është shqyrtuar nga kryetari i gjykatës së apelit, që ka arsyetuar rregullisht duke dhënë përgjigje për rrëzimin e saj. Gjyqtarja Sonila Bejtja konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë pretendim, për rrjedhojë asnjë fakt ose provë në lidhje me parregullsinë e procesit gjyqësor, ku është shqyrtuar kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi të gjyqtares E.Ll.

sikurse është vendimi nr. 876, datë 21.12.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin është shprehur se nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale vetëm me një provë, cilado qoftë ajo, edhe shkencore, nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë. Lidhur me këtë argument të fundit, Gjykata vëren se, pavarësisht se kërkuesi e ka parashtruar atë në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, në thelb ai lidhet me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit. Në këtë drejtim Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të mbështesë *a priori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rastet e ekzistencës së vendimeve njësuese/unifikuese, gjykatat, duke mos analizuar çështjen konform këtyre vendimeve, cenohet parimii sigurisë juridike të kërkuesit për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate (*shih vendimet nr. 64, datë 23.10.2025; nr. 47 datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj në kushtet kur kërkuesi nuk ka argumentuar nëse vendimi i referuar prej tij është njësues/unifikues i praktikës gjyqësore, pra që të jetë i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

21. Për rrjedhojë, argumentet e tjera të kërkuesit në vijim Gjykata do t'i analizojë në këndvështrim të *parimit të prezumimit të pafajësisë* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesi ka parashtruar se është dënuar pa prova, por vetëm mbi bazën e dyshimeve, pasi trupi i viktimës nuk është gjendur asnjëherë, madje ende sot, sipas akteve të gjendjes civile, rezulton i gjallë. Vetëm analiza e ADN-së për njollat e gjakut të gjendura në sediljen e makinës nuk mund të përdoret, nëse nuk shoqërohet me prova të tjera. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë zhvilluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer

veprën penale, duke e prezumuar të vdekur shtetasin F.F. Gjithashtu, sipas tij, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs për (pa)fajësinë e tij.

23. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimi ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykata e faktit mbi të cilat është disponuar për fajësinë e kërkuesit. Marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksionin e gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues, e në rastin konkret nuk konstatohen të dhëna ose indicie që të tregojnë zbatim arbitrar të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë është shprehur për pretendimin e kërkuesit se është dënuar vetëm mbi bazë të një prove, duke arsyetuar se përveç provës së analizës së ADN-së ka edhe prova të tjera, të cilat të çmuara në harmoni me njëra-tjetrën kanë krijuar bindjen për provueshmërinë e akuzës.

24. Subjektet e interesuara, Fatime dhe Petrit Fejzillari (trashëgimtarët e viktimës), kanë parashtruar se kërkuesi është personi i fundit që e ka parë/takuar djalin e tyre, i cili nga data 29.04.2018 deri më sot rezulton i zhdukur. Kërkuesi është person me rrezikshmëri të lartë dhe në raste analoge personat janë dënuar edhe për fshehjen e asgjësimin e kufomës, por ndaj kërkuesit nuk është ngritur kjo akuzë, ndoshta për arsye profesionale ose për shkak të diskriminimit, pasi kërkuesi i përket komunitetit rom. Ndaj prokurorit të çështjes dhe oficerit të Policisë Gjyqësore është bërë kallëzim penal për shpërdorim detyre.

25. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

26. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund

t`i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata ka pohuar se kur vlerësohet parimi i prezumimit të pafajësisë në çështjet penale, prezumimet e faktit ose të ligjit nuk janë të ndaluara, por ato duhet të jenë brenda kufijve të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe të sigurojnë të drejtat e mbrojtjes (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata ka evidentuar edhe dallimin që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë e kërkuesit edhe mbi disa prova të tjera (*shih vendimet nr. 40, datë 22.09.2011; nr. 42, datë 18.12.2007; nr. 9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, Gjykata ka pohuar se garancitë kushtetuese të tij janë konkretizuar në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit që procedon me ndjekjen penale (prokurorisë dhe gjykatave) për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi. Parimi i prezumimit të pafajësisë (neni 4 i KPP-së) përcakton se i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të tij, si dhe vendimi i fajësisë jepet kur ai rezulton fajtor përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ndërsa në nenin 152 të KPP-së parashikohet se çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre, se çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata e zakonshme i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi dhe se ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën *(shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese).*

28. Parimi i prezumimit të pafajësisë është trajtuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* në kuadrin e nenit 6, pika 2, të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja, ndër të tjera, në rastin kur ka pasur një akuzë penale dhe procedurat penale kanë përfunduar me dënimin e personit, ka theksuar se gjykatat duhet të garantojnë që parimi i prezumimit të pafajësisë të shihet si një garanci procedurale në kontekstin e një gjykimi penal, duke imponuar zbatimin e disa kërkesave të lidhura me: (i) barrën

e provës (*shih Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, 6 dhjetor 1988, § 77, Seria A nr. 146* dhe *Telfner kundër Austrisë, nr. 33501/96, § 15, 20 mars 2001*); (ii) prezumimet ligjore të lidhura me faktet dhe ato të lidhura me ligjin (*shih Salabiaku kundër Francës, 7 tetor 1988, § 28, Seria A nr. 141-A, dhe Radio Francë dhe të tjerë kundër Francës, nr. 53984/00, § 24, ECHR 2004-II*); (iii) privilegjin kundër vetinkriminimit (*shih Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar, 17 dhjetor 1996, § 68, raportet e vendimeve dhe aktgjykimeve 1996-VI, dhe Heaney dhe McGuinness kundër Irlandës, nr. 34720/97, § 40, ECHR 2000-XII*).

29. Lidhur me respektimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i takon ndarjes së detyrave midis juridiksionit kushtetues dhe atij të gjyqësorit të zakonshëm, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimin nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi dhe shtetasi F.F. punonin së bashku me shitjen e rrobave të përdorura. Automjeti në pronësi të shtetasit F.F. përdorej nga kërkuesi për tregti. Në datën 29.04.2018 kërkuesi dhe shtetasi F.F. kanë shkuar për tregti në qytetin e Laçit. Shtetasi F.F. kishte pasur me vete një shumë afërsisht 270.000 lekë. Po në këtë datë ka rezultuar se komunikimi i fundit telefonik i shtetasit F.F. me celularin e tij ka qenë në orën 14:54, ndërsa komunikimi i fundit i kërkuesit në orën 15:30. Të dy numrat e telefonit janë fikur pothuajse në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend (antena Miloti E). Kërkuesi e ka rindezur telefonin pas 11 orësh, duke hedhur hipoteza për vendndodhjen e tij në Tiranë, por nuk ka paraqitur prova në lidhje me të. Në datën 30.04.2018, në orën 09:15, kërkuesi është paraqitur në Komisariatin e Policisë Kurbin për të bërë kallëzim penal, pasi një ditë më parë shtetasi F.F., me të cilin e kishte lënë të takohej në orën 18:00 në qytetin e Laçit, kishte humbur kontaktet me të. Sipas tij, shtetasi F.F. kishte me vete 270.000 lekë, gjysma e të cilave i përkiste kërkuesit.

33. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka analizuar fillimisht se Prokuroria e Kurbinit në datën 02.05.2018, mbi bazën e materialit kallëzues të dërguar nga Komisariati i Policisë Kurbin, ka ngritur dyshime se shtetasi F.F. mund të jetë marrë peng nga persona të tjerë, për shkak të problemeve me lojërat e fatit dhe prokuroria ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "Heqja e paligjshme e lirisë". Nga procesverbali i datës 02.05.2018 rezulton se eksperti kriminalist, oficeri i Policisë Gjyqësore dhe vetë kallëzuesi kanë shkuar në vendet e treguara nga ky i fundit, por në asnjë prej këtyre vendeve nuk janë gjetur prova ose sende që mund të kishin lidhje me ngjarjen. Disa ditë pas ngjarjes, kërkuesi i ka dorëzuar nënës së shtetasit F.F. telefonin celular të këtij të fundit, i cili, sipas ekspertimit teknik, ka rezultuar se ishte i thyer dhe jofunksional. Një javë më pas, kërkuesi ka dërguar makinën në një lavazh në Peqin, duke kërkuar nga punonjësit e atij subjekti larjen e makinës jashtë e brenda. Në datën 09.05.2018, pas larjes së automjetit, shërbimet e Policisë Gjyqësore kanë bërë këqyrjen e automjetit. Në bazë të aktit të ekspertimit biologjik vlerësues nr. 5390, datë 16.05.2018, gomina e derës së pasme, nga ana e majtë e shoferit ka rezultuar pozitive nga testi specifik për gjak human. Për këqyrjen fizike të personit dhe marrjen e kampionëve biologjikë të pështymës (ADN) të prindërve të shtetasit F.F. është përpiluar akti i ekspertimit biologjik krahasues ADN-je nr. 5391, datë 16.05.2018, sipas të cilit, nga mostrat biologjike të marra nga gomina e derës së pasme të automjetit, ekzistojnë

lidhje gjenetike baba-bir dhe nënë-bir. Po ashtu, gjatë këqyrjes së mjetit janë gjetur një palë gërshërë, por në bazë të aktit të ekspertimit biologjik nr. 5520, datë 18.05.2018 është konkluduar se ato nuk përmbajnë mbetje humane për identifikim me anë të analizës së ADN-së. Po ashtu, edhe nga akti i ekspertimit biologjik të ADN-së të kryer për xhupin e veshur nga kërkuesi ditën e ngjarjes, është arritur në përfundimin se nuk ka pasur mbetje të vlefshme për identifikimin individual të analizës së ADN-së. Në vijim, edhe një grup punonjësish të policisë së Kurbinit, me qëllim gjetjen e shtetasit F.F., ka kontrolluar zona të ndryshme, por nga kontrolli nuk është konstatuar viktimë ose rrobë/send që mund të ketë pasur ai ditën kur është zhdukur. Ndërkohë, rezulton se prokuroria ka kryer edhe përgjim ambiental për bisedat mes kërkuesit dhe xhaxhait, sipas të cilave nuk do të flasin e tregojnë se çfarë ka ndodhur kur shprehen, ndër të tjera: *"Eeeee, se mos llafos. Joo. Ai ka ik vetë"*.

34. Për sa më lart, pas veprimeve hetimore të kryera për këtë çështje, në datën 15.05.2018 Prokuroria e Kurbinit ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, pasi, sipas saj, ishin krijuar dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se shtetasi F.F. ishte vrarë me qëllim vjedhjen e shumës të të hollave që kishte pasur me vete dhe dyshohej se autor i këtij veprimi ishte shoku i tij/kërkuesi. Mbi këtë bazë, prokuroria ka marrë të pandehur kërkuesin, si personi i fundit që kishte pasur kontaktet me shtetasin F.F., duke e akuzuar për veprën penale "Vjedhja me pasojë vdekjen", të parashikuar nga neni 141 i KP-së. Pas përfundimit të hetimeve (të cilat kanë zgjatur edhe për një afat 3-mujor), prokurori, me kërkesën e datës 04.12.2018, ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

35. Kërkuesi, gjatë fazës së gjykimit, ka dhënë deklarime/sqarime, duke ngritur disa alibi për vendndodhjen e tij ditën e ngjarjes, duke thënë se ka nuk qenë në qytetin e Laçit, por në fakt ka qenë në qytetin e Tiranës, tek e dashura e tij, por pa dhënë gjeneralitetet e saj dhe për këtë shkak nuk është bërë e mundur pyetja e saj si dëshmitare nga prokuroria, e cila nuk e ka konsideruar alibinë e pretenduar nga kërkuesi. Në cilësinë e dëshmitarëve janë pyetur prindërit e shtetasit F.F., bashkëshortja S.C. dhe shtetasi I.K., (daja i shtetasit F.F.). Këta dëshmitarë, në mënyrë të përmbledhur, kanë shprehur dyshimet e tyre në lidhje me marrëdhënien që kishte kërkuesi ndaj shtetasit F.F. dhe sjelljen që kishte pasur pas zhdukjes së tij, që sipas tyre ka qenë e dyshimtë. Në cilësinë e dëshmitarëve janë pyetur xhaxhai i kërkuesit dhe punonjësit e lavazhit ku ai kishte çuar makinën për ta larë një

javë pas ngjarjes. Kërkuesi ka dhënë shpjegime se ka qenë në komisariatin e policisë në orën 7:30-8:00, por sipas librit të pritjes ka qenë në orën 09:15. Për njollat e gjakut të gjendura në sediljen e makinës kërkuesi ka deklaruar se janë për shkak të një aksidenti që kishte pësuar shtetasi F.F., por sipas Prokurorisë së Kurbinit automjeti nuk ka qenë i përfshirë në asnjë aksident dhe shtetasi F.F. nuk ka pasur hemorragji.

36. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka arsyetuar se nga shqyrtimi gjyqësor, vlerësimi i provave shkresore dhe shkencore (aktet e ekspertimit biologjik), analiza e të dhënave të dërguara në formë elektronike nga operatorët telefonikë dhe provave me dëshmitarë, është provuar plotësisht ekzistenca e faktit penal dhe rrethanave të tij në versionin e parashtruar nga organi i akuzës. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se objekti i veprës penale ka qenë cenimi i pasurisë së viktimës dhe si pasojë e këtij cenimi ka ardhur vdekja. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kërkuesi ka kryer veprime me strategji për të mos rënë në sy, se autori i vërtetë ishte ai vetë dhe se i ka dorëzuar familjarëve të viktimës mallin e mbetur nga tregtia, por nuk ka dorëzuar telefonin tjetër që përdorte shtetasi F.F. për t'u lidhur me shërbimin e internetit, si dhe çelësat e makinës. Me qëllim fshehjen e të gjitha fakteve e provave, ndonëse automjeti nuk ishte i tij dhe shoku ende nuk ishte gjetur, kërkuesi e ka çuar makinën në lavazhin e personave që i njihte. Për njollat e gjakut, si provë thelbësore shkencore, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ato janë gjendur në sediljen e pasme dhe jo në vendin ku ulej shtetasi F.F. dhe nuk ka sens tjetër për krijimin e tyre përveçse me vendosjen e detyrueshme të personit/viktimës aty, me qëllim transportin e tij *(shih faqet 15-18 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin).*

37. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë kërkuesi ka paraqitur ankim, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur pretendime se është dënuar pa prova, për më tepër në rrethanat kur nuk është gjetur asnjë kufomë. Pas ankimit të kërkuesit dhe trashëgimtarëve të viktimës, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 14.05.2021**,** ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 867-128, datë 05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke e vlerësuar të drejtë këtë vendim. Gjykata e apelit ka konfirmuar provat e vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë dhe ka evidentuar se vrasja nga ndodhur në mizori, pasi kërkuesi vazhdon të refuzojë të tregojë vendndodhjen e trupit *(shih faqen 27 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë).*

38. Pas rekursit të kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në

dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1782, datë 05.11.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se shkaqet e ngritura në rekurs nuk e cenojnë vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi kjo gjykatë ka respektuar parimet e vlerësimit të lirë të provës e ato të çmuarjes së saj. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se nuk ka konstatuar mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal material ose procedural nga gjykata e apelit, me rëndësi për njësimin apo zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk është verifikuar shkelja ose zbatimi i gabuar i ligjit procedural penal me pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; nuk rezulton që vendimi i ankimuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

39. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë parashtrimet e palëve, Gjykata do të verifikojë nëse në procesin gjyqësor penal të zhvilluar ndaj kërkuesit gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë respektuar garancitë e parimit të prezumimit të pafajësisë në përcaktimin e fajësisë së tij, si dhe nëse kërkuesi ka marrë përgjigje për pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Konkretisht do të analizohet: i) *nëse kanë përcaktuar drejt dhe qartë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore;* (ii) *nëse kanë përmbushur detyrimin për barrën e provës, duke evidentuar provat determinante që provojnë fajësinë*, *nëse kanë filluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer veprën penale, nëse është respektuar e drejta për të mos u vetinkriminuar dhe nëse kanë vlerësuar se dyshimet shkojnë në favor të kërkuesit;* (iii) *nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe nëse është analizuar mjaftueshëm në vendimet gjyqësore lidhur me faktin që trupi i viktimës nuk është gjetur ose thjesht është prezumuar vdekja ose zhdukja e personit, gjë që ka passjellë edhe prezumimin se kërkuesi është fajtor*.

(i) Përcaktimi i drejtë dhe i qartë i fakteve të çështjes të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore

40. Nisur nga rrethanat e parashtruara në arsyetimet e vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të sipërcituara *(shih paragrafët 33 deri në 38 të këtij vendimi),* Gjykata vlerëson se në drejtim të kriterit të *përcaktimit të drejtë dhe të qartë të fakteve të çështjes të*

rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore, vendimet gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, edhe pse kanë përcaktuar gjerësisht rrethanat e faktit dhe janë përpjekur të evidentojnë shkallën e rëndësisë ose peshës që luan secili prej fakteve të analizuara në kompleksin e përgjithshëm të rrethanave të faktit, nuk kanë arsyetuar sa duhet se pse këto rrethana justifikonin faktin penal të vjedhjes me pasojë vdekjen ose si ky fakt penal lidhej me kërkuesin. Nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore nuk kuptohet sesi gjykatat kanë arritur në përfundimin se nga rrethanat rezulton se është synuar vjedhja e shtetasit F.F. dhe pse vrasja ka pasur si qëllim vjedhjen. Po ashtu, ndonëse gjykatat i kanë radhitur e përcaktuar qartë faktet më të rëndësishme që lidhen me rrethanat e çështjes për përcaktimin e përgjegjësisë ligjore të kërkuesit, nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktin që nuk ka një kufomë, nëse shtetasi F.F. është zhdukur ose është vrarë dhe pse është prezumuar si i tillë apo pse zhdukja është prezumuar si vrasje.

(ii) Përmbushja e detyrimit për barrën e provës duke evidentuar provat determinante, *konstatimi nëse procesi ka filluar me bindjen se kërkuesi ka kryer veprën penale, respekimi i së drejtës për mos u vetikriminuar dhe, vlerësimi se dyshimet shkojnë në favor të kërkuesit*

41. Në vijim, Gjykata vlerëson ta analizojë kriterin e dytë (ii) të zbërthyer në disa nënkritere, si më poshtë:

42. Në lidhje me nënkriterin *përmbushja e detyrimit për barrën e provës duke evidentuar provat determinante*, Gjykata konstaton se nga analiza e provave të lidhura me rrethanat e faktit të parashtruara në paragrafët 33 deri 38 të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka arsyetuar se nga shqyrtimi gjyqësor janë evidentuar dhe konsideruar si prova determinante ose thelbësore: provat shkencore, si akti i ekspertimit biologjik vlerësues për analizën e ADN-së; analiza e të dhënave të dërguara në formë elektronike nga operatorët telefonikë; fakti se sipas tabulateve telefonike telefoni i kërkuesit dhe i viktimës janë fikur në të njëjtën kohë; aktet e ekspertimit për njollat e gjakut, ku është përcaktuar vendi i gjetjes së tyre dhe drejtimi i gjurmës së këtyre njollave; analiza e provave me dëshmitarë; rezultatet e përgjimit ambiental të bisedës së kërkuesit me xhaxhain, pra të gjitha këto prova, në kompleksitetin e tyre, janë analizuar në unitet me njëra-tjetrën.

43. Në përfundim të analizës për këtë nënkriter, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë bërë përpjekje për të përmbushur detyrimin për barrën e provës, duke evidentuar disa prova determinante të

konsideruara si të rëndësishme ose thelbësore për të provuar ekzistencën e faktit penal dhe fajësinë e kërkuesit, duke bërë referencë, ndër të tjera, në provat shkencore të njollave të gjakut dhe të akteve të ekspertimit biologjik që lidhen me to, të dhënat elektronike nga operatorët telefonikë, fikjen e telefonave në të njëjtën kohë, provat me dëshmitarë dhe përgjimin ambiental mes kërkuesit dhe xhaxhait të tij, të cilat janë vlerësuar në unitet me njëra-tjetrën. Gjithsesi, nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm duket sikur ato e kanë çliruar prokurorin nga barra e provës, duke ia kaluar këtë barrë kërkuesit, i cili, sipas tyre, ka qenë në pozita mohuese dhe jo bashkëpunuese për të treguar vendin se ku është trupi i viktimës, gjë që për rrjedhojë e bën arsyetimin e vendimeve gjyqësore të paplotë. Mënyra e arsyetimit të gjykatave të faktit që kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ka kryer veprime me strategji për të mos rënë në sy se autori i vërtetë ishte ai vetë apo se është evidente që pasoja e ardhur, vrasja, ka qenë përvetësimi i shumës së parave që ai ka pasur me vete, apo se kërkuesi me qëndrimin e tij jobashkëpunues, mohues dhe mbi të gjitha duke tentuar të japë alibi të rreme për veprimet e tij ka synuar të fshehë krimin e kryer, janë përfundime të nxjerra pas një analize duke ia kaluar barrën e provës kërkuesit. Ndonëse fakti penal mund të nxirret nëpërmjet indicieve, me kusht që ato të jenë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën (*neni 152, pika 2, i KPP-së),* gjykatat e faktit nuk rezulton të kenë evidentuar se cilat janë këto indicie që të ndërlidhura vërtetojnë faktin e vjedhjes së shtetasit F.F. dhe faktin e vrasjes së tij me qëllim vjedhjen.

44. Në lidhje me nënkriterin që lidhet me të *drejtën për të mos u vetinkriminuar*, Gjykata thekson se bazuar në nenin 34/a, shkronja "c", të KPP-së çdo i pandehur ka të drejtën që të heshtë dhe të mos ndihmojë aspak në fajësimin e tij dhe në rastin konkret vetëm fakti që një person humbet kontaktet/zhduket, nuk përbën prezumim faktik për kryerjen e veprës penale të vrasjes dhe është detyrimi i organeve proceduese e në vijim i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të bërë lidhjen mes zhdukjes së një personi dhe identifikimit, si dhe ndjekjes penalisht të autorit/autorëve. Gjykata konstaton se prokuroria dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar ekzistencën e "mizorisë" në kryerjen e veprës penale, duke u bazuar vetëm në qëndrimin mohues të kërkuesit gjatë gjykimit, që ka refuzuar të tregojë trupin, pavarësisht se përpara se të evidentohet se vrasja ka ndodhur me mizori (gjë që del nga vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit), duhet që të shpjegohet qartë dinamika e kryerjes së veprës penale dhe të

arsyetohet në mënyrë të qartë pse zhdukja e kufomës e bën skenarin mizor, duke kryqëzuar faktet dhe rrethanat në mënyrë bindëse dhe të lidhura në mënyrë harmonike me njëra-tjetrën. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nga vendimet gjyqësore objekt i këtij shqyrtimi rezulton se e *drejta kushtetuese e të pandehurit për të mos u vetinkriminuar* është interpretuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në mënyrë arbitrare, në të kundër të qëllimit të saj.

45. Në drejtim të analizës së nënkriterit *nëse është filluar procesi me bindjen se kërkuesi e ka kryer veprën dhe nëse është vlerësuar se dyshimet shkojnë në favor të kërkuesit,* Gjykata vlerëson se nuk rezulton që të ketë filluar hetimi dhe gjykimi me dyshimin dhe paragjykimin se kërkuesi është fajtor për vrasjen e F.F. (se fillimisht u dyshua për rrëmbimin e tij për shkak të lojërave të fatit). Po ashtu edhe në vijim, prokuroria dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë grumbulluar prova të mjaftueshme dhe kanë bërë përpjekje për t'i analizuar ato duke i ndërlidhur me njëra-tjetrën, duke mos u udhëhequr nga ndonjë paragjykim për fajësinë e kërkuesit. Megjithatë, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të kishin analizuar dhe arsyetuar në mënyrë më të qartë lidhjen e faktit penal të vrasjes me kryerjen e vrasjes nga kërkuesi, në kushtet kur nuk është gjetur trupi i viktimës. Një arsyetim më i plotë dhe më i kujdesshëm i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm do të eliminonte edhe mundësinë e ekzistencës së *dyshimeve të cilat do të shkonin në favor të të pandehurit*.

(iii) Nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe prezumimet ligjore

46. Lidhur me këtë kriter, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, në kundërshtim me detyrimin e tyre, prokuroria dhe më pas gjykatat kanë nxjerrë prezumimin e faktit se shtetasi F.F. është vrarë me qëllim vjedhjen e tij nga kërkuesi. Ato e kanë prezumuar këtë fakt në mënyrë të paarsyeshme, duke u bazuar në rrethanën se ai rezulton i zhdukur dhe në faktin se në automjet është gjetur një njollë gjaku e tij. Nuk ka të dhëna të sakta, të rëndësishme dhe që përputhen me njëra-tjetrën as për kohën e saktë të zhdukjes, as për kohën që i përkasin njollat e gjakut në automjet, as për sendet që janë vjedhur. Duke vepruar në këtë mënyrë, nuk kanë mbajtur në konsideratë as të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit për të kundërshtuar akuzën e ngritur. Prokuroria dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë detyrimin për të qenë të qarta dhe të sakta në arsyetimin ligjor, për shkak

se vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi mbart rrezikun e një dënimi penal të ashpër, duke sjellë si pasojë rrezikimin e cenimit të të drejtave substanciale për jetën dhe lirinë e individit. Për të hetuar një zhdukje të dyshimtë dhe një vdekje të dyshimtë, analiza duhet të fillojë me zbulimin e trupit, të armës së krimit, të vendit të krimit, të motivit e të mekanizmit të vrasjes dhe në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë analizuar vlerën provuese të njollave të gjakut të lidhur me mungesën e një trupi në drejtim të fajësisë, për sa kohë që nuk rezulton të jetë gjetur as arma e krimit.

47. Në drejtim të kriterit *nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe prezumimet ligjore,* Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë prezumuar që ka vrasje vetëm nga fakti që personi nuk gjendej dhe nuk kanë arsyetuar sa dhe si duhet për faktin se trupi i viktimës nuk është gjetur, për të arritur në përfundimin se ka ndodhur vepra penale e vrasjes, për të cilën është akuzuar kërkuesi. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar se kërkuesi nuk ka bashkëpunuar për të treguar vendndodhjen e trupit të viktimës, por kjo nuk është e mjaftueshme për të justifikuar prezumimin e faktit. Gjykata vlerëson se në çështjet penale nuk mund të shmangen edhe prezumimet e fakteve, por ato duhet të përdoren nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duke mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e interesit që rrezikohet për shkak të natyrës dhe llojit të veprës penale të lidhur me ashpërsinë e masës së dënimit, e cila ndikon drejtpërdrejt në garantimin e të drejtave substanciale të mbrojtjes. Për këtë arsye, prezumimet e fakteve duhet të mbeten brenda kufijve të arsyeshëm, të cilët duhet të përcaktohen qartë përmes arsyetimit të vendimeve gjyqësore, që në rastin konkret duhet të fokusohej tek analiza përse fakti i vrasjes është prezumuar në kushtet e mungesës së trupit të viktimës, në analizë edhe të provave të tjera të grumbulluara në këtë proces penal. Nga vlerësimi i mësipërm, Gjykata arrin në konkluzionin se mënyra e arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për prezumimin faktit të zhdukjes, vdekjes ose vrasjes dhe autorit të saj, nuk është e plotë dhe qartë.

48. Në analizë të sa më lart, në konkluzion të të gjithë komponentëve/kritereve të analizuar më sipër, Gjykata vlerëson se ndonëse vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit kanë listuar gjerësisht faktet e çështjes për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore, ato nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktin penal të vjedhjes me pasojë vdekjen apo se si

ky fakt penal lidhej me kërkuesin, nisur nga fakti që nuk ka një kufomë, nëse viktima ka vdekur apo është vrarë dhe pse zhdukja e F.F. është prezumuar si vrasje. Në vendimet gjyqësore është prezumuar fakti se ka viktimë dhe ka vrasje vetëm nga fakti që personi nuk gjendet dhe nuk është arsyetuar sa dhe si duhet për faktin se trupi i viktimës nuk është gjetur, për të arritur në përfundimin se ka ndodhur vepra penale e vrasjes për shkak të vjedhjes, për të cilën është akuzuar kërkuesi. Ato kanë përmbushur në mënyrë jo të plotë detyrimin për t'iu përgjigjur në arsyetimin e vendimeve gjyqësore kërkuesit për *pretendimet e tij për cenimin e parimit të prezumimin e pafajësisë*, duke ceduar në analizën e një raporti të drejtë dhe harmonik të të gjithë ansamblit të provave që provojnë fajësinë, qofshin ato determinante/thelbësore të drejtpërdrejta ose indirekte, duke mbajtur në konsideratë se masa e kujdesit duhet të jetë në një nivel të arsyeshëm, për sa kohë jemi para një vepre penale, ku ashpërsia e masës së dënimit rrezikon ndjeshëm të drejtat kushtetuese substanciale. Në konkluzion të analizës së saj, Gjykata vlerëson se mënyra e arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm ka bërë që në dukje të zhvendoset barra e provës nga prokurori te kërkuesi, i cili nuk ka treguar se ku e ka fshehur trupin e viktimës.

49. Në vijim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formal dhe nuk ka riparuar shkeljen e gjykatave të faktit. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se arsyetimi i bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është një arsyetim jo bindës, duke *cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë*.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj dhe ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1782, datë 05.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 05.11.2025
Shpallur më 21.01.2026

Vendim nr. 68, datë 05.11.2025
(V-68/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 04.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (S) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SWINKELS FAMILY BREWERS N.V.,** përfaqësuar nga avokati Krenar Loloçi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
SHOQËRIA "ARSENI" SH.P.K., përfaqësuar nga administratori Lavdush Tormetaj.
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INTELEKTUALE, në mungesë.

OBJEKTI: **Rihapja e procesit gjyqësor dhe shfuqizimi i vendimit nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.**
Rishqyrtimi i kërkesës së kërkuesit të paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese në datën 02.02.2018 për të cilin u mor vendimi nr. 15, datë 11.03.2021 i Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 16, pika 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 71/c i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji organik i Gjykatës*); nenet 6, 14, 16, 28 dhe 126 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të Swinkels Family Brewers N.V. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar rihapjen e procesit në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) dhe pranimin e kërkesës për themelin e çështjes, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "Arseni" sh.p.k., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për themelin e çështjes, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (*DPPI*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është një shoqëri tregtare e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit holandez, me emrin ligjor Swinkles Family Brewers N.V. dhe me emër tregtar edhe Bavaria N.V., e cila ka në pronësi markën tregtare B-52, pije energjike, pronësi e fituar nëpërmjet aplikimit në vendin e origjinës, në regjistrin e markave tregtare të Beneluksit, dhe regjistrimit të datës 22.02.2008, me nr. 838872. Ajo ka aplikuar, gjithashtu, për regjistrim ndërkombëtar në datën 20.06.2008 dhe marka tregtare B-52 është regjistruar përfundimisht në datën 24.06.2008, me nr. regjistrimi ndërkombëtar 970878. Po kështu, ajo ka aplikuar për shtrirjen e efekteve të mbrojtjes së markës B-52 edhe në Shqipëri nëpërmjet aplikimit të datës 21.10.2008, ndërsa është regjistruar në datën 12.02.2009.

2. Subjekti i interesuar, shoqëria "Arseni" sh.p.k., është një shoqëri e së drejtës shqiptare, e cila është regjistruar si person juridik në datën 15.08.2006, me objekt kryesor të veprimtarisë së saj tregtare tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave, kryesisht ato ushqimore, ndër të cilat edhe pijen energjike B-52. Në lidhje me regjistrimin e kësaj marke tregtare janë zhvilluar disa procese gjyqësore.

3. Në datën 06.11.2008, në bazë të kërkesës së datës 18.04.2008 të shoqërisë së huaj "N.D.L.", me përfaqësues Z.L. dhe me adresë në Maqedoni (Maqedonia e Veriut), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave *(DPPM)*, sot DPPI-ja, në përputhje me dispozitat e ligjit të kohës nr. 7819, datë 27.04.1994 "Për pronësinë industriale", ka regjistruar në emër

të asaj shoqërie markën "B-52 Energy Drink", me nr. 11992 regjistrimi, sipas elementeve përkatëse.

4. Në datën 16.06.2010, me kontratën nr. 3076 rep., nr. 2163 kol., shoqëria "N.D.L.", e përfaqësuar nga Z.L., i ka shitur shoqërisë "Arseni" sh.p.k. markën, emrin, si dhe të gjitha të drejtat për këtë pije, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera ku ajo është e pajisur me patentë, kontratë që është e regjistruar në DPPM.

5. Në lidhje me regjistrimin e markës tregtare B-52 janë zhvilluar disa procese gjyqësore.

i) Procesi i parë gjyqësor

6. Mes palëve është zhvilluar procesi gjyqësor me objekt padie: "*Shfuqizimin e markës B-52 me nr. 970878, me pronar "Bavaria" N.V. Çregjistrimin e markës B-52 me nr. 970878 me pronar "Bavaria" N.V.*"" dhe objekt kundërpadie: "*Shfuqizimin e markës tregtare B-52 me nr. regjistrimi kombëtar 11992, në pronësi të shoqërisë "Arseni" sh.p.k.*". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12870, datë 26.12.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke shfuqizuar markën B-52 me nr. regjistrimi 970878, me pronar shoqërinë "Bavaria" N.V. dhe regjistrimin e vendimit të shfuqizimit në regjistrin e markave të DPPM-së. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1692, datë 05.09.2013. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-755 (66), datë 09.03.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1692, datë 05.09.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

ii) Procesi i dytë gjyqësor

7. Në datën 14.11.2013 shoqëria "Arseni" sh.p.k. i është drejtuar DPPM-së me kërkesë për regjistrimin e transferimit, në favor të saj, të pronësisë për markën ndërkombëtare B-52, me nr. 977607 regjistrimi ndërkombëtar. Në datën 10.04.2014 DPPM-ja ka dërguar pranë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale *(WIPO)* formularin përkatës për ndryshimin e pronësisë për markën ndërkombëtare me nr. 977607 regjistrimi nga pronari Z.L., përfaqësuesi i shoqërisë "N.D.L.", te shoqëria "Arseni" sh.p.k. Me urdhrin nr. 13, datë 15.04.2014 (*urdhri nr. 13/2024*), DPPM-ja, duke vlerësuar se transferimi i pronësisë së markës ndërkombëtare është bërë gabimisht, bazuar në një kontratë shitjeje me anë të së cilës bëhet transferimi i pronësisë së markës tjetër tregtare nr. 11992 regjistrimi, ka urdhëruar revokimin e transferimit (ndryshimit) të pronësisë së markës

ndërkombëtare, si dhe lënien e kësaj marke në pronësi të pronarit Z.L., duke njoftuar edhe WIPO-n dhe palët e interesuara.

8. Shoqëria "Arseni" sh.p.k. i është drejtuar gjykatës me padi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 13/2014 të DPPM-së. Me vendimin nr. 4986, datë 22.09.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke konstatuar si absolutisht të pavlefshëm urdhrin nr. 13/2014 të DPPM-së, për shkak se ka vepruar në kapërcim të kompetencave të njohura me ligj, për sa kohë nuk parashikohet mundësia që ky organ të revokojë aktet e tij, të paligjshme ose jo. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 345, datë 02.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-464 (111), datë 21.03.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se këto të fundit nuk kanë interpretuar dhe zbatuar drejt kërkesat e ligjit material.

9. Mbi ankimin e shoqërisë "Arseni" sh.p.k., Gjykata, me vendimin nr. 37, datë 07.07.2023, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-464 (111), datë 21.03.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 00-2024-5424 (489), datë 19.11.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi shoqëria "Arseni" sh.p.k. ka paraqitur ankim kushtetues individual, për të cilin, me vendimin nr. 266, datë 22.10.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

iii) Procesi i tretë gjyqësor

10. Në vitin 2011 kërkuesja ka bërë një tjetër regjistrim ndërkombëtar të markës tregtare B-52, me logo të re. Ajo, gjithashtu, ka bërë një regjistrim ndërkombëtar me nr. 1082916, datë regjistrimi 14.06.2011 të markës tregtare B-52, me të njëjtat karakteristika të logos dhe të njëjtin klasifikim sipas klasifikimit ndërkombëtar të Nice-s, në klasën 32, pije alkoolike dhe jo-alkoolike, pije energjike dhe pije sportive. Në datën 21.07.2011 DPPM-ja ka pranuar regjistrimin përkatës.

11. Subjekti i interesuar, shoqëria "Arseni" sh.p.k., i është drejtuar Bordit të Apelimit të DPPM-së për kundërshtimin e regjistrimit të mësipërm. Kjo kërkesë nuk është pranuar, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor. Shoqëria "Arseni" sh.p.k., duke pretenduar se ky regjistrim pranë DPPM-së është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore, i është drejtuar Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt shfuqizimin dhe çregjistrimin e mbrojtjes së markës B-52, me nr. 1082916, me pronar "Bavaria" N.V., si dhe marrjen e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7121, datë 24.06.2013, ka vendosur: "*Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Shfuqizimin e mbrojtjes së markës B-52, me nr. 1082916 regjistrimi, me pronar shoqëria "Bavaria" N.V. Regjistrimin e këtij vendimi shfuqizimi në Regjistrin e Markave të DPPM-së. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj.*". Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1868, datë 06.05.2014, dhe ky i fundit është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-2074(112), datë 05.10.2017.

13. Në datën 05.02.2018 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve të mësipërme gjyqësore, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit, parimit të paanshmërisë në gjykim, së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* si dhe *parimit të sigurisë juridike*. Për shkak se prej datës 16.07.2018 Gjykata nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për formimin dhe funksionimin e kolegjeve seleksionuese, kërkesa ka mbetur pa veprim dhe vetëm në datën 17.01.2020, me plotësimin e kuorumit të kërkuar ligji, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me plotësimin e kuorumit të kërkuar nga ligji për shqyrtimin paraprak të çështjeve prej saj, me vendimin e datës 29.01.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve.

14. Gjykata, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 15, datë 11.03.2021 (*vendimi nr. 15/2021*), ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në lidhje me pretendimet për cenimin e *parimit të paanshmërisë në gjykim, së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike*, Gjykata, bazuar në argumentet e parashtruara në mbështetje të tyre, ka vlerësuar se janë të pabazuara. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* Gjykata nuk arriti kuorumin e nevojshëm ligjor, pasi qëndrimet e gjyqtarëve u ndanë për sa i takon mënyrës sesi e kanë vlerësuar gjykatat e zakonshme pretendimin e kërkueses për keqbesimin në të drejtën e përfitimit të markës B-52 nga shoqëria "Arseni" sh.p.k. dhe nëse përgjigjja e dhënë nga ato gjykata plotësonte standardet e arsyetimit. Për rrjedhojë, ky pretendim është konsideruar i rrëzuar në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit organik të Gjykatës.

15. Në lidhje me procesin gjyqësor të vënë në lëvizje prej saj, të përmbyllur me vendimin e Gjykatës nr. 15/2021, kërkuesja, me kërkesën e datës 01.10.2021, i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) (*aplikimi nr. 48801/21, Swinkels Family N.V. kundër Shqipërisë*), duke pretenduar cenimin e nenit 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) edhe në drejtim të aksesit në Gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimit. GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 16.07.2024, ndërsa nuk ka gjetur shkelje të së drejtës së aksesit, ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së për të drejtën e kërkueses për një vendim të arsyetuar nga Gjykata, duke vlerësuar se asaj nuk i janë dhënë shkaqet ligjore përkatëse për refuzimin e ankimit kushtetues dhe se kjo mungesë e një arsyetimi të përshtatshëm nuk plotëson kërkesat për proces të drejtë gjyqësor (*shih paragrafin 76 të vendimit të GJEDNJ-së*). Sipas GJEDNJ-së, një vendim në të cilin konstatohet shkelje e Konventës i imponon shtetit të paditur një detyrim ligjor për t`i dhënë fund shkeljes dhe për të riparuar pasojat e saj. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve dhe shkeljet e konstatuara, forma më e përshtatshme e riparimit të shkeljeve të gjetura do të ishte rihapja e procedurave të brendshme (*shih paragrafët 78 dhe 83 të vendimit të GJEDNJ-së*).

16. Në datën 13.02.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, shfuqizimin e vendimit të saj nr. 15/2021 dhe rishqyrtimin e ankimit kushtetues të datës 02.02.2018, për të cilin është dhënë ai vendim. Me vendimin e datës 17.04.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe bazuar në parashikimet e ligjit organik të Gjykatës dhe të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese janë njoftuar për këtë qëllim edhe subjektet e interesuara, të cilat janë thirrur si palë në gjykimin kushtetues.

17. Subjekti i interesuar, shoqëria "Arseni" sh.p.k., në përmbajtje të parashtrimeve të tij përpara Gjykatës, ka kërkuar edhe përjashtimin nga gjykimi të tre gjyqtarëve, duke pretenduar se kanë qenë pjesë e trupit gjykues që ka dhënë vendimin e mëparshëm nr. 15/2021, ku është gjetur shkelje nga GJEDNJ-ja, për rrjedhojë janë në kushte papajtueshmërie për të marrë pjesë në këtë gjykim, pasi e kanë shprehur qëndrimin e tyre për objektin e çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet e datës 26.06.2025, ka vendosur rrëzimin e këtyre kërkesave si të pabazuara, duke vlerësuar se në rastin konkret nuk jemi përpara ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 36 i ligjit organik të Gjykatës për përjashtimin

e gjyqtarit kushtetues, por përpara zbatimit të një detyrimi që lind për Gjykatën për shkak të vendimmarrjes së GJEDNJ-së. Për më tepër, sipas Mbledhjes së Gjyqtarëve, pranimi i këtyre kërkesave do të çonte edhe në mosarritjen e kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e seancës plenare, me pasojë pamundësinë e shqyrtimit të çështjes.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

i) Për rihapjen e procesit në Gjykatë:

18.1. GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, për shkak të vendimit të refuzimit të ankimit kushtetues të kërkueses si pasojë e mungesës së kuorumit, i cili nuk jepte arsye për themelin e çështjes. Kërkesa respekton kriteret e nenit 71/c të ligjit organik të Gjykatës, pasi është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të GJEDNJ-së dhe pasojat e cenimit të të drejtave dhe lirive themelore vijojnë të ekzistojnë për shkak se vendimi nr. 15/2021 i Gjykatës vijon të jetë në fuqi dhe nuk është marrë asnjë masë ose veprim për shfuqizimin e tij ose rregullim i ri ligjor për mënjanimin e cenimit. Rihapja e procesit gjyqësor, siç interpreton GJEDNJ-ja në vendimin e saj dhe siç parashikohet edhe në ligjin organik të Gjykatës, do të thotë rishqyrtim nga e para të pretendimeve të ngritura në kërkesën e parë të datës 05.02.2018, çka respekton parimin e subsidiaritetit të gjykatës ndërkombëtare ndaj gjykatës kombëtare. GJEDNJ-ja i referohet pretendimit për shkelje të arsyetimit të gjykatave të zakonshme, por, në fakt, nga leximi i vendimit rezulton qartë se pretendimet për: (i) njëanshmërinë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe (ii) mosformimin e rregullt të trupit gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë të lidhura drejtpërdrejt me çështjen e mungesës së arsyetimit të vendimit. Nëse procesi gjyqësor rihapet vetëm për çështjen e mungesës së arsyetimit të vendimit dhe mbetet i mbyllur për çështjet e tjera për të cilat GJEDNJ-ja nuk është shprehur, do të thotë të mos kryhet një hetim i plotë në kuadër të rihapjes së procesit dhe rezultati do të ishte që sërish Gjykata do të rrezikonte të mos e përmbushte standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë kuptim, Gjykata ka

mundësi dhe duhet të rishqyrtojë çështjen nga e para për të gjitha pretendimet e ngritura nga kërkuesja. Kur rihapet një çështje për gjykim, kjo bëhet për të gjitha çështjet ose pretendimet dhe nuk mund të jetë selektive.

18.2. Çështja e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk mund të ndahet nga standardi i arsyetimit të vendimeve. Prania e një gjyqtari me mandat të përfunduar në gjykimin në Gjykatën e Lartë ka pasur si pasojë jo vetëm dhënien e një vendimi në dëm të kërkueses, por edhe dhënien e një vendimi tërësisht të paarsyetuar, siç e përcaktoi edhe GJEDNJ-ja. E njëjta logjikë vlen edhe për cenimin e parimit të paanshmërisë, në mënyrë të veçantë në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga gjyqtari A.Ç., i cili ka dhënë dorëheqjen një ditë pasi u mor vendimi. Duke mos u shprehur për këto dy pretendime GJEDNJ-ja i jep mundësinë Gjykatës që t`i vlerësojë dhe të arsyetojë për to pas rihapjes së procesit. Këto dy pretendime nuk janë shqyrtuar nga GJEDNJ-ja jo sepse janë vlerësuar të pabazuara, por sepse konstatimi i shkeljes së standardit të arsyetimit mjaftoi për të konkluduar se ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, për pasojë të krijonte mundësinë e rihapjes së çështjes gjyqësore përpara Gjykatës, çka mbështetet edhe nga paragrafi 78 i vendimit të GJEDNJ-së. Në rastin konkret nuk ndodhemi përpara "gjësë së gjykuar" lidhur me këto pretendime, për sa kohë GJEDNJ-ja nuk është shprehur për to.

ii) Për themelin e çështjes:

18.3. *Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykatat e faktit nuk janë shprehur në vendimet e tyre për pretendimin e kërkueses për keqbesim në veprimet e kryera nga shoqëria "Arseni" sh.p.k. Gjykata e shkallës së parë në pjesën arsyetuese të vendimit është shprehur përciptazi në lidhje me këtë pretendim, duke arsyetuar në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë, duke mos bërë një analizë tërësore të fakteve dhe provave të paraqitura nga kërkuesja. As gjykata e apelit, as Gjykata e Lartë nuk kanë mbajtur parasysh kontratën e shitjes me shumicë të lidhur mes palëve, që është thelbi ku bazohet pretendimi për keqbesim. Kjo kontratë i ka vendosur shoqërisë "Arseni" sh.p.k. detyrime në lidhje me markën e kërkueses, që përfshijnë edhe ndalimin që të fitojë pronësi apo të përdorë si të vetën një markë që është krejt

identike me markën B-52 të kërkueses. Çështja e keqbesimit është elementi më thelbësor dhe substancial i pretendimit të kërkueses, ndërkohë që gjykatat e faktit e kanë neglizhuar tërësisht, duke mos e shqyrtuar dhe marrë në konsideratë.

18.4. Gjykatat e faktit janë mjaftuar të shprehen shkarazi se shoqëria "Arseni" sh.p.k. e ka fituar të drejtën mbi markën B-52 nga shoqëria maqedonase, duke eliminuar kështu çështjen e keqbesimit. Gjykata e apelit thjesht referon në vendimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me çështjen e keqbesimit, pa shtuar asnjë argument tjetër nga ana e saj. Ajo gjykatë e ka anashkaluar plotësisht pretendimin sipas të cilit, regjistrimi i markës B-52 me nr. 11992, datë 18.04.2008, në emër të shoqërisë "Arseni" sh.p.k. është bërë në keqbesim, pasi midis dy shoqërive vazhdonte të zbatohej dhe të kishte efekte një marrëveshje furnizimi për tregtimin e pijes energjike B-52 në Shqipëri, që vazhdoi deri në vitin 2012, çka ndalonte shoqërinë "Arseni" sh.p.k. që të regjistronte apo të fitonte pronësi mbi një markë identike si marka e kërkueses, të cilën ai duhej ta shpërndante dhe ta mbronte në tregun shqiptar.

18.5. Gjykata e apelit kishte detyrimin që, në përputhje me nenet 14 dhe 16 të KPC-së, të merrte në shqyrtim kontratat e lidhura midis kërkueses dhe shoqërisë "Arseni" sh.p.k. dhe provat mbështetëse, ku qëndron edhe thelbi i pretendimit të kërkueses dhe palës tjetër në gjykim, DPPI-së. Nëse hetimi dhe analiza e pretendimit të kërkueses do të ishin bërë, do të evidentohej qartë se ai nuk ka lidhje me ngjashmërinë e markave tregtare B-52, por me ndalimin që kishte sipas kontratave shoqëria "Arseni" sh.p.k. për të fituar apo regjistruar pronësi për markën B-52 apo ndonjë markë tjetër të ngjashme me të.

18.6. Gjyqtari në pakicë në Gjykatën e Lartë ka shqyrtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga kërkuesja dhe DPPI-ja në lidhje me argumentet për keqbesimin dhe i ka konsideruar ato bindëse dhe të argumentuara mirë. Përkundrazi, shumica në atë gjykatë nuk dha asnjë arsye se përse nuk ishte dakord me mendimin e pakicës.

19. ***Subjekti i interesuar, shoqëria "Arseni" sh.p.k.,*** ka prapësuar si vijon:

i) Për rihapjen e procesit në Gjykatë:

19.1. GJEDNJ-ja ka shqyrtuar tre pretendime kryesore të kërkueses, por ka gjetur shkelje vetëm në një aspekt të caktuar dhe të kufizuar

të procesit gjyqësor, konkretisht për mungesën e arsyetimit, ndërkohë që dy pretendimet e tjera i ka konsideruar të pabazuara, duke i rrëzuar në mënyrë të qartë dhe të argumentuar. Për këtë arsye, kërkesa për rishqyrtim tërësor të çështjes, si të ishte një proces i ri gjyqësor që nis nga fillimi, nuk gjen mbështetje as në natyrën e vendimit të GJEDNJ-së, as në praktikën e ndjekur prej saj, as në kuadrin kushtetues dhe procedural shqiptar. GJEDNJ-ja nuk ka konstatuar shkeljen e së drejtës materiale të kërkueses dhe nuk ka dhënë një vendim që i hap rrugë zhbërjes së gjithë procesit gjyqësor të zhvilluar më herët. GJEDNJ-ja ka konstatuar vetëm një mangësi procedurale në raport me një nga tre vendimet e analizuara, e cila nuk është e mjaftueshme për të përmbysur të gjithë procesin gjyqësor, aq më tepër kur kjo mangësi është e izoluar dhe nuk prek themelin e vendimmarrjes. Vetë vendimi i GJEDNJ-së nuk përmban ndonjë urdhër ose udhëzim specifik për rishqyrtimin e çështjes nga Gjykata, as ndonjë kërkesë për zhbërjen e vendimeve të mëparshme të gjykatave të zakonshme, përkundrazi ia lë shtetit palë që të zgjedhë mjetet për zbatimin e vendimit, duke respektuar parimin e subsidiaritetit dhe rolin parësor të gjykatave të brendshme në këtë proces.

19.2. Parimi i *gjësë së gjykuar* nuk lejon që çështje të cilat janë shqyrtuar dhe mbi të cilat është vendosur në mënyrë përfundimtare nga një organ kompetent të rihapen sërish, përveçse nëse ekzistojnë prova ose rrethana të reja që justifikojnë një rishikim. Për rrjedhojë, Gjykata nuk duhet të shqyrtojë pjesën që tanimë përbën gjë të gjykuar, për sa kohë GJEDNJ-ja nuk ka konstatuar shkelje për pretendimet e tjera të kërkueses dhe as nuk është shprehur se do të ishte e nevojshme rihapja e procesit për to. Çdo përpjekje për të rikthyer në shqyrtim pretendime që tashmë janë rrëzuar, të arsyetuara në mënyrë të qartë nga Gjykata dhe të konsideruara të pajtueshme me KEDNJ-në nga GJEDNJ-ja, përbën jo vetëm një shkelje të parimit të sigurisë juridike, por edhe keqpërdorim të së drejtës për të kërkuar rihapjen e procesit të përfunduar përfundimisht.

ii) Për themelin e çështjes:

19.3. Pretendimi për *cenimin e standardit të arsyetimit* është i pabazuar. Gjykatat e zakonshme kanë arritur të shpjegojnë mjaftueshëm

arsyet e vendimmarrjes, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi gjyqësor, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të subjekteve në gjykim, duke përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument. Gjykatat e zakonshme e kanë trajtuar çështjen e qenies ose jo në keqbesim të shoqërisë "Arseni" sh.p.k. dhe pasi kanë vlerësuar provat dhe ligjin e zbatueshëm, kanë arritur në konkluzionin se në këtë rast nuk jemi në marrëdhënie keqbesimi. Pasi kanë analizuar datat e regjistrimeve të ndryshme të markave tregtare, faktin nga rrjedh e drejta e pronësisë për subjektin e interesuar, gjykatat kanë arritur në konkluzionin që në këtë rast nuk mundet që të ketë keqbesim dhe se marrëdhënia kontraktore e pretenduar nuk ka asnjë lidhje për sa i përket kohës së regjistrimit të markave dhe mënyrës së fitimit të pronësisë mbi markën tregtare nga shoqëria "Arseni" sh.p.k.

19.4. Argumenti i kërkueses i takon mirëfilli interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, të cilat, sipas saj, nuk kanë interpretuar një kontratë të caktuar juridike, duke mos e ngritur në nivel kushtetues. Pretendimet e kërkueses nuk qëndrojnë as në themel. Pretendimi për keqbesimin është i pabazuar, pasi, siç është argumentuar nga gjykatat e zakonshme, mënyra e fitimit të pronësisë mbi markën tregtare rrjedh nga një shoqëri e së drejtës maqedonase dhe jo nga marrëdhënia kontraktore e prezumuar me subjekte të ndryshme të së drejtës. Edhe pretendimi se është kopjuar ose shfrytëzuar reputacioni i shoqërisë "Bavaria" N.V. ka marrë përgjigje nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për më tepër, shoqëritë tregtare prezumohen se janë subjekte të ndryshme juridike dhe vetëm palët e tjera mund të pretendojnë se marrëdhënia kontraktore me një subjekt ndikon edhe në subjekte të tjera të së drejtës. Midis këtyre palëve ka pasur edhe procese të tjera gjyqësore, siç është ai ku kërkuesja, me kundërpadi, ka kërkuar shfuqizimin e pronësisë së shoqërisë "Arseni" sh.p.k. mbi markën B-52, e cila është rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, e drejta e pronësisë së subjektit të interesuar në raport me kërkuesen për markën B-52 është zgjidhur në favor të tij.

20. ***Subjekti i interesuar, DPPI-ja,*** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A) Për rihapjen e procesit në Gjykatë

21. Gjykata vëren se referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit të saj organik, nëse ajo ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit.

22. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues, duke mos përjashtuar edhe rastin e rihapjes së procesit sipas nenit 71/c të ligjit organik të Gjykatës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës për rihapje të procesit në këtë Gjykatë, sikurse të ankimit kushtetues individual, janë të natyrës kumulative, pra ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse kriteret ligjore të lartpërmendura plotësohen në rastin në shqyrtim.

23. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kërkesës për rihapjen e procesit, pasi ka qenë palë në procesin kushtetues, vendimin nr. 15/2021 të të cilit e ka ankimuar përpara GJEDNJ-së. Kjo e fundit, me vendimin e datës 16.07.2024, pasi ka konstatuar shkeljen e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar nga Gjykata, për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, ka vlerësuar se forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes do të ishte rihapja e procesit përpara kësaj Gjykate.

24. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis,* në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, Gjykata ka pohuar se llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare, pra nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 71/c, pika 4, të ligjit organik të Gjykatës. Në rastin konkret vendimi i GJEDNJ-së për çështjen e kërkueses është botuar në Fletoren Zyrtare nr.

191, datë 12.11.2024 dhe kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit në datën 13.02.2025, pra brenda afatit 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesja e përmbush edhe kriterin *ratione temporis.*

25. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae,* kërkuesja ka kërkuar rishqyrtimin e çështjes së saj për të gjitha pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues të datës 02.02.2018, duke parashtruar se rihapja e procesit nënkupton shqyrtimin në tërësi të çështjes së saj dhe se nga leximi i vendimit të GJEDNJ-së rezulton qartë se pretendimet për: *(i)* njëanshmërinë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe *(ii)* mosformimin e rregullt të trupit gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë të lidhura drejtpërdrejt me çështjen e mungesës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Sipas kërkueses, nëse procesi rihapet vetëm për çështjen e mungesës së arsyetimit të vendimit të Gjykatës dhe mbetet i mbyllur për çështjet e tjera për të cilat GJEDNJ-ja nuk është shprehur, do të thotë të mos kryhet një hetim i plotë në kuadër të rihapjes dhe rezultati do të ishte që sërish Gjykata do të rrezikonte të mos e përmbushte standardin e arsyetimit të vendimit.

26. Gjykata rithekson se në rastet e rihapjes së procesit, kufijtë e shqyrtimit të çështjes përcaktohen nga shkaku i rihapjes. Kjo do të thotë që kur shkaku i rihapjes së procesit ka të bëjë me një shkelje e cila prek vetëm një pjesë të vendimit të dhënë, atëherë procesi rihapet vetëm për atë pjesë. Nga ana tjetër, në rastet e rihapjes së procesit, kërkuesi nuk mund të zgjerojë shkaqet e ankimit kushtetues fillestar dhe as të shtojë argumente të tjera në lidhje me to (*shih vendimin nr. 48, datë 22.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të së drejtës për proces të rregullt në drejtim të standardit të arsyetimit, për shkak se vendimi nr. 15/2021 i Gjykatës nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkueses në ankimin kushtetues individual të datës 05.02.2018 për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme, në kushtet që ai është rrëzuar për mosarritje të shumicës së kërkuar të votave. Në lidhje me pretendimin për mungesën e arsyetimit nga gjykatat e zakonshme, i parashtruar si në ankimin kushtetues fillestar, ashtu dhe në kërkesën për rihapjen e procesit, në vendimin nr. 15/2021 të Gjykatës është pranuar se bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe se kërkuesja plotëson kriteret paraprake të legjitimimit.

27. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa për rihapjen e procesit është e bazuar dhe duhet të pranohet, duke shfuqizuar vendimin e saj nr. 15/2021 vetëm për atë pjesë të tij për të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje nga ana e saj (Gjykatës), pra vetëm për sa Gjykata ka disponuar për

rrëzimin e kërkesës (ankimit kushtetues fillestar) në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore të gjykatave të zakonshme. Për pretendimet e tjera të kërkueses, për të cilat GJEDNJ-ja nuk ka konstatuar shkelje, ato nuk mund të rimerren në shqyrtim për sa kohë Gjykata është shprehur me vendim në lidhje me to, vendim i cili për këtë pjesë ka natyrë përfundimtare (*res judicata*), ndaj këto pretendime nuk mund t'i nënshtrohen sërish kontrollit kushtetues. Në këtë pikë, Gjykata çmon të ritheksojë se nisur nga fuqia detyruese e vendimeve të GJEDNJ-së, e përcaktuar në nenin 46 të KEDNJ-së, detyrimi që lind në kuadër të zbatimit të vendimit të asaj gjykate në rastin konkret, konsiston vetëm në shqyrtimin e këtij pretendimi të kërkueses, shqyrtim i cili përmbush detyrimet që rrjedhin nga KEDNJ-ja për korrigjimin e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja (*shih vendimin nr. 48, datë 22.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa më lart, Gjykata në vijim do të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimit të kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykatat e zakonshme, të parashtruar në ankimin kushtetues fillestar dhe të përsëritur edhe në kërkesën për rihapjen e procesit drejtuar asaj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

29. Sipas kërkueses, gjykatat nuk janë shprehur për pretendimin e saj për keqbesim në veprimet e kryera nga subjekti i interesuar, shoqëria "Arseni" sh.p.k. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë në pjesën arsyetuese të vendimit është shprehur përciptazi në lidhje me këtë pretendim, duke arsyetuar në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë, duke mos bërë një analizë tërësore të fakteve dhe provave të paraqitura nga kërkuesja. Po sipas kërkueses, as gjykata e apelit, as Gjykata e Lartë nuk kanë mbajtur parasysh kontratën e shitjes me shumicë të lidhur mes palëve, që është thelbi ku bazohet pretendimi për keqbesim, kontratë që i ka vendosur shoqërisë "Arseni" sh.p.k. detyrime në lidhje me markën e kërkueses, të cilat përfshijnë edhe ndalimin që të fitojë pronësi apo të përdorë si të vetën një markë që është krejt identike me markën B-52. Kërkuesja ka pretenduar se çështja e keqbesimit është elementi më thelbësor dhe substancial i pretendimit të saj, ndërkohë që gjykatat e faktit e kanë neglizhuar tërësisht, duke mos e shqyrtuar dhe marrë në konsideratë.

30. *Subjekti i interesuar, shoqëria "Arseni" sh.p.k.,* ka prapësuar duke

argumentuar se gjykatat e zakonshme kanë arritur të shpjegojnë mjaftueshëm arsyet e vendimmarrjes, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të subjekteve në gjykim, duke përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Sipas këtij subjekti, gjykatat e kanë trajtuar çështjen e qenies ose jo të tij në keqbesim dhe pasi kanë vlerësuar provat dhe ligjin e zbatueshëm kanë arritur në konkluzionin se në këtë rast nuk jemi në marrëdhënie keqbesimi dhe se marrëdhënia kontraktore e pretenduar nuk ka asnjë lidhje për sa i përket kohës së regjistrimit të markave dhe mënyrës së fitimit të pronësisë mbi markën tregtare nga shoqëria "Arseni" sh.p.k. Po sipas tij, argumentet e kërkueses kanë bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, duke mos e ngritur pretendimin në nivel kushtetues dhe, për më tepër, ato nuk qëndrojnë as në themel.

31. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 24, datë 09.04.2024; nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare

ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim nëse në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të funksionit të tyre dhe në përputhje me detyrimin për të dhënë një vendim të arsyetuar, kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me shkaqet që kanë çuar në qëndrimin e tyre të shprehur në dispozitiv dhe nëse ky arsyetim plotëson standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

34. Gjykata vëren se në datën 16.07.2012 subjekti i interesuar, shoqëria "Arseni" sh.p.k., i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padi me objekt shfuqizimin dhe çregjistrimin e mbrojtjes së markës B-52 me nr. 1082916 të regjistruar në emër të kërkueses (*procesi i tretë gjyqësor*). Sipas atij subjekti (paditësja), lidhur me pronësinë e kësaj marke, ndërmjet po këtyre palëve është zhvilluar një proces tjetër gjyqësor dhe me vendimin nr. 12870, datë 26.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur shfuqizimi i markës tregtare B-52 me nr. regjistrimi 970878 në pronësi të kërkueses, për rrjedhojë regjistrimi është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë të drejtat e markave dhe patentave në Republikën e Shqipërisë, si edhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Po sipas paditëses, pavarësisht se ky proces ishte në shqyrtim në gjykatën e apelit, shoqëria "Bavaria" N.V. e ka regjistruar markën e re, e cila në figurë ka elemente identike me markën e regjistruar në pronësi të shoqërisë "Arseni" sh.p.k., duke tentuar që të anashkalojë eventualisht pasojat e procesit të mëparshëm gjyqësor.

35. Kërkuesja, shoqëria "Bavaria" N.V., në cilësinë e palës së paditur në procesin e tretë gjyqësor, ka prapësuar se marka tregtare B-52 me nr. regjistrimi 11992, datë 18.04.2008 në emër të paditëses, shoqërisë "Arseni" sh.p.k., është regjistruar në Shqipëri në keqbesim, pasi kjo pije energjike prodhohet në Holandë dhe është tregtuar në Shqipëri që gjatë periudhës 2006-2008. Sipas saj, marka tregtare B-52 me nr. regjistrimi ndërkombëtar 970878 gëzon statusin e "markës së mirënjohur", bazuar në faktet e tregtimit të saj në Shqipëri përpara regjistrimit abuziv si markë kombëtare me nr. regjistrimi 11992 dhe se pija energjike B-52 që tregton shoqëria "Arseni" sh.p.k. prodhohet në Maqedoni nga i njëjti person që në mënyrë abuzive ka regjistruar në Shqipëri markën tregtare B-52, me nr. regjistrimi 11992. Po sipas saj, ajo e ka importuar këtë pije energjike prej vitit 2011 me logon e re, me nr. regjistrimi ndërkombëtar 1082916,

datë 14.06.2011, të drejta që burojnë nga marka tregtare me nr. regjistrimi ndërkombëtar 970878.

36. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e palëve në gjykim, ka vlerësuar se paditësja, shoqëria "Arseni" sh.p.k., është pronare e markës tregtare B-52, pronësi e fituar nëpërmjet transferimit të pronësisë me anë të kontratës së shitjes të datës 16.06.2010 nga shoqëria e së drejtës maqedonase "N.D.L.", e cila e ka regjistruar fillimisht këtë markë në Republikën e Shqipërisë, me datë aplikimi 18.04.2008 dhe datë regjistrimi 06.11.2008, me kohëzgjatje të mbrojtjes deri më 18.04.2018. Po sipas asaj gjykate, e paditura, shoqëria "Bavaria" N.V., provoi gjatë gjykimit se ka regjistruar pronësinë e markës tregtare B-52 në vendet e Beneluksit, me datë 22.02.2008 (data e prioritetit 19.02.2008) dhe në vijim, në datën 20.06.2008, ka bërë një regjistrim ndërkombëtar të markës, ndërsa data e aplikimit për përcaktimin e Shqipërisë si vend ku kërkohet mbrojtja e markës tregtare B-52 është 21.10.2008 dhe regjistrimi datë 12.02.2009. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, aplikimi për regjistrim ndërkombëtar të markës B-52 në Shqipëri është bërë pas aplikimit dhe mbrojtjes së regjistruar të markës kombëtare në pronësi të paditëses, shoqërisë "Arseni" sh.p.k. Për sa i përket pretendimit për keqbesim, sipas gjykatës ai nuk provohet në kushtet kur nuk ka qenë paditësja ajo që ka bërë regjistrimin fillestar të markës B-52 me nr. regjistrimi 11992, datë 18.04.2008 në territorin e Republikës së Shqipërisë, por shoqëria maqedonase "N.D.L.", e cila e ka regjistruar atë kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht. Referuar parashikimeve të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë intelektuale", të ndryshuar (*ligji nr. 9947/2008*) dhe faktit se elementet që ai parashikon janë marrë në konsideratë nga autoriteti përkatës, DPPM-ja, që ka pranuar regjistrimin e markës tregtare nr. 11992 regjistrimi, datë 18.04.2008, në pronësi të paditëses, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se ajo do të konsiderohet si markë e mëparshme në kuptim të ligjit, e cila është regjistruar në Shqipëri jo vetëm përpara markës tregtare objekt i këtij gjykimi, me nr. regjistrimi 1082916, datë 21.07.2011, me pronar shoqërinë "Bavaria" N.V., por edhe markës tjetër të mëparshme të saj me nr. regjistrimi ndërkombëtar 970878, datë 20.06.2008.

37. Gjykata e apelit, e vënë në lëvizje me ankimin e kërkueses, ka vlerësuar se vendimi objekt ankimi është i drejtë, ndaj duhet lënë në fuqi. Sipas asaj gjykate, pretendimi i kërkueses se markat nuk kanë ngjashmëri është i pabazuar, pasi në vlerësim të kritereve që përcaktojnë

karakterin dallues të markës, ato kanë ngjashmëri dhe sjellin konfuzion te konsumatori, ndaj duhet të shqyrtohet se cila nga palët gëzon mbrojtje si rezultat i regjistrimit të saj, referuar regjistrimit të markës në Shqipëri dhe mbrojtjes së markës së regjistruar me parë. Sipas gjykatës së apelit, marka tregtare në Republikën e Shqipërisë është regjistruar fillimisht nga subjekti "N.D.L." me datë aplikimi 18.04.2008 dhe datë regjistrimi 06.11.2008, me kohëzgjatje të mbrojtjes deri në datën 18.04.2018 dhe lista e mallrave dhe/ose shërbimeve është klasa 32 sipas klasifikimit ndërkombëtar të Nice-s, pije joalkoolike, pije energjike, pije sportive. Gjykata e apelit ka vlerësuar se shoqëria "Bavaria" N.V. ka në pronësi markën tregtare B-52, pije energjike, pronësi e fituar nëpërmjet aplikimit në vendin e origjinës, pranë regjistrit të markave tregtare të Beneluksit me datë 19.02.2008, me nr. regjistrimi 1153546, markë e regjistruar përfundimisht në Beneluks me datë 22.02.2008, me nr. regjistrimi 838872 dhe pas aplikimit për regjistrim ndërkombëtar më 20.06.2008, marka tregtare B-52 është regjistruar përfundimisht më 24.06.2008, me nr. regjistrimi ndërkombëtar 970878. Sipas gjykatës së apelit, pas regjistrimit ndërkombëtar të markës, kërkuesja ka bërë aplikim ndërkombëtar pranë WIPO-s, më 21.10.2008, për të shtrirë efektet e mbrojtjes edhe në Shqipëri dhe përfundimisht, data e regjistrimit të Shqipërisë si shtet i përcaktuar është 12.02.2009. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka vlerësuar se data e aplikimit për mbrojtjen e markës B-52 është e mëvonshme nga regjistrimi i markës së paditëses, shoqërisë "Arseni" sh.p.k. dhe se pala e paditur (kërkuesja) ka keqinterpretuar datën e regjistrimit të markës në Beneluks me atë të regjistruar në Shqipëri. Për sa i përket keqbesimit, gjykata e apelit ka vlerësuar se në vitin 2010 është bërë kalimi i pronësisë me kontratë nga shoqëria maqedonase te paditësja, shoqëria "Arseni" sh.p.k., për të cilën nuk ka asnjë lloj keqbesimi në regjistrimin e markës dhe në blerjen e saj.

38. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja, e cila ka pretenduar se regjistrimi i markës nga shoqëria "Arseni" sh.p.k. është bërë në keqbesim, në mashtrim të ligjit dhe të parimeve profesionale e të konkurrencës së ndershme në treg, për sa kohë është faktuar në gjykim zhvillimi i aktivitetit të tregtimit të produktit B-52 në Shqipëri dhe marrëdhënia e kërkueses për një periudhë prej gjashtë vjetësh (10.08.2006 deri më 14.02.2012) me shoqërinë "Gjithësia Market", në pronësi të L.T., kohë gjatë së cilës ky shtetas ka ushtruar aktivitetin tregtar me emërtime të ndryshme, përfshirë "Arseni" sh.p.k. Në rekurs është pretenduar se mes shoqërisë "Tabacco Holding Group" sh.p.k. (shitësi), që kishte të

drejtën e importimit në Shqipëri të pijes energjike B-52, sipas kontratës së distribucionit të lidhur me shoqërinë "Bavaria" N.V., dhe shoqërisë "Arseni" sh.p.k. (blerësi) është lidhur kontrata e shitjes nr. 1950 rep., nr. 591/1 kol., datë 14.02.2011 për shitjen me shumicë të këtij produkti, sipas së cilës blerësi njeh dhe pranon produktin, si dhe të drejtat e lidhura me të, si dhe garanton shitësin se nuk do të ndërmarrë asnjë veprim për të përvetësuar, tjetërsuar ose për të regjistruar ndonjë markë të regjistruar të ligjshme, të njëjtë me atë të produktit B-52 në pronësi të "Bavaria" N.V. etj. Kështu, në rekurs është pretenduar se referuar dispozitave të kësaj kontrate shoqëria "Arseni" sh.p.k. ka pranuar pronësinë e kërkueses dhe të gjitha të drejtat në lidhje me markën B-52 objekt gjykimi, paraqitja vizuale e së cilës është pjesë e aneksit të kontratës, por gjykatat e faktit nuk janë shprehur për këtë marrëdhënie kontraktuale midis palëve ndërgjyqëse.

39. Po në rekurs kërkuesja ka pretenduar se regjistrimet e markës prej saj janë bërë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9947/2008 dhe se ajo gëzon të drejtën e prioritetit, që i lind subjektit, referuar nenit 4 të Konventës së Parisit, brenda gjashtë muajve nga data e depozitimit. Për rrjedhojë, efektet e regjistrimit fillestar të kryera nga Zyra e Beneluksit i kanë njohur kërkueses si datë prioritare atë të depozitimit të aplikimit (datë 19.02.2008), duke i dhënë certifikatën e prioritetit nr. 1153546 dhe brenda gjashtë muajve (datë 24.06.2008) ajo ka depozituar kërkesën për regjistrim ndërkombëtar të markës B-52. Sipas rekursit, kërkesa për të zgjedhur Shqipërinë është e datës 21.10.2008, në përputhje me Protokollin e Madridit, pasi subjektit i njihet e drejta që brenda 12 muajve nga data e depozitimit për regjistrim ndërkombëtar të zgjedhë vendet ku do të shtrijë regjistrimin, kohëzgjatje që fillon nga data e depozitimit (24.06.2008). Në rekurs është pretenduar, gjithashtu, se DPPM-ja duhet të kishte reaguar *ex officio* sikundër ka vepruar për të njëjtin rast zyra homologe maqedonase, duke çregjistruar markën në pronësi të subjektit "N.D.L.". Po kështu, është pretenduar edhe se gjykata e apelit ka anashkaluar parimin e hierarkisë së akteve, sipas nenit 116 të Kushtetutës, lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të TRIPS, Konventës së Parisit, Marrëveshjes së Madridit, si dhe Protokollit të Marrëveshjes së Madridit, të ratifikuara dhe të pranuara nga shteti shqiptar.

40. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen në seancë gjyqësore, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, në analizë të parashikimeve të ligjit nr. 9947/2008,

të Konventës së Parisit "Për mbrojtjen e pronësisë industriale" dhe të marrëveshjes së Madridit e të protokollit të saj. Në lidhje me pretendimin se regjistrimi i markës B-52 prej shoqërisë "Arseni" sh.p.k. është bërë në keqbesim ose është regjistrim abuziv, Kolegji Civil ka vlerësuar se është i pabazuar. Sipas tij, marka tregtare në Republikën e Shqipërisë është regjistruar fillimisht nga shoqëria e së drejtës maqedonase "N.D.L." me datë aplikimi 18.04.2008 dhe me datë regjistrimi 06.11.2008, ndaj shoqëria "Arseni" sh.p.k. është bërë pronare e markës B-52 në datën 16.06.2010 nëpërmjet transferimit të pronësisë me anë të kontratës së shitjes nga shoqëria maqedonase. Sipas atij kolegji, regjistrimi i markës tregtare B-52 me nr. regjistrimi kombëtar 11992 është bërë shumë më herët se regjistrimi i markës së shoqërisë "Bavaria" N.V. (datë 21.07.2011), madje edhe më parë se marka tjetër e mëparshme e kësaj shoqërie me nr. 970878 regjistrimi ndërkombëtar, datë 20.06.2008 dhe se konflikti mes palëve është zgjidhur me vendimin nr. 00-2016-755(66), datë 09.03.2016 të po asaj gjykate. Kolegji Civil i është referuar parashikimit të nenit 143, pika 5, të ligjit nr. 9947/2008.

41. Lidhur me pretendimin e kërkueses për prioritet, Kolegji Civil ka vlerësuar se është i pabazuar, pasi referuar datës prioritare (19.02.2008) që është regjistrimi në vendin e origjinës, shoqëria "Bavaria" N.V., brenda gjashtë muajve, ka depozituar kërkesën e datës 24.06.2008 për regjistrim ndërkombëtar për një listë shtetesh në të cilën nuk bënte pjesë Shqipëria, ndërkohë që shtesën për shtete të tjera për mbrojtje me datë prioriteti 19.02.2008 ajo mund ta bënte deri më 19.08.2008, por një gjë e tillë nuk ka rezultuar e provuar nga gjykatat e faktit. Në vlerësimin e atij kolegji, referuar Konventës së Parisit dhe nenit 147 të ligjit nr. 9947/2008, gjykatat e faktit kanë interpretuar drejt kur pranojnë se kërkesa për të zgjeruar mbrojtjen ndërkombëtare edhe për sa i përket Shqipërisë është e datës 21.10.2008, datë kjo e mëvonshme në raport me regjistrimin e palës tjetër. Ai kolegj ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin se DPPM-ja duhej të kishte vepruar me nismë, kurse për sa i përket pretendimit se markat nuk janë identike dhe nuk kanë njëanshmëri fonetike, ka vlerësuar se ky kërkim përbën një çështje të provuari që u përket gjykatave të faktit.

42. Në lidhje me pretendimin e kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykatat e zakonshme, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit organik të Gjykatës.

43. Sipas njërit qëndrim[1] u vlerësua se pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore është i bazuar, ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar për këtë shkak. Rezulton se kërkuesja në ankimet e saj përpara gjykatave të zakonshme ka ngritur si pretendim faktin e qenies në keqbesim të paditëses (subjektit të interesuar), shoqërisë "Arseni" sh.p.k., për sa kohë që kjo e fundit në momentin e lidhjes së kontratës me shoqërinë e së drejtës maqedonase "N.D.L.", ishte në dijeni të faktit se pronare e kësaj marke ishte kërkuesja, që e kishte regjistruar ndërkombëtarisht si të tillë, për shkak të marrëdhënies tregtare që këto dy palë kanë pasur me njëra-tjetrën bazuar në kontratën e lidhur mes tyre për importimin dhe distribucionin e kësaj pijeje në Shqipëri nga subjekti i interesuar. Në këto kontrata subjekti i interesuar jo vetëm që ka njohur pronësinë e kërkueses, por edhe ka garantuar se nuk do të ndërmarrë asnjë veprim për të përvetësuar, tjetërsuar ose regjistruar ndonjë markë të regjistruar të ligjshme me atë të produktit B-52 në pronësi të saj. Referuar vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat kanë pranuar pjesërisht padinë e paraqitur nga paditësja, shoqëria "Arseni" sh.p.k. (subjekti interesuar) me argumentet se: *i)* regjistrimi i markës tregtare në Shqipëri është bërë nga shoqëria maqedonase, ndërsa shoqëria "Arseni" sh.p.k. është bërë pronare e markës B-52 në datën 16.06.2010 nëpërmjet transferimit të pronësisë me anë të kontratës së shitjes nga shoqëria maqedonase, ndaj nuk ka keqbesim nga ajo; *ii)* regjistrimi kombëtar i markës nga shoqëria maqedonase është bërë shumë më herët se regjistrimi kombëtar i markës së shoqërisë "Bavaria" N.V. (datë 21.07.2011), madje edhe më parë se regjistrimi ndërkombëtar i markës tjetër të mëparshme (datë 20.06.2008); *iii)* konflikti mes palëve është zgjidhur me vendimin nr. 00-2016-755(66), datë 09.03.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në kuptim të standardit të arsyetimit vendimet e gjykatave janë të paqarta dhe kontradiktore, për shkak se ndërsa argumenti i përdorur prej tyre për ekzistencën e gjësë së gjykuar do të duhej të pengonte shqyrtimin në themel të pretendimeve të paditëses, në fakt, referuar argumenteve të tjera të vendimmarrjes, rezulton qartësisht se pretendimi për keqbesimin është shqyrtuar në themel prej tyre.

44. Nga ana tjetër, edhe referuar arsyetimit të gjykatave për regjistrimin e markës nga shoqëria maqedonase, duke u bazuar vetëm në kohën e këtij regjistrimi në Shqipëri dhe kalimin e saj paditëses (subjektit të interesuar)

[1] Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Holta Zaçaj, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska dhe Marjana Semini.

përmes kontratës së shitjes, ato nuk duket se shkojnë në të njëjtin drejtim, përveçse vendimet as nuk janë arsyetuar mjaftueshëm. Gjykatat kanë anashkaluar thelbin e pretendimit të kërkueses, pra paligjshmërinë e regjistrimit kombëtar (në Shqipëri) të markës nga shoqëria maqedonase dhe fitimin në vijim të të drejtave nga shoqëria "Arseni" sh.p.k. në raport me faktet relevante të regjistrimit të markës në vendin e origjinës dhe në regjistrin ndërkombëtar të markave nga kërkuesja, nga njëra anë, dhe shtetasi Z.L. (përfaqësuesi i shoqërisë maqedonase), nga ana tjetër, si dhe regjistrimin kombëtar (në Shqipëri) të markës nga shoqëria maqedonase, të vlerësuara sipas parimeve të pranuara në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale të cilat, sipas nenit 116 të Kushtetutës, në hierarkinë e akteve renditen menjëherë pas saj. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore është i bazuar, ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar për këtë shkak, duke u shfuqizuar vendimi i Gjykatës së Lartë dhe duke u kthyer çështja për shqyrtim në atë gjykatë, në mënyrë që t`u jepte përgjigje përfundimtare të arsyetuar pretendimeve të kërkueses.

45. Sipas qëndrimit tjetër[2] u vlerësua se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, për shkak se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkueses të parashtruara përpara tyre, duke u dhënë atyre përgjigje të arsyetuar, veçanërisht lidhur me pretendimin për keqbesimin në veprimet e shoqërisë "Arseni" sh.p.k. dhe për të drejtën prioritare. Lidhur me pretendimin

[2] Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtaret Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi.

Gjyqtarja Sonila Bejtja, e cila në vendimin e Gjykatës nr. 15/2021 ka votuar për pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesja në lidhje me dy nga pretendimet e paraqitura asokohe në ankimin kushtetues të datës 05.02.2018 (pretendimi për gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe lidhur me të edhe pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit), ndërkohë që ka votuar për rrëzimin e pretendimeve të tjera, ka vlerësuar se jo vetëm që rihapja e procesit nënkupton një rishqyrtim të çështjes për atë pretendim për të cilin është rihapur, por edhe se, për sa kohë që pretendimi për gjykatën e caktuar me ligj, ku bazohej edhe qëndrimi i mëparshëm i saj në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit, nuk mund të rimerret në shqyrtim, atëherë edhe rishqyrtimi i pretendimit për standardin e arsyetimit të vendimit duhet të bëhet në mënyrë të pavarur. Për këtë qëllim, gjyqtarja Sonila Bejtja vlerësoi të analizojë pretendimin për standardin e arsyetimit ashtu siç ai është ngritur në procesin konkret, pra vetëm në drejtim të përmbajtjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme, lidhur me mënyrën sesi kanë vlerësuar pretendimet e palëve në kuptim të "keqbesimit" dhe "prioritetit në regjistrim", dhe nëse kërkuesja ka paraqitur mjaftueshëm argumente në mbështetje të këtij pretendimi.

e kërkueses për kontratat e lidhura mes saj dhe përfaqësuesit të subjektit të interesuar për tregtimin e produktit B-52 në Shqipëri që prej vitit 2006, sipas të cilave ai ka njohur të drejtat e kërkueses mbi markën dhe ka marrë përsipër të mos kryejë asnjë veprim për të përvetësuar, tjetërsuar ose regjistruar ndonjë markë të regjistruar të ligjshme me atë të produktit B-52 në pronësi të "Bavaria" N.V. etj., edhe pse gjykatat nuk janë ndalur posaçërisht në këtë marrëdhënie të mëparshme mes tyre, në fakt ato i kanë dhënë përgjigje këtij pretendimi në këndvështrim të keqbesimit, për sa kohë kanë arsyetuar se marka B-52 mbi të cilën pretendon të drejta shoqëria "Arseni" sh.p.k. është regjistruar nga shoqëria e së drejtës maqedonase "N.D.L.", nga e cila i kanë kaluar subjektit të interesuar të drejtat e pronësisë.

46. Në kuptim të standardit të arsyetimit, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese në lidhje me objektin e çështjes së paraqitur për shqyrtim përpara tyre dhe thelbin e pretendimeve të ngritura nga palët në atë gjykim. Referuar arsyetimit të vendimeve të kundërshtuara, në tërësinë e tyre ato nuk rezultojnë arbitrare, jologjike dhe të pamjaftueshme apo kontradiktore ose të paqarta për sa u përket të dhënave të pasqyruara prej tyre. Ndërsa gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pretendim, nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara del qartë se ato kanë trajtuar çështjet thelbësore të faktit dhe të ligjit të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së parashtruar përpara tyre. Kështu, gjykatat kanë arsyetuar në veçanti në lidhje me pretendimet kryesore të padisë së paditëses (subjektit të interesuar) dhe thelbin e kundërshtimeve të kërkueses për të drejtën e pronësisë për markën tregtare dhe mbrojtjen që gëzon ajo. Vendimet e gjykatave të zakonshme përmbajnë mjaftueshëm arsyetim në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes dhe zbatimin e ligjit dhe ky përcaktim prej tyre i fakteve dhe i zbatimit të ligjit në vijim nuk duket se është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, ndaj kërkesa duhej të rrëzohej për këtë shkak.

47. Në përfundim, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit organik të Gjykatës, kërkesa e kërkueses për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore objekt kërkese si të papajtueshme me Kushtetutën konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71/c, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit në Gjykatën Kushtetuese.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese vetëm për sa është disponuar në lidhje me pretendimin e kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

3. Rrëzimin e ankimit kushtetues individual të kërkueses.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 05.11.2025
Shpallur më 12.12.2025

Vendim nr. 69, datë 06.11.2025
(V-69/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 06.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ALEKS ÇELA**

SUBJEKT I INTERESUAR:
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT, përfaqësuar nga Armando Bici dhe Resilda Bilaj, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3106 (321), datë 16.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 132 dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkuesit Aleks Çela (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar,

Shërbimit Informativ të Shtetit (*SHISH*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar pranë subjektit të interesuar, SHISH-it deri më 07.12.2006. Me urdhrin nr. 12-997, datë 07.12.2006 të drejtorit të SHISH-it "Për lirim nga shërbimi", ai është liruar nga shërbimi me motivacionin e shkeljes së rregullave nënligjore që normojnë veprimtarinë informative të SHISH-it. Pavarësisht motivit të lirimit, kërkuesi është trajtuar financiarisht me pension të parakohshëm.

2. Në datën 15.01.2014 SHISH-i i është përgjigjur me shkrim kërkuesit, duke i vënë në dispozicion ekstraktin e urdhrit të lirimit nga shërbimi. Disa ditë më pas, konkretisht në datën 31.01.2014, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, me objekt pavlefshmërinë absolute të urdhrit të lirimit, zgjidhjen e pasojave dhe shpërblimin e dëmit me pagën e një viti. Gjatë gjykimit, punëdhënësi, SHISH-i, ka paraqitur si provë të motivit të lirimit shkresën "ekstrakt" nr. 195/4 prot., datë 20.02.2014 të përpiluar nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, në përmbajtje të së cilës gjendeshin përmbledhje të tri materialeve në ngarkim të kërkuesit, duke parashtruar se kopjet e plota nuk mund të paraqiteshin, pasi ishin informacion i klasifikuar.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1487, datë 08.04.2014, ka vendosur mospranimin e padisë, me arsyetimin se ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor të përcaktuar nga neni 54 i ligjit nr. 9357, datë 17.03.2005 "Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit" (*ligji për statusin e SHISH-it*), si dhe jashtë afatit 3-vjeçar të përcaktuar nga neni 203 i Kodit të Punës.

4. Mbi bazën e apelit të kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1916, datë 21.09.2015, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, me arsyetimin se padia për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ mund të ngrihet në çdo kohë.

5. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 79, datë 18.01.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, vetëm për pjesën e dëmshpërblimit, duke urdhëruar punëdhënësin

t'i paguajë kërkuesit shpërblim me 12 paga mujore. Ndaj vendimit kanë paraqitur apel të dyja palët.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2438, datë 07.09.2016, ka vendosur ndryshimin e pjesshëm të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar edhe kërkimin për kundërshtimin e urdhrit të lirimit nga shërbimi të kërkuesit, me arsyetimin se nuk ishte respektuar forma për nxjerrjen e tij.

7. Mbi bazën e rekursit të subjektit të interesuar, SHISH-it, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-3106 (321), datë 16.07.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë. Sipas Gjykatës së Lartë, padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.

8. Në datën 10.02.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 15.04.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesi****,* në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

9.1.1. *E drejta për t'u mbrojtur,* pasi Gjykata e Lartë ka vlerësuar me nismën e saj pasojat e aktit administrativ dhe afatin e parashkrimit sipas Kodit të Punës. Kjo përbënte çështje ligjore që nuk ishte diskutuar në gjykim dhe kërkuesit, në kundërshtim me nenin 473/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), nuk i është dhënë paraprakisht koha për të paraqitur mendimin e tij me shkrim.

9.1.2. *Parimi i sigurisë juridike,* pasi afati i ngritjes së padisë ishte vlerësuar nga gjykata e apelit, e cila kur ktheu çështjen për rigjykim në shkallë të parë, pranoi që padia ishte paraqitur në afat. SHISH-i nuk paraqiti ankim ndaj këtij vendimi, ndaj çështja e afatit përbënte gjë të gjykuar, të cilën Gjykata e Lartë e ka cenuar me vendimin e saj, duke ndryshuar vendimet e gjykatave me të ulëta, me arsyetimin se padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Vendimi i gjykatës së apelit ishte i formës

së prerë dhe ishte ekzekutuar tërësisht, për pasojë kërkuesit sipas vendimit të Gjykatës së Lartë i duhet që pas 10 vjetësh të kthejë shumën e ekzekutuar të dëmshpërblimit, të cilën tashmë duhet t'ia mbajnë nga pensioni, duke i cenuar atij edhe të drejtën e pronës të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

9.1.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka dhënë asnjë argument përse nuk qëndronte pretendimi i kërkuesit për pavlefshmërinë absolute të urdhrit të lirimit. Ajo ka konstatuar pa argumente se ekzistonin shkaqe të pavlefshmërisë relative dhe jo asaj absolute të urdhrit të lirimit. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i gabuar, pasi urdhri i lirimit është absolutisht i pavlefshëm, për shkak se është marrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e parashikuar nga ligji për statusin e SHISH-it. Padia për pavlefshmërinë absolute, në të kundërt me sa arsyeton Gjykata e Lartë, mund të ngrihet në çdo kohë.

9.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit,* i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuesi gjendet në kushte pabarazie me shtetasit e tjerë për të cilët është vendosur mospranimi i rekursit nga Gjykata e Lartë në bazë të udhëzimit për heqjen dorë nga rekurset e depozituara nga administrata shtetërore.

10. ***Subjekti i interesuar, SHISH-i***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

10.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi:

10.1.1. Kërkuesit i është garantuar e *drejta për t'u mbrojtur,* sepse çështja e ligjit të zbatueshëm është debatuar në gjykimin në shkallë të dytë dhe është përfshirë në shkaqet e rekursit, duke i dhënë legjitimitet Gjykatës së Lartë sipas nenit 473/a të KPC-së të shprehet pa njoftim të veçantë për palët.

10.1.2. Gjykata e Lartë ka respektuar *parimin e sigurisë juridike,* pasi gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë vepruar në shkelje procedurale, në interpretim të gabuar të ligjit material dhe në kundërshtim me praktikën e asaj gjykate. Urdhri i drejtorit të SHISH-it për lirimin nga shërbimi është shprehje e njëanshme e vullnetit të punëdhënësit për t'i dhënë fund kontratës së shërbimit publik. Në kushtet kur ligji për statusin e SHISH-it nuk parashikon afate ankimi, gjejnë zbatim

dispozitat e Kodit të Punës. Kërkuesit i ka lindur e drejta për të ngritur padi në kohën kur marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë faktikisht, ndërsa padia është paraqitur në tejkalim të dukshëm të afatit 3-vjeçar të parashikuar në Kodin e Punës, për rrjedhojë e drejta e tij e padisë është parashkruar.

10.1.3. Vendimi përmbush *standardin e arsyetimit,* pasi i përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese.

10.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron. SHISH-i ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, duke mos hequr dorë nga rekursi, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Kryeministrit, i cili nuk përbën ndalim absolut dhe nuk cenon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre ligjore. Gjithashtu, SHISH-i ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit deri në shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, për shkak se kërkuesi ka të ardhura vetëm nga pensioni dhe rregullimi i pasojave në rast të ndryshimit të vendimeve nga Gjykata e Lartë, siç ka ndodhur, do të ishte i vështirë për t'u zbatuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në rastin konkret, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, ku i ka ngritur edhe në substancë pretendimet e tij kushtetuese. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

14. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit organik të Gjykatës, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata është shprehur se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahimi dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.01.2025, § 13*).

15. Në çështjen në shqyrtim, procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin e datës 16.07.2024 të Gjykatës së Lartë, i cili është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 10.09.2024. Kërkuesi ka pretenduar se ndonëse avokatja e tij ka pasur komunikime të mëparshme në rrugë elektronike me Gjykatën e Lartë, asaj nuk i është dërguar vendimi nëpërmjet postës elektronike. Sipas kërkuesit, ai ka marrë dijeni për vendimin e kundërshtuar në datën 05.02.2025, kur Gjykata e Lartë i është përgjigjur me shkrim kërkesës së tij për kopje të vendimit.

16. Gjykata, duke marrë në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së për detyrimin e Gjykatës së Lartë për njoftimin e vendimeve të saj, kohën e gjatë të kaluar nga momenti i paraqitjes së rekursit nga subjekti i interesuar dhe faktin që kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual në datën 10.02.2025, pra menjëherë pasi ka marrë përgjigje me shkrim nga Gjykata e Lartë, arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte (e drejta për t'u mbrojtur, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimi i sigurisë juridike), si dhe cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, të garantuar nga nenet 42 dhe 18 të Kushtetutës.

18. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së *drejtës për t'u mbrojtur,* kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë ka vlerësuar me nismën e saj pasojat e aktit administrativ dhe afatin e parashkrimit sipas Kodit të Punës. Kjo, sipas tij, përbënte çështje ligjore që nuk ishte diskutuar në gjykim, ndaj, në kundërshtim me nenin 473/a të KPC-së, kërkuesit nuk i është dhënë paraprakisht koha për të paraqitur mendimin me shkrim. Subjekti i interesuar, SHISH-i, ka prapësuar se ky pretendim nuk qëndron, sepse çështja e ligjit të zbatueshëm është debatuar në gjykimin në shkallë të dytë dhe është përfshirë në shkaqet e rekursit, duke i dhënë legjitimitet Gjykatës së Lartë sipas nenit 473/a të KPC-së të shprehej pa njoftim të veçantë për palët.

19. Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor, ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore, në kuptim edhe të parimit të barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr. 12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në Gjykatën e Lartë janë vënë në diskutim çështje ligji, për të cilat palët nuk kanë dhënë më parë mendimin e tyre, atëherë palëve duhet t'u jepet mundësia të paraqesin paraprakisht mendimin e tyre për çështjet ligjore të analizuara kryesisht nga ajo gjykatë në mënyrë që t'u garantohet efektivisht e drejta e aksesit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 13 datë 21.03.2023; nr. 7 datë 21.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata konstaton se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ligji i zbatueshëm dhe afati ligjor i parashkrimit të padisë ishin pjesë e debatit gjyqësor në të dyja shkallët e gjykimit. Konkretisht, gjatë gjykimit në shkallë të parë kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se marrëdhënia e punës në rastin e tij rregullohej nga ligji për statusin e SHISH-it, ndaj pasojat duhet të rregulloheshin nga ai ligj dhe jo nga Kodi i Punës. Ndërsa subjekti i interesuar, SHISH-i, ka prapësuar se padia kishte të bënte me marrëdhëniet e punës dhe ishte ngritur jashtë afatit 3-vjeçar të parashikuar nga Kodi i Punës, ndaj nuk duhej pranuar (*shih faqet 5 dhe 7 të vendimit nr. 79, datë 18.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Edhe në gjykimin në shkallë të dytë, kërkuesi ka pretenduar se pasojat e ndërprerjes së marrëdhënies së

punës duhej të rregulloheshin nga ligji për statusin e SHISH-it dhe jo nga Kodi i Punës, ndërsa subjekti i interesuar ka mbajtur të njëjtin qëndrim me atë të parashtruar përpara gjykatës së shkallës së parë, pra se duhej zbatuar Kodi i Punës (*shih faqet 3 dhe 4 të vendimit nr. 2438, datë 07.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit*). Po ashtu, subjekti i interesuar, SHISH-i, në aktin e rekursit ka ngritur sërish pretendimin se padia e kërkuesit ishte paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga Kodi i Punës. Në vijim, Gjykata e Lartë, duke identifikuar Kodin e Punës si ligjin e zbatueshëm për kërkimin për shpërblimin e dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, ka arritur në përfundimin se padia për atë kërkim ishte ngritur jashtë afatit ligjor 3-vjeçar, duke ndryshuar vendimet e gjykatave të faktit dhe duke rrëzuar padinë.

21. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se çështja e afatit 3-vjeçar të ngritjes së padisë, e parashikuar nga Kodi i Punës, është një çështje ligjore për të cilën kërkuesi ka qenë në dijeni dhe ka pasur mundësinë të debatonte e të jepte mendimin e tij. Me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë nuk ka vënë në diskutim me nismën e saj çështje të ligjit, të panjohura për kërkuesin dhe për të cilat atij nuk i ishte dhënë mundësia të dëgjohej dhe mbrohej. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes nga vendimi i Gjykatës së Lartë është haptazi i pabazuar.

22. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë para ligjit*, kërkuesi ka parashtruar se çështja e tij në Gjykatën e Lartë është trajtuar ndryshe nga raste të tjera, në të cilat është vendosur mospranimi i rekursit për shkak të heqjes dorë nga institucionet shtetërore. Subjekti i interesuar, SHISH-i, ka prapësuar se këto pretendime të kërkuesit nuk qëndrojnë, pasi udhëzimi për heqjen dorë nga rekurset nuk përbën ndalim absolut dhe nuk mund të zbatohet kur cenon të drejtën e institucioneve për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ligjore. Gjykata evidenton se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë të dhënë konkrete se cilat janë rastet e ngjashme në të cilat Gjykata e Lartë, megjithëse gjendej përpara rrethanave dhe fakteve të njëjta, ka mbajtur qëndrime të ndryshme. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të barazisë para ligjit nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit për cenimin e së *standardit të arsyetimit të vendimit* dhe *parimit të sigurisë juridike*, Gjykata çmon se këto pretendime bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe, nisur nga natyra dhe thelbi i tyre, do t'i analizojë në themel të lidhura së bashku.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesi ka pretenduar se afati për ngritjen e padisë ishte vlerësuar nga gjykata e apelit në vitin 2016, e cila kur ktheu çështjen për rigjykim në shkallë të parë, ka pranuar se padia ishte paraqitur në afat. Në kushtet kur SHISH-i nuk paraqiti ankim ndaj atij vendimi, çështja e afatit përbënte gjë të gjykuar, të cilën Gjykata e Lartë e cenoi me vendimin e saj, duke ndryshuar vendimet e gjykatave me të ulëta, me arsyetimin se padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Sipas kërkuesit, vendimi i gjykatës së apelit ishte i formës së prerë dhe ishte ekzekutuar tërësisht, për pasojë atij, bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, i duhet të kthejë shumën e ekzekutuar të dëmshpërblimit pas 10 vjetësh. Kjo shumë do t'i mbahet kërkuesit nga pensioni, duke i cenuar atij edhe të drejtën e pronës të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Kërkuesi parashtron se vendimi i Gjykatës së Lartë është i gabuar, pasi urdhri i lirimit është absolutisht i pavlefshëm, në kushtet kur është marrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e parashikuar nga ligji për statusin e SHISH-it dhe, si i tillë, mund të kundërshtohet në çdo kohë, në të kundërt me sa arsyeton Gjykata e Lartë.

25. Subjekti i interesuar, SHISH-i, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk qëndron, pasi urdhri i drejtorit të SHISH-it për lirimin nga shërbimi është shprehje e njëanshme e vullnetit të punëdhënësit për t'i dhënë fund kontratës së shërbimit publik. Ligji për statusin e SHISH-it nuk parashikon afate ankimi, ndaj zbatohet Kodi i Punës. Sipas subjektit të interesuar, kërkuesit i ka lindur e drejta për të ngritur padi në kohën kur marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë faktikisht, për rrjedhojë e drejta e tij e padisë është parashkruar, pasi padia është paraqitur në tejkalim të dukshëm të afatit 3-vjeçar të parashikuar në Kodin e Punës.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar lidhjen që siguria juridike ka me të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt, në të cilën ky parim përgjithësisht shfaqet në formën e gjësë së gjykuar. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 17, datë*

30.03.2021; nr. 50, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë *(shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* Po në këtë drejtim, Gjykata ka pranuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Kjo do të thotë se ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata do të verifikojë në vijim nëse arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, për rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit lidhur me afatin e parashkrimit të së drejtës së padisë, i ka cenuar atij parimin e sigurisë juridike në aspektin e gjësë së gjykuar.

29. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se kërkuesi është liruar nga detyra në vitin 2006, me motivacionin e shkeljes së rregullave nënligjore që normojnë veprimtarinë informative të SHISH-it. Pothuajse 8 vjet më pas, kërkuesi ka kërkuar nga punëdhënësi t'i vinte në dispozicion një kopje të urdhrit të lirimit. Në përgjigje të kërkesës atij i është dërguar një ekstrakt i urdhrit, me argumentin se urdhri për lirimin nga detyra përmbante informacion të klasifikuar sekret shtetëror. Me marrjen e përgjigjes, konkretisht në datën 31.01.2014, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, duke parashtruar dy kërkime: (i) konstatimin e pavlefshmërinë absolute të urdhrit për lirimin nga shërbimi, për shkak të mosrespektimit të procedurës ligjore dhe zgjidhjen e pasojave; (ii) detyrimin e ish-punëdhënësit që ta dëmshpërblente me pagën e 12 muajve.

30. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në datën

08.04.2014 ka vendosur mospranimin e padisë. Sipas asaj gjykate, nga koha e përfundimit të marrëdhënieve të punës, kërkimi për pavlefshmërinë e urdhrit të lirimit duhet të ishte ngritur brenda afatit 30-ditor të përcaktuar nga ligji për statusin e SHISH-it, ndërsa kërkimi për dëmshpërblimin nga marrëdhëniet e punës brenda afatit 3-vjeçar të përcaktuar nga Kodi i Punës. Padia e kërkuesit ishte ngritur pas 8 vjetëve nga përfundimi i marrëdhënieve të punës, ndaj ishte parashkruar dhe nuk mund të pranohej.

31. Mbi bazën e apelit të kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit në datën 21.09.2015 ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Ajo gjykatë ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar në cilësimin e mosmarrëveshjes, pasi urdhri i lirimit ishte akt administrativ. Në kushtet, kur ligji nuk parashikon afat parashkrimi të padisë për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, gjykata e shkallës së parë nuk duhej të kishte dhënë vendim mospranimi për shkak të mosrespektimit të kushtit formal të afatit, por ishte e detyruar të shqyrtonte themelin e mosmarrëveshjes dhe të jepte vendim përfundimtar. Kundër vendimit nuk është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë nga asnjë prej palëve, përfshirë subjektin e interesuar.

32. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në datën 18.01.2016 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, vetëm për pjesën e dëmshpërblimit. Ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se urdhri i lirimit, për shkak të motivimit, përbënte masë disiplinore, e cila nuk provohej se ishte e justifikuar sipas ligjit për statusin e SHISH-it. Për këtë arsye, ajo ka vendosur detyrimin e punëdhënësit, SHISH-it, t'i paguante kërkuesit dëmshpërblim prej 12 pagash mujore për të përballuar kushtet e jetesës gjersa kërkuesi të gjente punë tjetër. Lidhur me urdhrin e lirimit, gjykata e shkallës së parë është shprehur se, pavarësisht formës, ai nuk përbënte akt të mirëfilltë administrativ. Për rrjedhojë, kontrollit gjyqësor i nënshtrohej vetëm ligjshmëria e shkakut të zgjidhjes së marrëdhënies së punës dhe jo pavlefshmëria absolute e aktit të lirimit, pasi kjo e fundit do të passillte rikthimin në detyrë të kërkuesit, që nuk gëzon mbrojtje gjyqësore. Gjykata e shkallës së parë është shprehur edhe për afatin e paraqitjes së padisë, që ishte debatuar ndërmjet palëve. Ajo ka arritur në përfundimin se padia ishte paraqitur brenda afatit 30-ditor të përcaktuar nga ligji për statusin e SHISH-it për dy arsye: (i) çështja e afatit ishte shqyrtuar nga gjykata e apelit, që kishte urdhëruar rigjykimin e çështjes; (ii) afati 30-ditor fillonte në datën 15.01.2014, kur punëdhënësi i kishte komunikuar kërkuesit urdhrin e lirimit.

33. Gjykata Administrative e Apelit në datën 07.09.2016 ka vendosur ndryshimin e pjesshëm të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar edhe kërkimin për kundërshtimin e urdhrit të lirimit nga shërbimi të kërkuesit. Sipas gjykatës së apelit, urdhri i lirimit nuk ishte marrë në formën e kërkuar nga neni 45, shkronja "dh", i ligjit për statusin e SHISH-it, pasi punëdhënësi nuk kishte kryer dy vlerësime të njëpasnjëshme të rezultateve në punë. Lidhur me afatin e paraqitjes së padisë, gjykata e apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim me atë të shkallës së parë, duke u shprehur se padia ishte paraqitur brenda afatit ligjor 30-ditor, i cili kishte filluar nga data e komunikimit të urdhrit, më 15.01.2014.

34. Mbi bazën e rekursit të subjektit të interesuar, SHISH-it, Gjykata e Lartë në datën 16.07.2024 ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë. Sipas Gjykatës së Lartë, urdhri i lirimit nuk rezulton të jetë akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në vështrim të ligjit, pasi gjykata e apelit nuk ka dhënë ndonjë arsye që të mbështesë këtë konkluzion, ndërsa kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument bindës. Pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të urdhrit të lirimit, por ato janë paraqitur pas 8 vjetëve nga lirimi, pra jashtë afatit ligjor 30-ditor, afat i cili duhet të ishte marrë në shqyrtim kryesisht nga gjykata. Po ashtu, sipas Gjykatës së Lartë, edhe kërkimi për shpërblimin e dëmit nga ndërprerja e marrëdhënies së punës është paraqitur jashtë afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 203 i Kodit të Punës, që ka filluar në kohën e përfundimit të marrëdhënies së punës, ndaj e drejta e padisë edhe për këtë kërkim ishte parashkruar.

35. Nga analiza e vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, afati i ngritjes së padisë nuk ishte zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga gjykata e apelit në vitin 2015, vendimi i së cilës nuk u ankimua nga palët. Në të vërtetë, gjykata e apelit është shprehur vetëm për mungesën e afatit të padisë për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, duke marrë në shqyrtim objektin dhe shkakun e padisë. Në rigjykimin në shkallë të parë, gjykata ka arritur në përfundimin se nuk bëhej fjalë për pavlefshmëri absolute, por pavlefshmëri relative, duke arsyetuar se pavlefshmëria absolute sjell si pasojë rikthimin në detyrë të kërkuesit. Sipas gjykatës së shkallës së parë, jo vetëm që kërkuesi nuk e kërkoi rikthimin në detyrë, por kjo e drejtë nuk gëzon mbrojtje ligjore. Në vijim, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se urdhri i lirimit ishte akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, konkluzion i cili nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit nuk ka vënë në diskutim konkluzionin lidhur me afatin

për kundërshtimin e aktit si absolutisht të pavlefshëm, por e ka rrëzuar atë kërkim të padisë me arsyetimin se është i paargumentuar nga kërkuesi. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se pretendimet e kërkuesit kishin të bënin me kontrollin e ligjshmërisë së shkakut të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, pra me pavlefshmërinë relative të urdhrit të lirimit, si dhe me kërkimin për shpërblimin nga zgjidhja e pajustifikuar e marrëdhënies së punës. Parë nga ky këndvështrim, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkimet janë ngritur nga kërkuesi jashtë afateve ligjore, duke i llogaritur afatet nga koha e shkëputjes faktike të marrëdhënieve të punës.

36. Për sa më lart, Gjykata vlerëson *së pari*, se vendimi i gjykatës së apelit që ka kthyer çështjen për rigjykim nuk përbën gjë të gjykuar, pasi nuk ka zgjidhur çështjen e afatit të ngritjes së padisë në mënyrë përfundimtare. *Së dyti*, Gjykata e Lartë e ka argumentuar qëndrimin e saj se përse nuk qëndronte pretendimi i kërkuesit për pavlefshmërinë absolute të urdhrit të lirimit, duke vënë në dukje se argumentet e paraqitura nuk ishin bindëse. Në këtë kuptim, nuk rezulton që arsyetimi i Gjykatës së Lartë të jetë me gabime faktike ose ligjore, të tilla që ta bëjnë atë haptazi të paarsyeshëm nga këndvështrimi kushtetues.

37. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 06.11.2025
Shpallur më 04.12.2025

Vendim nr. 70, datë 06.11.2025
(V-70/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 06.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (B) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **BLEDAR BEDINI *alias* Imami,** përfaqësuar nga avokat Ardian Visha.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: **Shpallja si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatë së Lartë.**
Refuzimi i ekstradimit të shtetasit Bledar Bedini *alias* Imami nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Italisë.
Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka lënë në fuqi vendimin për lejimin e ekstradimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin**

dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Bledar Bedini *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pushimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin penal nr. 2858/2005, datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali, shtetasi shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami është deklaruar fajtor për veprën penale "Trafikimi i lëndëve narkotike", të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal italian dhe nenet 73 e 74 të ligjit italian "Për drogën". Ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane të drejtësisë, mbi bazën e urdhrit për burgosje nr. 57/2009 SIEP, datë 21.09.2009 të Prokurorisë së Përgjithshme të Milanos, Itali, për ekzekutimin e pjesës së mbetur të dënimit prej 7 vjetësh burgim.

2. Fillimisht, në vitin 2015 autoritetet italiane të drejtësisë kanë kërkuar njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit të lartpërmendur penal të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos, Itali ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami. Bazuar në këtë kërkesë, në datën 22.10.2015 ndaj kërkuesit është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg". Paraburgimi i kërkuesit ka vijuar deri në datën 26.10.2016 kur Gjykata e Lartë ka zëvendësuar masën e sigurimit me atë të "Detyrimit për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore", duke urdhëruar lirimin e tij.

3. Në datën 29.12.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur njohjen e vendimit penal të huaj, duke caktuar ndaj kërkuesit një dënim prej 7 vjetësh burgim. Pas gjykimit disa herë të çështjes nga gjykatat më të larta, në rigjykimin e fundit të saj Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 09.07.2019, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar kërkesën e prokurorit për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të huaj për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas

legjislacionit të brendshëm (shqiptar), referuar nenit 54 të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", të ndryshuar *(ligji nr. 10193/2009)*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs prokurori dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 30.09.2019.

4. Ndërkohë, në datën 15.02.2022 oficeri i Policisë Gjyqësore ka kryer përsëri arrestimin e përkohshëm të kërkuesit, tashmë për qëllime ekstradimi në shtetin italian, bazuar në urdhrin e burgosjes nr. SIEP 57/2009, datë 21.09.2009 të Prokurorisë së Përgjithshme të Milanos, Itali. Edhe në këtë rast ndaj kërkuesit është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg".

5. Në vijim, me kërkesën me Ref: EA 126 (2015) AR, datë 07.03.2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë ka kërkuar ekstradimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim të dhënë me vendimin nr. 2858/2005, datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali. Në kërkesë janë parashtruar të dhënat për veprën penale për të cilën është dënuar ky shtetas, cilësimi ligjor i veprës dhe të dhëna rreth vendit dhe kohës së kryerjes së saj (gjatë periudhës 2000-2001). Kërkesa është mbështetur në rregullat e përcaktuara në Konventën Evropiane të Ekstradimit (*KEE*), si dhe në Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e së njëjtës konventë dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, nënshkruar në Tiranë në datën 03.12.2007 *(Marrëveshja e Ekstradimit)*. Sipas kërkesës, sistemi juridik italian parashikon se dënimi me burgim parashkruhet me kalimin e një kohe të barabartë me dyfishin e dënimit të dhënë, por, gjithsesi, jo më të madhe se 30 vjet dhe jo më të vogël se 10 vjet.

6. Kërkesën për ekstradim të autoriteteve italiane të drejtësisë, në datën 17.03.2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ia ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ia ka dërguar atë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, në datën 18.03.2022, ka paraqitur kërkesë për miratimin e lejimit të ekstradimit të kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 375 akti, datë 14.09.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke miratuar lejimin e ekstradimit të kërkuesit në drejtim të Republikës së Italisë. Në thelb, gjykata ka arsyetuar se në kushtet kur Republika e Shqipërisë ka ratifikuar KEE-në, sipas së cilës ekstradimi i një shtetasi lejohet në qoftë se dënimi

nuk është parashkruar sipas ligjit të shtetit kërkues, duke qenë se dënimi i kërkuesit nuk rezulton të jetë parashkruar sipas ligjit italian, ai (ekstradimi) duhet të lejohet. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1242, datë 20.12.2022, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëruar lirimin e kërkuesit nga paraburgimi. Ajo i ka vlerësuar si të bazuara pretendimet e kërkuesit për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit sipas ligjit shqiptar, cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të kërkesave të përsëritura (referuar kërkesës për njohjen e vendimit penal të huaj), si dhe për mosdhënien e garancisë nga shteti italian për rishikimin e vendimit penal të huaj, në kushtet kur gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të kërkuesit. Sipas gjykatës së apelit, dënimi me burgim sipas vendimit penal të huaj, për të cilin kërkohet ekstradimi, është parashkruar dhe, bazuar në parimin e reciprocitetit, shteti shqiptar nuk mund të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet në të njëjtat kushte për veprat penale që ka juridiksion. Për sa kohë Italia e ka ratifikuar me rezervë paragrafin 2 të nenit 10 të KEE-së (ndryshuar me protokollin e katërt shtesë), zbatohet parimi i reciprocitetit dhe ajo nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite të k nga një shtet tjetër kontraktues. Për pasojë, duke mos qenë e zbatueshme norma konventore thirret për zbatim ligji i brendshëm, konkretisht neni 491, shkronja "ë", i Kodit të Procedurës Penale *(KPP),* sipas të cilit parashkrimi i dënimit sipas ligjit të shtetit të kërkuar përbën kusht ndalues për ekstradimin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs prokurori, me pretendimin se gjykata e apelit ka gabuar në zbatimin e ligjit, duke parashtruar edhe nevojën për unifikim të praktikës gjyqësore në kushtet e mungesës së harmonizimit mes parashikimeve të KEE-së (nenit 10, paragrafi 2) dhe dispozitave të KPP-së (nenit 491, shkronja "ë").

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur nisjen e procedurës së gjykimit për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet: (i) nëse zbatohet nga gjykata parimi i reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet, i cili ka vendosur rezervë ligjore mbi normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështjet që janë në juridiksionin e atij shteti; (ii) nëse gjykata duhet të lejojë ekstradimin e shtetasve shqiptarë, në rast se ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit shqiptar, drejt një shteti që për shkak të rezervës mbi normën ndërkombëtare refuzon ekstradimin e shtetasve të tij në rrethana analoge kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të atij shteti, për çështje që janë në

juridiksionin e tij. Gjatë shqyrtimit, me vendimin e datës 26.10.2023, ai kolegj ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes, duke i kërkuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* të kontrollojë pajtueshmërinë me nenin 39, pika 2, të Kushtetutës të shkronjës "ë" të nenit 491 të KPP-së, e cila nuk lejon ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Mbledhja e Gjyqtarëve, pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, me vendimin nr. 46, datë 12.03.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen dhe në përfundim, me vendimin nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin ishte lejuar ekstradimi i kërkuesit në Republikën e Italisë. Ai kolegj ka mbajtur qëndrimin njësues se gjykata lejon ekstradimin e shtetasve shqiptarë edhe kur ndjekja penale dhe dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës, duke zbatuar nenin 10, paragrafi 2, të KEE-së, të ndryshuar me protokollin e katërt shtesë të kësaj konvente, edhe në rastet kur një shtet palë ka vendosur rezervë ndaj kësaj norme ndërkombëtare. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i është njoftuar mbrojtësit të kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 23.10.2024.

10. Ndërkohë, me aktin nr. 2234/2 prot./A.H., datë 14.06.2024, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ekstradimin e kërkuesit për në Republikën e Italisë. Nisur nga fakti se kërkuesi nuk ndodhej i burgosur, është kërkuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Interpolit, marrja e masave për arrestimin e tij, me qëllim dorëzimin tek autoritetet italiane.

11. Në datën 24.12.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lejuar ekstradimi i tij për në Republikën e Italisë, si dhe refuzimin e ekstradimit. Kjo kërkesë, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 31.12.2024. Në vijim, në datën 11.03.2025, kërkuesi ka plotësuar ankimin me pretendime shtesë, duke kërkuar edhe pezullimin e vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata, me pretendimin se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendim i formës së prerë dhe në zbatim të tij autoritetet shqiptare do të vijonin me ekstradimin e tij, ndaj, në këto kushte, gjykimi i pritshëm

kushtetues do të zhvishej nga qëllimi dhe roli i tij dhe nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtat e shkelura atij.

12. Kolegji i Gjykatës në datën 12.03.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 18.03.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për pezullimin e vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pasi për shkak të qëndrimeve të ndryshme, nuk u arrit numri i kërkuar i votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës. Sipas njërit qëndrim, duke qenë se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt kërkimi, ka vendosur përfundimisht lejimin e ekstradimit të kërkuesit në drejtim të Republikës së Italisë dhe ky vendim mund të ekzekutohet përpara përfundimit të gjykimit në Gjykatë, kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë duhet të pranohet[1]. Sipas qëndrimit tjetër, duke qenë se ndaj kërkuesit nuk po zbatohet asnjë masë sigurimi personal dhe nuk ka një datë të përcaktuar për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkesa për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk duhet të pranohet[2].

13. Ndërkohë, në datën 16.06.2025 kërkuesi është arrestuar me qëllim ekstradimin e tij, dorëzimin tek autoritetet italiane, sipas aktit miratues të ekstradimit të ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë. Në vijim, me kërkesën e kërkuesit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 969 akti, datë 26.06.2025, ka vendosur lirimin e tij të menjëhershëm nga paraburgimi, me arsyetimin se Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë në datën 23.06.2025 ka revokuar aktin miratues të ekstradimit për arsye se autoritetet italiane në datën 10.03.2025 kanë revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit, në kushtet kur gjykata italiane në datën 11.09.2024 kishte vendosur shuarjen e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuesit, për shkak të parashkrimit sipas ligjit italian.

14. Në rrethanat si më lart *(shih paragrafin 13 të vendimit),* në çështjen me objekt njohjen e vendimit penal të huaj *(shih paragrafin 3 të vendimit),* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1183, datë

[1] Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi.

[2] Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini.

15.07.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorit, për shkak të heqjes dorë prej tij.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, në kërkesën fillestare dhe atë shtesë, ka parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë për lejimin e ekstradimit cenon:

15.1. *Parimin e mosgjykimit dy herë,* sipas nenit 34 të Kushtetutës *(të parashtruar në ankimin kushtetues të datës 24.12.2024)*, për shkak se gjykatat kanë shqyrtuar dhe gjykuar dy kërkesa (njohjen e vendimit të huaj dhe lejimin e ekstradimit) për të njëjtin fakt, ndaj një shtetasi shqiptar, me të njëjtin shtet kërkues. Gjykata e Lartë për të njëjtin fakt që kishte refuzuar njohjen e vendimit dhe ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë, lejoi ekstradimin në kundërshtim me parimet kushtetuese.

15.2. *Parimin e ligjshmërisë,* për shkak se, pavarësisht parashikimeve të nenit 10, paragrafi 2, të KEE-së, sipas të cilit ekstradimi i shtetasve ndalohet vetëm në rastet kur vepra penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar në bazë të legjislacionit të palës kërkuese (dhe jo më edhe të asaj të kërkuar), në kushtet kur Italia ka vendosur rezervë ndaj parashikimit të këtij neni, në respekt të parimit të reciprocitetit, gjykata në rastin e kërkuesit do të duhej të zbatonte nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së, i cili nuk lejon ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Po ashtu, lejimi i ekstradimit nga Gjykata e Lartë është bërë në kushtet e mungesës së garancisë rishikuese të parashikuar në nenin 491, shkronja "f", të KKP-së, sipas të cilit ekstradimi nuk mund të jepet kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit.

15.3. *Parimin e sovranitetit të shtetit (të parashtruar në ankimin kushtetues shtesë të datës 11.03.2025),* në kushtet kur lejimi i ekstradimit ka zhveshur shtetin shqiptar nga mbrojtja e shtetasve të tij në një situatë kur nuk ka një detyrim për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare referuar zbatimit të nenit 10 të protokollit të katërt shtesë të KEE-së.

15.4. *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve,* për shkak se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë, duke i njohur ministrit të Drejtësisë të drejtën të vlerësojë zbatimin e parimit të reciprocitetit, ka zhveshur gjykatat nga kompetenca për të vlerësuar zbatimin e kritereve dhe kushteve të ekstradimit, në kundërshtim me nenin 39 të Kushtetutës. Po ashtu, ky interpretim i ligjit nga Gjykata e Lartë e ka bërë të paqartë zbatimin e nenit 10 të protokollit të katërt shtesë të KEE-së, në shkelje të *parimit të sigurisë juridike*, duke lënë shteg për interpretime dhe zbatim të ndryshëm të tij, në kundërshtim edhe me *parimin e barazisë para ligjit.*

15.5. *Parimin e hierarkisë së akteve ligjore,* për shkak të vlerësimit të gabuar të zbatimit ose jo të detyrimeve që rrjedhin nga KEE-ja dhe nga parimi i reciprocitetit.

15.6. *Parimin e zbatimit të normës penale favorizuese,* për shkak se në mungesë të një detyrimi për zbatimin e KEE-së nisur nga rezerva e bërë nga shteti italian, neni 419, shkronja "ë", i KPP-së dhe dispozitat penale shqiptare janë normat juridike të zbatueshme dhe më të favorshme në rastin e kërkuesit, duke pasur parasysh se ato nuk lejojnë ekstradimin kur dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar, i cili parashikon afate më të ulëta për parashkrimin në raport me ato sipas legjislacionit italian.

15.7. *Lirinë personale,* për shkak se ajo është kufizuar pa ligj dhe në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, ndërsa për shkak të procesit të ekstradimit është mbajtur në paraburgim për një periudhë tejet të gjatë, deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë.

16. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme****,* në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se pas depozitimit nga kërkuesi të kërkesës në Gjykatë, Republika e Italisë ka revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit, ndërsa në datën 11.03.2025 Ministria e saj e Drejtësisë i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë shkresën Ref: EA 126 (2015) AR, datë 10.03.2025, bashkë me njoftimin për urdhrin N.918/2025 SIGE, datë 11.09.2024 të Gjykatës së Apelit të Milanos, e cila ka vendosur shuarjen e dënimit të dhënë ndaj kërkuesit për shkak të parashkrimit, si dhe heqjen e tij nga kërkimi ndërkombëtar, duke i bërë të ditur se nuk kërkon më ekstradimin e tij drejt Italisë. Për rrjedhojë, objekti i kërkesës së kërkuesit është shuar dhe ajo duhet të pushohet.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi në objektin e ankimit të tij ka kundërshtuar: i) vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor; ii) ekstradimin e tij në Republikën e Italisë. Ndërkohë, në përmbajtjen e ankimit shtesë kërkuesi, po ashtu, ka kundërshtuar edhe paraburgimin e tij për qëllime të ekstradimit në Republikën e Italisë, paraburgim ky që është vendosur në një procedurë tjetër të veçantë gjyqësore përmes vendimmarrjeve përkatëse të gjykatave të zakonshme.

19. Duke verifikuar kriteret e legjitimimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesa të tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të drejtat themelore të tij, çka do të thotë se ai duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në lidhje me kundërshtimin nga kërkuesi të vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, si dhe të ekstradimit të tij në

Republikën e Italisë, Gjykata, fillimisht, çmon të evidentojë se ekstradimi jashtë territorit, në kuptim të nenit 39, pika 2, të Kushtetutës, rregullohet nga KPP-ja, ndërsa rregullat plotësuese janë parashikuar edhe në ligjin nr. 10193/2009. Sipas këtij kuadri ligjor, procesi i ekstradimit për jashtë shtetit ka natyrë të dyfishtë, duke qenë pjesërisht administrativ për sa i përket veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe pjesërisht gjyqësor, pasi ai mund të lejohet vetëm me vendim gjyqësor, ku në rastin e lejimit është ministri i Drejtësisë ai që disponon përfundimisht për ekstradimin ose jo të një shtetasi.

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se autoritetet e drejtësisë italiane kanë paraqitur kërkesë për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, me të cilin ai ishte dënuar me burgim. Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë i ka dhënë rrugë kësaj kërkese dhe pas kërkesës së prokurorit, në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë, me vendimin e kundërshtuar nga kërkuesi, ka vendosur përfundimisht për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë. Në vijim, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, me aktin nr. 2234/2 prot./A.H., datë 14.06.2024, ka miratuar ekstradimin e kërkuesit për në Republikën e Italisë. Megjithatë, ekstradimi i kërkuesit nuk ka ndodhur ndërsa ai ka qenë në gjendje të lirë, ndaj është kërkuar marrja e masave për arrestimin e tij, me qëllim dorëzimin tek autoritetet italiane. Pikërisht në këtë situatë, përmes ankimit kushtetues individual të kërkuesit, çështja i është paraqitur Gjykatës. Ndërsa ajo ndodhej në pritje për t'u shqyrtuar, Gjykata e Apelit e Milanos, Itali, me urdhrin N. 918/2024, datë 11.09.2024, ka vendosur shuarjen e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuesit, për shkak të parashkrimit sipas ligjit italian. Nisur nga kjo, me shkresën Ref: EA 126 (2015) AR, datë 10.03.2025, autoritetet e drejtësisë italiane kanë revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Shqipërisë, duke ua përcjellë atë autoriteteve të drejtësisë shqiptare. Në vijim, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, me aktin nr. 1034/9 prot.A.H, datë 23.06.2025, ka revokuar aktin miratues të ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Italisë, për shkak të revokimit të kërkesës për ekstradim nga autoritetet italiane në kushtet kur me vendim të gjykatës italiane dënimi me burgim i kërkuesit ishte shuar.

22. Në situatën faktike në momentin e shqyrtimit të çështjes, Gjykata vlerëson se, ndonëse në kohën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual dhe referuar fakteve të bëra asaj prezente kërkuesi legjitimohej *ratione personae,* ky përfundim nuk mund të qëndrojë në rrethanat aktuale. Në

vlerësim të Gjykatës, ky kriter legjitimimi plotësohet vetëm në aspektin procedural, por jo edhe në atë substancial. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se qëllimi i ankimit kushtetues individual dhe interesi i kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për lejimin e ekstradimit dhe të procesit të ekstradimit është pikërisht garantimi i së drejtës për të mos u ekstraduar. Në rastin konkret, kërkuesi as nuk është ekstraduar dhe aktualisht as nuk ka ndonjë procedurë ekstradimi aktive. Kërkesa për ekstradimin e kërkuesit është revokuar nga autoritetet e drejtësisë italiane dhe nuk ka asnjë masë efektive për ekstradimin e tij në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim sipas vendimit penal nr. 2858/2005, datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali. Për më tepër, dënimi me burgim, që qëndronte në themel të kërkesës për ekstradimin e kërkuesit, tashmë nuk ekziston më, pasi është shuar me vendim të gjykatës italiane. Në këtë kuptim, situata që shkaktoi shkeljen e pretenduar të së drejtës së kërkuesit për të mos u ekstraduar ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme, duke mos pasur më asnjë rrezik për ekstradimin e tij në Republikën e Italisë me qëllim ekzekutimin e atij dënimi me burgim. Për pasojë, për sa kohë nuk evidentohet që ndonjë aspekt i së drejtës kushtetuese të pretenduar si e shkelur të jetë ende në rrezik, ankimi i kërkuesit ka humbur qëllimin thelbësor, pra mbrojtjen e së drejtës për të mos u ekstraduar dhe, në këtë kuptim, nuk evidentohet pasja nga ai e një interesi substancial. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, si dhe për procesin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë.

23. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e lirisë personale, të ngritura në përmbajtjen e ankimit të tij kushtetues individual shtesë, Gjykata vëren se ndonëse legjitimohet *ratione personae,* ankimi i tij nuk përmbush kriterin e legjitimimit *ratione temporis,* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, i cili ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret kërkuesi ka ngritur pretendime për paraburgimin e zbatuar ndaj tij, me qëllim ekstradimin në Republikën e Italisë, për periudhën deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë (nr. 1242, datë 20.12.2022), e cila vendosi mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëroi lirimin e tij nga paraburgimi, pra për periudhën 15.02.2022-20.12.2022. Në kushtet kur ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 24.12.2024, pas më shumë se 2 vjetësh edhe nga heqja

e kufizimit të lirisë personale, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është ngritur përtej afatit ligjor 4-mujor, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të rrëzohet, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 06.11.2025
Shpallur më 27.01.2026

Vendim nr. 71, datë 12.11.2025
(V-71/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 11.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (N) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **NAUREDA LLAGAMI**

SUBJEKT I INTERESUAR:
MBLEDHJA E POSAÇME E GJYQTARËVE TË GJYKATËS SË LARTË, përfaqësuar nga Miran Kopani, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimi i çështjes për rigjykim në këtë gjykatë me një trup tjetër gjykues; *ose* në mënyrë alternative, nëse Gjykata Kushtetuese vlerëson se ka juridiksion fillestar për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje:**
Shfuqizimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 30.09.2025 për zgjedhjen e z. Asim Vokshi si anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit. Kthimin e çështjes Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për të vendosur shpalljen e zgjedhjes së anëtares së Gjykatës Kushtetuese znj. Naureda Llagami.
Pezullimi i vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr. 80-25-3411,

datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 42, 131, pika 1, shkronjat "e" dhe "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja "e", 50, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, Naureda Llagami (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (*Mbledhja e Posaçme*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 11.12.2024 kryetari i Gjykatës së Lartë, në cilësinë e kryetarit të organit të emërtesës, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për zgjedhjen e anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj. Kërkuesja ka shprehur interesin e saj për të kandiduar për këtë funksion kushtetues.

2. Pas verifikimit të kritereve të kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës, të përcaktuara nga Ligji Organik i Gjykatës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (*KED*), me vendimin nr. 17, datë 17.06.2025, ka vendosur lejimin e kandidimit edhe të kërkueses. Në vijim, KED-ja, pas përfundimit të pikëzimit të kandidatëve, me vendimin nr. 28, datë 17.09.2025, e ka vlerësuar kërkuesen me 89.3 pikë, kurse me vendimin nr. 33, datë

17.09.2025 ka miratuar listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve. Sipas kësaj liste, i pari është renditur kandidati A.V. me 89.5 pikë, e dyta kërkuesja me 89.3 pikë dhe i treti kandidati F.B. me 77.83 pikë. Në datën 23.09.2025 KED-ja, bazuar në parashikimet e nenit 7/ç të Ligjit Organik të Gjykatës, i ka paraqitur organit të emërtesës, Gjykatës së Lartë, raportin dhe listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, si dhe dokumentacionin shoqërues.

3. Në datën 25.09.2025 kryetari i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1, ka vendosur thirrjen e Mbledhjes së Posaçme në datën 30.09.2025 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës.

4. Në datën 30.09.2025 është zhvilluar procesi i votimit të Mbledhjes së Posaçme, në të cilin kanë marrë pjesë 15 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Në përfundim të procesit të votimit, pas numërimit të votave të anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, komisioni i votimit ka konstatuar se kërkuesja ka marrë 8 vota, kandidati A.V. ka marrë 6 vota dhe kandidati tjetër F.B. nuk ka marrë asnjë votë, ndërsa një fletë votimi është shpallur e pavlefshme, për shkak se kishte edhe një shenjë tjetër përveç shenjës në kutinë e caktuar për të shprehur vullnetin për kandidatin. Për rrjedhojë, në kuptim të parashikimeve të pikës 4 të nenit 7/ç të Ligjit Organik të Gjykatës, në situatën që asnjë kandidat nuk ka arritur shumicën e 3/5-ve të votave të gjyqtarëve të pranishëm (9 vota), me vendimin nr. 2, datë 30.09.2025, Mbledhja e Posaçme ka zgjedhur kandidatin A.V., i renditur i pari në listën e KED-së për anëtar të Gjykatës. Ky vendim i është njoftuar Gjykatës dhe Presidentit të Republikës, me qëllim organizimin e ceremonisë së betimit të kandidatit për fillimin e detyrës.

5. Në datën 01.10.2025 kërkuesja, me pretendimin se vota e shpallur e pavlefshme ishte një votë në favorin e saj, ka kërkuar nga Gjykata e Lartë vënien në dispozicion të praktikës dokumentare të Mbledhjes së Posaçme të datës 30.09.2025. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 4785/1, datë 02.10.2025, i ka vënë në dispozicion kërkueses kopje të fletëve të votimit dhe procesverbaleve dhe në datën 13.10.2025 edhe regjistrimin audio të asaj mbledhjeje.

6. Në datën 03.10.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë me objekt "*Marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë dhe pezullimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes*". Më tej, në datën 10.10.2025 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës

së Parë Tiranë edhe kërkesëpadi, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme dhe deklarimin e rezultatit të votimit për kandidaten Naureda Llagami me 9 vota në favor të saj, duke u shpallur fituese për vakancën e krijuar në Gjykatë.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025, ka vendosur: "*Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe për pasojë mospranimin e shqyrtimit të kërkesës për masë sigurimi padie (për mungesë juridiksioni)*.". Sipas asaj gjykate, vendimi i Mbledhjes së Posaçme është akt me natyrë juridiko-kushtetuese dhe jo juridiko-administrative, ndaj nuk mund të kundërshtohet ose të pezullohet në gjykatën administrative.

8. Në datën 14.10.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues, ose në kërkim alternativ, nëse Gjykata vlerëson se ka juridiksion në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje: shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025, të Mbledhjes së Posaçme të Gjykatës së Lartë dhe deklarimin e rezultatit të votimit për kandidaten Naureda Llagami me 9 vota në favor të saj duke e shpallur fituese për vakancën e krijuar në Gjykatë. Po kështu, ajo ka kërkuar nga Gjykata edhe pezullimin e vendimeve nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme dhe nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. Në datën 15.10.2025 subjekti i interesuar, Mbledhja e Posaçme, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarit H.Z., të cilit i kishte mbaruar mandati kushtetues dhe pritej të zëvendësohej nga anëtari i sapozgjedhur nga Gjykata e Lartë. Sipas Mbledhjes së Posaçme, gjyqtari në fjalë ndodhej në kushtet e parashikuara nga neni 36, pika 1, shkronja "ç", i Ligjit Organik të Gjykatës, pasi ai ishte duke qëndruar në detyrë deri në zëvendësimin e tij nga gjyqtari pasues, pra gjendej në konflikt interesi, pasi dukej të kishte interes personal në vijimin e mandatit, për rrjedhojë në vonesën e emërimit të pasardhësit të tij.

10. Në datën 16.10.2025 edhe kërkuesja ka paraqitur në Gjykatë kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarëve I.T. dhe M.S., me arsyetimin se këta gjyqtarë nuk ofrojnë garancitë e nevojshme për paanshmërinë në gjykim, për shkak se në ushtrimin e funksionit të anëtarit të KED-së, në vlerësimin e kandidatëve, konkretisht të kërkueses dhe kandidatit tjetër A.V., ata kanë shprehur preferencë, duke vlerësuar

dhe renditur këtë të fundit me pikë më lart se kërkuesja. Kjo situatë, sipas kërkueses, ka përcaktuar zgjedhjen e kandidatit A.V. si gjyqtar kushtetues, për sa kohë asnjë nga dy kandidatët nuk ka fituar 3/5-at e votave të Mbledhjes së Posaçme.

11. Në datën 16.10.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit në datën 20.10.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve[1], si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

12. Po në datën 20.10.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve mori në shqyrtim edhe kërkesat për përjashtimin e tre gjyqtarëve nga gjykimi. Në lidhje me kërkesën e subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme, me vendimin nr. 24, datë 20.10.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve[2] vendosi pranimin e saj si të bazuar, me arsyetimin se në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të neneve 37, pika 1 dhe 36, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit Organik të Gjykatës dhe të nenit 18, pika 1, shkronja "ç", të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, pjesëmarrja në gjykim e gjyqtarit H.Z., në dukje, mund të krijonte te palët dyshimin e arsyeshëm të njëanshmërisë në kushtet kur vazhdimi i qëndrimit në detyrë të këtij gjyqtari përcaktohej nga finalizimi ose jo i procedurave për emërimin e gjyqtarit pasardhës që ishte edhe çështja objekt gjykimi para Gjykatës[3]. Kurse në lidhje me kërkesën e kërkueses për përjashtimin e gjyqtarëve I.T. dhe M..S., Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet nr. 25 dhe nr. 25/I, datë 20.10.2025, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar, me arsyetimin se: *së pari,* ankimi kushtetues i paraqitur nga kërkuesja lidhej me procedurat e ndjekura nga Mbledhja e Posaçme e Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës dhe jo me procedurat e ndjekura nga KED-ja për

[1] Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan kundër kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

[2] Gjyqtarja Fiona Papajorgji votoi për shqyrtimin e kësaj kërkese përpara shqyrtimit paraprak të themelit të çështjes.

[3] Gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi votuan për rrëzimin e kërkesës për përjashtim, pasi vlerësuan se arsyet e parashtruara nga Mbledhja e Posaçme për përjashtimin e gjyqtarit H.Z. nga shqyrtimi i çështjes nuk përbëjnë shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 36, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës. Kjo sipas qëndrimit të shprehur në *footnote* në vendimin nr. 24, datë 20.10.2025, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.
Gjyqtarët Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi, për më tepër, mbajtën qëndrimin se kryetari i Gjykatës së Lartë nuk legjitimohet formalisht në paraqitjen e kërkesave procedurale për llogari të Mbledhjes së Posaçme pa autorizimin e shprehur të kësaj të fundit. Kjo sipas qëndrimit të shprehur në *footnote* në vendimin nr. 24, datë 20.10.2025, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve; *së dyti*, ndonëse gjyqtarët për të cilët kërkohej përjashtimi, në cilësinë e tyre si anëtarë të KED-së, kishin kryer vlerësimin dhe pikëzimin e të dy kandidatëve, Mbledhja e Gjyqtarëve vërejti se pikëzimi i anëtarëve për gjyqtar të Gjykatës bëhet sipas rregullave dhe procedurave të mirëpërcaktuara në rregulloren përkatëse të KED-së dhe se anëtarët e saj, në çdo rast, kanë detyrimin të justifikojnë pikëzimin e kandidatëve[4]. Po në këtë datë, Mbledhja e Gjyqtarëve mori në shqyrtim edhe kërkesën e kërkueses për pezullimin e vendimeve të Mbledhjes së Posaçme dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të cilën vendosi rrëzimin e saj, me arsyetimin se nuk u provua ardhja e pasojave të drejtpërdrejta, të pakthyeshme ose të pariparueshme në të drejtat apo interesat e kërkueses[5].

13. Pas njoftimit të palëve nga Gjykata për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare dhe të drejtën për të paraqitur parashtrime me shkrim, në datën 03.11.2025 kërkuesja ka paraqitur kërkesë për shtimin/ndryshimin e objektit të kërkesës së saj kushtetuese. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi mori në shqyrtim kërkesën, me vendimin e datës 06.11.2025, njëzëri, vendosi: "*Pranimin e kërkesës së kërkueses Naureda Llagami. Saktësimin e objektit të kërkesës nr. 8 (N) Regjistri Themeltar, datë 14.10.2025, si vijon: "Shfuqizimin e vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë me një trup tjetër gjykues; ose në mënyrë alternative, nëse Gjykata Kushtetuese vlerëson se ka juridiksion fillestar për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje: Shfuqizimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 30.09.2025 për zgjedhjen e z. Asim Vokshi si anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit. Kthimin e çështjes Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për të vendosur shpalljen e zgjedhjes së anëtares së Gjykatës Kushtetuese znj. Naureda Llagami. Shtimi i bazës ligjore të kërkesës nr. 8 (N) Regjistri Themeltar, datë 14.10.2025 edhe me nenin 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës.*".

[4] Gjyqtarët Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi votuan për pranimin e kërkesës së kërkueses për përjashtimin e gjyqtarëve nga shqyrtimi i çështjes, duke i vlerësuar pretendimet e saj brenda shkaqeve të parashikuara nga neni 36, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës. Kjo sipas qëndrimit të shprehur në *footnote* në vendimet nr. 25 dhe 25/I, datë 20.10.2025, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

[5] Gjyqtarët Sandër Beci, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi votuan për pranimin e kërkesës, pasi sipas tyre u provua ardhja e pasojave të drejtpërdrejta në të drejtat ose interesat e kërkueses, të tilla që janë të pakthyeshme apo të pariparueshme.

14. Po ashtu, kërkuesja në datën 10.11.2025 ka paraqitur në Gjykatë edhe aktin "Kërkesë", me objekt "Kontrolli kushtetues mbi verifikimin e rrethanave që ndalojnë zgjedhjen e z. A.V. gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese", për të cilën Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 11.11.2025, vendosi pushimin e shqyrtimit të saj për shkak të nevojës për plotësim sipas kërkesave të ligjit dhe vijimin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual të kërkueses sipas objektit të saktësuar nga ajo dhe të pranuar me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve të datës 06.11.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesja*** ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të vendimit gjyqësor objekt kërkese. Në mënyrë të përmbledhur ajo ka pretenduar:

i) Për juridiksionin e Gjykatës:

15.1. Bazuar në vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës (*vendimi nr. 36/2021*), përmbajtja e shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit, ashtu edhe ato procedurale për verifikimin e zgjedhjes së funksionarëve publikë. Bazuar në këtë vendim Gjykata ka pranuar juridiksionin në këto çështje. Në rastin konkret, objekt i ankimit kushtetues është procedura e ndjekur për zgjedhjen e funksionarit publik, gjyqtarit të ri të zgjedhur nga Mbledhja e Posaçme dhe thelbi ka të bëjë vetëm me vlerësimin dhe numërimin e një vote, e cila është shpallur e pavlefshme. Kërkuesja nuk kundërshton vlerësimin e vullnetit të anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, por konstatimin e shkeljeve procedurale të kryera nga komisioni i votimit gjatë leximit dhe vlerësimit të votës së vetme të shpallur të pavlefshme.

15.2. Bazuar në parimin e shtetit të së drejtës, çdo akt i organeve të pushtetit publik, i nxjerrë jashtë diskrecionit të dhënë nga Kushtetuta ose ligji, i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Në këtë aspekt, edhe pse nuk është rasti konkret, do t'i nënshtrohej kontrollit kushtetues edhe vullneti i anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, nëse ky vullnet do të ishte shprehur jashtë ose në tejkalim të diskrecionit të dhënë nga Kushtetuta për të emëruar njërin prej

kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga KED-ja. Çështja e verifikimit të zgjedhjes së funksionarëve të organeve të sistemit të drejtësisë, të parashikuara në Kushtetutë, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, përbën një çështje të juridiksionit fillestar të Gjykatës. Kjo dallon nga rastet e tjera të parashikuara nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës.

15.3. Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës, e miratuar me vendimin nr. 1, datë 24.02.2022 (*Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme*), në ndryshim nga ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar (*ligji nr. 115/2016*), që parashikon të drejtën e ankimit kundër vendimit të Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, edhe në aspektin e konstatimit të shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit, në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk parashikon të drejtën e ankimit për këtë aspekt në ndonjë organ tjetër të pushtetit publik ose gjyqësor. Ndaj çështja e legjitimimit të kërkueses duhet të shqyrtohet bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës.

ii) Për legjitimimin e kërkueses:

15.4. Referuar vendimit nr. 36/2021 të Gjykatës kërkuesja legjitimohet, pasi ka identifikuar funksionarin publik, shkeljen kushtetuese që pretendohet se është cenuar gjatë procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës, si dhe aktin që ka materializuar këtë shkelje. Po ashtu, nga procesi i votimit kërkuesja ka pësuar një cenim personal dhe të drejtpërdrejtë nga akti që kundërshton, pasi është shkelur procesi i zgjedhjes së saj, si dhe e drejta për t'u zgjedhur anëtare e Gjykatës.

iii) Për themelin e pretendimeve:

15.5. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë *cenon të drejtën e aksesit në gjykatë*, pasi i ka mohuar kërkueses të drejtën për të kundërshtuar në gjykatë procedurën administrative të kryer për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës, mbi të cilën është mbështetur vendimi i Mbledhjes së Posaçme, procedurë në të cilën ajo është subjekt i prekur drejtpërdrejt dhe që ka sjellë pasoja ndaj saj, si dhe për të marrë një përgjigje për pretendimet e saj për procesin. Nuk ka asnjë përcaktim ligjor që të ndalojë ankimimin gjyqësor ndaj vendimit të Mbledhjes së Posaçme, vendim i cili, në

fakt, është administrativ dhe për të cilin kërkuesja gëzon të drejtën e ankimit në rrugë gjyqësore, duke ia nënshtruar atë juridiksionit administrativ për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e saj. Përjashtimi i kërkueses si një kandidat fitues për vendin e anëtarit të Gjykatës në mungesë të një shqyrtimi gjyqësor të pretendimeve të saj për procesin përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së dhe shtetit të së drejtës.

15.6. Edhe në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, nuk ka asnjë dispozitë ligjore e cila të ndalojë paraqitjen e ankimit në Gjykatë të kërkueses, që është një e drejtë kushtetuese, për kundërshtimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme. Legjislacioni në fuqi nuk ka përcaktuar as ndonjë ankim të posaçëm në ndonjë shkallë të pushtetit gjyqësor për vendimin e Mbledhjes së Posaçme. Me interpretimin që i ka bërë ligjit gjykata e shkallës së parë, ka kufizuar të drejtën e kërkueses për t`u ankuar ndaj vendimit të Mbledhjes së Posaçme.

15.7. Vota e shpallur e pavlefshme nga komisioni nuk përfshihet në rastet e nenit 13 të Rregullores së Mbledhjes së Posaçme, për rrjedhojë është e vlefshme për sa kohë që fleta e votimit e ka të qartë zgjedhjen e bërë nga gjyqtari. Në këtë rast nuk qëndron argumenti i cenimit të fshehtësisë së votës, pasi edhe në rast se votohet me shenjën "+", ajo mund të konfigurohet në mënyrë të tillë që një detaj i vogël të zbulojë fshehtësinë e votimit. Nëse do të bëjmë paralelizëm me proceset e votimit për zgjedhjet parlamentare dhe vendore, në nenin 116 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se zgjedhësi, pasi merr fletën e votimit, shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor shenjën "x" ose "+" ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e tij. Referuar akteve rregullatore të procesit zgjedhor që miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (manualet përkatëse për numërimin e votave nga komisionet), rezulton se ky i fundit rastin kur në fletën e votimit gjenden shenjat identike si në rastin e kërkueses e ka konsideruar si rast vote të vlefshme.

15.8. Është cenuar thelbi i kriterit procedural dhe universal të leximit dhe vlerësimit të votës (së vlefshme), që lidhet me qartësinë e shprehjes së vullnetit të votuesit. Në rastin konkret komisioni është bazuar vetëm në aspektin formal, duke anashkaluar qëllimin

dhe efektin që synohet të arrihet përmes parashikimit formal, duke konsideruar gjatë leximit dhe vlerësimit të votës një shenjë të bërë nga vetë votuesi, vullneti i të cilit është shprehur në formën e duhur.

15.9. Pretendimi i subjektit të interesuar se nuk duhet të zbatohen rregullat e Kodit të Zgjedhor, por parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës dhe Rregullores së Mbledhjes së Posaçme nuk është i bazuar, pasi në këtë rast ndodhemi përpara faktit të konfliktit të normave me fuqi të ndryshme juridike, ku norma me fuqi më të lartë ka epërsi ndaj asaj me fuqi më të ulët. Normat për leximin dhe vlerësimin e votës së anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, të thirrur për të zgjedhur gjyqtarin kushtetues, nuk burojnë nga Ligji Organik i Gjykatës, por nga Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme, e cila nuk ka vlerë të njëjtë juridike me Kodin Zgjedhor, që sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës është ligji i miratuar me tre të pestat.

15.10. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, edhe në votimin që realizohet në organet e sistemit të drejtësisë sipas ligjit nr. 115/2016, qartësia e vullnetit të shprehur të votuesit nuk është vetëm për votimin sipas Kodit Zgjedhor, por edhe për votimin e organeve kushtetuese të sistemit të drejtësisë (nenet 17 dhe 44 të ligjit nr. 115/2016). Qartësia e votimit në fletën e votimit është kriteri bazë dhe themeltar i vlerësimit të fletës së votimit dhe përcaktimit të vlefshmërisë së saj. Pakujdesi në votim, përfshirë edhe në trupën e Gjykatës së Lartë, mund të ndodhin. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, nuk mund të vlerësohet aspekti formal i shkëputur nga qëllimi dhe efekti që synohet të arrihet nëpërmjet tij, sepse kjo do të çonte në humbjen e vet kriterit të vlerësimit të standardit dhe parimit që synohet të mbrohet. Vlerësimi i çdo aspekti formal duhet të bëhet në lidhje të drejtpërdrejtë me qëllimin dhe efektin që kërkohet të arrihet përmes parashikimit të tij. Në rastin konkret vullneti është shprehur në mënyrë të qartë, por edhe në formën e duhur dhe të kërkuar, nëpërmjet vendosjes në pozicionin e saktë të shenjës përkatëse të parashikuar për të shprehur vullnetin. Në këtë kuptim, në këtë rast është keqzbatuar efekti i shenjës së bërë nga votuesi, i cili e ka shprehur vullnetin e tij në formën e kërkuar dhe qartësisht vetëm për një kandidat.

16. ***Subjekti i interesuar, Mbledhja e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

i) Për juridiksionin e Gjykatës:

16.1. Vendimi i Mbledhjes së Posaçme nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit kushtetues, pasi është një akt kushtetues me natyrë institucionale, dhe jo një akt i thjeshtë administrativ, ndaj të cilit mund të bëhet ankim gjyqësor nga individët që marrin pjesë në garën për t'u zgjedhur anëtar të Gjykatës. Vendimi nuk mund të kundërshtohet në asnjë gjykatë, pasi shpreh një vullnet institucional me natyrë kushtetuese për të bërë funksional një organ kushtetues dhe nuk ka për qëllim të krijojë pasoja me natyrë individuale ose kolektive, sikundër akti administrativ. Procedura e zgjedhjes së gjyqtarit nga Gjykata e Lartë nuk mund të jetë objekt i kontrollit gjyqësor as nga gjykata administrative, as nga vetë kjo Gjykatë.

16.2. Nëse Gjykata do të pranonte kërkimin e kërkueses për ta shpallur atë fituese për vendin vakant për të cilin ka kandiduar, do të tejkalonte kompetencat e saj kushtetuese e ligjore, duke qenë se ajo nuk ka asnjë kompetencë në zgjedhjen e anëtarit të saj. Referuar nenit 125 të Kushtetutës për emërimin/zgjedhjen e anëtarit të saj, vendimi i Gjykatës nuk mund të zëvendësojë apo t'i vendoset tre akteve të vullnetit të organeve të emërtesës. Nuk ekziston një mjet gjyqësor për të kontestuar emërimin ose zgjedhjen e gjyqtarit kushtetues, pasi është vendim i politikëbërësit i mbështetur në vullnetin e organit kushtetues, të cilit i është lënë kompetenca për të zgjedhur/emëruar anëtarin e Gjykatës.

16.3. I vetmi rast ku Gjykata mund të kishte juridiksion për të shqyrtuar procesin e zgjedhjes së gjyqtarit të saj është rasti kur vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit (neni 127, pika 1, shkronja "d", i Kushtetutës dhe neni 9, pika 1, shkronja "d", i Ligjit Organik të Gjykatës). Për sa kohë ky pretendim nuk është ngritur nga kërkuesja, Gjykata nuk mund të shprehet kryesisht për të. Gjithsesi, edhe sikur të ishte kërkuar prej kërkueses, sërish ajo nuk do të legjitimohej, pasi nuk ka interes të ligjshëm. Pretendimi për pazgjidhshmërinë e gjyqtarit duhet të plotësojë kushtin që gjyqtari të ketë filluar ushtrimin e detyrës, pra të jetë zgjedhur/emëruar dhe të ketë bërë betimin te Presidenti i Republikës.

ii) Për legjitimimin e kërkueses:

16.4. Kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae,* pasi nuk ka arritur të argumentojë se cila është e drejta që i është cenuar dhe sesi preket ajo personalisht nga vendimi i Mbledhjes së Posaçme. Ajo ka konkurruar për t'u zgjedhur anëtare e Gjykatës, por nuk ka një të drejtë subjektive që të zgjidhet, por vetëm pritshmëri për t'u zgjedhur. Kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë interesin e ligjshëm që i është cenuar përmes mohimit të aksesit, që është një e drejtë procedurale që duhet patjetër të lidhet me një të drejtë materiale që të mbrohet në gjykatë. Kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë as cenimin ose dëmin e shkaktuar nga vendimi i Mbledhjes së Posaçme, i cili nuk synon dhe nuk sjell pasoja për të, por për organin kushtetues që formësohet nga vullneti i atij organi.

16.5. Kërkuesja *nuk ka shteruar mjetet juridike efektive* në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës. Ajo kundërshton një vendim të gjykatës së shkallës së parë, e cila e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, pa iu drejtuar më parë me ankim të veçantë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, siç është disponuar në dispozitivin e vendimit objekt kundërshtimi dhe siç është parashikuar në nenin 9 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), si dhe nenin 59 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Argumenti i kërkueses bazohet vetëm në supozime dhe jo në ndonjë fakt juridik ose jurisprudencë të provuar.

iii) Për themelin e pretendimeve:

16.6. Pretendimi se në rastin e saj duhet të gjejnë zbatim rregullat e Kodit Zgjedhor është i pabazuar, pasi ato gjejnë zbatim vetëm në rast se nuk ka një ligj të posaçëm që parashikon rregulla të tjera që përjashtojnë ose zëvendësojnë dispozitat e tij. Në rastin e kërkueses, procesi i votimit nga Mbledhja e Posaçme është bazuar në Ligjin Organik të Gjykatës dhe Rregulloren e Mbledhjes së Posaçme, e miratuar në bazë të këtij ligji, ndaj nuk mund të zbatohen dispozitat e Kodit Zgjedhor.

16.7. Votimet politike ndryshojnë nga votimet institucionale që zhvillohen brenda organeve kushtetuese ose ligjore, pasi dy proceset kanë funksione, trupa gjykuese dhe qëllime të ndryshme,

dhe legjislatori ka vendosur standarde të veçanta për secilin rast. Në proceset zgjedhore politike parimi themelor është qartësia e vullnetit të zgjedhësit. Në këtë rast fshehtësia e votës mbron qytetarin nga ndikimi dhe presioni, por nuk e bën të pavlefshme një votë kur qëllimi është i qartë, edhe nëse shënimi nuk ndjek formën e saktë të përcaktuar. Ky standard përligjet nga vetë karakteri masiv dhe heterogjen i trupës votuese, e cila përfshin shtetas të niveleve të ndryshme arsimore dhe profesionale. Në votimet politike legjitimiteti buron nga vullneti i sovranit. Qëllimi është të garantohet që çdo zgjedhës, pavarësisht nivelit arsimor, të mund të shprehë lirisht zgjedhjen e tij. Në këtë proces qartësia e votës prevalon mbi formalizmin. Ndërsa në votimet institucionale legjitimiteti buron nga rregullsia procedurale, fshehtësia dhe paanshmëria. Të gjitha normat ligjore që rregullojnë këtë proces votimi janë të parashikuara nga ligji nr. 115/2016 (nenet 17, 45, 115, 143 etj.), ku janë vendosur rregulla të njëjta për pavlefshmërinë e votës, të cilat parashikojnë se çdo shenjë ose shkrim shtesë në fletën e votimit e bën atë të pavlefshme *ipso iure* dhe se në fletën e votimit nuk lejohet të bëhen shënime në favor ose disfavor të kandidatëve. Ky standard synon të sigurojë që vullneti i votuesit të shprehet në mënyrë të qartë, të pastër dhe të paidentifikueshme, duke përjashtuar çdo mundësi që përmes shenjave ose shkrimeve shtesë të cenohet fshehtësia e votës, të krijohen dyshime për autenticitetin e saj ose të lehtësohet identifikimi i votuesit. Përmes këtij rregulli ligjvënësi garanton integritetin e procesit të votimit, barazinë ndërmjet kandidatëve dhe besueshmërinë e vendimmarrjes së organeve të qeverisjes së drejtësisë. Në proceset e votimit që zhvillohen brenda institucioneve të drejtësisë, parimi themelor është fshehtësia dhe integriteti formal i votës. Këto votime nuk kanë karakter politik ose përfaqësues, por përbëjnë akte juridike të brendshme, të cilat prodhojnë pasoja direkte për strukturën dhe funksionimin e organeve kushtetuese. Trupa votuese në këto procese është e kufizuar numerikisht, e përbërë nga persona me kualifikim të lartë juridik, të cilët njohin rregullat procedurale dhe formale të fshehtësisë së votës, njohin dhe kuptojnë plotësisht formën e fletës së votimit dhe efektet e çdo devijimi prej saj.

16.8. Fleta e votimit është e pavlefshme, pasi nuk respekton përcaktimet e

neneve 12, pika 6 dhe 13, shkronja "b", të Rregullores së Mbledhjes së Posaçme, të cilat synojnë fshehtësinë dhe uniformitetin e votës. Ndalimi i shënimeve shtesë të parashikuara në këto dispozita është vendosur për të shmangur çdo lloj identifikimi të votës. Parashikimet e këtyre dispozitave janë rregulla të ndalimit absolut. Për të shpallur votën të pavlefshme nuk mjafton vetëm nëse vullneti është shprehur qartë apo jo. Votimi nuk është vetëm një akt i shprehjes së vullnetit, por dhe akt që duhet të mbetet i fshehtë. Edhe pse vullneti i votuesit mund të lexohet qartësisht në favor të një kandidati, vota mbetet e pavlefshme, sepse shkel parimin e fshehtësisë dhe të uniformitetit të procesit. Në procesin e votimit për anëtar të Gjykatës, qartësia e vullnetit nuk mjafton, por ajo duhet të shprehet në formën e qartë juridike, përndryshe cenon integritetin e procesit. Për më tepër që në rastin konkret votues janë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që e njohin mjaft mirë ligjin.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

17. Gjykata, referuar objektit të kërkesës në shqyrtim, vëren se kërkuesja ka ngritur dy kërkime: *i pari,* lidhet me konstatimin si antikushtetues të vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka disponuar për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor dhe për pasojë mospranimin e shqyrtimit të kërkesës së saj për sigurimin e kërkesëpadisë, si dhe pezullimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme; *i dyti,* ka të bëjë me zgjedhshmërinë/procesin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme, të zhvilluar në datën 30.09.2025, për rrjedhojë konstatimin antikushtetues të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme dhe shfuqizimin e vendimit të saj, si dhe kthimin e çështjes Mbledhjes së Posaçme për të vendosur shpalljen e zgjedhjes së kërkueses si anëtare të Gjykatës. Gjykata, bazuar në objektin e kërkesës, por edhe në thelbin e pretendimeve, vlerëson se kërkimi i parë për kushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor që ka disponuar për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, *prima facie* duket se përfshihet në fushën e veprimit të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, kurse kërkimi i dytë, ai për kushtetutshmërinë

e zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme, të zhvilluar në datën 30.09.2025, përfshihet në shkronjën "e" të po kësaj dispozite.

18. Për sa i takon referimit të kërkueses në shkronjën "f" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se, në kuptim të kësaj dispozite, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund ta vërë atë në lëvizje për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Gjykata vëren se në rastin konkret kërkuesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor, ku ka qenë palë në cilësinë e paditëses, në kuadër të të cilit është nxjerrë vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë dhe nga i cili është bartëse e të drejtave kushtetuese që lidhen me atë proces. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se ky vendim gjyqësor mund të kundërshtohet në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ndaj kjo dispozitë mund të shërbejë si bazë kushtetuese për kërkimet e parashtruara nga kërkuesja.

19. Kërkuesja ka kundërshtuar në objektin e kërkesës si procesin gjyqësor në gjykatën administrative të shkallës së parë, ashtu edhe vetë procedurën e votimit të zhvilluar nga Mbledhja e Posaçme dhe rezultatin e atij procesi, duke kërkuar edhe deklarimin e votës së dhënë në favorin e saj të vlefshme. Sipas kërkueses, bazuar në vendimin nr. 36/2021 të Gjykatës, përmbajtja e shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit dhe ato procedurale për verifikimin e zgjedhjes së funksionarëve publikë. Po ashtu, kërkuesja ka parashtruar se vetë Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, me vendimin nr. 36/2021 të saj ka pranuar juridiksionin e plotë për të vendosur për këtë çështje.

20. Sipas subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme, vendimi i saj nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit kushtetues, pasi është një akt kushtetues me natyrë institucionale dhe jo një akt i thjeshtë administrativ, ndaj të cilit mund të bëhet ankim gjyqësor nga individët që marrin pjesë në garën për t'u zgjedhur anëtar i Gjykatës. Sipas këtij subjekti, vendimi i Mbledhjes së Posaçme nuk mund të kundërshtohet në asnjë gjykatë, pasi shpreh një vullnet institucional me natyrë kushtetuese për të bërë funksional një organ kushtetues dhe nuk ka për qëllim të krijojë pasoja me natyrë individuale ose kolektive, sikundër akti administrativ dhe procedura e zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës nga Gjykata e Lartë nuk mund të jetë objekt i kontrollit

gjyqësor as nga gjykata administrative, as nga vetë Gjykata. Nëse Gjykata do të pranonte kërkimin e kërkueses për ta shpallur atë fituese për vendin vakant pranë saj, do të tejkalonte kompetencat e saj kushtetuese e ligjore, duke qenë se ajo, sipas Kushtetutës dhe ligjit, nuk ka asnjë kompetencë në zgjedhjen e anëtarit të saj. Po sipas këtij subjekti, Gjykata nuk mund të zëvendësojë ose t'i vendoset tre akteve të vullnetit të organeve të emërtesës, kur vjen çështja tek emërimi/zgjedhja e anëtarëve të saj.

21. Përkundrejt pretendimeve dhe prapësimeve të palëve si më sipër, lidhur me kërkimin e kërkueses në këndvështrim të nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre, ajo çmon të ndalet në vlerësimin e juridiksionit të saj në këtë drejtim.

22. Gjykata vëren se neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës parashikon se ajo vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre. Përmbajtja e shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit dhe ato procedurale për verifikimin e zgjedhjes së këtyre funksionarëve publikë (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me institutet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë, Gjykata ka theksuar se pazgjedhshmëria synon të ndalojë një kandidat të caktuar që të mund të emërohet në një funksion publik ose të fitojë një mandat nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në zgjedhje, kurse papajtueshmëria ka të bëjë me ndërprerjen e funksionit ose mandatit në rast se verifikohen shkaqe që nuk lejojnë ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të tij. Në çdo rast, si shkak pazgjedhshmërie ose papajtueshmërie shërbejnë fakte, rrethana ose sjellje që ndalojnë emërimin ose zgjedhjen, ose bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit publik, të cilat mund të jenë të parashikuara nga norma kushtetuese ose në ligje të veçanta. Instituti i papajtueshmërisë mbron ushtrimin e mandatit ose funksionit dhe synon parandalimin e mbivendosjes së kompetencave të ndara tek i njëjti person ose organ, në këtë mënyrë moscenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si element i shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së lartpërmendur, ka vlerësuar se kontrolli kushtetues për këto çështje ka natyrë individuale, pasi bazohet në vlerësimin e shkeljes konkrete për ato ndalime kushtetuese ose ligjore që përbëjnë shkak për konstatimin e papajtueshmërisë ose pazgjedhshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Në çështjet e përfshira në rregullimin e shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131, jo vetëm që bëhet fjalë për individin që merr funksion zyrtar, por qëllimi i saj është mbrojtja e interesit publik që në organe të parashikuara nga Kushtetuta funksionarët të zgjidhen sipas procedurave kushtetuese përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e zgjedhshmërisë dhe pajtueshmërisë me funksionin (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Me qëllim ushtrimin e kësaj kompetence nga Gjykata, kërkesa për verifikimin e zgjedhjes duhet të identifikojë funksionarin publik, shkeljen kushtetuese që pretendohet se është kryer gjatë procesit të zgjedhjes së tij, si dhe aktin konkret që materializon shkeljen kushtetuese. Për pasojë, procedura e verifikimit të zgjedhjes së funksionarëve të organeve të parashikuara nga Kushtetuta duhet parë e lidhur me këto koncepte dhe jo e lidhur me vlerësimin, qoftë edhe në aspektin e kushtetutshmërisë të procesit zgjedhor në tërësinë e tij (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Togfjalëshi "verifikimin e zgjedhjes së tyre" në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës duhet të interpretohet në kuptimin që ai ka të bëjë me verifikimin e respektimit të së drejtës individuale për t`u zgjedhur të funksionarit të organit kushtetues gjatë procesit zgjedhor (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesja ka identifikuar funksionarin publik të zgjedhur, që është anëtari i ri i Gjykatës i zgjedhur me vendimin nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme, si dhe ka ngritur pretendime për kontrollin kushtetues të aspekteve procedurale të zgjedhjes së këtij funksionari publik. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuesja ka pretenduar se në rastin konkret janë të pranishme ato rrethana që nuk lejonin zgjedhjen e anëtarit të ri të Gjykatës, për sa kohë që nuk ishte rasti sipas nenit 7/ç, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës që ai të konsiderohej i zgjedhur për shkak të ligjit, si kandidati i renditur i pari, për sa kohë që votat e marra nga kërkuesja përbënin kuorumin e nevojshëm ligjor sipas së njëjtës dispozitë (9 vota). Për rrjedhojë, në rastin konkret kërkuesja ka kërkuar nga Gjykata të ndalet në "verifikimin e zgjedhjes" së funksionarit në drejtim të shkeljes konkrete që ka të bëjë me (mos) ekzistencën e ndalimeve ligjore që do të përbënin shkak për konstatimin

e pazgjedhshmërisë së funksionarit publik, duke kundërshtuar edhe aktin konkret që materializon shkeljen kushtetuese të pretenduar, që është vendimi i Mbledhjes së Posaçme. Gjykata mban në konsideratë gjithashtu se në rastin e kërkueses (pa)rregullshmëria e procesit nuk i është nënshtruar asnjë kontrolli, për sa kohë që komisioni i votimit është organi i vetëm që ka bërë një interpretim si të rregullave të zbatueshme ashtu edhe të vullnetit të zgjedhësit, në mungesë të një vlerësimi tjetër të anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme (gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë) lidhur me interpretimin e këtyre rregullave dhe procedurës në tërësinë e saj.

25. Për rrjedhojë, kërkimi për konstatimin antikushtetues të procesit zgjedhor të zhvilluar në datën 30.09.2025 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme dhe shfuqizimin e vendimit të kësaj të fundit, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës.

26. Për sa më sipër, duke qenë se Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet e ngritura nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, të cilat në thelb lidhen me procesin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, vlerëson të mos marrë në analizë veçmas pretendimet e kërkueses për antikushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, por t'i shohë ato të lidhura me analizën e saj për legjitimimin e kërkueses për kërkimin për shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme dhe të vendimit të komisionit të votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit.

B. Për legjitimimin e kërkueses

27. Për kërkimin sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, kërkuesja ka pretenduar se nga procesi i votimit ajo ka pësuar një cenim personal dhe të drejtpërdrejtë nga akti që kundërshton, pasi i është shkelur procesi i zgjedhjes së saj, si dhe e drejta për t'u zgjedhur anëtare e Gjykatës.

28. Sipas subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme, lidhur me kërkimin sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae* për të vënë në lëvizje Gjykatën, pasi nuk ka arritur të argumentojë se cila është e drejta që i është cenuar dhe si preket personalisht nga vendimi nr. 2, datë 30.09.2025.

29. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore

që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

30. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të parë të legjitimimit *ratione personae,* Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

31. Kështu, sipas njërit qëndrim, nga analiza e parashikimeve kushtetuese dhe Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuesja, në cilësinë e individit, nuk legjitimohet *ratione personae* t'i drejtohet Gjykatës për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e funksionarit të organeve të parashikuara në Kushtetutë sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës. Kërkuesja si individ mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për çdo akt të pushtetit publik, siç janë edhe vendimet që ajo kundërshton, me ankim kushtetues individual sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Mirëpo kjo dispozitë për legjitimimin e individit kërkon që akti i pushtetit publik t'i ketë cenuar atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta. Në këtë pikëpamje, sipas këtij qëndrimi, e drejta për t'u zgjedhur në funksionin e gjyqtarit të Gjykatës nuk përbën të drejtë themelore kushtetuese, ndaj kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae*[6].

32. Sipas qëndrimit tjetër, individët që garojnë për funksionet e parashikuara në Kushtetutë legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës për kushtetutshmërinë e procesit të zgjedhjes për sa kohë janë pjesë e atij procesi. Për pasojë, ata justifikojnë interesin e tyre për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, bazuar edhe në nenin 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës[7].

[6] Votuan për moslegjitimimin *ratione personae* gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini.
[7] Votuan për legjitimimin *ratione personae* gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi.

33. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh në lidhje me kriterin e legjitimimit *ratione personae*, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkueses konsiderohet e rrëzuar, ndaj nuk është e nevojshme as analiza e mëtejshme e plotësimit të kritereve të tjera për legjitimimin.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat "e" dhe "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72, 73, pika 4 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.11.2025
Shpallur më 30.12.2025

Vendim nr. 72, datë 17.11.2025
(V-72/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese**,** Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë**,** me sekretare Anjeza Puka, në datën 17.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (V) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "VEGA" SH.A.,** e përfaqësuar nga administratorja Artenida Dervishi dhe anëtari i këshillit mbikëqyrës, avokat Erjon Kanxheri.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "JUS" SH.P.K.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.02.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Prishja/shfuqizimi i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 06.11.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 44, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës**

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim kërkesën e kërkueses, shoqërisë "Vega" sh.a. *(kërkuesja)*, për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes dhe konstatoi mungesën e mendimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Energjisë *(MIE)* dhe Zyrës së Përmbarimit Privat "Jus" sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja në datën 10.06.2011 ka lidhur me Ministrinë e Transportit dhe të Infrastrukturës *(MTI)* "Marrëveshje për caktimin dhe rinovimin e kontratës për ndërtimin e ndërtesës së terminalit të trageteve Durrës dhe infrastrukturës së kantierit lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe SCT d.d. më 6 maj 2008". Sipas pikës 20.6. të këtij akti, përveçse kur zgjidhet në mënyrë miqësore, çdo mosmarrëveshje zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar, sipas rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë *(ICC)*.

2. Për shkak se mes palëve kanë lindur mosmarrëveshje për zbatimin e kontratës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC-së. Kjo e fundit, me vendimin nr. 21069/MHM, datë 29.11.2016, ka vendosur pjesërisht në favor të kërkueses.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 97, datë 03.05.2017, ka vendosur njohjen dhe dhënien fuqi ligjore vendimit të ICC-së nr. 21069/MHM, datë 29.11.2016, duke lëshuar edhe urdhrin e ekzekutimit për këtë vendim. Për rrjedhojë, kërkuesja i është drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor privat për ekzekutimin e tij. Në datën 18.12.2017 MTI-ja ka ekzekutuar pagesën e detyrimeve dhe kostove procedurale, por pa përfshirë interesat për vonesën. Emërtimi i MTI-së ka ndryshuar në MIE. Për këtë qëllim, në këtë vendim emrat e institucioneve janë përdorur në përkëmbim të njëri-tjetrit.

4. Në datën 11.12.2018 MIE-ja ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Tiranë, me objekt pezullimin e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, si dhe kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit privat. Me vendimin nr. 10718, datë 26.12.2018, ajo gjykatë ka vendosur shpalljen e moskompetencës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në vijim, ajo gjykatë, me vendimin nr. 1228, datë 29.06.2020, ka vendosur pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesja dhe Zyra e Përmbarimit Privat "Jus" sh.p.k.

5. Me vendimin nr. 831 (86-2023-1153), datë 06.11.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Mbi rekursin e paraqitur nga palët ndërgjyqëse, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.02.2025, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Në datën 03.06.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 10.06.2025. Në datën 30.07.2025 një gjyqtar, pas njohjes me aktet, ka paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me anë të vendimit nr. 19, datë 30.07.2025, ka vendosur pranimin e kësaj kërkese. Kolegji i Gjykatës (pas plotësimit me anëtarin zëvendësues), në datën 31.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Në datën 29.10.2025 kërkuesja ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i ankimit kushtetues individual i paraqitur në datën 03.06.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesja,*** mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kufijtë ligjorë rishqyrtues. Ajo gjykatë ka shqyrtuar e vlerësuar prova dhe fakte, të cilat janë vlerësuar dhe arsyetuar nga gjykatat më të ulëta dhe asnjë palë nuk ka pasur pretendime. Rekursi i referohet interpretimit të provave dhe jo shkeljeve ligjore procedurale

ose materiale dhe, si i tillë, nuk duhet të ishte bazuar në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Është pikërisht ky roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, e cila nuk ka gjetur elemente të natyrës ligjore, por ka bërë një analizë të mirëfilltë fakti, duke tejkaluar kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin procedural.

8.2. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar*, pasi Gjykata e Lartë ka rishqyrtuar themelin e çështjes tashmë të gjykuar nga gjykata e arbitrazhit. Dispozitivi i vendimit të gjykatës së arbitrazhit është i qartë dhe i vetëzbatueshëm, dhe asnjë gjykatë nuk mund të ushtrojë kompetencë për të interpretuar rrethanat faktike ose dokumentet kontraktuale mbi të cilat është mbështetur vendimi. Për më tepër, ajo ka kërkuar verifikimin e metodologjisë së ndjekur nga gjykata e arbitrazhit për llogaritjen e detyrimit financiar. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka kryer një shqyrtim të përmbajtjes së kontratës, e cila përbënte objekt të drejtpërdrejtë të procesit të arbitrazhit dhe është analizuar nga kjo e fundit në kuadër të kompetencës së saj ekskluzive. Ndërkohë që gjykimi ka në thelb procedurat e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, në të cilat nuk lejohet rishqyrtimi i themelit të detyrimit ose përcaktimi i masës së tij. Në rastin konkret, orientimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, një dispozitë ligjore urdhëruese, e cila në mënyrë eksplicite ndalon shqyrtimin, vlerësimin ose analizën e një titulli ekzekutiv (vendim gjyqësor ose arbitrazhi) për fakte të mëhershme se dhënia e vendimit.

8.3. *Gjykimit brenda një afati të arsyeshëm,* për shkak se Gjykata e Lartë ka vepruar jashtë afateve ligjore për shqyrtimin e rekursit, duke shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 60 të ligjit nr. 49/2012, pasi vendimi është marrë në datën 19.02.2025, ndërkohë që rekursi është paraqitur në datën 11.12.2023.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Në datën 29.10.2025 kërkuesja që ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, nëpërmjet administratorit, ka paraqitur kërkesë, me objekt: "Heqje dorë nga kërkesa", në të cilën ka parashtruar se: *"Në zbatim të së drejtës së kërkueses për disponimin mbi kërkesën e paraqitur sipas nenit 31/b, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin*

dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, kërkuesja shoqëria "Vega" sh.a., ju drejtohet, duke kërkuar: Heqjen dorë nga kërkesa e shoqërisë "Vega" sh.a. regjistruar pranë Gjykatës Kushtetuese më 10.06.2025, nr. Regj. Them., 6 (V), me objekt: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.02.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Prishja/shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.02.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 06.11.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit.". Kërkesa është depozituar në Gjykatë në datën 29.10.2025 dhe u është komunikuar të gjitha palëve pjesëmarrëse në gjykim/subjekteve të interesuara, të cilat nuk kanë paraqitur prapësime në lidhje me të.

10. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku sipas nenit 16, pika 2, të Kushtetutës, dhe nenit 71, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, përfshihen edhe personat juridikë, sikurse shoqëria tregtare në këtë gjykim. Ndërsa neni 31/b i ligjit nr. 8577/2000 parashikon të drejtën e kërkuesit për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Heqja dorë nga kërkesa nuk pranohet kur Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes paraqet interes publik. Ndërsa pika 2 e nenit 43/b të po këtij ligji, që parashikon të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ia njeh këtë të drejtë kërkuesit në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

11. Mbi bazën e këtij kuadri normativ, Gjykata evidenton se për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues vepron parimi i disponibilitetit, sipas të cilit kërkuesit i njihet e drejta që procedurën e filluar prej tij ta ndërpresë përmes aktit të heqjes dorë. Ky i fundit, si rregull, passjell pushimin e shqyrtimit të çështjes, me përjashtim të rastit kur shqyrtimi i saj mbart interes publik.

12. Në rastin konkret, Gjykata çmon se duhet të analizojë nëse shqyrtimi i çështjes konkrete mbart interes publik, në kuptimin që të zbatohet rregulli përjashtimor i parimit të disponibilitetit. Nga përmbajtja e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, Gjykata vëren se ankimi kushtetues individual ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor, në të cilin kërkuesja ka qenë palë ndërgjyqëse në cilësinë

e palës së paditur. Kërkuesja ka pretenduar se asaj i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

13. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye bindëse për vazhdimin e gjykimit për shkak të një interesi publik, pasi pretendimet e kërkueses në këtë rast janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me cenimin e interesave të saj kushtetuese dhe në këto rrethana nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit. Për pasojë, gjykimi i çështjes duhet të pushohet, bazuar në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.11.2025
Shpallur më 26.11.2025

Vendim nr. 73, datë 19.11.2025
(V-73/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 11.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 9 (M) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **MARIGLEN QATO,** përfaqësuar nga avokat Ardian Leka, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurori Klodjan Braho.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 352, datë 24.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 164 (87-2024-223), datë 31.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1979 (299), datë 04.12.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 30, 32, pika 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës**

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet dhe prapësimet e kërkuesit Mariglen Qato (*kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme)*, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe shtetasi R.M. kanë qenë të punësuar nga muaji gusht i vitit 2015 deri në shkurt të vitit 2016 në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në varësi të Bashkisë së Tiranës. Në muajin shkurt shtetasi R.M. është punësuar në shoqërinë "Ujësjellës-Kanalizime Tiranë" sh.a., në pozicionin e drejtorit të përgjithshëm dhe në muajin mars të vitit 2016 edhe kërkuesi është punësuar në të njëjtën shoqëri, në pozicionin e drejtorit të departamentit mbështetës.

2. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 75, datë 27.04.2023 (*procedimi penal nr. 75/2023*) për veprat penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera dhe në ankande publike" dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë dhe 259, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*). Po kështu, Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi B.K., ka regjistruar procedimin penal nr. 121, datë 23.05.2023 (*procedimi penal nr. 121/2023*) për veprat penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera dhe në ankande publike" dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë dhe 259, paragrafi i dytë, të KP-së. Me vendimin e datës 23.05.2023 të prokurorit, të dyja procedimet penale janë bashkuar në një procedim të vetëm nr. 75/2023.

3. Në vijim të procedimit penal nr. 75/2023 janë kryer veprime hetimore e me vendimin nr. 401, datë 11.10.2023 të GJKKO-së është ushtruar kontroll në ambientet e zyrës së shoqërisë "5D konstruksion" sh.p.k., (fillimisht

e emërtuar si "Igor Elektrik" e më pas si "V.A.S. Konstruksion"), duke sekuestruar dokumente, njësi kompjuterike dhe aparate telefonie celulare, të cilat më pas i janë nënshtruar ekspertimit teknik kompjuterik, nga ku janë gjetur të dhëna se ortakët e vërtetë të kësaj shoqërie janë kërkuesi dhe shtetasi R.M., të cilët dyshohet se e kanë zotëruar në mënyrë të tërthortë prej vitit 2016.

4. Pas kryerjeve të veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për caktimin e masave të sigurimit "Arresti në burg" ndaj personave nën hetim, kërkuesit dhe shtetasit R.M., për veprat penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 259 e 25 të KP-së dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim", e kryer aq herë sa episode janë të procedueshme penalisht.

5. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 28, datë 28.03.2024, ka miratuar kërkesën dhe ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), për kryerjen e veprave penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" në 4 raste, të kryera në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 259 dhe 25 të KP-së dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim", të parashikuar nga neni 257, shkronja "a", pika 2, i KP-së.

6. Në datën 29.03.2024 Prokuroria e Posaçme ka dërguar për gjykim kërkesën për verifikimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal dhe marrjes në pyetje ndaj personave nën hetim, përfshirë dhe kërkuesin.

7. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 35, datë 30.03.2024, ka vendosur, ndër të tjera, vazhdimin e masës së sigurimit "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i KPP-së ndaj kërkuesit si person i hetuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 25 dhe 257, shkronja "a", pika 2, të KP-së.

8. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 18 (87-2024-123), datë 03.05.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 28, datë 28.03.2024 dhe nr. 35, datë 30.03.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

9. Ndërkohë, mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.09.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 18, datë 03.05.2024 të GJKKO-së së Apelit për kërkuesin dhe personin nën hetim R.M., duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit nëpërmjet kualifikimit të veprës penale. Kolegji Penal ka rekomanduar GJKKO-në e Apelit të marrë në shqyrtim vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë lidhur me masat e sigurisë ndaj kërkuesit dhe personit tjetër nën hetim R.M., duke vlerësuar raportin e masave të sigurimit me rëndësinë e faktit dhe sanksionin për veprat penale të kualifikuara nga organi i akuzës deri në fazën aktuale të hetimeve. Në rishqyrtim, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 57 (87-2024-323), datë 07.11.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 28, datë 28.03.2024 dhe nr. 35, datë 30.03.2024, në lidhje me llojin e masës së sigurimit "Arresti në burg" të caktuar ndaj kërkuesit dhe personit tjetër nën hetim, shtetasit R.M., me arsyetimin se është më e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit, rëndësinë e fakteve dhe sanksionet e parashikuara për veprat penale.

10. Në datën 28.05.2024 në GJKKO-në e Shkallës së Parë është regjistruar kërkesa penale nr. 313 akti, e paraqitur nga kërkuesi, me objekt paraqitjen e informacionit dymujor dhe verifikimin e kushteve dhe të kritereve që lidhen me nevojat e sigurimit ndaj personit nën hetim dhe zëvendësimin e masës së sigurimit në zbatim ndaj tij me një masë sigurimi më të butë. Në datën 30.05.2024 është regjistruar kërkesa penale nr. 320 akti nga personi tjetër nën hetim, shtetasi R.M., me objekt të njëjtë me kërkuesin. Në datën 10.06.2024 është regjistruar kërkesa penale nr. 352 akti e Prokurorisë së Posaçme, me objekt paraqitjen e informacionit dymujor për ecurinë e hetimeve ndaj kërkuesit dhe dy shtetasve të tjerë nën hetim, R.M. dhe T.T. Me vendimin e datës 12.06.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur bashkimin e kërkesave penale nr. 313 akti dhe nr. 320 akti me kërkesën penale nr. 352 të Prokurorisë së Posaçme, pasi të tria kërkesat lidhen me procedimin penal nr.75/2023 dhe gjenden për shqyrtim në të njëjtën fazë procedurale, para së njëjtës gjykatë, si dhe në thelb kanë të njëjtin objekt. Sipas Prokurorisë së Posaçme, referuar informacionit me shkrim dhe qëndrimit të mbajtur gjatë zhvillimit të gjykimit, në funksion të procedimit penal në ngarkim të kërkuesit, të shtetasit R.M. e personave të tjerë që hetohen në kuadër të të njëjtit procedim, janë kryer një sërë

veprimesh hetimore, si sekuestrimi i aparateve të telefonisë celulare, kryerja e ekspertimit teknik kompjuterik, ekspertimi teknik lidhur me përllogaritjen e fondit limit për procedurat e prokurimit të gjetura me shkelje, si dhe janë kryer veprime hetimore që lidhen me mënyrën e qarkullimit të shumave monetare nga shoqëria "5D Konstruksion" sh.p.k. dhe me burimin e të ardhurave të investuara nga shoqëria në aktivitete të tjera, si dhe shumat monetare që janë përfituar nga zotëruesit e shoqërisë tregtare.

11. Pas bashkimit të të dyja procedimeve penale nr. 75/2023 dhe 121/2023, në vijim të hetimeve, me urdhrin e datës 04.06.2024, Prokuroria e Posaçme ka bërë ndryshime në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, duke urdhëruar regjistrimin e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, i KP-së. Po kështu, sipas këtij urdhri të Prokurorisë së Posaçme, është regjistruar si person nën hetim personi juridik shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "5D Konstruksion" sh.p.k., si subjekt i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 25, si dhe 287 të KP-së. Sipas Prokurorisë së Posaçme, për kryerjen e një hetimi të plotë duhen kryer veprime të tjera hetimore në drejtim të grumbullimit të provave të tjera në ngarkim të personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin.

12. Kërkuesi, nëpërmjet avokatit mbrojtës, ka kundërshtuar në GJKKO-në e Shkallës së Parë masën e sigurimit, duke pretenduar se ajo është e papërshtatshme e duhet zëvendësuar me një masë më të butë, pasi (i) lidhur me informacionin dymujor të paraqitur nga prokurori konstatohet shkelje e të drejtave procedurale të kërkuesit, për shkak se njoftimi i akuzës i është dërguar me postë në burg, praktikë e panjohur nga ligji, si dhe e pazbatuar më parë, (ii) organi i akuzës ka paraqitur informacion për kryerjen e disa veprimeve hetimore, sikurse janë aktet e ekspertimit, por nuk ka njoftuar mbrojtësit ligjorë për vendimet për caktimin e ekspertëve. Me kërkesë të njëjtë i janë drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë edhe dy personat nën hetim, shtetasit R.M. dhe T.T.

13. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 352, datë 24.06.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit dhe të dy personave të tjerë nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj tij me vendimin nr. 28, datë 28.03.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr. 18, datë 03.05.2024 të GJKKO-së së Apelit, me arsyetimin se kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e

masave dhe përshtatshmëria e tyre nuk rezultojnë të kenë pësuar ndryshime thelbësore, pasi personat e akuzuar vijojnë të jenë në hetim për të njëjtat fakte, për të njëjtat vepra penale, të cilat mbartin të njëjtën rrezikshmëri shoqërore të vlerësuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në momentin fillestar dhe të gjetur të drejtë edhe nga gjykata më e lartë që ka shqyrtuar ankimin e personave nën hetim, duke miratuar masat e caktuara prej tyre. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe personi nën hetim R.M.

14. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 164 (87-2024-223), datë 31.07.2024, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, me arsyetimin se shkaqet e parashtruara në apelet e kërkuesit dhe të shtetasit R.M. janë të pabazuara në fakte dhe në ligj. Sipas asaj gjykate, Prokuroria e Posaçme dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk kanë reflektuar në qëndrimet e tyre mbi kualifikimin juridik të fakteve penale historike objekt procedimi, pavarësisht pjesës relevante arsyetuese të vendimit nr. 18, datë 03.05.2024 të GJKKO-së së Apelit. Sipas kësaj të fundit, konstatohet se për dy personat nën hetim/apelues nuk ka asnjë rrethanë që ka relativizuar rëndësinë juridike dhe faktike të fakteve penale historike të cilat u atribuohen, përkundrazi ka veprime hetimore të mëtejshme që e konsolidojnë bindjen për autorësinë e tyre. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs personi tjetër nën hetim, shtetasi R.M.

15. Mbi rekursin e personit nën hetim R.M., Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1979 (299), datë 04.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në rekurs nga personi nën hetim R.M. nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, si dhe nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për zhvillimin ose njësimin e praktikës gjyqësore, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, vendimi i ankimuar nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe për pasojë nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së në kohën e depozitimit.

16. Në datën 07.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit organik të Gjykatës është regjistruar më 19.05.2025. Në datën 10.07.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin

e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 23.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

17.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

17.1.1 *Parimit të prezumimit të pafajësisë,* të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar kërkuesin dhe personat nën hetim si fajtorë, ndonëse çështja ndodhet ende në fazën e hetimeve, duke e rikualifikuar faktin penal sipas neneve 143, paragrafi 3, 287 dhe 334, paragrafi 1, të KP-së, për kryerjen e veprës penale nga të hetuarit në formën e një grupi të strukturuar kriminal, sipas nenit 28, paragrafi 4, të KP-së dhe duke e rënduar pozitën e tyre.

17.1.2. *Parimit të paanshmërisë,* pasi GJKKO-ja e Apelit me vendimmarrjen e saj ka rënduar pozitën e kërkuesit, ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit në apel, duke shtuar fakte e akuza që nuk janë pretenduar as nga prokurori, as nga gjykata e shkallës së parë, si dhe ka caktuar një masë sigurimi ekstreme në mungesë totale të arsyetimit për pretendimin e mbrojtjes për pavlefshmëri të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ajo gjykatë e ka tejkaluar pragun e shfaqjes së një mendimi ose sugjerimi mbi formën e bashkëpunimit apo kualifikimin e faktit penal në ngarkim të kërkuesit, duke u shprehur me bindje në arsyetimin e saj se kërkuesi është fajtor e duke tentuar të orientojë prokurorinë që të veprojë sipas bindjes së saj.

17.1.3. *Parimit të sigurisë juridike,* pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.09.2024, e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprës penale, duke rekomanduar GJKKO-në e Apelit të marrë në shqyrtim

vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë lidhur me masat e sigurisë ndaj kërkuesit dhe personit tjetër nën hetim M.Q., duke vlerësuar raportin e masave të sigurimit me rëndësinë e faktit dhe sanksionin për veprat penale të kualifikuara nga organi i akuzës deri në fazën aktuale të hetimeve. Ndërkohë, GJKKO-ja e Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në vendimin nr. 18 (87-2024-123), datë 03.05.2024, me doza të thella paragjykimi dhe me bindjen e plotë se ai është fajtor, por për akuza edhe më të rënda nga sa pretendon organi i akuzës, ndërsa Kolegji Penal ka anashkaluar haptazi qëndrimin e Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 26.09.2024, duke mbajtur i njëjti trup gjykues qëndrim katërcipërisht të kundërt për të njëjtin fakt në dy momente të ndryshme.

17.2. *Liria personale, e garantuar nga neni 27, pikat 1 dhe 2, shkronja "c", i Kushtetutës dhe neni 5, pikat 1, shkronja "c", i KEDNJ-së,* në drejtim të s*tandardit të dyshimit të arsyeshëm dhe proporcionalitetit,* pasi GJKKO-të dhe Gjykata e Lartë nuk kanë pranuar kërkesën e tij për zëvendësimin e masës "Arresti në burg" me një masë më të lehtë, edhe pse gjatë periudhës së kryerjes së hetimeve kërkuesi nuk ka ndërmarrë ose tentuar ndonjë veprim për të kontaminuar provat apo për t'u larguar, ndaj arsyet e përmendura për bazueshmërinë e caktimit të masës së sigurimit nuk i përgjigjen shkakut të vërtetë të arrestimit të tij. Vendimet janë arbitrare dhe pasqyrojnë një arsyetim formal dhe të përgjithshëm të kritereve për caktimin e masës së sigurimit nga gjykatat, duke u bazuar vetëm mbi rrezikshmërinë e veprës dhe ashpërsinë e dënimit, pa dhënë asnjë rrethanë konkrete se në çfarë mënyre apo me cilin veprim kërkuesi plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 228, paragrafi 3, i KPP-së. Caktimi i një mase të sigurimit personal më të ashpër, në kushtet kur synimi mund të arrihej edhe nëpërmjet masave më të lehta, e bën masën e caktuar ndaj tij joproporcionale me akuzat në ngarkim të tij dhe me situatën faktike në momentin e caktimit të kësaj mase kur hetimet ishin kryer.

18. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,*** në mënyrë të përmbledhur, lidhur me themelin e çështjes, ka prapësuar si vijon:

18.1. Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të parimit të paanshmërisë nuk qëndron, pasi GJKKO-të e

Posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova për kërkuesin e hetuar për faktet penale në ngarkim të tij, për të cilat është caktuar masa e sigurimit, si dhe kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave, në përputhje me standardet kushtetuese dhe të GJEDNJ-së.

18.2. Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk qëndron, pasi shkaqet e parashtruara nga kërkuesi kanë objekt vendimin nr.18, datë 03.05.2024 të GJKKO-së së Apelit, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues, për më tepër është prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 232, datë 26.09.2024, ndaj nuk prodhon efekte të një vendimi gjyqësor, e konkretisht në arsyetimin e vendimit citohet se "gjyqtari i hetimit paraprak nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake" dhe se kjo ndërhyrje e gjyqtarit të hetimit paraprak në veprimtarinë e prokurorit, duke bërë kualifikim të faktit penal, është jashtë kompetencave të funksionit të gjyqtarit të hetimit paraprak.

18.3.Pretendimet për cenimin e standardit të dyshimit të arsyeshëm dhe proporcionalitetit nuk qëndrojnë, pasi nga GJKKO-të dhe nga Gjykata e Lartë kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me plotësimin e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit, rrezikut të ikjes së personit dhe rrezikut të ndërhyrjes në marrjen e provave. Vendimet e GJKKO-ve dhe të Gjykatës së Lartë nuk kanë bërë një arsyetim stereotip për plotësimin e kushteve dhe kritereve të përgjithshme, por i kanë ballafaquar kërkesat ligjore me rastin konkret dhe veprimet hetimore konkrete të ndërmarra në kuadër të këtij procedimi penal. Vendimmarrja e GJKKO-ve dhe e Gjykatës së Lartë referon në praktikën e GJEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe në vendimet unifikuese nr. 1, datë 08.01.2009 dhe nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, nuk qëndron arsyetimi i kërkuesit se vetë avancimi i hetimeve passjell zbutjen e nevojave të sigurimit si një konstatim ekstraligjor dhe që nuk i përgjigjet cilësisë që merr subjekti procedural nga "persona nën hetim" gjatë hetimit paraprak, në "të pandehur në çdo shkallë të procesit", që përfundon me vendimin e gjykatës e që bashkëshoqërohet me masën e sigurimit personal sipas specifikimeve të rastit konkret.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

19. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

20. Në rastin konkret, kërkuesi legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vet individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për

rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata çmon të ndalet në kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Gjykata vëren se ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit "Arresti në burg" në datën 28.03.2024 me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Procesi gjyqësor i caktimit të kësaj mase është në fazën e miratimit të saj nga gjykata e apelit (*shih paragrafët 5-9 të vendimit*). Ndërkohë, paralelisht me këtë proces, në kohën kur prokurori ka paraqitur informacionin dymujor për zbatimin e masës së sigurimit, kërkuesi ka kërkuar në gjykatë zëvendësimin e saj. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë në datën 24.06.2024. Kërkuesi ka paraqitur ankim, por gjykata e apelit në datën 31.07.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në vijim, Gjykata e Lartë në datën 04.12.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i personit nën hetim R.M., pasi kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs.

23. Në vijim të rrethanave të parashtruara më sipër, edhe pse e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim nuk rezulton që kërkuesi/mbrojtësi i caktuar prej tij të ketë vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë nëpërmjet rekursit dhe të ketë marrë përgjigje për pretendimet e paraqitura në të. Gjykata thekson se si rregull mjetet e ankimit, sikurse është edhe rekursi, kanë efekt dhe sjellin pasoja të drejtpërdrejta vetëm për individin që i ka ushtruar ato, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të caktuar. Edhe pse subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka prapësuar në lidhje me mosshterimin e mjeteve në drejtim të depozitimit të rekursit vetëm nga njëri prej të pandehurve, Gjykata konstaton se në rastin konkret e drejta e rekursit është ushtruar nga i bashkëpandehuri tjetër, ndërkohë që Gjykata e Lartë është shprehur në vendimin e saj vetëm për pretendimet e ngritura prej tij, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës së Lartë, edhe pse ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, pa përcaktuar se ndaj cilit prej të pandehurve ka prodhuar efekte, në fakt duket se ka

prodhuar efekte dhe pasoja vetëm për individin që e ka ushtruar të drejtën e rekursit. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se për sa kohë që kërkuesi nuk ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nuk i ka ngritur në atë shkallë të gjykimit pretendimet që ka paraqitur në Gjykatë, ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja f, të Kushtetutës.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të rrëzohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.11.2025
Shpallur më 12.12.2025

Vendim nr. 74, datë 20.11.2025
(V-74/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 20.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 6 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **BIBË KAZA,** përfaqësuar nga avokat Ndue Marku, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE, TIRANË.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3570, datë 19.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 42, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 45, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Bibë Kaza (*kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH)*, Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka shërbyer si oficer aktiv në Forcat e Armatosura nga data 18.05.1981 deri në datën 01.08.2004, kur ka dalë në rezervë me gradën "Kolonel" dhe me vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv për 23 vjet e 2 muaj.

2. Pas përfundimit të trajtimit me pagesë kalimtare, në datën 01.08.2006, kërkuesi është trajtuar në vijim me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi *(pensioni i parakohshëm).* Me vendimin nr. 4168, datë 25.01.2008 *(vendimi nr. 4168/2008)* DRSSH-ja, Tiranë i ka caktuar atij pensionin e parakohshëm, me të drejtë pagese nga data 01.08.2006, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie. Pensioni është përllogaritur në bazë të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8087/1996),* duke u përcaktuar në masën 16.007 lekë në muaj, sa pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi. Kërkuesi ka paraqitur disa kërkesa për rillogaritjen e pensionit të parakohshëm pranë DRSSH-së, Tiranë, por nuk ka marrë përgjigje.

3. Më pas, ai i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e DRSSH-së, Tiranë: (i) të rillogarisë dhe të paguajë masën e pensionit të parakohshëm në përputhje me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 " Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 9210/2004*), për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009, duke përfshirë indeksimin vjetor të pensionit; (ii) të paguajë diferencat midis masës së pensionit të rillogaritur dhe atij të paguar për të njëjtën periudhë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4655 (80-2015-3038), datë 25.09.2015, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit, sipas objektit të saj. Ajo ka arsyetuar se, edhe pse në çastin e lindjes

për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm ishte në fuqi ligji nr. 9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 9418/2005*), në mungesë të akteve nënligjore për zbatimin e tij, caktimi dhe llogaritja e masës së pensionit me të drejtë janë bazuar në ligjin nr. 8087/1996. Megjithatë, organi i sigurimeve shoqërore ka gabuar kur, për periudhën objekt gjykimi 01.08.2006 - 30.06.2009 ka kufizuar masën e pensionit të parakohshëm sipas nenit 11, shkronja "b", të këtij ligji, në kushtet kur, nga data 14.05.2004 shprehja "por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" në shkronjën "b" të këtij neni ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Referuar ekspertimit gjyqësor, diferenca e papaguar e pensionit të parakohshëm për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009 është 3.111.328 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1690 (1684), datë 20.04.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Ajo ka arsyetuar se, ndonëse në datën 01.08.2006 të lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm në fuqi ishte ligji nr. 9418/2005, bazuar në vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *(vendimi unifikues nr. 3/2016),* ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të tij është ligji nr. 8087/1996, përfshirë edhe kufizimin e masës së pensionit sipas nenit 11, shkronja "b", të tij sa masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Për rrjedhojë, pensioni i parakohshëm për kërkuesin është caktuar dhe paguar në përputhje me ligjin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3570, datë 19.09.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012).* Sipas këtij kolegji, shkaqeve në rekurs u ishte dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme, konkretisht të ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe

të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), duke e zgjidhur çështjen në meritë në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016.

7. Në datën 13.02.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, u regjistrua në datën 24.02.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 23.04.2025 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* për shkak se:

8.1. Gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të parashtruara përpara shqyrtimit të çështjes, të cilat as nuk i ka pasqyruar në vendimin e saj. Po kështu, ajo ka dalë përtej kufijve të ankimit të palës së paditur, duke u investuar kryesisht për çështje që nuk janë ngritur në ankim. Arsyetimi i vendimit të saj nuk përputhet me faktet dhe me situatën juridike të çështjes, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe jologjik. Në planin material, gjykata e apelit nuk ka zbatuar ligjin sipas përmbajtjes së tij në çastin e lindjes të së drejtës. Ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016, i cili ka përcaktuar si të zbatueshëm ligjin nr. 8087/1996 bashkë me kufizimin e masës së pensionit në nenin 11 të tij. Megjithatë, një zbatim i tillë i ligjit bie haptazi ndesh me parimin e ligjshmërisë, pasi mungesa e akteve nënligjore nuk e bën të pazbatueshëm nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, i cili zbatohet drejtpërdrejt. Për pasojë, vijon kërkuesi, është sjellë në fuqi një normë e shfuqizuar 12 vjet më parë, duke marrë kompetencat e pushtetit legjislativ dhe duke mos zbatuar ligjin në mënyrë uniforme, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Kushtetutës, por edhe të parimit të sigurisë juridike, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës.

8.2. Edhe pse në rekursin e tij janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, por edhe për shkelje të rënda të ligjit material dhe

atij procedural nga gjykata e apelit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mbajtur qëndrim formal, skematik dhe të thjeshtëzuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në lidhje me vendimin e kundërshtuar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhënë në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga ai, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu i kundërshtuar në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se, sipas jurisprudencës saj, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 24, datë 23.04.2025;*

nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka qenë palë në procesin ku është dhënë vendimi unifikues i kundërshtuar, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues, për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Në drejtim të legjitimimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 19.09.2024 dhe sipas korrespondencës së kërkuesit me atë gjykatë, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, ai vendim është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 14.10.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 13.02.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, por edhe të parimit të sigurisë juridike, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Nisur nga thelbi i pretendimeve, që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

15. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara përpara shqyrtimit të çështjes, të cilat as nuk i ka pasqyruar në vendimin e saj. Po kështu, ajo ka

dalë përtej kufijve të ankimit të palës së paditur, duke u investuar kryesisht për çështje që nuk janë ngritur në ankim. Arsyetimi i vendimit të saj, sipas kërkuesit, nuk përputhet me faktet dhe situatën juridike të çështjes, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe jologjik. Në planin material, gjykata e apelit nuk ka zbatuar ligjin sipas përmbajtjes së tij në çastin e lindjes të së drejtës. Ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016, i cili ka përcaktuar si të zbatueshëm ligjin nr. 8087/1996 bashkë me kufizimin e masës së pensionit në nenin 11 të tij. Megjithatë, një zbatim i tillë i ligjit bie haptazi ndesh me parimin e ligjshmërisë, pasi mungesa e akteve nënligjore nuk e bën të pazbatueshëm nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, i cili zbatohet drejtpërdrejt. Për pasojë, vijon kërkuesi, është sjellë në fuqi një normë e shfuqizuar 12 vjet më parë, duke marrë kompetencat e pushtetit legjislativ dhe duke mos zbatuar ligjin në mënyrë uniforme, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Kushtetutës, por edhe të parimit të sigurisë juridike, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës. Edhe Gjykata e Lartë, shprehet kërkuesi, ndonëse në rekursin e tij janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, por edhe për shkelje të rënda të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mbajtur qëndrim formal, skematik dhe të thjeshtëzuar.

16. Duke sjellë në vëmendje se neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon edhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata çmon të ritheksojë se roli i saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë. Ajo nuk vepron si "gjykatë e shkallës së katërt", ndaj ndërhyrja e saj justifikohet vetëm kur gjetjet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra kur gabimi ligjor ose faktik nga ato është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 24, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, Gjykata çmon të ritheksojë se ai përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat

mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohen sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 78, datë 06.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm ose në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 1, datë 31.01.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata rithekson gjithashtu se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës së ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe

ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Për legjislacionin që ka rregulluar ndër vite të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrollin e tyre kushtetues dhe për sa u përket përfundimeve njësuese të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, Gjykata e ka bërë tashmë në disa raste (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 24, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese),* ndaj çmon të mos ndalet në evidentimin e tij në hollësi edhe në këtë vendim.

21. Nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata, në vijim, do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

22. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 01.08.2006. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996 të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 16.007 lekë në muaj, sipas aktit administrativ, vendimit nr. 4168/2008 të DRSSH-së, Tiranë. Ai ka kërkuar nga kjo e fundit, në disa raste, rillogaritjen e masës së pensionit, por nuk ka marrë përgjigje. Pas kësaj, kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative, duke kërkuar detyrimin e organit administrativ t'i rillogarisë dhe t'i paguajë atij pensionin e parakohshëm për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009, në përputhje me masën e përcaktuar në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, si dhe t'i paguajë diferencat midis masës së pensionit të rillogaritur dhe atij të paguar, për të njëjtën periudhë.

23. Padia e kërkuesit është pranuar nga gjykata administrative e shkallës së parë. Ajo ka arsyetuar se, edhe pse në çastin e lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm ishte në fuqi ligji nr.

9418/2005, në mungesë të akteve nënligjore për zbatimin e tij, caktimi dhe llogaritja e masës së pensionit të parakohshëm me të drejtë është bazuar në ligjin nr. 8087/1996. Megjithatë, sipas saj, organi i sigurimeve shoqërore ka gabuar kur për periudhën objekt gjykimi 01.08.2006 - 30.06.2009 ka kufizuar masën e pensionit të parakohshëm sipas nenit 11, shkronja "b", të këtij ligji, në kushtet kur nga data 14.05.2004 shprehja "por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi", në shkronjën "b" të këtij neni ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Për pasojë, sipas asaj gjykate, llogaritja dhe pagimi i pensionit të parakohshëm për kërkuesin janë në kundërshtim me ligjin dhe referuar ekspertimit gjyqësor, diferenca e papaguar për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009 është 3.111.328 lekë.

24. Çështja është shqyrtuar në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Edhe sipas gjykatës së apelit, ndonëse në datën 01.08.2006 të lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm në fuqi ishte ligji nr. 9418/2005, bazuar në vendimin unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të tij ishte ligji nr. 8087/1996, përfshirë edhe kufizimin e masës së pensionit, sipas nenit 11, shkronja "b", të tij, sa masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, pensioni i parakohshëm për kërkuesin është caktuar dhe paguar në përputhje me ligjin.

25. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se pretendimeve në rekurs u ishte dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme dhe e ka zgjidhur çështjen në meritë në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016. Po sipas tij, nuk ka zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural nga Gjykata Administrative e Apelit dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

26. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 01.08.2006. Në atë kohë kjo e drejtë rregullohej nga nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005 të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, të cilat përcaktonin kushtet dhe kriteret

për përfitimin e pensionit të parakohshëm dhe masën e tij, konkretisht 50% të pagës referuese dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm (15 vjet për meshkujt), masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese, me kufizimin se për ushtarakët me gradën "Kolonel" masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të ishte më e madhe se 5-fishi i pensionit bazë. Ndërkohë, për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, sipas shkronjës "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, si dhe parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 9418/2005, sipas të cilit, me hyrjen e tij në fuqi, ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se do të përfitonte nga këto dispozita, pra se ndaj atij nuk do të zbatohej tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm (referuar ligjit nr. 9210/2004) ose që ky kufizim do të ishte deri në 5-fishin e pensionit bazë (referuar ligjit nr. 9418/2005 të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006).

27. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht ligjit në fuqi në çastin e lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm, konkretisht të ligjit nr. 9418/2005 të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se ky ligj nuk zbatohej, por zbatohej ligji nr. 8087/1996 i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, megjithëse neni 33 i ligjit të parë parashikonte shprehimisht se ky i dyti nuk do të zbatohej për ushtarakët e Forcave të Armatosura, që përfitonin sipas këtij ligji (ligjit të parë). Për këtë, ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin, duke iu referuar nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 10142/2009, është arritur në përfundimin se për periudhën nga data 01.01.1999 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi përllogaritej sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), përfshirë edhe përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në kohën kur në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005 (i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), i cili nuk zbatohej. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, zbatimi me fuqi prapavepruese i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është në përputhje me Kushtetutën, sikurse edhe Gjykata ka vlerësuar në vendimet nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013. Megjithatë, Gjykata vëren se neni 29 i ligjit nr. 10142/2009 rregullon rillogaritjen e të drejtave të njohura dhe pika 1 e tij përcakton zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8087/1996 deri në datën e hyrjes në

fuqi të këtij ligji (nr. 10142/2009), duke mos u shprehur për ndonjë efekt prapaveprues të ligjit në fjalë dhe as për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 ose rregullimin ndryshe të pasojave të ardhura nga zbatimi i tij. Po kështu, edhe në vendimet e referuara të Gjykatës nuk ka ndonjë vlerësim për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 për periudhën që ai ka qenë në fuqi dhe as për zbatimin në mënyrë përjashtimore me efekt prapaveprues të ligjit nr. 10142/2009, pra me qëllim rregullimin e ndonjë prej atyre situatave, të cilat, në aspektin kushtetues, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, do të lejonin, përjashtimisht, zbatimin me efekt prapaveprues të këtij ligji ndaj situatave ose marrëdhënieve të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi.

28. Përtej kësaj, Gjykata konstaton se ndonëse tavani i masës së pensionit maksimal të pleqërisë ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004, Gjykata Administrative e Apelit e kufizoi pensionin e parakohshëm të kërkuesit për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009 në masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke u mbështetur në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996 të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe duke vlerësuar se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohej për mungesë të daljes së akteve nënligjore për zbatimin e tij.

29. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit nuk duket se ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë për llogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se përmbush kërkesat e gjykimit të drejtë në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

30. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar përmbajtjen e ligjit nr. 9210/2004 dhe të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, si dhe mënyrën e interpretimit të tyre nga gjykata e apelit. Ajo nuk shprehet as për arsyet se përse ligji nr. 9418/2005 i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, i identifikuar nga të dyja gjykatat më të ulëta si ligji në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuesin, është i pazbatueshëm për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009. Po kështu, ajo nuk shpjegon se përse në rastin konkret kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues nr. 3/2016 për këtë periudhë dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm edhe nga gjykata e apelit (ligji nr. 8087/1996) vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit

të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar, sikurse ka pranuar gjykata e shkallës së parë. Për pasojë, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm, sikundër edhe për sa i përket zbatimit të kritereve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996 i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm.

31. Në rrethanat si më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve në rekurs të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke mbajtur në veçanti qëndrim për sa i përket kufizimit të masës së pensionit të kërkuesit për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009. Prandaj, vendimi i saj cenon të drejtën e kërkuesit për gjykim të drejtë në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimin e sigurisë juridike për të drejtën e pensionit të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji.

32. Për këto arsye, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit është i bazuar. Megjithatë, duke pasur parasysh rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material, prandaj vendimi i saj duhet të shfuqizohet.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3570, datë 19.09.2024 të Kolegjit

Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2025
Shpallur më 24.12.2025

Vendim nr. 75, datë 20.11.2025
(V-75/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 20.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 32 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **AFROVITI XUFA,** përfaqësuar nga avokat Thomas Dhimolea, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimin e vendimit nr. 77205-00133-00-2024, datë 16.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me nenin 6 të KEDNJ-së.**
Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.
Shfuqizimin e fjalës "/ose" në nenin 399/3, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile dhe, fjalinë "dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni" në nenin 399/4, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile, si të papajtueshëm me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
Pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

BAZA LIGJORE: **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 399/2, pika 1, shkronja**

“b”, 399/3, pika 1, 399/4, pika 2, 399/7, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska dhe mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Afroviti Xufa, në datën 09.02.2011, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi kundër disa shtetasve, një shoqërie tregtare dhe disa institucioneve shtetërore, me objekt: - anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 9, datë 03.02.2009 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë në lidhje me pasurinë nr. 35/41, truall me sipërfaqe 832,8 m^2, nga e cila 28 m^2 ndërtesë; - konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. 1286 rep., nr. 680 kol., datë 13.04.2010; - detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të fshijë pronën në emër të të paditurve dhe regjistrimin e saj në emër të kërkueses; - anulimin e lejes së sheshit dhe të ndërtimit; - marrjen e masës së sigurimit të padisë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 349, datë 26.02.2015, ka pranuar padinë sipas objektit të saj, duke rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë (bllokimin e pasurisë së mbivendosur pranë ZVRPP Vlorë dhe pezullimin e punimeve nga shoqëria ndërtuese e paditur). Mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1255, datë 23.11.2016, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i ka dërguar çështjen asaj për rigjykim. Më pas, mbi rekursin e palës së paditur, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11243-01576-00-2017, datë 07.05.2017.

3. Ndërkohë që çështja ishte në pritje për t’u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, kërkuesja, në datat 07.11.2023 dhe 17.01.2024, ka paraqitur dy kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të saj. Meqenëse çështja nuk është planifikuar për gjykim, në datën 25.11.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave

të gjykimit, në bazë të neneve 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja "c", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC).* Kërkesa është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin nr. 00-2025-61, datë 16.01.2025, ka vendosur pushimin e gjykimit të saj, me arsyetimin se çështja civile ishte planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi në datën 29.01.2025. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ, meqenëse Kolegji Civil kishte marrë masat për shqyrtimin e çështjes, kërkesa për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm kishte mbetur pa objekt dhe duhej pushuar, sipas nenit 399/7, pika 3, të KPC-së.

4. Në datën 09.06.2025 (sipas shërbimit postar), kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm. Kolegji i Gjykatës, në datën 15.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Përpara seancës plenare, në datën 18.11.2025, kërkuesja ka kërkuar edhe shpërblimin e shpenzimeve gjyqësore në vlerën 50.000 lekë.

5. Pas kalimit të çështjes në seancë plenare dhe pak ditë përpara zhvillimit të saj në datën 20.11.2025, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen civile të kërkueses. Sipas të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit të datës 05.11.2025 dhe Kolegji Civil ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1255, datë 23.11.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesja*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, me argumentet si vijon:

6.1. Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen e saj brenda 2-vjeçar të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së. Ky shqyrtim tashmë ka zgjatur më shumë se 8 vjet, pa qenë kërkuesja shkak i zvarritjes, ndërkohë që çështja nuk paraqitet komplekse dhe reforma në drejtësi nuk mund të përdoret si justifikim për vonesën. Zvarritja e gjykimit rrezikon gëzimin e së drejtës së pronës nga kërkuesja, e cila është 84 vjeç.

6.2. Edhe pse gjykimi i kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm u pushua për shkak të

planifikimit të datës së shqyrtimit të çështjes, në fakt çështja nuk u shqyrtua në datën e planifikuar dhe as është caktuar një datë e re për shqyrtimin e saj. Në këtë mënyrë kërkueses iu mohua edhe mundësia për të kërkuar shpërblimin e dëmit për shkeljen e afatit të arsyeshëm sipas nenit 399/4, pika 2, të KPC-së.

6.3. Kohëzgjatja tërësore e procedurave të gjykimit të çështjes në të gjitha shkallët gjyqësore tashmë ka kaluar tejkaluar 14 vjet dhe rrezikon të dyfishohet në rast të kthimit të çështjes në shkallë të parë.

6.4. Parashikimi i lidhëzës "/ose" në pikën 1 të nenit 399/3 të KPC-së dhe fjalia "dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni" në nenin 399/4, pika 2 të KPC-së, janë formalizma të tepruara që cenojnë në thelb të drejtën e individit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj janë të papajtueshme me Kushtetutën. Këto parashikime ligjore e bëjnë joefektiv mekanizimin e parashikuar për mbrojtjen e afatit të arsyeshëm, në kundërshtim me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, pasi individi mund të kërkojë shpërblimin e dëmit vetëm mbi bazën e vendimit që konstaton shkeljen e afatit të arsyeshëm dhe urdhëron përshpejtimin e procedurave, por jo në rastin e pushimit të gjykimit për shkak të marrjes së veprimeve të kërkuara nga individi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për

rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesja ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka pushuar gjykimin e kërkesës së saj për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave, si dhe përmbajtjen e neneve 399/3, pika 1, dhe 399/4, pika 2, të KPC-së. Ajo pretendon se vendimi dhe dispozitat ligjore i kanë cenuar të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

9. Gjykata ka theksuar se, në zbatim të neneve 49, pika 3, shkronja "e" dhe 71, pika 2, të ligjit organik, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë, krahas vendimit gjyqësor, edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, kërkuesi legjitimohet nëse janë plotësuar bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që kërkuesi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, përveç edhe interesin e tij për çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit të kundërshtuar; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; dhe (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që kërkuesi provon se e drejta e pretenduar e cenuar bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe rivendosja e saj është e mundur nga shqyrtimi kushtetues i çështjes *(shih vendimet nr. 85, datë 24.12.2024; nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Për sa i takon kriterit për legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i kushtëzuar. Si i tillë, ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 1, datë 25.01.2024; nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Në rastin konkret, kërkuesja është palë ndërgjyqëse në procesin civil ku ajo pretendon cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, pasi justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Për dispozitat ligjore të kundërshtuara, Gjykata konstaton se

nenet 399/3, pika 1 dhe 399/4, pika 2, të KPC-së rregullojnë konceptin e shpërblimit të drejtë për shkeljen e afatit të arsyeshëm dhe kompetencën për gjykimin e kërkesëpadive për shpërblimin e dëmit sipas nenit 399/6, pika 3, të KPC-së. Gjykata ka pohuar se, në parim, pretendime të kësaj natyre duhet të analizohen të lidhura ngushtësisht me vendimet gjyqësore të dhëna bazuar në dispozitën ligjore të kundërshtuar *(shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë rast, kërkuesja nuk është palë në një proces gjyqësor për shpërblimin e dëmit në kuptim të neneve 399/3 pika 1 dhe 399/4 pika 2, të lidhura me nenin 399/6, pika 3, të KPC-së. Për rrjedhojë, për sa kohë që cenimi i pretenduar i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nuk lidhet me zbatimin e dispozitave ligjore të kundërshtuara, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* për kërkimin që synon kontrollin kushtetues të tyre, pasi nuk justifikon interesin e saj real dhe të drejtpërdrejtë. Për rrjedhojë, kërkimi për shfuqizimin e dispozitave ligjore nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit organik të Gjykatës, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual pasi ka përdorur mjetin juridik parandalues/përshpejtues të parashikuar nga KPC-ja. Ajo ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, në bazë të neneve 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja "c", të KPC-së, për të cilën ajo gjykatë ka vendosur pushimin e gjykimit. Në ankimin kushtetues individual, ajo ankohet si për kohëzgjatjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe për kohëzgjatjen e procesit civil në tërësi, duke ngritur pretendime edhe për mungesën e efektivitetit të mjeteve të parashikuara nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

14. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* ka pranuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti "parandalues ose përshpejtues", i projektuar për të përshpejtuar procedurat në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti "riparues, kompensues ose monetar" që parashikon korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë edhe nëse procedura është ende në shqyrtim. Ligjvënësi shqiptar ka parashikuar një zgjidhje të kombinuar përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese, në nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Ky mekanizëm është vlerësuar, në parim, si efikas edhe nga GJEDNJ-ja, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar

të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur *(shih vendimet nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 11, datë 28.02.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesja, në datën 25.11.2024, ka përdorur mjetin parandalues/përshpejtues, por gjykimi i kërkesës së saj është pushuar me vendimin e datës 16.01.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se çështja civile do të shqyrtohej në datën 29.01.2025 (*shih supra paragrafin 3*). Megjithatë, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë, por edhe të dhënave në faqen zyrtare të saj, çështja e kërkueses nuk është është shqyrtuar në datën e planifikuar, për shkak të pengesës ligjore të trupit gjykues. Ajo është planifikuar për në datën 17.09.2025, por sërish nuk është shqyrtuar për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Çështja është shqyrtuar vetëm në datën 05.11.2025 dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1255, datë 23.11.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në këto rrethana, çështja civile e kërkueses është shqyrtuar pas 8 vjet e 6 muaj nga regjistrimi i saj në Gjykatën e Lartë dhe pas gati 1 viti nga përdorimi prej saj të mjetit parandalues dhe përshpejtues, duke përfunduar me dërgimin e saj për rishqyrtim në gjykatën e apelit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mjetet juridike nuk kanë qenë efektive për përshpejtimin e procedurave dhe kërkuesja nuk ka më mjete juridike efektive në dispozicion, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis,* në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit organik të Gjykatës, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se vendimi i Gjykatës së Lartë objekt ankimi i është njoftuar përfaqësuesit të kërkueses në adresën elektronike në datën 11.02.2025, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 09.06.2025 (sipas shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja pretendon cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar

çështjen civile të saj brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së. Ky shqyrtim tashmë ka zgjatur më shumë se 8 vjet, pa qenë ajo shkak i zvarritjes, ndërkohë që çështja nuk paraqitet komplekse dhe reforma në drejtësi nuk mund të përdoret si justifikim për vonesën. Zvarritja e gjykimit rrezikon gëzimin e së drejtës së pronës, ndërsa ajo është 84 vjeç. Sipas saj, pushimi i gjykimit të kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit për shkak të planifikimit të një date gjykimi, e cila në fakt nuk u respektua, e ka privuar nga e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit sipas nenit 399/4, pika 2, të KPC-së. Ajo thekson se kohëzgjatja tërësore e procesit ka kaluar 14 vjet dhe mund të dyfishohet në rast të rikthimit të çështjes në shkallë të parë.

19. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit llogaritet nga momenti i fillimit të procesit deri në dhënien e vendimit, duke përfshirë edhe vonesat e lidhura me reformën në drejtësi, të cilat nuk mund të rëndojnë mbi palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Në rastin konkret, mosmarrëveshja që po gjykohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhet me të drejtën e pronës, në kuadrin e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave. Procesi është vënë në lëvizje nga kërkuesja në datën 09.02.2011 dhe në shkallë të parë ka përfunduar në datën 26.02.2015, në favor të kërkueses, por pa pranuar sigurimin e padisë. Në apel çështja ka përfunduar në datën 23.11.2016, por pa vendim përfundimtar, ndërsa ajo është kthyer për rigjykim në shkallë të parë. Para se rigjykimi të vijonte, pala kundërshtare e kërkueses ka paraqitur rekurs dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 07.05.2017. Përpjekjet e kërkueses për përshpejtim (kërkesat e datave 07.11.2023 dhe 17.01.2024) nuk kanë sjell rezultat. Në datën 25.11.2024 ajo ka përdorur mjetin parandalues dhe përshpejtues, por Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin e kësaj kërkese, duke u mbështetur në planifikimin për shqyrtimin e çështjes civile. Në fakt, për shkak të pengesave ligjore dhe mosformimit të trupit gjykues, çështja është shqyrtuar vetëm në datën 05.11.2025, duke u dërguar për rishqyrtim në gjykatën e apelit, e cila tashmë duhet të shqyrtojë sërish çështjen.

21. Gjykata konstaton se shqyrtimi i çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar dukshëm afatin 2-vjeçar të parashikuar në nenin 399/2,

pika 1, shkronja "b", të KPC-së, përfshirë edhe zgjatjen e tij me 1 vit e 6 muaj të parashikuar në dispozitën kalimtare (neni 109, pika 4, shkronja "b") të ligjit ndryshues të KPC-së (ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017), i zbatueshëm në rastin konkret.

22. Në analizën e afatit të arsyeshëm, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave vlerësohet nën dritën e këtyre kritereve: (i) sjellja e kërkuesit; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në lidhje me kriterin e fundit, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se duke pasur parasysh atë që është në rrezik për kërkuesin, disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur kohëzgjatja e gjykimit ka qenë e konsiderueshme, Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm edhe në rastet që nuk kërkonin ndonjë trajtim të veçantë me përparësi, të tilla si mosmarrëveshjet për të drejtën e pronës të lidhura me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave *(shih vendimin nr. 46, date 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Duke verifikuar zbatimin e këtyre kritereve dhe standardeve kushtetuese në rastin konkret, Gjykata konstaton fillimisht se Gjykata e Lartë në vendimin e kundërshtuar, ndonëse i ka evidentuar kriteret e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, nuk ka bërë asnjë vlerësim konkret në raport me rrethanat e çështjes së kërkueses. Në këto rrethana, Gjykatës i kërkohet të verifikojë vetë këto kritere mbështetur në jurisprudencën e saj dhe atë të GJEDNJ-së.

25. Gjykata vëren se duhet të shqyrtojë kohëzgjatjen e procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, konkretisht periudhën nga data 07.05.2017 e regjistrimit të çështjes në atë gjykatë dhe deri në datën 05.11.2025 të përfundimit të shqyrtimit të saj. Po ashtu, ajo duhet të shqyrtojë edhe kohëzgjatjen tërësore të procedurave të gjykimit në të gjitha shkallët e gjykimit. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se KPC-ja ka parashikuar jo vetëm kohëzgjatjen që konsiderohet e arsyeshme për secilën shkallë të

procesit, por edhe të drejtën e individit palë në procedura që të përdorë mjetet parandaluese në secilën shkallë gjykimi. Edhe pse sipas ligjit zgjidhja përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese zbatohet për çdo shkallë dhe fazë të veçantë të procesit, kohëzgjatja e procedurave në secilën shkallë vlerësohet edhe në raport me kohëzgjatjen tërësore të procesit. Po sipas saj, edhe pse vlerësimi i kërkesave për shkelje të afatit të arsyeshëm, në kuptim të parashikimeve procedurale të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, bëhet në përputhje me rrethanat konkrete të çdo çështjeje të veçantë, kohëzgjatjen tërësore të saj dhe pasojat e kësaj kohëzgjatjeje në të drejtat e kërkuesit, qëllimi parësor i këtyre mjeteve juridike është njohja e shkeljes së kërkesës për "afat të arsyeshëm" dhe parandalimi i zgjatjes në mënyrë të tepruar të afatit të procesit përmes përshpejtimit të tij dhe, në enventualitet, korrigjimi i vonesave të ndodhura përmes shpërblimit të demit *(shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2025 të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Për sa i takon *sjelljes së kërkueses*, Gjykata konstaton se ajo nuk ka kontribuar në vonesa, përkundrazi, kërkuesja ka kërkuar në mënyrë aktive përshpejtimin e procedurave. Nuk ka ndonjë rrethanë që të tregojë se kërkuesja është bërë shkas për tejzgjatjen e procedurave të gjykimit të çështjes së saj në Gjykatën e Lartë.

27. Për sa i përket *kompleksitetit të çështjes*, Gjykata vëren se ajo nuk paraqitet veçanërisht komplekse për nga objekti i kontrollit të Gjykatës së Lartë, ndërsa ai ka konsistuar në ligjshmërinë e një vendimi jopërfundimtar të gjykatës së apelit për kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, çka nuk kërkon një shqyrtim të gjerë, sikurse edhe në fakt ka ndodhur, kur Gjykata e Lartë e ka përfunduar shqyrtimin brenda një seance. Në këtë kuptim, çështja nuk paraqitet komplekse, duke mos qenë ajo shkaku i tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë.

28. Për sa i takon *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vëren se vonesa në fakt duket se, kryesisht, lidhet me mbingarkesën e Gjykatës së Lartë. Sipas informacionit të dërguar nga kjo e fundit, deri në datën 31.10.2025, pranë saj janë të regjistruara 12.043 çështje civile, ndërkohë që ngarkesa e gjyqtarit relator të çështjes së kërkueses është 2122 çështje në shqyrtim.

29. Gjykata ka vlerësuar më parë se tejzgjatja e procedurave gjyqësore lidhet kryesisht me ngarkesën e lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si pasojë e reformës në drejtësi. Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së kësaj reforme, ligjvënësi dhe organet përgjegjëse duhet të marrin masa për të siguruar funksionimin normal të gjykatave dhe zbatimin e ligjit. Kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe

metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi kushtetues përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë *(shih vendimet nr. 58, date 17.09.2024; nr. 61, datë 20.11.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja, ka pranuar sfidat e rëndësishme me të cilat është përballur gjyqësori shqiptar pas reformave të ndërmarra në dekadën e fundit, përfshirë edhe si rezultat i verifikimit të gjyqtarëve dhe vonesat nga autoritetet emëruese në plotësimin e vendeve të lira të krijuara në këtë mënyrë, përveç edhe përparimin domethënës në fusha të caktuara, në veçanti me uljen e vazhdueshme të numrit të madh të çështjeve të prapambetura që ishin në pritje para Gjykatës së Lartë në vitin 2020 dhe shkallën në rritje të zgjidhjes së çështjeve të vërejtura në disa vitet e fundit. Megjithatë, ajo ka vërejtur se kohët mesatare të përpunimit të çështjeve ende duken të konsiderueshme në gjykatën më të lartë kombëtare për të gjitha llojet e çështjeve. Këta faktorë të një natyre të përgjithshme, mund të merren parasysh nga Gjykata, në një masë të përshtatshme, në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të tepërt të procedurave në një rast të veçantë. Në të njëjtën kohë, ato nuk janë të afta, më vete, të justifikojnë vonesa të një madhësie si ajo me të cilën është përballur kompania aplikuese në rastin aktual *(shih ARB sh.p.k dhe të tjerëve kundër Shqipërisë, 2025, §§ 121-122).*

31. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka ardhur për shkak të sjelljes së autoriteteve.

32. Për sa i përket rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja, Gjykata vëren se, edhe pse çështja nuk hyn në kategorinë e interesave "jetësore" që kërkojnë trajtim me përparësi, ajo lidhet me të drejtën e pronës dhe proceset e kthimit dhe kompensimit të pronave, ku Gjykata ka konstatuar më parë shkelje të afatit të arsyeshëm. Për më tepër, jo vetëm për shkak të asaj kohëzgjatje tërësore të procedurave në rastin konkret, por edhe rrethanave të veçanta të rastit, duket se çështja ka kërkuar trajtim me përparësi. Në këtë drejtim, përveç moshës së kërkueses, vlen të përmendet se procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë konsistonte në kontrollin e një vendimi jopërfundimtar të gjykatës së apelit, i cili pengonte zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, çka justifikonte trajtimin e saj me përparësi, në përputhje edhe me orientimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor,

në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", i nxjerr sipas delegimit të nenit 460, pika 4, të KPC-së dhe i zbatueshëm edhe për planifikimin e gjykimeve në Gjykatën e Lartë, referuar nenit 480, pika 2, të KPC-së.

33. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja është shprehur se njeh, në përputhje me përfundimet e Gjykatës Kushtetuese se, ndërsa merren me çështje të prapambetura të konsiderueshme dhe kërkojnë të sigurojnë trajtim të drejtë të të gjitha çështjeve në pritje, gjykatat kombëtare mund të kenë hapësirë të kufizuar për të përdorur mjetet juridike përshpejtuese të parashikuara nga ligji kombëtar në çështjet jo-prioritare. Pavarësisht kësaj, Shteti i paditur është ende i detyruar të ofrojë një mjet efektiv kompensues në rrethana të tilla. *(shih ARB sh.p.k dhe të tjerëve kundër Shqipërisë, 2025, § 122).*

34. Në këto rrethana, duke pasur parasysh vonesën prej 8 vitesh e 6 muajsh para Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkueses në këtë gjykatë ka tejkaluar afatin e arsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Mjetet e parashikuara nga KPC-ja për parandalimin dhe korrigjimin e shkeljes së afatit në rastin konkret nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe sjellja e autoriteteve ka sjellë cenim të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

35. Në kushtet kur gjykimi i çështjes së kërkueses tashmë ka përfunduar në Gjykatën e Lartë, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së si më lart, Gjykata vëren se mbetet të konstatohet vetëm cenimi i së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, njohje e shkeljes kjo, që sipas KPC-së, do t'i mundësonte kërkueses përdorimin efektiv të mjetit kompensues. Në këtë drejtim, Gjykata mban në konsideratë se, në parim, statusi i "viktimës" përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë. Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të gjykimit, çështja nëse kërkuesi ka marrë shpërblim të drejtë, është një çështje e rëndësishme dhe vendimi gjyqësor që cakton shpërblimin e drejtë përbën korrigjim të mjaftueshëm, rast në të cilin individi nuk mund të pretendojë më se është viktimë e shkeljes (shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

36. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses pranohet vetëm për sa i përket konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese

37. Kërkuesja, me shkresën e datës 18.11.2025, përpara seancës plenare, bazuar në nenin 28 të ligjit organik të Gjykatës, ka kërkuar edhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore për përgatitjen e ankimit kushtetues individual nga avokati i saj, duke paraqitur për këtë si provë faturën tatimore të datës 17.11.2025, lëshuar nga përfaqësuesi i saj, avokati Thomas Dhimolea, në vlerën 50,000 lekë (pa TVSH), me përshkrimin pagesë për ofrimin e shërbimit të përgatitjes së ankimit kushtetues individual.

38. Gjykata vëren se neni 28 i ligjit organik të saj parashikon rregullat për shpenzimet gjyqësore. Sipas këtij neni, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (pika 1); ndërsa, kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, Gjykata mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit, pjesërisht ose tërësisht, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 2). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, sipas të cilit kërkesa shoqërohet me aktin që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (pika 2); si dhe, në rast pranimi të ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 4).

39. Gjykata ka theksuar se, në parim, çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe se refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë, në mënyrë të pajustifikuar, të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas saj, në interpretim të dispozitave ligjore, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri në momentin e deklarimit të mbylljes së seancës plenare. Individi, është shprehur Gjykata, ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe janë në masë të arsyeshme, duke paraqitur ai aktet që dokumentojnë masën e shpenzimeve të kryera për qëllime të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të shoqëruara me fatura tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata është shprehur se kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të tij, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën

e kërkuar *(shih vendimet nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

40. Në lidhje me subjektin të cilit i ngarkohen shpenzimet e përfaqësimit, Gjykata është shprehur se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm. Në gjykimin kushtetues, individi synon të mbrojë të drejtat themelore të cenuara si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, ndaj përgjegjësia për mbulimin e këtyre shpenzimeve i takon vetë shtetit. Kjo logjikë pasqyrohet edhe në rregullimet ligjore për kompensimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren si të paditura Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (neni 399/4, pika 2, i KPC-së) *(shih vendimet nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

41. Mbi bazën e këtyre standardeve, Gjykata vëren se kërkimi i kërkueses për shpenzimet gjyqësore është paraqitur në formën e kërkuar dhe brenda afatit ligjor, pasi është depozituar me shkrim përpara seancës plenare. Po ashtu, shpenzimet e kërkuara gjyqësore kanë qenë të nevojshme, pasi lidhen me përgatitjen e ankimit kushtetues individual, të cilin, në mungesë të përvojës juridike të kërkueses për të kuptuar çështjen, por edhe moshën e saj, ajo nuk mund ta përgatiste vetë. Për sa i përket vërtetimit të shpenzimeve gjyqësore kërkuesja ka paraqitur faturën tatimore të lëshuar nga avokati, në të cilën përshkruhet shërbimi i ofruar dhe vlera e tij në masën 50 000 lekë. Megjithatë, duke mbajtur parasysh se çështja e përfunduar me këtë vendim nuk paraqitet komplekse, masa e arsyeshme e kompensimit të shpenzimeve të kërkueses për përgatitjen e ankimit kushtetues individual çmohet të jetë në vlerën 25 000 lekë, vlerë kjo e parashikuar edhe nga udhëzimi i përbashkët nr. 18, datë 05.08.2020, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, "Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore", në lidhje me shërbimin juridik jashtëgjyqësor (përgatitje kërkese në Gjykatë). Këto shpenzime, duke pasur parasysh natyrën e çështjes konkrete, e cila lidhet me konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, i ngarkohen Ministrisë së Financave. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe pranohet vetëm për vlerën e 25 000 lekë[1].

[1] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e të gjithë shumës së kërkuar.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të bazuara sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-61, datë 16.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkueses në vlerën 25 000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2025
Shpallur më 24.12.2025

Vendim nr. 76, datë 02.12.2025
(V-76/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 02.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SHOQËRITË "MALSIA SOLAR 1" SH.P.K., "MALSIA SOLAR 2" SH.P.K., "MALSIA SOLAR 3" SH.P.K.**, të përfaqësuar nga avokatë Korab Cani dhe Dritan Kruja, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, në mungesë.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3981 (362), datë 23.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkueseve, shoqërive "Malsia Solar 1" sh.p.k.; "Malsia Solar 2" sh.p.k., "Malsia Solar 3" sh.p.k. (*kërkueset*), që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkueset janë subjekte tregtare të regjistruara në datën 19.12.2012, me status aktiv, me seli në Tiranë dhe me të njëjtin objekt veprimtarie, në fushën e energjetikës, si dhe me të njëjtën pronësi të përbashkët shqiptare (E.S. me 18% të kapitalit) dhe të huaj (D.B. me 30%, E.K.A. me 30% dhe PV Consult Albania me 22%, ku kjo e fundit është me pronësi të përbashkët: K.K. 20% dhe G.I.K. me 80% të kapitalit).

2. Në kuadër të ushtrimit të aktivitetit tregtar, në datën 21.06.2014 shoqëritë janë pajisur me autorizim paraprak nga MIE-ja për ndërtimin e një centrali elektrik fotovoltaik në zonën e Malësisë së Madhe. Pasi kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor, përmes tre vendimeve të Këshillit të Ministrave të datës 14.01.2015 (*VKM-të nr. 20/2015, nr. 21/2015 dhe nr. 22/2015*), kërkueset kanë marrë autorizimin për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik. Këto vendime kanë përcaktuar se institucioni kompetent për ndjekjen e zbatimit të projektit është MIE-ja dhe afati për përfundimin e ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik është brenda muajit mars 2017 (*pika 1*). Po ashtu, kanë parashikuar edhe rastet kur autorizimet mund të revokohen nga ministria përgjegjëse për energjinë (*pika 7*).

3. Në datën 28.07.2016 Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar tre vendime për dhënien e lejeve të ndërtimit për objektin "Centrali elektrik fotovoltaik "Malsia Solar 1, 2, 3 sh.p.k.". Sipas vendimeve, dokumenti i lejes së ndërtimit i jepet subjektit zhvillues (shoqërive kërkuese) vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, në rastin konkret Bashkisë së Malësisë së Madhe.

4. Në vijim, në datën 09.11.2016 shoqëritë kërkuese i janë drejtuar Bashkisë së Malësisë së Madhe dhe për dijeni Kryeministrit, MIE-s dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (*AZHT*), me kërkesën se bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (*Ligji për Taksat Vendore*) taksa e ndikimit për projektet e ndërtimit të infrastrukturës në energji ishte 0.1% e vlerës së investimit.

5. Në datën 11.11.2016 Bashkia e Malësisë së Madhe i ka kthyer përgjigje kërkueseve se taksa e ndikimit në infrastrukturë që duhet të paguhej prej tyre ishte në masën 3% të vlerës së investimit (9.750.000 euro) dhe përllogaritej në shumën 39.926.250 lekë. Pas kësaj, në datën 14.11.2016, kërkueset i janë drejtuar kryetarit të Bashkisë së Malësisë së Madhe për t'u konsultuar me MIE-n dhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për sa i përket nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar Ligjit për Taksat Vendore.

6. Po ashtu, kërkueset në datën 23.11.2016 kanë paraqitur padi kundër Bashkisë së Malësisë së Madhe, me objekt saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve për sa i përkiste taksës së ndikimit në infrastrukturë nga procesi i instalimeve të paneleve diellore në parqet energjetike. Me vendimin nr. 258(296), datë 20.04.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueseve, me arsyetimin se taksa e ndikimit në infrastrukturë është përcaktuar nga organi i ngarkuar nga ligji, në rastin konkret Bashkia e Malësisë së Madhe dhe gjykata nuk mund të ndërhynte për sa kohë kërkueset nuk kishin kontestuar aktin administrativ, faturën e arkëtimit të lëshuar nga organi publik. Kërkueset e kanë kundërshtuar këtë vendim dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1205, datë 27.03.2018, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të tërheqjes prej tyre nga ankimimi.

7. Ndërkohë, kërkueset kanë vijuar përpjekjet për përcaktimin në një masë më të vogël të taksës së ndikimit në infrastrukturë edhe në rrugë jogjyqësore. Kështu, me shkresën e datës 12.01.2017, MIE-ja i është drejtuar Kryeministrisë, në të cilën sugjeron se një nga institucionet kompetente për të sqaruar nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë është Ministria e Financave, duke qenë se kjo e fundit ka iniciuar dhe hartuar Ligjin për Taksat Vendore. Me shkresën e datës 23.01.2017, Kryeministria ka njoftuar kërkueset se problematika e ngritur i është dërguar për ndjekje MIE-s.

8. Kërkueset në datën 30.01.2017 i janë drejtuar Ministrisë së Financave për qartësimin juridik të Ligjit për Taksat Vendore, e cila në datën 06.02.2017 ka sqaruar përfundimisht se taksa e ndikimit në infrastrukturë

duhet të jetë 0.1% e vlerës së investimit. Gjithashtu, MIE-ja, me shkresën e datës 20.02.2017, ka informuar kërkueset se objekti në rastin konkret është një projekt për ndërtimin e infrastrukturës në energji dhe, për rrjedhojë, referuar ligjit të vitit 2015, që ka ndryshuar Ligjin për Taksat Vendore, taksa e ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë 0.1% e vlerës së investimit.

9. Në vijim, në datën 30.08.2017, kërkueset i janë drejtuar përsëri Bashkisë së Malësisë së Madhe për faturimin e taksës në infrastrukturë në masën 0.1% të vlerës së investimit. Bashkia në fjalë, përmes shkresës së datës 04.09.2017, ka insistuar përsëri që taksa e ndikimit në infrastrukturë do të ishte 3% e vlerës së investimit. Pas kësaj, kërkueset, me shkresën e datës 02.10.2017, i janë drejtuar Kryeministrisë dhe Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes *(MSHMS*), me qëllim zgjidhjen e kësaj situate. Në vijim, MSHMS-ja, në muajin nëntor 2017, ka organizuar një takim ndërmjet kërkueseve dhe Bashkisë së Malësisë së Madhe, ku u arrit në përfundimin se niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte në masën 0.1% të vlerës së investimit.

10. Pas dërgimit të këtij njoftimi dhe përgatitjes në datën 13.12.2017 nga Bashkia e Malësisë së Madhe të faturave përkatëse të arkëtimit, kërkueset, në datën 13.01.2018, kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 520.260 lekë secila (gjithsej 1.560.780 lekë për të tria së bashku) dhe në datën 24.01.2018 i janë drejtuar për zbardhjen e lejes së ndërtimit AZHT-së. Kjo e fundit ka njoftuar kërkueset për pamundësinë e zbardhjes së lejeve të ndërtimit, pasi afati i parashikuar në autorizimet për këtë qëllim kishte mbaruar (afati ishte data 31.03.2017).

11. Në këtë situatë, kërkueset në datën 03.02.2018 i janë drejtuar sekretarit të përgjithshëm të autoritetit kontraktor, MIE-s, me shpjegime për vonesën e fillimit të punimeve. Pas këtij momenti shoqëritë kanë bërë disa kërkesa, duke kërkuar që ministria të njihte vonesat e krijuara nga Bashkia e Malësisë së Madhe dhe të shtynte afatin e ndërtimit të centralit.

12. Me shkresën e datës 10.09.2018, AZHT-ja i është drejtuar MIE-s për të konfirmuar afatet kohore të cilave duhet t'i referohej. Kjo e fundit, me shkresën e datës 09.10.2018, ka bërë me dije se ka filluar procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të tre projektvendimeve për Këshillin e Ministrave për shtyrjen e afatit të ndërtimit. Ky njoftim u është bërë me dije edhe kërkueseve në datën 15.10.2018 nga AZHT-ja dhe në datën 02.11.2018 nga MIE-ja.

13. Në vijim, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me shkresën e datës 09.01.2019, ka kthyer tre projektvendimet te MIE-ja,

pasi ka konstatuar se nuk ishin respektuar afatet e përfundimit të punimeve dhe se kërkesa për shtyrje afati ishte paraqitur në tejkalim të përcaktimeve në VKM-të nr. 20/2015, nr. 21/2015 dhe nr. 22/2015. Ky njoftim u është përcjellë kërkueseve me shkresën e datës 28.08.2019 nga MIE-ja.

14. Kërkueset, gjendur në këto rrethana, në datën 11.10.2019 i janë drejtuar gjykatës me padi, me objekt: (i) shfuqizimin e veprimit administrativ/shkresës së datës 09.01.2019 të sekretarit të përgjithshëm të Kryeministrisë, njoftuar me shkresën e datës 28.08.2019 të MIE-s; (ii) detyrimin e MIE-s që të nënshkruajë shtesën e autorizimit për shtyrjen e afatit të ndërtimit të centralit për një afat 6 mujor nga momenti i miratimit të shtesës së autorizimit; (iii) detyrimin e MIE-s të hartojë dhe propozojë projektvendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e shtesës së autorizimit që përmban shtyrjen e afatit të ndërtimit të centralit 6 muaj nga momenti i miratimit të shtesës së autorizimit; (iv) detyrimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e projektvendimit të propozuar nga MIE-ja lidhur me shtesën e autorizimit dhënë kërkueseve; (v) detyrimin e palëve të paditura të paguajnë shpenzimet gjyqësore.

15. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 122, datë 09.01.2020, ka vendosur: (1) pranimin e pjesshëm të padisë; (ii) konstatimin të paligjshëm të veprimit administrativ të formalizuar me shkresën e datës 09.01.2019 të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për kthimin e projektvendimit; (iii) detyrimin e Këshillit të Ministrave që të miratojë tre projektvendimet e iniciuara nga MIE-ja për shtesën e autorizimit; (iv) rrëzimin e padisë për palën e paditur, MIE-n, dhe të kërkimeve të tjera.

16. Pas ankimit të paraqitur nga MIE-ja dhe Avokatura e Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 511, datë 07.10.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me arsyetimin se vonesa dhe mosrespektimi i afatit të përfundimit të punimeve nuk kanë ardhur si pasojë e pamundësisë së kërkueseve për të përmbushur afatin e përcaktuar në 3 vendimet për miratimin e autorizimeve, por për arsye tërësisht objektive të pavarura nga kërkueset, të shkaktuara nga Bashkia e Malësisë së Madhe për shkak të mospërcaktimit në mënyrë të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, që ka sjellë pengimin e kërkueseve për pajisjen me dokumentin e lejes së ndërtimit dhe vijimin e punimeve për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs MIE-ja, e përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe kundërrekurs kërkueset.

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 26, datë 28.04.2022, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe, më pas, me vendimin nr. 00-2024-3981 (362), datë 23.09.2024, ka prishur dy vendimet e gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar padinë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

18. Në datën 17.02.2025 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 03.03.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 13.05.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit në datën 27.05.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 02.12.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak se kishte marrë pjesë në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. ***Kërkueset***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se Gjykata e Lartë u ka cenuar:

19.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

19.1.1. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj të lidhur me parimin e kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim diametralisht të kundërt nga ato të gjykatave të faktit, ndonëse gjendej përpara faktit se kërkueset janë penguar për të realizuar projektin për të cilin kanë marrë autorizimet nga Këshilli i Ministrave. Në rastin e tyre pengesë për të vijuar me procedurat e pajisjes me dokumentin e lejes së ndërtimit është bërë dukshëm Bashkia e Malësisë së Madhe, pra vonesa ka ardhur për arsye tërësisht objektive, të pavarura prej tyre. Disponimi nga ajo gjykatë ka sjellë për pasojë edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike*.

19.1.2. *Së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë faktet dhe provat e paraqitura prej tyre, ka anashkaluar në mënyrë të

pashpjeguar konkluzionet e gjykatës së apelit dhe të shkallës së parë, të cilat kanë analizuar imtësisht dhe me korrektësi situatën faktike dhe juridike.

19.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon analiza e fakteve dhe provave, duke mos dhënë asnjë argument ligjor se për përse administrata publike, si ajo në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror, nuk mori asnjë masë për eliminimin e situatës së paligjshmërisë, lehtësimin e kuptueshmërisë së bazës ligjore dhe nisjen e punimeve. Ndonëse këto shkaqe gjenden të listuara në pjesën përshkruese, në pjesën arsyetuese ato nuk merren në analizë nga Gjykata e Lartë. Mungesa e arsyetimit të vendimit bazuar në ligj dhe në prova ka cenuar pritshmëritë e kërkueseve, në kushtet kur ato kishin fituar të drejta në bazë të akteve administrative.

19.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkueset janë trajtuar në mënyrë arbitrare në raport me praktika të tjera të miratimit të shtesave të autorizimit, duke aplikuar një standard të dyfishtë, ndryshe për investitorët e tjerë në energji dhe ndryshe për to.

19.3. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi organet e administratës publike dhe ato vendore kanë mbajtur një qëndrim mohues në kushtet kur investimi nuk mund të vihej në jetë si rezultat i paqartësisë së ligjit dhe veprimeve e mosveprimeve të tyre. Vlera e investimit dhe dëmi ekonomik janë të pallogaritshëm dhe katastrofikë.

19.4. *Parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ka marrë një prerogativë që ligji nuk e përcakton si kompetencë të detyrës funksionale, duke tejkaluar kompetencat e tij. Shkresa për kthimin e 3 projektvendimeve MIE-s është e paligjshme në kuptim të nenit 109 të Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*), në kushtet kur sekretari i përgjithshëm ka marrë kompetencat e ekzekutivit. Kërkueset ndodheshin në kushtet e pamundësisë për të kërkuar zgjatjen e afatit të autorizimit përpara mbarimit të afatit, për sa kohë nuk kishin zgjidhur ende mosmarrëveshjen me Bashkinë e Malësisë së Madhe, pasi kjo kohë do të ndikonte në afatin e ndërtimit, për rrjedhojë, në rast

mospërfundimi të punimeve brenda afatit, do të humbitnin përfundimisht autorizimet e dhëna me vendimet e Këshillit të Ministrave. Këto veprime u kanë shkaktuar kërkueseve një dëm të pallogaritshëm ekonomik.

19.5. *Parimin e proporcionalitetit dhe racionalitetit*, të garantuara nga nenet 17 dhe 116 të Kushtetutës, pasi vendimi ka efekt shkatërrues për një investim privat që ndjek objektiva me interes publik (prodhimin e energjisë së pastër). Rrëzimi i padisë pa analizuar pasojat shoqërore, mjedisore dhe financiare, është jo vetëm joproporcional, por edhe joracional.

19.6. *Parimin e ndarjes së pushteteve*, të garantuar nga nenet 7 dhe 135 të Kushtetutës, pasi është mbivlerësuar roli i Kryeministrisë dhe është përjashtuar ministria kompetente nga çdo përgjegjësi. Vendimi ka shtuar konfuzionin institucional dhe ka deformuar mekanizmin e kontrollit ekzekutiv, duke legjitimuar ndërhyrjen arbitrare të një akti administrativ mbi një procedurë që kërkonte akt formal juridik.

20. ***Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit***, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim, duke prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, se:

20.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

20.1.1. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme e caktuar me ligj, kontradiktoritetit dhe sigurisë juridike*, nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkueset nuk kanë dhënë argumente në nivel kushtetues. Ndonëse ato pretendojnë shkelje ligjore nga ana e bashkisë, në asnjë rast nuk kanë parashtruar se në ç'mënyrë Gjykata e Lartë u ka cenuar të drejtat dhe parimet e pretenduara. Për më tepër, kërkueset nuk kanë një të drejtë të fituar në cilësinë e "pronës" për t'u mbrojtur në kuptimin kushtetues.

20.1.2. *Standardit të arsyetimi të vendimit,* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë në mënyrë të qartë ka argumentuar se në referim të shkaqeve të rekursit, vendimet e gjykatave të faktit janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material mbi rrethanat konkrete të çështjes në gjykim. Për më tepër, pretendimet e kërkueseve kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të provave dhe interpretimin e ligjit

nga gjykatat e zakonshme. Gjykatat e faktit nuk kanë marrë në konsideratë kompetencat e organeve publike administrative. Përkundër kompetencave të tyre, gjykatat e faktit kanë disponuar detyrimin e Këshillit të Ministrave të miratojë projektvendimin, çka është në kundërshtim me ligjin, pasi ato nuk mund t'i përcaktojnë vullnetin vendimmarrës një organi administrativ para se ai ta shqyrtojë sipas bindjes së brendshme dhe diskrecionit të vlerësimit që i jep ligji.

20.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron, pasi kërkueset nuk kanë parashtruar asnjë argument në nivel kushtetues. Ato nuk kanë dhënë argumente se kur Gjykata e Lartë ka vepruar në mënyrë të ndryshme në raste të ngjashme.

20.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* qartazi nuk qëndron, pasi në mungesë të një akti përfundimtar administrativ që njeh të drejtën reale ose ekonomike të kërkueseve, siç mund të ishte certifikata e përdorimit që jepet në përfundim të punimeve, nuk mund të flitet për një pronë të njohur ose të fituar sipas ligjit, e cila të gëzojë mbrojtje kushtetuese.

20.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë* është i pabazuar, pasi sekretari i përgjithshëm ka vepruar në ushtrim të kompetencës së tij të plotë për të kthyer aktet te ministrat propozues, në kushtet kur ato ishin në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, kompetencë e cila parashikohet në shkronjën "c" të nenit 9 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" (*Ligji për Këshillin e Ministrave*). Për më tepër, argumentet e kërkueseve, në thelb, kanë të bëjnë me arsyetimin e vendimit të kundërshtuar.

21. ***Subjekti i interesuar, MIE-ja***, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

22. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik,

subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Kërkueset, si persona juridikë, janë subjekte të së drejtës private dhe bartëse të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta, në përputhje me parashikimet e nenit 16 të saj. Ato legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, sepse kanë qenë palë në procesin gjyqësor, në vijim të të cilit është dhënë vendimi gjyqësor objekt kundërshtimi, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

24. Lidhur me kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, rezulton se kërkueset kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka ndryshuar vendimet e dy gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar padinë e tyre, ndaj në këto rrethana ato nuk kanë mjete të tjera ankimi në dispozicion. Për rrjedhojë, e kanë përmbushur edhe këtë kriter, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Organik të Gjykatës.

25. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë mban datën 23.09.2024, ndërsa është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 17.10.2024. Ankimi kushtetues individual është dërguar fillimisht në datën 17.02.2025 dhe në përmbajtje të tij kërkueset kanë parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë u ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme e caktuar me ligj, kontradiktoritetit, sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit, *parimin e barazisë përpara ligjit, parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë*, si dhe *të drejtën e pronës*. Për këto pretendime kërkueset legjitimohen *ratione temporis*, pasi i kanë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

26. Gjithashtu, Gjykata konstaton se në parashtrimet e paraqitura në datën 25.06.2025 kërkueset kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar

u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe në drejtim të *së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore,* për shkak se Gjykata e Lartë ka anashkaluar në mënyrë të pashpjegueshme konkluzionet dhe analizën e detajuar e korrekte të gjykatave të faktit; *parimin e proporcionalitetit dhe racionalitetit*, pasi vendimi nuk ka analizuar pasojat shoqërore, mjedisore dhe financiare; *parimin e ndarjes së pushteteve*, sepse Gjykata e Lartë ka shtuar konfuzionin institucional dhe ka deformuar mekanizmin e kontrollit ekzekutiv, duke legjitimuar ndërhyrjen arbitrare. Gjykata ka pohuar se, referuar nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të saj dhe nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimet nr. 32, datë 19.05.2025; nr. 4, datë 21.01.2025; nr. 28, datë 11.04.2024; nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e reja, të cilat përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual, nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ato janë paraqitur nga kërkueset pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

27. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkueset kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit,* bazuar në argumentin se ato janë trajtuar në mënyrë arbitrare në raport me praktika të tjera të miratimit të shtesave të autorizimit, duke aplikuar një standard të dyfishtë, ndryshe për investitorët e tjerë në energji dhe ndryshe për to. Ndërkohë, Gjykata vëren se këto argumente, në thelb, i referohen procesit administrativ të shqyrtimit të kërkesës së tyre dhe nuk shoqërohen me identifikimin e rasteve konkrete të ngjashme, për të cilat Gjykata e Lartë ka disponuar ndryshe nga ajo çfarë ka vendosur për kërkueset. Në këto rrethana, Gjykata çmon se sikurse me të drejtë kanë prapësuar subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, pasi argumentet nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

28. Lidhur me pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës,* kërkueset kanë argumentuar se organet e administratës publike dhe ato vendore kanë mbajtur një qëndrim mohues, në kushtet kur investimi nuk mund të vihej në jetë si rezultat i paqartësisë së ligjit dhe veprimeve e mosveprimeve të tyre dhe se vlera e investimit dhe dëmi ekonomik janë të pallogaritshëm dhe katastrofikë. Për këtë pretendim subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se ai qartazi nuk qëndron, për shkak se mungon akti përfundimtar administrativ që njeh të

drejtën reale ose ekonomike të kërkueseve, siç mund të ishte certifikata e përdorimit që jepet në përfundim të punimeve, rrjedhimisht në këtë situatë nuk mund të flitet për një pronë të njohur ose të fituar sipas ligjit, e cila të gëzojë mbrojtje kushtetuese.

29. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*), duke parashikuar, ndër të tjera, se prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil (*pika 2*). Gjykata ka pohuar se e drejta e pronës përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme i kësaj të drejte *(shih vendimet nr. 31, datë 18.04.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo e drejtë në thelb u referohet vetëm pasurive ekzistuese të individit, përfshirë edhe pretendimet nëpërmjet të cilave një kërkues mund të argumentojë se ka të paktën "një pritshmëri legjitime" (e cila duhet të jetë më konkrete se sa thjesht një shpresë) se do të realizohen, domethënë se do të fitojë gëzim efektiv të një të drejte pronësie *(shih vendimin nr. 30, datë 02.05.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për të nxjerrë kuptimin e së drejtës së pronës, Gjykata i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*), e cila ka pranuar se të ardhurat e ardhshme përbëjnë "posedim" vetëm nëse të ardhurat janë fituar ose janë përfundimisht të pagueshme (*shih Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë [DhM], 11 janar 2007, § 64; Denisov kundër Ukrainës [DhM], 25 shtator 2018, § 137; Juszczyszyn kundër Polonisë, 6 tetor 2022, § 344; Gyulumyan dhe të tjerë kundër Armenisë, 21 nëntor 2023, § 101*). Vëllimi i biznesit që gëzon një profesion i lirë - pa të ardhura fikse dhe pa xhiro të garantuar - i cili u nënshtrohet rreziqeve të jetës ekonomike, nuk përbën një "pronë" (*shih Federata Greke e Doganierëve, Gialouris dhe të tjerë kundër Greqisë, 6 prill 1995*). Po sipas GJEDNJ-së, shpresa për njohjen e një të drejte pronësie, që ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive, nuk mund të konsiderohet si një "posedim" në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe as një pretendim i kushtëzuar që shuhet si rezultat i mospërmbushjes së kushtit (*shih Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë [DhM], 12 korrik 2001, §§ 82-83; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (vendim) [DhM], 10 korrik 2002, § 69*).

30. Në kontekst të sa më sipër dhe duke marrë në konsideratë rrethanat e rastit në shqyrtim (autorizimi i marrë ka qenë paraprak dhe investimi

nuk është përmbushur), Gjykata çmon se nuk ka bazë të arsyeshme që të mbështesë ndonjë pritshmëri legjitime për të drejtën e pronës të kërkueseve. Me fjalë të tjera, interesi pronësor i kërkueseve nuk mund të karakterizohet si një e drejtë e pronës private, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i tyre për cenimin e së drejtës së pronës nuk qëndron.

31. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit, duke disponuar një vendim diametralisht të kundërt me atë që kanë dhënë gjykatat e faktit dhe në disfavor të kërkueseve dhe, nga ana tjetër, thelbin e argumenteve të parashtruara nga të gjitha palët pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues që lidhen me mënyrën e arsyetimit të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve të çështjes, çmon ta analizojë këtë pretendim në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, i cili ka natyrë kushtetuese dhe, si i tillë, hyn në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

32. Kërkueset kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar faktet dhe provat dhe nuk ka dhënë asnjë argument ligjor se përse administrata publike, si ajo në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror, nuk mori asnjë masë për eliminimin e situatës së paligjshmërisë, lehtësimin e kuptueshmërisë së bazës ligjore dhe nisjen e punimeve. Ndonëse këto shkaqe gjenden të listuara në pjesën përshkruese, në pjesën arsyetuese ato nuk merren në analizë nga Gjykata e Lartë. Sipas kërkueseve, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar faktin se shkresa e sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave është e paligjshme, në kushtet kur është marrë një prerogativë që ligji nuk e përcakton si kompetencë të detyrës funksionale të tij. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka vlerësuar faktin se kërkueset ndodheshin në kushtet e pamundësisë për të kërkuar zgjatjen e afatit të autorizimit përpara mbarimit të afatit, për sa kohë nuk kishin zgjidhur ende mosmarrëveshjen me Bashkinë e Malësisë së Madhe, pasi kjo kohë do të ndikonte në afatin e ndërtimit e, për rrjedhojë, në rast mospërfundimi të punimeve brenda afatit, do të humbnin përfundimisht autorizimet e dhëna me VKM-të.

33. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se Gjykata e Lartë në mënyrë të qartë ka argumentuar se në referim të shkaqeve të rekursit, vendimet e gjykatave të faktit janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material mbi rrethanat konkrete të

çështjes në gjykim. Për më tepër, pretendimet e kërkueseve kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të provave dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Gjykatat e faktit nuk kanë marrë në konsideratë kompetencat e organeve publike administrative. Përkundër kompetencave të tyre, gjykatat e faktit kanë disponuar detyrimin e Këshillit të Ministrave të miratojë projektvendimin, çka është në kundërshtim me ligjin, pasi ato nuk mund t'i përcaktojnë vullnetin vendimmarrës një organi administrativ para se ai ta shqyrtojë sipas bindjes së brendshme dhe diskrecionit të vlerësimit që i jep ligji.

34. Gjykata është shprehur se arsyetimi është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se funksioni i tij është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë *(shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Zbatimi i standardit të arsyetimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë *(shih vendimet nr. 50, datë 18.10.2023; nr. 3, datë 23.01.2014; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

35. Po kështu, Gjykata është shprehur se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke zbatuar standardet e mësipërme kushtetuese në raport

me rrethanat dhe faktet e çështjes të marra në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, Gjykata vëren se kërkueset, në cilësinë e subjektit zhvillues, në vitin 2015 kanë marrë nga Këshilli i Ministrave autorizimet përfundimtare për zbatimin e projektit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltanik me afat përfundimi dy vjet (mars 2017). Për shkak të mosdakordësisë me Bashkinë e Malësisë së Madhe për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.1% apo 3%), kërkueset nuk kanë mundur të marrin në kohë lejet e ndërtimit për fillimin e punimeve. Situata e mosmarrëveshjes me Bashkinë e Malësisë së Madhe ka zgjatur përreth një vit, nëntor 2016 - nëntor 2017, deri kur kjo e fundit u dakordësua pas ndërhyrjes së institucioneve qendrore të ekzekutivit (MIE-së dhe Ministrisë së Financave) për nivelin e taksës 0.1 % mbi vlerën e investimit. Pas kryerjes së pagesës, në muajin janar 2018 kërkueset kanë kërkuar pajisjen me lejen e ndërtimit, por për shkak të tejkalimit të afatit të përcaktuar në VKM-të për dhënien e autorizimit (mars 2017), nuk është bërë e mundur pajisja sipas kërkesës së tyre. Në vijim, pas komunikimeve në rrugë administrative, me qëllim shtyrjen e afateve të punimeve, në muajin dhjetor 2018, MIE-ja ka nisur për miratim në Këshillin e Ministrave tre projektvendime për këtë qëllim. Të tria këto akte i janë kthyer mbrapsht MIE-s nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me argumentin se nuk janë respektuar afatet e punimeve dhe kërkesa për shtyrje është paraqitur jashtë afateve ligjore. Në këtë situatë, në tetor të vitit 2019 kërkueset kanë vënë në lëvizje rrugën gjyqësore.

37. Gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, mbështetur në të njëjtën linjë arsyetimi, u kanë dhënë të drejtë kërkueseve, duke detyruar Këshillin e Ministrave të miratojë tre projektvendimet për shtyrjen e afateve të punimeve. Sipas gjykatave, MIE-ja ka përmbushur detyrimin e saj për hartimin e tre projektvendimeve, duke pranuar zgjatjen e afatit të autorizimit dhe ka vazhduar procedurat për miratimin e tyre në Këshillin e Ministrave. Po kështu, gjykatat kanë vlerësuar se Këshilli i Ministrave nuk ka bërë një hetim të plotë të çështjes dhe nuk ka marrë parasysh njoftimet e bëra nga kërkueset drejtuar Këshillit të Ministrave dhe MIE-s, por në kundërshtim me ligjin ka vendosur që të mos pranojë shtesën e autorizimit të bërë nga vetë organi kompetent, MIE-ja. Për më tepër, sipas gjykatave, kërkueset nuk mund të kërkonin zgjatjen e afatit të autorizimit përpara mbarimit të afatit, për sa kohë nuk kishin zgjidhur ende mosmarrëveshjen me Bashkinë e Malësisë së Madhe lidhur me vlerën që duhej të paguanin për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Kjo, pasi zgjatja e afatit të autorizimit jepet vetëm një herë dhe për një afat jo më

të gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit dhe, nëse kërkueset nuk do të arrinin të përfundonin punimet brenda afatit, do të humbnin përfundimisht autorizimin. Po kështu, sipas gjykatave, MIE-ja është institucioni që shqyrton dhe vlerëson arsyet e parashtruara nga mbajtësi i autorizimit për zgjatjen e afatit të autorizimit të kërkuar dhe jo Këshilli i Ministrave. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave duhej të dilte me një vendim konkret për miratimin ose jo të këtyre projektvendimeve dhe jo të procedonte me një shkresë të sekretarit të përgjithshëm për kthimin e tyre pa një vendimmarrje konkrete. Mosrespektimi i parashikimeve nënligjore lidhur me zgjatjen e afatit të autorizimit për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë (në rastin konkret central elektrik fotovoltaik), bën që veprimi administrativ i kryer nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, i formalizuar me shkresën e datës 09.01.2019, për kthimin e projektvendimeve është veprim i paligjshëm në kuptim të nenit 109 të KPA-së.

38. Përkundër arsyetimit të gjykatave të faktit, Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore, në prani të palëve, ka vlerësuar se problematika e çështjes objekt gjykimi lidhet me kuptimin e drejtë të bazës juridike për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, që i referohet nenit 24 të vendimit nr. 1701, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar (*Vendimi për Procedurat e Dhënies së Autorizimit*), përmbajtjes së tre vendimeve për miratimin e autorizimit dhe marrëveshjeve të datës 18.03.2015. Konkretisht, shprehet Gjykata e Lartë, kuptimi i ligjit nga një organ publik i pushtetit vendor siç është Bashkia e Malësisë së Madhe, për sa i takon nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk mund të përbëjë në vetvete forcë madhore për të justifikuar mosrespektimin e afateve nga kërkueset. Pushteti vendor nuk është në varësi të pushtetit qendror, ndaj korrespondenca që kërkueset kanë pasur me MIE-n për zgjidhjen e "konfliktit" me bashkinë, nuk justifikon mosrespektimin e afateve prej tyre. Për më tepër, sipas Gjykatës së Lartë, kërkueset kanë paraqitur edhe padi kundër Bashkisë së Malësisë së Madhe, me objekt saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet kërkueseve dhe organit publik për sa i përket masës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga procesi i instalimit të paneleve diellore sipas lejeve ndërtimore të dhëna nga autoritetet kompetente. Padia e tyre është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, ndërsa më pas ato kanë hequr dorë nga ankimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Ndaj,

"pengesa" ose "vështirësitë" financiare të kërkueseve për mospagimin e masës 3% të vlerës së investimit, siç i kërkohej nga Bashkia e Malësisë së Madhe, në vend të masës 0.1% të vlerës, nuk mund të përbëjnë arsye të mjaftueshme për mosrespektimin e afateve, pasi ato ishin ngjarje që mund të shmangeshin ose nëpërmjet pagimit të taksës dhe më pas zgjidhjes gjyqësish të pretendimeve për paligjshmërinë e nivelit të saj dhe veprimeve të Bashkisë së Malësisë së Madhe, ose nëpërmjet respektimit të afatit 60-ditor të njoftimit sipas parashikimit të shprehur qartë në VKM-të nr. 20-21-22/2015 (*shih paragrafin 41 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po sipas Gjykatës së Lartë, nuk ka dyshime që kërkueset nuk e kanë respektuar afatin për të paraqitur kërkesë për zgjatjen e autorizimit paraprak, i cili duhet të ishte kërkuar dhe paraqitur përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në autorizimin bashkëlidhur VKM-ve nr. 20-21-22/2015. Ndërkohë, shkresat e vitit 2018 të kërkueseve për shpjegime për vonesat e fillimit të punimeve janë bërë rreth 1 vit pasi ka përfunduar afati, duke qenë kështu haptazi në kundërshtim me afatet e kërkuara në aktet nënligjore (*shih paragrafin 42 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

39. Gjithashtu, sipas argumentimit të Gjykatës së Lartë, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Këshillin e Ministrave, ky i fundit ka rol aktiv dhe diskrecionar në drejtim të verifikimit të plotësimit të kushteve për paraqitjen e kërkesës për zgjatjen e afatit të miratimit të punimeve dhe miratimin ose refuzimin e kërkesës. Kjo, pasi ndonëse akti nënligjor i njeh kompetencën ministrisë së linjës për të propozuar miratimin ose refuzimin e kërkesës, mbetet gjithsesi në kompetencën e Këshillit të Ministrave marrja e vendimit përfundimtar për miratimin/refuzimin e zgjatjes së lejes. Rrjedhimisht është nën përgjegjësinë e tij ligjore miratimi i një vendimi të tillë, në drejtim të verifikimit të ekzistencës së kushteve që justifikojnë, apo jo këtë kërkesë (*shih paragrafin 44 po aty*). Disponimi i gjykatave të faktit sipas të cilit detyrohet Këshilli i Ministrave që të miratojë projektvendimet është i pabazuar në ligj, pasi gjykatat nuk mund t'i përcaktojnë paraprakisht vullnetin vendimmarrës një organi administrativ, para se ai ta shqyrtojë çështjen, sipas bindjes së tij dhe diskrecionit të vlerësimit që i jep ligji (*shih paragrafin 46 po aty*).

40. Gjykata vëren se sikurse është shprehur edhe Gjykata e Lartë, në nenin 24 të Rregullores së miratuar me Vendimin për Procedurat e Dhënies së Autorizimit është parashikuar se mbajtësi i autorizimit mund t'i paraqesë ministrisë përgjegjëse për energjinë një kërkesë me shkrim për zgjatjen e afatit të autorizimit, duke dhënë arsyet për zgjatjen e kërkuar dhe se

ministria në fjalë, nëse e sheh të arsyeshme, pranon zgjatjen e afatit të autorizimit dhe vazhdon procedurat për miratimin e saj në Këshillin e Ministrave ose në të kundërt, i propozon Këshillit të Ministrave heqjen e autorizimit. Po kështu, sipas këtyre parashikimeve, çdo zgjatje e afatit të autorizimit për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë mund të jepet vetëm një herë dhe mund të jetë jo më e gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit, që përcaktohet në autorizim dhe se mbajtësi i autorizimit njofton me shkrim ministrinë përgjegjëse për energjinë, jo më vonë se 60 ditë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në autorizim, kur ai e ka të qartë se nuk mund të jetë në gjendje të përmbushë afatin përkatës (*shih paragrafin 38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nga ana tjetër, sipas shkronjës "c" të nenit 9 të Ligjit për Këshillin e Ministrave, sekretari i përgjithshëm kthen në bazë të argumenteve ligjore projektaktet e paraqitura për shqyrtim, kur ato bien në kundërshtim me Kushtetutën ose me ligjin. Ndërsa në nenin 24, pika 3, të po këtij ligji, përcaktohet se sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave jua kthen për plotësim ministrave propozues projektaktet, kur ato nuk përmbushin kriteret dhe kushtet e paraqitjes së tyre, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet e Këshillit të Ministrave, në bazë e për zbatim të tij (*shih paragrafin 45 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

41. Për sa më lart, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të saj.

42. Sipas *njërit qëndrim* u vlerësua se pretendimi i kërkueseve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i bazuar, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse ka analizuar parashikimet ligjore që gjejnë zbatim në interpretimin e rrethanave dhe fakteve të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, nuk i ka trajtuar ato të ndërvarura me njëra-tjetrën, duke mos mbajtur në konsideratë faktin se kërkueset kanë qenë në pamundësi objektive dhe përtej vullnetit të tyre për të përmbushur dhe realizuar projektin sipas autorizimeve të marra nga Këshilli i Ministrave. Ajo nuk ka marrë parasysh se ndërmjet kërkueseve dhe institucioneve vendore dhe qendrore ka pasur një komunikim aktiv dhe të shpeshtë për të zgjidhur situatën e krijuar nga bashkia dhe jo nga kërkueset. Konkretisht, në proces janë përfshirë 5 institucione të nivelit qendror – Këshilli i Ministrave, MIE-ja, Ministria e Financave, MSHMS-ja dhe AZHT-ja, të cilat edhe ndërmjet tyre kanë pasur komunikime për sa i takon interpretimit ligjor për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, megjithëse ligji e parashikonte qartësisht

nivelin e taksës, gjë e cila u konfirmua edhe nga Ministria e Financave. Situata e krijuar nga bashkia ndërkohë ka sjellë pengesa që kërkueset të përmbushnin në kohë detyrimet e tyre. Kjo çështje dhe dinamikat e saj nuk janë analizuar dhe as vlerësuar me objektivitet nga Gjykata e Lartë, duke bërë që arsyetimi i saj formalisht të mbështetet vetëm në parashikimet ligjore pa marrë në konsideratë rrethanat dhe faktet e çështjes, për më tepër të provuara dhe të pranuara edhe nga vetë institucionet. Në këtë kontekst, pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë rezulton të jetë formaliste dhe jokoherente në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese. Thënë kjo, interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit, duke e bërë atë formalist. Parë në këtë këndvështrim, kërkesa duhet pranuar dhe Gjykata duhet të disponojë shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.[2]

43. Ndërsa sipas *qëndrimit tjetër*, pretendimi i kërkueseve për cenimin e standardit të arsyetimit është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë arsye të mjaftueshme për vlerësimin e saj në raport me dispozitat ligjore të aplikueshme që e kanë çuar në zgjidhjen e çështjes sipas përmbajtjes së dispozitivit. Vendimi rezulton të jetë i qartë në përmbajtje dhe pjesët përbërëse të tij janë të lidhura me njëra-tjetrën, ndërsa pjesa arsyetuese paraqet interpretimin ligjor bazuar në rrethanat dhe faktet e çështjes, që nuk përmban gabime faktike ose ligjore. Për rrjedhojë, në kundërshtim nga sa kërkueset pretendojnë, interpretimi nga Gjykata e Lartë i kuadrit ligjor të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, nga këndvështrimi kushtetues, nuk rezulton të jetë i paarsyeshëm, duke qenë se ajo si gjykatë ligji ka parashtruar në vendimin e saj në mënyrë të plotë të gjitha argumentet ligjore mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundimin e paraqitur në dispozitiv. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë nuk ka cenuar standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor e rrjedhimisht kërkesa duhet rrëzuar.[3]

44. Në përfundim, Gjykata konkludon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të saj, kërkesa e kërkueseve konsiderohet e rrëzuar.

[2] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

[3] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi dhe Ilir Toska.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 02.12.2025
Shpallur më 13.01.2026

Vendim nr. 77, datë 02.12.2025
(V-77/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 02.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 12 (K) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **KLODIANA CANKJA**, përfaqësuar nga avokat Rezart Tërshana, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE, përfaqësuar nga Enkela Dudushi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE, KRYEMINISTRIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim.

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK, përfaqësuar nga Gjergji Moçka.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatja e shtetit, Irma Qosja.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr.1060 (86-2023-1406), datë 14.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4952, datë 11.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 5, 18, 43, 44, 49, 107, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe**

2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 71 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet dhe prapësimet me shkrim të kërkueses Klodiana Cankja (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Kryeministrisë së Republikës së Shqipërisë (*Kryeministria*), Departamentit të Administratës Publike (*DAP*) dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Prokurimit Publik (*APP*), i cili ka vënë në dijeni Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) me shkresën nr. 3929 prot., datë 18.06.2025 se nuk ka vendimmarrje të tij për kërkuesen dhe vendimi nr. 311/2, datë 04.02.2014 është nxjerrë nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, duke njoftuar edhe Avokaturën e Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka ushtruar detyrën e drejtoreshës së përgjithshme të APP-së prej vitit 2005, ndërsa në vitin 2008 ka fituar statusin e nëpunësit civil. Në vijim, me shkresën e datës 27.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, kërkuesja është vënë në dijeni për fillimin e procedurës disiplinore të nisur ndaj saj, me pretendimin e disa shkeljeve disiplinore në ushtrimin e detyrës së saj, si: (i) moszbatimi dhe tejkalimi i funksioneve të përcaktuara me ligj nga APP-ja për propozimet për marrje masash disiplinore; (ii) mosverifikimi rast pas rasti i sistemit elektronik nga APP-ja dhe i zbatimit të procedurave të prokurimeve publike pas nënshkrimit të kontratës, duke sjellë si pasojë shpalljen e fituesit pa

përfunduar afatet ankimore; (iii) moskërkimi i mendimit nga Komisioni i Prokurimit Publik për propozimet ose problematikat që ky i fundit mund të ketë hasur me kuadrin ligjor për sa u përket propozimeve për ndryshime ligjore të vitit 2012 në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (*ligji nr. 9643/2006*), të shfuqizuar dhe në ligjin nr. 125, datë 25.04.2013 "Për koncensionet dhe partneritetin publik-privat" (*ligji nr.125/2013*), si dhe është ftuar të japë sqarime me shkrim, të dëgjohet vetë ose me përfaqësues ligjorë apo të paraqesë dëshmitarë, duke caktuar datën 30.01.2014 për shqyrtimin e shkeljeve.

2. Me shkresën e datës 30.01.2014, kërkuesja ka dërguar sqarimet me shkrim pranë sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, duke pretenduar se nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument ose material, në mënyrë që të marrë dijeni për rastet e referuara si shkelje të ligjit të prokurimit publik, duke i hequr mundësinë të mbrohet e të ketë trasparencë për shkeljet e pretenduara. Në vijim, me vendimin nr. 311/2 prot., datë 04.02.2014 *(vendimi për largimin nga detyra)* sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ka marrë ndaj kërkueses masën disiplinore të largimit nga shërbimi civil për të njëjtat shkelje të konstatuara me shkresën e tij të datës 27.01.2014 për fillimin e ecurisë disiplinore.

3. Duke mos qenë dakord me vendimin e largimit nga detyra, kërkuesja ka paraqitur padi kundër Këshillit të Ministrave, duke kërkuar: (i) anulimin e aktit administrativ, vendimit për largimin nga detyra; (ii) kthimin në pozicionin e mëparshëm; (iii) pagimin e pagës nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ditën e riemërimit në detyrë.

4. Me vendimin nr. 2780, datë 29.05.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se Këshilli i Ministrave nuk ka legjitimitet pasiv për të qenë palë në procesin gjyqësor, pasi procedura është ndjekur nga Kryeministria. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3926, datë 17.11.2016, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3581, datë 28.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

5. Në datën 31.01.2017 kërkuesja i është drejtuar sërish me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër DAP-it, sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Kryeministrisë dhe APP-së, duke kërkuar: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit për largimin nga detyra; (ii) kthimin në vendin e punës ose në një pozicion të

barasvlershëm me të; (iii) dhënien e pagës si drejtoreshë e përgjithshme e APP-së ose të një pozicioni të barasvlershëm me të nga data 03.04.2014 deri në ditën e kthimit në vendin e punës.

6. Me vendimin nr. 2056 (80-2017-2092), datë 15.05.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1060 (86-2023-1406), datë 14.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4952, datë 11.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr.49/2012*).

9. Në datën 11.03.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 19.03.2025. Në datën 27.05.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 03.06.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 02.12.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak se kishte marrë pjesë në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues individual.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

10.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial,* pasi Kolegji Administrativ nuk ka dhënë asnjë argument përse pretendimet e kërkueses, të ngritura në rekurs, nuk përbëjnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, ndërkohë që pretendohej zbatimi i gabuar i ligjit material e procedural dhe mosrespektimi i praktikës gjyqësore të Kolegjit Administrativ.

Në këtë mënyrë gjykatat i kanë shkelur kërkueses të drejtën për garancitë dhe trajtimin e nëpunësve publikë, të garantuar nga nenet 4 dhe 107 të Kushtetutës.

10.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, nga pala kundërshtare në procesin gjyqësor nuk është depozituar asnjë provë që të vërtetonte ndjekjen e procedurave të parashikuara nga legjislacioni për largimin nga shërbimi të një nëpunësi civil.

10.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi në rekurs kërkuesja ka argumentuar se gjykatat e faktit, teksa kanë arsyetuar se ligji i zbatueshëm në çështjen e saj ishte ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" (*ligji nr.8549/1999*), kanë vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 00-2014-730, datë 06.03.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit ligji nr.152, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" (*ligji nr.152/2013*) ishte i zbatueshëm nga data e hyrjes në fuqi të tij (01.10.2013) për të gjitha çështjet që ishin në shqyrtim nga gjykatat, për sa kohë për to nuk kishte ende një vendim gjyqësor të formës së prerë.

10.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka pasqyruar kërkimet dhe argumentet e kërkueses në vendimmarrjen e tij, si dhe nuk ka arsyetuar përse kundërshtimet e ngritura nga kërkuesja dhe që lidhen me zbatimin e ligjit dhe me praktikat e tjera identike të Gjykatës së Lartë, nuk përfshihen në rastet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Argumentet e dhëna nga gjykatat e faktit janë kontradiktore, pasi edhe pse kanë konstatuar se asnjë nga shkeljet e pretenduara nga pala e paditur nuk bën referim në situata konkrete të kryera nga kërkuesja në shkelje të ligjit për prokurimin publik, në vendimmarrje kanë vlerësuar se vendimi i sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave nuk është një akt absolutisht i pavlefshëm. Gjykatat e faktit në arsyetimin e tyre për rrëzimin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të vendimit të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, kanë referuar në vendimmarrjet e gjykatave të faktit të cilat kanë rrëzuar padinë e kërkueses për

pavlefshmërinë relative për shkak të ndërgjyqësisë së gabuar, pa shqyrtuar në themel kërkimet e kërkueses paditëse.

10.2. *Të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* dhe *parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi gjykatat e faktit kanë shfaqur qasje të ndryshme për çështje identike, për të cilat ka edhe praktikë nga Gjykata e Lartë.

11. ***Subjektet e interesuara, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Kryeministria*** dhe ***Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar, si vijon:

11.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial* nuk qëndron, pasi pretendimet e kërkueses për mosmarrje përgjigje shteruese për shkeljen e së drejtës për garancitë dhe trajtimin e nëpunësve publikë nuk janë ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

11.2. Pretendimet për *cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* dhe *të parimit të barazisë para ligjit* nuk qëndrojnë, pasi kërkuesja nuk ka identifikuar asnjë fakt konkret që të tregojë anshmërinë ose mungesën e objektivitetit të gjykatave.

11.3. Pretendimi për *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit* nuk qëndron, pasi vlerësimi i fakteve dhe i provave të administruara, si dhe interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë arbitrar.

11.4. Pretendimi për *cenimin e parimit të sigurisë juridike* nuk qëndron, pasi për sa kohë që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë shprehur me vendim njësues për çështje të kësaj natyre, kërkuesi nuk mund të ketë pritshmëri të ligjshme për zbatimin e ligjit, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues ose njësues në lidhje me të. Kërkuesja nuk ndodhet në kushtet e një të drejte të fituar nga ligji ose gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, e cila të jetë vënë në dyshim nga vendimi i Gjykatës së Lartë.

11.5. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit* nuk qëndron, pasi gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar pretendimet e kërkueses, duke u dhënë përgjigje shteruese, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk plotësonte kushtet paraprake

të pranueshmërisë sipas nenit 480, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Verifikimi i shkaqeve të rekursit përmes procedurës seleksionuese është veprimtari e domosdoshme në funksion të garantimit të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj.

12. ***Subjekti i interesuar, DAP-i,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar, si vijon:

12.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron, pasi kërkuesja nuk ka përcaktuar se në cilat raste të ngjashme me çështjen e saj është respektuar ky parim, si dhe nëse ka pasur diskriminim ose favorizim të palëve të tjera ndërgjyqëse në gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në shqyrtimin e rekursit nga kolegji i Gjykatës së Lartë. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, referimi në vendimmarrje i vendimit pilot nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023 i të njëjtit kolegj, ku është trajtuar procedura e shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë së rekurseve dhe natyra seleksionuese e gjykatës, hedh poshtë pretendimin e saj për trajtim të pabarabartë ose diskriminues ndaj saj, veçanërisht në kushtet kur vendimi pilot ka për qëllim mbajtjen e qëndrimeve të njëjta për çështje të ngjashme gjatë procedurave seleksionuese.

12.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk qëndron, pasi vendimi i largimit nga detyra është nxjerrë në kohën kur zbatohej ligji nr. 8549/1999 për shkak të aktit normativ nr. 5, datë 30.09.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të Këshillit të Ministrave, që ka shtyrë fillimin e efekteve të ligjit të ri nr. 152/2013, edhe pse me pas ky akt u shfuqizua me vendimin nr. 5/2014 të Gjykatës, por pa pasoja prapavepruese në rastin e kërkueses, e cila e ka depozituar padinë në gjykatën e shkallës së parë në datën 31.01.2017, pra pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 5/2014 të Gjykatës. Vendimi nr. 00-2014-730, datë 06.03.2014, të cilit i referohet kërkuesja, nuk përbën vendim unifikues që mund t'i sillte pritshmëri të ligjshme në zgjidhjen e çështjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

12.3. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit lidhur me të drejtën e aksesit* nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk plotësonte kushtet

paraprake të pranueshmërisë sipas nenit 480, shkronja "a", të KPC-së. Për sa i përket pretendimit se procedura disiplinore është kryer në kundërshtim me ligjin, ka rezultuar se veprimet e sekretarit të përgjithshëm kanë qenë të rregullta dhe konform ligjit. Gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim dhe kanë analizuar e vlerësuar pretendimet e kërkueses, duke u dhënë përgjigje të arsyetuara, ndërkohë që këto pretendime janë përsëritur në rekursin e saj, duke mos përmbushur asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Gjykatat e faktit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim, pra nuk janë vendime diametralisht të kundërta, për të cilat Gjykata e Lartë do të duhet të kishte ushtruar një rol aktiv.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, Gjykata vëren se subjektet e interesuara, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Kryeministria dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se

kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, pasi pretendimet në drejtim *të së drejtës së aksesit substancial* për mosmarrje përgjigje shteruese për shkeljen e së drejtës për garancitë dhe trajtimin e nëpunësve publikë nuk i ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Për këtë pretendim Gjykata konstaton se kërkuesja i ka parashtruar argumentet e saj për shkeljen e procedurave ligjore prej të cilave rrjedh cenimi i thelbit të të drejtave të nëpunësit civil, të garantuara nga nenet 4 dhe 107 të Kushtetutës, si në ankimin drejtuar gjykatës së apelit, ashtu edhe në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkuesja e plotëson kriterin për shterimin e mjeteve juridike efektive, si për pretendimin për cenimin e aksesit substancial, ashtu edhe për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në kërkesën drejtuar Gjykatës. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 11.12.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në datën 11.03.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial*, *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimit të barazisë përpara ligjit dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.*

18. Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit,* të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe *të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, kërkuesja i ka ndërlidhur me pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se gjykatat e faktit kanë shfaqur qasje të ndryshme për çështje identike, për të cilat ka edhe praktikë nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, sipas saj, në rekurs ishin ngritur çështje të rëndësishme të zbatimit të ligjit (nuk duhej zbatuar ligji nr. 8549/1999, por ligji nr. 152/2013) dhe të praktikës gjyqësore (vendimi nr. 00-2014-730, datë 06.03.2014 i Kolegjit Administrativ), të cilat duhet të ishin trajtuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, subjektet e interesuara, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave,

Kryeministria dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se pretendimet e kërkueses nuk qëndrojnë, pasi nuk ka identifikuar asnjë fakt konkret për anshmëri ose mungesë objektiviteti të gjykatave, ndërkohë që nuk mund të ketë pritshmëri të ligjshme për zbatimin e ligjit në kushtet kur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë kryer një interpretim unifikues ose njësues në lidhje me të. Po kështu, subjekti i interesuar, DAP-i, ka prapësuar se kërkuesja nuk ka përcaktuar se cilat janë rastet e ngjashme me çështjen e saj, si dhe nëse ka pasur diskriminim ose favorizim të palëve të tjera ndërgjyqëse gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në shqyrtimin e rekursit nga kolegji i Gjykatës së Lartë. Sipas subjektit të interesuar, referimi i vendimit pilot nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023 i të njëjtit Kolegj Administrativ, ku është trajtuar procedura e shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë së rekurseve dhe natyra seleksionuese e gjykatës, hedh poshtë pretendimin e kërkueses për trajtim të pabarabartë ose diskriminues ndaj saj, veçanërisht në kushtet kur vendimi pilot ka për qëllim mbajtjen e qëndrimeve të njëjta për çështje të ngjashme gjatë procedurave seleksionuese.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të mbështesë *a priori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rastet e ekzistencës së vendimeve njësuese/unifikuese, gjykatat, duke mos analizuar çështjen konform këtyre vendimeve, cenojnë parimin e sigurisë juridike të kërkuesit për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate (*shih vendimin nr. 47, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar këtyre standardeve kushtetuese, në kushtet kur vendimet e referuara prej kërkueses nuk janë njësues/unifikues të praktikës gjyqësore, pra që të jenë të detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pretendimet e saj për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe parimit të sigurisë juridike nuk mund të merren në shqyrtim.

20. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit substancial, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të parimit të barazisë*

së armëve e të kontradiktoritetit, duke parashtruar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë analizuar në themel nëse ekzistojnë ose ajo shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, në mungesë të provave për shkeljet e pretenduara nga punëdhënësi, të cilat e bëjnë aktin administrativ absolutisht të pavlefshëm. Duke pasur parasysh thelbin e argumenteve dhe ndërlidhjen mes tyre, Gjykata vlerëson t'i analizojë ato në këndvështrim të së *drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*, të cilat janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

21. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ, në dhomën e këshillimit, nuk ka dhënë asnjë argument përse pretendimet e kërkueses të ngritura në rekurs nuk përbëjnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, ndërkohë që në rekurs janë argumentuar e analizuar në mënyrë të qartë shkaqet ligjore, zbatimi i gabuar i ligjit material e procedural, si dhe shkalla e shkeljes, e cila duhet të trajtohet sipas praktikave të ndryshme gjyqësore. Sipas kërkueses, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë shkelur të drejtën për garancitë dhe trajtimin e nëpunësve publikë, të garantuar nga nenet 4 dhe 107 të Kushtetutës. Po kështu, sipas kërkueses, gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, nga pala kundërshtare në procesin gjyqësor nuk është depozituar asnjë provë që të vërtetonte ndjekjen e procedurave të parashikuara nga legjislacioni për largimin nga shërbimi të një nëpunësi civil. Sipas kërkueses, Kolegji Administrativ nuk ka pasqyruar kërkimet dhe argumentet e kërkueses në vendimmarrjen e tij, si dhe argumentet e dhëna nga gjykatat e faktit janë kontradiktore, pasi edhe pse kanë konstatuar se asnjë nga shkeljet e pretenduara nga pala e paditur nuk bën referim në situata konkrete të kryera nga kërkuesja në shkelje të ligjit për prokurimin publik, në vendimmarrje kanë vlerësuar se vendimi i sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave nuk është një akt absolutisht i pavlefshëm. Sipas kërkueses, gjykatat e faktit, në arsyetimin e tyre për rrëzimin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të vendimit të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, kanë referuar në vendimmarrjet e gjykatave të faktit, të cilat kanë rrëzuar padinë e kërkueses për pavlefshmërinë relative

për shkak të ndërgjyqësisë së gabuar, pa shqyrtuar në themel kërkimet e kërkueses paditëse.

22. Subjektet e interesuara, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Kryeministria dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar pretendimet e kërkueses, duke u dhënë përgjigje shteruese, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk plotësonte kushtet paraprake të pranueshmërisë sipas nenit 480, shkronja "a", të KPC-së dhe verifikimi i shkaqeve të rekursit përmes procedurës seleksionuese është veprimtari e domosdoshme në funksion të garantimit të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas tyre, vlerësimi i fakteve dhe i provave të administruara, si dhe interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë arbitrar.

23. Subjekti i interesuar, DAP-i, ka prapësuar se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim dhe kanë analizuar e vlerësuar pretendimet e kërkueses, duke u dhënë përgjigje të arsyetuara, ndërkohë që këto pretendime janë përsëritur në rekursin e saj, duke mos përmbushur asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Sipas subjektit të interesuar, pretendimi i kërkueses se procedura disiplinore është kryer në kundërshtim me ligjin nuk qëndron, pasi ka rezultuar e rregullt dhe konform ligjit. Sipas subjektit të interesuar, gjykatat e faktit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim, pra nuk janë vendime diametralisht të kundërta, për të cilat Gjykata e Lartë do të duhet të kishte ushtruar një rol aktiv.

24. Lidhur me të drejtën e aksesit, Kushtetuta në nenin 42, pika 2, të saj sanksionon të drejtën e individit t'i drejtohet një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. E drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).* Megjithatë, zbatimi i këtij parimi vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes. Ndërsa ka pohuar se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë, Gjykata ka theksuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Kurse për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në fazën e shqyrtimit paraprak të rekurseve, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 22, datë 06.06.2011; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesja ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin thelbësor të parashtruar gjatë gjykimit të çështjes së saj, që ka të bëjë me (pa) ligjshmërinë e procedurës së nxjerrjes së aktit të largimit të saj nga detyra.

28. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesja, e cila ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të largimit nga detyra, kthimin në vendin e punës ose në një pozicion të barasvlershëm me të, si dhe dhënien e pagës si drejtoreshë e përgjithshme e APP-së ose pagën e një pozicioni të barasvlershëm me të nga data 03.04.2014 deri në ditën e kthimit në punë. Në padi kërkuesja ka parashtruar se largimi i saj nga shërbimi civil është bërë në mënyrë të paligjshme, pa u zbatuar procedurat ligjore, duke mos i vënë në dispozicion aktet që dokumentonin shkeljet konkrete të pretenduara se janë kryer prej saj. Kërkuesja, në thelb, ka pretenduar se procedura administrative (disiplinore) e ndjekur për lirimin e saj nga shërbimi civil ka qenë formale vetëm në dukje, për sa kohë në aspektin substancial asaj nuk i është garantuar e drejta e mbrojtjes, në kushtet kur shkeljet disiplinore të atribuara janë formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe, për më tepër, ato as nuk janë shoqëruar me aktet dokumentare që, sipas subjektit të interesuar, vërtetonin shkeljet. Ndonëse ajo ka kërkuar sqarime dhe aktet përkatëse dokumentare, kërkesa e saj nuk është marrë parasysh dhe asaj i është dhënë menjëherë masa disiplinore ekstreme e largimit nga shërbimi civil. Në këtë kuptim, sipas kërkueses, ajo është vënë në pamundësi për të paraqitur pretendimet dhe provat e saj për ekzistencën e fakteve dhe, po ashtu, për kualifikimin e tyre si shkelje disiplinore, sikundër në vijim edhe për rëndësinë e atyre shkeljeve, në pikëpamje të proporcionalitetit të masës disiplinore të propozuar.

29. Gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se pretendimet e kërkueses kishin të bënin me pavlefshmërinë relative të aktit të largimit nga detyra, duke arsyetuar se verifikimi i ligjshmërisë ose paligjshmërisë së aktit të largimit nga detyra nuk i përket gjykimit për pavlefshmëri absolute të aktit, pasi analiza e shkeljeve disiplinore të pretenduara nga organi punëdhënës është analizë e ligjit material dhe jo e atij procedural, ndaj bëhet në gjykimin për shfuqizimin e aktit dhe jo në atë për pavlefshmërinë absolute të tij. Më tej, gjykata e shkallës së parë ka evidentuar se ato pretendime ishin zgjidhur me vendimin gjyqësor përfundimtar të mëparshëm që kishte rrëzuar padinë për pavlefshmëri relative të aktit të largimit nga detyra, për shkak të moslegjitimimit pasiv të palës së paditur. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja, e cila ka pretenduar se nga provat e administruara në gjykimin në shkallë të parë dhe analiza ligjore e tyre, ka rezultuar e provuar se nuk është depozituar asnjë akt

dokumentues i shkeljeve të pretenduara nga punëdhënësi, duke mos u zbatuar në këtë mënyrë procedurat ligjore të kërkuara nga legjislacioni për nxjerrjen e aktit të largimit nga detyra.

30. Ndërkohë, gjykata e apelit është ndalur fillimisht në natyrën e gjykimit, duke iu referuar neneve 35 dhe 37 të ligjit nr. 49/2012, të cilat kanë parashikuar se është detyrim i organit publik të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit dhe të fakteve të parashtruara e të vëna në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë, si dhe është gjykata ajo që shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore e faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Sipas asaj gjykate, edhe pse është konstatuar se organi administrativ që ka disponuar me aktin e largimit nga shërbimi civil nuk i ka shoqëruar me praktika konkrete kategoritë e shkeljeve të pretenduara se janë kryer nga kërkuesja, në mënyrë që kjo e fundit të provonte para gjykatës se shkeljet disiplinore që i vihen në ngarkim nuk qëndrojnë, në thelb ato janë shkaqe që ligjvënësi i lidh me rastet e paligjshmërisë të aktit administrativ, sipas nenit 118 të Kodit të Procedurës Administrative *(KPA),* të cilat pasi janë shqyrtuar, janë rrëzuar nga gjykatat e faktit në procesin për pavlefshmëri relative të aktit administrativ. Akti i largimit nga detyra nuk paraqet elemente të pavlefshmërisë absolute, pasi është marrë nga një organ administrativ i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij të përcaktuar në nenin 8 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", nenin 25 të ligjit nr. 8549/1999 (ligji i zbatueshëm në momentin e largimit të kërkueses nga shërbimi civil) dhe VKM-së nr. 306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil". Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesja, e cila ka pretenduar sërish se gjatë gjykimit nuk është paraqitur asnjë akt që të vërtetojë ndjekjen e procedurave të parashikuara nga ligji për nxjerrjen e aktit të largimit nga detyra, si dhe mungesa e provave shkresore e ka kthyer në një akt absolutisht të pavlefshëm. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

31. Për sa më sipër Gjykata vëren se, ndonëse në objektin e padisë së kërkueses është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit për largimin e saj nga shërbimi civil mbi shkakun se ai është nxjerrë në

kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, duke iu referuar për këtë KPA-së në fuqi (neni 116, shkronja "c"), gjykatat e zakonshme të faktit, këtij pretendimi të kërkueses, i janë përgjigjur se, në thelb, përmes tij, kundërshtohej ligjshmëria e aktit administrativ, pra synohej pavlefshmëria relative e tij sipas nenit 118 të KPA-së, çka, sipas tyre, përbënte gjë të gjykuar. Po ashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar edhe se akti i largimit nga detyra nuk paraqet elemente të pavlefshmërisë absolute, pasi është marrë nga një organ administrativ i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij, referuar shkronjave "a" dhe "b" të nenit 116 të KPA-së, por pa vënë në diskutim dhe kthyer përgjigje për shkakun e pretenduar nga kërkuesja sipas shkronjës "c" të këtij neni. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, megjithëse ndodhej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, atë të së drejtës së aksesit, në ushtrim të funksionit të saj dhe parimit të subsidiaritetit duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkueses. Mospranimi i rekursit të kërkueses nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkueses.

32. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4952, datë 11.12.2024 të Kolegjit

Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 02.12.2025
Shpallur më 17.02.2026

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Klodiana Cankja, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr.1060, datë 14.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-4952, datë 11.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit",* jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, pasi vlerësoj se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesja është larguar nga detyra e drejtoreshës së përgjithshme të APP-së pas marrjes së masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për shkelje të procedurave disiplinore në ushtrimin e detyrës së saj. Duke mos qenë dakord me vendimin e largimit nga detyra, kërkuesja ka paraqitur padi kundër Këshillit të Ministrave, duke kërkuar anulimin e këtij vendimi, rikthimin në pozicionin e punës, si dhe pagimin e pagës. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë për shkak të moslegjitimimit pasiv të palës së paditur, qëndrim i mbajtur edhe nga gjykata e apelit, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të saj. Në vijim, kërkuesja i është drejtuar sërish gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të largimit nga detyra, kthimin në vendin e punës ose në një pozicion të barasvlershëm me të, si dhe dhënien e pagës si drejtoreshë e përgjithshme e APP-së ose pagën e një pozicioni të barasvlershëm me të nga data 03.04.2014 deri në ditën e kthimit në punë. Në padi kërkuesja ka parashtruar se largimi i saj nga shërbimi civil është bërë në mënyrë të paligjshme, pa u zbatuar procedurat ligjore, duke mos i vënë në dispozicion aktet që dokumentonin shkeljet konkrete të pretenduara se janë kryer prej saj. Kërkuesja, në thelb, ka pretenduar se procedura administrative (disiplinore) e ndjekur për lirimin e saj nga shërbimi civil ka qenë formale vetëm në dukje, për sa kohë në aspektin substancial asaj nuk i është garantuar e drejta e mbrojtjes, në kushtet kur shkeljet disiplinore të atribuara janë formuluar në mënyrë

të përgjithshme dhe, për më tepër, ato as nuk janë shoqëruar me aktet dokumentare që, sipas subjektit të interesuar, vërtetonin shkeljet. Ndonëse ajo ka kërkuar sqarime dhe aktet përkatëse dokumentare, kërkesa e saj nuk është marrë parasysh dhe asaj i është dhënë menjëherë masa disiplinore ekstreme e largimit nga shërbimi civil. Në këtë kuptim, sipas kërkueses, ajo është vënë në pamundësi për të paraqitur pretendimet dhe provat e saj për ekzistencën e fakteve dhe, po ashtu, për kualifikimin e tyre si shkelje disiplinore, sikundër në vijim edhe për rëndësinë e atyre shkeljeve, në pikëpamje të proporcionalitetit të masës disiplinore të propozuar.

3. Në këto kushte, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke ngritur, ndër të tjera, disa pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të cilat shumica ka vendosur t'i analizojë në drejtim të cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit.

4. Konkretisht, shumica, pasi ka konstatuar se kërkuesja si në ankim, ashtu edhe në rekurs ka pretenduar se gjatë gjykimit nuk është paraqitur asnjë akt që të vërtetojë ndjekjen e procedurave të parashikuara nga ligji për nxjerrjen e aktit të largimit nga detyra, duke e kthyer atë në një akt absolutisht të pavlefshëm, ka analizuar faktin nëse Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim dhe u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkueses. Sipas shumicës, ndonëse në objektin e padisë së kërkueses është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit për largimin e saj nga shërbimi civil, mbi shkakun se ai është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, duke iu referuar për këtë KPA-së në fuqi (neni 116, shkronja "c"), gjykatat e zakonshme të faktit këtij pretendimi të kërkueses i janë përgjigjur se, në thelb, përmes tij kundërshtohej ligjshmëria e aktit administrativ, pra synohej pavlefshmëria relative e tij sipas nenit 118 të KPA-së, çka, sipas tyre, përbënte gjë të gjykuar. Po ashtu, sipas shumicës, gjykata e apelit ka arsyetuar se akti i largimit nga detyra nuk paraqet elemente të pavlefshmërisë absolute, pasi është marrë nga një organ administrativ i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij, referuar shkronjave "a" dhe "b" të nenit 116 të KPA-së, por pa vënë në diskutim dhe kthyer përgjigje për shkakun e pretenduar nga kërkuesja sipas shkronjës "c" të këtij neni.

5. Ndërkohë, sipas shumicës, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, megjithëse ndodhej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, atë të së drejtës së aksesit, në ushtrim të funksionit të saj dhe parimit të subsidiaritetit, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit

të kërkueses. Sipas shumicës, mospranimi i rekursit të kërkueses nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkueses, si dhe të çon në përfundimin se pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar (*shih paragrafët 31-32 të vendimit*).

6. Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës në lidhje me këtë pretendim, pasi vlerësoj se Gjykata e Lartë ka vepruar brenda rolit dhe funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit. Në këtë kuptim, sikurse thekson edhe shumica, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, Gjykata në çdo rast nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka arsyetuar se nuk plotësohen kushtet për pranueshmërinë e tij, pasi shkaqet e rekursit haptazi nuk mbështeten në asnjë nga rastet e

parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, që bën të mundur cenimin në thelb të vendimit të gjykatës së apelit, si dhe është detyrë e kërkueses të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë shkaqet ligjore lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural. Kjo do të thotë se Gjykata e Lartë, ndonëse nuk është shprehur specifikisht lidhur me pretendimin e kërkueses për të drejtën e aksesit, në ushtrim të funksionit të saj, për sa kohë ka vlerësuar se nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë lejuar shkelje procedurale që do ta bënin të pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e saj (*shih paragrafin 7 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), ka çmuar të drejtë qëndrimin dhe interpretimin ligjor që ka bërë kjo e fundit për mënyrën e zbatimit të ligjit.

9. Prandaj jam i mendimit se interpretimi që gjykata e apelit ka bërë, se akti i largimit nga detyra nuk paraqet elemente të pavlefshmërisë absolute, pasi është marrë nga një organ administrativ i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij të përcaktuar në nenin 8 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", nenin 25 të ligjit nr. 8549/1999 (ligji i zbatueshëm në momentin e largimit të kërkueses nga shërbimi civil) dhe VKM-në nr. 306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", duket se është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë. Për më tepër, fakti që Gjykata e Lartë ndodhej në kushtet e dy vendimeve me qëndrime të njëjta të dy gjykatave më të ulëta, nuk e detyron këtë gjykatë të shprehet në mënyrë të zgjeruar për secilin pretendim ose për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta *(shih vendimet nr. 39, datë 25.06.2015; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo edhe në linjë me jurisprudencën kushtetuese, e cila ka pranuar se arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e saj (*shih vendimet nr. 16, datë 12.03.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, nuk duket të jetë arbitrare dhe e paarsyeshme.

10. Për më tepër, sikurse rezulton nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore, kërkuesja e ka ushtruar të drejtën e saj të paraqitjes së ankimit/rekursit, ku përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e saj, në veçanti për pavlefshmërinë absolute të aktit të largimit nga detyra, duke iu garantuar në këtë mënyrë edhe e drejta e aksesit. Siç e ka theksuar Gjykata në disa raste, aksesi në gjykatë nuk është një e drejtë absolute,

por ai mund të kufizohet në interes të parimeve të tjera të rëndësishme kushtetuese, si siguria juridike dhe në çdo rast është e nevojshme që subjektet e së drejtës të tregojnë diligjencën e duhur qoftë në drejtim të respektimit të afateve procedurale, qoftë në drejtim të mirëformulimit të pretendimeve të tyre.

11. Në përfundim, unë, gjyqtari në pakicë, vlerësoj se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtar: Genti Ibrahimi

Vendim nr. 78, datë 03.12.2025
(V-78/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Asim Vokshi, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 03.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 7 (K) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KLEANT KESHI (alias GENTIAN HYSA),** përfaqësuar nga avokat Ardian Visha, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1319 (184), datë 16.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Refuzimi i ekstradimit të shtetasit Kleant Keshi alias Gentian Hysa nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Italisë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, 134, pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj *(KEDNJ)*; nenet 27, 49, pika 3, shkronja "e", 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, Kleant Keshi (alias Gentian Hysa) (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është deklaruar fajtor nga gjykatat italiane në tre procese penale, konkretisht: (i) për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", të parashikuar nga neni 73 i ligjit nr. 309/1990 dhe neni 240 i Kodit Penal Italian, për të cilën është dënuar me 4 vjet e 4 muaj burgim, me gjobë në masën 18.000 euro, si dhe me dënim plotësues "Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike"; (ii) për veprat penale "Dëmtimi" dhe "Kundërshtimi i zyrtarit publik", të parashikuara nga nenet 337, 582 dhe 576 të KP-së italiane, në rrethana cilësuese, për të cilat është dënuar me 5 muaj burgim; (iii) për veprat penale "Vjedhja", në rrethana rënduese dhe "Kundërshtimi i zyrtarit publik", të parashikuara nga nenet 624, 625, paragrafi 7, 337 dhe 99, paragrafi 4, të KP-së italiane, për të cilat është dënuar me 1 vit burgim. Mbi bazën e këtyre vendimeve gjyqësore, prokurori pranë Gjykatës së Apelit Torino ka nxjerrë urdhrin nr. SIEP 939/2020, datë 15.12.2020, duke përcaktuar ndaj kërkuesit dënimin përfundimtar me 5 vjet e 5 muaj e 27 ditë burgim për të tria dënimet penale të vendosura ndaj tij, për të cilat ka kërkuar arrestimin e përkohshëm, me qëllim ekstradimin dhe, mbi bazën e këtij urdhri, në datën 07.01.2021 kërkuesi është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, Itali.

2. Në datën 13.01.2021 kërkuesi është arrestuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër *(Prokuroria e Dibrës)* i ka kërkuar asaj gjykate vleftësimin të ligjshëm të arrestit të përkohshëm, me qëllim ekstradimin e tij në Itali. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 6, datë 16.01.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurisë "Arresti në burg". Këtë vendim kërkuesi e ka kundërshtuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 115, datë 05.02.2021, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës

së shkallës së parë nr. 6, datë 16.01.2021. Kërkuesi, më pas, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër kërkesën me objekt shuarjen/revokimin e masës së sigurisë "Arresti në burg", të caktuar me vendimin nr. 6, datë 16.01.2021 të asaj gjykate, pasi, sipas tij, dënimi i mbetur për t'u ekzekutuar ishte tepër i shkurtër. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 27, datë 05.03.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Edhe këtë vendim kërkuesi e ka kundërshtuar me ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

3. Lidhur me themelin, Prokuroria e Dibrës ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër kërkesë për ekstradimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 28, datë 16.03.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë, duke lejuar ekstradimin e kërkuesit për zbatimin e urdhrit nr. SIEP 939/2020, datë 15.12.2020 të prokurorit pranë Gjykatës së Apelit të Torinos, për të tria çështjet penale për të cilat ishte gjykuar dhe dënuar, pasi nuk ekzistojnë rrethanat që përbëjnë pengesa ligjore të cilat nuk lejojnë ekstradimin dhe, po kështu, kërkesa plotëson kriteret procedurale dhe materiale për këtë qëllim. Kërkuesi në datën 24.03.2021 ka paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 258, datë 17.03.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket lejimit të ekstradimit për ekzekutimin e vendimit të dënimit të tij për veprat penale "Dëmtimi" dhe "Kundërshtimi i zyrtarit publik" dhe të vendimit për veprat penale "Vjedhja", në rrethana rënduese dhe "Kundërshtimi i zyrtarit publik", por e ka ndryshuar atë vendim, duke vendosur refuzimin e ekstradimit të kërkuesit për ekzekutimin e vendimit të dënimit të tij për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", pasi për këtë të fundit është parashkruar ndjekja penale sipas legjislacionit shqiptar dhe në bazë të parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale, kërkuesi nuk mund të ekstradohet. Vendimin nr. 258, datë 17.03.2022 të gjykatës së apelit e kanë kundërshtuar të dyja palët me rekurse në Gjykatën e Lartë.

5. Ndërkohë, pas dhënies së vendimit nr. 258, datë 17.03.2022, gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim edhe ankimin e kërkuesit ndaj vendimit nr. 27, datë 05.03.2021 të gjykatës së shkallës së parë, që kishte rrëzuar kërkesën e tij, me objekt: "Shuarje/revokim ose zëvendësim të masës shtrënguese të përkohshme "Arresti në burg"" *(shih paragrafin 2 të vendimit)*. Me vendimin nr. 278, datë 28.03.2022, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës, duke zëvendësuar masën "Arresti në burg", të caktuar

me vendimin nr. 6, datë 16.01.2021 të gjykatës së shkallës së parë, me masën "Arresti në shtëpi", sipas nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1250 (264), datë 13.10.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 258, datë 17.03.2022 të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 28, datë 16.03.2021 të gjykatës së shkallës së parë. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka arsyetuar se pretendimet e ngritura në rekursin e kërkuesit nuk janë të bazuara dhe për to ka marrë përgjigje të arsyetuar. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka vlerësuar se rekursi i prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë përmban shkaqe të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, të cilat lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykata e apelit, pasi në kushtet kur Republika e Italisë e ka pranuar me rezervë Protokollin e katërt shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin *(Konventa për Ekstradimin)*. Sipas saj, edhe pse shteti italian ka bërë rezervë në nenin 10, paragrafi 2, të Konventës në ndryshim nga shteti shqiptar, në këtë rast nuk zbatohet parimi i reciprocitetit, por ai i hierarkisë së akteve. Ky vendim i Gjykatës së Lartë është ankimuar nga kërkuesi në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata),* duke ngritur si pretendime cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me të drejtën e aksesit.

7. Prokuroria në datën 08.11.2022 ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal të lejimit të ekstradimit, i cili nuk është ekzekutuar për shkak të largimit të kërkuesit nga banesa, duke regjistruar ndaj tij procedimin penal nr. 451, datë 15.11.2022 për veprën penale "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal (*KP*).

8. Gjykata, me vendimin e saj nr. 48 të datës 11.10.2023, pasi e ka marrë çështjen në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit 00-2022-1250 (264), datë 13.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë atij kolegji.

9. Gjykata në vendimin e saj ka arsyetuar se Gjykata e Lartë është prirur nga shpejtësia në gjykimin e çështjes, duke e marrë në shqyrtim me prioritet në raport me çështjet e tjera të regjistruara, si dhe duke shkurtuar afatin ligjor të njoftimit me 20 ditë, pa dhënë arsye për këtë shkurtim dhe në rrethanat që as palët nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre në drejtim të shkurtimit të tij. Në këtë kuptim, Gjykata ka çmuar se mosrespektimi i afateve të publikimit të datës së seancës në faqen zyrtare të Gjykatës së

Lartë, si dhe mosnjoftimi nga ana e sekretarisë së kësaj gjykate të datës së seancës në adresën elektronike të depozituar nga avokati i kërkuesit, përbëjnë shkelje me natyrë thelbësore, vërtetimi i të cilave ka shkaktuar pamundësinë e kërkuesit për të marrë pjesë në gjykim. Me fjalë të tjera, këto shkelje procedurale të konstatuara kanë karakter të tillë që kanë passjellë kufizimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim për kërkuesin, gjykim i cili kishte interes të lartë për të, pasi lidhej drejtpërdrejt me kufizimin e së drejtës kushtetuese për të mos u dëbuar nga territori, përveçse me anë të ekstradimit. Bazuar në këto premisa, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, duhej të kishte respektuar rregullat e njoftimit të parashikuara nga neni 436 i KPP-së, në drejtim të njoftimit elektronik dhe afatit 30-ditor, për t'u dhënë palëve mundësinë të ushtronin të drejtën e tyre të mbrojtjes me cilësi dhe efektivitet, aq më tepër kur në rastin konkret duhej pasur në konsideratë fakti se vendimet e dhëna nga dy gjykatat e shkallëve më të ulëta ishin diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën dhe gjykata e apelit kishte dhënë vendim të favorshëm për kërkuesin.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në rishqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen dhe me vendimin nr. 00-2024-1319 (184), datë 16.07.2024 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 258, datë 17.03.2022 dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 28, datë 16.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Kolegji Penal ka arsyetuar se ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore që ai të ekstradohet dhe të vuajë dënimin në Itali dhe se rekursi i tij, ndryshe nga ai i prokurorit, nuk përmbush kërkesat e nenit 432 të KPP-së.

11. Në datën 17.02.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 15.04.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

12.1. *Cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës për t'u dëgjuar,* pasi në kushtet kur, referuar edhe ndryshimeve në KPP e vitit 2017, vendimi i Gjykatës së Lartë është vendim i formës së prerë, ajo gjykatë duhej ta kishte gjykuar

çështjen në seancë publike me praninë e palëve si një garanci shtesë për të drejtat e tij.

12.2. *Ekstradimi është lejuar pa ligj,* pasi është lejuar mbi një dënim të parashkruar sipas legjislacionit shqiptar dhe në kundërshtim me nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së, e cila parashikon se nuk mund të jepet ekstradimi "*kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar*". Ndërsa në nenin 32 të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 "*Për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë*", të ndryshuar *(ligji nr. 10193/2009)* parashikohet se përveç kushteve të parashikuara në KP dhe në KPP, ekstradimi i një personi në drejtim të një shteti të huaj lejohet kur ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk është parashkruar sipas *legjislacionit të shtetit kërkues.* Parashkrimi ka gjetur zbatim deri në ratifikimin e Protokollit të katërt shtesë, i cili ka riformuluar nenin 10 të Konventës, duke e ndaluar ekstradimin e shtetasve vetëm nëse vepra penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar në bazë të legjislacionit të palës kërkuese dhe jo më edhe të asaj të kërkuar. Republika e Italisë ka rezervuar të drejtën për të mos zbatuar nenin 10, paragrafi 2 të Konventës për Ekstradimin, kur kërkesa për ekstradim bazohet në vepra penale për të cilat ai shtet ka juridiksion sipas së drejtës së tij penale. Moszbatimi i parimit të reciprocitetit nga ana e vendit tonë i ka cenuar atij interesat dhe e ka vendosur shtetin shqiptar në një pozitë inferioriteti. Në zbatim të nenit 26 të Konventës për Ekstradimin, shteti italian nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues. Në këto kushte do të zbatohej ligji i brendshëm, pra neni 491, shkronja "ë", i KPP-së dhe kërkuesi nuk mund të ekstradohej.

12.3. *Ekstradimi është lejuar në mungesë të garancisë rishikuese dhe në kundërshtim me nenin 491, shkronja "f", të KPP-së,* sipas të cilit nuk mund të jepet ekstradimi kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit. Gjykata e Lartë e ka rrëzuar pretendimin e kërkuesit se atij nuk i është dhënë garancia rishikuese, duke vlerësuar se nuk ka argument konkret për këtë pretendim, pasi në KPP-në italiane është parashikuar instituti i rishikimit dhe i rivendosjes në afat. Lejimi i ekstradimit në kundërshtim me garancitë procedurale ka cenuar nenin 39 të Kushtetutës.

13. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar, si vijon:

13.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në seancë publike gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk qëndron, pasi parashikimi i bërë në nenin 462 të KPP-së (i cili lejon ekzekutimin e vendimit të ekstradimit vetëm pas vendimit të Gjykatës së Lartë) nuk ndryshon natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, por thjesht shtyn ekzekutimin e vendimit të lejimit të ekstradimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Policisë së Shtetit pas vendimit të Gjykatës së Lartë.

13.2. Pretendimi për faktin se ekstradimi është lejuar për një dënim të parashkruar sipas legjislacionit shqiptar dhe në kundërshtim me nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së nuk qëndron, pasi, neni 39, pika 2, i Kushtetutës parashikon se ekstradimi lejohet kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare dhe vetëm me vendim gjykate. Në rastin konkret të dyja shtetet janë nënshkruese të Konventës dhe protokolleve shtesë të saj dhe neni 10 (i ndryshuar) parashikon se ekstradimi lejohet në rastet kur ndjekja penale nuk është parashkruar sipas ligjit të vendit kërkues, pavarësisht nëse është parashkruar sipas ligjit të vendit të kërkuar. Ky përcaktim krijon konflikt me nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së dhe në rastin konkret, referuar nenit 122, pika 2, të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare kanë përparësi ndaj legjislacionit vendas. Kjo linjë arsyetimi është përdorur edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj njësues nr. 125, datë 22.05.2024. Në përfundim ky unanimitet jurisprudencial konfirmon se KPP-ja nuk duhet aplikuar në kushtet kur bie ndesh me Konventën për Ekstradimin.

13.3. Pretendimi për faktin se ekstradimi është lejuar në mungesë të garancisë rishikuese dhe në kundërshtim me nenin 491, shkronja "f", të KPP-së nuk qëndron, pasi nga aktet e dosjes së ekstradimit rezulton se kërkuesi në të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara në Itali është përfaqësuar me avokatë të zgjedhur prej tij dhe të paktën në njërën çështje ka qenë edhe personalisht i pranishëm në seancë. Po ashtu, ai, nëpërmjet të zgjedhurve të tij, ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit. Të gjitha këto fakte tregojnë se kërkuesi nuk përfiton nga shkaku ndalues i KPP-së.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se me vendimin e saj nr. 48 të datës 11.10.2023, ajo ka marrë në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen e kërkuesit dhe ka vendosur shfuqizimin e vendimit 00-2022-1250 (264), datë 13.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë atij kolegji për shkak të mosrespektimit të afateve të publikimit të datës së seancës dhe të mosnjoftimit të datës së seancës në adresën elektronike të kërkuesit. Ankimi kushtetues i kërkuesit është paraqitur pas rishqyrtimit të çështjes me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2024-1319 (184), datë 16.07.2024 (objekt kërkimi), për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së

drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit *(shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 17.02.2025, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet prej tij është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 16.07.2024, por rezulton se i është dërguar mbrojtësit të kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 16.10.2024. Në këto rrethana, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe faktin se ekstradimi është lejuar pa ligj dhe në mungesë të garancisë rishikuese.

20. Për sa i takon cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar, kërkuesi ka pretenduar se në kushtet kur referuar edhe ndryshimeve në KPP e vitit 2017, vendimi i Gjykatës së Lartë është vendim i formës së prerë, ajo gjykatë duhej ta kishte gjykuar çështjen në seancë publike me praninë e palëve si një garanci shtesë për të drejtat e tij.

21. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në seancë publike nuk qëndron, pasi parashikimi i bërë në nenin 462 të KPP-së nuk ndryshon natyrën kushtetuese të funksionit të Gjykatës së Lartë. Ky parashikim i vendosur në seksionin e ekzekutimit të vendimeve dhe jo në seksionin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë ka si *ratio legis* pamundësinë e vënies në ekzekutim të vendimit të lejimit të ekstradimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Policisë së Shtetit pa u realizuar kontrolli ligjor i vendimeve të gjykatave më të ulëta nga Gjykata e Lartë. Neni 462 i KPP-së nuk është rregullim i posaçëm gjykimi, por rregullim i posaçëm ekzekutimi. Gjithashtu, nëse ligjvënësi do të kishte dashur të shprehte vullnetin e tij në lidhje me natyrën e gjykimit të rekurseve me objekt ekstradimin, ndryshe nga shqyrtimi i rekurseve të tjera, do të kishte vendosur një parashikim të tillë në seksionin që parashikon gjykimin në Gjykatën e Lartë. Në konkluzion, neni 462 i KPP-së nuk determinon mënyrën e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë.

22. Gjykata vëren se, në thelb, pretendimi i kërkuesit lidhet me

ndryshimin e nenit 462 të KPP-së, i cili në pikën 3, shkronja "c", parashikon aktualisht se në rastin e ekstradimit vendimi i formës së prerë që vihet në ekzekutim është ai i Gjykatës së Lartë. Sipas kërkuesit, ky formulim detyron Gjykatën e Lartë, që në rastin e ekstradimeve, rekursin ta shqyrtojë në seancë publike, me pjesëmarrjen e palëve. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata çmon se ndryshimi ligjor në fjalë nuk ndryshon as kompetencat e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, as nuk prezanton ndonjë procedurë të veçantë të shqyrtimit të rekursit në rastet e ekstradimit. Ndryshimi ligjor ka të bëjë me kohën e ekzekutimit të vendimit penal në rastin e ekstradimeve, pra në ndryshim nga gjykimet e tjera penale, vendimi për ekstradimin merr formë të prerë dhe ekzekutohet, jo me dhënien e vendimit nga gjykata e apelit, por me dhënien e vendimit nga Gjykata e Lartë. Ky ndryshim ligjor duket që lidhet me faktin se procedura e ekstradimit synon dorëzimin e individit te një juridiksion penal i huaj, ndaj për të mbrojtur të drejtën themelore të individit për të mos u dëbuar, nga njëra anë, por edhe saktësinë e veprimeve në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, ligjvënësi ka zgjedhur këtë moment ekzekutimi, të ndryshëm nga rregulli i përgjithshëm. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se ndryshimi ligjor i nenit 462 të KPP-së ka të bëjë me ekzekutimin e vendimmarrjes dhe jo me procedurën e shqyrtimit të rekursit, pasi kjo e fundit zhvillohet sipas rregullave të zakonshme të parashikuara në nenet 432 e vijues të KPP-së. Lidhur me këto të fundit, ashtu siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë publike u përket vetë kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

23. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se ekstradimi është lejuar pa ligj dhe në mungesë të garancisë rishikuese. Nisur nga thelbi i kërkesës së kërkuesit, por edhe nga argumentet e parashtruara në ankimin e tij kushtetues individual, duket se ato në fakt kanë të bëjnë me të drejtën për të mos u dëbuar, të garantuar nga neni 39 i Kushtetutës, ndaj pretendimet e tij do të trajtohen në këndvështrim të kësaj të drejte.

24. Në këtë këndvështrim, kërkuesi ka dhënë dy argumente. Argumenti i parë i tij është se ekstradimi është lejuar në mungesë të garancisë rishikuese dhe në kundërshtim me nenin 491, shkronja "f", të KPP-së, sipas të cilit nuk mund të jepet ekstradimi kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë,

me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit. Për rrjedhojë, lejimi i ekstradimit në kundërshtim me garancitë e lartpërmendura procedurale ka cenuar të drejtën vetjake të kërkuesit për të mos u dëbuar, të garantuar në nenin 39 të Kushtetutës.

25. Lidhur me këtë argument të kërkuesit, subjekti i interesuar ka prapësuar se ai nuk qëndron, pasi nga aktet e dosjes së ekstradimit rezulton se kërkuesi në të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara në Itali është përfaqësuar me avokatë të zgjedhur prej tij dhe të paktën në njërën çështje ka qenë edhe personalisht i pranishëm në seancë. Po ashtu, ai, nëpërmjet të zgjedhurve të tij, ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit. Të gjitha këto fakte tregojnë se kërkuesi nuk përfiton nga shkaku ndalues i KPP-së.

26. Gjykata vëren se referuar akteve të dosjes gjyqësore, ku janë administruar edhe vendimet e autoriteteve italiane, rezulton se në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, në të gjitha proceset gjyqësore në Itali, ai është përfaqësuar me përfaqësues ligjorë, duke ushtruar në këtë mënyrë të gjitha të drejtat e tij procedurale, për rrjedhojë nuk rezulton të jetë dënuar në mungesë. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky argument i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

27. Argumenti i dytë i kërkuesit, që lidhet me pretendimin se ekstradimi është lejuar për një dënim të parashkruar sipas legjislacionit shqiptar dhe në kundërshtim me nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së, bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të shqyrtohet nga Gjykata në vijim në kuadër të së drejtës për të mos u dëbuar, të parashikuar nga neni 39 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për pretendimin lidhur me të drejtën për të mos u dëbuar

28. Kërkuesi ka pretenduar se ekstradimi është lejuar pa ligj, pasi është lejuar për një dënim të parashkruar sipas legjislacionit shqiptar dhe në kundërshtim me nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së, e cila parashikon se nuk mund të jepet ekstradimi "kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar". Çështja e parashkrimit është trajtuar edhe nga Protokolli i katërt shtesë i Konventës për Ekstradimin, i cili ka riformuluar nenin 10 të saj, duke ndaluar ekstradimin e shtetasve vetëm nëse vepra penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar në bazë të legjislacionit të palës kërkuese dhe jo më edhe të asaj të kërkuar. Republika e Italisë ka rezervuar të drejtën për të mos zbatuar nenin 10, paragrafi 2, të Konventës për Ekstradimin kur kërkesa për ekstradim bazohet në vepra penale për të

cilat ai shtet ka juridiksion sipas së drejtës së tij penale. Sipas kërkuesit, moszbatimi i parimit të reciprocitetit nga ana e vendit tonë i ka cenuar atij interesat dhe e ka vendosur shtetin shqiptar në një pozitë inferioriteti. Në zbatim të nenit 26 të Konventës për Ekstradimin, shteti italian nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues. Në këto kushte, sipas kërkuesit, do të duhej të zbatohej ligji i brendshëm, pra neni 491, shkronja "ë", i KPP-së dhe kërkuesi nuk mund të ekstradohej.

29. Subjekti i interesuar për këtë argument të kërkuesit ka prapësuar se ai nuk qëndron, pasi neni 39, pika 2, i Kushtetutës parashikon se ekstradimi lejohet kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare dhe vetëm me vendim gjykate. Në rastin konkret të dyja shtetet janë nënshkruese të Konventës për Ekstradimin dhe protokolleve shtesë të saj dhe neni 10 (i ndryshuar) parashikon se ekstradimi lejohet në rastet kur ndjekja penale nuk është parashkruar sipas ligjit të vendit kërkues, pavarësisht nëse është parashkruar sipas ligjit të vendit të kërkuar. Ky përcaktim krijon konflikt me nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së dhe në rastin konkret, referuar nenit 122, pika 2, të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare kanë përparësi ndaj legjislacionit vendas. Kjo linjë arsyetimi është përdorur edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj njësues nr. 125, datë 22.05.2024. Në përfundim, ky unanimitet jurisprudencial konfirmon se KPP-ja nuk duhet aplikuar në kushtet kur bie ndesh me Konventën për Ekstradimin.

30. Neni 39, pika 2, i Kushtetutës parashikon se "*ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor"*.

31. Gjykata në jurisprudencën e saj për nenin 39, pika 2, të Kushtetutës ka pohuar se togfjalëshi "vetëm me vendim gjyqësor" do të thotë se lejimi i ekstradimit vlerësohet përmes një procesi gjyqësor, i cili në këto raste duhet të përmbushë standardet e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe të materializuara në jurisprudencën kushtetuese *(shih vendimet nr. 48, datë 11.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ndërkohë që nga përmbajtja e neneve 5, 39 dhe 116 të Kushtetutës, si dhe nenit 10 të KPP-së, burimet e së drejtës që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin shqiptar janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të ratifikuara, parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të pranuara, si dhe dispozitat e KP-së dhe të KPP-së *(shih vendimin nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se me ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998 shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën për Ekstradimin dhe dy protokollet shtesë të saj. Sipas nenit 10 të kësaj Konvente: "*Ekstradimi nuk akordohet nëse parashkrimi i aktit ose i dënimit hyn në fuqi qoftë falë legjislacionit të palës që kërkon, qoftë nga ai i palës së kërkuar*". Gjithashtu, Gjykata konstaton se në datën 01.06.2014 ka hyrë në fuqi Protokolli i katërt shtesë i Konventës së lartpërmendur, i cili ka ndryshuar nenin 10 të saj, duke parashikuar: "1. *Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar është parashkruar sipas ligjit të palës kërkuese. 2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të palës së kërkuar.*". Shteti shqiptar e ka ratifikuar protokollin në fjalë me ligjin nr. 117/2013, datë 15.04.2013, ndërkohë që edhe pala italiane e ka ratifikuar protokollin duke vendosur rezervë për ndryshimet e bëra në nenin 10 të Konventës për Ekstradimin. Po ashtu, mes Italisë dhe Republikës së Shqipërisë është lidhur edhe marrëveshja dypalëshe e ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike për çështjet penale të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre", ndërkohë që marrëveshja nuk ka parashikim të ndryshëm nga Konventa.

33. Referuar Konventës për Ekstradimin, ekstradimi konsiston në një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar penal dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, në veçanti ekstradimi për jashtë shtetit, janë rregulluar më hollësisht nga KPP-ja dhe ligji nr. 10193/2009.

34. Për sa i përket legjislacionit vendas, neni 491 i KPP-së parashikon, midis të tjerash: *"Nuk mund të jepet ekstradimi [...] ë) kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar; f) kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit."*. Ndërsa neni 9 i ligjit nr. 10193/2009 ka parashikuar: "*Kërkesa e autoritetit gjyqësor të huaj pranohet nëse përmban garancitë për reciprocitet, të dhëna nga shteti kërkues, që përfshijnë pritshmërinë që ky shtet të ekzekutojë një kërkesë të ngjashme të drejtuar nga autoritetet gjyqësore vendase.*".

35. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Gjykata do të vlerësojë nëse ekstradimi i kërkuesit është bërë në respektim të nenit 39, pika 2, të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën vetjake për të mos u dëbuar, si dhe brenda përcaktimeve të legjislacionit penal në raport edhe me parimin e reciprocitetit.

36. Për kërkesën për lejimin e ekstradimit të paraqitur nga organi i akuzës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka arsyetuar se duhet lejuar ekstradimi i kërkuesit, në zbatim të urdhrit nr. SIEP 939/2020, datë 15.12.2020 të prokurorit pranë Gjykatës së Apelit të Torinos, për të tria çështjet penale për të cilat ishte gjykuar dhe dënuar, pasi nuk ekzistojnë rrethana që përbëjnë pengesa ligjore të cilat nuk lejojnë ekstradimin dhe, po kështu, kërkesa plotëson kriteret procedurale dhe materiale për këtë qëllim.

37. Gjykata e Apelit Tiranë, nga ana e saj, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket lejimit të ekstradimit për ekzekutimin e vendimit të dënimit të tij për veprat penale "Dëmtimi" dhe "Kundërshtimi i zyrtarit publik" dhe të vendimit për veprat penale "Vjedhja", në rrethana rënduese dhe "Kundërshtimi i zyrtarit publik", por e ka ndryshuar atë vendim, duke vendosur refuzimin e ekstradimit të kërkuesit për ekzekutimin e vendimit të dënimit të tij për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike". Ajo gjykatë i është drejtuar me shkresë Ministrisë së Drejtësisë për mendim për zbatimin e parimit të reciprocitetit, për sa kohë që Italia ka vendosur rezervë për nenin 10 (të ndryshuar) të Konventës. Në përgjigje Ministria e Drejtësisë ka parashtruar se Republika e Shqipërisë nuk ka ende një rezervë lidhur me nenin 10 që parashikon si arsye për refuzimin e ekstradimit vetëm parashkrimin e ndjekjes penale sipas ligjit të palës kërkuese dhe jo sipas ligjit të palës së kërkuar.

38. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se ndërsa për dy dënime Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka lejuar me të drejtë ekstradimin, për dënimin për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", për sa kohë në një rast analog Italia do të refuzonte zbatimin e paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës për Ekstradimin (të ndryshuar), ishte rasti që të zbatohej parimi i reciprocitetit. Në zbatim të nenit 41 të Konventës, vlerëson ajo gjykatë, Italia "*nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues*", për sa kohë që ka miratuar me rezervë Protokollin e katërt. Në kushtet e mësipërme, duke mos zbatuar normën e mësipërme konventore, ajo gjykatë ka zbatuar ligjin e brendshëm, nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së, sipas të cilit përbën kusht ndalues për ekstradimin rasti kur është parashkruar dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar.

39. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e prokurorit, ka arsyetuar se e gjen të bazuar në ligj atë dhe se gjykata e apelit në mënyrë të gabuar ka aplikuar si kriter ndalues të ekstradimit (vetëm për veprën penale prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike) kriterin e parashkrimit të ndjekjes penale nga shteti i kërkuar (shteti shqiptar). Ky interpretim i gjykatës së apelit vjen ndesh me Protokollin e katërt shtesë të Konventës për Ekstradimin (neni 10 i Konventës, i ndryshuar nga Protokolli i katërt shtesë), që parashikon se ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të palës së kërkuar. Gjithashtu, Kolegji Penal arsyeton edhe faktin se nuk ka një harmonizim të kuadrit ligjor shqiptar dhe normave të Protokollit të Katërt Shtesë të Konventës në raport me ligjin e brendshëm, lidhur me normën e zbatueshme për rastet e parashkrimit. Më tej, ai kolegj ka argumentuar se në bazë të parimit të hierarkisë së normave dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kanë epërsi mbi normat vendase në rast mospajtimi. Kolegji Penal ka argumentuar edhe faktin se pavarësisht se lidhur me nenin 10 të Konventës për Ekstradimin, shteti italian ka vendosur rezervë në zbatim, nga ana e Republikës së Shqipërisë nuk është bërë një gjë e tillë, si dhe nuk është kërkuar zbatimi i parimit të reciprocitetit mes vendeve.

40. Kolegji Penal në përfundim ka arsyetuar edhe për një shkresë të Ministrisë së Drejtësisë lidhur me çështjen (administruar nga Gjykata e Apelit Tiranë), ku sipas asaj gjykate konkludohet se parimi i reciprocitetit mund të zbatohet në rastet kur kërkues është shteti shqiptar dhe jo e kundërta, si në rastin konkret. Kjo mënyrë arsyetimi, sipas Kolegjit Penal, shkon në të njëjtën linjë edhe me vendimin njësues nr. 00-2024-1611 (125) datë 22.05.2024, ku, ndër të tjera, përcaktohet se për sa i takon zbatimit të parimit të reciprocitetit, ai është në vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë, si autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar, ndërkohë që gjykata vlerëson kushtet për lejimin e ekstradimit.

41. Duke mbajtur parasysh faktet e çështjes, rregullimet ligjore dhe konventore, si dhe standardet e mësipërme kushtetuese, fillimisht Gjykata vlerëson të verifikojë kriteret e sanksionuara në nenin 39, pika 2, të Kushtetutës. Në çështjen konkrete rezulton se Republika e Shqipërisë është palë në Konventën për Ekstradimin, po ashtu si shteti italian, ndërkohë që procedura e lejimit të ekstradimit për në shtetin italian të kërkuesit është bërë me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Lartë.

42. Duke mbajtur parasysh pretendimet e kërkuesit, në thelb, ai argumenton se disponimi i Gjykatës së Lartë për lejimin e ekstradimit

bie ndesh me pikën 2 të nenit 39 të Kushtetutës. Lidhur me arsyetimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur zbatueshmërinë e Konventës në raport me KPP-në, Gjykata vëren se neni 116 i Kushtetutës parashikon rendin juridik të normave, i cili në vetvete nuk përbën vetëm një radhitje të barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përftuar kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014; nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lexim të kombinuar të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe kanë epërsi ndaj ligjeve që nuk pajtohen me të. Në këtë drejtim Konventa për Ekstradimin dhe protokollet shtesë të saj renditen mbi legjislacionin penal vendas dhe kanë përparësi në zbatim ndaj tij. Në këtë kontekst, Gjykata evidenton se në kushtet e një përplasjeje normash mes nenit 10 të ndryshuar të Konventës për Ekstradimin dhe nenit 491, shkronja "ë", të KPP-së, janë normat e Konventës për Ekstradimin që gjejnë zbatim, përfundim ky i arritur edhe nga Kolegji Penal në vendimin objekt shqyrtimi. Pra, në kushtet kur nuk është parashkruar dënimi në vendin kërkues, pavarësisht nëse është parashkruar në vendin e kërkuar, ekstradimi do të lejohet. Për më tepër, ky përfundim i Kolegjit Penal është në të njëjtën linjë dhe nuk bie në kundërshtim as me vendimin njësues të Kolegjit Penal nr. 00-2024-1611, i Vendimit (125), datë 22.05.2024 i cili e ka njësuar tashmë praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e Konventës për Ekstradimin me përparësi mbi legjislacionin vendas.

43. Kërkuesi gjithashtu, e ka lidhur të drejtën për të mos u dëbuar edhe me argumentin se Republika e Shqipërisë duhej të kishte zbatuar parimin e reciprocitetit ndaj palës italiane, duke mos lejuar ekstradimin e tij për sa kohë kjo e fundit kishte vendosur rezervë për nenin 10 të Konventës për Ekstradimin. Gjykata ka vlerësuar se parimi i reciprocitetit presupozon zbatimin e mjeteve ligjore të ndërsjella në marrëdhëniet ndërshtetërore. Në të drejtën ndërkombëtare reciprocitet do të thotë e drejta për barazi dhe respekt të ndërsjellë midis shteteve. Kështu, në bashkëpunim në fushën penale, doktrina dhe praktika ndërkombëtare kanë konfirmuar që bashkëpunimi i shteteve mund të bëhet edhe në mungesë të traktateve dypalëshe, bazuar në parimin e reciprocitetit *(shih vendimin nr. 13, datë 12.07.2004 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjithashtu, parimi i reciprocitetit,

si rregull, zbatohet nëpërmjet instrumenteve ndërkombëtare, si traktatet e marrëveshjet, në të cilat parashikohen të drejtat e detyrimet e ndërsjella. Por, në raste të veçanta, në mungesë të këtyre marrëveshjeve, shtetet nuk pengohen që të zbatojnë drejtpërdrejt parimin e reciprocitetit, normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe vullnetin e mirë në rastet që u paraqiten. Zbatimi i tyre është në interes të forcimit të bashkëpunimit mes shteteve në luftë kundër krimit të organizuar dhe kriminalitetit në përgjithësi *(shih vendimin nr. 13, datë 12.07.2004 të Gjykatës Kushtetuese)*.

44. Mbi këto premisa, Gjykata mban parasysh se reciprociteti është një parim i së drejtës ndërkombëtare që kryesisht zbatohet midis shteteve në mungesë të traktateve dhe marrëveshjeve. Megjithatë, në rastin konkret vetë Konventa e parashikon atë të zbatueshëm në rastin e saj në nenin 26 midis shteteve nënshkruese, të cilat kanë paraqitur rezerva për pjesë të caktuara të Konventës për Ekstradimin ose të protokolleve shtesë të saj, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret me shtetin italian. Parimi i reciprocitetit gjen gjithashtu zbatim edhe në nenin 9 të ligjit nr. 10193/2009.

45. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se në rastin konkret nuk rezulton që Shqipëria të ketë paraqitur rezervë për ndryshimet e nenit 10 të Konventës për Ekstradimin, siç ka bërë shteti italian, pavarësisht se Konventa ia jep këtë të drejtë. Në këto kushte, siç edhe vetë Konventa për Ekstradimin parashikon, parimi i reciprocitetit nuk mund të zbatohet vetiu, por kërkon ushtrimin e këtij instrumenti nga ana e shtetit shqiptar, mbi të njëjtën dispozitë për të cilën ka paraqitur rezervë shteti italian. Lidhur me zbatimin e këtij instrumenti, Gjykata vëren, ndër të tjera, se edhe në një eventualitet të paraqitjes së rezervës, nuk janë gjykatat ato që e zbatojnë këtë parim dhe detyra e sistemit gjyqësor është vetëm verifikimi nëse plotësohen kushtet sipas parashikimeve të neneve 490 e vijues të KPP-së. Po ashtu, referuar KPP-së, autoriteti përgjegjës që disponon për ekstradimin është ministri i Drejtësisë, referuar nenit 499 të KPP-së. Gjithashtu, ministri i Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8322, datë 02.04.1998 që ka ratifikuar Konventën për Ekstradimin, është në pozicionin e duhur për të pasur informacionin e plotë për faktet që kanë rëndësi për parimin e reciprocitetit. Në këto kushte, referuar rrethanave konkrete të rastit objekt shqyrtimi kushtetues, siç ka arsyetuar edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, rezulton se parimi i reciprocitetit, si një instrument i së drejtës ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor penal, nuk mund të zbatohet nga gjykatat e zakonshme, por nga autoritetet politike

kombëtare. Ky konstatim i gjykatave të zakonshme nuk përmban ndonjë element antikushtetutshmërie, ndaj nuk ka vend të cenohet nga gjykata. Në këtë kontekst, me të drejtë Kolegji Penal i ka rrëzuar si të pabazuara pretendimet e kërkuesit lidhur me zbatimin e parimit të reciprocitetit në rastin konkret.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit lidhur me të drejtën për të mos u dëbuar janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 03.12.2025
Shpallur më 17.02.2026

Vendim nr. 79, datë 12.12.2025
(V-79/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 12.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (H) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **HAJRI THAÇAJ**

SUBJEKT I INTERESUAR:
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, pika 3, 7, 15, 42, 44, 55, 81, pika 1, 116, pika 1, 118, 124, 131, pika 1, shkronja "f", 132, pika 1, 134, pika 1, shkronja "i", 141, 142, pika 1, 145, 146, pika 2, 170, 174, 175 dhe 178 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 1, 6, 14, 17, 18 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Hajri Thaçaj (*kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë me detyrë oficer pranë Komandës së Zbulimit të Forcave Tokësore me gradën "Nënkolonel" deri në nxjerrjen në rezervë me urdhrin nr. 355, datë 23.07.2003. Pas përfitimit të pagesës kalimtare në masën 23.479 lekë, kërkuesi i është drejtuar DRSSH-së, Tiranë për përfitimin e pensionit të parakohshëm, e cila ka caktuar pensionin me vendimin nr. 4394, datë 01.08.2005, në masën 15.693 lekë në muaj, për periudhën e shërbimit 34 vjet. Ndërkohë, në datën 04.05.2016 kërkuesi ka dalë në pension pleqërie.

2. Duke mos qenë dakord me masën e pensionit të parakohshëm, në datën 17.11.2006 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e të padituri të paguajë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 (*ligj nr. 8087/1996*). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4887, datë 05.06.2009, ka vendosur: pranimin e kërkesëpadisë; detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, të rillogarisë masën e pensionit të parakohshëm të kërkuesit në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë të shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese; detyrimin e palës së paditur t'i paguajë diferencën e masës së pensionit që nga data e fillimit të pensionit 01.08.2005 deri në 30.04.2009. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 438, datë 12.03.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4887, datë 05.06.2009 të gjykatës së shkallës së parë. Me vendimin nr. 00-2012-2012, datë 11.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga DRSSH-ja, Tiranë (*procesi i parë gjyqësor*). Në zbatim të këtyre vendimeve kërkuesit i është përllogaritur masa e pensionit në shumën 52.584 lekë në muaj.

3. DRSSH-ja, Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" (*ligj nr. 10142/2009*), ka përllogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuesit me të drejtë pagese nga data 01.07.2009 në masën 21.439 lekë në muaj.

4. Me vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 (*vendim nr. 33/2010*) Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka vendosur shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 2 të nenit 14, si dhe të nenit 27 të ligjit nr. 10142/2009. Në vijim të këtij vendimi, kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, për të vazhduar pagesën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i moszbatimit të vendimit të Gjykatës nr. 33/2010 për periudhën 01.05.2009-04.03.2013, duke e llogaritur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet si një të drejtë të fituar; indeksimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10410, datë 21.10.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, për t'i paguar kërkuesit pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese për 15 vjet shërbimi, duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet, duke u paguar diferenca midis masës së pensionit që do të dalë dhe masës së pensionit që kërkuesi ka përfituar për çdo muaj, duke filluar nga data 01.05.2009 deri në datën 01.07.2009; detyrimin e palës së paditur për t'i paguar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën nga 01.05.2009-01.07.2009 bashkë me rritjet përkatëse; rrëzimin e kërkesëpadisë për sa i përket shpërblimit të dëmit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi dhe pala e paditur.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1591, datë 22.04.2014, ka vendosur moskompetencën e shqyrtimit të çështjes dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 4331, datë 27.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 10410, datë 21.10.2013. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur dhe kërkuesi.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1378 (724), datë 23.06.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 4331, datë 27.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të analizohen faktet për të zgjidhur çështjen duke zbatuar ligjin sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara *(vendimi unifikues nr. 3/2016)*. Kundër këtij vendimi të Kolegjit Administrativ kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë. Me vendimin nr. 21, datë 19.12.2019, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", si dhe kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

8. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10410, datë 21.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligj nr. 49/2012*), (*procesi i dytë gjyqësor*).

10. Në datën 19.03.2025 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në datën 20.03.2025. Në datën 04.06.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 18.06.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Me vendimin e datës 11.12.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesën e një gjyqtari për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

A. Vendimi unifikues nr. 3/2016 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka cenuar:

11.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1.1. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara dhe res judicata*, pasi kërkuesi ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 01.08.2005-01.07.2009 me vendim gjyqësor të formës së prerë. E drejta e këtij pensioni është fituar më parë edhe me ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004 dhe vendimin nr. 33/2013 të Gjykatës. Pra, atij i lind e drejta e vazhdimësisë të së drejtës së fituar më parë deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë vendimin nr. 33/2010 të Gjykatës, i cili ka hyrë në fuqi përpara vendimit nr. 2/2013 të kësaj të fundit dhe vendimit unifikues. Vendimi nr. 2/2013 i Gjykatës nuk e ka shfuqizuar vendimin e saj të mëparshëm, prandaj e drejta e pensionit të kërkuesit është fituar me vendimin nr. 33/2010.

11.1.2. *Parimit të gjykimit të drejtë*, pasi e drejta e pensionit të parakohshëm ka lindur në datën 01.08.2005, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004 dhe neni 11 i ligjit nr. 8087/1996 duhet të zbatohet sipas nenit 49 të ligjit 9210/2004, sipas të cilit shprehja "jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" është shfuqizuar. Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues nuk e kanë pranuar zbatimin e këtij neni, me argumentin se nuk ishin miratuar aktet nënligjore, ndonëse kanë pasur detyrimin e zbatimit të tij. Në këtë mënyrë ato kanë marrë kompetencat e organit ligjvënës, kanë shkelur nenin 141 të Kushtetutës dhe kanë ndryshuar ligjin pas një periudhe 11-vjeçare, ndonëse vendimet e gjykatave për pensionin e parakohshëm kishin marrë formë të prerë dhe ishin ekzekutuar. Gjykata në vendimin e saj nr. 2/2013 është mbështetur në prova fiktive të paraqitura nga subjektet e interesuara në atë gjykim, pa shifra dhe pa llogaritur borxhin publik. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të konstatojë shkelje edhe të vendimit të saj nr. 2/2013.

11.2. *Të drejtën për mbrojtjen shoqërore të punës*, të garantuar nga neni 49, paragrafi 2, i Kushtetutës, pasi vendimi unifikues nr. 3/2016 ul në mënyrë të ndjeshme deri në 50% përfitimin financiar

të pensionit të parakohshëm, duke e përgjysmuar dhe duke përkeqësuar situatën financiare dhe ekonomike nën nivelin jetik, pra nën pagën minimale. Ushtarakët nuk kanë profesion tjetër dhe ata nuk mund të angazhohen në punë të tjera, pasi kjo kategori është e moshuar. Gjithashtu, ushtarakët nuk kanë të ardhura të tjera shtesë dhe familja jeton me pensionin e tyre. Ushtarakët nuk përfitojnë as të drejta suplementare financiare.

11.3. *Të drejtën për pension,* të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës*,* pasi kufizimi i pensionit të parakohshëm të ushtarakëve nuk plotëson kriteret e kufizimit të nenit 17 të Kushtetutës, pasi nuk është bërë për një interes publik. Po kështu, kufizimi nuk është bërë me ligj, por me vendime gjyqësore, si vendimi i Gjykatës nr. 33/2010 dhe vendimi unifikues nr. 3/2016. Ligji nr. 10142/2009 nuk ka parashikuar shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Kushtetuta dhe kuadri ligjor nuk parashikojnë kufizimin e pensionit të parakohshëm. Shkaqet e kufizimit të kësaj të drejte nga vendimi unifikues janë alogjike, pasi përballimi i pasojave në buxhetin e shtetit nuk mund të bëhet vetëm nëpërmjet kufizimit të të drejtave të ushtarakëve.

11.4. *Parimin e proporcionalitetit*, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi pensioni i parakohshëm i llogaritur sipas vendimeve të formës së prerë ka qenë në masën 52.584 lekë, ndërsa pas prishjes së tyre nga Gjykata e Lartë ai është ulur në masën mbi 50%. Nga dalja e vendimit të Gjykatës nr. 2/2013 deri në vendimin unifikues të vitit 2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka kaluar një periudhë 3-vjeçare dhe ky vendim i fundit nuk ka marrë parasysh se interesi publik ka ndryshuar si rezultat i inflacionit, borxhit publik, etj.

11.5. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kufizimi i pensionit të parakohshëm është bërë vetëm për ushtarakët, për shkak të përkatësisë shoqërore të tyre dhe gjendjes ekonomike. Ndikimi në buxhetin e shtetit, reduktimi i borxhit publik etj. nuk mund të përballohen vetëm nga ushtarakët. Shumë kategori të tjera funksionarësh publikë nuk janë prekur nga ulja e pensionit të parakohshëm. Ky parim është cenuar nga vendimi unifikues nr. 3/2016, i cili ka prekur vetëm pensionet e ushtarakëve.

11.6. *Parimin e moszbatimit të fuqisë prapavepruese*, pasi pensioni

i parakohshëm i kërkuesit është caktuar në datën 01.08.2005, përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës nr. 3/2013 dhe vendimit unifikues dhe ligji i zbatueshëm ishte ligji në fuqi në kohën e lindjes të së drejtës, konkretisht ai nr. 8087/1996, i ndryshuar. Edhe Gjykata nuk mund të ndryshojë të drejtën e pensionit me një vendim tjetër të saj. Kolegjet e Bashkuara i kanë dhënë fuqi prapavepruese nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, ndonëse ai parashikon se rillogaritja bëhet vetëm për ata persona për të cilët pensioni i parakohshëm nuk është caktuar, në ndryshim nga situata e kërkuesit, duke marrë kompetencat e pushtetit ligjvënës.

11.7. *Të drejtën për informim*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka vënë në dispozicion kërkuesit kopje të dosjes gjyqësore të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Palë në atë gjykim ishte shoqata e ushtarakëve, pjesë e së cilës është edhe kërkuesi, për rrjedhojë ai ka të drejtë të njihet me dosjen gjyqësore që i përket vendimit unifikues. Ky vendim i shtrin efektet financiare jo vetëm te palët ndërgjyqëse, por tek të gjithë personat që preken prej tij.

11.8. *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, pasi Gjykata e Lartë ka ndryshuar përmbajtjen e nenit 11, shkronja "b", të ligjit nr. 8087/1996 dhe ka shfuqizuar nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, duke shtuar fjalët "por masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi". Kjo gjykatë nuk ka respektuar Kushtetutën, por ka vepruar në kundërshtim me nenet 7 dhe 141 të saj. Neni 48 i ligjit nr. 9210/2004 nuk delegonte Këshillin e Ministrave të nxirrte akte nënligjore për zbatimin e nenit 49 të tij. Gjykata e Lartë ka marrë kompetencat e ligjvënësit. Ligji nr. 8087/1996 dhe neni 49 i ligjit nr. 9210/2004 prevalojnë mbi vendimin unifikues, pra edhe njësimi i praktikës gjyqësore cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

B. Vendimi nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka cenuar:

11.9. *Parimin e gjykimit të drejtë*, pasi rekursi i kërkuesit është paraqitur në përputhje me nenin 475 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), në të cilin janë pasqyruar shkaqet e parashikuara në nenin 58, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012. Vlerësimet e Kolegjit Administrativ të

Gjykatës së Lartë janë jologjike, ndonëse kërkuesi ka paraqitur shkaqe që lidhen me interpretimin e kuadrit ligjor për pensionin e parakohshëm të ushtarakëve.

11.10. *Të drejtën e aksesit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka keqinterpretuar rekursin, duke mos e gjykuar çështjen e tij.

11.11. *Standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë duhet të analizonte shkaqet e rekursit referuar nenit 58, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012. Ajo gjykatë ka bërë një vlerësim jologjik dhe nuk është bazuar në nenin 480/a të KPC-së dhe nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

11.12. *Parimin e subsidiaritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kontrolluar respektimin e standardeve kushtetuese dhe nuk ka analizuar pretendimet e paraqitura në rekurs, duke anashkaluar shkeljet kushtetuese.

11.13. *Parimin e disponibilitetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar se gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen në kundërshtim me kufijtë e shqyrtimit gjyqësor.

C. Vendimi nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit ka cenuar:

11.14. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:*

11.14.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar kërkuesin për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në përputhje me nenin 460, pika 5, të KPC-së. Në këtë mënyrë kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për të paraqitur pretendimet e tij në lidhje me vendimin unifikues nr. 3/2016. Mosnjoftimi i kërkuesit ka sjellë si pasojë pamundësinë e tij për të kërkuar përjashtimin e relatorit të çështjes, E.R., ndaj të cilit ai kishte paraqitur kallëzim penal.

11.14.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykata e apelit nuk është shprehur për pretendimet e kërkuesit të paraqitura në kërkesat e datave 19.04.2019, 28.05.2019 dhe parashtrimet e datës 16.07.2019, kërkesat për themelin e vendimit, pretendimet lidhur me shkeljet kushtetuese, përparësinë e zbatimit të ligjit nr. 8087/1996, si dhe saktësinë e fakteve të pranuara nga gjykimi i mëparshëm. Kjo gjykatë nuk ka pasqyruar të dhënat e vendimit të kërkuesit, çka ngre

dyshimin se bëhet fjalë për vendimin e një pale tjetër. Vendimit i mungon arsyetimi për zbatimin e ligjit, por thjesht bëhet referim në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë dhe vendimin unifikues. Në këtë mënyrë kjo gjykatë nuk ka kryer hetim të plotë.

11.14.3. *Parimit të disponibilitetit*, pasi gjykata e apelit nuk i është referuar situatës ligjore që ekzistonte në datën 01.08.2005, koha e përfitimit të pensionit të parakohshëm, pra pas hyrjes në fuqi të nenit 49 të ligjit nr. 9210/2004.

11.14.4. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi relatori i çështjes është në konflikt interesi me kërkuesin, për shkak se ai ka paraqitur kallëzim penal për këtë gjyqtar.

11.14.5. *Parimit të gjykimit të drejtë*, pasi vendimi i gjykatës së apelit nuk është bazuar në të drejtën e fituar me ligjet e mëparshme dhe llogaritja e pensionit të parakohshëm nuk është bërë sipas të drejtës së fituar më parë.

12. ***Subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, për kundërshtimin e vendimeve nr. 1040

(86-2023-1381), datë 11.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu objekt i ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se sipas jurisprudencës kushtetuese, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 59, datë 16.10.2025; nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka qenë palë në procesin ku është dhënë vendimi unifikues i kundërshtuar, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme të gjykimit, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 50, datë 20.06.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 31, datë 03.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Gjykata vëren se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi relatori i çështjes në gjykatën e apelit ka qenë në konflikt interesi me kërkuesin, për shkak se ka paraqitur kallëzim penal për këtë gjyqtar. Lidhur me këtë pretendim, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar

për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore, në mënyrë që atij t'i jepej mundësia për të kërkuar përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes.

18. Bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata vëren se shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes, të paktën 15 ditë përpara. Ndërkohë, rregullat procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, pikërisht neni 482, paragrafi i tretë, i KPC-së, parashikojnë se njoftimi i palëve nga sekretaria gjyqësore bëhet përmes shpalljes së listave të shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit.

19. Në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, seanca e planifikuar në datën 08.10.2023 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues, si rrjedhojë e kërkesës për dorëheqje të gjyqtares E.Ç., e cila është pranuar nga zëvendëskryetari i asaj gjykate. Më tej është proceduar me plotësimin e përbërjes së trupit gjykues nëpërmjet shortit elektronik. Seanca e planifikuar është shtyrë me qëllim njoftimin e palëve ndërgjyqëse me shpallje publike në ambientet e gjykatës dhe në faqen zyrtare të saj. Njoftimi për datën dhe orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues rezulton të jetë shpallur në datën 17.11.2023. Në kuptim të këtyre rrethanave, Gjykata çmon se gjykata e apelit ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore për sa i përket njoftimit të palëve. Në këto kushte, ndonëse kërkuesi rezulton të jetë njoftuar rregullisht, ai nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit E.R. nga gjykimi i çështjes së tij. Për rrjedhojë, për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 22.10.2024, i cili është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 20.11.2024, ndërsa

kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 15.01.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

21. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të disponibilitetit dhe subsidiaritetit nga Gjykata e Lartë, si dhe të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nga vendimi unifikues, Gjykata vëren se kërkuesi i ka paraqitur për herë të parë në parashtrimet para seancës të datës 22.07.2025, pra si të tilla ato përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual. Referuar nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto pretendime të reja nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ato janë paraqitur nga kërkuesi pasi ishte vendosur kalimi i çështjes në seancë plenare.

22. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi për procesin gjyqësor për masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ka pretenduar cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor,* si në gjykatën e apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë, në drejtim *të parimit të gjykimit të drejtë*, *së drejtës së aksesit*, *standardit të arsyetimit të vendimit* dhe *parimit të disponibilitetit*.

23. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit*, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Gjykata, në kushtet kur konstatoi se njoftimi i kërkuesit është bërë në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse (*shih paragrafin 19 të vendimit*), çmon se pretendimi i tij është haptazi i pabazuar. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e kësaj të drejte nga Gjykata e Lartë, kërkuesi ka argumentuar se kjo e fundit ka keqinterpretuar rekursin, duke mos e gjykuar çështjen e tij, pretendim i cili bazuar në thelbin e tij do të analizohet në kuadër të parimit të gjykimit të drejtë.

24. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të gjykimit të drejtë, standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të disponibilitetit, Gjykata vëren se, për sa kohë, në thelb, kërkuesi ka paraqitur të njëjtat argumente që lidhen me mënyrën e interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

25. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk është shprehur në lidhje me objektin e kërkesave dhe parashtrimeve të tij, për pretendimet lidhur me shkeljet kushtetuese, përparësinë e zbatimit të ligjit nr. 8087/1996 dhe saktësinë e fakteve të pranuara nga gjykimi i mëparshëm. Sipas tij, e drejta e pensionit të parakohshëm është një e drejtë e fituar më parë me ligjin nr. 8087/1996 dhe vendimin nr. 33/2013 të Gjykatës, si dhe me vendime gjyqësore të formës së prerë. E drejta e pensionit të parakohshëm ka lindur në datën 01.08.2005, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004 dhe neni 11 i ligjit nr. 8087/1996 duhet të zbatohet sipas nenit 49 të ligjit 9210/2004, sipas të cilit shprehja "jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" ishte shfuqizuar. Sipas kërkuesit, pensioni i parakohshëm i tij është caktuar në datën 01.08.2005, përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës nr. 3/2013 dhe vendimit unifikues dhe ligji i zbatueshëm ishte ligji në fuqi në kohën e lindjes të së drejtës, konkretisht ai nr. 8087/1996, i ndryshuar. Po kështu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar shkaqet e rekursit referuar nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, ndonëse ai ka paraqitur shkaqe që lidhen me interpretimin e kuadrit ligjor për pensionin e parakohshëm të ushtarakëve.

26. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 24, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, Gjykata ka theksuar se, ai përfshin, mes të

tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohen, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 78, datë 06.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm ose në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 1, datë 31.01.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata gjithashtu çmon të ritheksojë edhe se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës

të ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Në praktikën e saj Gjykata ka marrë tashmë në analizë pretendimet për masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ish-ushtarakët në disa raste (*shih vendimet nr. 74, datë 20.11.2025; nr. 59, datë 16.10.2025; nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 24, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese),* prandaj për legjislacionin që ka rregulluar ndër vite të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrollin e tyre kushtetues dhe për sa u përket përfundimeve njësuese të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, çmon të mos ndalet në evidentimin e tij në hollësi edhe në këtë vendim.

31. Në referim të sa më sipër, nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata në vijim do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

32. Po kështu, Gjykata sjell në vëmendje se pretendimet e kërkuesit për sa i përket së drejtës për pension të parakohshëm lidhen si me periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10149/2009, ashtu dhe me periudhën pas hyrjes në fuqi të tij (01.07.2009). Në këtë drejtim, ndonëse në rastin e kërkuesit e drejta e pensionit të parakohshëm për periudhën deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10149/2009 i korrespondon një periudhe të shkurtër kohore (01.05.2009-01.07.2009) e për pasojë një vlere relativisht të vogël monetare, duke mbajtur në konsideratë se pensioni i parakohshëm për ushtarakët e Forcave të Armatosura garanton ruajtjen e një niveli të

krahasueshëm jetese dhe ekonomike për ta, Gjykata çmon ta analizojë pretendimin e tij edhe për këtë periudhë.

33. Konkretisht, Gjykata vëren se në datën 23.07.2003 kërkuesi është nxjerrë në rezervë, pasi ka shërbyer si oficer aktiv me gradën "Nënkolonel". Fillimisht, ai është trajtuar me pagesë kalimtare bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar. E drejta e pensionit të parakohshëm i ka lindur në datën 01.08.2005, masa e të cilit është kundërshtuar nga kërkuesi në gjykatë. Për procesin e parë gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2009 ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së kërkuesit dhe se atij duhet t'i kthehen diferencat e masës së pensionit nga data 01.08.2005, kur i ka lindur e drejta, deri në datën 30.04.2009. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të palës së paditur.

34. Në vijim të vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, për të vazhduar pagesën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i moszbatimit të vendimit të Gjykatës nr. 33/2010 për periudhën 01.05.2009-04.03.2013, duke e llogaritur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet si një e drejtë e fituar; indeksimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit.

35. Për procesin e dytë gjyqësor, objekt kundërshtimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10410, datë 21.10.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur për të paguar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese për 15 vjet shërbimi, duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet, duke u paguar diferenca midis masës së pensionit që do të dalë dhe masës së pensionit që kërkuesi ka përfituar për çdo muaj duke filluar nga data 01.05.2009 deri në datën 01.07.2009; detyrimin për t'i paguar pensionin e parakohshëm për periudhën nga 01.05.2009-01.07.2009 bashkë me rritjet përkatëse dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për sa i përket shpërblimit të dëmit. Kjo gjykatë ka arsyetuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Sipas saj, DRSSH-ja ka gabuar në përllogaritje, pasi kufizimi "jo më shumë se pensioni maksimal në shkallë vendi" ka qenë i shfuqizuar kur kërkuesi ka dalë në rezervë dhe prandaj atij duhet t'i paguhet diferenca e masës së pensionit nga data

01.05.2009 deri në datën 01.07.2009. Kjo gjykatë gjithashtu ka pranuar edhe kërkimin për indeksimin e pensionit të parakohshëm.

36. Gjykata Administrative e Apelit, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes, me vendimin nr. 4331, datë 27.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas saj, në momentin kur kërkuesi ka dalë në rezervë, shprehja "por jo më shumë se pensioni maksimal në shkallë vendi" në nenin 49 të ligjit 9210/2004 është shfuqizuar dhe pala e paditur duhet të bazohej në nenin 35 të ligjit 9210/2004, i cili parashikonte se oficerët gëzojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50 % të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm ushtarakut i jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, pala e paditur duhet të bazohej në nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006 dhe t'i paguajë kërkuesit diferencën e masës së pensionit nga data 01.05.2009 deri në datën 01.07.2009.

37. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2017 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 4331, datë 27.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Ky kolegj ka arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të analizohen faktet për të zgjidhur çështjen duke zbatuar ligjin sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara.

38. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10410, datë 21.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8251/1999, duke e vendosur kufizimin e masës maksimale të pensionit në shkallë vendi te shtesa për vjetërsi dhe jo në masën totale të pensionit. Në këtë konkluzion gjykata e apelit ka arritur duke u mbështetur në arsyetimin e vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara.

39. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2021. Sipas këtij kolegji, është detyrë e palës rekursuese të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke

argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural dhe përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Po sipas kolegjit, nëse shkaqet ligjore nuk arrihen të parashtrohen dhe të argumentohen sipas kërkesave që ka neni 58 i ligjit nr. 49/2012, atëherë Gjykata e Lartë është e detyruar të vendos mospranimin e rekursit.

40. Duke marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret dhe bazuar në standardet kushtetuese të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 01.08.2005, moment në të cilin zbatohej ligji 9210/2004. Në pikën 3 të nenit 35 të këtij ligji ishte përcaktuar se kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi përcaktoheshin në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Në nenin 11 të ligjit të fundit parashikohej se masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ishte 50% e pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Ndërkohë, për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, por edhe të vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm gjatë procesit të parë gjyqësor, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se ai do të përfitonte nga ky shfuqizim, pra se ndaj atij nuk do të zbatohej ky kufizim në masën e pensionit të parakohshëm të paktën deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009.

41. Nisur nga sa më sipër, për sa i përket periudhës së përfitimit nga kërkuesi të pensionit të parakohshëm deri në datën 01.07.2009, Gjykata, në linjë edhe me vendimmarrjen e mëparshme të saj, vëren se pavarësisht shfuqizimit të tavanit maksimal të pensionit të parakohshëm me nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka përllogaritur masën e pensionit sipas parashikimit ligjor në fuqi për atë periudhë, por ka përcaktuar se masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke vlerësuar se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohej për mungesë të daljes së akteve nënligjore për zbatimin e tij.

42. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit nuk duket se ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012,

sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë përllogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.

43. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit nr. 9210/2004, si dhe mënyra e interpretimit të tij nga gjykata e apelit nuk rezultojnë të jenë analizuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, ajo nuk shprehet pse në rastin në shqyrtim kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues edhe për periudhën 01.05.2009-01.07.2009, si dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm për këtë periudhë vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar. Në këtë drejtim, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs lidhur me zbatueshmërinë e kritereve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 01.05.2009-01.07.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm apo se ajo (Gjykata e Lartë) ka dhënë mjaftueshëm argumente për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe për mënyrën e interpretimit të tij nga gjykata e apelit.

44. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Pra, ajo gjykatë nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti nëse kufizimi "jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" përfshinte edhe periudhën kohore 01.05.2009-01.07.2009. Prandaj vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuesit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji, të paktën për periudhën kohore 01.05.2009-01.07.2009. Në këto kushte, Gjykata, nisur edhe nga roli subsidiar i saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se i përket Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit

për interpretimin e ligjit material prej tyre, prandaj duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i saj.

45. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për periudhën pas datës 01.07.2009, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, deri në datën 04.03.2013 (*datë kur ka hyrë në fuqi vendimi nr. 2/2013 i Gjykatës*). Lidhur me këto pretendime të kërkuesit, Gjykata, sikurse është shprehur edhe më parë (*shih vendimin nr. 59, datë 16.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), vëren se interpretimi i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, për periudhën pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra pas datës 01.07.2009, nga gjykata e apelit dhe pranimi i tij nga Gjykata e Lartë nuk duket i paarsyeshëm dhe që të bjerë ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, pra i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Prandaj, pretendimet e kërkuesit në lidhje me të drejtën e pensionit të parakohshëm për periudhën 01.07.2009 – 04.03.2013 janë të pabazuara.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri.

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.12.2025
Shpallur më 12.01.2026

Vendim nr. 80, datë 16.12.2025
(V-80/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Asim Vokshi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 12.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (Gj) 2025 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUES: **GJERGJ SOKOLI,** përfaqësuar nga avokat Sokol Dedndreaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Ilir Proda.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokati i shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 117 (86-2021-58), datë 24.02.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-3623, datë 24.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).***

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Gjergj Sokoli *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit *(DPPSH)* dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë punonjës policie në detyrën "shef i Seksionit" dhe "specialist" në seksionin kundër trafiqeve të paligjshme, në seksionin kundër krimit të organizuar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë nga muaji qershor i vitit 2006 deri në datën 13.01.2007. Në datën 31.01.2007 kërkuesi është ndaluar si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. Me shkresën nr. 301 prot., datë 25.01.2007 të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë, ai është pezulluar paraprakisht nga detyra, me motivacionin se ndaj tij kishte filluar procedimi penal. Me urdhrin nr. 133/1, datë 25.01.2007 *(urdhri për përjashtimin)* të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kërkuesi është përjashtuar nga Policia e Shtetit, me motivacionin "*Për shkelje të betimit, abuzime të rënda me atributet e policisë dhe me mirëbesimin e publikut dhe për veprime që cenojnë në mënyrë të pariparueshme ligjin dhe detyrën*", duke urdhëruar edhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare.

2. Pas shqyrtimit të çështjes penale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 258, datë 25.09.2007, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë, i Kodit Penal dhe dënimin me 2 vjet burgim dhe 500 000 lekë gjobë, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 133, datë 23.11.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 637, datë 25.11.2009, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Me shkresën nr. 446 prot., datë 08.05.2008, kërkuesi është liruar nga Institucioni i Ekzekutimit të

Dënimeve Penale. Pasi çështja është dërguar për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, bazuar në nenin 377 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP),* ka tërhequr akuzën dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur kalimin e akteve të çështjes penale Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila në datën 20.09.2010 ka vendosur pushimin e hetimit në ngarkim të kërkuesit. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues ka rezultuar se në datën 09.01.2013 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesëpadi për kompensimin e burgimit të padrejtë për periudhën nga 31.01.2007 deri në 08.05.2008.

3. Kërkuesi në datën 04.10.2013 i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar detyrimin e DPPSH-së/palë e paditur për të paguar pagën mujore nga data e arrestimit deri në momentin e përfundimit të shqyrtimit të padisë, për të paguar pagesën e avokatit, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe dëmshpërblimin shëndetësor dhe moral. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 642, datë 23.01.2014, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 2414, datë 15.05.2014, ka vendosur deklarimin e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Sipas akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore rezulton se gjatë kohës që çështja ka qenë duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, në datën 26.06.2014 subjekti i interesuar, si palë e paditur në atë gjykim, ka depozituar disa prova shkresore, mes tyre edhe urdhrin për përjashtimin e kërkuesit nga strukturat e policisë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë në seancat përgatitore të zhvilluara në datat 05.09.2014 dhe 03.10.2014, ku kërkuesi ka qenë i pranishëm, është shprehur për faktin se subjekti i interesuar ka depozituar këto prova, mes tyre edhe urdhrin për përjashtimin. Në vijim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 517 akti, datë 03.10.2014, ka vendosur t'i parashtrojë Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore mes Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe të vazhdojë shqyrtimin e çështjes deri në një vendim të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me shqyrtimin e mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2014-4100, datë 20.11.2014, ka

vlerësuar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykata kompetente për zgjidhjen e çështjes.

4. Pas shqyrtimit të themelit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2895 (80-2015-1485), datë 28.05.2015, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe dëmshpërblimin e kërkuesit me 12 (dymbëdhjetë) paga për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme. Pas ankimit të kërkuesit dhe DPPSH-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2369, datë 25.05.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 258 (80-2018-260), datë 01.02.2018, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e DPPSH-së t'i paguajë kërkuesit si dëmshpërblim pagën e 12 (dymbëdhjetë) muajve punë, për shkak të paligjshmërisë së përjashtimit të tij nga Policia e Shtetit dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ndërsa kërkuesi në datën 03.11.2020 ka paraqitur parashtrime me shkrim. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 117 (86-2021-58), datë 24.02.2021, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për pjesën e pranimit të padisë. Në mënyrë të përmbledhur, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor nga momenti i marrjes dijeni për urdhrin e përjashtimit.

6. Në datën 20.04.2021 kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe në datën 03.05.2024 ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, e cila është pranuar nga gjyqtari relator. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3623, datë 24.09.2024, të marrë në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*.

7. Kërkuesi në datën 21.01.2025 *(data e shërbimit postar)* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 11.04.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se janë cenuar:

8.1. *E drejta e aksesit substancial e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe t'u mbrojtur*, pasi Gjykata Administrative e Apelit duke vendosur pushimin e çështjes dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mospranimin e rekursit, nuk kanë shqyrtuar në themel pretendimet e ngritura, për rrjedhojë është kufizuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Urdhri për përjashtimin nga policia nuk është komunikuar asnjëherë, megjithëse kërkuesi ka kërkuar disa herë vënien e tij në dispozicion. Për këtë akt kërkuesi ka marrë dijeni vetëm në seancën paraprake të datës 20.04.2015 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pas marrjes dijeni ka kërkuar shtimin e objektit të padisë për shfuqizimin e urdhrit. Për këtë arsye, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është në kundërshtim me rrethanat e çështjes dhe situatën ligjore, sepse është i bazuar vetëm në indicie ose hamendësime të paverifikuara, kur sipas nenit 29 të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" *(ligji nr. 8553/1999)* parashikohet detyrimi për komunikimin e aktit drejtpërdrejt. Gjykata Administrative e Apelit kishte detyrimin për të shqyrtuar në themel pretendimet dhe disponimi i saj ka cenuar të drejtën e aksesit. Komunikimi i drejtpërdrejtë i vendimit për përjashtimin është i lidhur edhe me ushtrimin në mënyrë efektive jo vetëm të së drejtës për ankim, por edhe për realizimin e një mbrojtjeje efektive, pasi pa njohur shkaqet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e masës disiplinore, kërkuesi nuk mund të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën për t'u mbrojtur duke paraqitur argumente, shkaqe dhe kundërshtime për motivet ku është bazuar masa disiplinore. Edhe Gjykata e Lartë, nëpërmjet vendimit të saj, nuk i ka dhënë mundësi kërkuesit për t'u dëgjuar, duke shkelur të drejtën e aksesit.

8.2. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka përmbushur detyrimin për t'u dhënë mundësi të barabarta palëve në gjykim.

8.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar dhe arsyetuar asnjë prej shkaqeve ligjore të ngritura në rekurs, megjithëse ishin të lidhura me

cenimin e parimeve kushtetuese si gjatë gjykimit, ashtu edhe në procedimin disiplinor, gjatë të cilit nuk është zbatuar asnjë e drejtë për kërkuesin. Shkeljet kanë qenë flagrante dhe kalojnë kufijtë e pavlefshmërisë absolute për shkak të shkeljes së hapur të ligjit. Për kërkuesin nuk është kryer asnjë procedurë hetimi disiplinor dhe nuk është kryer asnjë njoftim për urdhrin për përjashtimin. Në datën 25.01.2007 kur DPPSH-ja ka nxjerrë urdhrin për lirimin, kërkuesi ka qenë në gjendje arresti (prej datës 13.01.2007). Dhënia e masës disiplinore është bërë pa u kryer asnjë verifikim për faktet, pa u marrë deklaratë nga dëshmitarët dhe pa u komunikuar me kërkuesin për shkeljet që i atribuoheshin, për rrjedhojë moszbatimi i procedurës e bën urdhrin të marrë në shkelje të ligjit dhe procedurës. Gjykata e Lartë duhet të kishte vlerësuar nëse kërkuesit i ishte dhënë mundësia për t'u dëgjuar për pretendimet e tij përpara organit administrativ. Megjithëse kërkuesi ka parashtruar se nuk ka marrë dijeni për urdhrin e lirimit, si gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk e kanë marrë në analizë dhe nuk e kanë arsyetuar këtë pretendim. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, nuk janë pasqyruar shkaqet e parashtruara në rekurs dhe në parashtrimet shtesë, që ishin për cenimin e së drejtës së aksesit, të së drejtës për punë, të garantuar në nenin 49 të Kushtetutës dhe për dëmshpërblim, sipas nenit 44 të Kushtetutës. Për këto arsye, vendimi i Gjykatës së Lartë ka vënë në dyshim të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara në rekurs, qoftë me arsyetim minimal.

9. ***Subjekti i interesuar, DPPSH-ja,*** ka prapësuar, si vijon:

9.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar,* për shkak të mungesës së dijenisë/komunikimit të urdhrit për përjashtimin, është i pabazuar. Nga materialet që ndodhen në dosje është e provuar se kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin e përjashtimit nga Policia e Shtetit, pasi ai ka qenë në gjendje arresti dhe ndaj tij ka filluar çështja penale. Kërkuesi ka kërkuar që të rikthehej në Policinë e Shtetit dhe ka ngritur padi në gjykatë në lidhje me këto kërkime, fakt që tregon se ka qenë në dijeni të largimit. Gjithashtu, kërkuesi pretendimin për mosnjoftimin e urdhrit për përjashtimin nga strukturat e Policisë së Shtetit nuk e ka ngritur më parë në instancat gjyqësore. Kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e tij në nivel kushtetues, por është përqendruar në

mënyrën se si është ndjekur procedura administrative nga organi publik. Vlerësimi i afatit të parashkrimit të padisë është element thelbësor i zhvillimit të procesit dhe i legjitimitetit të tij, pasi lidhet drejtpërdrejt me ekzistencën e së drejtës së padisë. Në çështjen në shqyrtim, gjykata e apelit ka çmuar se e drejta e kërkuesit për shqyrtimin e kërkimeve të tij kundër aktit për përjashtimin nga Policia e Shtetit dhe rivendosjen e pasojave është shuar për shkak të kalimit të afatit ligjor, të parashikuar nga ligji i posaçëm. Për këtë shkak, bazuar në nenin 112 të Kodit Civil kërkuesi nuk mund t'i mbrojë të drejtat e tij të pretenduara të cenuara nga ndërprerja e kontratës së shërbimit publik nëpërmjet gjykatës dhe kjo e fundit nuk mund t'i marrë në shqyrtim gjyqësor.

10. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, ka prapësuar si vijon:

10.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur* është i pabazuar. Pretendimet e ngritura nga kërkuesi për cenimin e procesit të rregullt ligjor gjatë procesit disiplinor janë ngritur vetëm në parashtrimet drejtuar Kolegjit Administrativ dhe jo në rekurs. Në këto rrethana kërkimet e tij kanë rënë në dekadencë, për sa kohë nuk janë ngritur në rekurs në mënyrë që edhe pala e paditur të njihej me to dhe të paraqiste parashtrimet e saj. Vlen të theksohet se edhe në rast se çështja kthehet për rigjykim në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk mund të paraqesë asnjë pretendim shtesë. Çdo pretendim që nuk është parashtruar në rekurs konsiderohet sikur është hequr dorë. Pretendimi i kërkuesit se ka marrë dijeni për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit pas më shumë se 8 vjetësh është i pabazuar. Ai ka marrë dijeni për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës si i përjashtuar nga Policia e Shtetit së paku në datën 01.11.2011, kur ka bërë kërkesë për rikthimin në punë dhe kërkesëpadia është paraqitur jashtë afatit 30-ditor që ka njohur ligji i posaçëm nr. 8553/1999. Kërkuesi nuk ka arritur të provojë se është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e tij për cenimin e së drejtës së aksesit.

10.2. *Pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* kërkuesi e ka parashtruar vetëm në mënyrë deklarative, duke pasqyruar disa qëndrime të kësaj Gjykate. Për më tepër, nga aktet rezulton se kërkuesi ka pasur mundësi për të ndjekur të gjithë hapat proceduralë dhe për të paraqitur mbrojtjen e tij. Nëse

kërkuesi ka dështuar të paraqesë brenda afatit pretendime ose të ndjekë rrugët e duhura të ankimit, kjo nuk i atribuohet shkeljes nga ana e gjykatave, por neglizhencës ose strategjisë së tij.

10.3. *Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar*. Kërkimi për mosnjoftimin e urdhrit për përjashtimin nuk përbëjnë objekt shqyrtimi në Gjykatë, pasi në thelb argumentet e tij nuk paraqesin asnjë cenim të natyrës kushtetuese, por kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga gjykatat e zakonshme. Gjithashtu, pretendimi i kërkuesit për t'u dëgjuar në fazën administrative të dhënies së masës disiplinore është shqyrtuar në mënyrë të plotë nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila i ka vlerësuar pretendimet të pabazuara. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë i përmbush standardet për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata konstaton

se subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka pretenduar se kërkimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor gjatë procesit disiplinor të tij, të zhvilluar nga DPPSH-ja, janë ngritur vetëm në parashtrimet drejtuar Kolegjit Administrativ dhe jo në rekurs. Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka ngritur pretendime në lidhje me procesin disiplinor (administrativ), për rrjedhojë pretendimi i subjektit të interesuar në këtë drejtim është i pabazuar. Ndërkohë, subjekti tjetër i interesuar, DPPSH-ja, ka prapësuar se kërkuesi pretendimin për mosnjoftimin e urdhrit për përjashtimin nga strukturat e Policisë së Shtetit nuk e ka ngritur më parë në instancat gjyqësore. Gjykata, nisur nga fakti se thelbi i pretendimeve të kërkuesit lidhet me marrjen dijeni efektivisht për urdhrin për përjashtimin, do ta analizojë këtë pretendim së bashku me themelin e pretendimeve.

14. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 24.09.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 21.01.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi i ka paraqitur pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e mbrojtur, parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

17. Për pretendimin e cenimit *të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, në këtë Gjykatë kërkuesi ka parashtruar vetëm referenca në jurisprudencën kushtetuese, por nuk ka parashtruar argumente konkrete për të provuar këtë pretendim në nivel kushtetues. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se pretendimi nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Në lidhje me pretendimet e tjera, Gjykata konstaton se kërkuesi

pretendimin për cenimin e së *drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur* e ka ndërlidhur *me cenimin e së drejtës së aksesit substancial*, për këtë arsye ato do të trajtohen në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial*. Në vijim, Gjykata vlerëson se duke nisur nga fakti që argumentet e parashtruara nga kërkuesi në thelb i referohen mënyrës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore të marra nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë për sa i përket momentit të marrjes dijeni të urdhrit për përjashtimin nga strukturat e policisë dhe mënyrës së interpretimit të ligjit të zbatueshëm, duke e konsideruar kërkesëpadinë si të paraqitur jashtë afatit ligjor, të gjitha pretendimet do të analizohen së bashku në drejtim *të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit duke vendosur pushimin e çështjes për shkak të paraqitjes së kërkesëpadisë jashtë afatit, si dhe Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit nuk kanë shqyrtuar në themel pretendimin kryesor për mosnjoftimin e urdhrit për përjashtimin. Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit se kërkimi për shfuqizimin e këtij urdhri është paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor bie në kundërshtim me rrethanat e çështjes, situatën ligjore dhe është i bazuar vetëm në hamendësime të paverifikuara. Sipas kërkuesit, urdhri për përjashtimin nuk i është njoftuar asnjëherë drejtpërdrejt dhe ai ka marrë dijeni vetëm gjatë seancës paraprake të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

20. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka prapësuar se kërkuesi ka qenë në dijeni për urdhrin për përjashtimin, pasi ka qenë në gjendje arresti për shkak të fillimit të procedimit penal. Pas përfundimit të çështjes penale ai ka kërkuar që të rikthehej në Policinë e Shtetit, duke ngritur padi në gjykatë në lidhje me këto çështje. Gjithashtu, kërkuesi në ankimin kushtetues individual nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e tij në nivel kushtetues.

21. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi i kërkuesit se ka marrë dijeni për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit pas më shumë se 8 vjetësh është i pabazuar. Ai ka marrë dijeni për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës si i përjashtuar nga Policia e Shtetit së paku kur ka bërë kërkesë për rikthimin në punë dhe më pas i është drejtuar me padi

gjykatës administrative të shkallës së parë, dukshëm jashtë afatit 30-ditor që ka njohur ligji i posaçëm nr. 8553/1999.

22. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesi ka marrë përgjigje për pretendimin thelbësor të parashtruar gjatë gjykimit të çështjes së tij për momentin e marrjes dijeni të urdhrit për përjashtimin, si dhe nëse ky kërkim është vlerësuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për procesin e rregullt ligjor. Në

këtë kuptim do të analizohet nëse interpretimi i ligjit të zbatueshëm nga gjykatat për zgjidhjen e çështjes, duke e konsideruar kërkesëpadinë si të paraqitur jashtë afatit ligjor, ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues në drejtim të *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pas fillimit të procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, kërkuesi është përjashtuar nga Policia e Shtetit me motivacionin "*Për shkelje të betimit, abuzime të rënda me atributet e policisë dhe me mirëbesimin e publikut dhe për veprime që cenojnë në mënyrë të pariparueshme ligjin dhe detyrën*". Ndërkohë, sikurse rezultoi edhe nga rrethanat e çështjes, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 20.09.2010 ka vendosur pushimin e hetimit në ngarkim të kërkuesit. Në vijim, nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton së kërkuesi, me kërkesën e datës 01.11.2011 drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, ka kërkuar rikthimin në strukturat e Policisë së Shtetit dhe nuk rezulton të ketë marrë përgjigje nga kjo e fundit.

27. Në datën 04.10.2013 kërkuesi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar detyrimin e DPPSH-së për të paguar pagën mujore nga data e arrestimit deri në momentin e përfundimit të shqyrtimit të padisë, për të paguar pagesën e avokatit, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe dëmshpërblimin shëndetësor dhe moral. Sikur u parashtrua në rrethanat e çështjes *(shih paragrafin 3 të vendimit),* Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, nga ana e saj, ka vendosur deklarimin e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

28. Gjykata vëren se sipas akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, gjatë kohës që çështja ka qenë duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, rezulton se: *së pari*, subjekti i interesuar, DPPSH-ja, me shkresën e datës 24.06.2014 (e cila mban shënimin nga sekretaria gjyqësore "*depozituar nga pala e paditur në datën 26.06.2014*"), ka depozituar provat shkresore në funksion të atij procesi gjyqësor, ku mes tyre është edhe një kopje e urdhrit për përjashtimin e kërkuesit nga strukturat e policisë; *së dyti,* nga procesverbalet e seancave përgatitore të zhvilluara në datat 05.09.2014 dhe 03.10.2014, gjatë të cilave kërkuesi ka qenë i pranishëm, rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka administruar provat e depozituara nga subjekti i interesuar me shkresën

e sipërcituar të datës 24.06.2014, mes tyre edhe urdhrin për përjashtimin e kërkuesit nga strukturat e policisë. Në kushtet kur kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë këtyre dy seancave përgatitore kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka administruar urdhrin për përjashtimin nga strukturat e policisë, Gjykata vlerëson se ai ka marrë dijeni për të, për rrjedhojë nuk qëndron pretendimi i tij se nuk ka marrë dijeni për urdhrin e përjashtimit.

29. Në vijim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 517 akti, datë 03.10.2014, ka vendosur t'i parashtrojë Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore dhe vazhdimin e shqyrtimit të çështjes deri në shprehjen me vendim të Gjykatës së Lartë. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencës dhe caktimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykatë kompetente, çështja është regjistruar në datën 20.03.2015. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore rezulton se në seancën përgatitore të datës 20.04.2015 të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, DPPSH-ja ka paraqitur përsëri prova shkresore, mes të cilave edhe urdhrin për përjashtimin. Kërkuesi ka qenë i pranishëm në atë seancë, duke marrë dijeni për këto prova. Seanca e radhës (e datës 05.05.2015) nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së kërkuesit për arsye shëndetësore. Ndërsa në seancën e datës 18.05.2015 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për shtimin e objektit të padisë, duke kërkuar edhe shfuqizimin e urdhrit për përjashtimin dhe sipas përmbajtjes së kësaj kërkese rezulton se ai ka pretenduar se ka marrë dijeni për këtë akt pas vënies në dispozicion nga subjekti i interesuar në kuadër të hetimit gjyqësor të çështjes. Në seancën e fundit, të datës 28.05.2015, pas administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e DPPSH-së t'i paguajë kërkuesit dëmshpërblim me 12 (dymbëdhjetë) muaj pagë, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj. Kjo gjykatë ka arsyetuar se pretendimi i kërkuesit për shfuqizimin e urdhrit për përjashtimin është i pabazuar, pasi urdhri nuk është një akt administrativ, shfaqje e vullnetit të administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, por është shfaqje e vullnetit të administratës publike në cilësinë e punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës, për të cilën mund të ngrihet padi për kërkimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës. Këtë qëndrim Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka bazuar edhe

në vendimin unifikues nr. 7, datë 01.06.2011 të Gjykatës së Lartë *(shih faqet 5-8 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).*

30. Pas ankimit të kërkuesit dhe DPPSH-së, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur rëndë rregullat për zgjidhjen e kërkimeve të palëve, duke mos u shprehur për të gjitha kërkimet në tërësi dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

31. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur kryerjen e ekspertimit vlerësues të dëmit pasuror dhe jopasuror, si dhe mjeko-ligjor të kërkuesit. Në përfundim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, dëmshpërblimin me pagë për 12 (dymbëdhjetë) muaj punë, për shkak të paligjshmërisë së përjashtimit të tij nga Policia e Shtetit dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim DPPSH-ja, ndërsa kërkuesi në datën 03.11.2020 ka paraqitur parashtrime me shkrim. Gjykata Administrative e Apelit, mes të tjerave, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për kërkimet lidhur me shfuqizimin e urdhrit për përjashtimin. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se e drejta e kërkuesit për t'iu drejtuar me ankim gjykatës së juridiksionit të zakonshëm për kundërshtimin e urdhrit për përjashtimin është ushtruar tej afatit 30-ditor të parashikuar nga ligji i posaçëm. Kërkuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare në datën 13.01.2007. Padia objekt i këtij procesi është ngritur pas përfundimit të një procesi tjetër gjyqësor, për kompensimin për burgimin e padrejtë (i përfunduar në datën 15.04.2013) dhe sipas vendimit përkatës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, gjatë atij procesi janë administruar akte të tjera të korrespondencës mes kërkuesit dhe punëdhënësit, si dhe kartela e punësimit. Sipas gjykatës së apelit, pretendimi i kërkuesit se nuk ka qenë në dijeni të urdhrit për përjashtimin dhe se ka marrë dijeni për këtë urdhër në datën 20.04.2015 (gjatë seancës paraprake të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë) është i pabazuar, pasi provat shkresore, duke përfshirë edhe urdhrin për përjashtimin, janë depozituar nga punëdhënësi edhe me herët, në datën 24.06.2014 *(shih paragrafin 28 të vendimit)*. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe

nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të mos ketë garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes ose të mos ketë sqaruar rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi dhe se parashtrimi në rekurs i pretendimeve që lidhen vetëm me çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë *(shih faqen 8 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

32. Nga analiza në tërësi e rrethanave të çështjes dhe vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se kërkimi thelbësor i kërkuesit i ngritur gjatë procesit gjyqësor lidhet me marrjen dijeni të urdhrit për përjashtimin nga strukturat e policisë. Kërkuesi ka pretenduar se urdhri nuk i është komunikuar drejtpërdrejt dhe se ai ka marrë dijeni vetëm në datën 20.04.2015 gjatë zhvillimit të seancës paraprake në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kur nga subjekti i interesuar, DPPSH-ja, janë paraqitur provat në funksion të procesit gjyqësor objekt kundërshtimi edhe në këtë Gjykatë. Në fakt, sikur u parashtrua më sipër *(shih paragrafin 28 të vendimit),* procesi gjyqësor ka nisur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe gjatë dy seancave përgatitore të zhvilluara në atë gjykatë, ku kërkuesi ka qenë i pranishëm, janë cituar provat e depozituara nga subjekti i interesuar në datën 26.06.2014 (me shkresën e datën 24.06.2014), mes tyre edhe një kopje e urdhrit për përjashtimin e kërkuesit nga strukturat e policisë. Në këto kushte dhe bazuar në provat e administruara, Gjykata Administrative e Apelit ka analizuar të gjitha rrethanat dhe ka arritur në përfundimin se kërkuesi ka qenë në dijeni të urdhrit për përjashtimin të paktën në datën 01.11.2011, kur ka bërë kërkesë për rikthimin në strukturat e Policisë së Shtetit, por në çdo rast ai ka marrë dijeni gjatë seancave përgatitore të zhvilluara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe se padia e tij për shfuqizimin e urdhrit për përjashtimin nga strukturat e policisë është paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor të parashikuar në ligjin specifik.

33. Në vijim, Gjykata vlerëson të evidentojë se, si rregull, gjatë procesit administrativ për largimin nga detyra, administrata, si punëdhënëse, nuk mund t'i shmanget detyrimit për t'i njoftuar individit aktin e largimit nga detyra. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkuesi ka qenë në dijeni të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, për rrjedhojë edhe të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, për shkak të arrestimit të tij, sepse: *së pari,* në datën 09.01.2013 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Korçë me kërkesëpadi për kompensimin e burgimit të padrejtë dhe gjatë këtij procesi gjyqësor ai i është referuar faktit që është i papunë, ndërkohë që rezulton se Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë ka depozituar prova shkresore, përfshirë edhe urdhrin për përjashtimin e kërkuesit nga policia; *së dyti,* kërkuesi, që në momentin e depozitimit të padisë, në objektin e saj ka kërkuar edhe rikthimin në punë, duke lënë të nënkuptuar se ai i referohet faktit që nuk është më në marrëdhënie pune; *së treti,* ndonëse kërkuesi ka pretenduar se në seancën e datës 20.04.2015 është njohur me urdhrin e përjashtimit dhe ka paraqitur kërkesë për shtimin e objektit të padisë, duke kërkuar edhe shfuqizimin e atij urdhri, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues rezulton se ai ka marrë dijeni më parë gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Më konkretisht, në datën 26.06.2014 kur nga subjekti i interesuar janë depozituar prova shkresore, mes tyre edhe urdhri për përjashtimin e kërkuesit, të cilat janë administruar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë; *së katërti*, edhe Gjykata Administrative e Apelit e ka argumentuar qëndrimin e saj për pabazueshmërinë e pretendimit të kërkuesit për mosmarrjen dijeni të urdhrit për përjashtimin, duke vënë në dukje se argumenti i tij për marrjen dijeni për atë urdhër vetëm në datën 20.04.2015 (gjatë seancës paraprake të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë) nuk mbështetet në fakte e në prova. Ndonëse nga përmbajtja e dosjes gjyqësore rezulton se në seancën paraprake të datës 20.04.2015 në gjykimin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, DPPSH-ja ka paraqitur urdhrin për përjashtimin e kërkuesit nga Policia e Shtetit, kjo nuk ka qenë hera e parë që ky urdhër paraqitej si provë në atë proces gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit ka konstatuar se të njëjtat akte janë paraqitur më herët nga subjekti i interesuar në vitin 2014 (me shkresën e datës 24.06.2014) gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për rrjedhojë kërkesëpadia e tij është vlerësuar e paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor sipas ligjit specifik.

34. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm i përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ato kanë arsyetuar vendimet e tyre bazuar në provat e administruara në gjykim, të shqyrtuara dhe vlerësuara në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën. Gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuesit për marrjen dijeni të urdhrit për përjashtimin, duke parashtruar argumente për rrëzimin e tij dhe interpretimi që i ka bërë ligjit për zgjidhjen

e mosmarrëveshjes, nisur edhe nga periudha e gjatë që ka kaluar nga momenti kur ka ndodhur largimi nga detyra i kërkuesit deri në paraqitjen e kërkesëpadisë, nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues, pasi kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për kërkimin e tij. Gjithashtu, arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloj vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

35. Për rrjedhojë, në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.12.2025
Shpallur më 04.02.2026

Vendim nr. 81, datë 16.12.2025
(V-81/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryesuese, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 12.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (D) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **DESHIRE SUBASHI,** përfaqësuar nga avokate Evelina Qirjako, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA

MINISTRIA E DREJTËSISË, përfaqësuar nga Xhelal Kasaj, Ornela Marku, Erjon Ndreca, Albjona Toçi, me autorizim.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, përfaqësuar nga kryetari, Ilir Rusi.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, përfaqësuar nga komisioneri Robert Gajda.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, pika 1, 5, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Deshire Subashi (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, i cili e ka lënë në çmim të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) rrëzimin ose pranimin e kërkesës, mendimin me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*KMD*), i cili nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me çështjen konkrete, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja rezulton se është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë me vendimin nr. 3, datë 23.02.1993 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*KLD*). Po ashtu, rezulton se me vendimin nr. 146, datë 04.09.2003 të KLD-së kërkuesja është zgjedhur anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*KQZ*), me mandat 7-vjeçar. Në këtë kohë në fuqi ka qenë Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003. Përgjatë ushtrimit të këtij mandati ka hyrë në fuqi ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor Republikës së Shqipërisë", i cili sillte si pasojë ligjore ndërprerjen para kohe të mandatit të kërkueses si anëtare e KQZ-së. Në datën 02.02.2009 kërkuesja është rizgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë anëtare e KQZ-së, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në përfundim të mandatit të saj, në muajin tetor të vitit 2012.

2. Pas përfundimit të mandatit si anëtare e KQZ-së, kërkuesja rezulton t'i jetë drejtuar tri herë KLD-së për t'u rikthyer në pozicionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, të cilin ajo e ka ushtruar deri para kohës së emërimit të saj në detyrën e anëtarit të KQZ-së. Po ashtu, rezulton se KLD-ja nuk i ka marrë asnjëherë në shqyrtim këto kërkesa të kërkueses. Ndërkohë, gjatë kohës së parashtrimit të kërkesave nga

kërkuesja, rezulton që nga KLD-ja janë shpallur vende vakante pikërisht për emërime në detyrën e gjyqtarit në gjykatën e apelit. Pra, nga koha e paraqitjes së kërkesës për t'u rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës nga kërkuesja pranë KLD-së, deri në paraqitjen për gjykim të kërkesëpadisë është provuar dhe pranuar në gjykimin në gjykatat e zakonshme se nga pala e paditur, KLD-ja, janë bërë emërime në gjykatën e apelit. Në të njëjtën kohë rezulton se KLD-ja ka marrë në shqyrtim kërkesa edhe të ish-anëtarëve të tjerë të KQZ-së, për rikthimin e tyre në detyrat që ata kishin ushtruar para fillimit të emërimit dhe të ushtrimit të mandatit si anëtarë të KQZ-së.

3. Në këto rrethana, referuar faktit se kërkesa e saj nuk është marrë asnjëherë në shqyrtim nga KLD-ja, kërkuesja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt konstatimin e diskriminimit, ndreqjen e shkeljes së ligjit dhe shpërblimin e dëmit material dhe moral, si dhe detyrimin e KLD-së të marrë në shqyrtim kërkesën dhe të vendosë emërimin e saj në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7462, datë 17.12.2014, ka vendosur: "Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Konstatimin e diskriminimit për shkak të mosmarrjes në shqyrtim të kërkesës së palës paditëse nga ana e palës së paditur, KLD-së. Detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses. Detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë moralisht paditësen në masën një milion lekë, për shkak të konstatimit të diskriminimit […].". Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur, KLD-ja, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1106, datë 16.03.2017 (*vendimi i themelit*), ka vendosur: "Ndryshimin e vendimit nr. 7462, datë 17.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; pranimin e pjesshëm të padisë; detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë paditësen për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097, datë 23.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit" (*ligji nr. 8097/1996*), deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e KQZ-së, për periudhën nga data 01.01.2013 deri në datën 01.01.2016. Rrëzimin e padisë në kërkimet e tjera [...]". Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja, si dhe pala e paditur në proces, KLD-ja.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-

3621 (370), datë 24.09.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të themelit për sa i përket kërkimit për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit për këtë shkak, dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me tjetër trup gjykues, si dhe lënien në fuqi të vendimit të themelit për pjesën tjetër. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se në lidhje me kërkimin e kërkueses për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit për këtë shkak, Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykimin e çështjes, duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen në themel, të kryejë një cilësim të saktë të fakteve dhe rrethanave në këtë mosmarrëveshje, si dhe t'u japë përgjigje pretendimeve të palëve ndërgjyqëse për ta zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin dhe normat e tjera në fuqi. Po sipas Kolegjit Administrativ, pjesa tjetër e vendimit të themelit që ka disponuar për dëmshpërblimin e kërkueses duhet të lihet në fuqi.

7. Po ashtu, rezulton se pala e paditur, KLD-ja, ka kërkuar nga Gjykata Administrative e Apelit sqarimin e pikës 3 të dispozitivit të vendimit të themelit për urdhërimin: "Detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë paditësen për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097/1996, deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e KQZ-së, për periudhën nga data 01.01.2013 deri në datën 01.01.2016", duke kërkuar nga gjykata se cila është masa e dëmshpërblimit e caktuar prej saj.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 375, datë 20.12.2017 (*vendimi i sqarimit*), ka sqaruar se dëmi që pala e paditur detyrohet t'i paguajë paditëses (kërkueses), në zbatim të vendimit të themelit, është shuma që do të rezultojë nga diferenca ndërmjet pagës referuese për pozicionin e nënkryetares së KQZ-së dhe përfitimit që ajo ka marrë në masën 50% të pagës referuese në zbatim të ligjit nr. 8097/1996.

9. Ndaj vendimit të sqarimit ka paraqitur rekurs kërkuesja, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 13.02.2018. Krahas rekursit, rezulton se kërkuesja ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë edhe dy akte të titulluara "Notë verbale", të cilat mbajnë datat 18.09.2024 dhe 22.10.2024. Sipas këtyre akteve, si fillim kërkuesja ka parashtruar kundërshtimet e saj në lidhje me vendimin e sqarimit të gjykatës së apelit, duke i kërkuar Gjykatës së Lartë bashkimin e kësaj çështjeje me atë të gjykimit të themelit të kërkesëpadisë (akti i datës 18.09.2024), ndërsa në vijim, me aktin e datës 22.10.2024, i ka kërkuar Gjykatës së Lartë se duke qenë se kjo e fundit e ka zgjidhur çështjen e saj të themelit, çështja tjetër me objekt "Sqarimi dhe interpretimi i vendimit të themelit" ka rënë dhe nuk ka më objekt. Për

këtë arsye, kërkuesja i ka kërkuar Gjykatës së Lartë pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se kërkuesja, me shkresat nr. 5210 prot., datë 22.10.2024 dhe nr. 5239 prot., datë 24.10.2024, ka kërkuar pushimin e çështjes, bazuar në nenin 490 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Për këtë arsye, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se nuk ka vend për trajtimin e mëtejshëm të shkaqeve të rekursit, për shkak të heqjes dorë prej tij.

11. Në datën 13.03.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili është regjistruar në datën 17.03.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 23.04.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

12. Në datën 26.11.2025, një prej gjyqtarëve të Gjykatës, bazuar në nenin 36, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit Organik të saj dhe nenin 18, pika 1, shkronja "ç", të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, kërkesë e cila është pranuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës në të njëjtën datë.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. ***Kërkuesja*** ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se është cenuar:

13.1. *E drejta e aksesit dhe e drejta e ankimit efektiv*, pasi kërkuesja në asnjë moment nuk ka hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes së saj në Gjykatën e Lartë. Heqja dorë është supozuar nga vetë Gjykata e Lartë, ndërkohë që kërkuesja nuk ka shfaqur asnjë vullnet për të hequr dorë nga shqyrtimi i rekursit të saj. Po ashtu, rezulton se nga të gjitha aktet e paraqitura nga kërkuesja në Gjykatën e Lartë, nuk shfaqet vullneti i saj për të hequr dorë nga rekursi. Këto të drejta janë cenuar edhe për faktin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit bazuar nën një prezumim të gabuar se kërkuesja kishte hequr dorë nga e drejta e rekursit.

13.2. *Parimi i disponibilitetit dhe e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi nga notat verbale të depozituara nëpërmjet *e-mail*-it nga përfaqësuesja e kërkueses, në asnjë rresht të tyre nuk përmendet termi "heqje dorë" nga rekursi dhe as neni 490 i KPC-së. Shkaku i këtyre notave verbale ka qenë që në mbështetje të rekursit të paraqitur nga kërkuesja me objekt "Prishjen e vendimit të sqarimit dhe pushimin e gjykimit", të evidentohej disponimi i vendimit të themelit për dëmin pasuror, i cili ishte i ligjshëm dhe u konfirmua nga Gjykata e Lartë tre muaj përpara me vendimin nr. 00-2024-3621 (370), datë 24.09.2024. Pra, baza dhe shkaku i notave verbale ka qenë pushimi i gjykimit të çështjes për kërkesën për sqarim vendimi, si çështje e mbetur pa objekt dhe gjykimi i së cilës nuk mund të vazhdonte bazuar në dispozitat procedurale. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka vendosur *ultra petita* mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, pa ushtruar asnjëherë kjo e fundit deponimin e kësaj të drejte nëpërmjet kërkesës për heqje dorë nga rekursi, në përputhje me nenin 490 të KPC-së. Nota verbale e kërkueses është dërguar prej saj pranë Gjykatës së Lartë në formë të skanuar, ndërsa nga përfaqësuesja e kërkueses është nënshkruar pa tagra përfaqësimi për të hequr dorë nga rekursi, pasi prokura për përfaqësuesen e legjitimonte këtë të fundit vetëm për gjykimin e themelit të çështjes. Nota verbale nga përfaqësuesja është dërguar me qëllim informimin e Gjykatës së Lartë për gjykimin tjetër të zhvilluar pranë saj.

13.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë, duke deformuar vullnetin e kërkueses, e ka privuar atë nga pritshmëritë e ligjshme të krijuara për çështjen e saj, si dhe nga garantimi i realizimit të së drejtës për mbrojtje efektive përpara një gjykate të caktuar me ligj. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin në aspektin substancial dhe material. Po ashtu, në rastin konkret është krijuar një anomali juridike, ku për të njëjtën çështje dhe me të njëjtat palë, ekzistojnë dy vendime të së njëjtës gjykatë që disponon në mënyra të ndryshme. Nga njëra anë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e themelit të gjykatës së apelit në lidhje me të drejtën për të përfituar pagën e plotë për periudhën nga data 01.01.2013 deri në datën 01.01.2016, dhe nga ana tjetër, me vendimin objekt të këtij gjykimi kushtetues, për shkak të mospranimit të rekursit,

si pasojë e heqjes dorë (sipas Kolegjit Administrativ), ka lënë në fuqi vendimin e sqarimit, i cili ka përgjysmuar vlerën e dëmit pasuror që i është njohur kërkueses me vendimin e themelit.

14. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë***, e ka lënë vlerësimin e çështjes në çmim të Gjykatës.

15. ***Subjekti i interesuar, KLGJ-ja***, ka parashtruar se pretendimet e kërkueses nuk janë të bazuara, pasi ajo ka paraqitur rekurs, si dhe nota verbale, mbi bazën e të cilave ka shprehur qëndrimin e saj për çështjen. Po ashtu, Kolegji Administrativ në rastin konkret nuk ka disponuar me dy vendimmarrje të ndryshme, por një çështje të kërkueses e ka zgjidhur në themel, duke e dërguar për rigjykim në gjykatën e apelit, ndërsa për tjetrën, bazuar në notat verbale të saj, nuk u ka hyrë shkaqeve të rekursit.

16. ***Subjekti i interesuar, KMD-ja***, ka parashtruar se duke qenë se çështja objekt i këtij gjykimi kushtetues nuk lidhet me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, ka vlerësuar mos të mbajë qëndrim në lidhje me pretendimet e kërkueses, por ka paraqitur një mendim me shkrim, duke evidentuar garancitë që ofron ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

17. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në këtë këndvështrim, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt

të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

19. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Ky rregull, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues, me objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të saj ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit që kishte disponuar për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit. Për nga natyra dhe qëllimi, ky lloj vendimi i bashkohet si pjesë përbërëse vendimit përfundimtar që ka disponuar për themelin e çështjes së kërkueses, pra për të drejtën e dëmshpërblimit të saj. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ajo e ka përmbushur këtë kriter, pasi nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, të pretenduara si të cenuara.

21. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 17.12.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 13.03.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit 4-mujor.

22. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së *drejtës së aksesit* dhe *së drejtës së ankimit efektiv*, *parimit të disponibilitetit* dhe atij të *sigurisë juridike*, si dhe *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak se, sipas saj, Gjykata e Lartë, duke i konsideruar kërkesat e saj të shprehura në aktet "Notë verbale" si heqje dorë nga gjykimi i çështjes, i ka deformuar vullnetin.

23. Për sa më lart, Gjykata, duke mbajtur parasysh natyrën dhe

përmbajtjen e argumenteve të parashtruara në mbështetje të këtyre pretendimeve të kërkueses, vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, ndaj, në vijim, do ta shqyrtojë çështjen në themel në këtë drejtim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka konsideruar kërkesat e saj të paraqitura në atë gjykatë si kërkesa për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, ndërkohë që ajo në asnjë moment nuk e ka kërkuar një gjë të tillë. Sipas kërkueses, në këtë rast heqja dorë është supozuar nga vetë Gjykata e Lartë, pasi ajo nuk ka shfaqur asnjë vullnet për të hequr dorë nga shqyrtimi i rekursit të saj. Në këtë kuptim, kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka deformuar vullnetin e saj, duke e privuar nga pritshmëritë e ligjshme të krijuara për çështjen.

25. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka parashtruar se Kolegji Administrativ në rastin e kërkueses nuk ka disponuar me dy vendimmarrje të ndryshme, por një çështje të saj e ka zgjidhur në themel, ndërsa për tjetrën nuk u ka hyrë shkaqeve të rekursit. Ndërkohë, subjekti tjetër i interesuar, KMD-ja, ka vlerësuar mos të mbajë qëndrim në lidhje me pretendimet e kërkueses, ndërsa subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, e ka lënë vlerësimin e çështjes në çmim të Gjykatës.

26. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës ka parashikuar se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

27. Lidhur me të drejtën e aksesit, Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet

pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 05.11.2025; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 05.11.2025; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura dhe nisur nga konteksti i rrethanave të çështjes, në rastin konkret Gjykata do të analizojë aktet e paraqitura nga kërkuesja (notat verbale) pranë Gjykatës së Lartë, pas depozitimit të rekursit dhe vlerësimin që u ka bërë kjo e fundit atyre, për të arritur në përfundimin nëse ky vlerësim përkon me vullnetin e kërkueses. Për këtë arsye, Gjykata do të analizojë edhe arsyetimin e bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e kundërshtuar nga kërkuesja, për të vlerësuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

30. Gjykata vëren se për kërkesëpadinë e kërkueses Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke disponuar, ndër të tjera, detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses, si dhe detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë moralisht paditësen në masën një milion lekë, për shkak të konstatimit të diskriminimit. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, për sa i përket masës së dëmshpërblimit që përfiton kërkuesja (vendimi i themelit), duke disponuar se KLD-ja duhet ta dëmshpërblejë atë për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar

pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097/1996 deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e KQZ-së, për periudhën nga data 01.01.2013 deri në datën 01.01.2016. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në datën 24.09.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të themelit të gjykatës së apelit vetëm për sa i përket kërkimit për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin për këtë shkak, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit, ndërsa e ka lënë në fuqi atë vendim për pjesën tjetër, për sa i përket dëmshpërblimit të kërkueses në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097/1996.

31. Gjykata Administrative e Apelit, pas kërkesës së KLGj-së për sqarimin dhe interpretimin prej saj të vendimit të themelit, ka sqaruar me vendim dispozitivin e vendimit (të themelit). Ndaj këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs. Referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se kërkuesja, krahas rekursit, ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë edhe dy akte të tjera të titulluara "Notë verbale" të datës 18.09.2024 (akti i parë) dhe të datës 22.10.2024 (akti i dytë).

32. Referuar këtyre akteve, Gjykata konstaton se kërkuesja në aktin e parë, si fillim ka parashtruar kundërshtimet e saj në lidhje me vendimin e sqarimit të gjykatës së apelit, duke i kërkuar Gjykatës së Lartë bashkimin e kësaj çështjeje me atë të gjykimit të themelit të kërkesëpadisë. Gjithashtu, kërkuesja ka vijuar me pretendimet e saj në lidhje me kërkesëpadinë e çështjes së themelit, duke i kërkuar në përfundim Gjykatës së Lartë "pranimin e rekursit të pjesshëm të saj" për çështjen e themelit. Ndërsa, referuar aktit të dytë, Gjykata vëren se kërkuesja i ka parashtruar Gjykatës së Lartë se kjo e fundit, me vendimin e datës 24.09.2024, e ka zgjidhur themelin e kërkesëpadisë së saj. Në këto kushte, referuar të njëjtit akt, sipas kërkueses, çështja që do të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë, me objekt "Sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr. 1106, datë 16.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit", ka rënë dhe nuk ka më objekt. Si konkluzion, në aktin e dytë, kërkuesja i ka kërkuar Gjykatës së Lartë që "*pasi të marrë në shqyrtim çështjen, të vendosë pushimin e gjykimit të saj, në kushtet kur çështja e themelit tashmë është zgjidhur me vendim përfundimtar të formës së prerë të datës 24.09.2024 të Gjykatës së Lartë dhe si pasojë çështja me objekt "sqarim/interpretim" në datën e zhvillimit të gjykimit paraqitet pa objekt"*.

33. Në lidhje me këto kërkesa të kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit për çështjen me objekt sqarimin dhe

interpretimin e vendimit të themelit, duke vlerësuar se kërkuesja, me shkresat nr. 5210 prot., datë 22.10.2024 dhe nr. 5239 prot., datë 24.10.2024, ka kërkuar pushimin e çështjes, bazuar në nenin 490 të KPC-së dhe për këtë arsye ka vlerësuar se nuk ka vend për trajtimin e mëtejshëm të shkaqeve të rekursit, për shkak të heqjes dorë prej tij (*shih paragrafin 11 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

34. Ndërkohë, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Gjykata vëren se rezulton e administruar vetëm shkresa "Notë verbale" nr. 5210 prot., datë 22.10.2024. Për këtë arsye, Gjykatës së Lartë iu kërkua nga Gjykata të vinte në dispozicion një kopje të shkresës nr. 5239 prot., datë 24.10.2024, të depozituar nga kërkuesja dhe të cituar në vendimin e Kolegjit Administrativ. Në përgjigjen e saj Gjykata e Lartë ka informuar se ky akt është dërguar në rrugë elektronike në një nga adresat e asaj gjykate, i cili është protokolluar me ato ekstremitete, por nuk rezulton të jetë administruar në dosjen gjyqësore dhe ka të njëjtën përmbajtje si shkresa nr. 5210 prot., datë 22.10.2024, e depozituar nga kërkuesja në rrugë shkresore, dhe të dyja bashkë janë përmendur në vendimin e Kolegjit Administrativ.

35. Nisur nga sa më lart, Gjykata konstaton se nëpërmjet aktit nr. 5210 prot., datë 22.10.2024 (akti i dytë), nuk rezulton që kërkuesja të ketë hequr dorë nga shqyrtimi i rekursit. Jo vetëm kaq, por sipas këtij akti, Gjykata vëren se kërkuesja nuk i është referuar asnjëherë si bazë ligjore nenit 490 të KPC-së (rastet e heqjes dorë nga rekursi), as në formë dhe as në përmbajtje, por e gjendur përballë faktit se çështja e themelit ishte zgjidhur tashmë nga i njëjti kolegj i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3621 (370), datë 24.09.2024, i ka kërkuar kësaj të fundit të pushojë çështjen me objekt sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit, pasi kishte mbetur pa objekt.

36. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se qartazi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të kishte vlerësuar me kujdes përmbajtjen e aktit/memories së depozituar nga pala, për të arritur në përfundimin se kërkuesja kërkonte pushimin e gjykimit për shkak se çështja kishte mbetur pa objekt, duke iu referuar në fakt parashikimit të nenit 299, shkronja "c", të KPC-së, sipas të cilit në rastet kur gjykimi nuk mund të vijojë më dhe kjo konstatohet prej gjykatave më të larta, ato prishin vendimin e gjykatës më të ulët dhe pushojnë çështjen. Kërkuesja kishte kundërshtime për vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit që shprehej për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit, por meqenëse ndërkohë themeli

i çështjes ishte vendosur (për shkak të vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës së Lartë), diskutimi dhe gjykimi i rekursit kundër vendimit nr. 375, datë 20.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit (*vendimi i sqarimit*), nuk kishte më kuptim. Për rrjedhojë, Gjykata evidenton se me vlerësimin që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka bërë aktit nr. 5210 prot., datë 22.10.2024, nuk ka analizuar drejt vullnetin e shprehur nga kërkuesja në të, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së aksesit. Kjo do të thotë se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke interpretuar në mënyrë të pakujdesshme vullnetin e kërkueses, për rrjedhojë duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk u ka dhënë në substancë përgjigje pretendimeve të saj.

37. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, prandaj ankimi kushtetues individual i saj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.12.2025
Shpallur më 23.01.2026

Vendim nr. 82, datë 18.12.2025
(V-82/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 06.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (K) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KLODIANA CANKJA, ERMELINDA CANKJA, ARDIT CANKJA, DRITA CANI, SUZANA CANI, MARVIS CANI, ENGJËLL TIRANA, BRIAN TIRANA, HELGA HASEKIU**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonzaj, me autorizim.

MINISTRIA E BRENDSHME, përfaqësuar nga prefekti i qarkut Elbasan, Ilir Bejtja, me urdhër delegimi.

BASHKIA E ELBASANIT, në mungesë.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4040, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 18, 41, 42, 43, 44, 131, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 71 e në vijim të ligjit**

nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Bashkisë së Elbasanit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 228, datë 14.05.2014 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga hapja dhe sistemimi i rrugës "11 Nëntori", segmenti nga shkolla "Jorgji Dilo" deri te "Rotonda te Posta", të Bashkisë së Elbasanit" (*VKM-ja e Shpronësimit)*, bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" *(Ligji për Shpronësimet*), ka shpronësuar kundrejt shpërblimit disa pasuri të paluajtshme që prekeshin nga hapja dhe sistemimi i rrugës "11 Nëntori" në qytetin e Elbasanit. Dy prej pasurive të paluajtshme të shpronësuara u përkisnin trashëgimlënësve ligjorë të kërkuesve. Pasuria e parë ishte truall me sipërfaqe 202 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 82 m^2, e shpronësuar kundrejt shpërblimit 4.577.120 lekë, duke vlerësuar ndërtesën me vlerën 45.119 lekë/m^2, truallin me vlerën 4.081 lekë/m^2 dhe drufrutorët me vlerën 53.000 lekë. Pasuria e dytë ishte truall me sipërfaqe 262,15 m^2 e shpronësuar kundrejt shpërblimit prej 1.172.434,15 lekësh, duke e vlerësuar truallin sërish me vlerën 4.081 lekë/m^2 dhe drufrutorët me vlerën 102.600 lekë. Si rezultat i këtij shpronësimi, të shpronësuarit e këtyre dy pasurive kanë përfituar shpërblimin gjithsej prej 5.749.554,15 lekësh.

2. Shpërblimi është përllogaritur sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.02.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" (*VKM-ja e Kritereve Teknike të Vlerësimit*) dhe nr. 187, datë 06.03.2013 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë" (*VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013*). Kjo e fundit është miratuar bazuar në vendimin nr. 658, datë 26.09.2012 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë" (*Metodologjia e Vlerësimit të Pronave*), i cili, për të përllogaritur vlerën e pasurive të paluajtshme, krijon një proces të plotë administrativ të mbledhjes të të dhënave të tregut nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas çmimit të kontratave të shitjes të regjistruara prej tyre.

3. Vlera e ndërtesës për njësi/m^2 është përcaktuar me shkrim në shtator 2013 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Elbasan, me referencë *de jure* te mesatarja e shitblerjes të këtyre lloj pasurive gjatë vitit 2013 në zonën kadastrale ku ndodhej pasuria e kërkuesve. Ndërsa vlera e truallit për njësi/m^2 është konfirmuar me shkrim në tetor 2013 nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me referencë te VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013.

4. Me pretendimin se vlera e shpërblimit nuk i përgjigjej çmimit të tregut, një nga bashkëpronarët e dy pasurive ka paraqitur padi në gjykatë kundër Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë së Elbasanit, duke kërkuar ndryshimin e pjesshëm të VKM-së së Shpronësimit vetëm për sa i përket vlerës së shpërblimit. Gjatë gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka pranuar ndërhyrjen kryesore të bashkëpronarëve të tjerë, me të njëjtin objekt si ai i padisë dhe gjykimi ka vazhduar edhe me pjesëmarrjen e tyre.

5. Ndërkohë që çështja po shqyrtohej në gjykatën e shkallës së parë, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 514, datë 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë" (*VKM-ja e Vlerës së Pronës 2014),* me të cilin vlera e truallit për njësi/m^2 në zonën kadastrale të pasurive të kërkuesve u caktua në masën 7.502 lekë/m^2.

6. Gjatë gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me kërkesë të përfaqësuesit të kërkuesve, ka caktuar ekspert në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme për të përcaktuar vlerën e shpërblimit. Në datën 19.11.2014 eksperti ka paraqitur aktin e ekspertimit, për të cilin

kishte përdorur metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë, duke marrë parasysh ecurinë e transaksioneve të pronave të ngjashme, karakteristikat e veçanta të pasurive të shpronësuara dhe pozicionimin e tyre. Sipas ekspertit, pasuria e parë vlerësohej me 7.472.000 lekë (24.000 lekë/m^2 për truallin dhe 56.000 lekë/m^2 për ndërtesën), ndërsa pasuria e dytë me 6.291.600 lekë (24.000 lekë/m^2). Si rezultat i përllogaritjeve të ekspertit, shpërblimi i shpronësimit për të dyja pasuritë duhej të ishte 13.763.600 lekë.

7. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 88, datë 28.01.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se institucionet publike provuan në gjykim ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre në caktimin e vlerës së shpronësimit. Sipas saj, institucionet publike e kishin llogaritur shpërblimin sipas VKM-së së Kritereve Teknike të Vlerësimit që referonte te VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013. Për sa i takon aktit të ekspertimit, që kishte përcaktuar një vlerë dukshëm më të lartë, gjykata e shkallës së parë është shprehur se eksperti nuk e kishte arsyetuar konkluzionin e tij, ekspertimi nuk kishte vlerë të paracaktuar provuese dhe nuk lidhej me provat e tjera të shqyrtuara. Po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar se nuk mund t'i referohej një vlere të kërkuar nga palët dhe të mbështetur nga eksperti, por ajo duhej përcaktuar sipas një metodologjie shtetërore, në mënyrë që të mos cenohej përmbushja e interesit publik.

8. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Kjo e fundit me vendimin nr. 2182/2256, datë 18.05.2017, ka arsyetuar se shpërblimi i shpronësimit ishte përllogaritur bazuar në Ligjin për Shpronësimet, i cili në nenet 17 dhe18 autorizon Këshillin e Ministrave të caktojë kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së shpërblimit. Më tej, ajo gjykatë është shprehur se, në të kundërt me sa pretendonin kërkuesit, vlera e shpronësimit nuk përllogaritet sipas akteve nënligjore në fuqi në kohën kur del vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton shpronësimin, por sipas atyre në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësimin. Në mbështetje të këtij arsyetimi, gjykata e apelit ka analizuar përmbajtjen e neneve 10, 17 dhe 19 të Ligjit për Shpronësimet, të cilat rregullojnë procedurën e shpronësimit, përllogaritjen e vlerësimit paraprak dhe të atij përfundimtar të pasurisë që shpronësohet. Për rrjedhojë, sipas Gjykatës Administrative të Apelit, shpërblimi ishte i drejtë, pasi ishte përllogaritur nga institucionet publike bazuar në VKM-në e Vlerës së Pronës 2013 dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësimin.

9. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4040, datë 22.10.2024, ka vendosur mospranimin e tij. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat e faktit kishin përcaktuar saktë faktet e mosmarrëveshjes dhe kishin analizuar hollësisht Ligjin për Shpronësimet.

10. Në datën 14.02.2025 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 02.05.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Gjykata në datën 06.11.2025 ka zhvilluar seancën plenare mbi bazë të dokumenteve dhe deri në datën 18.12.2025 ka biseduar për marrjen e vendimit. Përgjatë kohës së bisedimeve, gjyqtarja Holta Zaçaj, njëherazi Kryetare e Gjykatës, ka përfunduar ushtrimin e detyrës, për rrjedhojë nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë u janë cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.1.1. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë pa arsyetim nuk ka bërë zëvendësimin procedural të një prej rekursuesve (ndërhyrës kryesor në proces), që kishte ndërruar jetë, megjithëse ishte kërkuar me shkrim në datën 15.10.2024, duke paraqitur edhe dëshminë e trashëgimisë ligjore.

11.1.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë sipërfaqësore, pa analizuar pretendimet e kërkuesve. Ajo nuk ka dhënë përgjigje për pretendimet se përse nuk është aplikuar vlera e tokës në momentin e shpronësimit dhe as përse gjykata e apelit nuk ka analizuar aktin e ekspertimit. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk është bindës dhe bie ndesh me qëndrimin që ajo ka mbajtur në raste të tjera të ngjashme.

11.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi vlera e shpronësimit është shumë e ulët, duke i vendosur kërkuesit në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta

me pronarët e pasurive të ngjashme, që i shesin pronat me çmimet e tregut, si dhe me ata që janë shpronësuar pas dy muajve, që janë shpërblyer me çmimet e reja të rritura me gati 100%.

11.3. *E drejta e pronës,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi atyre u është mohuar përfitimi i shpërblimit të drejtë, i cili më së paku duhet të ishte i njëjtë me çmimin e miratuar në vitin 2014 kur ndodhi shpronësimi dhe jo me çmimin e VKM-së së Vlerës së Pronës 2013, që i referohet situatës së tregut në vitin 2012. Shpërblimi nuk është aspak në koherencë me çmimet e aplikuara në të njëjtën zonë si përpara ashtu edhe pas shpronësimit. Për më tepër, rruga e re Tiranë-Elbasan ka rritur ndjeshëm vlerën e pronës. Për rrjedhojë, është cenuar edhe *parimi i sigurisë juridike*.

12. ***Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit,*** kanë prapësuar mbi të njëjta argumente, duke u shprehur, në mënyrë të përmbledhur, se:

12.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është haptazi i pabazuar. Çështja lidhet drejtpërdrejt me shpërblimin e drejtë, që ka të bëjë me vlerësimin dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, ndaj nuk i përket juridiksionit kushtetues. Gjykata e apelit ka vlerësuar pretendimet në mënyrë të plotë mbi bazën e akteve të dosjes gjyqësore. Shpronësimi është bërë në përputhje me Ligjin për Shpronësimet dhe aktet nënligjore në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësimin. Akti i ekspertimit ka qenë teorik dhe jo konkret, pasi eksperti nuk ka sjellë asnjë argument dhe provë bindëse për vlerën e pronës të përllogaritur prej tij sipas metodologjive të përcaktuara në VKM. Gjykata e Lartë ka plotësuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit, pasi ka shprehur përmbledhtazi shkaqet e mospranimit të rekursit dhe pjesa arsyetuese lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv.

12.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron, pasi argumentet nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Fakti që gjykatat kanë vendosur ndryshe në raste të tjera, nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e kërkuesve. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë shprehur me vendim njësues për çështje të kësaj natyre, ndaj kërkuesit nuk mund të kenë pritshmëri të ligjshme për pretendimet e tyre.

12.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi metodologjia e përdorur në përcaktimin e vlerës së shpronësimit të pasurisë nuk shfaq probleme në aspektin kushtetues. Po kështu, interpretimi që gjykatat i kanë bërë konceptit kushtetues të "shpërblimit të drejtë" nuk rezulton të jetë arbitrar.

13. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme, përfaqësuar nga prefekti i qarkut Elbasan**,* në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara. Procedura e shpronësimit është bërë në përputhje me aktet ligjore në fuqi në atë kohë. Çmimi, përllogaritja dhe vlera për shpronësim për kategorinë "truall" janë bërë nga Bashkia e Elbasanit, bazuar në VKM-në e Vlerës së Pronës 2013, ku është përcaktuar çmimi për të gjitha pronat që do të shpronësohen për interes publik, për rrjedhojë Ministria e Brendshme nuk mund të rishikojë përllogaritjen e çmimit.

14. ***Subjekti i interesuar, Bashkia e Elbasanit,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

15. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin nuk është pranuar rekursi i tyre ndaj vendimeve gjyqësore që kanë rrëzuar padinë e tyre për shpërblimin nga shpronësimi, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar. Ata e kanë përmbushur

edhe *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion,* të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor për çështjen e shpërblimit nga shpronësimi. Po kështu, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 22.10.2024 dhe ankimin kushtetues individual e kanë paraqitur në datën 14.02.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae* kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit), parimi i barazisë përpara ligjit dhe e drejta e pronës private e lidhur me sigurinë juridike, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 18 dhe 41 të Kushtetutës.

18. Për sa i takon *së drejtës së aksesit*, ata kanë parashtruar se gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, dy prej bashkëpronarëve të pasurisë, që kishin vënë në lëvizje procesin gjyqësor (paditësja dhe një ndërhyrëse kryesore), kanë ndërruar jetë. Sipas tyre, Gjykata e Lartë, pa dhënë asnjë argument, ka vepruar ndryshe për kalimin procedural, pasi për një bashkëpronar e ka bërë kalimin, ndërsa për tjetrin jo, megjithëse për këtë të fundit kërkuesit, në datën 15.10.2024, kishin paraqitur kërkesë me shkrim.

19. Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë janë shënuar emrat e trashëgimtarëve ligjorë të njërit prej bashkëpronarëve (paditëses), si dhe emrat e bashkëpronarëve të tjerë (ndërhyrësit kryesorë). Ndërsa në pjesën arsyetuese është përshkruar se me vendim të ndërmjetëm është bërë kalimi procedural i palës paditëse te fëmijët e saj bazuar në dëshminë e trashëgimisë që mban datën 28.01.2020 (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nuk rezulton që e njëjta procedurë të jetë ndjekur për trashëgimtarët ligjorë të bashkëpronarit tjetër (një prej ndërhyrësve kryesorë), që ka ndërruar jetë, përpara dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, gjë që *prima facie* përbën shkelje procedurale. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson *(shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Mbi bazën e këtij standardi, si dhe duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, se kërkuesit nuk kanë argumentuar sesi kjo shkelje ka pasur ndikim vendimtar në ecurinë e procesit dhe interesat e tyre,

dhe, nga ana tjetër, se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre, që kanë mbajtur të njëjtin qëndrim përgjatë të gjithë procesit, konkludohet se shkelja nuk është thelbësore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar.

20. Gjykata vëren se pretendimet e tjera të kërkuesve (standardi i arsyetimit të vendimit, parimi i barazisë përpara ligjit dhe e drejta e pronës), kanë të bëjnë me shpërblimin nga shpronësimi. Konkretisht, kërkuesit janë ankuar bazuar në nenet 42, 18 dhe 41 të Kushtetutës, duke parashtruar se Gjykata e Lartë, në ndryshim nga qëndrimi që ka mbajtur në raste të tjera të ngjashme, ka dështuar t'u japë përgjigje për vlerën e shpërblimit për dy pasuritë e shpronësuara, si dhe për refuzimin e rezultateve të ekspertimit. Ndërsa subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se arsyetimi i Gjykatës së Lartë plotëson standardet kushtetuese dhe se përcaktimi i shpërblimit ka të bëjë me interpretimin e ligjit dhe me çmuarjen e provave, ndaj nuk përbën çështje kushtetuese. Sipas tyre, në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk ka dhënë vendim njësues për çështje të kësaj natyre, nuk mund të ngrihen pretendime për qëndrimet e saj në çështje të ngjashme.

21. Neni 41 i Kushtetutës, teksa garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*), përcakton, ndër të tjera, se ligji mund të parashikojë shpronësimin vetëm për interesa publikë (*pika 3),* ndërsa shpronësimi lejohet vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (*pika 4)* dhe për mosmarrëveshjet për masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë (*pika 5*).

22. Në jurisprudencën kushtetuese për sa u takon garancive të nenit 41 të Kushtetutës është pohuar se e drejta e pronës përjashtimisht mund të cenohet vetëm në formën e *"shpronësimit"* dhe të *"kufizimit"*. Kufizimi i ligjshëm që mund t'i bëhet së drejtës së pronësisë, në njërën prej këtyre dy situatave, kërkohet të realizohet me *"ligj", "vetëm për interesa publikë"* dhe *"vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë"* (*shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Shpërblimi i drejtë është koncept kushtetues i lidhur me rastet e shpronësimit ose kufizimit të së drejtës së pronës me ligj për interesa publikë gjatë një marrëdhënieje midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyn një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm për masën e shpërblimit (*shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se gjatë gjykimit të zhvilluar përpara gjykatave të zakonshme nuk ka pasur kundërshtim për faktin se dy pasuritë e kërkuesve

janë shpronësuar bazuar në Ligjin për Shpronësimet për zbatimin nga Bashkia e Elbasanit të projektit për interes publik për hapjen dhe sistemimin e rrugës "11 Nëntori" brenda qytetit. Me fjalë të tjera, është fakt i pakundërshtueshëm se kërkuesit kanë pësuar ndërhyrje me ligj në të drejtën themelore të pronës, ndërhyrje e cila ka plotësuar edhe kriterin e interesit publik. Thënë këtë, çështja kryesore që është shtruar për zgjidhje përpara gjykatave të zakonshme lidhet me proporcionalitetin e ndërhyrjes, konkretisht me vlerën për metër katror të truallit dhe të ndërtesës, me të cilat është përllogaritur shpërblimi i kërkuesve për shpronësimin. Edhe pse gjykatat e zakonshme, si rregull, janë në pozicionin më të mirë për të përcaktuar ekzistencën dhe masën e dëmit, për shkak të kompetencës së tyre për të shqyrtuar dhe vlerësuar provat, Gjykata thekson se, sipas neneve 41, pika 4 dhe 17, të Kushtetutës, ajo ka juridiksion për të vlerësuar nëse shpërblimi për shpronësimin është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm, pra nëse është proporcional.

24. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se prapësimi i subjekteve të interesuara se rasti nuk përbën çështje kushtetuese nuk qëndron, ndaj do ta shqyrtojë themelin e saj në këndvështrim të standardit të arsyetimit të lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës, që hyn në juridiksionin kushtetues. Brenda të njëjtit këndvështrim dhe për aq sa është i zbatueshëm parimi i barazisë përpara ligjit, Gjykata do t'u japë përgjigje edhe argumenteve të palëve për qëndrimin e ndryshëm që Gjykata e Lartë ka mbajtur në çështje të tjera të ngjashme.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës

25. Kërkuesit kanë parashtruar se janë shpronësuar përkundrejt një shpërblimi të padrejtë. Vlera e shpronësimit është llogaritur në kohën e kërkesës për shpronësim sipas VKM-së së Vlerës së Pronës 2013, e cila i ka përcaktuar çmimet sipas situatës së tregut në vitin 2012. Ndërkohë, kërkuesit janë shpronësuar në vitin 2014, vit në të cilin u miratua VKM-ja e Vlerës së Pronës 2014, që rriti vlerën e tokës me gati 100%, ndaj gjykatat e zakonshme duhej t'u referoheshin vlerave të nxjerra nga akti i ekspertimit. Shpërblimi nuk është në koherencë me çmimet e aplikuara në të njëjtën zonë si përpara, ashtu edhe pas shpronësimit. Rruga e re Tiranë-Elbasan ka rritur ndjeshëm vlerën e pronës. Sipas kërkuesve, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk është bindës dhe bie ndesh me qëndrimin që ajo

ka mbajtur në vendime të tjera të ngjashme. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se përse gjykata e apelit nuk ka analizuar aktin e ekspertimit.

26. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se shpërblimi i shpronësimit është përcaktuar nga gjykatat e zakonshme sipas metodologjisë në fuqi, që nuk shfaq probleme kushtetuese. Interpretimi i "shpërblimit të drejtë" nga gjykatat nuk rezulton të jetë arbitrar dhe nuk cenon të drejtën e kërkuesve. Sipas tyre, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesve për aktin e ekspertimit, njësoj si gjykata administrative e shkallës së parë, se eksperti nuk ka sjellë asnjë argument bindës në aktin e ekspertimit për përllogaritjen e shpërblimit. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, Ministria e Brendshme, ka prapësuar se shpërblimi është përllogaritur nga Bashkia e Elbasanit bazuar në VKM-në e Vlerës së Pronës 2013, për rrjedhojë ministria nuk mund të rishikonte përllogaritjen e shpërblimit.

27. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

28. Sipas Gjykatës, e drejta e individit të shpronësuar për shpërblim të drejtë përbën garanci kushtetuese me natyrë materiale në rastin e shpronësimit (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 41 i Kushtetutës nuk ka përcaktuar kriteret që duhen zbatuar për përcaktimin e "shpërblimit të drejtë", që do të thotë se kushtetutëbërësi e ka lënë në diskrecionin e ligjvënësit për të përcaktuar treguesit konkretë të vlerësimit të tij (*shih vendimin nr. 33, datë 30.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata e ka marrë edhe më parë në analizë "shpërblimin e drejtë", të parashikuar në nenin 41, pika 4, të Kushtetutës, por rastet kanë pasur të bëjnë me procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave të marra padrejtësisht nga shteti në vitet 1945-1990 dhe jo me shpronësimet e tjera për interes publik. Për rastet e para, Gjykata, duke interpretuar edhe nenin 181 të Kushtetutës, ka theksuar se garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*KEDNJ*) për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e padrejta nga shteti. Në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, Gjykata e ka interpretuar shpërblimin e drejtë të lidhur me interesin publik, veçanërisht me respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Sipas saj, nga kriteret kushtetuese të "rregullimit të drejtë" dhe të "shpërblimit të drejtë", të pranuara në nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës, kriteri për shpërblimin ose kompensimin në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Lidhur me shpërblimin nga shpronësimi, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka theksuar se autoritetet vendase gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin e masës së tij. Roli i saj është i kufizuar, ajo respekton gjykimin e ligjvënësit për shpërblimin për shpronësimin përveçse kur ai është haptazi i paarsyeshëm (*shih Lithgow dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 08.07.1986, § 122*). Sipas GJEDNJ-së, ekuilibri midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore individuale, si rregull, arrihet kur shpërblimi që i paguhet të shpronësuarit lidhet në mënyrë të arsyeshme me vlerën e tregut, të përcaktuar në kohën e shpronësimit (*shih Gashi kundër Kroacisë, datë 13.12.2007, § 41*). Çdo qasje tjetër mund të hapë derën për një shkallë pasigurie, madje edhe arbitrariteti (*shih Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë [DhM], datë 25.10.2012, § 111*). Megjithatë, rregulli për shpërblimin e plotë sipas çmimit të tregut nuk është pa përjashtime (*shih Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM], datë 29.03.2006, § 96*). Objektivat legjitimë të "interesit publik" (siç janë ato që ndiqen në masat e reformës ekonomike ose ato për të arritur një drejtësi më të madhe sociale) mund të kërkojnë që shpërblimi të jetë më i ulët se çmimi i plotë i tregut (*shih James dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 21.02.1986, § 54*).

31. Gjykata, në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, vë në dukje se shpronësimi është një institut juridik, i cili, nëpërmjet një akti individual të bazuar në ligj dhe për interes publik, shuan të drejtën e pronës për një pasuri private, në këmbim të një shpërblimi të drejtë, në rastet kur kjo është e nevojshme për të realizuar përmbushjen e interesit publik. Shpronësimi është rezultat i masave ose i reformave të planifikuara për të përmbushur interesa publikë, ndaj ligjvënësi dhe ekzekutivi, si rregull, gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi në caktimin e shpërblimit, sepse janë në pozicionin e duhur për të pasur njohuri të drejtpërdrejta të shoqërisë, nevojave dhe burimeve. Në këtë drejtim, një kusht thelbësor është vlerësimi nëse përdorimi i ri i pasurisë që shpronësohet do të sjellë dobi publike më të madhe sesa ajo që rrjedh nga përdorimi aktual i saj, pra kur interesi publik mbizotëron kundrejt interesave privatë të pronarit të pasurisë.

32. Natyra e shpërblimit nga shpronësimi ndryshon nga ajo e dëmshpërblimit sipas së drejtës civile, pasi nuk synon të rimbursojë individin e prekur nga të gjitha humbjet aktuale dhe të ardhshme që lidhen me dëmin e pësuar, siç është fitimi i munguar. Në fakt, ai synon në parim të pasqyrojë shumën financiare të nevojshme për të zëvendësuar pasurinë e shpronësuar me një pasuri të së njëjtës kategori dhe cilësi, dhe merr parasysh vetëm vlerën në kohën e shpronësimit dhe jo zhvillimet e ardhshme të pronës. Me fjalë të tjera, qëllimi i shpërblimit sipas nenit 41, pika 4, të Kushtetutës, është të rivendosë një gjendje "të barasvlershme me gjendjen e mëparshme".

33. Thelbi i garancisë kushtetuese, të parashikuar në nenin 41, pika 4, të Kushtetutës, është të garantojë ekuilibrin midis interesit publik dhe shuarjes të së drejtës së pronës së individit, prej nga rrjedh detyrimi i prerë dhe i pakushtëzuar i shtetit për të siguruar një shpërblim të drejtë për shpronësimin. Ky shpërblim mund të korrespondojë me një vlerësim të plotë, por mund të jetë edhe më i ulët, pasi llogaritja e tij nuk merr në konsideratë vetëm interesin e individit të prekur, por e peshon atë në raport me interesin publik. Kështu, kur shteti ndërmerr një projekt të madh që kërkon shpronësimin e shumë individëve, barra e shpronësimit ndahet mes shumë individëve dhe pabarazia individuale zvogëlohet. Në këto rrethana, ekuilibrimi i interesit publik me atë privat mund të justifikojë dhënien e një shpërblimi më të ulët sesa vlera e plotë e pronës.

34. Megjithatë, shpërblimi dukshëm i ulët vendos barrë joproporcionale ndaj individit dhe mund të përbëjë cenim të Kushtetutës. Për këtë arsye, autoritetet kompetente, gjatë procedurës së shpronësimit, dhe më tej gjykatat

e zakonshme, gjatë procesit gjyqësor, duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjithë faktorët relevantë për përcaktimin e shpërblimit nga shpronësimi për të arritur ekuilibrin e duhur dhe për të mos i vendosur individit një barrë të tepruar. Shpërblimi nga shpronësimi duhet të jetë domosdoshmërisht rezultat i ekuilibrimit të interesave të individit të shpronësuar me ato të publikut të gjerë. Ai nuk mund të përfaqësojë as njohjen e njëanshme të interesave të pronarit dhe as vetëm ato të publikut të gjerë.

35. Në vështrim të kritereve të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesit kundërshtojnë vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të tyre. Në situatën kur rekursi nuk është shqyrtuar në themel dhe për të respektuar kufirin midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, Gjykata për zgjidhjen e çështjes do t'i japë përgjigje pyetjes nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm për vlerën e shpërblimit që kanë përfituar kërkuesit nga shpronësimi, pra për proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronësisë, që, siç u theksua, atyre u është kufizuar me ligj dhe për interes publik (*shih supra paragrafin 23*).

36. Në këtë këndvështrim, Gjykata konstaton se Bashkia e Elbasanit në janar të vitit 2014 ka paraqitur kërkesë për shpronësim në Ministrinë e Brendshme për të realizuar projektin për hapjen dhe sistemimin e rrugës "11 Nëntori" brenda qytetit. Në cilësinë e kërkueses së shpronësimit, ajo ka kryer procedurën e vlerësimit paraprak të pasurive dhe ka përgatitur dokumentacionin që duhet të shoqëronte kërkesën për shpronësim. Sipas saj, dy pasuritë e kërkuesve vlerësoheshin paraprakisht me 4.577.120 lekë (pasuria e parë) dhe 1.172.434,15 lekë (pasuria e dytë), vlera të cilat janë llogaritur me 4.081 lekë/m^2 për truallin dhe 45.119 lekë/m^2 për ndërtesën. Bashkia e Elbasanit në përcaktimin e vlerave të pasurive ka bashkëpunuar me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan (për ndërtesën) dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (për truallin). Të dyja këto institucione, në vjeshtën e vitit 2013, kanë deklaruar me shkrim çmimin për njësi për metër katror, me referencë te VKM-ja e Kritereve Teknike të Vlerësimit dhe VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013, si dhe mesataren e transaksioneve të vitit 2013. Nuk rezulton që vlerësimi paraprak i pasurive nga Bashkia e Elbasanit të jetë rishikuar nga Ministria e Brendshme, si institucioni kompetent për të ndjekur procedurën e shpronësimit, e cila ka propozuar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave vendimin e shpronësimit, duke e konsideruar vlerësimin paraprak si përfundimtar. Në datën 14.05.2014 Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM-në e Shpronësimit,

duke caktuar shpërblimin e kërkuesve me 4.577.120 lekë (pasuria e parë) dhe 1.172.434,15 lekë (pasuria e dytë).

37. Megjithëse kërkuesit kanë paraqitur padi në gjykatë për masën e shpërblimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës në datën 28.01.2015 ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se kërkuesit nuk kanë sjellë asnjë provë që tregonte se vendimi i shpronësimit nuk ishte i mbështetur në ligj, ndërsa akti i ekspertimit i shqyrtuar gjatë gjykimit nuk lidhej me provat e tjera shkresore dhe nuk ishte i besueshëm (*shih supra paragrafin 7*). Vendimi i saj është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit në datën 18.05.2017, e cila, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se kërkuesit ishin shpërblyer në përputhje me nenin 19 të Ligjit për Shpronësimet, sipas metodikës ligjore dhe se jo domosdoshmërisht shpërblimi i drejtë nënkupton vlerën e tregut të pasurisë (*shih supra paragrafin 8*).

38. Kërkuesit kanë paraqitur rekurs, duke ngritur, ndër të tjera, pretendimin se shpërblimi nga shpronësimi ishte i padrejtë dhe i gabuar, si dhe në kundërshtim me konceptin e "shpërblimit të drejtë", të përcaktuar nga Kushtetuta, Kodi Civil dhe Ligji për Shpronësimet, ndaj shpërblimi i tyre duhej caktuar sipas përllogaritjeve të aktit të ekspertimit që ishin kryer në gjykatën e shkallës së parë. Pavarësisht këtij pretendimi, Gjykata e Lartë, në datën 22.10.2024, me arsyetim të kufizuar, ka vendosur mospranimin e rekursit, me fjali të standardizuara se përfundimi i gjykatave të faktit ishte i bazuar në ligj, se gjykata e apelit kishte analizuar drejt Ligjin për Shpronësimet dhe se pretendimet që lidheshin me vlerësimin e provave dilnin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih supra paragrafin 9*).

39. Duke mbajtur në konsideratë faktin se Gjykata e Lartë është shprehur se gjykata e apelit ka analizuar drejt Ligjin për Shpronësimet, Gjykata çmon të vërë në dukje përmbajtjen e tij. Ligji në fjalë parashikon se shpronësimi bëhet vetëm për interes publik, kur interesi publik mbizotëron ndaj interesave privatë të pronarëve të tyre, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (*neni 2*); parimet e transparencës, barazisë së qytetarëve dhe mbrojtjes të të drejtave dhe interesave pronësorë të tyre duhet të respektohen (*neni 3*); ai mund të bëhet për shkaqe të ndryshme, përfshirë realizimin e projekteve kombëtare ose vendore dhe investimeve në funksion të mjedisit, shëndetit etj., sikundër infrastrukturës në shërbimin dhe interesin e publikut (*neni 8*).

40. Për sa i takon së drejtës së pronës private në rastin e shpronësimit, Ligji për Shpronësimet parashikon tre garanci: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e ndërhyrjes minimale - shpronësimi duhet të kufizohet vetëm në masën e domosdoshme për arritjen e qëllimit publik (*neni 2*); *garancia e dytë* ka të bëjë me shpërblimin e drejtë - ai llogaritet në masë të njëjtë me vlerën e plotë të vlerësimit përfundimtar të pasurisë së shpronësuar dhe është i menjëhershëm, pasi paguhet njëkohësisht me transferimin e pasurisë te shteti (*nenet 2, 4, 16 dhe 19*); *garancia e tretë* ka të bëjë me ankimin e të shpronësuarit në gjykatë për masën e shpërblimit (*neni 24*).

41. Ligji për Shpronësimet ka parashikuar edhe procedurën e caktimit të shpërblimit nga shpronësimi. Kërkuesi i shpronësimit, ku përfshihen edhe autoritetet bashkiake, kur aplikon te ministria kompetente, duhet të paraqesë një numër dokumentesh, midis të cilave edhe vlerësimin paraprak të objekteve të shpronësimit dhe masën e shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat (*neni 10, shkronja "ç"*). Ndërkohë, ministri kompetent urdhëron ngritjen e një komisioni të posaçëm për të mbikëqyrur procedurën e shpronësimit, anëtarët e të cilit duhet të jenë me përvojë dhe kualifikim të posaçëm në fushën juridike, ekonomike dhe inxhinierike (*neni 11*). Me anë të këtij komisioni, ministria kompetente kryen një sërë veprimesh për verifikimin e ligjshmërisë së kërkesës për shpronësim dhe të dokumentacionit të saj (*nenet 12-15*). Në vijim, komisioni i posaçëm llogarit shumën e shpërblimit të pasurisë që shpronësohet, bazuar në vlerën fillestare, amortizimin, destinacionin, vendndodhjen, indekset e ndryshimit të çmimeve të tregut dhe të monedhës, si dhe kriteret e tjera teknike të miratuara nga Këshilli i Ministrave (*neni 17*). Ministri kompetent duhet më pas të paraqesë në Këshillin e Ministrave propozimin për shpronësim të shoqëruar me një numër dokumentesh, ku përfshihet edhe shuma e shpërblimit të propozuar (*neni 20*). Këshilli i Ministrave vendos për shpronësimin kur propozimi për shpronësim konsiderohet se është i bazuar në ligj dhe në fakt. Vendimi i shpronësimit duhet të përfshijë pasuritë private që shpronësohen dhe pronarët respektivë të tyre, shumën e shpërblimit që do të paguhet, si dhe afatin dhe mënyrën e pagesës (*neni 21*).

42. Mbi bazën e fakteve të përcaktuara nga gjykatat e faktit, Gjykata fillimisht vëren se, ndonëse shpronësimi u vendos në datën 14.05.2014, shpërblimi i kërkuesve përkon me vlerësimin paraprak të pasurive të kryer nga Bashkia e Elbasanit në vjeshtën e vitit 2013, bazuar në vlerat e përcaktuara nga VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013, e cila rezulton të

jetë miratuar në datën 06.03.2013. Në këtë pikë evidentohet se: VKM-ja për Vlerën e Pronës 2013 hartohet sipas Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, që nënkupton një proces mbledhjesh të dhënash për të gjithë territorin e Republikës - proces që zgjat në kohë, ndaj nuk duket i pabazë pretendimi i kërkuesve se vlerat e vitit 2013 *de facto* pasqyrojnë situatën e tregut në vitin 2012; VKM-ja e Vlerës së Pronës 2014 që dyfishoi vlerat e pronave, *de facto* pasqyron situatën e tregut në vitin 2013; shuma e shpërblimit nga shpronësimi, sipas kërkuesve, nuk mjafton të sigurojë as një apartament me sipërfaqe të vogël. Po kështu, nuk rezulton që gjykatat e faktit të kenë shqyrtuar nëse Ministria e Brendshme, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse, kishte bërë verifikimet nëpërmjet komisionit të posaçëm sipas kritereve ligjore të nenit 17 të Ligjit për Shpronësimet, me qëllim vlerësimin përfundimtar të pronës. Për rrjedhojë, nuk konsiderohet e paarsyeshme që kërkuesit kishin pritshmëri për një vlerë më të lartë shpërblimi.

43. Në vijim, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë caktoi ekspert gjatë gjykimit, i cili konkludoi se vlera e tregut për m^2 për truallin ishte 24.000 lekë/m^2, ndërsa për ndërtesën ishte 56.000 lekë/m^2, vlera sipas të cilave shpërblimi i kërkuesve pothuajse trefishohej (*shih supra paragrafin 6*). Megjithatë, kjo provë nuk u vlerësua e besueshme nga gjykata e shkallës së parë, me fjalinë standarde që nuk përputhej me provat e tjera shkresore dhe se eksperti ishte teorik. Po kështu, gjykata e apelit nuk dha ndonjë arsye se përse konkluzioni i ekspertit nuk duhej marrë në konsideratë, edhe pse kërkuesit e kishin ngritur si shkak të veçantë në aktin e apelit. Për më tepër, ndonëse Ligji për Shpronësimet parashikon se vlerësimi paraprak i pronës llogaritet në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësim, ndërsa ministria përgjegjëse bën vlerësimin përfundimtar, i cili i propozohet Këshillit të Ministrave, gjykata e apelit u shpreh se shpërblimi përcaktohet në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësim, duke zhbërë një prej garancive ligjore të shpërblimit të drejtë, atë të përllogaritjes së tij me vlerën e pasurisë në kohën e shpronësimit. Në këtë mënyrë, gjykata e apelit dështoi t'u jepte kërkuesve një përgjigje specifike për pretendimin kryesor të tyre, i cili ishte vendimtar për zgjidhjen e çështjes.

44. Megjithëse rekursi i kërkuesve për mungesën e arsyetimit nga gjykata e apelit për shpërblimin e drejtë nga shpronësimi kishte të bënte me një shkelje potenciale të të drejtave kushtetuese, të cilën gjykatat e zakonshme kanë detyrimin ta shqyrtojnë me kujdesin e duhur, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje të shprehur

pretendimit për përllogaritjen e shpërblimit nga shpronësimi, i cili ishte edhe pretendimi vendimtar për zgjidhjen e çështjes. Në këtë pikë, Gjykata vëren se kërkuesit kanë sjellë në vëmendje të saj edhe qëndrimin e ndryshëm që Gjykata e Lartë ka mbajtur në dy raste të ngjashme, në të cilat ajo ka pohuar se në funksion të realizimit efektiv të së drejtës kushtetuese për mbrojtjen e pronës, në rastet e kufizimit me ligj të saj, merr rëndësi identifikimi i vlerës së drejtë të shpërblimit, duke iu afruar, për sa është e mundur, vlerës së vërtetë të pasurisë së paluajtshme në kohën e shpronësimit, pa akorduar masë më të lartë dhe as një masë të ulët ose të papërfillshme (*shih vendimet nr. 00-2024-1495 (161), datë 16.04.2024 dhe nr. 00-2024-4901 (443), datë 29.10.2024 të Gjykatës së Lartë*). Në mbështetje të këtij qëndrimi, Gjykata rithekson se kur individi shpronësohet nga pasuria private vetëm një shpërblim i drejtë garanton ekuilibrin midis interesit publik dhe shuarjes të së drejtës së pronës (*shih supra paragrafët 33 – 34*).

45. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkuesve u janë cenuar të drejtat kushtetuese të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës i lidhur me nenin 41, pika 4, të saj nga vendimi i Gjykatës së Lartë.

46. Gjykata, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, rithekson rolin e pazëvendësueshëm të Gjykatës së Lartë, së cilës i përket detyra kushtetuese për të siguruar njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ajo gjykatë nuk ka asnjë pengesë të zgjidhë vetë çështjen ose të orientojë zgjidhjen e saj nga gjykata më e ulët, duke njësuar e zhvilluar edhe praktikën gjyqësore në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato të GJEDNJ-së të trajtuara në këtë vendim.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4040, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.12.2025
Shpallur më 22.01. 2026

Vendim nr. 83, datë 18.12.2025
(V-83/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Asim Vokshi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "INDUSTRI NDËRTIM" SH.P.K.,** përfaqësuar nga avokat Ardian Kasapi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
KUJTIM IBRAJ, përfaqësuar nga avokat Arben Llapi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 218, datë 21.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 236, datë 20.04.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 11, 15, 16, pika 2, 18, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49, pikat 3, shkronja "e" dhe 4, si dhe 50, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, shoqërisë "Industri Ndërtim" sh.p.k., *(kërkuesja)*, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Kujtim Ibraj, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, në cilësinë e sipërmarrëses, ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. 2149 rep., 490 kol., datë 14.11.2009 *(kontrata e sipërmarrjes)* me subjektin e interesuar Kujtim Ibraj, në cilësinë e porositësit, për ndërtimin e dy godinave 8-katëshe në qytetin e Lezhës. Në kontratë kanë qenë të parashikuara kushtet e sipërmarrjes: pjesa takuese, afati i përfundimit të punimeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, si dhe penalitetet në rast të vonesës në përfundimin e punimeve. Në kontratën e sipërmarrjes parashikohej edhe "penaliteti", sipas të cilit për çdo vonesë në përfundimin e plotë të ndërtesës sipërmarrësi do t'i paguante pronarit të truallit, në raport me sipërfaqen reale të pjesës takuese të pambaruar të ndërtimit, penalitetin 1% në muaj. Në datën 16.11.2009 palët kanë hartuar edhe një aneks kontrate, sipas së cilës, nëse do të kishte probleme me afatin e marrjes së dokumenteve të pronësisë, për pjesët takuese të pronarit të truallit, për shkak të ndryshimeve në projektin e zbatuar me mirëkuptimin e të dyja palëve, nuk do të aplikoheshin sanksionet dhe penalitetet për kërkuesen. Subjekti i interesuar, duke pasur pretendime për mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore, konkretisht për mospërfundimin e objektit sipas kushteve të kontratës, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në datën 24.10.2011 me padi me objekt të përgjithshëm për detyrimin e kërkueses për të përmbushur kushtet sipas kontratës së sipërmarrjes së lidhur ndërmjet tyre, si dhe dëmshpërblimet përkatëse. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë janë zhvilluar gjithsej 8 (tetë) seanca përgatitore, ku kërkuesja ka qenë i pranishme vetëm në një seancë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 23.02.2012, ia ka dërguar për kompetencë çështjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi subjekti i interesuar ka

paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2012-1456 (222), datë 03.05.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të datës 23.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

2. Pas kthimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në datën 02.07.2012 është vendosur kalimi drejtpërdrejt i çështjes në seancë gjyqësore. Për shqyrtimin e çështjes në themel janë zhvilluar gjithsej 16 seanca gjyqësore, gjatë të cilave kërkuesja ka marrë pjesë vetëm në një seancë nëpërmjet avokatit të saj, që ka kërkuar kohë për t'u njohur me aktet/provat (në seancën e datës 06.11.2012). Gjatë gjykimit të themelit të çështjes, në datën 06.12.2012 subjekti i interesuar ka paraqitur kërkesë për shtimin/saktësimin e objektit (vlerës) të padisë, sipas së cilës eksperti i caktuar në datën 10.09.2012 nga gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar si vlerë të penalitetit kontraktor, 1% për çdo muaj dëmshpërblim për pjesën takuese të subjektit të interesuar, shumën 11.876.36 euro. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 218, datë 21.03.2013, (*vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë*) ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e kërkueses të përmbushë detyrimin kontraktor për llogari të subjektit të interesuar sipas kontratës së sipërmarrjes, si dhe t'i paguajë penalitetet kontraktore, 1% si dëmshpërblim për pjesën takuese të tij, në shumën 196.800 euro, si vlerë deri në datën e kryerjes së aktit të ekspertimit, si dhe vlerën shtesë 11.876.36 euro për çdo muaj pas kësaj date deri në momentin e ekzekutimit përfundimtar të vendimit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesja, duke parashtruar, ndër të tjera, edhe pretendime për formimin e trupit gjykues.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 236, datë 20.04.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me ndryshimin: detyrimin e kërkueses të përmbushë detyrimin sipas kushteve të kontratës së sipërmarrjes për të paguar penalitetet 1% në muaj, në vlerën 11.536.55 euro, detyrim i cili fillon në datën 14.05.2011 (ditën kur ka lindur detyrimi kontraktor) deri në përmbushjen e kushteve të kontratës së sipërmarrjes. Në mënyrë të përmbledhur, Gjykata e Apelit Shkodër në lidhje me pretendimin për formimin e trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë ka arsyetuar se është i pabazuar, sepse kërkuesja duhet ta kërkonte në seancë përgatitore dhe nuk rezulton të ketë paraqitur kërkesë si në seancën përgatitore, ashtu edhe më vonë gjatë procesit civil *(shih faqen 6 të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër).* Gjykata e apelit në përcaktimin e vlerës 1 % në muaj të penalitetit të kontratës ka përsëritur

pjesërisht hetimin gjyqësor, ka thirrur po të njëjtin ekspert teknik të marrë nga gjykata e shkallës së parë dhe në përfundim e ka vlerësuar të drejtë aktin e ekspertimit për përcaktimin e çmimeve të sipërfaqeve të banimit (që nuk ishin fiksuar në kontratë) *(shih faqen 9 të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër)*.

4. Kërkuesja, ndaj vendimit të gjykatës së apelit, ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, ku, ndër të tjera, ka ngritur edhe pretendime se me shtesën e objektit të padisë, vlera e saj e kalonte shumën 20 milionë lekë, ndaj gjykata ka pasur detyrimin për të pyetur palët nëse gjykimi do të duhej të vazhdonte me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë, gjë të cilën nuk e ka kryer dhe se seanca e vetme e vlefshme është ajo e datës 06.11.2012 në të cilën avokati ka kërkuar kohë për t'u njohur me aktet e dosjes, ndërsa administratori i shoqërisë ka paraqitur raport shëndetësor dhe për këtë arsye gjykata nuk mund të vendoste gjykimin në mungesë. Gjithashtu, kërkuesja ka paraqitur edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 370, datë 01.07.2015, (*vendimi i pezullimit të ekzekutimit*) ka vendosur pranimin e kërkesës duke pezulluar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

5. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021, bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC),* ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së, si dhe revokimin e vendimit të tij të pezullimit të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Në lidhje me kërkimin për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se sipas nenit 35 të KPC-së, parimisht gjykimi në shkallë të parë zhvillohet nga një trup gjykues i përbërë me një gjyqtar, përjashtimisht, për paditë me vlerë më të lartë se 20 milionë lekë, gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë nëse përmbushen dy kushte: *së pari,* njëra nga palët ndërgjyqëse kërkon që gjykimi të zhvillohet me tre gjyqtarë dhe, *së dyti,* kërkesa e palës paraqitet në seancë përgatitore, në të kundër konsiderohet e rënë në dekadencë nëse paraqitet në një moment tjetër të gjykimit. Sipas Gjykatës së Lartë, në rastin konkret nuk rezulton që kërkuesja të ketë respektuar këtë dispozitë ligjore gjatë gjykimit në shkallë të parë *(shih faqen 6 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).*

6. Kërkuesja në datën 29.09.2021 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, me objekt kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të sipërcituara. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 126, datë 29.10.2021 *(vendimi nr. 126/2021),* ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosplotësimit të kriterit *ratione temporis*. Kolegji ka arsyetuar se referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë ka rezultuar se kjo e fundit në datën 01.02.2021 ka shpallur publikisht listën e çështjeve të cilat do të shqyrtoheshin në datën 16.02.2021, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses. Pas këtij njoftimi, Gjykata e Lartë ka publikuar në faqen e saj zyrtare përfundimin e gjykimit të çështjes, duke publikuar edhe vendimmarrjen e saj, për rrjedhojë Kolegji ka vlerësuar datën 17.02.2021 për fillimin e afatit 4-mujor. Ndërkohë, kërkuesja ka pretenduar se për vendimin e Gjykatës së Lartë ka marrë dijeni me shkresën nr. 431/1 prot., datë 04.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (ku ndodhej dosja përkatëse), pas kërkesës së saj për vënien në dispozicion të vendimit.

7. Pas vendimit të Kolegjit të Gjykatës, kërkuesja i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ),* duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi Gjykata nuk kishte pranuar për shqyrtim kërkesën për shkak të zbatimit të afatit të ri 4-mujor. GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 14.01.2025 (*Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*), ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*, pasi kërkueses i ishte cenuar e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës. GJEDNJ-ja ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve. Vendimi i GJEDNJ-së është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 18.02.2025. Pas vendimit të GJEDNJ-së, kërkuesja në datën 06.03.2025 i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesë sipas objektit, e cila është regjistruar në datën 17.03.2025, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës.

8. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak, me vendimin e datës 22.05.2025, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 126/2021 të Kolegjit, rihapjen e procesit dhe kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Në pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit, Kolegji vlerësoi se kërkesa përmbush kriterin *ratione temporis* të parashikuar në nenin 71, shkronja "c", pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare

(nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë). Në rastin konkret, vendimi i GJEDNJ-së është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 18.02.2025 dhe kërkuesja i është drejtuar asaj në datën 06.03.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71, shkronja "c", pika 4, i Ligjit Organik të Gjykatës. Gjithashtu, edhe pretendimet *ratione materiae* janë në juridiksionin e kompetencën e Gjykatës. Kolegji po në datën 22.05.2025 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 12.06.2025 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesja*****,** në mënyrë të përmbledhur, në ankimin kushtetues individual të paraqitur në datën 29.09.2021 ka pretenduar cenimin e s*ë drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka garantuar të drejtën e kërkueses për t'u njoftuar për zhvillimin e gjykimi kundër saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka konsideruar se kërkuesja ka marrë dijeni për seancën përgatitore, edhe pse rezulton se administratori i shoqërisë nuk ka nënshkruar njoftimin, përkundrazi rubrika "Marrësi" është lënë bosh, pa asnjë shënim. Edhe pas shqyrtimit të kompetencës tokësore nga Gjykata e Lartë, çështja ka vijuar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kjo gjykatë ka vijuar gjykimin në mungesë të kërkueses, me argumentin se "ka marrë dijeni". Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër kërkuesja ka bërë kërkesë të përsëritur për përjashtimin e ekspertit, pasi nuk kishte cilësitë e duhura profesionale, pasi ishte vetëm inxhinier topograf dhe jo inxhinier ndërtimi dhe thirrjen e një eksperti të ri, ndërkohë kur gjykata e apelit ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor. Kërkueses i është cenuar e drejta për t'u gjykuar *nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi në referim të vlerës së objektit të padisë (mbi 20 milionë lekë), trupi gjykues që duhej të gjykonte çështjen duhej të përbëhej nga tre gjyqtarë dhe jo nga një gjyqtar. Nëse kërkueses do t'i ishte krijuar mundësi për të marrë pjesë në gjykim, do të kërkonte gjykimin prej tre gjyqtarësh.

9.2. *Së drejtës së aksesit,* pasi në seancën gjyqësore të datës 06.12.2012 pala paditëse ka paraqitur kërkesë për shtimin e objektit të padisë, për të cilën kërkuesja nuk është njoftuar, pasi nuk ka pasur mundësi reale për të qenë e pranishme në gjykim, për shkak të gjendjes shëndetësore të administratorit të saj. Gjykata duhej të kishte bërë njoftimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit *(QKB)* {ish-Qendra Kombëtare e Regjistrimit *(ish-QKR-ja)*} në regjistrin e shoqërive tregtare, sipas nenit 141/a të KPC-së. Kërkuesja nuk është njohur me aktin e ekspertimit të kryer në shkallë të parë, duke mos pasur mundësi të bëjë prapësimet e saj, duke iu cenuar e drejta për t'u mbrojtur.

9.3. *Parimit të barazisë së armëve,* pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka dështuar në njoftimin rregullisht të kërkueses për zhvillimin e seancave gjyqësore. Mosmarrja dijeni dhe dështimi i gjykatës së shkallës së parë për njoftimin e kërkueses në mënyrë të ligjshme i ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar, për t'i bërë pyetje ekspertit dhe aksesin substancial, duke dhunuar në këtë mënyrë parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

9.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të ankimit efektiv,* pasi Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuesja në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, pavlefshmërinë e njoftimeve, problemet procedurale për ndërgjyqësinë, për aktin e ekspertimit dhe për përjashtimin e ekspertit. Në përmbajtje të vendimit të gjykatës së apelit nuk ka asnjë arsyetim për problematikat procedurale dhe kushtetuese të ngritura nga kërkuesja. Si gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, duke mos dëgjuar kërkuesen për pretendimet e saj dhe duke mos arsyetuar vendimet e tyre, kanë *cenuar deri në mohim të drejtën e kërkueses për ankim efektiv.*

9.5. *Lirisë së veprimtarisë ekonomike,* pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vendosur rrëzimin e pretendimeve të kërkueses, duke mos u dhënë fakteve që qëndrojnë në themel të çështjes kuptimin e duhur dhe duke sjellë pasoja të pariparueshme për të. Gjykatat duhet të kishin arritur në përfundimin se parashikimi kontraktor për dorëzimin e pjesëve takuese përpara marrjes së aktit të kolaudimit është një parashikim që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe si i tillë është i pavlefshëm

e pa pasoja për palët. Sipas aktit të kolaudimit të vitit 2012 ka rezultuar se objekti ka përfunduar sipas lejes së ndërtimit. Në të kundërt, akti i ekspertimit i kryer nga eksperti i thirrur nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm, i hartuar në vitin 2015, ka arritur në përfundimin se objekti ishte i papërfunduar. Gjykatat për zgjidhjen e themelit të çështjes duhet të ishin bazuar në rregullimet ligjore/nënligjore të kohës së mosmarrëveshjes dhe ishin të detyruara të zbatonin parimin "*gjykata e njeh ligjin*". Sipas këtij parimi, edhe sikur kërkuesja të mos e kishte pretenduar, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ishin të detyruara t'i referoheshin rregullimit ligjor të fushës. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar me dashje mashtrimin e ekspertit në lidhje me faktin e mospërfundimit të punimeve. Akti i kolaudimit është hartuar e nënshkruar në datën 23.01.2012, vetëm 7 muaj pas kalimit të afatit të përfundimit të punimeve të parashikuara për në datën 14.05.2011. Në rastin më të mirë penalitetet do të duhej të llogariteshin vetëm për 7 muaj dhe vetëm për pjesën takuese.

10. ***Subjekti i interesuar, Kujtim Ibraj**,* në parashtrimet e datës 10.07.2025 ka prapësuar, si vijon:

10.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk është i bazuar, pasi njoftimi për seancën përgatitore (të datës 23.02.2012) është kryer sipas nenit 130 të KPC-së. Fletëthirrja për zhvillimin e kësaj seancë është nënshkruar nga ftuesi dhe dëshmitari. Në këtë drejtim, kërkuesja nuk ka paraqitur asnjë pretendim si ndaj ftuesit dhe dëshmitarit që ka nënshkruar fletëthirrjen apo ka paraqitur kallëzim ndaj tyre për falsitet të aktit. Kërkuesja ka qenë e pranishme nëpërmjet avokatit L.G. në seancën e datës 16.12.2012 dhe nuk ka ngritur asnjë pretendim për paligjshmëri të njoftimeve ose pavlefshmëri të akteve të njoftimit. Kërkuesja ka marrë dijeni edhe për seancën e datës 17.07.2012, pasi fletëthirrja është nënshkruar si nga postieri, ashtu dhe nga dëshmitari A.M., në këtë mënyrë njoftimi konsiderohet i rregullt. Gjykata e shkallës së parë ka vijuar gjykimin në mungesë, në zbatim të nenit 179, paragrafët e dytë dhe të tretë të KPC-së, pasi ajo gjykatë nuk mund të kryente asnjë veprim tjetër pas konfirmimit se kërkuesja kishte marrë dijeni për gjykimin dhe nuk kishte pasur asnjë shkak të justifikuar për mosparaqitjen në gjykim. Pretendimi për mosnjoftimin e

kërkueses është trajtuar si nga Gjykata e Apelit Shkodër, po ashtu edhe nga Gjykata e Lartë, të cilat e kanë vlerësuar si të pabazuar dhe nuk kanë konstatuar shkelje procedurale gjatë gjykimit në shkallë të parë.

10.2. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar,* pasi gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë është bërë vetëm saktësimi i kërkimeve sipas rezultateve të aktit të ekspertimit, pasi procesi gjyqësor ka filluar me padi me objekt të përgjithshëm. Pretendimi është shqyrtuar edhe nga gjykata e apelit, që e ka vlerësuar të drejtë vendimin e shkallës së parë dhe i ka trajtuar të gjitha kërkimet e ngritura në ankim. Pretendimi për vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e ekspertit, nuk është ngritur në nivel kushtetues. Gjykata e apelit i ka arsyetuar në vendimin e saj të gjitha pretendimet e paraqitura në ankim, si për aktin e ekspertimit, pavlefshmërinë e njoftimeve dhe mospjesëmarrjen në gjykim. Vendimi i gjykatës së apelit është ligjor dhe nuk cenon asnjë aspekt të të drejtave kushtetuese. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë ka analizuar të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs dhe ka arritur në përfundimin se vendimet e gjykatave më të ulëta janë rrjedhojë e një procesi të ligjshëm dhe pa asnjë shkelje procedurale. Në lidhje me llogaritjen e penalitetit 1% të vlerës së punimeve të papërfunduara nuk ka pasur nevojë për njohuri të posaçme, por për njohuri minimaliste matematikore. Akti i ekspertimit që ka realizuar evidentimin e punimeve të pakryera dhe vlerën e tyre kishte përfunduar dhe ishte depozituar në dosjen gjyqësore. Për rrjedhojë, duhej të bëhej vetëm një llogaritje e thjeshtë matematikore, të cilën jo vetëm gjykatat, por edhe vetë palët mund ta bënin lehtësisht.

10.3. *Pretendimi për cenimin e lirisë ekonomike është i pabazuar,* pasi edhe në vitin 2023 përsëri një pjesë e konsiderueshme e objektit ishte e papërfunduar, fakt që është provuar nga një akt ekspertimi i dorëzuar në datën 13.06.2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në një proces tjetër civil. Të drejtat e subjektit të interesuar janë ende të paekzekutuara nga viti 2009 kur ka filluar marrëdhënia kontraktuale dhe nga viti 2011 kur duhej të merreshin në dorëzim sipërfaqet ndërtimore. Ndërsa kërkimi për përjashtimin e ekspertit nuk përbën shkelje kushtetuese.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për themelin e pretendimeve

11. Gjykata vëren se pretendimet *ratione materiae* të paraqitura nga kërkuesja lidhen me cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim *të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* e *të së drejtës së ankimit efektiv*, të drejta që garantohen nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar edhe *cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike*, si pasojë e vendimeve gjyqësore të marra mbi bazën e provave të paligjshme. Për këtë pretendim, Gjykata konstaton se kërkuesja ka parashtruar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke mos marrë për bazë pretendimet e saj, nuk u kanë dhënë fakteve që qëndrojnë në themel të çështjes kuptimin e duhur, duke sjellë pasoja të pariparueshme për të. Sipas kërkueses, gjykatat duhej të kishin arritur në përfundimin se parashikimi kontraktor për dorëzimin e pjesëve takuese përpara marrjes së aktit të kolaudimit, është një parashikim i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe si i tillë është i pavlefshëm e pa pasoja për palët. Gjykata vlerëson se në thelb pretendimi i parashtruar nga kërkuesja lidhet me vlerësimin e provave, zbatimin e ligjit dhe të neneve të kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete, për rrjedhojë pretendimi do të duhet të rimerret në shqyrtim nga ato gjykata, nëse Gjykata do të gjejë shkelje të procedurës së gjykimit që rrëzon vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

12. Për pretendimet e tjera, për cenimin e *së drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, *së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së ankimit efektiv,* Gjykata vëren se kërkuesja të gjitha pretendimet e saj i ka lidhur me të njëjtat argumente që i referohen: i) mosnjoftimit për të qenë e pranishme në seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara në gjykatën e shkallës së parë; ii) mospranimit të kërkesës për përjashtimin e ekspertit; iii) mosdhënies së mundësisë për të kërkuar gjykimin me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, për shkak të vlerës së padisë dhe mosnjoftimit të saj nga gjykata e shkallës së parë; iv) mosmarrjes përgjigje të arsyetuar për pretendimet e saj nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm gjatë shqyrtimit të çështjes. Për këtë arsye, në vijim, Gjykata do të analizojë

në themel pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në drejtim të *cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me gjykatën e caktuar me ligj.*

A.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

13. Kërkuesja ka pretenduar se në referim të vlerës së objektit të padisë (mbi 20 milionë lekë), gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë duhej të bëhej nga trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë dhe jo nga një gjyqtar. Sipas kërkueses, nëse gjykata e shkallës së parë do ta kishte njoftuar për zhvillimin e seancave, ajo do të kishte mundësi për të paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh. Sipas saj, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi me natyrë kushtetuese të ngritur në ankim e rekurs.

14. Subjekti i interesuar, Kujtim Ibraj, ka prapësuar se njoftimet për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë janë kryer sipas parashikimeve ligjore dhe se në seancat gjyqësore ku kërkuesja është përfaqësuar me avokat nuk ka ngritur asnjë pretendim për falsitet të fletëthirrjeve ose të nënshkrimeve të njoftuesit dhe të dëshmitarëve. Padia nuk duhet të gjykohej me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, pasi objekti i padisë pas rezultateve të aktit të ekspertimit është saktësuar dhe nuk ka pasur shtim të tij. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë analizuar dhe u kanë dhënë përgjigje të gjitha kërkimeve të kërkueses.

15. Gjykata është shprehur se arsyetimi është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se funksioni i tij është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë *(shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Zbatimi i standardit të arsyetimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e

vendimeve të tyre. Detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë *(shih vendimet nr. 50, datë 18.10.2023; nr. 3, datë 23.01.2014; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"*. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në lidhje me vlerën e kërkesëpadisë, si një kusht thelbësor në përcaktimin e përbërjes së rregullt të trupit gjykues sipas dispozitave të KPC-së, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se vlera e padisë përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar për gjykatën e caktuar me ligj *(shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 19, datë 25.04.2013; nr. 13, datë 18.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit,* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë parashtrimet e palëve, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuesja ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin e saj të ngritur në rekurs lidhur me shkeljet me natyrë kushtetuese të pretenduara që kanë

ndodhur gjatë gjykimit të çështjes, duke shqyrtuar konkretisht nëse Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkueses për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.*

20. Gjykata, referuar dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues, vëren se subjekti i interesuar Kujtim Ibraj i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesëpadi pa e përcaktuar qartë dhe në mënyrë shifrore vlerën e objektit të padisë që lidhet me detyrimin për të përmbushur detyrimin kontraktor sipas kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes tyre. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë nga data 08.11.2011 deri në datën 21.03.2013 (seanca për dhënien e vendimit) janë zhvilluar në tërësi 24 seanca, nga të cilat 16 seanca gjyqësore dhe pjesa tjetër seanca përgatitore. Kërkuesja nuk ka marrë pjesë në 22 seanca, për të cilat gjykata e shkallës së parë ka proceduar me njoftimin me fletëthirrje. Këto fletëthirrje në pjesën më të madhe janë firmosur nga dëshmitarë, vetëm në dy raste nga administratori dhe pjesa tjetër nga familjarë të administratorit (vëllai dhe bashkëshortja). Gjatë zhvillimit të seancës përgatitore të datës 16.01.2012 sipas përmbajtjes së procesverbalit rezulton se subjekti i interesuar, ndër të tjera, ka parashtruar se ka kryer një akt ekspertimi eksperti i zgjedhur nga ai, që mban datën 30.11.2011, ku është llogaritur vlera prej 1% (dëmshpërblimi sipas penalitetit kontraktor mujor të pretenduar në padi) e shprehur në lekë dhe shuma totale është e barabartë me 1.697.640 lekë, si dhe ka paraqitur edhe mandatpagesën që mban datën 19.12.2011, sipas së cilës ishte paguar 3% e vlerës së padisë, në shumën 280.100 lekë (gjë që tregon se në këtë moment kohor objekti real i padisë sipas taksës gjyqësore të paguar, përfshirë edhe pullat e taksës në momentin fillestar të depozitimit të padisë në gjykatë, duke marrë për bazë vlerën 3%, është nën 20 milionë lekë). Kërkuesja nëpërmjet administratorit të saj në këtë seancë ka kërkuar kohë për t'u njohur me aktet. Në seancën përgatitore të radhës, në datën 23.02.2012, kërkuesja nuk ka qenë e pranishme. Në këtë seancë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes për kompetencën tokësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si gjykata kompetente, ka zhvilluar 16 seanca gjyqësore, të cilat janë shtyrë pas kërkesës së avokatit të kërkueses, duke parashtruar arsye të ndryshme, si gjendja shëndetësore ose për shkak të pjesëmarrjes në gjykime të tjera, si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të administratorit të shoqërisë.

21. Gjatë seancës gjyqësore të datës 06.12.2012 avokati i subjektit

të interesuar/paditës në atë gjykim ka paraqitur kërkesë për shtimin/ saktësimin e objektit dhe ka kërkuar kohë për pagesën e vlerës 3% të padisë sipas aktit të ekspertimit të hartuar nga eksperti i caktuar nga gjykata, sipas të cilit vlera e padisë ishte në shumën 199.915.52 euro. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesës, duke saktësuar objektin e padisë për përmbushjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes, për të paguar penalitetet kontraktore 1%, si dëmshpërblim në shumën 196.800 euro si vlerë deri në datën e kryerjes së aktit të ekspertimit, si dhe vlerën shtesë 11.876.36 euro, për çdo muaj pas kësaj date deri në momentin e ekzekutimit përfundimtar të vendimit gjyqësor. Po këtë ditë, sipas datës së mandatpagesës, subjekti i interesuar ka paguar 3% të vlerës së padisë në shumën 546.150 lekë. Për shkak të njoftimit të kërkueses, gjykata e shkallës së parë ka vendosur shtyrjen e seancës për në datën 20.12.2012, për të cilën kërkuesja është njoftuar me fletëthirrje. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kërkuesja nuk është njoftuar për kërkesën për shtimin (saktësimin) e objektit të padisë. Edhe në këtë seancë (të datës 20.12.2012) kërkuesja nuk ka qenë e pranishme dhe seanca është shtyrë për në datën 08.01.2013. Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore pasardhëse (nga data 24.01.2013 deri në dhënien e vendimit në datën 21.03.2013), kërkuesja nuk ka qenë e pranishme, por rezulton se për dy seanca gjyqësore ka paraqitur përsëri kërkesë për shtyrje për shkak të gjendjes shëndetësore të administratorit të saj. Në seancën e datës 08.03.2013 gjykata e shkallës së parë ka vijuar me njoftimin e kërkueses nëpërmjet shpalljes në mjediset e asaj gjykatë dhe të ish-QKR-së. Në seancën e fundit të datës 21.03.2013 nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se kërkuesja ka paraqitur kërkesë për shtyrje, duke bashkëlidhur një mandat blerjeje për një biletë udhëtimi. Po gjatë kësaj seance gjyqësore (në datën 21.03.2013) përfaqësuesi i subjektit të interesuar ka depozituar mandatpagesën (e datës 06.12.2012) për vlerën 3% të padisë dhe në përfundim gjykata e shkallës së parë është tërhequr për vendim duke vendosur pranimin e padisë.

22. Sikur u parashtrua në rrethanat e çështjes, pas ankimit të kërkueses, Gjykata e Apelit Shkodër, mes të tjerash, ka arsyetuar se kërkimi për sa i përket formimit të trupit gjykues me tre gjyqtarë, për shkak të vlerës së padisë mbi 20 milionë lekë, është i pabazuar *(shih paragrafin 3 të këtij vendimi).* Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021, objekt i ankimit kushtetues, ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbushte kriteret e parashikuara nga neni

472 i KPC-së, gjykata e apelit ka respektuar normat procedurale dhe palët kanë pasur mundësi për të realizuar mbrojtjen e tyre, si dhe ka revokuar vendimin e tij për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjykata e Lartë ka arsyetuar edhe për kërkimin për gjykatën e caktuar me ligj *(shih paragrafin 5 të këtij vendimi)*

23. Për sa më lart, Gjykata ndonëse konstaton se nga procesverbalet dhe fletëthirrjet gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë kërkuesja ka kërkuar shtyrjen në të paktën 20 seanca (përgatitore dhe gjyqësore), ajo vlerëson se megjithëse mosparaqitja e kërkueses në ndonjë rast mund të duket si e qëllimshme ose abuzive, kjo nuk i justifikon gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe Gjykatën e Lartë që të mos i japin përgjigje të argumentuar pretendimit për gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me gjykimin e çështjes me trup gjykues me tre gjyqtarë për shkak të vlerës së objektit të padisë, të lidhur me pretendimin e kërkueses për zhvillimin në mungesë të saj të seancave gjyqësore, duke u mjaftuar vetëm me një referencë në nenin 158/a të KPC-së. Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhej të kishin arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për të përcaktuar momentin e marrjes dijeni nga ana e kërkueses për vlerën finale të objektit të padisë, sepse nga ky moment do të krijoheshin kushtet që ajo mund të kërkonte gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, si një e drejtë që i njihej nga ligji (edhe pse saktësimi i shifrës së objektit të padisë është bërë gjatë fazës së hetimit gjyqësor jo për fajin e kërkueses) ose do të parashtronte prapësimet/mbrojtjen e saj lidhur me shtimin e objektit të padisë. Në këtë kuptim, nëse seanca e datës 16.01.2012 do të konsiderohej momenti kur paditësi ka saktësuar përfundimisht vlerën monetare të objektit të padisë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet ta kishin analizuar me kujdes këtë moment procedural, për sa kohë gjykata e shkallës së parë e ka shtyrë gjykimin për të njoftuar kërkuesen për saktësimin/shtimin e objektit të padisë. Gjykatat duhej të verifikonin nëse kërkuesja kishte marrë dijeni për vlerën totale të objektit të padisë ose jo. Gjithashtu, arsyetimi i gjykatës së apelit se subjekti i interesuar në seancën gjyqësore të datës 06.12.2012 nuk ka kërkuar shtimin e objektit të padisë, por ka saktësuar vlerën monetare të detyrimit të kërkuar në objektin e padisë (i cili deri në këtë seancë ka qenë i përgjithshëm dhe i papërcaktuar saktë), nuk është i mjaftueshëm në drejtim të respektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi kërkuesja nuk ka marrë përgjigje për kërkimin e saj për gjykimin e

çështjes nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë. Po ashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka marrë përgjigje edhe për pretendimin për pavlefshmërinë e klauzolës kontraktore që parashikonte penalitetin 1% mbi vlerën e detyrimit të papërmbushur, e cila ishte përcaktuese për vlerën e objektit të padisë, kjo e fundit e lidhur me kërkimin e kërkueses për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për më tepër, Gjykata vlerëson se edhe fakti që Gjykata e Lartë ka pranuar kërkesën e kërkueses për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që përcaktonte detyrim për kërkuesen, ka qenë një tregues se, referuar shkaqeve të rekursit, në shqyrtimin e kësaj çështjeje ajo, si gjykatë ligji, duhej të tregohej më e kujdesshme në arsyetimin sa më të plotë të vendimit të saj, duke iu referuar akteve procedurale (letërthirrjeve ose procesverbaleve) të ndodhura në dosjen gjyqësore.

24. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se pavarësisht se në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë pasqyruar pretendimet e kërkueses, përfshirë edhe ato që lidhen me themelin e çështjes për sa i përket vlefshmërisë së penalitetit kontraktor, të cituara në pjesët arsyetuese të këtij vendimi, ajo nuk ka analizuar mjaftueshëm pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuesja në lidhje me respektimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit, si element thelbësor i vendimit të drejtë, pasi nuk u ka treguar palëve se ato janë dëgjuar rregullisht prej saj dhe se nuk u është kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i bazuar.

25. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo duhet të pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.12.2025
Shpallur më 16.02.2026

Vendim nr. 84, datë 22.12.2025
(V-84/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Asim Vokshi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 04.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (K) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KLEMENT SHEHU**

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1457 (30-2024-4547), datë 12.06.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2024-1747, datë 31.10.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dëmshpërblimi për heqjen e lirisë në mënyrë të padrejtë, dëmin psikologjik të shkaktuar, si dhe fitimin e munguar.

BAZA LIGJORE: **Nenet 34, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ), si dhe* neni 4 i Protokollit nr. 7 saj; neni 53 i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale; nenet 8, 9 dhe 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; nenet 71**

e 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Klement Shehu *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është gjykuar në gjendje të lirë nga Gjykata e Frosinones, Itali dhe Gjykata e Apelit Romë për kryerjen e veprës penale "Prodhimi, trafikimi dhe mbajtja e paligjshme e substancave narkotike dhe lëndëve psikotrope", të parashikuar nga neni 73, paragrafët 1 dhe 1-bis, i dekretit të Presidentit të Republikës së Italisë nr. 309/1990, lidhur me rrethanat e parashikuara nga nenet 81 (më shumë se një herë) dhe 110 (në bashkëpunim) të Kodit Penal italian. Me vendimin e datës 12.07.2019 të asaj gjykate ai është dënuar me 6 vjet burg dhe 25.000 euro gjobë, ndërsa në datën 20.02.2020 Gjykata e Kasacionit e Republikës së Italisë ka rrëzuar rekursin e tij. Në vijim, në datën 19.06.2021 Zyra e Ekzekutimeve Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme në Gjykatën e Apelit Romë ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr. 412/2020, sipas të cilit, pas zbritjes së periudhave të qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpie, kërkuesi duhej të vuante përfundimisht një dënim prej 4 vjetësh e 21 ditësh burg, si dhe të paguante gjobën prej 25.000 eurosh.

2. Bazuar në urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet italiane, kërkuesi është arrestuar në Shqipëri në datën 07.01.2022 dhe në datën 08.01.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*, për qëllime ekstradimi. Në mungesë të paraqitjes nga autoritetet italiane të kërkesës për ekstradim, bazuar në

kërkesën e tyre të datës 01.02.2022 për procedimin me ekzekutimin e dënimit penal në Shqipëri, me vendimin e datës 14.02.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur shuarjen e masës së sigurimit për efekt ekstradimi dhe, pavarësisht kërkesës së prokurorisë për caktimin e masës "Arresti me burg" për efekt njohjeje vendimi të huaj, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i KPP-së. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër *(Prokuroria e Gjirokastrës)*, për pjesën që ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit për procedurën e njohjes së vendimit penal italian.

3. Me vendimin nr. 54/21-2022-921, datë 13.06.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur të mos njohë dënimin me gjobë të dhënë nga autoritetet italiane, ndërsa ka njohur dënimin penal të Gjykatës së Apelit Romë, duke caktuar ndaj kërkuesit dënimin me 6 vjet burgim dhe përcaktuar si kohë për t'u vuajtur prej tij 4 vjet e 21 ditë burgim, për shkak të vuajtjes së një pjese të dënimit në shtetin italian. Po kështu, ajo ka shuar masën e sigurimit "Arresti në shtëpi" të caktuar ndaj kërkuesit në datën 14.02.2022 dhe, bazuar në nenin 59 të KP-së, ka pezulluar ekzekutimin e dënimit prej 4 vjetësh e 21 ditësh, duke e vendosur kërkuesin në provë për një periudhë prej 3 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryente vepër tjetër penale e të mbante kontakte me Shërbimin e Provës. Ndërsa, bazuar në nenin 60, pika 9, të KP-së, gjykata ka urdhëruar edhe që gjatë periudhës së provës kërkuesi të mos shoqërohet me persona të dënuar. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim organi i ndjekjes penale, i cili ka kërkuar ndryshimin e pjesshëm të tij, për sa i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit. Po kështu, në zbatim të vendimit të gjykatës së rrethit, në datën 16.06.2022 organi i prokurorisë ka urdhëruar shuarjen e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" të caktuar ndaj kërkuesit.

4. Ndërkohë që ankimi i prokurorisë ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër po shqyrtohej nga gjykata e apelit, në datën 07.08.2022 kërkuesi ka udhëtuar drejt Greqisë, ku është ndaluar nga autoritetet greke në zbatim të urdhërarrestit ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij nga autoritetet italiane dhe është ekstraduar në Itali, ku ka vazhduar të vuajë dënimin e dhënë nga gjykatat italiane. Gjatë kësaj periudhe, bazuar në nenin 16, paragrafi 5, të dekretit legjislativ italian nr. 286, datë 25.07.1998, të ndryshuar, për rregullat e emigracionit dhe masat ndaj të huajve *(dekreti legjislativ nr. 286/1998)*, që përcaktonte disponimin me masën e dëbimit *(ekspuls)*, si sanksion alternativ ndaj të dënuarve të cilëve

u kishin mbetur më pak se 2 vjet për të vuajtur, ai i është drejtuar dy herë Zyrës Mbikëqyrëse në Romë për disponimin ndaj tij me këtë masë. Kërkesa e parë është rrëzuar me vendimin nr. 2023/11004, datë 14.08.2023 të Zyrës Mbikëqyrëse, për shkak se nuk përmbushej kushti "më pak se 2 vjet" i përcaktuar nga dispozita e dekretit legjislativ, ndërsa kërkesa e dytë është pranuar me vendimin nr. 2024/233, datë 09.01.2024, për shkak se dënimi i mbetur për t'u ekzekutuar ishte më pak se 2 vjet. Përmes vendimit të dytë kërkuesi është informuar edhe se masa e dëbimit do të shuhej automatikisht pas 10 vjetësh nga ekzekutimi i saj dhe se në rastin e hyrjes në territorin italian në mënyrë të paligjshme, ai do të burgosej në zbatim të dënimit penal, përveç sanksioneve të tjera që gjenin zbatim. Vendimi i dëbimit i është njoftuar kërkuesit nga autoritetet italiane më 17.01.2024.

5. Kërkuesi është kthyer në territorin shqiptar në datën 31.01.2024 dhe në datën 10.05.2024 ai i është drejtuar gjykatës së apelit me kërkesë për mospranimin e ankimit të prokurorisë, duke parashtruar si shkak mungesën e objektit, në kushtet kur nga data e ndalimit 07.08.2022 deri në datën 10.01.2024 kishte vuajtur tërësisht dënimin e dhënë nga shteti italian. Me vendimin nr. 1457 (30-2024-4547), datë 12.06.2024, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka lënë në fuqi vendimin nr. 54/21-2022-921, datë 13.06.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me ndryshimin e mosaplikimit të nenit 59 të KP-së për sa i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit prej 4 vjetësh e 21 ditësh burgim dhe vendosjes së kërkuesit në provë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi. Nga ana tjetër, Prokuroria e Gjirokastrës, bazuar në nenet 462-463 të KPP-së dhe dispozitat e ligjit nr. 79/2020, datë 25.06.2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" *(ligji nr. 79/2020)*, ka nxjerrë urdhrin nr. 128, datë 03.07.2024 *(urdhër nr. 128/2024)* për ekzekutimin e vendimit të gjykatës së rrethit, të ndryshuar nga gjykata e apelit, sipas të cilit nga përllogaritjet e kohës së kaluar nën masat e sigurimit "Arresti në burg" dhe "Arresti në shtëpi" kërkuesit i kishin mbetur për të vuajtur 3 vjet, 6 muaj e 25 ditë burgim. Për ekzekutimin e këtij urdhri është ngarkuar Policia Gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, megjithatë vendimi nuk është ekzekutuar.

6. Në datën 18.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, duke vënë në dispozicion të kësaj gjykate edhe kopje të vendimit italian të dëbimit e të përgjigjes së datës 07.10.2022 të Interpolit për heqjen e të dhënave të tij nga sistemi i kërkimit ndërkombëtar për llogari të shtetit

italian. Me vendimin nr. 00-2024-1403, datë 25.07.2024, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës, ndërsa me vendimin nr. 00-2024-1747, datë 31.10.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar se ai kishte marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e tij nga gjykata e apelit, vendimi i së cilës ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj edhe për sa i përket vuajtjes së dënimit në shtetin italian.

7. Po kështu, përpara dhënies së vendimeve të lartpërmendura nga Gjykata e Lartë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me kërkesë për shuarjen e dënimit. Me vendimin nr. 130/21-2024-2213, datë 23.12.2024, gjykata ka vendosur rrëzimin e saj, me arsyetimin se, sipas nenit 11 të ligjit nr. 79/2020, procedura për ekzekutimin e dënimeve penale vihet në lëvizje nga prokurori, të cilit në lidhje me çështjen i ishte përcjellë informacioni ndërinstitucional mes Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Italisë për gjendjen e ekzekutimit të dënimit penal italian ndaj kërkuesit. Në vijim, pas vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, me vendimin e datës 23.12.2024, Prokuroria e Gjirokastrës ka vendosur shfuqizimin e urdhrit të saj nr. 128/2024, për shkak se kërkuesi kishte vuajtur dënimin e dhënë në Republikën e Italisë, si dhe ka urdhëruar Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër për heqjen e kërkuesit nga kërkimi.

8. Në datën 03.03.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 10.03.2025. Në datën 06.05.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual i kanë cenuar:

8.1. *Parimin ne bis in idem*, të garantuar nga neni 34 i Kushtetutës në lidhje me *parimin e sigurisë juridike*, pasi *i)* është dënuar me 4 vjet e 21 muaj burg nga gjykata e apelit, ndonëse kishte vuajtur dënimin për të njëjtën vepër në shtetin italian. Në kushtet kur në momentin e ekstradimit nga Greqia në Itali vendimi i gjykatave

shqiptare për njohjen e dënimit penal të huaj nuk kishte marrë formë të prerë, shteti italian ka njohur dhe llogaritur kohën e dënimit të vuajtur prej tij në Shqipëri dhe ai ka vijuar vuajtjen e dënimit në shtetin italian. *ii)* Në këtë proces gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me nenet 512-518 të KPP-së. Ajo nuk ka marrë provat e kërkuara nga ligji e nuk ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor. *iii)* Në njohjen e vendimit penal të huaj autoritetet shqiptare të drejtësisë nuk kanë marrë në konsideratë e trajtuar shkresën e zyrës qendrore të Interpolit për heqjen e tij nga kërkimi ndërkombëtar për llogari të autoriteteve italiane, vendimin e datës 09.01.2024 të këtyre të fundit për lirimin e kërkuesit, për shkak të vuajtjes së plotë të dënimit, si dhe korrespondencën zyrtare të autoriteteve italiane të datës 20.11.2024 që vërtetonte ekzekutimin e vendimit penal.

8.2. *Lirinë personale*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi i është hequr liria në mënyrë arbitrare, duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm psikologjik dhe fitim të munguar.

8.3. *Të drejtën për proces të rregullt* ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të:

8.3.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi shqyrtimi i çështjes nga gjykata e apelit është zhvilluar në një seancë të vetme dhe gjykata nuk i ka dhënë mundësi të paraqesë prova të reja në formën e kërkuar nga ligji, në shkelje të nenit 427 të KPP-së, ndërsa Gjykata e Lartë nuk i ka marrë parasysh pretendimet e tij.

8.3.2. *Parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit* të lidhur me *parimin e barazisë përpara ligjit,* të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi *i)* organi i prokurorisë dhe gjykata e apelit nuk kanë bashkëpunuar me autoritetet italiane për sigurimin, përmes letërporosive, të akteve provuese për vuajtjen e dënimit në shtetin italian, në shkelje të neneve 8/a, 427 dhe 509-511 të KPP-së. Në datën 13.10.2022 organet e drejtësisë italiane u kanë komunikuar zyrtarisht autoriteteve të drejtësisë shqiptare revokimin e kërkimit ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij, informacion i cili nuk është trajtuar asnjëherë nga autoritetet shqiptare. *ii)* Vendimi i gjykatës së apelit është marrë pa administruar në mënyrë të plotë dhe të barabartë provat e mbrojtjes. Kjo gjykatë ka favorizuar pretendimet e prokurorisë, pa lejuar shqyrtim të plotë e të gjithanshëm të çështjes.

8.3.3. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, për shkak se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë marrë parasysh argumentet kryesore të tij.

8.3.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* si rrjedhojë e arsyetimit të Gjykatës së Lartë se asnjëra nga palët pjesëmarrëse në procesin gjyqësor në shkallë të parë nuk ka ngritur pretendimin se dënimi për të ishte shuar ose ishte vuajtur në shtetin italian. Një arsyetim i tillë tregon edhe *njëanshmërinë* e kësaj gjykate në gjykimin e çështjes.

8.4. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** ka prapësuar:

8.4.1. Pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit *ne bis in idem* dhe *parimit të sigurisë juridike* janë të pabazuara. Vendimet e gjykatave shqiptare për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja nuk kanë karakter penal, por administrativo-penal. Ky qëndrim është konfirmuar edhe në vendimin unifikues nr. 5, datë 10.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në momentin e ndalimit në Shqipëri në datën 07.01.2022, kërkuesit i kishin mbetur për të vuajtur 4 vjet e 21 ditë burg, periudhë kjo e njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Gjatë procesit të zhvilluar nga kjo gjykatë, kërkuesi nuk ka kundërshtuar njohjen e vendimit penal të gjykatës italiane dhe nuk ka pretenduar se ka kryer dënimin ose se po dënohet dy herë për të njëjtën vepër, por ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë, çka është pranuar nga gjykata. Ndërsa për periudhën 07.01.2022-14.02.2022 ai ka qenë nën masën e sigurimit "Arresti në burg" për qëllime të urdhërarrestit ndërkombëtar, pasi nuk e kishte kryer ende dënimin e caktuar në Itali. Pra, efektivisht kërkuesi nuk ka kryer asnjë ditë burgim në Shqipëri në ekzekutim të vendimit të shtetit italian dhe problematikat në ekzekutimin e këtij të fundit janë pasojë e veprimeve të tij.

8.4.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, për shkak të *mosanalizimit të provave nga gjykata, mosmarjes në konsideratë të argumenteve të mbrojtjes e pamundësisë efektive për t'u mbrojtur, gjykimit të njëanshëm e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi kërkuesi ka qenë dakord me vendimin e

gjykatës së rrethit dhe nuk e ka ankimuar atë. Procedura e ekstradimit të tij nga Greqia për në Itali është realizuar pa dijeninë dhe përfshirjen e shtetit shqiptar, ndërsa autoritetet italiane nuk kanë informuar shtetin shqiptar për veprimet e ndërmarra në ekzekutimin e vendimeve të gjykatave italiane, edhe pse këto veprime kishin ndikim në procesin e njohjes së vendimit penal. Pavarësisht se kërkuesi ka qenë në dijeni të procesit për njohjen e vendimit të autoriteteve italiane, ai nuk ka kërkuar prej tyre tërheqjen e kërkesës për njohje ose komunikimin palës shqiptare të ekzekutimit të vendimit në Itali. Edhe pse ka informuar gjykatën e apelit për shlyerjen e dënimit në Itali, kërkuesi nuk ka paraqitur prova bindëse për këtë fakt, ndërsa është orientuar nga gjykata të ndjekë procedurën e shuarjes së dënimit përmes vënies në lëvizje të procesit përkatës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Për sa i takon legjitimimit *ratione personae,* Gjykata ka pohuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 21, datë 22.04.2025; nr.*

17, datë 13.03.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *lirinë personale*. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka e prapësuar si të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se efektivisht kërkuesi nuk ka kryer asnjë ditë burgim në Shqipëri në ekzekutim të vendimit të shtetit italian.

12. Liria personale garantohet nga neni 27 i Kushtetutës, pika 2, shkronja "a", e të cilit parashikon se ajo nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Në çështjen në shqyrtim Gjykata evidenton se kërkuesi është dënuar me vendim përfundimtar nga gjykatat italiane dhe, në kuadër të këtij dënimi, gjykata e rrethit ka caktuar fillimisht ndaj tij masën e sigurimit "Arresti në burg" për qëllime ekstradimi, nën të cilën ai ka qëndruar në burg për 1 muaj e 7 ditë, e në vijim masën "Arresti në shtëpi", për qëllim njohjen e vendimit penal italian, e cila është zbatuar për një periudhë prej 4 muajsh. Më pas, po kjo gjykatë ka njohur dënimin penal italian prej 4 vjetësh e 21 ditësh, ndërsa ka pezulluar ekzekutimin e tij, duke e vënë kërkuesin në provë, vendim i cili është ndryshuar nga gjykata e apelit vetëm për sa i përket vënies së kërkuesit në provë. Gjykata vë në dukje se kërkuesi nuk ka paraqitur ankim ndaj masave të sigurimit të caktuara ndaj tij gjatë procedurës së njohjes së vendimit penal italian dhe në ankimin kushtetues individual nuk ka kundërshtuar heqjen e lirisë për shkak të këtyre masave, por për shkak të njohjes së dënimit të dhënë nga gjykatat italiane. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, edhe pse vendimet objekt të ankimit kushtetues individual kanë njohur dënimin me burgim prej 4 vjetësh e 21 muajsh të dhënë ndaj kërkuesit, ato nuk rezultojnë të jenë zbatuar asnjëherë. Në këtë situatë, në kushtet kur kërkuesi nuk është privuar efektivisht nga liria personale, pasi vendimet e kundërshtuara nuk kanë sjellë pasoja ndaj tij, Gjykata vlerëson se ai nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimin e cenimit të kësaj lirie.

13. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata konstaton se objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimi i gjykatës së apelit,

për të cilin kërkuesi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit, si dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, për kundërshtimin e të cilit ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Në këtë situatë çmohet se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

15. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor për njohjen e vendimit penal të Gjykatës së Apelit Romë, i është njoftuar në rrugë elektronike avokates së kërkuesit në datën 20.12.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 03.03.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet objekt të ankimit kushtetues individual i kanë cenuar *parimin ne bis in idem* në lidhje me *parimin e sigurisë juridike*, si dhe *të drejtën për proces të rregullt ligjor* (në disa aspekte), të garantuara respektivisht nga nenet 34, 4 dhe 42 të Kushtetutës. Duke pasur parasysh argumentet në themel të këtyre pretendimeve, të cilat parashtrohen në drejtim të mosmarrjes parasysh nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë të argumenteve e provave të paraqitura prej tij për vuajtjen e plotë të dënimit italian dhe moskërkimit nga autoritetet italiane të provave që provonin këtë fakt, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë së armëve. Për këtë qëllim, Gjykata do të verifikojë mënyrën sesi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë zbatuar dispozitat procedurale gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje të vendimit penal të huaj, duke iu referuar për këtë qëllim arsyetimit të këtyre gjykatave.

17. Krahas sa më lart, Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kërkuar edhe shpërblimin e dëmit psikologjik të shkaktuar si rrjedhojë e vendimeve të kundërshtuara, si dhe fitimin e munguar. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, shqyrtimi i kërkesës për dëmshpërblim nuk bën pjesë në juridiksionin e saj *(shih vendimet nr. 17, datë 26.09.2022; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Gjykata vlerëson se kërkimet për shpërblimin e dëmit psikologjik dhe fitimin e munguar nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Për sa më sipër, Gjykata do të analizojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit, duke i trajtuar ato së bashku në drejtim të *parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë së armëve*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë së armëve

19. Kërkuesi ka pretenduar se është dënuar me burgim nga gjykata e apelit, ndonëse kishte vuajtur dënimin për të njëjtën vepër në shtetin italian. Sipas tij, në njohjen e vendimit penal të huaj kjo gjykatë nuk ka marrë në konsideratë shkresën e zyrës qendrore të Interpolit për heqjen e tij nga kërkimi ndërkombëtar ose vendimin e autoriteteve italiane për lirimin e tij, për shkak të vuajtjes së plotë të dënimit. Po sipas kërkuesit, kjo gjykatë nuk ka bërë shqyrtim të plotë të çështjes, nuk ka marrë provat e kërkuara nga ligji, nuk ka bashkëpunuar me autoritetet italiane për sigurimin e akteve provuese për vuajtjen e dënimit në shtetin italian, e nuk ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, në shkelje të neneve 8/a, 427 dhe 509-518 të KPP-së. Këto pretendime nuk janë marrë parasysh as nga Gjykata e Lartë.

20. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata e rrethit kërkuesi nuk ka pretenduar se e ka kryer dënimin, por ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të tij dhe vënien në provë, çka edhe është pranuar. Ai ka qenë dakord me këtë vendim dhe nuk e ka ankimuar atë. Ekstradimi i kërkuesit nga Greqia për në Itali dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës italiane janë realizuar pa dijeninë e shtetit shqiptar, edhe pse këto veprime kishin ndikim në procesin e njohjes së vendimit penal. Po kështu, gjatë vuajtjes së dënimit në Itali kërkuesi nuk ka kërkuar nga autoritetet italiane tërheqjen e kërkesës për njohje ose komunikimin palës shqiptare të ekzekutimit të vendimit në Itali. Problematikat në ekzekutimin e vendimit të shtetit italian janë pasojë e veprimeve të tij. Ndonëse ka informuar gjykatën e apelit për shlyerjen e dënimit në Itali, kërkuesi nuk ka paraqitur prova bindëse për këtë fakt.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, që sanksionohet në nenin 4 të Kushtetutës, si një prej parimeve themelore të organizimit shtetëror. Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim konsiston në detyrimin për zbatimin e tërësisë së normave juridike nga organet shtetërore, përfshirë edhe nga gjykatat *(shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Po sipas Gjykatës, në procesin penal parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, i lidhur ngushtë me mbrojtjen e të pandehurit,

përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij *(shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 13, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Gjykata vëren se titulli X, kreu III, seksioni I, i KPP-së rregullon procedurën e ekzekutimit të vendimeve penale të huaja në Shqipëri. Konkretisht, neni 512 parashikon njohjen e vendimeve penale të huaja, neni 514 kushtet e njohjes, neni 515 masat shtrënguese për qëllime të njohjes së këtyre vendimeve, neni 516 caktimin nga gjykatat të dënimit, ndërsa neni 518 ekzekutimin e vendimeve penale të huaja.

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se zbatimi i parimit *ne bis in idem* duket se nuk përjashtohet edhe në rastet kur bëhet fjalë për njohjen e vendimeve penale të huaja. Qëllimi i këtij parimi është pengimi i ndjekjes penale dhe i gjykimit të dyfishtë në të njëjtin juridiksion dhe mbrojtja e sigurisë juridike. Në këtë drejtim vlen të theksohet se vendimi i njohjes së një vendimi penal të huaj nuk është vendim penal i ri. Ai ka natyrë deklarative, konfirmuese dhe ekzekutuese, ndërsa konkretizon pasojat reale penale ndaj personit. Megjithatë, në rastin kur në një shtet ekziston një vendim penal i formës së prerë (përfundimtar) për të njëjtin fakt penal, njohja nga ai shtet i një vendimi penal të huaj shndërrohet në të vërtetë në një gjykim të dyfishtë pikërisht nga pasojat reale që prodhon vendimi i njohjes, ndërsa për shkak të këtij vendimi i dënuari përballet me të njëjtat pasoja si në rastin e një dënimi të ri *(shih vendimin nr. 11, datë 13.03.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Sipas jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë, në procesin e njohjes të një dënimi penal të huaj gjykata shqiptare nuk e shqyrton çështjen në themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e shtetit dënues, por verifikon nëse ekzistojnë kushtet për njohjen e vendimit të huaj, duke iu përgjigjur atij vendimi me një vendim që konverton dënimin e huaj me një dënim të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, duke përcaktuar edhe dispozitat përkatëse që zbatohen *(shih vendimet unifikuese nr. 5, datë*

10.10.2002; nr. 154, datë 15.04.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

26. Gjykata evidenton se paragrafët 5 dhe 9 të nenit 16 të dekretit legjislativ italian nr. 286/1998 kanë parashikuar masën e dëbimit nga territori, e cila zbatohet ndaj të huajve të ndaluar që ndodhen në njërën nga situatat e përcaktuara në nenin 13, paragrafi 2, të këtij dekreti *(hyrje në territorin italian pa iu nënshtruar kontrollit kufitar, shkelje e lejes së qëndrimit, etj.)* dhe që janë duke vuajtur një dënim me burgim, qoftë edhe të mbetur, jo më shumë se dy vjet. Në rastin e konkurrimit të krimeve ose bashkimit të dënimeve konkurruese, dëbimi urdhërohet edhe kur pjesa e dënimit për krimet që nuk lejojnë dëbimin është vuajtur. Dëbimi, si zëvendësim ose sanksion alternativ ndaj burgimit, nuk zbatohet për rastet e përmendura në nenin 19 *(për shkak seksi, orientimi seksual, gjinie, gjuhe, shtetësie, feje, opinionesh politike, situatash personale ose sociale etj.)*.

27. Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, Gjykata do të verifikojë në vijim: i) nëse gjykata e apelit ka marrë në konsideratë pretendimet e kërkuesit për vuajtjen e plotë të dënimit me burgim të dhënë nga gjykata italiane, për sa kohë po procedohej për njohjen e një vendimi me burgim, i cili ishte i paekzekutueshëm në efektet e tij, si rrjedhojë e caktimit të masës së dëbimit; ii) nëse në zbatim të parimit të subsidiaritetit Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit për cenimin nga gjykata e apelit të parimit të barazisë së armëve, si pasojë e mosmarrjes në shqyrtim të këtyre pretendimeve; iii) arsyetimin e gjykatës së apelit për paraqitjen nga kërkuesi të një kërkesë të veçantë për shuarje dënimi, duke e orientuar atë drejt një procesi tjetër gjyqësor, ndërkohë që po procedonte me njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, si dhe nëse Gjykata e Lartë e ka analizuar ose korrigjuar këtë gjë. Në varësi të përfundimit të kësaj analize, Gjykata do të vlerësojë më tej nëse arsyetimi i gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë në procesin e njohjes së dënimit të dhënë nga gjykata italiane ka çuar në cenimin e parimit të sigurisë juridike në kuptim të pritshmërive të ligjshme të kërkuesit.

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi është dënuar përfundimisht me 4 vjet e 21 ditë burgim dhe 25.000 euro gjobë nga Gjykata e Apelit Romë, vendim i cili është njohur në Shqipëri me kërkesë të autoriteteve italiane. Gjatë procesit të njohjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vlerësuar se dënimi në shtetin shqiptar nuk mund të kalonte dënimin përfundimtar të dhënë nga gjykata italiane, ndërsa vendimi me gjobë, shoqërues i dënimit me burgim, nuk mund të njihej e ekzekutohej,

bazuar në vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës. Në përfundim të gjykimit, me vendimin e datës 13.06.2022 gjykata ka njohur si dënim të mbetur për t'u vuajtur nga kërkuesi 4 vjet e 21 ditë, ndërsa e ka vënë atë në provë për një periudhë 3-vjeçare, me kusht që përgjatë kësaj periudhe të mos kryente vepra të tjera penale, si dhe të mbante kontakte me shërbimin e provës.

29. Kërkuesi është liruar bazuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër që e ka vënë në provë dhe në datën 07.08.2022 ka udhëtuar për në Greqi, ku është arrestuar e më pas ekstraduar për në Itali, duke vuajtur dënimin në këtë shtet deri në datën 31.01.2024 kur është kthyer në territorin shqiptar për shkak të caktimit ndaj tij të masës së dëbimit nga shteti italian. Në vijim, në datën 10.05.2024 ai i është drejtuar gjykatës së apelit me kërkesë për mospranimin e ankimit të prokurorisë, me argumentin se kishte vuajtur tërësisht dënimin me burgim të dhënë nga shteti italian, duke vënë në dispozicion të kësaj gjykate edhe vendimin e dëbimit të autoriteteve italiane.

30. Me vendimin e datës 12.06.2024, pas gjykimit të çështjes në një seancë të vetme, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit në pjesën që ka dënuar kërkuesin me 4 vjet e 2 muaj burgim, ndërsa e ka ndryshuar atë në pjesën që ka vënë kërkuesin në provë, duke vlerësuar se zbatimi nga ajo gjykatë i nenit 59 të KP-së ishte i gabuar në këndvështrim të nenit 516, pika 3, të KPP-së, pasi Gjykata e Apelit Romë nuk kishte pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim ose vënë kërkuesin në provë. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit se kishte vuajtur dënimin në shtetin italian, gjykata e apelit i ka vlerësuar ato të pabazuara, me arsyetimin se krahas faktit që provat në këtë drejtim ndodheshin në shtetin italian dhe duheshin marrë me letërporosi, këto pretendime nuk mund të ishin objekt i procesit të njohjes së vendimit penal të huaj, por për këtë qëllim kërkuesi duhej t'u drejtohej gjykatave me kërkesë për shuarje dënimi, duke bashkëlidhur provat që mbështesnin një pretendim të tillë.

31. Në vlerësim të vendimeve të gjykatave të faktit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vënë në dukje se ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit ishte ushtruar vetëm nga organi i ndjekjes penale. Ndërsa për sa u përket shkaqeve të rekursit, ka vlerësuar se gjykata e apelit e kishte shqyrtuar çështjen konform nenit 425, pika 1, të KPP-së, pasi sipas vendimit të autoriteteve italiane për dëbimin e kërkuesit, si masë alternative ndaj burgimit, rezultonte se nga dënimi penal atij i kishin mbetur për t'u shlyer,

krahas gjobës, edhe 3 vjet, 9 muaj e 25 ditë burgim, nga të cilat zbriteshin 180 ditë lirimi të parakohshëm, dhe se shlyerja e dënimit kishte filluar në datën 07.08.2022 e përfundonte në datën 02.12.2025. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë ka çmuar të drejtë arsyetimin e gjykatës së apelit se provat për vuajtjen e dënimit në shtetin italian duhet të paraqiteshin në kërkesën për shuarje dënimi, me argumentin se, sipas nenit 518 të KPP-së, veprimet e ekzekutimit të vendimit kryhen nga prokurori dhe pasi vendimi i njohjes merr formë të prerë, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës së vendit të ekzekutimit për kërkesa e pretendime që i përkasin kësaj faze, sikurse është edhe ajo për shuarjen e dënimit.

32. Gjatë gjykimit të çështjes nga Gjykata e Lartë kërkuesi i është drejtuar gjykatës së rrethit me kërkesë për shuarjen e dënimit të njohur nga gjykatat e faktit, për të cilën, me vendimin e datës 23.12.2024, gjykata ka vendosur rrëzimin, me arsyetimin se kompetenca për pushimin e ekzekutimit të dënimit penal i përkiste prokurorit dhe se ajo nuk mund të shuante vendimin e njohjes, pasi ai nuk përbënte një vendim dënimi. Po në të njëjtën datë Prokuroria e Gjirokastrës ka shfuqizuar urdhrin e saj të mëparshëm nr. 128/2024, që kishte përcaktuar dënimin prej 3 vjetësh, 6 muajsh e 25 ditësh burgim të mbetur për t'u vuajtur nga kërkuesi, duke e konsideruar të vuajtur këtë dënim.

33. Në analizë të vendimmarrjeve të kundërshtuara përkundrejt rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit kërkuesi ka vënë në dispozicion të kësaj gjykate vendimin e dëbimit të dhënë nga autoritetet italiane. Pavarësisht kësaj, gjykata ka proceduar me njohjen e dënimit të plotë me burgim të dhënë nga gjykata italiane, ndonëse ky dënim ishte i paekzekutueshëm në efektet e tij, si rrjedhojë e caktimit ndaj kërkuesit të masës së dëbimit. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar se pretendimet për ekzekutimin e vendimit penal të huaj duhej të parashtroheshin në proces të veçantë për shuarjen e dënimit, edhe pse kompetenca për ekzekutimin e tij i përkiste vetë kësaj gjykate. Ndërkohë, pavarësisht pretendimit të kërkuesit për cenimin nga gjykata e apelit të parimit të barazisë së armëve, për shkak të mosmarrjes në konsideratë dhe moskërkimit të akteve që provonin kryerjen e plotë të dënimit, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e kësaj gjykate, edhe pse ka pranuar se vendimi i dëbimit përbën masë alternative dënimi. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se veprimet e ekzekutimit kryhen nga prokurori, ndërsa subjekti i njohjes ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës së ekzekutimit me kërkesa e pretendime që i përkasin kësaj faze,

sikurse është edhe shuarja e dënimit, duke bërë të ekzekutueshëm në rendin e brendshëm vendimin e plotë të gjykatës italiane, në interpretim të ngushtë të dispozitave të legjislacionit shqiptar dhe jurisprudencës kushtetuese për njohjen e vendimeve penale të huaja.

34. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata fillimisht rithekson se në rastin konkret nuk gjen zbatim parimi *ne bis in idem*, për sa kohë kërkuesi nuk ndodhet në situatën kur për të njëjtin fakt penal juridiksioni gjyqësor shqiptar të ketë dhënë dy vendime, pra atë të njohjes dhe një vendim tjetër penal. Në vijim, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme, duke mos respektuar parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, kanë zbatuar formalisht ligjin, duke ia kaluar kompetencën për riparimin e situatës prokurorisë, e cila ndonëse *de facto* ka shfuqizuar urdhrin e saj të mëparshëm për burgosjen e kërkuesit, sipas sistemit tonë ligjor ka kompetencën të ekzekutojë vendimet gjyqësore dhe jo të ndryshojë thelbin e vendimmarrjes gjyqësore. Ato gjykata kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi, në cilësinë e individit, duke e vënë atë në pozicion të pafavorshëm me prokurorinë, e cila si subjekti që ka vënë në lëvizje procedurën e njohjes, ka detyrimin të provojë në gjykim ekzistencën e një vendimi të ekzekutueshëm, të vlefshëm për njohje. Me fjalë të tjera, si rrjedhojë e vendimmarrjeve të kundërshtuara kërkuesi duket se është vënë në situatën, ku krahas një dënimi të caktuar nga një juridiksion i huaj, ekzekutimi i të cilit është ndërprerë, me anë të caktimit të një mase alternative (dëbim) ndaj tij përmes njohjes, është caktuar sërish dënimi me burgim 4 vjet e 21 ditë. Në kushtet kur ekzekutimi i dënimit të vendimit penal të gjykatës italiane lidhej drejtpërsëdrejti me procesin e njohjes në Shqipëri të atij vendimi, Gjykata vlerëson se ndryshimi i situatës juridike të kërkuesit duhej të ishte trajtuar nga Gjykata e Lartë në kuadër të garantimit të parimit të sigurisë juridike në fushën penale. Në këtë kontekst, duke mos marrë në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete, përmes mospranimit të rekursit Gjykata e Lartë ka lejuar ekzekutimin e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuesit nga gjykata italiane, veprim që nuk përputhet me funksionin e saj si gjykatë ligji.

35. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë së armëve janë të bazuara, sipas arsyetimit të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1747, datë 31.10.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.12.2025
Shpallur më 10.02.2026

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuesit, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 1457 (30-2024-4547), datë 12.06.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nr. 00-2024-1747, datë 31.10.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam kundër vendimit të shumicës për prishjen e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe për kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, për arsyet e mëposhtme.

2. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trupë të përbërë nga tre gjyqtarë, ka vepruar dhe ka gjykuar brenda kompetencave që i njeh neni 141, pika 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 14/a, 432 e 433 të KPP-së, kur ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Gjykata e Lartë në vendimin e saj u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuesi, duke argumentuar për to e duke thënë praktikisht se çështjet që lidhen me ekzekutimin e vendimit penal të huaj, të cilat njihen në Shqipëri, i përkasin fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Sipas nenit 518, pikat 1, 2 dhe 3 të KPP-së që parashikon se: "*1. Pasi janë njohur, vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen sipas ligjit shqiptar. 2. Prokurori pranë gjykatës që ka bërë njohjen e vendimit merr masa për ekzekutimin e tij. 3. Dënimi me burgim i vuajtur në shtetin e huaj llogaritet për efektet e ekzekutimit.*". Pra, e njëjtë si në rastin e kalimit në fazë ekzekutimi të një vendimi penal themeli të gjykatave vendase, edhe në rastin e bërjes të ekzekutueshëm të një vendimi penal për njohjen e vendimit penal të gjykatës së huaj, prokurori duhet të bëjë llogaritjet përkatëse sipas nenit 465 të KPP-së dhe t'i njoftojë të dënuarit dhe mbrojtësit të tij urdhrin përkatës të ekzekutimit. Nëse gabimisht prokurori konstaton se ka vend për ekzekutim, kur në fakt vendimi i njohjes së një vendimi penal të huaj, për çfarëdolloj shkaku (përfshirë dhe dëbimin dhe lirimin me kushtin që i dënuari të mos kthehet në Itali, të ndodhur shumë kohë pas paraqitjes së kërkesës për njohje vendimi penal të huaj) duhet të quhet i shuar, atëherë kërkuesi ka të drejtë që të kundërshtojë në gjykatë konform neneve 470, pika 1, (gjykata kompetente) dhe 480 (shuarja e dënimit) të KPP-së.

3. Sipas nenit 512, pika 2, të KPP-së "Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshjeje

ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar." Në mungesë të ekzistencës së kushteve për mosnjohjen e vendimit penal të huaj, sipas nenit 514 të KPP-së, gjykatat nuk kishin ndonjë arsye për të mos njohur vendimin e huaj të gjykatave italiane, pasi kërkuesi nuk kishte paraqitur ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ankimi në gjykatën e apelit ishte bërë vetëm nga prokurori, për zbatimin e nenit 59 të KPP-së. Kërkuesi ishte dakord që të lihej në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë (njohje vendimi me pezullim me kusht) dhe ka kërkuar mospranimin e ankimit të prokurorit në gjykatën e apelit, por kjo situatë ishte e njëjtë me atë që ka ndodhur në fakt, ku prokuroria në fazën e ekzekutimit ka konstatuar se nuk ka vend për ekzekutim, për shkak të dëbimit të kërkuesit nga autoritetet italiane dhe pezullimin e ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit, me kusht që të mos shkelte në Itali për një numër vitesh, pasi në të kundërt do të vuante pjesën e mbetur të dënimit. Pikërisht ky fakt, i cili lidhet me fazën e ekzekutimit të dënimit, shihet në fazën e ekzekutimit të vendimit të njohjes, që sipas nenit 518, pikat 2 dhe 3 të KPP-së vlerësohet nga prokurori dhe kontrollohet nga gjykata në rast të gabimeve nga ky i fundit. Kjo do të ndodhte në çdo rast, kur ekzekutimi i vendimit të gjykatës do të vlerësohej se ishte shuar, për fakte të ngjara pas dhënies së vendimit penal të formës së prerë nga gjykata e huaj.

4. Në rastin objekt shqyrtimi kushtetues, pikërisht një gjë e tillë ka ndodhur, ku siç pranon edhe shumica në paragrafin 33 të vendimit të saj, gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm me kërkesë për shuarjen e dënimit të dhënë përmes vendimeve të gjykatave të zakonshme gjatë procesit të njohjes, e cila është rrëzuar me vendimin e datës 23.12.2024 të kësaj gjykate, me arsyetimin se në kushtet kur gjendja e ekzekutimit të vendimit dërguar autoriteteve shqiptare nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë i ishte përcjellë për kompetencë prokurorit, ishte pikërisht ai që duhej të pushonte ekzekutimin, për sa kohë që vendimi i njohjes nuk përbënte vendim dënimi. Po në datën 23.12.2024 Prokuroria e Gjirokastrës ka vendosur shfuqizimin e urdhrit të saj të ekzekutimit nr. 128/2024, me arsyetimin se kërkuesi e kishte vuajtur dënimin në Republikën e Italisë.

5. Në këtë pikë vlen të theksohet se edhe sikur të pranohet se gjykatat nuk kanë treguar vigjilencën e duhur për zbatimin e nenit 516, pika 3, të KPP-së, përsëri kërkuesit nuk i ka ardhur asnjë dëm. Gjykatat e kanë analizuar situatën e tij dhe kanë arritur në përfundimin se ajo zgjidhet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal të njohjes së vendimit penal të

huaj, ashtu siç edhe është vepruar nga prokuroria kompetente. Këtu duhet mbajtur parasysh edhe fakti se gjykata e apelit e ka shqyrtuar çështjen vetëm me ankimin e prokurorit dhe se konform nenit 425, pika 1, të KPP-së, që përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel "*1. Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkë të pandehurve që nuk kanë bërë apel.*". Gjykata e Lartë dhe ajo e apelit (e cila kishte për shqyrtim vetëm ankimin e prokurorit) nuk kanë thënë se kërkuesi nuk ndodhet në kushtet e shuarjes së dënimit (për shkak të pezullimit me kusht të vuajtjes së tij me vendim të gjyqtarit mbikëqyrës në Itali), por këtë kërkesë ai duhej ta paraqiste pranë organit kompetent të ekzekutimit të vendimeve penale, sepse përbënte element që shihet në fazën e ekzekutimit, siç edhe është parë nga prokuroria përkatëse.

6. Nuk pajtohem me konkluzionin e arritur nga shumica në paragrafin 35 të vendimit se vendimmarrja e prokurorisë ndryshon thelbin e vendimmarrjes gjyqësore, pasi prokuroria në këtë rast ka zbatuar kompetencat e veta sipas fazës së ekzekutimit të vendimit penal, e jo fazës së njohjes së tij nga gjykatat vendase. Ndaj mendoj se Gjykata e Lartë në këtë rast nuk ka cenuar nga pikëpamja kushtetuese parimin e sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë së armëve, sepse siç është argumentuar më lart dhe siç kanë pranuar gjykatat e zakonshme, kërkuesi nuk mund të burgosej dhe nuk është burgosur, për sa kohë që vendimi i njohur i gjykatës së huaj ishte pezulluar nga autoritetet kompetente italiane disa vite pasi kishte marrë formë të prerë, me kusht që kërkuesi të mos shkelte në territorin italian, fakt ky i konstatuar jo vetëm nga gjykatat (bazuar në provat e kufizuara të sjella nga kërkuesi në gjykatën e apelit), por edhe nga organi kompetent për ekzekutimin e vendimeve penale, që është prokuroria. Kthimi për rigjykim i çështjes në këtë rast individual nuk passjell përmirësim të situatës për kërkuesin e nuk rivendos ndonjë të drejtë të tij, pasi nuk rezulton t'i jetë cenuar ndonjë e drejtë kushtetuese.

Anëtar: Asim Vokshi

Vendim nr. 85, datë 23.12.2025
(V-85/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 18.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (Y) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **YLLI ZYLA**, përfaqësuar nga avokat Rezart Tërshana, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
MINISTRIA E MBROJTJES, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Aleks Marku.
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5124, datë 18.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 18, 42, 43, 44, 49, 52, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 141, 142 dhe 167 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 27, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Ylli Zyla (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradën "Kolonel", duke kryer detyra të ndryshme. Me urdhrin nr. 1818, datë 20.09.2013 të ministrit të Mbrojtjes, të nxjerrë në bazë të nenit 26 të ligjit nr. 9171, datë 22.01.2004 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" *(Ligji për Karrierën Ushtarake)* dhe nenit 19, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ai është liruar nga detyra e komandantit të Policisë Ushtarake dhe është vënë në dispozicion të Forcave të Armatosura deri në sistemimin në detyrë tjetër. Me të njëjtin urdhër kërkuesit i është njohur e drejta që, deri në sistemimin në detyrën e re, të paguhej me pagën mujore të gradës për dy muaj sipas nenit 26 të Ligjit për Karrierën Ushtarake.

2. Kërkuesi nuk është sistemuar në detyrë tjetër. Pas dy muajve, ai i është drejtuar me kërkesë për risistemim Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo e fundit, në datën 19.12.2013 i është përgjigjur se i kishte përcjellë propozimet përkatëse Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe se procedurat e emërimit të personelit të liruar ishin ende në proces.

3. Në këto rrethana, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e Ministrisë së Mbrojtjes ta rikthente në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër në nivelin e gradës "Kolonel", si dhe t'i paguante pagën e plotë deri në rikthimin në punë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1865, datë 24.04.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar Ministrinë e Mbrojtjes t'i paguante kërkuesit pagën mujore sipas gradës që mbante, duke filluar nga

data 20.11.2013 deri në emërimin ose nxjerrjen e tij në rezervë/lirim, ndërsa kërkimet e tjera janë rrëzuar. Kundër vendimit ka paraqitur apel vetëm Ministria e Mbrojtjes, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 887, datë 24.04.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit, me arsyetimin se padia nuk mund të ngrihej. Sipas gjykatës së apelit, ligjvënësi kishte përcaktuar kufi të pagesës deri në 2 muaj dhe ushtaraku nuk mund të paguhej përtej këtij afati. Pas kalimit të afatit ushtaraku mund të investonte gjykatën për të kërkuar nxjerrjen e aktit të emërimit në një detyrë tjetër, por në rastin konkret ky kërkim nuk ishte paraqitur. Po ashtu, sipas gjykatës së apelit, Ministria e Mbrojtjes kishte përmbushur detyrimin ligjor për dhënien e pagesës 2-mujore, ndërsa rikthimi në detyrë nuk parashikohej nga Ligji për Karrierën Ushtarake.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3518, datë 01.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ai (kërkuesi) nuk kishte apeluar pjesën e rrëzuar të padisë, që lidhej me kërkimin për t'u sistemuar në një detyrë tjetër sipas gradës që mbante, ndaj gjykata e apelit me të drejtë kishte prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kishte pushuar gjykimin e çështjes.

6. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, ministri i Mbrojtjes ka lëshuar urdhrin nr. 1180, datë 05.09.2014, me të cilin, bazuar në ligjin nr. 9183, datë 05.02.2004 "Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ka nxjerrë në lirim kërkuesin për shkelje të rënda disiplinore.

7. Në datën 16.07.2015 kërkuesi ka ngritur sërish padi në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e Ministrisë së Mbrojtjes t'i paguante pagën për periudhën e mbajtjes së tij në dispozicion të Forcave të Armatosura, tashmë nga data 20.11.2013 deri në datën e lirimit, më 05.09.2014. Në atë padi, kërkuesi ka pretenduar se pavarësisht kalimit të afatit 2-mujor të parashikuar nga neni 26 i Ligjit për Karrierën Ushtarake, Ministria e Mbrojtjes nuk e kishte sistemuar në detyrë tjetër dhe as e kishte nxjerrë në rezervë/lirim, pra e kishte mbajtur në dispozicion, për rrjedhojë nuk duhej t'i kishte ndërprerë pagën e ushtarakut aktiv.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5248 (80-2015-3527), datë 21.10.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave

të Armatosura kishin detyrimin për të paguar ushtarakun në dispozicion vetëm 2 muaj dhe se, në thelb, kërkimi i padisë ishte gjë e gjykuar, duke iu referuar për këtë qëllim procesit gjyqësor të përfunduar me vendim pushimi (*shih paragrafët 4-5 të vendimit*). Me këtë arsyetim, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk mund të paguhej përtej 2 muajve, ndaj veprimtaria administrative e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ishte e drejtë dhe në respektim të plotë të ligjit.

9. Megjithëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 4425, datë 26.10.2017. Gjykata e apelit ka arsyetuar, ndër të tjera, se janë të pabazuara pretendimet e kërkuesit për cenimin e neneve 49 e vijues të Kushtetutës, pasi mospërfitimi i pagës për periudhën 20.11.2013 – 05.09.2014 është rezultat i zbatimit të Ligjit për Karrierën Ushtarake dhe vendimmarrja e Ministrisë së Mbrojtjes nuk ia ka mohuar të drejtat kushtetuese kërkuesit.

10. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5124, datë 18.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin standard se nga vlerësimi i rrethanave të mosmarrëveshjes arrihet në përfundimin se në rekurs nuk ishte parashtruar ndonjë argument i qenësishëm që të lidhej me shkaqet e parashikuara nga ligji për paraqitjen e rekursit.

11. Në datën 03.04.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 12.06.2025, bazuar në nenin 36, pika 3, shkronja "ç", të Ligjit Organik të Gjykatës, ka pranuar kërkesën për heqjen dorë të gjyqtarit relator të çështjes. Në vijim, në datën 24.06.2025 Kolegji i Gjykatës, me përbërjen e re, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 04.12.2025, bazuar në nenin 36, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Organik të Gjykatës, ka pranuar edhe kërkesën për heqjen dorë të një anëtari tjetër.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë i janë cenuar:

12.1. *E drejta për fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme,* e parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe *e drejta për ndihmë*

në kushtet e mbetjes pa punë për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij, e parashikuar nga neni 52, pika 2, i Kushtetutës. Pretendimet e tij për këto të drejta kushtetuese nuk janë marrë parasysh nga gjykatat e zakonshme dhe veçanërisht nga Gjykata e Lartë. Ministria e Mbrojtjes i ka ndërprerë pagën pa marrë vendim për risistemimin ose lirimin e tij, duke e mbajtur në statusin e ushtarakut aktiv për periudhën 20.11.2013 – 05.09.2014. Kërkuesi, për shkak të kufizimeve të nenit 167 të Kushtetutës, nuk mund të punësohej në vend tjetër, ndërsa sipas nenit 16 të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji për Statusin e Ushtarakut)*, gëzonte të drejtën e punës së garantuar. Ai ka humbur edhe përfitimin e sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakut. Neni 129 i Kodit të Punës detyron punëdhënësin të paguajë punëmarrësin në rast mosaktivizimi.

12.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi arsyetimi i gjykatave për pamundësinë e Ministrisë së Mbrojtjes për ta paguar pas kalimit të afatit 2-mujor është arbitrar në këndvështrimin kushtetues, duke cenuar edhe *parimin e sigurisë juridike*. Gjykatat nuk kanë vlerësuar detyrimin e këtij organi për ta risistemuar brenda këtij afati. Gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar shkakun ligjor të padisë. Gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pyetjes nëse lirimi nga detyra është i njëjtë me lirimin nga shërbimi aktiv ose statusin e ushtarakut të liruar nga detyra, të cilit nuk i jepet punë nga punëdhënësi. Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje se përse pretendimet e tij të ngritura në rekurs nuk parashikoheshin nga ligji, duke cenuar edhe të *drejtën për akses substancial* e *atë të ankimit*.

12.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi edhe pse për çështjen e mbajtjes së ushtarakëve në dispozicion kishte qëndrime të ndryshme të gjykatave, Gjykata e Lartë nuk ka vendosur njësimin e praktikës. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në një rast tjetër ka mbajtur qëndrim tërësisht të ndryshëm me atë të çështjes së kërkuesit.

13. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

13.1. Pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, ndaj nuk i përkasin juridiksionit kushtetues.

13.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme* dhe *së drejtës për ndihmë në kushtet e mbetjes pa punë për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij* janë të pabazuara. Neni 26 i Ligjit për Karrierën Ushtarake ndalon shprehimisht pagimin e pagës tej afatit ligjor 2-mujor kur ushtaraku nuk është emëruar në detyrë tjetër. Kërkuesi gjatë periudhës që ka kërkuar të paguhet nuk ka kryer punë konkrete, reale dhe efektive, ndaj vazhdimi i pagesës tej afatit ligjor ishte shkelje e dispozitave ligjore dhe kapërcim i kompetencave të Ministrisë së Mbrojtjes.

13.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* nuk qëndron, pasi çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në përputhje me ligjin. Neni 4 i Kodit të Punës përjashton nga fusha e zbatimit të tij çështjet e punësimit të personave që rregullohen me ligj të veçantë, siç janë ushtarakët, ndaj referimi në nenin 129 të atij Kodi nuk qëndron. Neni 26 i Ligjit për Karrierën Ushtarake përcakton qartë ndalimin e pagesës tej afatit 2-mujor të vënies në dispozicion. Gjykatat janë shprehur në mënyrë shteruese për pretendimet e kërkuesit, në respektim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese.

14. ***Subjekti i interesuar, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

15. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në

Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kundërshton vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin nuk është pranuar rekursi i tij ndaj vendimeve gjyqësore që kanë rrëzuar padinë e tij për të drejtat që rrjedhin nga statusi i ushtarakut, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar. Ai e ka përmbushur edhe *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion,* të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin e tij gjyqësor. Po kështu, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kundërshton vendimin e datës 18.12.2024 të Gjykatës së Lartë dhe ankimin kushtetues e ka paraqitur në datën 03.04.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme, të drejtën për ndihmë në kushtet e mbetjes pa punë për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij, të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit të lidhur me sigurinë juridike, aksesin substancial dhe ankimit, si dhe parimin e barazisë përpara ligjit. Në thelb, kërkuesi pretendon se, përmes arsyetimit të saj, Gjykata e Lartë ka lejuar një interpretim të ligjit që ka sjellë cenimin e së drejtës për punë, në kuptimin që ai, nga njëra anë, ndalohej të punonte sipas nenit 167 të Kushtetutës dhe, nga ana tjetër, nuk i takonte e drejta e pagës gjatë kohës që ishte ushtarak aktiv në dispozicion. Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit, ndaj çështja nuk i përket juridiksionit kushtetues.

18. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se detyra e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është të vlerësojnë provat dhe të interpretojnë ligjin për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë*

23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Mbi bazën e këtij standardi dhe duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve të kërkuesit, Gjykata vlerëson se çështja ka të bëjë me të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar të lidhur me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, të garantuara nga nenet 49 dhe 42 të Kushtetutës, ndaj ndryshe nga sa prapëson subjekti i interesuar, çështja hyn në juridiksionin kushtetues dhe në vijim do të analizohet themeli i saj. Brenda të njëjtit këndvështrim dhe për aq sa është i zbatueshëm parimi i barazisë para ligjit, Gjykata do t'u japë përgjigje edhe argumenteve të palëve lidhur me qëndrimin e ndryshëm që Gjykata e Lartë ka mbajtur në çështje të tjera të ngjashme.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit në lidhje me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme

19. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa marrë parasysh pretendimet e tij për interpretimin arbitrar të dispozitave të Ligjit për Karrierën Ushtarake nga gjykatat e zakonshme. Sipas tij, gjykatat nuk kanë konsideruar faktin se pas kalimit të afatit ligjor 2-mujor, Ministria e Mbrojtjes e ka mbajtur kërkuesin në dispozicion, pa marrë masa për sistemimin ose lirimin e tij nga detyra e ushtarakut aktiv dhe duke i ndërprerë pagën padrejtësisht. Për rrjedhojë, kërkuesi ka qenë në pamundësi për t'u punësuar në një punë tjetër, si dhe i është hequr mundësia për të përfituar nga sigurimi shoqëror suplementar si ushtarak. Po sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë vlerësuar detyrimin e ministrisë për risistemimin e tij brenda afatit ligjor dhe nuk kanë sqaruar nëse lirimi nga detyra barazohej me lirimin nga shërbimi aktiv.

20. Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes, ka prapësuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë gjykatat e faktit janë shprehur në mënyrë shteruese për pretendimet e kërkuesit. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, neni 26 i Ligjit për Karrierën Ushtarake ndalon shprehimisht pagimin e pagës tej afatit ligjor 2-mujor kur ushtaraku nuk është emëruar në detyrë tjetër. Gjatë periudhës që ka kërkuar të paguhet, kërkuesi nuk ka kryer punë konkrete, reale dhe efektive, ndaj vazhdimi i pagesës tej afatit ligjor përbënte shkelje të dispozitave ligjore dhe kapërcim të kompetencave të Ministrisë së Mbrojtjes.

21. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar i garantohet

individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

